Laura Shuteriqi
Mimoza Naka
Adriana Keco
Agim Vranovci
Marsida Çobo
Vlora Bunjaku

LIBËR PËR MËSUESIN

ABETARE



dukagjini
shtëpia botuese publishing house

BOTIME
pegi

ABETARE E PËRBASHKËT SHQIPËRI-KOSOVË
Fituese në konkursin e përbashkët të shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit
e Republikës së Shqipërisë dhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
e Republikës së Kosovës

Korrik 2022

Redaktorë gjuhësorë: Fatjon ZEKAJ

Korrektore letrare: Mariola PORO, Bleina ÇIZMJA

Arti grafik: Elvis BEJTJA, Shend TIGANI

Koordinatore projekti: Msc. Arlinda RRUSHI

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © Dukagjini & Pegi.
Të gjitha të drejtat lidhur me këtë botim janë ekskluzivisht të zotëruara nga Botime "Dukagjini", Kosovë dhe "Pegi", Shqipëri. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër
qarkullimi tregtar pjesërisht ose tërësisht pa miratimin paraprak nga botuesi

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016:811.18(072) (075.2)

Abetare : libër për mësuesin / Laura Shuteriqi ... etj. - Prishtinë : Dukagjini, 2022. - 630 f. : ilustr. ; 29 cm.

Gjuha shqipe -- Abetare -- Tekste për mësuesit -- Tekste për shkolla fillore
1. Shuteriqi, Laura 2. Vranovci, Agim 3. Naka, Mimoza 4. Çobo, Marsida 5. Keco, Adriana 6. Bunjaku, Vlora

ISBN 978-9951-05-724-0

Adresa: Rruga "Hajdar Dushi", nr. 27, Prishtinë
E-mail: info@dukagjinipublishing.com
Web: www.dukagjinibotime.com
Cel.: +383 38 24 40 31

Adresa: Rruga e Elbasanit, Pallati Filipeu, nr. 2, Tiranë
E-mail: botimepegi@botimepegi.al
Web: www.botimepegi.al
Cel.: +355 69 40 075 02

ABETARJA E PËRBASHKËT MBARËKOMBËTARE

1. Hyrje

Ndër vite, Abetarja e gjuhës shqipe ka qenë dhe është një nga mjetet kryesore për ta mbajtur të bashkuar kombin shqiptar. Mësimi i gjuhës shqipe përmes abetares ka luajtur rolin e bashkimit kombëtar, si dhe të arsimimit e edukimit të shqiptarëve kudo ku kanë qenë dhe kudo ku abetaret janë përdorur. Ato nuk i kanë munguar gjuhës shqipe. Janë hartuar dhe shtypur më shumë se 170 abetare deri sot nga atdhedashësit e arsimuar shqiptarë të të gjitha trevave, kudo ku ata kanë jetuar: në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në diasporën e vjetër dhe të re.

Edhe Abetarja e përbashkët e vitit 2022 vjen në vazhdën e përpjekjeve të arsimdashësve të kombit shqiptar për të ruajtur, pasuruar dhe trashëguar gjuhën dhe kulturën shqipe.
Abetarja e re vjen sot me një sërë elementesh të reja dhe bashkëkohore, si në aspektin metodologjik, didaktik e gjuhësor, që lidhen me procesin e lexim-shkrimit fillestar.
Ka një këndvështrim krejt të ri në zbatimin e metodave bashkëkohore të lexim-shkrimit. Ato janë të gërshetuara në mënyrë funksionale me njëra-tjetrën. Janë gërshetuar në mënyrë krejt të dukshme elementet e metodave *fonike-alfabetike, silabike, analitike-sintetike e më gjerë.*
Elementet e metodës analitike-sintetike janë tepër të dallueshme dhe e përshkojnë tekstin përgjatë gjithë shtrirjes së tij.
Gjithashtu, në brendësi të tekstit zbatohen metoda dhe teknika bashkëkohore të lexim-shkrimit fillestar dhe të zhvillimit të mendimit kritik.
Përmbajtja tematike e Abetares është krejt e re dhe reflekton një kontekst të ri social e kombëtar të shoqërisë shqiptare Shqipëri-Kosovë e më gjerë.

2. RISI

Disa nga tiparet e Abetares së re janë:

- Abetarja mbështetet në përmbajtje, metodologji e praktika bashkëkohore të të nxënit.
- Abetarja, përmes lëndës përmbajtjesore, aplikative të përfshirë brenda saj, synon të përmirësojë cilësinë e lexim-shkrimit fillestar. Ta bëjë atë të kuptimshëm, logjik e kritik.
- Mbështetet në veprimtari ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat ngërthejnë dhe lidhin fort nxënësin me librin.
- Ruan dhe respekton në përpikëri standardin e gjuhës shqipe duke përdorur një fjalor të përshtatshëm dhe të kuptueshëm për moshën.
- Dialektet, si burim i pashtershëm i gjuhës shqipe, janë të përfshira në leksikun e këtij teksti, në forma të ndryshme përmes fjalëve që tashmë janë bërë pjesë të standardit.
- Është e shoqëruar me variantin digjital, i cili do t'i japë një hapësirë të gjerë mësimit të gjuhës shqipe në shkollë dhe përtej saj.

Është e shoqëruar me "Fletoren e punës", e cila ka zënë një vend të rëndësishëm në këtë paketë, duke qenë e pasur me ushtrime nga më të ndryshmet.

- Është e shoqëruar me një libër mësuesi , i cili do të mundësojë dhe ndihmojë mësuesit në përgatitjen e tyre të përditshme për planifikimin dhe modelimin e mësimdhënies së suksesshme, përgatitur nga mësuese me kompetencë e përvojë të duhur.
- Abetarja e re synon të pasqyrojë plotësisht kërkesat e paketës të re kurrikulare, duke u mbështetur në kritere të reja shkencore dhe metodike, si dhe duke u mbështetur në kompetenca të të nxënit, të cilat zbërthehen në tekstin e mësuesit orë pas ore dhe ofrojnë forma pune për të arritur kompetencën e kërkuar për çdo fushë studimi të përshkruar në kornizën e programit për këtë tekst.
- Abetarja sjell të zbatuar në mënyrë krijuese një informacion të ri edukativ, një kontekst të ri social.
- Si nismë mbarëkombëtare, Abetarja do të përmbushë interesat e fëmijëve shqiptarë në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Malin e Zi, në diasporë dhe të të gjithë atyre që duan ta mësojnë gjuhën shqipe.
- Të mësuarit kontekstual, me fusha tematike, është një parim tjetër që respektohet në këtë Abetare. Bashkëveprimi dhe puna në grupe zënë vend të dukshëm gjatë shtrirjes së materialit përgjatë gjithë tekstit, duke ndikuar në cilësinë e të nxënit të nxënësve.

3. Struktura e Abetares

Abetarja ka një strukturë të thjeshtë, të kuptueshme, të aplikueshme. Ajo është e ndarë në tri pjesë:

- Pjesa përgatitore;
- Pjesa e Abetares;
- Pjesa e përforcimit (leximе).

Struktura e çdo pjese është një risi më vete. Ato drejtohen nga parime të përcaktuara didaktike.

Pjesa e parë (përgatitore) shoqërohet me veprimtari të gjera, të larmishme dhe integruese, ku dalin në pah disa elemente të leximshkrimit, si: njohja dhe leximi i shkronjave, bashkimi i shkronjave në rrokje, njohja e zanoreve, njohja e bashkëtingëlloreve, formimi i disa fjalëve të thjeshta në mënyrë globale, por edhe analitike-sintetike, të cilat janë rrokje-fjalë, të llojit: *ma, ka, la, kap,* të cilat fitohen përmes lojës me njëri-tjetrin, nën udhëheqjen e mësuesit/es, përmes këngës, vizatimit, manipulimit me etiketa shkronjash gjatë punës në grupe etj. Ajo janë shumë tërheqëse dhe zbavitëse për nxënësit, realizohen me mjete të thjeshta rrethanore, por edhe përmes variantit digjital tashmë i gatshëm për të pasuruar didaktikën e zbatimit të kësaj abetareje. Veprimtaritë e pjesës përgatitore e përgatitin nxënësin për të fituar disa shprehi të thjeshta leximi, të cilat ndihmojnë tepër në fazat e mëtejshme të fitimit të shprehive të leximshkrimit logjik dhe të kuptueshëm nga ana e tyre. Kjo fazë ndihmon për eliminimin e leximit global, i cili dëmton të lexuarit logjik dhe të kuptueshëm. Nxënësi shkon në periudhën e dytë të të mësuarit të leximshkrimit me shkronja të mësuara, por jo si një lexues i rregullt, por si një lexues i pajisur me disa elemente leximi dhe shkrimi.

Në këtë pjesë janë përdorur edhe elemente të metodave fonetike-alfabetike, silabike, globale, analitike-sintetike, të cilat gërshetohen së bashku jo vetëm në këtë pjesë, por edhe gjatë shtrirjes në të gjithë tekstin. Ato janë përdorur të limituara, duke u dhënë mundësinë fëmijëve që të hyjnë në procesin e leximshkrimit gradualisht pa vështirësi konjitive dhe psikologjike.

Nëpërmjet kësaj periudhe synohet të aftësohen fëmijët për të folur, për ta pasuruar fjalorin bazë, për t'i risistemuar strukturat gjuhësore të fituara në këtë moshë, për unifikimin e një gjuhe të përbashkët

shkollore, për shmangien e streseve të moshës të diktuara nga mjedisi i ri (shkolla), për zhvillimin e një sërë aftësish motorike të nevojshme për lexim-shkrimin etj., për artikulimin fonetik të alfabetit, për njohjen e shkronjave e formimin e disa rrokjeve dhe fjalëve të shkurtra rrokje-fjalë.
Lexim-shkrimi paraprihet nga një periudhë përgatitore e organizuar me shumë vëmendje dhe e studiuar mirë në planin metodave të respektuara, duke nisur nga metoda fonike alfabetike, silabike dhe në vijim duke kaluar në atë analitike-sintetike.
Këto metoda janë përdorur të gërshetuara dhe ndryshe i quajmë ***metoda mikse*, DIVIZA** jonë metodologjike që përshkon tërë Abetaren.
Kjo zgjedhje metodologjike i përshtatet kapacitetit konjitiv të një fëmije 6-vjeçar, në aftësitë njohëse të tij për të lexuar, aftësi këto që ka nisur t'i marrë në parapërgatitjen e bërë që në klasat e arsimit parashkollor.
Përmes veprimtarive kreative, lojërave, interaktivitetit, kjo pjesë e parë e librit synon të futë fëmijët me lehtësi në botën e madhe të librit, në procesin e fitimit të lexim-shkrimit.

Në këtë pjesë të parë, përmes metodave të sipërpërmendura dhe teknikave të të nxënit, nxënësit mësojnë: *alfabetin e gjuhës shqipe* dhe *lidhin tingullin me shenjën* (shkronjën). Kënga e alfabetit që e shoqëron këtë fazë, bashkë me shkronjat e alfabetit, janë një hyrje entuziaste në botën e madhe të librit të parë, Abetares.
Njohja e zanoreve përmes një veprimtarie hulumtuese të nxënësve bën që ata të fiksojnë në kujtesën e tyre shtatë tingujt dhe shtatë shkronjat që u korrespondojnë.
Në fazën fillestare, në vijim të metodës alfabetike, kalohet në një moment të rëndësishëm, në atë të sintezës, bashkimit të dy shkronjave në një rrokje. Këtu kemi zbatimin e metodës silabike, e cila bën të mundshme që nxënësit të nisin të kuptojnë se shkronjat, duke u bashkuar me njëra-tjetrën, krijojnë rrokje/fjalë:

MA, KA, DI, PA, PI, LA, KAM.

Moment thelbësor ky, i cili duhet vlerësuar mirë nga çdo mësues/e. Mësuesi/ja duhet t'i shumëfishojë këta shembuj dhe të përdorë etiketa të thjeshta shkronjash lëvizore për të realizuar veprimtari të kësaj natyre. Por, për këtë qëllim, shumë lehtë mund të përdorë edhe platformën digjitale.

Ai/ajo duhet t'i ushtrojë sa më shumë nxënësit për të krijuar rrokje/fjalë me dy ose tri shkronja.
Ajo që ka rëndësi këtu është se nëse mësuesit arrijnë t'i bëjnë fëmijët të njohin të gjitha shkronjat, t'i shkruajnë ato të veçuara dhe të bashkuara (dy-tri bashkë), atëherë ka ndodhur diçka shumë e rëndësishme: **Kemi shmangur metodën globale deri në 0,** e cila pengon leximin e kuptimshëm, duke nxitur një të lexuar mekanik.

Pjesë e dytë e Abetares lidhet drejtpërsëdrejti me procesin e lexim-shkrimit të kuptimshëm. Kjo pjesë është e ndarë në gjashtë module, ku në secilin prej tyre punohen nga gjashtë shkronja të renditura sipas një qëndrimi shkencor dhe të vendosura sipas shkallës së shpeshtësisë së tyre në tekstet e shkruara të

gjuhës shqipe. Çdo modul shoqërohet me një përsëritje për çdo grup shkronjash dhe me fletë pune kontrolluese për shkallën e përvetësimit të tyre, e cila ndodhet në fletoren e punës.

Struktura e faqes për çdo shkronjë lidhet me prezantimin e tingullit /shkronjës. Shoqërohet me një ilustrim masiv, i cili zbaton parimin tematik ku përmes simboleve të vendosura anash faqes, kërkohet që nxënësit të shohin (*syri*), të dëgjojnë (*veshi*), të flasin (*goja*). Prezantimi i temës, përdorimi i fjalorit që lidhet me të duke pasuruar leksikun, janë një gjetje e rëndësishme për zhvillimin e të folurit të fëmijëve. Më tepër, faqja përkatëse pasqyron ushtrime të larmishme dhe forma të reja të përdorura për herë të parë, që lidhen me punën me tingullin/shkronjën, me rrokjen dhe me fjalën.

Çdo faqe e Abetares është e shoqëruar me një sistem shenjash e simbolesh që orientojnë nxënësit, të cilët ende nuk dinë të lexojnë dhe të shkruajnë, në lidhje me aktivitetin që do të kryhet. Disa prej tyre janë:

- *Veshi* - për të dëgjuarit;
- *goja* - për të folurit;
- *libri* - për të lexuarit;
- *lapsi* - për të shkruarit etj.

Njëkohësisht, këto simbole tregojnë edhe kërkesat që ka programi për çdo fushë studimi dhe kompetencat që duhet të arrihen për çdonjërën fushë, në përshtatje me kornizën e programit të Abetares të përfshirë në paketën e ofruar nga MAShTI dhe MAS-i.

Në çdo faqe është bërë kujdes që në mënyrë të përshkallëzuar të paraqiten tekste që lidhen me temën bazë të faqes, duke nisur me tekste sa më të thjeshta, të shkurtra e tërheqëse për botën e fëmijëve. Këto tekste vazhdimisht shoqërohen me një aparat pedagogjik (pyetje-përgjigje, situata alternative përmes të cilave nxënësit duhet të lexojnë, të kërkojnë përgjigjen në tekst, ta nënvizojnë atë, ta përshkruajnë apo ta argumentojnë në mënyrë të thjeshtë.
Për herë të parë në Abetare është përfshirë edhe një rubrikë e re, "Shtëpia e fjalëve", e cila shpjegon në mënyrë të thjeshtë kuptimin e fjalëve të reja të cilat nxënësit i ndeshin për herë të parë.

Pjesa e periudhës së mësimit të Abetares është shumë e rëndësishme. Metoda analitike-sintetike e përshkon këtë periudhë, është përdorur me mjaft kujdes dhe e gërshetuar më së miri me metodat e tjera të lexim-shkrimit. Në këtë periudhë të mësimit të Abetares, elementet globale janë eliminuar plotësisht. Në këtë periudhë jo vetëm që është bërë kujdes që mos përdoren fjalë në të cilat mund të kenë shkronja të pamësuara, por periudha e paraabetares i ka zhdukur këto elemente, pasi shkronjat mësohen që në fazën përgatitore.
Në çdo faqe të Abetares bëhet kujdes që të shqiptohet mirë tingulli i ri që mësohet. Ka kërkesa dhe ushtrime që aktivizojnë të dëgjuarit, të folurit, përshkrimin e fabulave në qendër të faqes, të cilat më pas krijojnë dhe tekstin e lidhur. Ushtrimet e larmishme për shqiptimin dhe gjetjen e tingujve dhe shkronjave përkatëse, plotësimin e rrokjeve në fjalë ku ato mungojnë, gjetjen e tyre në strukturë të fjalës, në

pozicione të ndryshme, ndarjen në rrokje, duke zbritur deri në analizën dhe sintezën e fjalëve, e bëjnë çdo faqe të Abetares të jetë interaktive, e larmishme dhe shumë tërheqëse.

Çështjet gjuhësore që lidhen edhe me sistemin gramatikor e drejtshkrimor të gjuhës shqipe janë pjesë e punës në çdo faqe të Abetares. Aty zë vend të dukshëm puna me analizën dhe sintezën e fjalisë, çështje të fjalëformimit dhe drejtshkrimit të fjalëve, të shenjave të pikësimit, të përdorimit të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë, të pikës e pikëpyetjes në fund të saj.

Në këtë pjesë të Abetares, një vend të rëndësishëm zë edhe puna me tekstet e lidhura përmes fabulave që janë ofruar. Tematika e tyre lidhet kryesisht me botën e fëmijëve. Ato janë shumë tërheqëse dhe nxënësit gjejnë veten, jetën e tyre të përditshme. Larmia tematike e teksteve, lidhja me botën e fëmijëve dhe interesat e tyre, e bën Abetaren shumë bashkëkohore dhe të përshtatshme me kontekstin social të shoqërisë shqiptare të kësaj kohe.

Njëkohësisht, puna me tekstet e lidhura synon të ushtrojë në mënyrë intuitive nxënësit për të marrë konceptin e fjalisë dhe mjaft elemente të gramatikës, gjithmonë në mënyrë intuitive: përdorimi i shenjave të pikësimit, shkronja e madhe, fjalët që tregojnë cilësi, fjalët që tregojnë veprime etj.

Në çështjen e ushtrimit të të lexuarit të teksteve të lidhura, është bërë kujdes që të ofrohet edhe një aparat pedagogjik i thjeshtë, por që nxit të lexuarit dhe që i kthen nxënësit te teksti duke kërkuar, gjetur, nënvizuar, ndërvepruar dhe punuar në grup me tekstin, si dhe duke nxitur të menduarit kritik.

Të mësuarit për të lexuar përmes lojës, hulumtimit, ndërveprimit janë aspekte didaktike që shoqërojnë Abetaren në të gjitha faqet e saj dhe kanë sjellë një risi tjetër në këtë tekst.

Ne kërkojmë që në çdo kërkesë të ushtrimeve ta drejtojmë nxënësin te teksti për të gjetur atë që i kërkohet.

Shprehitë e të lexuarit dhe të shkruarit përforcohen në ***pjesën e tretë*** të Abetares, e cila synon të rritë më tej cilësinë e të lexuarit.

Në këtë pjesë realizohen disa objektiva që lidhen me përforcimin e cilësisë së lexim-shkrimit. Jepen pjesë letrare me aparate të thjeshta pedagogjike, përmes të cilave kërkohet që nxënësit të lexojnë, të argumentojnë, të krahasojnë, të debatojnë etj.

Gradualisht punohet edhe me fjalinë, rendin e fjalëve në fjali, llojet e fjalive (dëftore, pyetëse), me strukturën e tekstit (hyrje, zhvillim, mbyllje), me karakteristikat e llojeve të teksteve letrare dhe joletrare.

Ofrohen përralla, tregime, vjersha, këshilla, rregulla e informacione të thjeshta, përmes të cilave synohet të përforcohen aftësitë lexuese dhe shkruese, si dhe të nxitet përshkrimi, argumenti, krahasimi e vlerësimi për situata të thjeshta gjuhësore.

Shkrimtarët më në zë të letërsisë shqipe për fëmijë, shqiptarë e kosovarë, por edhe të letërsisë botërore, kanë zënë vend në këtë pjesë të librit.

Ilustrimet që i shoqërojnë këto pjesë janë tërheqëse dhe përcjellin shumë mesazhe edukative. Ato trajtojnë tema të kohës për botën e fëmijëve: *për lojën, për shëndetin, për mjedisin dhe më gjerë.*

Sigurisht, përmes tyre punohet në mënyrë fare të thjeshtë edhe për evidentimin e karakteristikave strukturore të teksteve të tipave të ndryshëm, të fjalive, shenjave të pikësimit etj.

4. Fletorja e punës

Paralelisht me të lexuarit dhe ushtrimet rreth tij ecin edhe elementet e shkrimit, kryesisht përmes fletores së punës, ku gjenden ushtrime të ndryshme gjuhësore që përfshijnë aspektin e bukurshkimit, të diktimit, të kopjimit dhe të shkrimit krijues dhe vetjak, pjesë e punës me këtë fletore, duke përmbushur kërkesat e programit.

Duke nisur nga shkronja te rrokja, te fjala, në këtë fletore janë përfshirë edhe elemente të bukurshkrimit, drejtshkrimit, kopjimit të shkrimit. Ne e vlerësojmë shumë shkrimin e dorës në këtë fletore dhe i kemi lënë vend të konsiderueshëm këtij komponenti të të mësuarit të lexim-shkrimit fillestar. *Ne duam që nxënësit të lexojnë, të mendojnë në mënyrë kritike dhe t'i shkruajnë mendimet.*

Në lidhje me shkrimin, është treguar kujdes që nxënësit të mësojnë t'i shkruajnë mirë shkronjat, t'i lidhin qartë në rrokje dhe fjalë, të respektojnë hapësirat mes fjalëve, të shkruajnë fjalë deri në tri rrokje, të shkruajnë modele të thjeshta të punëve me shkrim: letër, kartolinë, urime; të përshkruajë objekte të thjeshta, edhe tregime të shkurtra me hyrje të gatshme ose me fjalë që mungojnë, të cilat duhet t'i plotësojnë.

Elementet e sistemit gjuhësor kanë zënë vendin e duhur edhe në fletoren e punës dhe janë në përputhje me kërkesat e programit. Ne duam që nxënësi të lexojë dhe të shkruajë mendimin përmes kësaj fletoreje pune, duke përmbushur kërkesat e programit të paketës së ofruar.

5. Platforma digjitale

Platforma digjitale është një tjetër risi e kësaj pakete kurrikulare. Abetarja është e shoqëruar edhe me librin e nxënësit në variantin digjital, si një hap i parë për të punuar *online* me të. Kjo përbën një arritje të rëndësishme të arsimit tonë, që po hedh hapa të sigurt në përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Trajnime të vazhdueshme do ta shoqërojnë formimin e mësuesve me aftësi të duhura digjitale, të mëtejshme, për ta përdorur këtë platformë në mënyrë të suksesshme dhe efikase.

Kjo platformë do të përdoret nga nxënës, mësues, prindër, pasi krijon ndërveprim mes të tria palëve.

6. Libri i mësuesit

Libri i mësuesit është përgatitur nga një grup mësuesesh me përvojë, të cilat edhe janë konsultuar në vazhdimësi gjatë hartimit të Abetares, ku si fokus ka qenë gjithmonë lidhja e ngushtë e dimensionit teorik me atë praktik.

Në librin e mësuesit do të ofrohen drafte alternative të planifikimit të programit dhe zbërthimit të tij analitik. Mësuesit nuk duhet të mbeten peng i këtyre zbërthimeve përmes drafteve ndihmëse, por në mënyrë individuale apo edhe në grupe të hartojnë programet e tyre analitike duke e zbërthyer programin në përshtatje me nevojat e përvojat e tyre, ta përshtatin në mënyrën më të mirë të mundshme, për zbatimin me sukses të kësaj Abetareje.

Në faqet zyrtare në internet të shtëpive botuese "Dukagjini" dhe "Pegi" do të gjeni në vazhdimësi materiale ndihmëse.

Po ashtu, një platformë *online* do të ofrohet për një komunikim të autorëve me mësuesit e klasës së parë në Shqipëri dhe në Kosovë. Kjo platformë do të përmbajë shumë rubrika duke nisur nga programi, modelimi, këshillimi, formimi teorik e të tjera. Do të jetë ndërvepruese, në mënyrë që të gjithë mësuesit të këmbejnë me njëri-tjetrin përvoja të vazhdueshme.

Suksese të gjithëve në rrugën e zbatimit të Abetares së re të gjuhës shqipe!
Mimoza Gjokutaj, Naser Zabeli, Saranda Kumnova-Pozhegu, Tereza Babasuli

	SHKOLLA:			
	PLANI VJETOR:	**2022 /2023**		
	FUSHA E KURRIKULËS:			
	KLASA :			
	MËSIMDHËNËSI/JA:			

Lënda-ët e fushës kurrikulare	**T E M A T M Ë S I M O R E T Ë S H P Ë R N D A R A G J A T Ë M U A J V E**				**Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës I. (Klasa e I-rë.)**	
	GJYSMËVJETORI I PARË		**GJYSMËVJETORI I DYTË**			
	SHTATOR-TETOR (59 orë)	**NËNTOR-DHJETOR (59 orë)**	**JANAR-SHKURT-MARS (74 orë)**	**PRILL–MAJ-QERSHOR (67 orë)**	**I**	**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**
						1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
Lënda: Gjuhë shqipe	Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme. Tingujt, shkronjat,	Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme. Tingujt, shkronjat,	Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme. Tingujt, shkronjat,	Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme. Tingujt, shkronjat,	**II**	**Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ**
						1, 6, 7, 8.
					III	**Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm**
						1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.
					IV	**Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv**

	rrokjet, fjala, fjalia, intonacioni, shenjat e pikësimit, foljet ndihmëse kam dhe jam. Emri, mbiemri, përemri.	rrokjet, fjala, fjalia, intonacioni, shenjat e pikësimit, foljet ndihmëse kam dhe jam. Emri, mbiemri, përemri.	rrokjet, fjala, fjalia, intonacioni, shenjat e pikësimit, foljet ndihmëse kam dhe jam. Emri, mbiemri, përemri.	rrokjet, fjala, fjalia, intonacioni, shenjat e pikësimit, foljet ndihmëse kam dhe jam. Emri, mbiemri, përemri.		2, 3, 4, 5, 6.
					V	**Kompetenca personale – Individ i shëndoshë**
						1, 3, 4, 5, 6, 7.
					VI	**Kompetenca qytetare – Qytetar i Përgjegjshëm**

	Poezia, përrallëza, përralla, tregime, gjëegjëzë, fjalë të urta, mesazhe, urimi letra të thjeshta, porosi, shënime personale.	Poezia, përrallëza, përralla, tregime, gjëegjëzë, fjalë të urta, mesazhe, urimi letra të thjeshta, porosi, shënime personale.	Poezia, përrallëza, përralla, tregime, gjëegjëzë, fjalë të urta, mesazhe, urimi letra të thjeshta, porosi, shënime personale.	Poezia, përrallëza, përralla, tregime, gjëegjëzë, fjalë të urta, mesazhe, urimi letra të thjeshta, porosi, shënime personale. Sinonimet, antonimet hiperbola, krahasimi personifikimi		1, 2, 3, 4, 5, 6.

Shënim:

Ky plan vjetor është një plan i sugjeruar nga ne, por jo i detyrueshëm për zbatim nga mësuesit. Çdo mësues/e, është i/e lirë të hartojë një plan tjetër duke ia përshtatur klasës si dhe kërkesave të nxënësve të tij/saj, gjithmonë në përputhje me programin mësimor.

Ky plan është hartuar në përputhje të plotë me programin e Abetares.

PLANI MËSIMOR I PERIUDHËS I

PLANI:	**SHTATOR - DHJETOR**
VITI SHKOLLOR:	**2022-2023**
FUSHA E KURRIKULËS:	**GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**
LËNDA :	**GJUHË SHQIPE**
KLASA :	**I**

TEMA-T mësimore:	- Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme; - Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta; Mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale; - Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit; Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri.

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit –Komunikues efektiv

I.1 Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;

I.2 Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar;

I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;

I.4 Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur;

I.5 Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit;

I.6 Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët;

I.8 Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimi të një tregimi, shikimi apo performimi të një vallëzimi, dëgjimi apo performimi të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse;

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.7 Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna;

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;

III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit;

III.5 Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë;

III.6 Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;
III.7 Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive;
Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv
IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;
Kompetenca personale – Individ i shëndoshë
V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj;
V.7 Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajte të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.);
Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
VI.5 Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij;
VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Të dëgjuarit dhe të folurit
1.1 Shkëmben ide gjatë diskutimit, bën pyetje dhe përgjigjet duke përdorur mimikën, fjalë dhe fjali të thjeshta;
1.2 Identifikon elementet kryesore dhe konceptet nga tregimet e thjeshta (ngjarjen, personazhet etj.), dallon gjuhën figurative nga ajo jofigurative;
1.4 Përdor përvojat personale në bashkëbisedim;
1.5 Përdor përvojat personale që lidhen me shqetësimet, me interesat dhe me vetëbesimin e tij nëpërmjet bisedave dhe diskutimeve;
1.7 Përcjell informacione nga mjete audio-vizuele (TV, kompjuter etj.);
Të lexuarit
2.1 Përdor strategji për të lexuar me kënaqësi tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë si dhe elementet e përdorimit të gjuhës;
2.2 Lexon me zë tregim të shkurtër dhe përdor pjesë plotësuese të tekstit (foto, vizatim etj.);
2.3 Zhvillon shkathtësitë për të lexuarit e kuptimshëm;
2.4 Përflet apo parafrazon tekstet që ka lexuar;
2.8 Lexon materiale të ndryshme nga mjete audio- vizuale;
Të shkruarit
3.1 Përshkruan tekste sipas modeleve dhe shkruan për të komunikuar idetë e veta me të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive dhe teksteve të shkurtra;
3.5 Shkruan fjalët duke parë figura;
3.7 Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë;
3.8 Përdor drejt shenjat kryesore të pikësimit;

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme	• Kupton elemente të ndryshme kulturore; • Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë; • Përdor drejt fjalët zonjushë, zonjë, zotëri, si dhe përemrat ti, ju kur u drejtohet të rriturve; •Luan role sipas modeleve; • Shfaq kujdes për ambientin që e rrethon;	1. Në shkollë, fq. 6, 7 2. Fletore pune - Në shkollë, fq. 6,7 3. Alfabeti, fq. 8, 9 4. Fletore pune – Alfabeti, fq.8,9 5. A e gjen dot? fq. 10, 11 6. Fletore pune - A e gjen dot? fq.10,11 7. Unë jam, fq. 12, 13 8. Fletore pune - Unë jam, fq. 12, 13 9. Loja me shkronja, fq. 14, 15 10. Fletore pune - Loja me shkronja, fq. 14, 15	118 orë	Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj); Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtim); Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); Diskutim dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit; Mësimdhënie e bazuar në përvojë (lojë me role, dramatizim)	Informata kthyese; Vlerësim i ndërsjellë; Listë kontrolli; Dy yje, një dëshirë; Dosja personale;	Matematika Njeriu dhe natyra Shoqëria dhe mjedisi Shkathtësi për jetë Edukatë figurative Edukatë muzikore **Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**	Abetarja Fletore pune e abetares Libri digjital Burime nga internet Libra për fëmijë Fjalori i gjuhës shqipe

Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri. Poezia, përrallëza, përralla, tregimi. Gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.	• Ndërton mirë fjalitë dhe shqipton me intonacionin e duhur; • Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali; • Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë; • Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit; • Shkruan fjalë duke parë figura; • Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat; • Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse; •Përdor lojën për të mësuar;	11. Klasa ime, fq. 16, 17 12. Fletore pune - Klasa ime, fq. 16,17 13. Shkronja A, fq. 18 14. Fletore pune, fq. 18-19 15. Shkronja A, fq. 19 16. Fletore pune, fq. 19-20 17. Shkronja I, fq. 20 18. Fletore pune, fq. 21-22 19. Shkronja I, fq. 21 20. Fletore pune, fq. 22-23 21. Shkronja M, fq. 22 22. Fletore pune, fq. 24-25 23. Shkronja M, fq. 23 24. Fletore pune, fq.25- 26 25. Shkronja R, fq. 24 26. Fletore pune, fq. 27-28 27. Shkronja R, fq. 25 28. Fletore pune, fq.28-29 29. Shkronja E, fq. 26 30. Fletore pune, fq. 30-31 31. Shkronja E, fq. 27 32.Fletore pune, fq.31- 32 33. Shkronja U, fq. 29				Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm. Edukimi për qytetari demokratike	

	• Dallon elemente themelore të poezisë nga proza; • Flet në mënyrë të pavarur për një tekst të shkurtër letrar ose jo letrar; • Përflet ngjarjen kryesore në tekst; • Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara; • Identifikon mjetet audio-vizuale dhe ato të teknologjisë informative dhe i përdorë ato për të dëgjuar, për të komunikuar dhe për të bërë regjistrime; ;	34. Fletore pune, fq. 33-34 35. Shkronja U, fq. 30 36. Fletore pune, fq.34- 35 37. Përsëritje 1, fq.30 38. Fletore pune, fq.36, 37 39. Përsëritje 1, fq.31 40. Shkronja N, fq.32 41. Fletore pune, fq.38 42. Shkronja N, fq.33 43. Fletore pune, fq.39 44. Fletore pune, fq.40 45. Shkronja Ë, fq. 34 46. Fletore pune, fq.41 47. Shkronja Ë, fq. 35 48. Fletore pune, fq.42 49. Fletore pune, fq.43 50. Shkronja O, fq. 36 51. Fletore pune, fq.44 52. Shkronja O, fq. 37 53. Fletore pune, fq.45 54. Fletore pune, fq.46 55. Shkronja L, fq. 38 56. Fletore pune, fq.47 57. Shkronja L, fq. 39					

		58. Fletore pune, fq.48 59. Fletore pune, fq.49 60. Shkronja K, fq. 40 61. Fletore pune, fq.50 62. Shkronja K, fq. 41 63. Fletore pune, fq.51 64. Fletore pune, fq.52 65. Shkronja J, fq. 42 66. Fletore pune, fq.53 67. Shkronja J, fq. 43 68. Fletore pune, fq.54 69. Fletore pune, fq.55 70. Përsëritje 2, fq. 44 71. Fletore pune, fq.56, 57 72. Përsëritje 2, fq. 45 73. Shkronja P, fq. 46 74. Fletore pune, fq.58 75. Shkronja P, fq. 47 76. Fletore pune, fq.59 77. Fletore pune, fq.60 78. Shkronja B, fq. 48					

		79. Fletore pune, fq.61-62 80. Shkronja B, fq. 49 81. Fletore pune, fq.62-63 82. Shkronja B, fq. 48-49 83. Shkronja T, fq. 50 84. Fletore pune, fq.64-65 85. Shkronja T, fq. 51 86. Fletore pune, fq.65-66 87. Shkronja T, fq. 50-51 88. Shkronja D, fq. 52 89. Fletore pune, fq.67-68 90. Shkronja D, fq. 53 91. Fletore pune, fq.68-69 92. Shkronja D, fq. 52 - 53 93. Shkronja S, fq. 54 94. Fletore pune, fq.70-71 95. Shkronja S, fq. 55 96. Fletore pune, fq.71-72 97. Shkronja S, fq. 54 - 55 98. Shkronja H, fq. 56 99. Fletore pune, fq.73-74 100. Shkronja H, fq. 57 101. Fletore pune, fq.74-75 102. Shkronja H, fq. 56 - 57					

		103. Përsëritje 3, fq.58 104. Fletore pune, fq.76, 77 105. Përsëritje 3, fq.59 106. Shkronja Sh, fq. 60 107. Fletore pune, fq.78-79 108. Shkronja Sh, fq. 61 109. Fletore pune, fq.79-80 110. Shkronja Sh, fq. 60-61 111. Shkronja F, fq. 62 112. Fletore pune, fq.81-82 113. Shkronja F, fq. 63 114. Fletore pune, fq.82-83 115. Shkronja F, fq. 62-63 116. Projekt 1 117. Projekt 1 118. Vlerësim njohurish 1					

PLANI MËSIMOR I PERIUDHËS II

PLANI:	**JANAR - MARS**	
VITI SHKOLLOR:	**2022-2023**	
FUSHA E KURRIKULËS:	**GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**	
LËNDA :	**GJUHË SHQIPE**	
KLASA :	**I**	

TEMA-T mësimore:	- Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme; - Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale; - Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri;

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit –Komunikues efektiv

I.1 Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;

I.2 Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar;

I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;

I.4 Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur;

I.5 Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit;

I.6 Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët;

I.8 Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimi të një tregimi, shikimi apo performimi të një vallëzimi, dëgjimi apo performimi të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse;

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.7 Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna;

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;

III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit;

III.5 Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë;
III.6 Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;
III.7 Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive;
Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv
IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;
Kompetenca personale – Individ i shëndoshë
V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj;
V.7 Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajte të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.);
Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
VI.5 Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij;
VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Të dëgjuarit dhe të folurit
1.1 Shkëmben ide gjatë diskutimit, bën pyetje dhe përgjigjet duke përdorur mimikën, fjalë dhe fjali të thjeshta;
1.2 Identifikon elementet kryesore dhe konceptet nga tregimet e thjeshta (ngjarjen, personazhet etj.), dallon gjuhën figurative nga ajo jofigurative;
1.4 Përdor përvojat personale në bashkëbisedim;
1.5 Përdor përvojat personale që lidhen me shqetësimet, me interesat dhe me vetëbesimin e tij nëpërmjet bisedave dhe diskutimeve;
1.7 Përcjell informacione nga mjete audio-vizuele (TV, kompjuter etj.);
Të lexuarit
2.1 Përdor strategji për të lexuar me kënaqësi tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë si dhe elementet e përdorimit të gjuhës;
2.2 Lexon me zë tregim të shkurtër dhe përdor pjesë plotësuese të tekstit (foto, vizatim etj.);
2.3 Zhvillon shkathtësitë për të lexuarit e kuptimshëm;
2.4 Përflet apo parafrazon tekstet që ka lexuar;
2.5 Identifikon elementet kryesore të një teksti të shkurtër: ngjarjen, personazhet etj., dallon gjuhën figurative (metaforike) nga ajo jofigurative. jep përshtypje në lidhje me një tekst të shkurtër letrar a joletrar;
2.6 Identifikon të dhënat kryesore dhe konceptet nga tregimet e thjeshta;
2.8 Lexon materiale të ndryshme nga mjete audio- vizuale;

Të shkruarit
3.1 Përshkruan tekste sipas modeleve dhe shkruan për të komunikuar idetë e veta me të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive dhe teksteve të shkurtra;
3.5 Shkruan fjalët duke parë figura;
3.7 Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë;
3.8 Përdor drejt shenjat kryesore të pikësimit;
3.9 Përdor teknologjinë informative (për të shkruar fjalë, fjali, numra, simbole, tinguj, vizatime etj.);

Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha e mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore**	**Burimet**
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.	- Kupton elemente të ndryshme kulturore; -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë; -Luan role sipas modeleve; - Ndërton mirë fjalitë dhe shqipton me intonacionin e duhur;	119. Shkronja V, fq. 64 120. Fletore pune, fq.84-85 121. Shkronja V, fq. 65 122. Fletore pune, fq.85-86 123. Shkronja V, fq. 64-65 124. Shkronja Dh, fq. 66 125. Fletore pune, fq.87-88 126. Shkronja Dh, fq. 67 127. Fletore pune, fq.88-89 128. Shkronja Dh, fq. 66-67 129. Shkronja Rr, fq. 68 130. Fletore pune, fq.90-91 131. Shkronja Rr, fq. 69 132. Fletore pune, fq.91-92 133. Shkronja Rr, fq. 68-69 134. Shkronja Q, fq. 70	74 orë	Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj); Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtim); Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); Diskutim dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të	Informata kthyese; Vlerësim i ndërsjellë; Listë kontrolli; Dy yje, një dëshirë; Dosja personale;	Matematika Njeriu dhe natyra Shoqëria dhe mjedisi Shkathtësi për jetë Edukatë figurative Edukatë muzikore	Abetarja Fletore pune e abetares Libri digjital Burime nga internet

Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat pikësimit intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri. Poezia, përrallëza, përralla, tregimi. Gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.	-Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali; - Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë; -Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit; -Shkruan fjalë duke parë figura; -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat; -Identifikon mjetet audio-vizuale dhe ato të teknologjisë informative dhe i përdorë ato për të dëgjuar, për të komunikuar dhe për të bërë regjistrime; - Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa	135. Fletore pune, fq.93-94 136. Shkronja Q, fq. 71 137. Fletore pune, fq.94-95 138. Shkronja Q, fq. 70-71 139. Përsëritje 4, fq.72 140. Fletore pune, fq.96-97 141. Përsëritje 4, fq.73 142. Shkronja G, fq. 74 143. Fletore pune, fq. 98-99 144. Shkronja G, fq. 75 145. Fletore pune, fq. 99-100 146. Shkronja G, fq. 74 - 75 147. Shkronja C, fq. 76 148. Fletore pune, fq. 101-102 149. Shkronja C, fq. 77 150. Fletore pune, fq. 102-103 151. Shkronja C, fq. 76 - 77 152. Shkronja Ç, fq. 78 153. Fletore pune, fq.104-105 154. Shkronja Ç, fq. 79 155. Fletore pune, fq.105-106 156. Shkronja Ç, fq. 78 - 79 157. Shkronja Gj, fq. 80 158. Fletore pune, fq.107-108 159. Shkronja Gj, fq. 81 160. Fletore pune, fq.108-109 161. Shkronja Gj, fq. 80 – 81 162. Shkronja Ll, fq. 82 163. Fletore pune, fq.110-111 164. Shkronja Ll, fq. 83 165. Fletore pune, fq.111-112 166. Shkronja Ll, fq. 82 - 83 167. Shkronja Y, fq. 84 168. Fletore pune, fq.113-114 169. Shkronja Y, fq. 85 170. Fletore pune, fq.114-115		vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit; Mësimdhënie e bazuar në përvojë (lojë me role, dramatizim)		**Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm. Edukimi për qytetari demokratike	Libra për fëmijë Fjalori i gjuhës shqipe

	gabime dhe në mënyrë shprehëse; -Përdor lojën për të mësuar; -Dallon elemente themelore të poezisë nga proza; -Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara. -Përflet ngjarjen kryesore në tekst; -Dallon pjesët e shkruara nga pjesët e ilustruara; - Flet në mënyrë të pavarur për një tekst të shkurtër letrar ose jo letrar;	171. Përsëritje 5, f. 86 172. Fletore pune, fq.116-117 173. Përsëritje 5, 87 174. Shkronja Nj, fq. 88 175. Fletore pune, fq.118-119 176. Shkronja Nj, fq. 89 177. Fletore pune, fq.119-120 178. Shkronja Th, fq. 90 179. Fletore pune, fq.121-122 180. Shkronja Th, fq. 91 181. Fletore pune, fq.122-123 182. Shkronja X, fq. 92 183. Fletore pune, fq.124-125 184. Shkronja X, fq. 93 185. Fletore pune, fq.125-126 186. Shkronja Z, fq. 94 187. Fletore pune, fq.127-128 188. Shkronja Z, fq. 95 189. Fletore pune, fq.129-130 190. Projekt 2 191. Projekt 2 192. Vlerësim njohurish 2					

	PLANI:	**PRILL - MAJ - QERSHOR**
	VITI SHKOLLOR:	**2022-2023**
	FUSHA E KURRIKULËS:	**GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**
	LËNDA :	**GJUHË SHQIPE**
	KLASA :	**I**

TEMA-T mësimore:	- Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme; - Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale; - Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri;-Sinonimet, antonimet, hiperbola, krahasimi, personifikimi.

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit –Komunikues efektiv

I.1 Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;

I.2 Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar;

I.3 Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash;

I.4 Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur;

I.5 Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit;

I.6 Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët;

I.8 Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimi të një tregimi, shikimi apo performimi të një vallëzimi, dëgjimi apo performimi të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse;

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.6 Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën në një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse;

II.7 Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna;

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1 Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;

III.2 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj;

III.3 Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit;

III.4 Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;

III.5 Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë;
III.6 Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale;
III.7 Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive;
Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv
IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj);
IV.3 Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar;
IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet;
IV.6 Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta (të shëndetshme) dhe anasjelltas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes;
Kompetenca personale – Individ i shëndoshë
V.4 Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët**;**
V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj;
V.7 Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajte të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.);
Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
VI.1 Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë;
VI.2 Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.;
VI.3 Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar;
VI.5 Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij;
VI.6 Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Të dëgjuarit dhe të folurit
1.1 Shkëmben ide gjatë diskutimit, bën pyetje dhe përgjigjet duke përdorur mimikën, fjalë dhe fjali të thjeshta;

1.2 Identifikon elementet kryesore dhe konceptet nga tregimet e thjeshta (ngjarjen, personazhet etj.), dallon gjuhën figurative nga ajo jofigurative;
1.3 Jep përshtypjen për një tekst të shkurtër letrar;
1.4 Përdor përvojat personale në bashkëbisedim;
1.5 Përdor përvojat personale që lidhen me shqetësimet, me interesat dhe me vetëbesimin e tij nëpërmjet bisedave dhe diskutimeve;
1.7 Përcjell informacione nga mjete audio-vizuele (TV, kompjuter etj.);
Të lexuarit
2.1 Përdor strategji për të lexuar me kënaqësi tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë si dhe elementet e përdorimit të gjuhës;
2.2 Lexon me zë tregim të shkurtër dhe përdor pjesë plotësuese të tekstit (foto, vizatim etj.);
2.3 Zhvillon shkathtësitë për të lexuarit e kuptimshëm;
2.4 Përflet apo parafrazon tekstet që ka lexuar;
2.5 Identifikon elementet kryesore të një teksti të shkurtër: ngjarjen, personazhet etj., dallon gjuhën figurative (metaforike) nga ajo jofigurative. jep përshtypje në
lidhje me një tekst të shkurtër letrar a joletrar;
2.8 Lexon materiale të ndryshme nga mjete audio- vizuale;
Të shkruarit
3.1 Përshkruan tekste sipas modeleve dhe shkruan për të komunikuar idetë e veta me të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive dhe teksteve të shkurtra;
3.4 Vizaton diçka të thjeshtë mbi bazë imagjinare dhe shkruan disa fjali për përmbajtjen e figurës që ka vizatuar;
3.5 Shkruan fjalët duke parë figura;
3.6 Shkruan fjali të thjeshta në kohën e tashme, të kryer dhe të ardhme;
3.7 Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë;
3.8 Përdor drejt shenjat kryesore të pikësimit;
3.9 Përdor teknologjinë informative (për të shkruar fjalë, fjali, numra, simbole, tinguj, vizatime etj.);

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikula redhe situatat jetësore	Burimet
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri,	•Kupton elemente të ndryshme kulturore; • Përdor drejt fjalët zonjushë, zonjë, zotëri, si dhe përemrat ti, ju kur u drejtohet të rriturve; • Luan role sipas modeleve; - Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë; • Shfaq kujdes për ambientin që e rrethon; • Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara.	193. Shkronja Xh, fq. 96 194. Fletore pune, fq.130-131 195. Shkronja Xh, fq. 97 196. Fletore pune, fq.131-132 197. Shkronja Zh, fq. 98 198. Fletore pune, fq.133-134 199. Shkronja Zh, fq. 99 200. Fletore pune, fq.134-135 201. Përsëritje 6, fq. 100 202. Fletore pune, fq.136-137 203. Përsëritje 6, fq.101 204. Projekt 3 205. Projekt 3 206. Ne tani lexojmë vetë, fq.102 207. Fjalë që tregojnë njerëz, F. pune, fq. 138 208. Legjenda e luledielit, fq. 103 209. Legjenda e luledielit, fq. 103 210. Fjalë që tregojnë kafshë, F. pune, fq. 139 211. Ditëlindja e Blinit, fq. 104, 105 212. Ditëlindja e Blinit, fq.104, 105 213. Fjalë që tregojnë sende, F. pune, fq.140	67 orë	Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj); Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtim); Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); Diskutim dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit; Mësimdhënie e bazuar në përvojë (lojë me role, dramatizim)	Informata kthyese; Vlerësim i ndërsjellë; Listë kontrolli; Dy yje, një dëshirë; Dosja personale;	Matematika Njeriu dhe natyra Shoqëria dhe mjedisi Shkathtësi për jetë Edukatë figurative Edukatë muzikore **Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	Abetarja Fletore pune e abetares Libri digjital Burime nga internet Libra për fëmijë Fjalori i gjuhës shqipe

mbiemri, përemri. Poezia, përrallëza, përralla, tregimi. Gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.	• Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë; • Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali; • Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit; • Shkruan fjalë duke parë figura; • Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat; • Identifikon mjetet audio-vizuale dhe ato të teknologjisë informative dhe i përdorë ato për të dëgjuar, për të komunikuar dhe për të bërë regjistrime;	214. Vizatuesja e vogël, fq. 106, 107 215. Vizatuesja e vogël, fq. 106, 107 216. Një apo disa? F. pune, fq. 141 217. Kush e hëngri akulloren? fq. 108 218. Varka – çadër, fq. 109 219. Shkronja e madhe, F. pune, fq. 142 220. Dua një qenush, fq. 110, 111 221. Dua një qenush, fq. 110, 111 222. Përshkruajmë, F. pune, fq. 143 223. Biskota më gjyshen, fq. 112, 113 224. Biskota më gjyshen, fq. 112, 113 225. Fjalë që tregojnë cilësi, F. pune, fq. 144 226. Porosia e fundit e Skënderbeut, fq. 114, 115 227. Parku i Mirushës, fq. 116, 117 228. Parku i Mirushës, fq. 116, 117 229. Fjalë që tregojnë veprim, F. pune, fq. 145 230.Shoqja e Arbës, Bora, fq. 118, 119 231. Shoqja e Arbës, Bora, fq. 118, 119				Edukimi për qytetari demokratike	

	• Përdor lojën për të mësuar; -Dallon elemente themelore të poezisë nga proza; -Përflet ngjarjen kryesore në tekst; - Flet në mënyrë të pavarur për një tekst të shkurtër letrar ose jo letrar; -Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara.	232. Unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato, F. pune, fq. 146 233. Si ruhet atdheu? fq. 120 234. Shoku i ri i klasës, fq. 121 235. Shoku i ri i klasës, fq. 121 236. Kam, ke, ka, kanë, F. pune, fq. 147 237. Tri pyetje, fq.122, 123 238. Tri pyetje, fq. 122, 123 239. Është, ishte, do të jetë, F. pune, fq. 148 240. Nënë Tereza, fq. 124 241. Çfarë është paqja? fq. 125 242. Dje, sot, nesër, F. pune, fq. 149 243. Tre miqtë e Dimalit, fq. 126, 127 244. Tre miqtë e Dimalit, fq. 126, 127 245. Fjalë me kuptime të ndryshme, F. pune, fq. 150 246. Edhe unë di të bëj gol, 128, 129 247. Edhe unë di të bëj gol, fq. 128, 129 248. Pika dhe pikëpyetja, F. pune, fq. 151 249. Akuariumi, fq. 130, 131 250. Akuariumi, fq. 130, 131 251. Zhvendosim fjalët në fjali, F. pune, fq. 152 252. Fjalë të urta dhe gjëegjëza, fq. 132, 133					

		253. Shtojmë dhe heqim fjalë në fjali, F. pune, fq. 153 254. Në park, fq. 134, 135 255. Në park, fq. 134, 135 256. Vlerësim njohurish 3 257. Takim i paharruar, fq. 136, 137 258. Takim i paharruar, fq. 136, 137 259. Lexim jashtë klase 3					

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Kupton elemente të ndryshme kulturore.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Në shkollë</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e ditës së parë të shkollës.
• Përqëndrohet në çështjet kryesore kur tregon një përvojë të tijën.
• Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
shkollë, klasë, nxënës, urim</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Lapsat në mes</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, njohuritë paraprake të nxënësve.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Bëhet prezantimi dhe urimet me rastin e ditës së parë të shkollës.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Bisedë
Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit rreth ditës së parë të shkollës.
- Si ndiheni sot? Pse?
- Si u përgatitët për ditën e sotme?</td></tr>
</table>

- Kush ju ndihmoi?
- Çfarë urimi ju bënë prindërit?
- Çfarë patë kur hytë në oborr?
- Si ishte shkolla? Po klasa?
- A gjetët shokë apo shoqe që i njihnit më parë?

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Prezantohet libri i Abetares dhe lihen nxënësit të shkëmbejnë mendime me njëri-tjetrin për 2-3'. Njihen shkurt me përmbajtjen e tekstit dhe më pas orientohen ta hapin në faqen 6.

Lihen disa minuta të diskutojnë me shokun/shoqen dhe tërhiqet vëmendja te titulli i mësimit, i cili shkruhet edhe në tabelë. Lexohet globalisht së bashku me nxënësit dhe më pas nxiten të përshkruajnë figurën duke u ndihmuar me pyetjet:

- Çfarë shikoni në figurë? Ku po shkojnë fëmijët?
- Si e kuptoni që po shkojnë në shkollë? Çfarë mbajnë në duar?
- Kush i pret në hyrje të shkollës?
- Si është shkolla e tyre? Çfarë ka përreth shkollës?
- A ngjan ajo me shkollën tuaj? Pse?
- Ku ndryshojnë?
- Çfarë ju pëlqen më shumë të shkolla që shikoni?
- Si ndihen fëmijët? Pse?

Tregohet kujdes që, gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehen saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota. Gjithashtu do të orientohen që të dëgjojnë me vëmendje shokun/shoqen kur flet dhe të mos e ndërpresin.

Tërhiqet vëmendja e nxënësvë te urimi *MIRË SE VINI!* Lexohet globalisht.

Hapi 3. Lapsat në mes

Drejtohet pyetja:

- Si mendoni, pse fëmijët kanë emocione në ditën e parë të shkollës?

Udhëzohen nxënësit të mbajnë një laps në dorë. Secili i përgjigjet pyetjes, lë lapsin në mes të tavolinës dhe dëgjon përgjigjet e nxënësve të tjerë.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxiten të tregojnë si u ndjenë gjatë orës së mësimit.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shprehjen e mendimeve, ndjenjave dhe emocioneve të ditës së parë të shkollës.
- Përqëndrimin në çështjet kryesore, kur tregojnë një përvojë të tyren.
- Të shprehurit saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Bisedoni me prindërit për ditën e parë të shkollës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Kupton elemente të ndryshme kulturore.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1.
Njësia mësimore: Fletore pune: Në shkollë	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan emocionet e ditës së parë të shkollës. • Përshkruan mbi bazën e figurave. • Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota. • Shkruan elementet e shkrimit duke ndjekur modelin.	**Fjalë kyçe:** shkollë, klasë, lojë **Teknika dhe strategji:** ❖ Bisedë ❖ Vëzhgo- Diskuto ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, etiketa me emrat e nxënësve, mjete shkrimi.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Prezantohen nxënësit me radhë dhe secilit i jepet etiketa me emrin e vet, të cilën e vendosin mbi tavolinë

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bisedë

Nxiten te mendojnë rreth pyetjes:

- Çfarë bëjnë nxënësit në shkollë?

Mbasi lihen të mendojnë për 2-3', dëgjohen përgjigjet nga disa nxënës.

Hapi 2. Vëzhgo- Diskuto

Prezantohet Fletorja e punës së Abetares dhe njihen shkurt me përmbajtjen e saj.

Hapet në faqen 6 dhe lihen disa minuta të diskutojnë me shokun/shoqen.

Nxiten të dëgjojnë "tregimin" e improvizuar mbi bazën e figurës:

Ishte një ditë e bukur me diell. Nxënësit dolën në oborrin e shkollës dhe nisën të luanin lojërat që pëlqenin më shumë.

Nxiten nxenësit të përshkruajnë figurën duke u ndihmuar me pyetjet:

- Cilat lojëra po luajnë fëmijët?
- Si ndihen ata?
- Pse mendoni se janë të gëzuar?
- Çfarë vini re te fëmijët që po luajnë më top?
- Pse njëri nga fëmijët është ulur në karrocën me rrota?
- A ka të drejtë dhe ai të luajë së bashku me fëmijët e tjerë?

Hapi 3. Punë në dyshe

Tërhiqet vëmendja e nxënësvë te vijat e ndërprera që ndodhen te të dyja faqet.

Demonstrohet në tabelë shkrimi i tyre.

Ushtrohen nxënësit të imitojnë shkrimin e tyre duke lëvizur dorën në ajër.

Disa nxënës vazhdojnë modelet e nisura në tabelë.



Duke punuar në dyshe nxënësit kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera në Fletoren e punës.

Gjatë punës kontrollohen dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Në një fletë nxënësit praktikojnë shkrimin e vijave të ngjashme me ato që punuan te Fletorja e punës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e emocioneve të ditës së parë të shkollës.
- Përshkrimin mbi bazën e figurave.
- Të shprehurit saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.
- Shkrimin e elementeve të shkrimit duke ndjekur modelin.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Vizatoni vija si ato që punuat në klasë. (Mund të përdoret fleta e mëposhtme.)

UNË JAM _____













<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
- Ndërton mirë fjalitë dhe shqipton me intonacionin e duhur;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Alfabeti</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Tregon me saktësi lidhjen shkronjë-tingull.
• Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.
• Nuk e ndërpret shokun kur është duke folur.
• Ndjek me sy shokun gjatë kohës që flet.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
alfabet, shkronjë, zanore, bashkëtingëllore</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Lojë
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, njohuritë paraprake të nxënësve, Cd, tabela e alfabetit, etiketa me shkronjat e mëdha, loja me flluska.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Arte, Matematikë
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet kënga e alfabetit dhe këndohet bashkë me nxënësit.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake
Nxiten nxënësit të tregojnë çfarë kanë mësuar në parashkollor.
- Cilat shkronja mbani mend?</td></tr>
</table>

Hapi 2. Lojë

U shpërndahen nxënësve etiketa me shkronjat e mëdha të shtypit. Në varësi të numrit të nxënësve që janë në klasë, mund t'u jepen dy shkronja disave prej tyre me qëllim që të plotësohen 36 shkronjat e alfabetit.

Mësuesja shqipton tingullinn A dhe nxënësi që e ka etiketën e saj çohet dhe e ngjit në tabelë ku paraprakisht është shkruar fjala ALFABETI. Më pas shqipton tingullin B e kështu me radhë derisa të jenë ngjitur të gjitha shkronjat. Ndihmohen nxënësit që kanë vështirësi në identifikimin e shkronjave. Loja mund të zhvillohet edhe në dyshe me qëllim që nxënësit të ndihmojnë njëri-tjetrin.

Lexohen korazi shkronjat dhe theksohet se të gjitha shkronjat së bashku formojnë alfabetin.

Hapi 3 . Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapen librat dhe lihen disa minuta të diskutojnë me shokun/shoqen.

Lexohet titulli globalisht së bashku me nxënësit dhe më pas nxiten të përshkruajnë figurën duke u ndihmuar me pyetjet:

- Çfarë shikoni në figurë?
- Çfarë po bën vajza?
- Cili prej jush e ka luajtur këtë lojë?
- Çfarë ka brenda në flluska?
- Cila është shkronja e parë?
- Çfarë ngjyre ka ajo?
- Cilat shkronja kanë ngjyrë të kuqe si A-ja?

Theksohet se shkronja me ngjyrë të kuqë janë zanore, kurse të tjërat bashkëtingëllore.

Lexohen shkronjat me radhë korazi nga nxënësit.

Tregohet kujdes që, gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehen saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota. Gjithashtu do të orientohen që të dëgjojnë me vëmendje shokun/shoqen kur flet dhe të mos e ndërpresin.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Ngjitin figurën e duhur mbi shkronja (ndodhen në fund të librit të nxënësit).

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin mbi bazën e figurave.
- Lidhjen e shkronjës me tingullin përkatës.

• Të shprehurit saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota. • Mosndërprerjen e shokut kur është duke folur. • Ndjekjen me sy të shokut gjatë kohës që flet.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani disa shkronja të alfabetit në një fletë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** - Ndërton mirë fjalitë dhe shqipton me intonacionin e duhur;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1.
Njësia mësimore: Fletore pune: Alfabeti	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Emërton shkronjat e alfabetit. • Tregon me saktësi lidhjen shkronjë-tingull. • Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota. • Nuk e ndërpret shokun kur është duke folur. • Tregon vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave.	**Fjalë kyçe:** alfabet, shkronjë, tingull **Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë ❖ Vëzhgo-Diskuto-Plotëso ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, Cd, tabela e alfabetit, etiketa me shkronjat e mëdha, fletë, ngjyra, mjete shkrimi.	**Lidhja me fushat e tjera:** Arte Matematikë **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Ridëgjohet kënga e alfabetit.	

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lojë

Zhvillohet një lojë dëgjimore me nxënësit për të identifikuar lidhjen tingull-shkronjë.

Para nxënësve vendoset tabela e alfabetit. Mësuesja shqipton një tingull dhe kërkon nga nxënësit që të tregojnë shkronjën përkatëse te tabela e alfabetit. Më pas u kërkohet të gjejnë disa fjalë që e përmbajnë këtë tingull. Loja përsëritet disa herë dhe nxënësit bashkëveprojnë në grup nëse kanë vështirësi në identifikimin e shkronjave.

Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto-Plotëso

Hapen Fletoret e punës në faqen 8 dhe lihen disa minuta të diskutojnë me shokun/shoqen.

- Çfarë shikoni në figurë?
- A janë të gjithë rrethorët me shkronja?
- Çfarë ka në vend të tyre?
- Fillojmë të lexojmë shkronjat e para: A, B, C, Ç.
- Cila shkronjë duhet vendosur pas shkronjës Ç?
- Çfarë ka figura ?(diellin)
- Cilin tingull dëgjoni në fillim të fjalës dielli?
- Pra do të vendoset shkronja D.

Vazhdohet leximi i shkronjave të tjera deri në fund duke zëvëndësuar figurat e dhëna me shkronjat përkatëse. Tërhiqet vëmendja e nxënësve në shqiptimin e qartë dhe të saktë të të gjithë tingujve.

Më pas nxënësit ngjitin shkronjat që mungujnë në vend të figurave. Gjatë punës, kontrollohen dhe ndihmohen. Për t'u ardhur në ndihmë nxënësve janë dhënë shkronjat të renditura në krye të faqes.

Hapi 3 . Turi i galerisë

Nxënësit zgjedhin disa shkronja dhe vizatojnë figura të thjeshta të cilave u fillon emri me këto shkronja.

Në fund i ngjitin në një kënd të klasës dhë vëzhgojnë punën e njëri-tjetrit.



Demonstrim i rezultateve të arritura:

Lexohen shkronjat e alfabetit korazi.

Vlerësohen nxënësit për:

- Emërtimin e shkronjave të alfabetit.
- Shqiptimin drejt të tingujve.
- Lidhjen e tingullit me shkronjën përkatëse.
- Të shprehurit saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.
- Shfaqjen e vullnetit dhe besimit gjatë kryerjes së detyrave.

Detyrë shtëpie:

Nxënësve u sugjerohet një detyrë e ngjashme me atë që kryejnë në klasë në hapin 3.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni; Foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri	**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1.
Njësia mësimore: A e gjen dot?	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan mbi bazën e figurave. • Emërton shkronjat e alfabetit duke u bazuar te figurat. • Shqipton drejt tingujt. • Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.	**Fjalë kyçe:** alfabet, shkronjë, zanore, bashkëtingëllore **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Vëzhgo- Analizo- Plotëso
Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, njohuritë paraprake të nxënësve, tabela e alfabetit, etiketa me shkronjat e mëdha, etiketa me emrat e nxënësve, figura të faqes 11.	**Lidhja me fushat e tjera:** Arte, Matematikë **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Organizimi i orës së mësimit	

Veprimtari paraprake

Ridëgjohet kënga e alfabetit dhe këndohet nga nxënësit 1-2 herë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

- Sa shkronja ka alfabeti i Gjuhës shqipe?

Tregohet etiketa me një nga shkronjat e mëdha të alfabetit dhe u kërkohet nxënësve ta shqiptojnë tingullin e saj (p.sh.E).

- Cilit prej jush i fillon emri me këtë shkronjë?

Përsëritet veprimtaria me disa shkronja.

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

U paraqitet nxënësve fotoja e ariut dhe nxiten të bëjnë një koment të shkurtër:

- Çfarë është?
- Çfarë dini për të?

Shkruhet fjala **A**RIU dhe lexohet globalisht me nxënësit.

- Me cilën shkronjë fillon kjo fjalë?
- Gjeni disa fjalë të tjera që nisin me shkronjën A.

Kështu veprohet edhe me figurat e tjera të faqes 11.

Në përfundim lexohen korazi shkronjat që u shkruajtën në tabelë.

- Çfarë kanë të përbashkët këto shkronja? (Janë zanore).

Këndohet kënga e zanoreve:

A, e, ë, i, o, u, y
eja të lozim të dy.
Shkronjat bashkë t'i bashkojmë
rrokjet bukur t'i formojmë.

Hapi 3 . Vëzhgo- Analizo- Plotëso

Improvizohet një ngjarje mbi bazën e figurës:

Ishte një ditë e bukur. Pranvera kishte ardhur dhe lulet kishin çelur. Ana dhe Drini shkuan në park. Me vete morrën edhe robotin Ufi. Ata vendosën të luanin një lojë që e kishin mësuar në klasë me mësuesen e tyre. Loja titullohej " A E GJENI DOT"?

Shkruhet titulli në tabelë dhe lexohet globalisht së bashku me nxënësit.

Nxiten të hapin librat dhe lihen disa minuta të diskutojnë me shokun/shoqen.

- Pse loja titullohet “A e gjeni dot”?
- Çfarë duhet të gjejnë fëmijët?
- Ndihmojini të lidhin shkronjat me figurat.
- A mund të quhet ndryshe “Loja e zanoreve”? Pse?

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit zgjedhin dy prej zanoreve dhe vizatojnë figura të thjeshta që u fillon emri me to

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin mbi bazën e figurave.
- Emërtimin e shkronjave të alfabetit.
- Shqiptimin drejt të zanoreve.
- Të shprehurit saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Vizatoni figura që u fillon emri me zanore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni; Foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri			**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme.	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1.	
Njësia mësimore: Fletore pune: A e gjen dot?			**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi:			**Fjalë kyçe:** alfabet, shkronjë, zanore, bashkëtingëllore	

• Emërton shkronjat e alfabetit duke u bazuar te figurat. • Shqipton drejt tingujt. • Shkruan elementet e shkrimit duke ndjekur modelin.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë ❖ Vëzhgo- Diskuto- Plotëso ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, tabela e alfabetit, etiketa me shkronjat e mëdha, etiketa me emrat e nxënësve.	**Lidhja me fushat e tjera:** Arte, Matematikë **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit të tregojnë cilat shkronja përmban emri i tyre.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lojë

Një nxënës "shkruan" një shkronjë të madhe të shtypit duke lëvizur dorën në ajër pa e thënë emrin e shkronjës.

Nxënësit e tjerë duhet të gjejnë cila shkronjë është. Përsëritet loja disa herë duke aktivizuar sa më shumë nxënës.

Hapi 2. Vëzhgo- Diskuto-Plotëso

Hapet Fletorja e punës në faqen 10 dhe lihen disa minuta të diskutojnë me shokun/shoqen.

Lexohet titulli globalisht nga nxënësit.

Emërtohen figurat e dhëna duke tërhequr vëmendjen e nxënësve te shqiptimi i saktë dhe i qartë: *akullore, ëmbëlsirë, elefant, iriq, ujk, ylber, orë.*

- Çfarë tregon figura e parë?
- Me cilën shkronjë fillon emri i saj?
- Ngjiteni shkronjën A te rrethori poshtë akullores.
- Çfarë tregon figura e dytë?
- Me cilën shkronjë fillon?
- Ngjiteni shkronjën Ë te rrethori poshtë ëmbëlsirës.

Vazhdohet me figurat e tjera.

Gjatë punës nxënësit kontrollohen dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Lexohen korazi shkronjat që ngjitën dhe kujtohen që janë zanoret e Gjuhës shqipe.

Hapi 3. Punë individuale

Tërhiqet vëmendja e nxënësvë te elementet e shkrimit qe ndodhen te të dyja faqet.

Demonstrohet në tabelë shkrimi i tyre.

Ushtrohen nxënësit të imitojnë shkrimin e tyre duke lëvizur dorën në ajër.

Disa nxënës vazhdojnë modelet e nisura në tabelë.



Në mënyrë individuale nxënësit kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera dhe më pas vazhdojnë modelet e nisura. Gjatë punës kontrollohen dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura: Përsëritin këngën e zanoreve:

A,e,ë, i,o,u,y
eja të lozim të dy.
Shkronjat bashkë t'i bashkojmë
rrokjet bukur t'i formojmë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Emërtimin e shkronjave të alfabetit duke u bazuar te figurat.
- Shqiptimin drejt të tingujve.
- Shkrimin e elementeve të shkrimit duke ndjekur modelin.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Vizatoni vija si ato që punuat në klasë. (Mund të përdoret fleta e mëposhtme.)

UNË JAM _____



<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
- Ndërton mirë fjalitë dhe shqipton me intonacionin e duhur;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Unë jam .....</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Emërton shkronjat e alfabetit.
• Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.
• Nuk e ndërpret shokun kur është duke folur.
• E sheh në sy shokun gjatë kohës që flet.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
ANA, DRINI, ERA, ILIRI, UFI, POKI.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Bisedë
❖ Lexim global
❖ Vëzhgo- Diskuto</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, njohuritë paraprake të nxënësve, interneti, Cd, tabela e alfabetit, etiketa me shkronjat e mëdha.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Arte, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja bën një prezantim të shkurtër për veten.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Bisedë
Nxiten nxënësit të prezantohen para klasës me dy – tre fjali, p.sh:
Unë quhem Blerta. Kam një motër që quhet Jona. Prindërit e mi quhen Arta dhe Albert.
Për nxënësit që kanë vështirësi, mësuesja drejton pyetje si:
- Si quhesh?
- A ke motër ose vëlla?</td></tr>
</table>

- Si quhen mami dhe babi?

Hapi 2. Lexim global

Njihen nxënësit me personazhet që do të shfaqen herë pas here në mësimet e Abetares.

Paraqiten etiketat me emrat e tyre:

ANA, DRINI, ERA, ILIRI, UFI, POKI.

Vendosen në një vend të dukshëm dhe lexohen globalisht bashkë më nxënësit.

Hapet libri i Abetares në faqen 12 dhe lexohen globalisht emrat pranë personazheve.

Nxiten të përshkruajnë shkurt secilin prej personazheve.

Hapi 3 . Vëzhgo- Diskuto

Nxitet mendimi i nxënësve duke improvizuar një histori të shkurtër mbi bazën e figurës:

Mbasi gjetën zanoret, Ana dhe Drini shkuan në park të gjenin edhe shkronjat e tjera. Ishin shumë shkronja prandaj thërritën për ndihmë edhe Ilirin me Erën. Me ta shkuan edhe qenushi Poki dhe roboti Ufi. Së bashku do ta kishin më të lehtë.

- Si mendoni, pse fëmijët janë të kënaqur?
- I njihni ju shkronjat që gjetën ata?
- Le t'i lexojmë së bashku.

Theksohet se janë bashkëtingëlloret e Gjuhës shqipe.

- Shikoni shkronjat që ndodhen te lulet me ngjyrë rozë. Çfarë mund të thoni për to?(janë shkronja dyshe).

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit vizatojnë disa lule dhe shkruajnë bashkëtingëllore në mesin e luleve.

Detyra mund të vazhdojë në shtëpi.

Vlerësohen nxënësit për:

- Emërtimin e shkronjave të alfabetit.
- Përshkrimin mbi bazën e figurave.
- Të shprehurit saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.
- Mosndërprerjen e shokut kur është duke folur.
- Ndjekjen me sy të shokut gjatë kohës që flet.

Detyrë shtëpie:

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
- Ndërton mirë fjalitë dhe shqipton me intonacionin e duhur;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Fletore pune: Unë jam .....</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Nuk e ndërpret shokun kur është duke folur.
• E sheh në sy shokun gjatë kohës që flet.
• Shkruan elementet e shkrimit duke ndjekur modelin.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
ANA, DRINI, ERA, ILIRI, , JONA, UFI, POKI.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Vëzhgo- Diskuto-Plotëso
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, tabela e alfabetit, etiketa me shkronjat e mëdha, etiketa me fjalët ANA, DRINI, ERA, ILIRI, JONA,UFI, POKI, mjete shkrimi.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Arte, Matematikë
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit vendosen në formë rrethi. I jepet etiketa e një shkronje nxënësit të parë. Ai duhet ta shqiptojë. Nëse nuk e di thotë “Pas” dhe e kalon te nxënësi tjetër.
Përsëritet me disa shkronja.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Lojë</td></tr>
</table>

Mësuesja përshkruan një nga nxënësit pa i thënë emrin, p.sh.: është i gjatë, i ka flokë kaçurrela të shkurtra, ka trup të dobët, sot ka veshur një bluzë blu, etj.
Nxënësit e tjerë duhet të gjejnë emrin e nxënësit që përshkroi mësuesja. Përsëritet loja disa herë duke aktivizuar sa më shumë nxënës.

Hapi 2. Vëzhgo- Diskuto-Plotëso
Hapet Fletorja e punës në faqen 12 dhe lihen disa minuta të diskutojnë me shokun/shoqen.
Lexohet titulli globalisht nga nxënësit dhe shkruajnë emrin e tyre mbi vijë.

- Çfarë shikoni në figurë
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- A i njihni këta fëmijë?
- Ku i kemi njohur? (te mësimi i Abetares)
- Gjeni në figurë ku ndodhet Jona. Lexojmë së bashku emrin e saj.
- Si është veshur Jona? Pse është veshur me rroba sportive? Çfarë mban në dorë? Si mendoni, pse është e gëzuar?
- Kaloni lapsin sipër shkronjave të emrit. Lexojeni përsëri.

Kështu veprohet edhe për personazhet e tjera.
Lexohen korazi nga nxënësit emrat që plotësuan.

Hapi 3. Punë individuale
Tërhiqet vëmendja e nxënësvë te elementet e shkrimit qe ndodhen te të dyja faqet.
Demonstrohet në tabelë shkrimi i tyre.
Ushtrohen nxënësit të imitojnë shkrimin e tyre duke lëvizur dorën në ajër.
Disa nxënës vazhdojnë modelet e nisura në tabelë.



Në mënyrë të pavarur nxënësit kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera dhe më pas vazhdojnë modelet e nisura.
Gjatë punës kontrollohen dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:
Nxënësit shkruajnë vija të ngjashme në një fletë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin mbi bazën e figurave.
- Mosndërprerjen e shokut kur është duke folur.
- Ndjekjen me sy të shokut gjatë kohës që flet.
- Shkrimin e elementeve të shkrimit duke ndjekur modelin.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Vizatoni vija si ato që punuat në klasë. (Mund të përdoret fleta e mëposhtme.)

UNË JAM _____





<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tinguj, shkronja, zanore dhe bashkëtingëllore, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1, 4.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Loja me shkronjat</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Shqipton drejt tingujt.
• Formon rrokje duke bashkuar shkronjat.
• Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
shkronjat, rrokje</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Vëzhgo- Diskuto
❖ Gushkuqi rrethor</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, tabela e alfabetit, etiketa me shkronjat e mëdha, etiketa me rrokjet e fq.14,15.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Arte, Matematikë
Lidhja e me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Rikujtohet kënga e zanoreve:
A,e,ë, i,o,u,y
eja të lozim të dy.
Shkronjat bashkë t’i bashkojmë
rrokjet bukur t’i formojmë.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Lojë</td></tr>
</table>

Mbi tavolinë vendosen etiketa me shkronja të mëdha të shtypit. Etiketat përgatiten dy nga dy me ngjyra të njëjta në mënyrë që me to të formohen rrokjet.

Çohen nxënësit dy nga dy dhe marrin etiketat me ngjyrë të njëjtë. Shqiptojnë tingujt e tyre dhe i tregojnë në drejtim të shokëve.

- Afrojini etiketat pranë njëra-tjetrës.
- Lexojmë çfarë u formua.

Njihen me konceptin e rrokjes dhe përsëritet disa herë loja duke aktivizuar sa më shumë nxënës.

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 14 dhe lexohet titulli globalisht.

- Pse mësimi titullohet *LOJA ME SHKRONJA?*
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Ku janë ulur?
- Kush po i ndihmon?
- Çfarë kanë formuar me shkronja?
- Cilat rrokje kanë formuar?
-

Hapi 3 . Vëzhgo- Diskuto

Nxënësit lihen disa çaste të vëzhgojnë rrokjet e formuara dhe t'i lexojnë.

Kjo veprimtari kryhet në dyshe.

Mbasi nxënësit diskutojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin, i ndajnë mendimet e tyre me gjithë klasën.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Gushkuqi rrethor: Nxënësit lexojnë me radhë rrokjet: LA, MI, RU, KO, RI, BO.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin mbi bazën e figurave.
- Shqiptimin drejt të tingujve.
- Formimin e rrokjeve duke bashkuar shkronjat.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Përgatitni disa etiketa me rrokje duke përdorur shkronjat e mëdha të shtypit.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tinguj, shkronja, zanore dhe bashkëtingëllore, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Fletore pune: Loja me shkronjat</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan mbi bazën e figurave.
• Shqipton drejt tingujt.
• Lexon globalisht fjalë.
• Shkruan elementet e shkrimit duke ndjekur modelin.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
shkronjat, rrokje, fjalë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Vëzhgo- Diskuto-Plotëso
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, njohuritë paraprake të nxënësve, tabela e alfabetit, etiketa me shkronjat e mëdha.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Arte, Matematikë
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja “shkruan” një shkronjë të madhe të shtypit në ajër pa i thënë emrin. Nxënësit duhet të gjejnë cila shkronjë është dhe imitojnë “shkrimin” e saj në ajër.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake</td></tr>
</table>

Mësuesja shqipton tingullin B dhe kërkon të çohen në këmbë nxënësit që e kanë shkronjën B në emrin e tyre. Mbasi çohen, nxënësit shqiptojnë emrin e tyre dhe tregojnë nëse shkronjën B e kanë në fillim në mes apo në fund.

Përsëritet veprimtaria me shkronja të tjera.

Hapi 2. Vëzhgo- Diskuto-Plotëso

Hapet Fletorja e punës në faqen 14 dhe lexohet titulli globalisht.

Emërtohen figurat e dhëna duke tërhequr vëmendjen në shqiptimin e qartë të tyre.

Tërhiqet vëmendja te etiketa me fjalën e parë MOLLA. Lexohet globalisht nga nxënësit.

Theksohet se fjala është ndarë në dy pjesë që quhen rrokje: MO dhe LLA. Nxënësit i lexojnë dhe kalojnë lapsin sipër pikave.

Përsëritet veprimtaria me fjalët e tjera.

Hapi 3. Punë individuale

Tërhiqet vëmendja e nxënësve te elementet e shkrimit qe ndodhen te të dyja faqet.

Demonstrohet në tabelë shkrimi i tyre.

Ushtrohen nxënësit të imitojnë shkrimin e tyre duke lëvizur dorën në ajër.

Disa nxënës vazhdojnë modelet e nisura në tabelë.



Në mënyrë të pavarur nxënësit kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera dhe më pas vazhdojnë modelet e nisura.

Gjatë punës kontrollohen dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit shkruajnë vija të ngjashme në një fletë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin mbi bazën e figurave.
- Shqiptimin drejt të tingujve.
- Leximin global të fjalëve.
- Shkrimin e elementeve të shkrimit duke ndjekur modelin.

• Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruajnë vija të ngjashme.

UNË JAM _____



UNË JAM _____



<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
- Ndërton mirë fjalitë dhe shqipton me intonacionin e duhur;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Klasa ime</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shpreh mendimet e tij për një temë të caktuar.
• Përqëndrohet në çështjet kryesore kur përshkruan.
• Shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.
• Ndjek me sy shokun gjatë kohës që flet.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
shkollë, klasë, fjalë, rrokje, mami, lule</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Fjala e fshehur
❖ Vëzhgo-Diskuto
❖ Analizë&Sintezë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Abetare, njohuritë paraprake të nxënësve, tabelë alfabeti, etiketa me shkronjat e mëdha, etiketat me emrat e nxënësvë.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Arte, Shoqëria dhe mjedisi
Lidhja e me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxiten të flasin për shokun që kanë më pranë.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Fjala e fshehur
Në një kuti vendosen etiketa me emrat e nxënësve të klasës të shkruara me shkronja të mëdha të shtypit. Etiketat vendosen të palosura.
Secili nxënës merr një etiketë dhe së bashku me të tjerët e lexon në mënyrë globale dhe i jepet nxënësit që ka atë emër.
Përsëritet veprimtaria deri sa të shpërndahen të gjitha etiketat.</td></tr>
</table>

Hapi 2. Vëzhgo- Diskuto

Hapet libri i Abetares në faqen 16 dhe lexohet titulli në mënyrë globale.

Lihen nxënësit të vërejnë për disa çaste.

Nxiten të përshkruajnë figurën duke u ndihmuar me pyetjet:

- Çfarë shikoni te klasa që tregohet në figurë?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Çfarë mbajnë mbi tavolinë?
- Provoni të lexoni emrat e nxënësve.

Ndihmohen nxënësit në leximin global të emrave të fëmijëve.

- Çfarë ka shkruar mësuesja në tabelë?
- Si ndihen fëmijët?

Hapi 3. Analizë & Sintezë

Shkruhen në tabelë rrokjet dhe fjalët si në tabelën e figurës:

MA MI MAMI

- Çfarë ka shkruar mësuesja në tabelë?
- Si lexohet rrokja e parë? Nga cilat shkronja formohet kjo rrokje?
- Si lexohet rrokja e dytë? Nga cilat shkronja formohet?
- Cila fjalë formohet kur bashkohen rrokjet MA dhe MI?

Përsëritet për fjalën tjetër:

LU LE LULE

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Duke punuar në dyshe nxënësit lexojnë në mënyrë globale fjalët: MAMI, BABI, LUAJ, KAM, JAM,

Dëgjohen disa nxënës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shprehjen e mendimeve të tyre për një temë të caktuar.
- Përqëndrimin në çështjet kryesore, kur përshkruajnë.
- Të shprehurit saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota.

• Ndjekjen e shokut kur është duke folur;
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani emrat e pjesëtarëve të familjes.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** - Ndërton mirë fjalitë dhe shqipton me intonacionin e duhur;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1.
Njësia mësimore: Fletore pune: Klasa ime	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shpreh mendimin e tij për një temë të caktuar. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit. • Vlerëson punët e të tjerëve.	**Fjalë kyçe:** klasë, fjalë, rrokje, djem vajza **Teknika dhe strategji:** ❖ Tryezë e rrumbullakët ❖ Vëzhgo-Diskuto ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, tabelë alfabeti, etiketa me shkronjat e mëdha, mjete shkrimi, ngjyra.	**Lidhja me fushat e tjera:** Arte, Shoqëria dhe mjedisi **Lidhja e me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

U lexohet nxënësve vjersha “Mësoi Adi shkronjën A”.

Adi i vogël ka mësuar
shkronjën A për ta lexuar.
Se me A fillon Adushi,
akullorja dhe arushi.

Adi ynë ka mësuar
shkronjën A dhe për ta shkruar.
Ndaj me shkronjën A e mbushi
plot një fletë, vogëlushi.

I tha mami: Më mos shkruaj.
I tha babi: Dil e luaj.
Qejf të luajë Adi s'ka.
Do të shkruajë shkronjën A.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Tryezë e rrumbullakët

Nxënësit vendosen në formë rrethore para klasës. Nëse janë shumë nxënës, veprohet me disa prej tyre. Nxiten nxënësit të thonë emrin e shokut/shoqes që kanë në krah dhe të tregojnë një cilësi të tij/saj (p.sh. Ky është Eri. Është gjithmonë i qeshur).

Hapi 2. Vëzhgo- Diskuto

Hapet Fletorja e punës në faqen 16 dhe lexohet titulli në mënyrë globale.

Lihen nxënësit të vërejnë për disa çaste.

Nxiten të përshkruajnë figurën duke u ndihmuar me pyetjet:

- Çfarë shikoni në figurë?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Si qëndrojnë në karrige?
- Pse duhet mbajtur trupi drejt?
- Çfarë mbajnë mbi tavolinë?
- Si është klasa e tyre?

Hapi 3. Punë individuale

Numërohen vajzat dhe djemtë në klasë dhe ngjyrosin rrethorët te detyra e parë. Në përfundim tregojnë çfarë ka më shumë djem apo vajza duke u bazuar te rrethorët e ngjyrosur.

Më pas plotësojnë emrin e mësueses/mësuesit.

Në mënyrë të pavarur kalojnë lapsin mbi figurë dhe e ngjyrosin.

Gjatë punës kontrollohen dhe ndihmohen.

Demonstrim i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë në mënyrë globale fjalët në fund të faqes:

HA, RA, PI, LUAN, KAP, FLE.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shprehjen e mendimit të tyre për një temë të caktuar.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
- Vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani fjalët në fund të faqes: HA, RA, PI, LUAN, KAP, FLE.

UNË JAM _____



UNË JAM _____



UNË JAM _____



UNË JAM _____



UNË JAM _____



<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
- Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Shkronja A, fq. 18</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin A.
• Identifikon shkronjën A.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin A në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
ariu, akullore, anija, atlete, ananas</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-Analizo
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës A të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën A.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
U tregohen nxënësve pesë etiketa me shkronjat e mëdha të shtypit, p.sh: A,B,M,I,L.Nxiten t’i shqiptojnë. Më pas, pa parë nxënësit, hiqet njëra nga etiketat dhe u tregohen përsëri. Nxënësit duhet të gjejnë cila shkronjë mungon. Përsëritet veprimtaria disa herë duke aktivizuar sa më shumë nxënës.

Veprimet në situatë
Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo
Paraqitet një foto e ariut dhe nxiten nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër rreth saj:
-Çfarë shikoni?
-Çfarë dini për ariun? Ku jeton ai?</td></tr>
</table>

-Me se ushqehet?

-Ta shqiptojmë së bashku fjalën.

Shkruhet fjala ARIU në tabelë dhe nxiten ta lexojnë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës A.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: A-RI-U.

-Pra, fjala ARIU ka tri rrokje. Ku ndodhet shkronja A? (në fillim)

Përsëritet veprimtaria edhe për fjalën AKULLORE.

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 18 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës A që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull zanor.

Meqenëse janë orët e para të shkronjave u sqarohen nxënësve kuptimet e simboleve me të cilat do të punohet edhe në mësimet e tjera.  *shiko*  *dëgjo*  *fol*

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin: ari, akullore, pemë, kërpudha, lule, bar. Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë?

-Ku ndodhet ariu? Cila stinë është? Nga e kuptoni që është verë?

-Lexoni fjalët që janë shkruar në figurë (ARIU, AKULLORE).

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Rikujtohet kuptimi i simboleve. Mbasi të shqiptojnë fjalët e secilës figurë**,** nxënësit do të ngjyrosin figurat te të cilat dëgjojnë tingullin A (ariu, atlete, ananas).

Ushtrimi i dytë:

- Dëgjojeni me kujdes fjalën e parë: *anija.*

-Ku e dëgjoni tingullin a te kjo fjalë: në fillim, në mes apo në fund? (në fillim dhe në fund).

-Prandaj janë ngjyrosur rrethori i fillimit dhe i fundit.

-Po te figura e dytë çfarë shikoni? Dëgjojeni fjalën me kujdes: *breshka*. Ku e dëgjoni tingullin A?

-Cilin rrethor duhet ta ngjyrosni?(rrethorin e fundit)

Te fjala *ora* do të ngjyroset rrethori i fundit; te fjala *arra* do të ngjyroset rrethori i parë dhe i fundit; te fjala *domate* do të ngjyroset rrethori i mesit (dhe i fundit nëse shqiptohet *domatja*).

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën A. **Vlerësohen nxënësit për:** • Shqiptimin e tingullit **A.** • Identifikimin e shkronjës **A.** • Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **A** në pozicione të ndryshme. • Përshkrimin e figurës qendrore.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin A.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1; 3. 5		
Njësia mësimore: Fletore pune faqe 18-19		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **A ,a** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **A, a** në fjalët e dhëna. • Plotëson fjalët me shkronjën **A, a.** • Dallon shkronjën **A, a** në një grup shkronjash të dhëna. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** akullore, makina, macja, kapela,anija **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **A, a**, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **A, a** në pozicione të ndryshme.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake***				

Dëgjohet vjersha e shkronjës A.

Në çdo gjuhë të botës mbarë
unë A-ja jam e parë.
Dhe si tingull dhe si shkronjë
rri në krye porsi zonjë.

Komandante alfabeti
nuk më zgjodhi parlamenti.
E dini ku është sekreti?
Hë mendoni! Kush e gjeti?

Jua them unë: më zgjodhi bebi.
Se kur lind ai, posa,
E hap gojën, oh sa shumë!
Qan e s'lodhet a, a, a…

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet fjala **AKULLORE** në tabelë dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

-Çfarë shije ka akullorja?

-Cila ju pëlqen më shumë?

-Pse nuk duhet ta hamë akulloren kur jemi të djersitur?

-Me cilën shkronjë fillon fjala?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja A e shtypit, e madhe dhe e vogël .

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **A**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. 

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën a të vogël.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 18 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin akulloren, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Sqarohet kuptimi i simbolit të detyrës së parë dhe në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjat A, a. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit do të qarkojnë shkronjën A.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë shkronën A duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Identifikojnë shkronjën A, a në grupin e shkronjave të dhëna dhe i lidhin me shkronjat e dhëna në shportë.

Ushtrimi i pestë: Plotësojnë fjalët e dhëna me shkronjën a.

Ushtrimi i gjashtë: Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për ngjyrosjen e shkronjave.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë nga një rresht me shronjën A, a.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **A, a** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **A, a** në fjalët e dhëna.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **A, a.**
- Dallimin e shkronjës **A, a** në një grup shkronjash të dhëna.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën **A, a**.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1; 3. 5		
Njësia mësimore: Shkronja A, fq. 19		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **A.** • Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **A.** • Dallon shkronjën **A** (të shtypit dhe të dorës, të madhe dhe të vogël) në një grup shkronjash të dhëna. • Shkruan shkronjën **A** të shtypit mbi bazën e modelit.		**Fjalë kyçe:** ariu, akullore, arra **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje- përgjigje ❖ Punë individuale ❖ Lojë		

• Plotëson fjalët me shkronjën **A**.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **A** të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, etiketa me emrat e nxënësve**,** mjete shkrimi, ngjyra.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit që e kanë shkronjën A në emrin e tyre të shkruajne emrin në tabelë. Më pas qarkojnë shkronjën A dhe tregojnë nëse ndodhet në fillim, në mes apo në fund.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje- përgjigje

Hapet libri në faqen 19 të Abetares dhe nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin: ari, akullore, pemë, lule, kafshë, bar, tullumbace.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë ka veshur ariu?

-Çfarë mban në dorë ai?

-Ku duhet të shkojë?

-Çfarë është shkruar në rrugën ku duhet të kalojë ariu?

-Kaloni lapsin tuaj sipër shkronjave.

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Rikujtohet kuptimi i simboleve. Mbasi të shqiptojnë fjalën ARRA**,** nxënësit do të shkruajnë shkronjën A në kutizat që duhet.

Ushtrimi i dytë

Në pjesën e parë të ushtrimit është shkruar shkronja A sipas ritmit me shuplaka:

1 përplasje e shuplakave⟶ A

2 përplasje të shuplakave⟶ A A

3 përplasje të shuplakave⟶ A A A

Ndihmohen nxënësit të plotësojnë ushtrimin në vazhdim: përplasin shuplakat sipas figurës dhe më pas shkruajnë shkronjën A.

Ushtrimi i tretë

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për ngjyrosjen e shkronjave.

Hapi 3. Lojë

Me anë lojës nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që përmbajnë shkronjën A.

Një nxënës, pasi mendohet për 2-3', del para klasës dhe numëron 5 fjalë që përmbajnë shkronjën A.

Aktivizohen sa më shumë nxënës në lojë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Në libra për fëmijë nxënësit qarkojnë shronjën A, a.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **A.**
- Identifikimin e fjalëve që e përmbajnë tingullin **A** (me anë të dëgjimit).
- Dallimin e shkronjës **A** (të shtypit dhe të dorës, të madhe dhe të vogël) në një grup shkronjash të dhëna.
- Shkrimin e shkronjës **A** të shtypit mbi bazën e modelit.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **A.**

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:
-Shkruani dy rreshta me shkronjën **A**.

- Në copëza gazetash qarkoni shronjën A, a.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1; 3. 5		

<table>
<tr><td>Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 19-20</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën A, a të dorës sipas modelit.
• Plotëson fjalët me shkronjën A, a në pozicione të ndryshme.
• Shkruan me të diktuar A a A a .
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
ariu, pema, arra, anija, Ana, Artani, Anisa</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës A, a, A, a të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën A, a, A, a në pozicione të ndryshme.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shkencat e natyrës</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja emërton disa nga objektet që ndodhen në klasë. Nëse nxënësit dëgjojnë tingullin a përplasin duart. Nëse e dëgjojnë dy herë te e njëjta fjalë, i përplasin dy herë. Nxiten të tregojnë dhe pozicionin në të cilin ndodhet.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake
Paraqiten para nxënësve etiketa me fjalët: ariu, pema, arra, anija, Ana, Artani, Anisa.
Aktivizohen nxënësit të identifikojnë shkronjën A,a dhe ta qarkojnë.
Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe te emrat e njerëzve.
Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Analizë & sintezë
Prezantohet grafiku i shkronjës A. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.
Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.
Përsëritet veprimtaria për shkronjën a.</td></tr>
</table>

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 19 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve duke shpjeguar për secilin ushtrim kuptimin e simboleve meqenëse janë orët e para.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën  . Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit lexojnë globalisht fjalët mbi bazën e figurave dhe i plotësojnë me shkronjën .

Ushtrimi i tretë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën  duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i katërt: Lexojnë globalisht fjalët dhe i plotësojnë me shkronjën . Ritheksohet shkrimi i emrave të njerëzve me shkronjë të madhe.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë me të diktuar nga një rresht me **A , a,** .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës , të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën , në pozicione të ndryshme**.**
- Shkrimin me të diktuar të A a .
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga tri rreshta me .

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Shkronja I, fq. 20</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin I.
• Identifikon shkronjën I.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin I në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
iriqi, qeni, lepuri, kikiriku</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Dil rrotull-Fol rrotull
❖ Vëzhgo-Diskuto
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës I të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën I.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësimi fillon me një gjëegjëzë për iriqin:
Është i vogël, i rrumbullakuar
dhe punëtor i papërtuar.
Përmbi shpinë gjemba ka,
Për fortesë e për kala. (iriqi)

Veprimet në situatë
Hapi 1. Dil rrotull-Fol rrotull
U drejtohet nxënësve pyetja:
- Çfarë dini për iriqin?</td></tr>
</table>

Nxënësit lëvizin në hapësirat boshe të klasës. Në momentin që dëgjojnë përplasjen e duarve nga mësuesja, ndalojnë, formojnë dyshe me shokun/shoqen që kanë pranë dhe këmbejnë mendime në lidhje me pyetjen që ju është drejtuar. Në fund shkëmbejnë mendimet e tyre me të gjithë nxënësit e klasës. Shkruhet fjala *IRIQI* në tabelë dhe njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto

Hapet libri në faqen 20 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës I që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull zanor, ashtu si dhe tingulli A.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin: iriqi, lepuri, urithi, bari, pemët, guri, tullumbace, etj. Ndihmohen me pyetjet:

- Çfarë shikoni në figurë?

-Çfarë po bëjnë kafshët? Çfarë loje po luajnë?

-Në çdo tullumbace fshihet një send ose kafshë që përmban tingullin I.

-Çfarë mund të ketë?

Shkruhen disa nga fjalët që sugjerojnë nxënësit në tabelë.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Rikujtohet kuptimi i simboleve. Mbasi të shqiptojnë fjalët e secilës figurë**,** nxënësit do të ngjyrosin figurat te të cilat dëgjojnë tingullin I (iriqi, qeni, kikirik).

Ushtrimi i dytë:

- Dëgjojeni me kujdes fjalën e parë: iriqi.

-Ku e dëgjoni tingullin **i** te kjo fjalë: në fillim, në mes apo në fund? (në fillim, në mes dhe në fund).

-Prandaj janë ngjyrosur të tre rrethorët.

-Po te figura e dytë çfarë shikoni? Dëgjojeni fjalën me kujdes: lepuri. Ku e dëgjoni tingullin **i**?

-Cilin rrethor duhet ta ngjyrosni?(rrethorin e fundit)

Te fjala *patina* do të ngjyroset rrethori i mesit; te fjala *kubi* do të ngjyroset rrethori i fundit; te fjala *dielli* do të ngjyroset rrethori i mesit dhe i fundit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën I.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **I.**
- Identifikimin e shkronjës **I.**

• Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **I** në pozicione të ndryshme. • Përshkrimin e figurës qendrore.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin I.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**	**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1; 3. 5
Njësia mësimore: Fletore pune faqe 21-22	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **I, i** të shtypit sipas modelit; • Identifikon shkronjën **I, i** në fjalët e dhëna; • Plotëson fjalët me shkronjën **I, i;** • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** iriqi, shkronjë e madhe, shkronjë e vogël, rrokje **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **I, i** , magnetofon, Cd, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **I, i** në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Dëgjohet vjersha e shkronjës I.

Më shihni mua!
Jam ndër shkronjat më e thjeshta.
Mbani mend?
Në krve iam në Abetare.

Mesin hiç nuk e përkul,
pikën fort mbi kokë e ngul.
Kudo shkoj, kudo që vete,
gjithnjë pikën mbaj me vete.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Shkruhet fjala **IRIQI** në tabelë dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

-Sa shkronja ka kjo fjalë?

-Cila shkronjë është e para?

-A ka të tjera shkronja I?

-Ku ndodhen ato?

Një nxënës e qarkon shkronjën I.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja I e shtypit, e madhe dhe e vogël .

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **I**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. 

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën i të vogël. 

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 21 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin iriqin, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjat I, i. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit do të qarkojnë shkronjën I.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë shkronën I duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Lidhin shkronjat I me shigjetë.

Ushtrimi i pestë: Shqiptohen fjalët mbi bazën ë figurave dhe plotësojnë fjalët e dhëna me shkronjën i.

Ushtrimi i gjashtë: Nxënësit punojnë në dyshe për të lexuar rrokjet me shkronjat a dhe i. Dëgjohen disa prej tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Shkruajnë nga dy rreshta me **I, i.** **Vlerësohen nxënësit për:** • Shkrimin e shkronjës **I, i** të shtypit sipas modelit. • Identifikimin e shkronjës **I, i** në fjalët e dhëna. • Plotësimin e fjalëve me shkronjën **I, i.** • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga tri rreshta me **I, i**.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1; 3. 5		
Njësia mësimore: Shkronja I, fq. 21		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **I**. • Plotëson fjalët me shkronjën **I**. • Lexon në mënyrë globale fjalë që përmbajnë shkronjën **I**. • Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar.		**Fjalë kyçe:** iriqi, ishulli **Teknika dhe strategji:** ❖ Imagjinatë e drejtuar ❖ Vëzhgo-Diskuto- Plotëso ❖ Turi i galerisë		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **i**, përralla "Iriqi dhe mollët", plastelinë, shkopinj të vegjël, etj.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Zhvillohet një bisedë e shkutër rreth përrallave:

- A ju pëlqejnë përrallat? Pse?
- Cila është përralla juaj e preferuar?

Veprimet në situatë

Hapi 1. Imagjinatë e drejtuar

Nxiten nxënësit të dëgjojnë përrallën "Iriqi dhe mollët".

Një mëngjes, iriq gjembaçi doli nga strofka e tij për të gjetur ushqim. Bëri një copë udhë dhe, për t'u çlodhur, u ndal nën një pemë. Vendi qe mbushur plot me mollë të vogla, që kishin rënë prej pemës nga era. "Sa mirë!- mendoi me vete iriq gjembaçi. –Tani do ta mbush barkun duke i ngrënë mollët njëra pas tjetrës. Dhe ashtu bëri. Filloi të hante iuritur mollët e shijshme. Hëngri sa hëngri, dhe në mendje i erdhën shokët e tij, iriqët e tjerë. Po si t'i merrte mollët për ta? Në gojë ai mund të mbante vetëm një kokërr mollë. Pasi u mendua pak, iriq gjembaçi u kthye me kurriz nga toka. Në gjembat e tij u ngulën shumë mollë.

- *Si ju duket veprimi i iriq gjembaçit?*
- *Po ju si do të vepronit?*

Njihen me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja I e shtypit dhe e dorës, e madhe dhe e vogël.



Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto- Plotëso

Hapet libri në faqen 21 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës I që ndodhet në krye të faqes. Rikujtohen edhe një herë fjalët e figurave që përmbajnë shkronjën I dhe lexohet globalisht fjala IRIQI.

Ushtrimi i parë: Rikujtohet kuptimi i simboleve. Mbasi të shqiptojnë fjalën *ISHULLI***,** nxënësit do të shkruajnë shkronjën I në kutizat që duhet.

Ushtrimi i dytë: Në pjesën e parë të ushtrimit është shkruar shkronja I sipas ritmit me shuplaka:

1 përplasje e shuplakave—→

2 përplasje të shuplakave—→I

3 përplasje të shuplakave—→I I

Ndihmohen nxënësit të plotësojnë ushtrimin në vazhdim: përplasin shuplakat sipas figurës dhe më pas shkruajnë shkronjën I.

Hapi 3. Turi igalerisë

Organizohen nxënësit në grupe dhe modelojnë iriqin duke përdorur plastelinë, shkopinj të vegjël, etj.

Gjatë punës kontrollohen, ndihmohen.

Punimet ekspozohen në një kënd të klasës ku nxënësit vështrojnë punën e njëri-tjetrit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit identifikojnë emrat e shokëve/shoqeve që përmbajnë shkronjën I.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **I.**
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **I**.
- Leximin në mënyrë globale të fjalëve që përmbajnë shkronjën **I**.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Në copëza gazetash qarkoni shkronjën **I, i.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1; 3. 5		
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 22-23		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **I, i** të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me shkronjën **I, i** në pozicione të ndryshme**.**		**Fjalë kyçe:** miu, libri, insekti, birila, Ina, Iliri,Irma **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë		

• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit.	❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës i të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën I, i, I, i në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Rikujtohet përralla"Iriqi dhe mollët" nga disa nxënës.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Paraqiten para nxënësve etiketa me fjalët: **miu, libri, insekti, birila, Ina, Iliri, Irma.**

Aktivizohen nxënësit të identifikojnë shkronjën I,i dhe ta qarkojnë.

Ritheksohet përdorimi i shkronjës së madhe te emrat e njerëzve.

Nëse ka nxënës që u fillon emri me shkronjën I, nxiten ta shkruajnë në tabelë.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës I. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtorojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën i të vogël.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 22 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën i. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Tregohet kujdes në lidhjen e shkronjës a me shkronjën i për të formuar ai.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit lexojnë globalisht fjalët *miu, libri, insekti, birila* mbi bazën e figurave dhe i plotësojnë me shkronjën i.

Ushtrimi i tretë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën I duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i katërt: Lexojnë globalisht fjalët *Ina, Iliri,Irma* dhe i plotësojnë me shkronjën **I, i** .

Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe për shkrimin e emrave të njerëzve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë me të diktuar **I, i , I, i , A, a, a, ai.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **I, i** të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **I, i** në pozicione të ndryshme**.**
- Shkrimin me të diktuar të **I, i , I, i , A, a, a, ai.**
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

- Shkruani nga tri rreshta me **I, i**.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme**.**		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1.		
Njësia mësimore: Shkronja M, fq. 22		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi:		**Fjalë kyçe:** mami im, mali, milingona, mace, majmuni, domate, këmba,qilimi,molla.		

• Shqipton tingullin **M.** • Identifikon shkronjën **M**. • Përshkruan figurën qendrore. • Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **M** në pozicione të ndryshme. • Lexon rrokje dhe fjalë me shkronja të mësuara.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Vëzhgo-Diskuto-Plotëso ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **M** të shtypit, kube kartoni me shkronja si në figurën e tekstit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **M**.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit të flasin shkurtimisht për mamin e tyre:

- Si quhet?
- Ku punon? Etj.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Mbi tavolinë vendosen disa kube. Në njërën prej faqeve të çdo kubi, shkruhen shkronja në mënyrë që të formohet *MAMI IM* .

U tregohen shkronjat nxënësvë dhe u kërkohet që të shqiptojnë qartë secilën prej tyre.

- Cilën fjalë mund të formojmë me shkronjat që lexuam?

Mbasi dëgjohen mendimet e nxënësve, shkruhet në tabele *MAMI IM.*

Veçohet dhe prezantohet shkronja M.

Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto-Plotëso

Hapet libri në faqen 22 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës M që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin. Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë?

-Çfarë po bëjnë fëmijët? Me kë po luajnë?

-Çfarë kanë formuar me kube? Lexojini fjalët e formuara.

-Si mendoni se ndjehen fëmijët?

-Po ju si ndiheni kur luani me prindërit? Çfarë lojërash bëni me ta?

Nxënësit kalojnë lapsin mbi shkronjat e dhëna me vija të ndërprera.

Hapi 3. Punë individuale
Ushtrimi i parë: Mbasi të shqiptojnë fjalët e secilës figurë**,** nxënësit do të ngjyrosin figurat te të cilat dëgjojnë tingullin M (mali, milingona, mace).
Ushtrimi i dytë: Duke mbajtur ritmin me shuplaka, nxënësit lexojnë rrokjet e dhëna dhe kalojnë lapsin sipër shkronjave.
Ushtrimi i tretë: -Dëgjojeni me kujdes fjalën e parë: *majmuni.*
-Ku e dëgjoni tingullin **M** te kjo fjalë: në fillim, në mes apo në fund? (në fillim dhe në mes).
-Prandaj është ngjyrosur rrethori i fillimit dhe i mesit.
Te fjala *domate* do tëngjyroset rrethori i mesit, te fjala *këmba* do të ngjyroset rrethori i mesit; te fjala *qilimi* do të ngjyroset rrethori i mesit; te fjala *molla* do të ngjyroset rrethori i fillimit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit lexojnë rrokjet dhe fjalët: *MA, MI, IM, AM**,** MAMI, MAMI IM.*

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **M.**
- Identifikimin e shkronjës **M.**
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **M** në pozicione të ndryshme.
- Leximin e rrokjeve dhe fjalëve me shkronja të mësuara;

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Vizatoni figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin M.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali.		

<table>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1; 3. 5</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore: Fletore pune faqe 24-25</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën M, m të shtypit sipas modelit.
• Identifikon shkronjën M, m në një grup shkronjash të dhëna.
• Plotëson fjalët me shkronjën M, m.
• Shkruan rrokje me shkronjat e mësuara.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
molla, mulliri, metër, muri, termometër, timoni, majmuni.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i M, m, magnetofon, Cd, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën M, m, në pozicione të ndryshme, mollë, kuti kartoni.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Në një kuti të mbyllur vendoset një kokërr mollë. Nxënësit do të gjejnë çfarë ka brenda në kuti. Mbasi japin mendimin e tyre, mund të pyeten:
- Pse mendon se është ...?

Veprimet në situatë
Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
Shkruhet fjala MOLLA në tabelë dhe lexohet globalisht. Nxiten nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve:
-Cila fjalë është shkruar në tabelë?
-Çfarë është molla?
-Pse duhet ta hamë gjithmonë?
- Me cilën shkronjë fillon fjala?
Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja M ,m.
Hapi 2. Analizë & sintezë</td></tr>
</table>

Analizohen në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.



Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Provojnë disa nxënës ta shkruajnë në tabelë.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 24 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin mollën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjat **M,m**.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit do të identifikojnë shkronjën M, m në grupin e shkronjave të dhëna dhe do ta ngjyrosin.

Ushtrimi i tretë: Emërtojnë figurat e dhëna (mulliri, metër, muri) dhe shkruajnë shkronjën M mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Plotësojnë me shkronjën **M** dhe lexohen globalisht fjalët.

Ushtrimi i pestë: Ngjyrosin figurat që përmbajnë rrokjen **MA** (macja, mali) dhe **MI** (miu, miza)

Ushtrimi i gjashtë: Shkruajnë dhe lexojnë fjalët AMI, MAMI.

Ushtrimi i shtatë: Shkruajnë dhe lexojnë rrokjet dhe fjalët e dhëna.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë nga një rresht me M, m, ma, mi.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **M, m** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **M, m** në një grup shkronjash të dhëna.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **M, m .**
- Shkrimin e rrokjeve me shkronjat e mësuara.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me **M, m , ma, mi.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme.</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1; 3. 5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Shkronja M, fq. 23</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin M.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin M në pozicione të ndryshme.
• Dallon shkronjën M (të shtypit dhe të dorës, të madhe dhe të vogël) në një grup shkronjash të dhëna.
• Lexon rrokje dhe fjalë me shkronja të mësuara.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
mami, mami im, miu</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Vëzhgo-Diskuto
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti, etiketa me m, a, i, ma, mi, am, im, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën M.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxiten të përshkruajnë familjen e tyre, p.sh: Familja ime përbëhet nga mami, babi, ...
Theksohet se familja është e rëndësishme dhe se çdo fëmijë ka të drejtë të ketë një familje.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake
Nxënësit ulen në formë rrethi. U tregohen foto me figura që përmbajnë shkronjën m. Nxënësit do të emërtojnë figurën dhe do të identifikojnë tingullin m. Tregohet pozicioni në të cilin ndodhet shkronja.</td></tr>
</table>

Nëse munden, nxënësit mund t'i shkruajnë fjalët në tabele. (Fotot mund të jënë: mollë, mal, makinë, majmun, limon, etj.)

Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto

Dy nxënës mbajnë në dorë etiketat me shkronjat **m** dhe **a**.

Shqiptohen tingujt e tyre nga nxënësit. U kërkohet nxënësve të afrohen me njëri-tjetrin.

- Çfarë u formua? (rrokja **ma**).
- Ndërroni vendet. Po tani çfarë formohet? (rrokja **am**).

Përsëritet veprimtaria me shkronjat **m** dhe **i** për të formuar rrokjet **mi** dhe **im**.

Përsëritet me rrokjet **ma** dhe **mi** për të formuar fjalën **mami** dhe më pas **mami im.** Shkruhen dhe në tabelë rrokjetdhe fjalët e formuara. Lexohen korazi nga nxënësit:

m a ma

m i mi

a m am

i m im

ma mi mami

Hapi 3. Punë individuale

Hapet libri në faqen 23 të Abetares dhe nxiten të vëzhgojnë për disa çaste.

Ushtrimi i parë: Emërtohet figura (*MIU*) dhe lexohet fjala në mënyrë globale. Duke ndjekur simbolet përkatëse, nxënësit plotësojnë kutizat.
Ushtrimi i dytë: Shkruajnë dhe lexojnë **ma, mi, mami, am, im.**
Ushtrimi i tretë: Identifikojnë shkronjën **M, m,** M, m dhe e qarkojnë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në një letër të palosur si fizarmonikë shkruhen**: ma, mi, im, am, mami, MA, MI, AM, IM, MAMI.**

Nxënësit e kalojnë letrën dorë më dorë dhe lexojnë rrokjen ose fjalën që ndodhet në një nga palosjet.

Ndihmohen nxënësit që mund të kenë vështirësi.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **M.**
- Dallimin e shkronjës **M** (të shtypit dhe të dorës, të madhe dhe të vogël) në një grup shkronjash të dhëna
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **M** në pozicione të ndryshme.

• Leximin e rrokjeve dhe fjalëve me shkronja të mësuara.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga një rresht me **ma, mi, am, im, mami, mami im.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**	**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1; 3. 5
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 25-26	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën M, m të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë. • Shkruan me të diktuar shkronjat e dorës që ka mësuar deri tani. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** mami, mali, makina **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **M, m, M, m** etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **M, m, M, m** në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Arte Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Dëgjohet vjersha e shkronjës M.

Më-më-më, ma-ma-ma,
fjalë e parë në botë: MAMA!
Më dhemb dhëmbi, oh, o ma!
Më shpoi gjembi, oh, o ma!
Nëm pak ujë, hë o ma!
Nëm pak bukë, hë pra ma!
Dhe mami kur ka shqetësim,
psherëtin: o mami im!

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Paraqiten etiketa me fjalët (ose shkruhen në tabelë): **mi , mami**, mami, **Ami, Mia, Mia .**

Aktivizohen nxënësit të identifikojnë shkronjën **M, m, M, m**.

Përcaktojnë pozicionin e saj dhe e qarkojnë.

- Pse disa fjalë janë shkruar me shkronjë të madhe në fillim?
- Cilit prej jush i fillon emri me shkronjën M?

Nxënësit shkruajnë emrin e tyre në tabelë.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës M. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën m.

Disa nxënës e shkruajnë edhe në tabelë.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 19 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve duke shpjeguar për secilin ushtrim kuptimin e simboleve meqenëse janë orët e para.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën m, ma, mi, mami im .

Gjatë punës ndihmohen në lidhjen e shkronjave me njëra-tjetrën.

Ushtrimi i dytë: Emërtohen figurat dhe plotësohen fjalët me rrokjen ma.

Ushtrimi i tretë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë M, Mia, Ami duke parë modelin e dhënë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i katërt:

Shkruajnë me të diktuar nga një rresht me A, a, m, M, ma, mi, mami, Mia

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës M, m të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me rrokjet që mungojnë.

• Shkrimin me të diktuar të shkronjat e dorës që ka mësuar deri tani. • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga dy rreshta me **m, M, mami, Mia** .

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme**.**		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1.		
Njësia mësimore: Shkronja R, fq. 24		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **R.** • Përshkruan figurën qendrore. • Identifikon shkronjën **R**. • Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **R** në pozicione të ndryshme.		**Fjalë kyçe:** robot, çadër, rosë, raketë, reçel, gomar, kurorë **Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimi ❖ Vëzhgo-Diskuto-Plotëso ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **R** të shtypit, gjëegjëzë për avionin, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **R**.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Mësimi fillon me një gjëegjëzë për avionin: *Zog nuk është, por ka fletë,* *e çan qiellin si shigjetë.* *Është objekt shtegëtar,* *fluturon dimër, behar.*				

Veprimet në situatë

Hapi 1. Stuhi mendimi

Nxiten nxënësit të tregojnë çfarë dinë për avionin dhe shkruhen të gjitha mendimet në tabelë.



Përshkruajnë ndonjë udhëtim që mund të kenë bërë me avion.

Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto- Plotëso

Hapet libri në faqen 24 të Abetares dhe nxiten të përshkruajnë figurën qendrore:

- Çfarë shikoni në figurë?

-Ku mendoni se po shkon Ana?

-Çfarë ka marrë me vete?

-Çfarë shikon nga dritarja? (re)

Shkruhet fjala ***RE*** në tabelë dhe lexohet në mënyrë globale.

Veçohet tingulli ***R.***

Shqiptojnë tingullin e shkronjës R që ndodhet në krye dhe theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera te shkronjat mbi re.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Mbasi të shqiptojnë fjalët e secilës figurë**,** nxënësit do të ngjyrosin figurat te të cilat dëgjojnë tingullin R (robot, çadër, rosë).

Ushtrimi i dytë: Duke mbajtur ritmin me shuplaka, nxënësit lexojnë rrokjet e dhëna dhe kalojnë lapsin sipër shkronjave.

Ushtrimi i tretë: - Dëgjojeni me kujdes fjalën e parë: *roboti*.

-Ku e dëgjoni tingullin **r** te kjo fjalë: në fillim, në mes apo në fund? (në fillim).

-Prandaj është ngjyrosur rrethori parë.

-Po te figura e dytë çfarë shikoni? Dëgjojeni fjalën me kujdes: *traktori.* Ku e dëgjoni tingullin **r**?

-Cilin rrethor duhet ta ngjyrosni?(rrethorin e parë dhe të fundit)

Te fjala *reçel* do të ngjyroset rrethori i parë; te fjala *gomari* do të ngjyroset rrethori i fundit; te fjala *kurorë* do të ngjyroset rrethori i mesit dhe i fundit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën R në fillim, në trup të tyre ose në fund. **Vlerësohen nxënësit për:** • Shqiptimin e tingullit **R.** • Përshkrimin e figurës qendrore. • Identifikimin e shkronjës **R.** • Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **R** në pozicione të ndryshme.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Vizatoni figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin R.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1; 3. 5		
Njësia mësimore: Fletore pune faqe 27-28		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **R, r** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **R, r** në një grup shkronjash të dhëna. • Plotëson fjalët me shkronjën **R, r.** • Shkruan rrokje me shkronjat e mësuara. • Ndan fjalët në rrokje.		**Fjalë kyçe:** rosa, dritare, treni, radio, lepuri, ariu, fletore, lepuri **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **R, r**, magnetofon, Cd, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **R, r,** në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Dëgjohet kënga:
Rosat po lahen brenda në liqen,
kokën ulin poshtë, bishtin lart e ngrenë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet fjala **ROSA** në tabelë dhe lexohet globalisht. Nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Çfarë është rosa?

-Ku rri?

-Si quhet i vogli i saj?

- Me cilën shkronjë fillon fjala?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **R ,r.**

Hapi 2. Analizë & sintezë

Analizohen në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.



Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Provojnë disa nxënës ta shkruajnë në tabelë.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 27 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin rosën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjat **R,r**.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit do të identifikojnë shkronjën **R,r** në grupin e shkronjave të dhëna dhe do ta ngjyrosin.

Ushtrimi i tretë: Emërtojnë figurat e dhëna (dritare, tren, radio), identifikojnë shkronjën **R** dhe e shkruajnë mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Plotësojnë me shkronjën **R** dhe lexohen globalisht fjalët.

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë dhe lexojnë rrokjet **RA, RI, AR, IR.**

Ushtrimi i gjashtë: Duke ndjekur shigjetat, ndahen në rrokje dhe shkronja fjalët e dhëna.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ndahen në rrokje e shkronja fjalët mami, Mira.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **R, r** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **R, r** në një grup shkronjash të dhëna.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **R,r .**
- Shkrimin e rrokjeve me shkronjat e mësuara.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje e shkronja.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me **R, r, ra, ri, Mira, Miri.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme**.**		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1.		
Njësia mësimore: Shkronja R, fq. 25		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **R.** • Identifikon shkronjën **R** në fjalë të ndryshme. • Lexon rrokje dhe fjalë me shkronja të mësuara. • Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar.	**Fjalë kyçe:** robot, Mira, Miri, i ri, im **Teknika dhe strategji:** ❖ Bisedë ❖ Vëzhgo-Diskuto-Plotëso ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **R, r, R, r**, etiketa me **R, A, I, MI,** letra me ngjyra, gërshërë, lodra të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Dëgjohet vjersha e shkronjës R.

Shkronja R rri na dëgjon,
me qetësi kur e shqiptojm'
dhe kënaqet, lumturohet,
kur askush nga ne s'gabohet.

Dhe kur bëjmë ndonjë gabim,
në shqiptim apo në shkrim,
na shikon, na këshillon,
kur punojmë të mos nxitojm'.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bisedë

Nxiten nxënësit të flasin për lodrat e tyre.

- Cila është lodra juaj e preferuar?

Shkruhen përgjigjet e nxënësve në tabelë me shkronja të mëdha.

Identifikohet shkronja R te fjalët e shkruara duke e qarkuar dhe përcaktohet nëse është në fillim, në trup të fjalës apo në fund.

Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto- Plotëso

Hapet libri në faqen 25 të Abetares dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve:

Ushtrimi i parë:.

- Çfarë shikoni?
- Përse mund të përdoret roboti?

Shkruhet fjala në tabelë për t'i orientuar më mirë nxënësit:

R	**O**	**B**	**O**	**T**	**I**

- Sa rrokje ka fjala? Cilat janë?
- Sa shkronja ka? Cilat janë?
- Cila shkronjë mungon këtu?

	O	**B**	**O**	**T**	**I**

Një nxënës plotëson fjalën me shkronjën R. Plotësohet edhe në libër.

Ushtrimi i dytë: Dy nxënësve u jepen etiketat me shkronjat R dhe A . Shqiptohen tingujt e tyre dhe afrohen pranë njëri- tjetrit.

- Çfarë formojnë këto dy shkronja? (rrokjen RA)
- Ndërroni vendet.
- Cila rrokje formohet tani? (rrokja AR)

Përsëritet veprimtaria me shkronjat R dhe I për të formuar rrokjet RI, IR.

Më pas veprohet me rrokjet: MI , RA për të formuar fjalën MIRA dhe MI, Ri për të formuar fjalën MIRI.

\

Hapi 3. Punë në dyshe

Nxënësit në grupe ose në dyshe përgatitin kindera me lodrat e tyre.

Në fund vëzhgojnë punën e njëri-tjetrit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit lexojnë nga tabela: **r, R, ri, ra, ar, ir, Mira, Miri**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **R.**
- Identifikimin e shkronjës **R** në fjalë të ndryshme**.**
- Leximin e rrokjeve dhe fjalëve me shkronja të mësuara.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani në fletoren tuaj nga një rresht me **ri, ra, ar, ir, Mira, Miri.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore:	**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**	-Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali.

<table>
<tr><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1; 3. 5</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 28-29</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën R, r të dorës sipas modelit.
• Plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë.
• Shkruan rrokje e fjalë me shkronjat e dorës të mësuara duke parë modelin.
• Shkruan me të diktuar shkronjat e dorës që ka mësuar deri tani dhe fjalë me to.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
ariu, peri, Rimi, Mira</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës R, r, R, r
CD, internet.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet kënga e alfabetit.
Identifikohet shkronja R në tabelën e alfabetit.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake
Mësuesja lëviz dorën në ajër duke imituar shkrimin e shkronjës M.
Nxënësit e tjerë gjejnë cila shkronjë është.
Përsëritet edhe për shkronjat a, i, m, I.
Mund të provohet edhe me rrokjet ma, mi, am, im.</td></tr>
</table>

Nxënësi që e gjen shkronjën apo rrokjen sipas lëvizjes së dorës, e shkruan në tabelë.
Lexohen korazi nga të gjithë nxënësit.

Hapi 2. Analizë & sintezë
Prezantohet grafiku i shkronjës R. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.
Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.
Përsëritet veprimtaria për shkronjën r.
Demonstrohet lidhja e shkronjë r me shkronjat e tjera për të formuar rrokjet ra, ri, Ra, Ri.
Disa nxënës i shkruajnë edhe në tabelë.

Hapi 3. Punë individuale
Hapet Fletorja e punës në faqen 28 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.
Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën r, ra, ri . Gjatë punës ndihmohen në lidhjen e shkronjave me njëra-tjetrën.
Ushtrimi i dytë: Emërtohen figurat dhe plotësohen fjalët me rrokjen ri.
Ushtrimi i tretë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë R, Rimi, Mira duke parë modelin e dhënë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura
Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar nga një rresht me r, R , ra, ri , Rimi, Mira .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës R, r të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me rrokjet që mungojnë.
- Shkrimin e rrokjeve e fjalëve me shkronjat dorës të mësuara duke parë modelin.
- Shkrimin me të diktuar të shkronjave të dorës që ka mësuar deri tani.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Shkruani nga një rresht me **r, R, ra, ri, Rimi, Mira** .

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Shkronja E, fq. 26</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin E.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin E në pozicione të ndryshme.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
era, elefanti, shishe, dele, televizor, enë, lule, çifteli, jelek</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Dil rrotull-Fol rrotull
❖ Imagjinatë e drejtuar
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës E të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën E, foto të vjeshtës.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
U shpërndahen nxënësve etiketa me shkronjat e mëdha të shtypit SH, T, E, V, J, A. Nxënësit që do të kenë shkronjat në dorë do të diskutojnë së bashku dhe do të gjejnë cila fjalë formohet.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Dil rrotull-Fol rrotull
U drejtohet nxënësve pyetja:
- Çfarë dini për vjeshtën?</td></tr>
</table>

Nxënësit lëvizin në hapësirat boshe të klasës. Në momentin që dëgjojnë përplasjen e duarve nga mësuesja, ndalojnë, formojnë dyshe me shokun/shoqen që kanë pranë dhe këmbejnë mendime në lidhje me pyetjen që ju është drejtuar. Në fund shkëmbejnë mendimet e tyre me të gjithë nxënësit e klasës. Ilustrohet biseda me foto të vjeshtës.

Shkruhet fjala *VJESHTA* në tabelë dhe njihen nxënësit me temën e mësimit.

-Ku ndodhet shkronja **E** te fjala VJESHTA?

Një nxënës qarkon shkronjën E.

Hapi 2. Imagjinatë e drejtuar

Nxiten të dëgjojnë një tregim të improvizuar:

Ishte një ditë vjeshte. Gjethet e pemëve ishin zverdhur. Era, Drini dhe Iliri dolën të shëtisnin së bashku te parku pranë shtëpisë. Në fillim çdo gjë po kalonte mjaft mirë, por papritur...

- Çfarë mendoni se ka ndodhur?

Hapet libri në faqen 26 të Abetares dhe lihen të vëzhgojnë figurën për një çast.

Dëgjohen mendimet e disa nxënësve. Tërhiqet vëmendja te gjethet e rëna nga era, çadra, kapela.

Lexohen globalisht fjalët e Erës: UAAA! ERAAAA!

Nxënësit mund të imtojnë erën.

Shqiptojnë tingullin e shkronjës E që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull zanor, ashtu si dhe tingulli A dhe I. Kalojnë dorën sipër vijave të ndërprera të shkronjës E

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Emërtojnë secilën figurë dhe ngjyrosin figurat te të cilat dëgjojnë tingullin **E** (elefant, shishe, dele, televizor).

Ushtrimi i dytë: Në pjesën e parë të ushtrimit është shkruar shkronja E sipas ritmit me shuplaka:

1 përplasje e shuplakave→E 2 përplasje E E→ 3 përplasje E E E →

Ndihmohen nxënësit të plotësojnë ushtrimin në vazhdim: përplasin shuplakat sipas figurës dhe më pas shkruajnë shkronjën E.

Ushtrimi i tretë: - Çfarë shikoni në figurën e parë? Pse është ngjyrosur rrethori i fillimit?

- Cilin rrethor duhet të ngjyrosni për *lulen*? (rrethorin e fundit) Pse?

Te fjala *çifteli* do të ngjyroset rrethori i mesit; te fjala *elefant* do të ngjyroset rrethori i fillimit dhe i mesit; te fjala *jelek* do të ngjyroset rrethori i fillimit dhe i fundit. Tërhiqet vëmendja te çiftelia dhe jeleku i qëndisur si elemente të kulturës sonë kombëtare.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën E në fillim, në mes ose në fund. **Vlerësohen nxënësit për:** • Shqiptimin e tingullit **E.** • Përshkrimin e figurës qendrore. • Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **E** në pozicione të ndryshme.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Vizatoni figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin E.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1; 3. 5		
Njësia mësimlore: Fletore pune, faqe 30-31		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **E, e** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **E, e** në një grup shkronjash të dhëna. • Plotëson fjalët me shkronjën **E, e.** • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** elefant, ena, dele, qeni, ekrani **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **E, e**, magnetofon, Cd, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **E, e** në pozicione të ndryshme.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Dëgjohet vjersha e shkronjës E.

Kur këndojmë këngë labe,
mbajmë iso dhe bëjmë e,e,e.
Zgjatim dredhim ëmbël zërin
ndonjëherë këndojmë dhe ne.

Shkronjën "E" e ka të parën
më e madhja kafshë në botë,
por kuptohet, jo balena.
Këtë emër kush e thotë?

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Shkruhet fjala **ELEFANTI** në tabelë dhe nxiten nxënësit të tregojnë çfarë dinë për të. Më pas u drejtohen pyetjet:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

-Sa shkronja ka kjo fjalë?

-Cila shkronjë është e para?

-A ka të tjera shkronja E?

-Ku ndodhen ato?

Një nxënës e qarkon shkronjën E.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **E, e**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.



Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 30, ngjyrosin elefantin dhe udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjat **E, e** duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Shqiptohen fjalët mbi bazën ë figurave dhe plotësojnë fjalët e dhëna me shkronjën **E.**

Ushtrimi i tretë: Identifikojnë shkronjën **E, e** në grupin e shkronjave të dhëna duke ngjyrosur gjethet që përmbajnë shkronjën **E, e**.

Ushtrimi i katërt: Emërtojnë figurat dhe i lidhin me shigjetë me fjalët përkatëse. Plotësojnë fjalët me shkronjën **E.**

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë shkronjën e parë të secilës figurë në kutizat poshtë tyre dhe lexohen fjalët e formuara *ERMIRI, ERA*.

Ushtrimi i gjashtë: Nxënësit punojnë në dyshe për të lexuar shkronjat dhe rrokjet e mësuara. Dëgjohen disa prej tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë nga dy rreshta me **e, E.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **E, e** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **E, e** në një grup shkronjash të dhëna.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **E, e.**
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

- Shkruani nga dy rreshta me **E, e, me, re, Eri**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1; 3. 5		
Njësia mësimore: Shkronja E, fq. 27		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **E**. • Plotëson fjalët me shkronjën **E**. • Lexon rrokje dhe fjalë që përmbajnë shkronjën **E**. • Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar.	**Fjalë kyçe:** era, Ema, emri **Teknika dhe strategji:** ❖ Pyetja sjell pyetjen ❖ Vëzhgo-Diskuto- Plotëso ❖ Punë në dyshe
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, njohuritë paraprake të nxënësve, vjershë për vjeshtën, letra mengjyra, shkronja ilustruese, etiketa me **E, E, E, RA, RI, MA**.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

U lexohet nxënësve vjersha për vjeshtën:

Vjeshtë e artë a s'më thua
çfarë dhurate më solle mua?
Vjeshta qesh dhe më thot':
Të kam sjell dhurata plot.
Hapi duart vogëlush,
plot me fruta do t'i mbush:
mollë, dardha, ftonj dhe rrush.

Nxiten të shprehin mendimet e tyre rreth përmbajtjes së saj.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Pyetja sjell pyetjen

U paraqiten nxënësve etiketat me **E, E, E, RA, RI, MA**.

- Cilat fjalë mund të formohen duke përdorur këto etiketa?

Mbasi diskutojnë me njëri-tjetrin, nxënësit shkëmbejnë idetë e tyre me gjithë klasën.

Shkruhen fjalët në tabelë ***ERA, ERI, EMA*** dhe lexohen nga nxënësit.

- Çfarë mund të themi për këto fjalë? (janë emra njerëzish)
- Çfarë kanë të përbashkët këta emra? (përmbajnë shkronjën E)
- Cili prej jush e ka shkronjën E në emrin e tij?

Nxënësit që e kanë shkronjën E i shkruajnë emrat në tabelë.

Theksohet se çdo njeri ka të drejtë të ketë një emër.

Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto- Plotëso

Hapet libri në faqen 27 të Abetares dhe udhëzohen hap pas hapi në plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Mbasi të shqiptojnë fjalën *ERA,* nxënësit do të shikojnë grafikun e shkronjës E, do të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera dhe më pas do të shkruajnë shkronjën E në kutizën që duhet.

Ushtrimi i dytë: Duke ndjekur shigjetat nxënësit formojnë rrokje dhe fjalë, i shkruajnë dhe në fund i lexojnë.

Hapi 3. Punë në dyshe

Lexohet në heshtje ushtrimi i fundit.

Nxënësit lexojnë me radhë nga një rresht.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pemët në vjeshtë: Nxënësve u shpërndahen fletë me ngjyra të prera në formë gjethesh.

Në to nxënësit shkruajnë shkronja dhe i ngjitin.



Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **E.**
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **E**.
- Leximin e rrokjeve dhe fjalëve që përmbajnë shkronjën **E**.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruajnë në një fletë emra njerëzish që përmbajnë shkronjën **E**.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1; 3. 5		

<table>
<tr><td>Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 31-32</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën E, e të dorës sipas modelit.
• Shkruan rrokje e fjalë me shkronjat e dorës të mësuara duke parë modelin.
• Shkruan me të diktuar shkronjat e dorës që ka mësuar deri tani dhe fjalë me to.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
emri, Era, Ermiri</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës E, e, E, e , mjete shkrimi.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shkencat e natyrës</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Zhvillohet një lojë e thjeshtë për vënien në lëvizje të gishtave të dorës, p.sh:
-Sot do të mbledhim frutat që piqen në vjeshtë. Ngrijini duart lart. Hapini gishtat që të kapni mollët e pjekura dhe mbyllini. Ulini krahët poshtë, hapini gishtat dhe lëshojini mollët në shportë.
Përsëritet për vjeljen e dardhave, gështenjave, kumbullave, etj.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake
Prezantohen shkronjat e dorës që janë mësuar deri tani: a, m, i, r, I, M, A, R.
Nxënësit i shqiptojnë një nga një dhe tregojnë për secilën nëse është zanore apo bashkëtingëllore.
Nxiten të tregojnë nga një fjalë për secilën. Shkruhen fjalët në tabelë dhe lexohen nga nxënësit.
a → ari M Mira →
m → mami A Ami →
i → iri R Rimi →
r → re I Ira →</td></tr>
</table>

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **e.** Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën e madhe.

Demonstrohet lidhja e shkronjë e me shkronjat e tjera për të formuar rrokjet re, me, Ra, Ri.

Disa nxënës i shkruajnë edhe në tabelë.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 31 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën e, re, me, emri im . Gjatë punës ndihmohen në lidhjen e shkronjave me njëra-tjetrën.

Ushtrimi i dytë: Emërtohen figurat dhe plotësohen fjalët me shkronjën e.

Ushtrimi i tretë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë E, Era, Ermiri duke parë modelin e dhënë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar nga një rresht me e, E, re, me, era, Era .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës E, e të dorës sipas modelit.
- Shkrimin e rrokjeve e fjalëve me shkronjat dorës të mësuara duke parë modelin.
- Shkrimin me të diktuar të shkronjave të dorës që ka mësuar deri tani.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga një rresht me **e, E, Era, Ema, Emi, Ermiri** .

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore:	**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**	-Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme

<table>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1.</td></tr>
<tr><td>Njësia mësikmore: Shkronja U, fq. 29</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin U.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin U në pozicione të ndryshme.</td><td>Fjalë kyçe:
UFI, ujku, rrushi, ulliri, ura, shiu,muri, peshku, këpuca,</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Imagjinatë e drejtuar
❖ Vëzhgo-Diskuto-Plotëso
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës U të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën U.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësimi fillon me një gjëegjëzë për Tokën:
Porsi top është rrumbullak,
Mot e jetë sillet qark.
Pa benzinë shkon e vjen
Kur lëviz askush s’e ndien.
- Çfarë është Toka?
- Çfarë dini për planetët?

Veprimet në situatë
Hapi 1. Imagjinatë e drejtuar
Nxiten nxënësit të imagjinojnë një planet magjik ku në vend të njerëzve ka robotë.
Mbasi mendojnë për 2-3’ dëgjohen mendimet e nxënësvë.

Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto- Plotëso
Hapet libri në faqen 28 të Abetares dhe nxiten të përshkruajnë figurën qendrore:
- Çfarë shikoni në figurë?
-Çfarë është UFI?</td></tr>
</table>

-Ku ndodhet UFI?

-Çfarë ka përreth tij?

- Shkruhet fjala ***UFI*** në tabelë dhe lexohet në mënyrë globale.

Veçohet tingulli ***U.***

Shqiptojnë tingullin e shkronjës U që ndodhet në krye dhe theksohet se është tingull zanor. Kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera te shkronjat.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Mbasi të shqiptojnë fjalët e secilës figurë**,** nxënësit do të ngjyrosin figurat te të cilat dëgjojnë tingullin U (ujku, rrushi, ulliri).

Ushtrimi i dytë: Në pjesën e parë të ushtrimit është shkruar shkronja U sipas ritmit me shuplaka:

1 përplasje e shuplakave→U 2 përplasje UU→ 3 përplasje UUU →

Ndihmohen nxënësit të plotësojnë ushtrimin në vazhdim: përplasin shuplakat sipas figurës (U, UU) dhe (U UUU).

Ushtrimi i tretë: - Çfarë shikoni në figurën e parë? Pse është ngjyrosur rrethori i fillimit?

- Cilin rrethor duhet të ngjyrosni për *shiun*? (rrethorin e fundit) Pse?

Te fjala *muri* do të ngjyroset rrethori i fillimit; te fjala *peshku* do të ngjyroset rrethori i fundit; te fjala *këpuca* do të ngjyroset rrethori i mesit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën U në fillim, në mes ose në fund dhe mund të plotësohet një tabelë e tillë:

U	U	U
Uma	lumë	ariu .....

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **U.**
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **U** në pozicione të ndryshme.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Vizatoni figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin U.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
- Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1; 3. 5.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 33-34</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën U, u të shtypit sipas modelit.
• Identifikon shkronjën U, u në një grup shkronjash të dhëna.
• Plotëson fjalët me shkronjën U, u.
• Shkruan fjalë të thjeshta që përmbajnë shkronjën u.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
ujku, peshku, flutura, shiu, ura, miu, muri</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i U, u, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën U, u në pozicione të ndryshme.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shkencat e natyrës</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Paraqitet foto e ujkut dhe lihen nxënësit të tregojnë çfarë dinë për të.
Shkruhet fjala UJKU në tabelë dhe lexohet globalisht.
Veçohet shkronja U dhe njihen me temën e mësimit.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake
U paraqiten nxënësve etiketa me fjalë të thjeshta që përmbajnë shkronjën U:
ura ariu muri miu
Nxiten t’i lexojnë fjalët dhe të identifikojnë shkronjën u.</td></tr>
</table>

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **U, u.** Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.



Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë dhe më pas e shkruajne edhe në tabelë.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 33, ngjyrosin ujkun dhe udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjat **U, u** duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Shqiptohen fjalët mbi bazën ë figurave dhe plotësojnë fjalët e dhëna me shkronjën **U.**

Ushtrimi i tretë: Me shkronjat e dhëna formojnë fjalët që duhet dhe i shkruajnë poshtë figurave.

Ushtrimi i katërt: Identifikojnë shkronjën **U, u** në grupin e shkronjave të dhëna dhe ngjyrosin pjesët përkatëse. Plotësohet figura e ujkut.

Ushtrimi i pestë: Nxënësit punojnë në dyshe për të lexuar shkronjat, rrokjet dhe fjalët me shkronjat e mësuara.

Dëgjohen disa prej tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë fjalë që përmbajnë shkronjën U në mënyrë globale.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **U, u** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **U, u** në një grup shkronjash të dhëna.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **U, u.**
- Shkrimin e fjalëve të thjeshta që përmbajnë shkronjën u.

• Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga një rresht me **U, u, mu, ru, ura, muri**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1; 3. 5.		
Njësia mësimore: Shkronja U, fq. 30		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **U**. • Plotëson fjalët me shkronjën **U**. • Lexon fjalë të thjeshta që përmbajnë shkronjën **U**. • Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar.		**Fjalë kyçe:** UFI, ujku, ura, miu, ariu, emri **Teknika dhe strategji:** ❖ Pyetja sjell pyetjen ❖ Vëzhgo-Diskuto- Plotëso ❖ Punë në dyshe		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të ariut, urës, murit, mjete shkrimi.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Lapsat në mes: - Nëse do të kishit një robot si UFI, çfarë do të donit të bënte për ju? ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 1.*** Diskutim për njohuritë paraprake U paraqiten foto të ariut, murit, urës.				

Nxënësit emërtojnë figurat dhe shkruajnë fjalët e tyre në një fletë. Në fund qarkojnë shkronjën u. Mbasi përfuundojnë me të tria fjalët, rishikojnë punën me njëri-tjetrin dhe më pas tre nxënës i shkruajnë në tabelë.

Hapi 2. Vëzhgo-Diskuto- Plotëso

Hapet libri në faqen 29 të Abetares dhe lihen të shprehin mendimet e tyre rreth figurës:

- Ku ndodhen fëmijët?

Lexohet me intonacionin e duhur: UAAA, UUUFIII!

- Pse habiten fëmijët me UFIN?
- Udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Mbasi të shqiptojnë fjalën *UJKU,* nxënësit do të shikojnë grafikun e shkronjës U, do të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera dhe më pas do të shkruajnë shkronjën U në kutizën që duhet.

Ushtrimi i dytë: Duke ndjekur shigjetat nxënësit formojnë fjalë me rrokjet e dhëna, i shkruajnë dhe në fund i lexojnë. (*URA, MIU, MURI. ARIU)*

Hapi 3. Punë në dyshe

Lexojnë në heshtje ushtrimin e fundit.

UNË KAM ROBOT.

ROBOTI IM E KA EMRIN RIU.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit lexojnë fjalitë e ushtrimit të fundit.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **U.**
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën **U**.
- Leximin e fjalëve që përmbajnë shkronjën **U**.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani në një fletë fjalë që përmbajnë shkronjën U.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme.</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1; 3. 5.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 34-35</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën U, u të dorës sipas modelit.
• Shkruan rrokje e fjalë me shkronjat e dorës të mësuara duke parë modelin.
• Shkruan me të diktuar shkronjat e dorës që ka mësuar deri tani dhe fjalë me to.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
ariu, muri, ura, ruan,Urimi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës U, u, U, u ,mjete shkrimi.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shkencat e natyrës</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet vjersha e shkronjës U.
Uuu, sa vapë që bën në verë,
kur ke diellin përmbi kokë!
Uuu sa ftohtë do të bëjë në dimër,
kur të bjerë dëborë mbi tokë.
Pra ne themi shkronjën U
për të shprehur një habi
dhe provuam që ta gjejmë
në shumë fjalë edhe fjali.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

U shpërndahen nxënësve etiketa me shkronjat e mësuara dhe lihen të formojnë fjalë me to.

Fjalët që formojnë nxënësit shkruhen në tabelë dhe lexohen.

ara, ura, ariu, muri, emri, era, Era, Ama, Ema, etj.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **u.** Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën e madhe.

Demonstrohet lidhja e shkronjë u me shkronjat e tjera për të formuar rrokjet ru, ur, mu, um.

Disa nxënës i shkruajnë edhe në tabelë.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 34 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën u sipas modelit.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit në mënyrë të pavarur shkruajnë shkronjën U, u, rrokje dhe fjalë me to duke ndjekur modelin e dhënë. Gjatë punës ndihmohen në lidhjen e shkronjave me njëra-tjetrën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar nga një rresht me U, u, ru, mu, ur, um, ura, muri, Urimi.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës U, u të dorës sipas modelit.
- Shkrimin e rrokjeve e fjalëve me shkronjat dorës të mësuara duke parë modelin.
- Shkrimin me të diktuar të shkronjave të dorës që ka mësuar deri tani dhe fjalëve që formohen me to.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Diktim me shkronjat e dorës të mësuara dhe fjalë me to.

Unë jam ……

Aa



A A A A A A A A

a a a

Unë jam ……..

i i



Unë jam ……



Mm

M M M M

M M M M

M M M M

m m m m

m m m m

m m m m

Unë jam ……





Unë jam ……



E e

E

E

E

e

e

e

Unë jam ……



Uu



<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1, 2; 3. 5.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Përsëritje 1 (faqja 30 e Abetares)</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Dallon shkronjat e mësuara A, I, M, R, E, U.
▪ Shqipton tingujt A, I, M, R, E, U.
▪ Pasuron fjalorin me fjalë që fillojnë me A, I, M, R, E, U, ose i kanë në trup ato.
▪ Lexon rrokjet dhe fjalët e dhëna.
▪ Analizon fjalët duke i ndarë në rrokje e shkronja
▪ Qarkon figura sipas udhëzimeve të dhëna.
▪ Formon fjali të thjeshta me fjalët e faqes.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
shkronjat A, I, M, R, E, U, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, lidh, qarko, analizo</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Punë në grupe
❖ Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjave A, I, M, R, E, U, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjat A, I, M, R, E, U, tabela plastike, figura, fletë A4.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
</table>

Organizimi i orës së mësimit



Veprimtari paraprake

Mësuesja paraqet para nxënësve një pemë të përgatitur me maket ose të vizatuar, me të gjithë shkronjat e alfabetit dhe diskutojmë rreth saj.

- Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe?
- Sa prej tyre janë zanore e sa bashkëtingëllore?
- Le të rikujtojmë shkronjat e mësuara duke i marrë ato nga pema. (shkëputen shkronjat dhe vendosen para tabelës)

  A, I, M, R, E, U
- Cilat nga shkronjat e mësuara janë zanore e cilat bashkëtingëllore?

Nxënësit shqiptojë saktë dhe bukur tingujt përkatës të secilës shkronjë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Rikujtimi i njohurive të marra

Mësuesja paraqet para nxënësve etiketat me të 4 modelet e seciles shkronjë të mësuar dhe nxënësi i emërton ato.

A e madhe e shtypit, **i** e vogël e shtypit, M e madhe e dorës, e e vogël e dorës

- Nga ndryshojnë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës?
- Sa nxënës kemi në klasë qu u fillon emri me shkronjat **A, I, M, R, E, U**?
- Rikujtojmë si shkruhen emrat e njerëzve.

Ushtrohen nxënësit të shkruajnë disa nga këto emra në tabelë.

Hapi 2. Punë në grupe

Mësuesja ndan klasën në 6 grupe dhe secilit prej tyre i shpërndan etiketën e një shkronje të mësuar.

G1 – a, G2 – i, G3 – m, G4 – r, G5 – e, G6 – u

- Gjeni sa me shumë rrokje e fjalë që kanë në trup shkronjën tuaj brenda një kohe të caktuar.

Një nga nxënësit i shkruan ato në një fletë A4 dhe më pas një përfaqësues nga grupi i paraqet ato para klasës.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë rrokje e fjalë të sakta?

Hapi 3. Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur

Hapet libri në faqen 30 te Abetares dhe udhëzohen nxënësit në punimin e ushtrimeve të dhëna.

- **Në ushtrimin e parë** janë dhënë shkronjat e mësuara në të katër format e tyre, shtypi, dore, të mëdha e të vogla. Nxënësi bashkon vizat e dhënë për t'i pasqyruar shkronjat e plota dhe më pas i emërtojnë ato.
- **Në ushtrimin e dytë** nxënësi lidh shkronjat e dhëna me figurat përkatëse, duke u bazuar tek shkronja me të cilën ato fillojnë, psh. *A – arra, M – macja* etj.
- **Në ushtrimin e tretë** për secilën shkronjë janë dhënë disa figura. Nxënësi pasi emërton secilën figurë, do të qarkojë ato figura që lidhen me shkronjën e dhënë, psh. me shkronjën A qarkon– *ariu, akullore, ananas* dhe lë pa qarkuar *librin.*

Mësuesja ushtron nxënësin që fjalet e qarkuara ti analizojë dhe të ndërtojë fjali me to. Në varësi të kohës, kjo mund të bëhet me gojë ose me shkrim në tabelë. P.sh

akullore						
a	Ku		llo		re	
a	k	U	ll	o	r	e

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja u shpërndan nxënësve disa pjesëza nga revista ose gazeta dhe nxënësit qarkojnë shkronjat e mësuara.

Më pas ata i këmbejnë me shokun e bankës dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Në fund mësuesja bën vlerësimet përfundimtare.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjave të mësuara A, I, M, R, E, U.
- ✓ Shqiptimin e saktë të tingujve A, I, M, R, E, U.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që fillojnë me A, I, M, R, E, U, ose i kanë në trup ato.
- ✓ Leximin e rrokjeve dhe fjalëve të dhëna.
- ✓ Analizën e fjalëve duke i ndarë në rrokje e shkronja.
- ✓ Qarkimin e figurave sipas udhëzimeve të dhëna.
- ✓ Formimin e fjalive të thjeshta me fjalët e faqes.

Detyrë shtëpie:

Shkruani nga një rresht për secilën shkronjë në katër format e saj.

Shkruani nga dy fjalë për secilën shkronjë A, I, M, R, E, U.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme.</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2. 1, 2; 3. 5.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Përsëritje 1. Fletore pune, faqja 36</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Shkruan shkronjat e mësuara A, I, M, R, E, U në katër format e tyre.
▪ Krijon rrokje të ndryshme me shkronjat A, I, M, R, E, U.
▪ Lexon rrokje, fjalë e grupe fjalësh.
▪ Krijon fjalë me shkronja e rrokje të dhëna.
▪ Plotëson fjalët me shkronja mungesore.
▪ Kthen fjalët nga shkrim shtypi në shkrim dore.
▪ Shfaq dëshirë e vullnet për të punuar.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
shkronjat A, I, M, R, E, U, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur
❖ Punë në grupe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjave A, I, M, R, E, U, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjët A, I, M, R, E, U , tabela plastike, figura, fletë formati.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Edukim fizik, sporte e shëndet, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsmi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Zhvillohet me nxënësit loja e fjalëve. Klasa ndahet në grupe dhe brenda grupit krijohen çifte. Mësuesja ka përgatitur një kapele më karton, të cilën ia vë në kokë një nxënësi. Tek kapelja ajo vë një foto. Nxënësi që ndodhet përballë ia shpjegon nxënësit që e mban me fjali, lëvizje e shprehi dhe mundohet që ai ta gjejë. Nëse nxënësi e gjen fiton pikë grupi i tij. Më pas ndërrohen vendet.
Fotot janë me pamje e objekte që lidhen me mësimet e zhvilluara.
   </td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1. Rikujtimi i njohurive të marra

Rikujtohen shkronjat e mësuara me anë të etiketave dhe krijohen rrokje me to. Organizohet në formë loje ku mësuesja shpërndan etiketa të ndryshme të secilës shkronjë të mësuar dhe nxënësit lëvizin të lirë nëpër klasë dhe gjejnë shokët e tyre duke krijuar grupe katërshe – katërshe. Më pas prezantohen.

P.sh.

- *Unë jam **M** e madhe e shtypit.*
- *Unë jam **m** e vogël e shtypit.*
- *Unë jam M e madhe e dorës.*
- *Unë jam m e vogël e dorës.*

Të gjithë së bashku: *Shkronja **M** është një bashkëtingëllore.*

Kështu veprohet edhe me rastet e tjera.

Dallohen zanoret nga bashkëtingëlloret e mësuara.

U paraqiten nxënësve etiketa me rrokje e shkronja dhe ato pasi i lexojnë i shkruajnë në fletore me shkronja dore. ma –ma Eri – Eri, mami - mami

Hapi 2. Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur

Hapet fletorja e punës në faqen 36 dhe udhëzohen nxënësit në plotësimin e saj.

Fillimisht nxënësi lexon etiketat e shkronjave A, I, M, R, E, U dhe më poshtë plotëson ato në të katër format e mësuara duke bashkuar vijat dhe duke plotësuar vendet bosh.

- **Në ushtrimin e parë** nxënësi lexon rrokjet e dhëna. Mësuesja udhëzon nxënësin që të krijojë me to edhe fjalë, psh. *mu + ri = muri em + ri = emri ...*
- **Në ushtrimin e dytë** nxënësi lidh shkronjat me figurën e dhënë sipas shkronjës me të cilën ajo fillon. *A – akullore, I – iriqi, M – muri ...*
- **Në ushtrimin e tretë** nxënësi përshkruan figurën dhe më pas plotëson fjalën me shkronjën që mungon. Lexohen fjalët.
- **Në ushtrimin e katërt** me etiketat e dhëna nxënësi krijon fjalë që tregojnë emra njerëzish. Kujtojmë se emrat e njerësve shkruhen me shkronjë të madhe.
  Ushtrohen nxënësit që ti shkruajnë emrat e njerësve në të tria format në fletore, psh.
  ERA – Era – Era

Hapi 3.Punë në grupe.

U paraqiten nxënësve shkronja të ngatërruara dhe udhëzohen të formojnë fjalën e saktë që ka kuptim. Organizohen gjithsej 5 – 6 grupe, psh. *r, i, a, u ---- ariu u, r, i, m --- muri*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja shkruan në tabelë dy fjalë dhe një grupe fjalësh (kjo edhe në varëi të kohës) me shkronja të mëdha shtypi. Ajo udhëzon nxënësin që në fletore të shkruajë fjalën sic është dhe më pas ta rishkruajnë atë me shkronja shtypi të vogla dhe me shkronja dore. P.sh.

- *URA, EMRI, REA ME ERËN E MAMIN.*
- *ura, emri, Rea me Erën e mamin*
- *ura, emri, Rea me Erën e mamin*

Mësuesja kontrollon vazhdimisht punën e nxënësve dhe bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjave të mësuara A, I, M, R, E, U në katër format e tyre.
- ✓ Krijimin e rrokjeve të ndryshme me shkronjat A, I, M, R, E, U.
- ✓ Leximin e rrokjeve, fjalëve e grupeve të fjalëve.
- ✓ Krijimin e fjalëve me shkronja e rrokje të dhëna.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronja mungesore.
- ✓ Kthimin e fjalëve nga shkrim shtypi në shkrim dore.
- ✓ Shfaqjen e dëshirës e vullnetit për të punuar.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani shkronjat e mësuara në 4 format e tyre, nga një rresht secila.
2. Shkruani fjalët e ushtrimit 3 me shkronja shtypi dhe shkronja dore.
3. Qarkoni shkronjat e mësuara tek një fletë reviste ose gazete.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 2; 3. 5.		

Njësia mësimore: Përsëritje 1 (faqja 31 e Abetares)	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Dallon shkronjat e mësuara A, I, M, R, E, U. ▪ Krijon rrokje të ndryshme me shkronjat A, I, M, R, E, U. ▪ Lexon rrokje, fjalë e fjali. ▪ Kthen grupet e fjalëve nga shkrim shtypi në shkrim dore. ▪ Analizon fjalitë duke i ndarë në etiketa. ▪ Tregon me fjali të thjeshta përrallën "Mamadhia dhe kecat". ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit	**Fjalë kyçe:** shkronjat A, I, M, R, E, U, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla. **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Punë në grupe ❖ Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjave A, I, M, R, E, U, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjët A, I, M, R, E, U , tabela plastike, figura, fletë A4, skeda.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim fizik, sporte dhe shëndet, Matematikë, Arte. **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake Identifikimi i shkronjave të mësuara.

Mësuesja u paraqet nxënësve skeda në formë fjalëkryqi me shkronja të ndryshme dhe udhëzon nxënësit të ngjyrosin shkronjat e mësuara.

- A ju ngjan me një forme matematikore pjesa e ngjyrosur?
- Me cilën? (trekëndësh)

q	S	H	t	o	a	p	O	o	j	k
B	V	c	s	m	J	A	G	h	k	n
d	d	g	I	H	Y	Z	u	b	d	sh
v	f	U	c	v	X	n	b	e	xh	k
p	r	s	d	f	B	h	j	k	R	J
E	e	u	i	I	M	R	r	a	E	M
s	d	f	G	H	t	j	J	K	Y	Z
Q	T	Y	O	o	p	T	K	K	n	L

Veprimet në situatë

Hapi 1. Rikujtimi i njohurive të marra

Mësuesja paraqet etiketa të ndryshme me shkronjat e mësuara dhe nxënësit i emërtojnë ato.

- **I** e madhe e shtypit, **r** e vogël e shtypit, U e madhe e dorës, a e vogël e dorës

Më pas ajo paraqet etiketa me rrokje dhe ushtron nxënësit ti lexojnë ato dhe të krijojnë fjalë, psh.

U + Ra URA + = Mi ra Mira

Hapi 2. Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur.

Hapet libri në faqen 31 te Abetares dhe udhëzohen nxënësit në plotësimin e tyre.

- *Në ushtrimin e parë* nxënësi do të lexojë shkronjat e do krijojnë rrokje, të cilat më pas i shkruan, psh. *M+A = MA, R + I = RI ....*
- *Në ushtrimin e dytë* janë dhënë rrokje të krijuara të cilat nxënësi i lexon dhe më pas ua ndërron vendin shkronjave duke krijuar rrokje të reja, psh. *MA – AM, RI – IR ....*
- *Në ushtrimin e tretë* janë dhënë disa grupe fjalësh me shkronja të mëdha shtypi, të cilat nxënësi i lexon, i rishkruan ato me shkronja të vogla shtypi e më pas me shkronja dore.

  URA E RE – ura e re – ura e re ...

  Në ushtrimin e katërt janë dhënë fjali. Nxënësi i analizon ato duke dalluar fjalët që e përbëjnë. Pasi ndan fjalët ai ngjyros kutitë përkatëse dhe diskutojnë rreth tyre.

Ani	luan	me	mua.

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala më e gjatë? Po më e shkurtër?

Hapi 3. Përrallëza

Në tekst janë paraqitur fotot e përrallës “Mamadhia dhe kecat”. Brenda mundësive mësuesja mund të paraqesë në vidioprojektor edhe pjesë nga filmi vizatimor.

Mësuesja ndan klasën në tri grupe dhe secilit prej tyre i jap një foto për të krijuar një pjesë të historisë. Kur grupet janë gati fillojnë të tregojnë dhe krijohet përralla e plotë. Mësuesja ndihmon nxënësit hap pas hapi në shprehitë e tyre.

- *Mamadhia i dha porosi kecave.*
- *Në shtëpi erdhën ujku.*
- *Ujku e pësoi.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në alfabetin e dhënë në fund të faqes 30 – 31 nxënësit ngjyrosin shkronjat e mësuara.

Mësuesja ka përgatitur një fletë pune për nxënësit me 2 -3 ushtrime të thjeshta; shkrimin e shkronjave, krijimin e disa rrokjeve, shkrim fjale sipas figurës. (kjo në varësi edhe të kohës)

Nxënësit punojnë të pavarur dhe mësuesja kontrollon vazhdimisht punën e nxënësve duke dhënë sygjerimet përkatëse dhe në fund bën kontrollin e jep vlerësimit përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjave të mësuara A, I, M, R, E, U.
- ✓ Krijimin e rrokjeve të ndryshme me shkronjat A, I, M, R, E, U.
- ✓ Leximin e rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- ✓ Kthimin e grupeve të fjalëve nga shkrim shtypi në dore.
- ✓ Analizën e fjalive duke i ndarë në etiketa.
- ✓ Tregimin me fjali të thjeshta të përrallës "Mamadhia dhe kecat".

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani një fjalë për secilën shkronjë në tri forma, me shkronja të mëdha shtypi, shkronja të vogla shtypi dhe shkronja dore. Analizo tri prej tyre.
2. (Për nxënësit më të përparuar) Shkruani një fjali për cdo figurë tek përralla "Mamadhia dhe kecat".

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 2; 3. 5.		
Njësia mësimore: Shkronja **N,** fq. 32		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi:		**Fjalë kyçe:**		

<table>
<tr><td>

- Dallon shkronjën ***N, n*** të shtypit.
- Shqipton tingullin ***N*** duke e lidhur me shkronjën ***N***.
- Përshkruan figurën qendrore.
- Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin ***N*** (në pozicione të ndryshme).
- Lexon globalisht fjalë që kanë shkronjën N në trup të tyre.
- Shkruan shkronjë ***N, n*** të shtypit si edhe rrokje te krijuar me to.

</td><td>shkronja N, n, numra, shkronjë, tingull, nxënës

Teknika dhe strategji:
❖ Bashkëbisedim
❖ Vëzhgim – përshkrim
❖ Punë e drejtuar
❖ Analizë -sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës N dhe shkronjave te mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën N, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, etiketa me numra, fletë A4..</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Edukim fizik, sporte dhe shendet
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimatri paraprake
Mësuesja organizon me nxënësit lojën “Thirrja e numrave”. Loja mund të zhvillohet në oborr ose në ambjentet e klasës. Klasa do të ndahen në dy grupe me numër të barabartë nxënësish dhe secili prej tyre mbart nga një numer 1, 2,3... Nxënësit qëndrojnë përballë njëri – tjetrit, mësuesja me një shami në dorë thërreth një numër dhe nga secila skuadër vrapon ai numër për të tërhequr shaminë. Loja përsëritet disa herë.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Bashkëbisedim
Mësuesja i paraqet nxënësve etiketa me numra dhe nxënësit i emërtojnë ato. Pyet:
- Çfarë janë këta që lexuam?
- Përse na duhen numrat?
- Në cilën lëndë mësojmë për numrat?

Hapi 2 Vëzhgim - përshkrim
Hapet teksti i Abetares në faqen 32 dhe përqëndrohemi tek përshkrimi i figurës qëndrore. Mësuesja me anë të disa pyetjeve krijon një bashkëbisedim me nxënësit:
- Në cilin ambjent ndodhemi?</td></tr>
</table>

- Çfarë po bën secili prej fëmijëve?
- Atëherë në cilën orë mësimi janë femijët në foto?
- Çfarë mjetesh kanë përdorur ato?
- Le ti vendosim nga një emër fëmijëve dhe të shohim se cilin numër ka secili prej tyre?
- Po roboti çfarë numri mban në dore?
- Le ta shqiptojmë së bashku fjalën NUMRAT.

Shkruhet fjala në tabelë dhe nxiten nxënësit ta lexojnë globalisht. Dallohet shkronja ***N*** me një ngjyrë tjetër dhe lexohet disa herë. Mësuesja bën kujdes që tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë.

Hapi 3. Punë e drejtuar

Pasi lexohet tingulli i shkronjes mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës ***N*** të madhe të shtypi dhe ***n*** të vogël të shtypit; fillimisht në ajër duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë.

Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plasteline, fije etj

Ushtrohen nxënësit të thonë fjalë që fillojne ose e kanë në trup shkronjën ***N*** dhe mësuesja i shkruan në tabelë duke bërë dallimin e shkronjes ***N*** me një ngjyrë tjetër.



- Shkronja ***N*** është zanore apo bashkëtingëllore?

Klasifikojmë shkronjën ***N*** tek grupi i bashkëtingëlloreve.

Hapi 4. Analizë - sintezë

Nga grupi i fjalëve që mësuesja ka shkruar në tabelë shkëput fjalën *NUMRAT* dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **N.**

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: NU - MRAT.
- Pra, fjala NUMRAT ka dy rrokje. Ku ndodhet shkronja ***N***? (në rrokjen e parë) N-U

Përsëritet veprimtaria edhe për fjalë të tjera, duke kryer analizë e sintezë të tyre.

Hapi 5. Punë individuale

Mësuesja udhëzon nxënësin tek punimi i ushtrimeve të faqes.

- *Ushtrimi i parë:* Duke u bazuar tek simbolet mësuesja shpjegon se do të dëgjojnë me kujdes fjalën e pasqyruar në foto dhe më pas do të ngjyrosin rrethin përkatës se në cilën rrokje është shkronja ***N***, psh.
- Tek fjala NUMRAT, ku e dëgjojmë shkronjën N? (në fillim)

Atëherë ngjyroset rrethi i parë. Nëse shkronja ndodhet në mes rrethori i dytë dhe nëse ndodhet në fund rrethori i tretë. Kur shkronja ndodhet në dy vende mgjyrosen dy rrethore sipas vendit përkatës.

- *Ushtrimi i dytë:* Me atë të ritmit të krijuar nga përplasja e shuplakave nxënësi lexon rrokjet e krijuara. Respektohet hapësira që ritmi i krijuar të dalë sa më i këndshëm.

- NA NA NI NE NU NA NA 1-*2* *1-2-3* *1-2*

Nxënësit bashkojnë pikat dhe krijojnë rrokjet e plota gjatë intërpretimit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten nxënësit të tregojnë sa më shumë fjalë që përmbajnë shkronjën N.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjës ***N, n*** të shtypit.
- ✓ Shqiptimin e tingullit ***N*** duke e lidhur me shkronjën ***N***.
- ✓ Përshkrimin e figurën qendrore.
- ✓ Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin ***N*** (në pozicione të ndryshme).
- ✓ Leximin globalisht të fjalë që kanë shkronjën ***N*** në trup të tyre.
- ✓ Shkrimin e shkronjë ***N, n*** të shtypit si edhe rrokje te krijuar me të

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani 3 rreshta me shkronjën ***N, n.***
2. Shkruani 3 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën ***N***. Mund t'i shoqëroni edhe me vizatime.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**	**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 2; 3. 5.
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 38	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjës **N, n** të shtypit sipas modelit.	**Fjalë kyçe:** Shkronja **N, n**, numra, numëratore, shkronjë, tingull, notë muzikore

▪ Plotëson fjalët me shkronjën që mungon. ▪ Përshkruan figurën e dhënë. ▪ Dallon shkronjën **N, n** në figurën e dhënë. ▪ Ndan fjalët në rrokje. ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyce. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkebisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, numëratore, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **N, n**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **N**, tabela plastike, figura.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Edukim fizik, sporte dhe shëndet

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja ndan klasën në grupe me nga 4- 5 nxënës dhe secilit grup i vendos një numëratore.

Gjithashtu mësuesja mban një të tillë për ilustrim.

- A e njihni këtë mjet mësimor që keni përpara?
- Si quhet?
- Për çfarë e përdorim ne atë?

Me anë të numëratores ne mund të numërojmë dhe mund të kryejmë veprime matematikore.

Mësuesja ilustron me shembuj.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Analizë – sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën NUMËRATORE dhe kryen analizë –sintezë të saj në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën ***N***.



Veçohet shkronja ***N*** dhe nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurse janë edhe në fletoren e punës.

- ***N*** e madhe e shtypit. ***N*** e madhe e dorës

- ***n*** e vogël shtypit **n** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se sot do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 2 Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës ***N, n***, fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4 për shkrimin e shkronjave ***N, n***.



Shkronja ***N*** ka tri hapa përkatës dhe shkronja ***n*** dy hapa.

Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

Hapi 3. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 38. Lexojnë fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës ***N*** dhe më pas në mënyrë globale fjalën NUMËRTORE. Ngjyrosin figurën e dhënë të numëratores.

Nxënësi ushtrohet i pavarur në ushtrimet e dhëna, pas shpjegimit hap pas hapi të mësueses.

- **Në ushtrimin 1** sipas udhëzimeve të dhëna edhe në pjësen e parë të orës nxënësi plotëson grafikun e shkronjës ***N, n*** sipas hapave përkatës.
- **Në ushtrimin 2** nxënësi përshkruan figurën dhe plotëson shkronjën që mungon.Në rastin tonë nxënësi plotëson shkronjën ***N*** të dhënë me pika. Me gojë nxënësit bëjnë analizë të fjalës për të nxjerrë në pah shkronjën e re.
- **Në ushtrimin 3** mësuesja ushtron nxënësin të përshkruajë figurën dhe ambjentin përkatës aty. Në këtë ambjent janë shpërndarë shkronja të ndryshme. Nxënësi qarkon me një ngjyrë sipas dëshirës shkronjën ***N, n,*** e cila gjendet në vende të ndryshme në figurë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën ***N, n*** dhe në varësi të kohës edhe ndonjë nga fjalët e fletores së punës.

Ushtrohen nxënësit të krijojnë fjali me gojë me fjalët kyçe.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës ***N, n*** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjën që mungon.
- ✓ Përshkrimin e figurës së dhënë
- ✓ Dallimin e shkronjën ***N, n*** në figurën e dhënë.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.

✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët kyce.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruani 2 rreshta me grafikun e shkronjes ***N*** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës ***n.*** 2. Shkruani 6 fjalë që përmbajnë shkronjën ***N, n*** në pozicione të ndryshme (2 për secilin). Mund t'i shoqëroni me foto ose vizatime.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 2; 3. 5.		
Njësia mësimore: Shkronja N, fq. 33		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Lexon fjalë e fjali. ▪ Plotëson fjalët me shkronjat e rrokjet që mungojnë. ▪ Bashkon rrokje për të formuar fjalë. ▪ Organizon fjalët për të krjuar fjali. ▪ Shfaq besim dhe vullnet për të punuar.		**Fjalë kyçe:** Shkronja **N, n**, numrat **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive paraprake ❖ Lexim i drejtuar, lexim zinxhir ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në grupe		
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën ***N***, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, etiketa me numra, fletë A4.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Edukim fizik, sporte dhe shëndet **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Mësuesja organizon një lojë më numra në klasë.				

- *Secili nga ju nuk do të ketë një emër, por një numër. Unë do të bëj një pyetje dhe do të them se cili numër do të përgjigjet. Nëse ju nuk përgjigjeni brenda pak sekondash humbisni piken e rreshtit tuaj.*

Mësuesja u thotë nxënësve numrin e tyre sipas vendosjes edhe në regjistër dhe më pas pyet.

- Cili numër vjen pas numrit 4? Le të përgjigjet numri 12.
- .....

Veprimet në situatë

Hapi 1. Rikujtim i njohurive paraprake, Lexim i drejtuar

Mësuesja u sugjeron nxënësve që të rikujtojnë figurën e faqes së mëparshme dhe të diskutojnë rreth saj.

- Në cilën orë mësimore janë nxënësit?
- Çfarë mbajnë disa prej tyre në duar?
- Çfarë po bëjnë nxënësit në tabelë?
- Po roboti?

Ja se si quhen ata; Ana, Iliri, Nini dhe Ufi, i cili është personazhi ynë robot.

- Le të shohim se çfarë ka në duar secili prej tyre?

Mësuesja paraqet në flipchart tekstin "ME NUMRA" bashkë me ilustrimet përkatëse dhe e lexon atë hap pas hapi. Gjatë leximt bëhen edhe pyetje, që të kuptohet më mirë përmbajtja.

- Ana mori numrin 9. Çfarë numri mori Ana? Numrin 9.
- -----

Hapi 2. Lexim zinxhir

Mësuesja udhëzon nxënësit të hapin tekstin e Abetares në faqen 33 dhe bëhet fillimisht leximi i etiketave të shkronjës ***N***. Më pas nxënësit përshkruajnë çfarë shohin në figura.

Ushtrohen nxënësit me radhë (zinxhir) në leximin e fjalive. Kujtojmë që në fund të fjalisë vendoset pikë (.) dhe se emrat e njerëzve shkruhen gjithmonë me shkronjë të madhe.

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit më qarkimin e altërnativës së saktë.

Hapi 3. Punë e pavarur

Sipas simboleve të dhëna mësuesja do t'u shpjegojë nxënësve se çfarë do të punojnë tek secili ushtrim.

- *Në ushtrimin e parë* nxënësit përshkruajnë figurën dhe ndajnë fjalën në rrokje. Ato plotësojnë rrokjen që mungon psh.

  Balena --- ba + le + na

- *Në ushtrimin e dytë* janë dhënë rrokjet dhe nxënësit do t'i bashkojnë ato në mënyrë që fjala të ketë kuptim dhe gjithashtu të përshtatet me foton e ilustruar.



Hapi 4. Punë në grupe

Mësuesja u shpërndan nxënësve etiketa më fjalë, sic jepen edhe tek ushtrimi 3 në tekst. Mirë është që etiketat t'i presë të ngjashme si në libër në mënyrë që fjalia të krijohet si një puzzle.

Pasi i shpërndan grupeve etiketat i udhëzon ato që ti bashkojnë siç duhet dhe të formojnë fjali me kuptim.

- Cili nga grupet e mbaroi më shpejt edhe më saktë?

Lexohet fjalia e krijuar. ***Nini luan me numra.***

E plotësojnë atë edhe në tekst. Bëhet analiza e fjalisë.

- Sa fjalë ka kjo fjali?
- Cila nga fjalët e përmbajnë shkronjën **N, n**?.
- Ku ndodhet ajo në fillim , në mes apo në fund të fjalës?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Lexohen fjalë me etiketa të vendosura në tabelë në mënyrë globale ose jo p.sh.

NATA, NËNA, NËNTA, MAKINA, NUMËRATORJA...

Nxënësit më të përparuar ndërtojnë edhe fjali me to.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjat e rrokjet që i mungojnë.
- ✓ Bashkimin e rrokjeve për të formuar fjalë.
- ✓ Organizimin e fjalëve për të krjuar fjali.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe të vullnetit për të punuar.

Detyrë shtëpie:

1. Lexoni disa herë faqen e Abetares.

2. Shkruani nga një rresht me çdo fjalë të mësuar në ushtrimet 2 e 3. Shoqëroi ato edhe me vizatime.
3. Shkruani një fjali me fjalën NUMRAT.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**	**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 2; 3. 5.
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 39	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan rrokje të formuara me shkronjën ***N.*** ▪ Lexon shkronja, rrokje e fjalë përkatëse në përbërje të së cilës është shkronja **n.** ▪ Kryen analizë të fjalëve. ▪ Formon fjali të thjeshta me fjalë të dhëna. ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** shkronjë, rrokje, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Lexim i drejtuar ❖ Punë në grupe ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, etiketa më shkronja e rrokje, fletë të fotokopjuara me fjalë që përmbajnë shkronjën ***n*** në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja organizon punën në çife. Në tavolinë vendosen etiketat me zanoret e mësuara. Një nxënës mban në dorë etiketën me shkronjën N dhe nxënësi tjetër i drejton një nga etiketat me zanore. Nxënësi i parë lexon rrokjen e krijuar, psh.

N + A = NA

Veprimtaria përsëritet me nxënësin tjetër.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim i drejtur, punë në grupe

A + N = AN

Klasa ndahet në tri grupe. Mësuesja ka përgatitur etiketa më rrokje ose fjalë të shkurtra si:

na, ne, ni, nu, an, en, in, un, Ana, Eni, Ina, Ani, Nina, Nini...

Thërritet emri i një nxënësi nga secili grup (me radhë). Kur ai e lexon skuadra e tij fiton pikë. Nëse jo, humbet dhe vazhdon anëtari i një grupi tjetër.

- Cili grup grumbulloi më shumë pikë?

Hapi 2. Punë e pavarur

Mësuesja pas veprimtarive të mësipërme do të udhëzojë nxënësit të hapin fletoren e punës në faqen 39 për të punuar të pavarur ushtrimet e dhëna, pas rekomandimeve përkatëse.

- **Në ushtrimin 1** nxënësi shkruan rrokjet e krijuara nga bashkimi i shkronjës ***N*** me zanoret e dhëna dhe anajelltas, psh. *N + E = NE, U + N = UN .....*
- **Në ushtrimin 2** janë dhënë në një mur të improvizuar me tulla, rrokje të ndryshme të krijuar me shkronjën ***n***. Nxënësi udhëzohen nga mësuesja që pasi ti lexojë ato të ngjyrosë rrokjet e njejta, brenda një rreshti, qofshin këto të mëdha apo të vogla të shtypit.
- **Në ushtrimin 3** nxënësi lexon duke nisur nga shkronja deri tek fjala, duke shtuar hap pas hapi një shkronjë dhe anasjelltas, psh. *n, nu, num, numr, numra*

Mësuesja ushtron nxënësin që të zhvillojnë analizën e fjalëve të dhëna në ushtrimin pasardhës duke i ndarë ato në rrokje e shkronja.



Shënim: Ushtrimin pasardhës që lidhet me punimin e shkronjës së dorës do të punohet në orën pasardhëse, kur të merren modelet e shkronjës së dorës dhe që përkon me faqen 40.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të krijojnë me goje fjali të thjeshta me fjalët e dhëna në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të shkruajnë ndonjë fjali në fletoren e tyre.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e rrokjeve të formuara me shkronjën ***N.***
- ✓ Leximin e shkronjave, rrokjeve e fjalëve përkatëse në përbërje të së cilës është shkronja ***n.***

✓ Analizën e fjalëve. ✓ Formimin e fjalive të thjeshta me fjalët e dhëna. ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruaj nga një rresht me rrokjet e formuara me shkronjën ***N, n.*** 2. Analizo fjalët: numër, nënta, nina – nana. 3. Nxënësit më të përparuar mund të ndërtojnë fjali me këto fjalë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 2; 3. 5.		
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 40		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Modelon bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës N, n. ▪ Shkruan elementët e shkronjës së dorës. ▪ Plotëson me shkrim dore shkronjën N, n në pozicione të ndryshme. ▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën N, n, rrokje e fjalë me shkrim dore. ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** shkronjat e dorës N, n, rrokje, fjalë, grupfjalësh, modelim. **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Demostrim ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, grafiku i shkronjës N, n dhe shkronjave të mësuara të dorës foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **N**, etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë A4, CD, magnetofon.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja u reciton nxënësve vjershën e shkronjës ***N*** ose e vë atë në magnetofon për ta dëgjuar të regjistruar. Diskutojnë së bashku rreth saj.

N....si nëna që ninulla më tregon,
N ... si nata që me ëndrra të bukura më mbulon,
N... si notari që bukur noton,
N ... si natyra që lulëzon,
e ne me ngjyra na mbulon.

- Çfarë mund të themi për këtë vjershë?
- Sa fjalë me shkronjën ***N*** mbajtët mend?
- A mund t'i shtojmë vargje të tjera vetë?

Veprimet në situatë

Hapi 1. Rikujtim i njohurive të marra

- Ashtu sic ne e dimë tashmë kemi katër forma paraqitjeje për secilën shkronjë. Kemi punuar me shkronjat e shtypit dhe sot do ndalemi tek shkronjat e dorës.

Mësuesja paraqitet etiketat e shkronja **N, n, N, n** në të gjitha format si shtypi dhe dore si dhe fjalë që përmbajnë shkronjën ***n*** në pozicione e lloje të ndryshme shkrimesh.

Lexohen dhe diskutohet rreth tyre për ngjashmëritë dhe ndryshimet.

Zhvillohet përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Bëhet leximi i tyre në kor.

Përsëriten shkronjat ***N, n*****,** të shtypit dhe grafiku i tyre. Nxiten nxënësit të thonë fjalë që fillojnë me **N** dhe shkruhen disa prej tyre.

Hapi 2. Demostrim

Mësuesja paraqet modelin e shkronjës së dorës N, n. Nxënësit ngrenë dorën në ajër dhe lëvizin nën drejtimin e mësueses sipas modelit të shkronjës së dorës N, n. Bëhet dallimi mes shkronjave **N, n** të shtypit nga të dorës. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën. Gjithashtu mësuesja demostron edhe lidhjen e shkronjës N,n me shkronja të tjera për krijimin e rrokjeve e fjalëve. Nxënësi ushtrohet fillimisht në fletë A4 me lapsa ose ngjyra për të mësuar grafikun e tyre.

Hapi 3. Punë e pavarur

Më pas nxënësi punon në fletoren e punës sipas modelit. Paraqet lidhja e shkronjës së re me shkronjat e tjera dhe dallimi i saj me shkronjën M.

Nxënësi fillon me ushtrimin e fundit të faqes 39, ku plotëson fillimisht modelimin e shkronjës ***n*** të vogël të dorës dhe më pas plotëson tek fjalët e dhëna shkronjën n të dorës që mungon.

Më pas nxënësi plotëson rrokjet ; na, ne, ni, nu.

Pas shkronjës së vogël punohet grafiku i shkronjës së madhe të dorës dhe grupet e fjalëve ; N, Nina me ariun, Nani me nënën.

Vëzhgohet plotësimi i faqes duke dhënë udhëzimet përkatëse.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara, fjalë e grupe fjalësh. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

N, n, A, i, M, u, na, ni, nu, ne, Ani, Ina, Nina, numra, Eni me ariun .....

Mësuesja bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës N, n.
- ✓ Shkrimin e elementeve të shkronjave të dorës.
- ✓ Plotësimin me shkrim dore të shkronjës N, n në pozicione të ndryshme.
- ✓ Shkrimin në formë të diktuar të shkronjës N, n, shkronjave të tjera të mësuara, rrokjeve e fjalëve me shkrim dore.
- ✓ Shfaqjen e besimit e vullnetin e treguar gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës N, n.
2. Shkruani rrokje e fjalë me shkronja dore.
3. Korrigjoni diktimin e bërë në klasë.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan fjalë duke parë figura.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Shkronja Ë, fq.34</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Dallon shkronjën Ë, ë të shtypit.
▪ Shqipton tingullin Ë duke e lidhur me shkronjën Ë.
▪ Përshkruan figurën qendrore.
▪ Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin Ë (në pozicione të ndryshme).
▪ Lexon fjalë e fjali të thjeshta që kanë shkronjën Ë në trup të tyre.
▪ Shkruan shkronjën Ë, ë të shtypit si edhe rrokje e fjalë të krijuara me to.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
shkronja Ë, ë, tingull, rrokje, fjalë , fjali.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Bashkëbisedim
❖ Vëzhgim – përshkrim
❖ Analizë -sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Ë dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën Ë, foto të fëmijëve në plazh tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, fletë a4.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Arte, Edukim fizik, sporte dhe shendet
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja udhëzon nxënësit që të mbyllin sytë dhe të dëgjojnë rrëfimin e mësueses. Le të ëndërrojmë së bashku:</td></tr>
</table>

"Po më hahet diçka e ëmbël dhe për këtë arsye mendoj të shkojmë në një ëmbëltore. Kur arrijmë atje shohim lloj lloj ëmbëlsirash, me shije të ndryshme si luleshtrydhe, krem karamel, lajthi, çokollatë. Mendova të zgjedh njërën prej tyre po kë të zgjedh ..., të gjitha ëmbëlsirat janë shumë të mira. Në një moment dal të thërras shkokët e mi që janë jashtë dhe kur kthehem embëlsirat janë zhdukur..... Ç'të ketë ndodhur vallë? Ishim në realitet apo në një ëndërr?!"

Nxënësit hapin sytë dhe diskutojnë rreth kësaj imagjinate.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bashkëbisedim. Analizë - Sintezë

Mësuesja i paraqet nxënësve foto të embëlsirave të ndryshme dhe dyqanit të ëmbëltores. Pyet:

- A ju pëlqejnë ëmbëlsirat?
- Cilat janë të preferuarat tuaja?
- Me çfarë shkronje fillon fjala "ëmbëlsirë"?

Mësuesja prezanton para nxënësve shkronjën ***Ë*** dhe kërkon nga ato të thonë sa më shumë fjalë.

Analizojmë fjalën *ëmbëlsirë* për të nxjerrë në pah shkronjën ***Ë***, por edhe fjalë të tjera

ËM + MBËL + SI +RË KËR + PU + DHË



Veçohet shkronja ***Ë*** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxjerrim etiketat përkatëse të shkronjës ***Ë, ë*** dhe emërtohen ato.

Ë – e madhe e shtypit, ***ë*** - e vogël e shtypit.

Mësuesja bën kujdes që tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë nga ana e nxënësve.

- Shkronja ***Ë*** është zanore apo bashkëtingëllore?

Klasifikojmë ***Ë*** tek grupi i zanoreve duke i rikujtuar edhe njëherë ato.

Hapi 2. Vëzhgim - përshkrim

Hapet teksti i Abetares në faqen 34 dhe përqëndrohen tek përshkrimi i figurës qëndrore. Mësuesja me anë të disa pyetjeve krijon një bashkëbisedim me nxënësit

- Në cilin ambient ndodhemi?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Më çfarë po luajnë ato?
- Çfarë ka në dorë Iliri?
- Po Jona me çfarë po e ndërton kalanë?

Pasqyrohen në tabelë etiketa me fjalitë e dhëna në tekst dhe paralelisht mësuesja në tabelë e nxënësit në libër, ngjyrosin me një ngjyrë shkronjat ***Ë***.

Hapi 3. Punë e drejtuar, analizë

Pasi lexohet tingulli i shkronjes mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës ***Ë*** të madhe të shtypi, fillimisht në ajër duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë formati për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plasteline, fije etj

Hapi 4. Punë individuale

- **Ushtrimi i parë:** Duke u bazuar tek simbolet mësuesja lexon fjalën e pasqyruar në foto dhe më pas nxënësi ngjyros rrethin përkatës, psh.
  Tek fjala ËMBËLSIRË, ku e dëgjojmë shkronjën ***Ë***? (në fillim, në mes dhe në fund)
  Atëherë ngjyrosen të tri rrathët e dhëna.
- **Ushtrimi i dytë:** Me atë të krijimit të ritmit nga përplasja e shuplakave të duarve, nxënësi lexon tingullin e shkronjës ***Ë*** dhe shkruan grafikun e saj fillimisht duke bashkuar pikat.

- ***Ë Ë Ë Ë Ë Ë, 1, 1 – 2, 1 – 2 – 3.***

- **Ushtrimi i tretë:** Me shkronjat e dhëna, por edhe duke u bazuar në figurat, nxënësi formon fjalën dhe e shkruajnë atë, psh. *nëna, rërë, urë.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ndahet klasa në grupe dhe secili prej tyre shkruan shkronjën Ë,ë dhe më pas bën analizën e njërës prej fjalëve të dhëna në ushtrimin 3. *G1- nënë, G2 - rërë, G3 - ura*

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjën ***Ë, ë*** të shtypit.
- ✓ Shqiptimin e tingullit ***Ë*** duke e lidhur me shkronjën ***Ë***.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.
- ✓ Identifikimin me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin ***Ë*** (në pozicione të ndryshme).
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive të thjeshta që kanë shkronjën ***Ë*** në trup të tyre.
- ✓ Shkrimin e shkronjës ***Ë, ë*** të shtypit si edhe rrokje e fjalë te krijuara me to.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani 2 rreshta me shkronjën ***Ë, ë.***

2. Shkruani 3 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën ***Ë***. Mund ti shoqërosh edhe me vizatime.
3. Lexoni tekstin.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjalë duke parë figura.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.
Njësia mësimore: Fletore pune, fq.41	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjës ***Ë, ë*** të shtypit sipas modelit. ▪ Ndan fjalët në rrokje. ▪ Plotëson fjalët me shkronjën që mungon ▪ Ngjyros shkronjën ***Ë, ë*** pasi e ka dalluar nga të tjerat ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Shkronja ***Ë, ë*** e madhe dhe e vogël e shtypit, ëmbëlsira, gërshërë, këmbë, lugë, hënë **Teknika dhe strategji:** ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake, veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkebisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës ***Ë, ë***, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën ***Ë***, tabela plastike, figura, CD, magnetofon.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Mësuesja intërpreton një vjershë për shkronjën Ë, ose e vendos atë në CD.	

- Me kë ngjan shkronja ***Ë***?
- Nga ndryshon ajo nga motra e saj ***E***?

Si dy pika ujë ngjajnë

Veç dy pika uji i ndajnë.

Paraqiten etiketat e shkronjave ***E, e, Ë, ë*** për të parë ndryshimet mes tyre

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Analizë – sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën ËMBËLSIRA dhe kryen analizë –sintezë të saj në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën ***Ë***.



Veçohet shkronja ***Ë*** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Veçohet shkronja ***Ë*** dhe nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurëse janë edhe në fletoren e punës.

- **Ë** e madhe e shtypit. Ë e madhe e dorës
- **ë** e vogël shtypit **ë** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 2 Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës ***Ë, ë***. Fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4 për shkrimin e shkronjave ***Ë, ë***.



Shkronja ***Ë*** punohet me katër hapa, ndërsa shkronja ***ë*** me dy hapa dhe pikat.

Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

Hapi 3. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 41. Lexojnë fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës ***Ë*** dhe më pas në mënyrë globale fjalën ËMBËLSIRA.

Nxënësit ushtrohen në pavarur në ushtrimet e dhëna pas përshkrimit të punës nga ana e mësueses për çdo ushtrim.

- **Në ushtrimin 1** sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës ***Ë*** të madhe të shtypit dhe **ë** të vogël të shtypit.
- **Në ushtrimin 2** nxënësi lexon shkronjat e dhëna dhe ngjyrosin nga brenda të gjitha shkronjat ***Ë, ë*** duke dalluar kështu ato nga të tjerat.
- **Në ushtrimin 3** mësuesja ushtron nxënësin të përshkruajë figurat e dhëna. Nxënësi lexon fjalën në mënyrë globale dhe plotësojnë shkronjën ***Ë*** në vendin e duhur. Me gojë ndërtojmë fjali me fjalët e dhëna.

.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën ***Ë, ë*** dhe në varësi të kohës edhe fjalë nga fletorja e punës.

Mësuesja kontrollon vazhdimisht punën dhe bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës ***Ë, ë*** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjën që mungon.
- ✓ Ngjyrosjen e shkronjën ***Ë, ë*** pasi e ka dalluar atë nga të tjerat.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët e dhëna.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 2 rreshta me grafikun e shkronjes ***Ë*** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës ***ë.***
2. Shkruaj 6 fjalë që përmbajnë shkronjën ***Ë, ë*** në pozicione të ndryshme (2 për secilin). Mund t'i shoqëroni me foto ose vizatime.
3. Formo dy fjali sipas dëshirës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.		

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.
Njësia mësimore: Shkronja Ë, fq. 35	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton saktë tingullin e shkronjës ***Ë, ë.*** ▪ Lexon fjalë e fjali. ▪ Përshkruan me fjalor të thjeshtë figurat e dhëna. ▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit. ▪ Kryen analizë e sintezë të fjalëve. ▪ Organizon fjalët për të krjuar fjali. ▪ Shfaq bësim e vullnet për të punuar	**Fjalë kyçe:** shkronja **Ë, ë**, në rënë, lodrat e ujit, kala me rërë. **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive paraprake ❖ Lexim i drejtuar, lexim zinxhir ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në grupe
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën ***Ë***, tabela plastike, figura, lodra për fëmijë, fletë A4.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth temës "*Në rërë*".

- A ju pëlqen që ti kaloni pushimet verore në det?
- Cilat janë disa nga lodrat e ujit që merrini gjithmone me vete? (lopatë, kove...)
  (brenda mundësive disa prej tyre mund të jenë edhe në klasë gjatë orës së mësimit)
- Çfarë ju pëlqen të ndërtoni buzë detit?
- A jua ka prishur ndonjëherë dallga kalanë me rërë?

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Rikujtim i njohurive paraprake, Lexim i drejtuar

Mësuesja u sugjeron nxënësve që të rikujtojnë figurën e faqes paraprake dhe të diskutojnë rreth saj.

- Ku ndodhen fëmijët?
- Çfarë po ndërtojnë ata?

Ata quhen Iliri dhe Jona. Le të njihemi me tëpër.

Mësuesja paraqet ne flipçart tekstin "NË RËRË" bashkë me ilustrimet përkatëse dhe e lexon atë hap pas hapi. Gjatë leximt mësuesja bën pyetje që të kuptohet përmbajtja.

- Iliri luan me Jonën në rërë. Ku luan Iliri me Jonën? Në rërë.
- -----

Hapi 2. Lexim zinxhir

Mësuesja udhëzon nxënësit të hapin tekstin e Abetares në faqen 35 dhe bëhet fillimisht leximi i etiketave të shkronjës ***Ë***. Më pas nxënësit përshkruajnë çfarë shohin në figura.

Ushtrohen nxënësit me rradhë (zinxhir) në leximin e fjalive. Kujtojmë që në fund të fjalisë vendoset pikë (.) dhe se emrat e njerësve shkruhen gjithmonë me shkronjë të madhe.

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit më qarkimin e altërnativës së saktë.

Hapi 3. Punë e pavarur

Sipas simboleve të dhëna mësuesja u shpjegon nxënësve se çfarë do të punojnë tek secili ushtrim.

- Në ushtrimin e parë nxënësit do të bëjnë analizë të fjalëve duke i ndarë ato në rrokje e shkronja.



Hapi 4. Punë në grupe

Mësuesja u shpërndan nxënësve etiketa më fjalë siç jepen edhe tek ushtrimi 2 në tekst. Mirë është që etiketat t'i presë të ngjashme si në libër në mënyrë që fjalia të krijohet si një puzzle.

Pasi i shpërndan grupeve etiketat i udhëzon ato që ti bashkojnë sic duhet dhe të formojnë një fjali të saktë.

- Cili nga grupet e mbaroi më shpejt edhe më saktë?

Lexohet fjalia e krijuar. ***Jona luan në rërë.***

E plotësojnë atë edhe në tekst. Bëhet analiza e fjalisë.

- Sa fjalë ka kjo fjali?
- Cila nga fjalët e përmbajnë shkronjën ***ë***?
- Ku ndodhet ajo në fillim, në mes apo në fund të fjalës?

Nxënësit plotësojnë gjithashtu edhe pazëllin e shkronjës ***Ë*** duke gjetur alternativën e saktë që e bën atë të plotë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë, të cilat i paraqet në tabelë dhe ushtron nxënësin që ti lexojë ato, psh.

- *RËRË, ERË, ËMBËLSIRË, ENË, ËNDËRR, ...*

Nxënësit më të përparuar ndërtojnë edhe fjali me to.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e saktë të tingullit të shkronjës **Ë, ë.**
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive.
- ✓ Përshkrimin me fjalor të thjeshtë te figurave.
- ✓ Përgjigjet e pyetjeve rreth tekstit.
- ✓ Kryerjen e analizës e sintezës të fjalëve.
- ✓ Organizimin e fjalët për të krjuar fjali.
- ✓ Besimin dhe vullnetin për të punuar.

Detyrë shtëpie:

1. Lexoni disa herë faqen.
2. Shkruani tekstin “NË RËRË”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.		

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 42	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjës ***Ë, ë*** të shtypit sipas modelit. ▪ Ngjyros shkronjën ***Ë, ë*** duke e dalluar atë. ▪ Krijon rrokje të cilat kanë në përbërje shkronjën ***Ë.*** ▪ Lidh rrokjet dhe krijon fjalë. ▪ Krijon fjali me anë të bashkimit të etiketave. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** shkronja ***Ë, ë*** e madhe dhe e vogël e shtypit, rrokje, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës ***Ë, ë***, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën ***Ë***, tabela plastike, figura.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja organizon punën në çife. Në tavolinë vendosen etiketat me shkronja të mësuara. Një nxënës mban në dorë etiktën me shkronjën ***Ë*** dhe nxënësi tjetër i drejton një nga etiketat e tjera me bashkëtingëllore të mësuara më parë. Nxënësi i parë lexon etiketën e krijuar, p.sh.

Veprimtaria përsëritet me nxënësin tjetër.

N + Ë = NË

Ë + M = ËM

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Lexim i drejtur, punë në grupe

Klasa ndahet në tri grupe. Mësuesja ka përgatitur etiketa më rrokje ose fjalë të shkurtra si:

- *në, më, rë, ër, ëm, ën, enë, rërë, urë, nënë ....*

Thërritet emri i një nxënësi nga secili grup (me radhë). Ai lexon etiketën skuadra e tij fiton pikë. Nëse jo, humbet dhe vazhdon një anëtar i grupit tjetër.

- Cili grup grumbulloi më shumë pikë?

Hapi 2. Punë e pavarur

Mësuesja pas veprimtarive të mësipërme udhëzon nxënësin të hapë fletoren e punës në faqen 42 për të punuar ushtrimet e dhëna, pas shpjegimeve e shembujve përkatës të dhënë nga ajo.

- **Në ushtrimin 1** nxënësi përshkruan figurën e dhënë. Jemi në rënën e plazhit ku shohim gjurmë këmbësh si edhe lodra të ndryshme. Nxënësi sheh me kujdes dhe zbulon shkronjën ***Ë*** të krijuar me anë të gjurmëve. Pasi i ka identifikuar, i ngjyros ato.
- **Në ushtrimin 2** janë dhënë rrokje, të cilat nxënësi ua këmben vendet dhe krijon rrokje të reja. ËR --- RË
- **Në ushtrimin 3** nxënësi lidh me shigjetë rrokjet për të formuar fjalë dhe më pas i shkruajnë ato. Nxënësi që mbaron më shpejt u sugjerohet të ndërtojnë fjali të thjeshta me fjalët e dhëna.
- **Në ushtrimin 4** janë dhënë të shkruara me shkronja të mëdha shtypi, të vogla shtypi dhe dore disa fjalë. Nxënësi dallon fjalët e njëjta dhe i ngjyros me një ngjyrë, pra përdoren tri ngjyra.
- **Në ushtrimin 5** mësuesja udhëzon nxënësin të lexojë etiketat e dhëna dhe me to të krijojnë fjali duke i renditur saktë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të krijojnë me goje fjali të thjeshta me fjalët e dhëna në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të shkruajnë ndonjë fjali të thjeshtë në fletoren e tyre të klasës.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës ***Ë, ë*** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Ngjyrosjen e shkronjës ***Ë*** pasi e ka dalluar atë në foton e dhënë.
- ✓ Krijimin e rrokjeve të cilat kanë në përbërje shkronjën ***Ë.***
- ✓ Lidhjen e rrokjeve për të krijuar fjalë.
- ✓ Krijimin e fjalisë me anë të bashkimit të etiketave.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani nga një rresht me rrokjet e formuara me shkronjën ***Ë, ë***
2. Shkruani fjalët arë, urë, rërë.
3. Nxënësit më të përparuar mund të ndërtojnë fjali me këto fjalë.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 43</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës Ë, ë.
▪ Plotëson me shkrim dore shkronjën Ë, ë në pozicione të ndryshme, në rrokje e fjalë.
▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën Ë, ë, rrokje e fjalë me shkrim dore.
▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
shkronja e dorës Ë, ë, rrokje, fjalë, grupfjalësh</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Imagjinatë e drejtuar
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Demostrim
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, grafiku i shkronjës Ë, ë dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën Ë, ë, etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë A4, ngjyra.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Arte</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja vë në sfond këngën e shkronjës Ë
“Ëmbëlsirat që i duam shumë, ëndrrat që shohim në gjumë .....” diskutojnë së bashku rreth saj.
- Si ndiheni kur dëgjoni këtë këngë?
- Cilat nga fjalët e përdorura në këngë përmbajnë në trup të tyre shkronjën Ë.
Mësuesja i pasqyron tek thesi i fjalëve.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1 Imagjinatë e drejtuar

Mësuesja paraqet me etiketa shkronjën ***Ë*** dhe ***ë*** të shtypit dhe i emërtojnë së bashku.

- ***Ë***-e madhe e shtypit, ***ë***–e vogël e shtypit.

Tani le të mbyllim sytë:

"Ngrini dorën me të cilën shkruani duke bërë një hark lart, harkun e rrotullojmë dhe zbresim poshtë. Kur arrijmë në mes të rrugës realizojmë një kthesë... Ecim përsëri deri në fund në formë harkore ku bëjmë përsëri një kthesë të bukur. Më pas vendosim dy pika lart. Ja tek u formua shkronja Ë e madhe e dorës"

Kështu veprojmë edhe me shkronjën ë në mënyrë që nxënësit të mësojnë në fillim formën e shkronjës në ajër.

- Me kë ju ngjan kjo shkronjë?

Mësuesja paraqitet etiketat e shkronjës ***Ë, ë, Ë, ë*** në të gjitha format si shtypi dhe dore si dhe fjalë që përmbajnë shkronjën **ë** në pozicione të ndryshme e në lloje të ndryshme shkrimesh.

Lexohen dhe diskutohen rreth tyre për ngjashmëritë dhe ndryshimet.

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra

Zhvillohet përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Bëhet leximi i tyre në kor.

Hapi 3. Demostrim

Mësuesja paraqet modelin e shkronjës së dorës Ë, ë në tabelë duke përshkruar elementët e hapat përkatës të saj. Bëhet dallimi mes shkronjave **Ë, ë** të shtypit nga të dorës. Ngrihen nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën Ë,ë . Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fleta formati me bojra uji.

Demostrohet gjithashtu lidhja e shkronjës ***ë*** me shkronja të tjera për të krijuar rrokje e fjalë.

Hapi 4. Punë e pavarur

Më pas nxënësi punon në fletoren e punës sipas modelit.

Fillimisht nxënësi ushtrohet në grafikun e shkronjës ë të vogël të dorës, rrokje, fjalë të krijuar me të.

Në ushtrimin pasardhës, përshkruajnë figurën dhe plotësojnë fjalën me shkronjën e munguar që në rastin tonë është shkronja ë

Më pas ato do të paraqesin grafikun e shkronjës Ë të madhe të dorës dhe grupin e fjalësve Nëna me Rinën.

Vëzhgohet plotësimi i faqes hap pas hapi nga mësuesja, e cila jep edhe udhëzimet përkatëse.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara me to, fjalë e grupe fjalësh. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

N, n, A, i, M, u, Ë, ë, më, në, rë, ër, ëm, ën, enë, nënë, Era me Rinën e Anën .....

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës Ë, ë.
- ✓ Plotësimin me shkrim dore të shkronjës Ë, ë në pozicione të ndryshme, të rrokjeve e fjalëve të krijuara me të .
- ✓ Shkrimin në formë të diktuar të shkronjës Ë, ë, shkronjave të tjera të mësuara, rrokjeve e fjalëve me shkrim dore.
- ✓ Shfaqjen e besimit e vullnetin e treguar gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës Ë, ë.
2. Shkruani rrokje e fjalë me shkronja dore, marrë nga fletorja e punës. Shoqëro me foto ose vizatime sipas dëshirës.
3. Korigjoni diktimin e bërë në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme**.**		**Rezultati i të nxënit të temës:** -Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.		
Njësia mësimore: Shkronja O, fq. 36		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Dallon shkronjën **O, o** të shtypit.		**Fjalë kyçe:** shkronja O, o, ora, orari, oktapodi, roboti; tingull, rrokje, fjalë , fjali		

▪ Shqipton tingullin **O** duke e lidhur me shkronjën **O**. ▪ Përshkruan figurën qendrore. ▪ Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **O** (në pozicione të ndryshme). ▪ Lexon fjalë e fjali të thjeshta që kanë shkronjën **O** në trup të tyre. ▪ Shkruan shkronjë **O, o** të shtypit si edhe rrokje e fjalë te krijuara me to.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Bashkebisedim ❖ Vëzhgim – përshkrim ❖ Analizë -sintezë ❖ Punë individuale ❖ Interpretimi i rezultateve
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **O** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **O**, foto ilustruese në lidhje me zbatimin e orarit, tabela plastike, fletë A4, plasteline, fije, makarona.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Edukim fizik, sporte dhe shendet **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja e nis mësimin me një veprimtari ndryshe.

- Merr një qese të errët dhe fus brenda një orë, në mënyrë që nxënësit të mos e shohin. Më pas shkon tek nxënësit dhe i thotë atyre që ta prekin atë dhe të japin mendimin se çfarë mund të jetë. Pa u shprehur mësuesja udhëzon nxënësit ta vizatojnë atë që mendojnë në një fletë formati. Kur nxënësit mbarojnë, mësuesja e zbulon.



- A e gjeti ndokush?
- Për çfarë e përdorim orën?
- Me çfarë fillon fjala "ora"? **O**RA

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bashkëbisedim

Mësuesja i paraqet nxënësve foto të ndryshme të orave dhe pyes nxënësit:

- Si është e ndërtuar ora?
- Për çfarë na shërben neve ajo?
- A i zbatoni ju oraret e vendosura?

Mësuesja prezanton para nxënësve se do të punojnë më shkronjën **O** dhe kërkon nga ato të thonë sa më shumë fjalë. Mësuesja i shkruan tek pema e mendjes dhe shkëput për analizë disa prej tyre.

- Analizojmë fjalën OKTAPODI për të nxjerrë në pah shkronjën ***O***, por edhe fjalë të tjera

OK + TA + PO + DI RO + BO + TI

Veçohet shkronja **O** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxjerrim etiketat përkatëse të shkronjës ***O, o*** dhe emërtohen ato.

O – e madhe e shtypit, **o -** e vogël e shtypit

Mësuesja bën kujdes që tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë nga ana e nxënësve.

Hapi 2 Vëzhgim - përshkrim

Hapet teksti i Abetares në faqen 36 dhe përqendrohen nxënësit tek përshkrimi i figurës qendrore.

Mësuesja me anë të disa pyetjeve krijon një bashkëbisedim me nxënësit.

Secili rresht (grup) përqëndrohet në një nga figurat e dhëna për përshkrimin e saj.

- Çfarë paraqitet në figurë?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Po ju zakonisht në çfarë ore zgjoheni?
- Mëngjesin kur e konsumoni?
- Në cilën orë fillon mësimi?

Atëherë mund të themi se veprimtaritë janë bërë ME ORAR. Mësuesja u lexon nxënësve fjalitë për secilën figurë dhe u shpjegon atyre pse në fund kemi tri pika. Nxënësi plotëson mendimin duke u bazuar tek figura.

Hapi 3. Punë e drejtuar, analizë

Pasi lexohet tingulli i shkronjës mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **O, o** të shtypit, fillimisht në ajër duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë A4, me anë të ngjyrave, për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plasteline, fije etj

Hapi 4. Punë individuale

- **Ushtrimi i parë:** Duke u bazuar tek simbolet mësuesja u shpjegon nxënësve se pas dëgjimit me kujdes të fjalës së pasqyruar në foto, të ngjyrosin rrethin përkatës se ku ndodhet shkronja O, psh.
- Tek fjala *OKTAPODI*, ku e dëgjojmë shkronjën O? (në fillim dhe në mes)

Atëherë do të ngjyrosim dy rrathët e parë. Nxënësit punojnë të pavarur rastet e tjera pas dëgjimit.

- **Ushtrimi i dytë:** Duke ndjekur ritmin nga përplasja e shuplakave të duarve, nxënësi bashkon pikat dhe plotëson grafikun e shkronjës. O O O O O O 1, 1 - 2, 1 – 2 - 3

- **Ushtrimi i tretë:**

  Nxënësi përshkruan fotot e dhëna qarkon shkronjën O tek fjalët e dhëna.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ndahet klasa në grupe dhe secili prej tyre bën analizën e njërës nga fjalët e dhëna në ushtrimin 3.

- *ora, oktapodi, dora, roboti*

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjën **O, o** të shtypit.
- ✓ Shqiptimin e tingullit **O, o** duke e lidhur me shkronjën **O, o**.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.
- ✓ Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **O,o** (në pozicione të ndryshme).
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive të thjeshta që kanë shkronjën **O, o** në trup të tyre.
- ✓ Shkrimin e shkronjës **O**, **o** të shtypit si edhe rrokje e fjalë te krijuara me to.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani 2 rreshta me shkronjën **O, o.**
2. Shkruani 5-8 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën **O, o**. Mund t'i shoqëroni edhe me vizatime.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore:	**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri	-Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 44	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi:	**Fjalë kyçe:**

▪ Shkruan shkronjës **O, o** të shtypit sipas modelit. ▪ Ndan fjalët në rrokje. ▪ Plotëson fjalët me shkronjën që mungon. ▪ Dallon shkronjën **O**, duke e qarkuar atë. ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	Shkronja **O, o** e madhe dhe e vogël e shtypit, ora, robori, torta, kova, koka, balona **Teknika dhe strategji:** ❖ Gjëegjëza ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **O, o**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **O**, tabela plastike, figura, CD, magnetofon.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën **O**, ose e vendos atë në CD.

- Me kë ngjan shkronja **O**?

O... si unazat e lojrave olimpike,

O... si ora që bën tik tak pa pushuar,

O... si aktapodi që tentakulat hap,

.....

Paraqiten etiketat e shkronjave **O, o** dhe emërtohen.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Gjëegjëza, Analizë – sintezë

Mësuesja u lexon nxënësve një gjëegjëzë:

- *Pa zë heshtur numëron, askush punën s'ia mohon. Kush është? (ora)*

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *ora* dhe kryen analizë –sintezë të saj në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **O**.



Veçohet shkronja **o** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurse janë edhe në fletoren e punës.

- **O** e madhe e shtypit. **O** e madhe e dorës
- **o** e vogël shtypit **o** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se sot do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 2. Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **O, o**, fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4 me bojra uji për shkrimin e shkronjave **O, o**.

Si shkronja **O** e madhe e shtypit, ashtu edhe shkronja **o** e vogël e shtypit kanë vetëm një hap

Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.



Hapi 3. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 44.

Lexojnë fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **O**, lexohet fjala ORA me të cilën u punua analiza më parë dhe ushtrohet nxënësi që ta ngjyrosë atë.

Mësuesja shpjegon hap pas hapi dhe nxënësi punon i pavarur.

- **Në ushtrimin 1** sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës **O** të madhe të shtypit dhe **o** të vogël të shtypit.
- **Në ushtrimin 2** mësuesja aktivizon nxënësin të përshkruajë figurat e dhëna. Nxënësi lexon fjalën në mënyrë globale dhe plotëson shkronjën **O** në vendin e duhur. Me gojë ndërton fjali me fjalët e dhëna.
- **Në ushtrimin 3** nxënësi qarkon shkronjën **o** tek fjalët e dhëna pas përshkrimit përkatës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **O, o** dhe fjalët e ushtrimit 3 të fletores së punës.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **O, o** të shtypit sipas modelit.

✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje. ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjën që mungon . ✓ Qarkimin e shkronjes **o**, duke e dalluar nga të tjerat ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët e dhëna. ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruani 2 rreshta me grafikun e shkronjes **O** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **o.** 2. Shkruani 6 fjalë që përmbajnë shkronjën **O, o** në pozicione të ndryshme. (2 për secilin, në fillim, në mes, në fund). Mund t'i shoqëroni me foto ose vizatime. 3. Ndërtoni 1-2 fjali me fjalë nga faqja e mësimit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.		
Njësia mësimore: Shkronja O, fq. 37		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton saktë tingullin e shkronjës **O.** ▪ Përshkruan me fjalor të thjeshtë zbatimin e orarit për veprimtaritë ndryshme gjatë ditës. ▪ Lexon fjalë e fjali. ▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit. ▪ Bashkon rrokjet për të formuar fjalë. ▪ Organizon fjalët për të krjuar fjali.		**Fjalë kyçe:** Shkronja **O, o**, O, o, orar, ora. **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive paraprake ❖ Lexim i drejtuar, lexim zinxhir ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në dyshe		

▪ Shfaq bësim e vullnet për të punuar.	
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **O**, tabela plastike, figura që tregojnë veprimtari gjatë ditës, fletë A4.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth temës "Me orar".

- Në çfarë orë zgjoheni në mëngjes?
- Kur e hani mëngjesin?
- Po detyrat e shtësisë në cilën orë i filloni?
- Sa kohë harxhoni për të luajtur?
- Në çfarë ore shkoni në shtrat për të fjetur?

Në fund mësuesja u sugjeron nxënësve zbatimin e një orari për veprimtaritë bazë gjatë ditës pasi ndikon pozitivisht tek ta.

Veprime në situatë

Hapi 1. Rikujtim i njohurive paraprake, Lexim i drejtuar

Mësuesja u sugjeron nxënësve që të rikujtojnë figurën e faqes paraprake dhe të diskutojnë rreth saj.

- Ne u njohëm me Erën dhe Mirin të cilët zbatonin një orar. Le të rikujtojmë së bashku veprimtaritë e tyre.
- Ne cilën orë zgjoheshin?
- Kur e hanin mëngjesin?
- Në çfarë ore niste mësimi?

Le të njihemi me tëpër me veprimtaritë e tjera gjatë ditës në mësimin e ri.

Mësuesja paraqet në flipçart tekstin "ME ORAR" bashkë me ilustrimet përkatëse dhe e lexon atë hap pas hapi. Mësuesja ilustron me orë veprimtaritë e tyre dhe nxënësit plotësojnë me numër oraret e veprimtarive me ndihmën e mësueses. Fjalitë plotësohen duke u bazuar në figurat e veprimtarive. Gjatë leximit bëhen edhe pyetje që nxënësit të kuptojnë më mirë përmbajtjen.

- Në orën 1 Era dhe Miri ..... Kur drekojnë fëmijet? Në orën 1.

- -----

Hapi 2. Lexim zinxhir

Mësuesja udhëzon nxënësit të hapin tekstin e Abetares në faqen 37 dhe bëhet fillimisht leximi i etiketave të shkronjës **O** në të katër format e saj. Më pas nxënësit përshkruajnë çfarë shohin në figura. Ushtrohen nxënësit me radhë në leximin e fjalive. Kujtojmë që në fund të fjalisë vendoset pikë (.) dhe se emrat e njerëzve shkruhen me shkronjë të madhe.

Fjalitë në faqen tonë janë me tri pika (...). Kjo do të thotë që fjalia nuk ka përfunduar, ajo vazhdon dhe plotësohet bazuar ne figurë.

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit më qarkimin e altërnativës së saktë.

Hapi 3. Punë e pavarur

Sipas simboleve të dhëna mësuesja do t'u shpjegojë nxënësve se çfarë do të punojnë tek secili ushtrim.

- *Në ushtrimin e parë* nxënësit do të plotësojnë fjalën me rrokjen që mungon. Në rastin konkret me **o** dhe **ro**, konkretisht orari dhe roboti.

Hapi 4. Punë në dyshe

Mësuesja ka përgatitur etiketa më rrokje dhe ua shpërndan nxënësve në dyshe. Ato rendisin etiketat për të formuar një fjalë të saktë. Dyshet që mbarojnë më shpejt bëjnë analizë të fjalës dhe krijojnë me gojë fjali me atë fjalë.

Hapi 5. Punë e pavarur

Mësuesja udhëzon nxënësit që të lidhin fjalët për të krijuar fjali sipas modelit të dhënë.

Fjalitë e krijuara janë:

- *Ori mori orën.*
- *Nora luan me robot.*
- *Ola e Ori morën orarin*.

Të pavarur nxënësit ngjyrosin oktapodin e dhënë dhe me gojë ndërtojnë fjali me të

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë të cilat lexohen nga nxënësit. p.sh.

ROBOTI, OKTAPODI, orar, Nora, Ola, piano, dora ...

Nxënësit më të përparuar ndërtojnë edhe fjali me to.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e saktë të tingullit të shkronjës **O**.
- ✓ Përshkrimin me fjalor të thjeshtë te figurave.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive.
- ✓ Përgjigjet e pyetjeve rreth tekstit.
- ✓ Bashkimin e rrokjeve për të krijuar fjalë.
- ✓ Organizimin e fjalëve për të krjuar fjali.
- ✓ Besimin dhe vullnetin për të punuar.

Detyrë shtëpie:

1. Lexoni disa herë faqen e librit.
2. Shkruani të sakta fjalitë e ushtrimit të fundit në libër.
3. Qarkoni në një artikull reviste shkronjat **O.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.		
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 45		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore Nxënësi: ✓ Shkruan shkronjës **O, o** të shtypit sipas modelit. ✓ Krijon rrokje të cilat kanë në përbërje shkronjën **O** ✓ Lidh rrokjet dhe krijon fjalë. ✓ Krijon fjali me anë të bashkimit të etiketave. ✓ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Shkronja **O, o** e madhe dhe e vogël e shtypit, rrokje, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake ❖ Veprimtari e udhëhequr		

	❖ Bashkebisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **O, o**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **O**, tabela plastike, figura.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte,

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja organizon punën në çife. Në tavolinë vendosen etiketat me shkronja të mësuara. Një nxënës mban në dorë etiktën me shkronjën **O** dhe nxënësi tjetër i drejton një nga etiketat e tjera me bashkëtingëlloret e mësuara. Nxënësi i parë lexon etiketën e krijuar, p.sh. M + O = MO

Veprimtaria përsëritet me nxënësin tjetër.

o + r = or

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Lexim i drejtur, punë në grupe

Klasa ndahet në tri grupe. Mësuesja ka përgatitur etiketa më rrokje ose fjalë të shkurtra si:

no, mo, ro, or, om, on, orë, orar, Ori, Rina ....

Thërritet emri i një nxënësi nga secili grup (me radhë). Ai lexon etiketën dhe skuadra e tij fiton pikë. Nëse jo, humbet dhe vazhdon një anëtar i grupt tjetër.

- Cili grup grumbulloi më shumë pikë?

Hapi 2. Punë e pavarur

Mësuesja pas veprimtarive të mësipërme udhëzon nxënësit të hapin fletoren e punës në faqen 45 për të punuar të pavarur ushtrimet e dhëna, hap pas hapi pas shpjegimit të saj.

- **Ushtrimi i parë.** Mësuesja ka përgatitur në flipchart një labirit si ai i ushtrimit të parë në tekst. Ngre një nxënës në tabelë të punojë dhe të tjerët në fletoret e punës. Le të gjejmë folenë e milingonës duke ndjekur shkronjën **o**. - Cila është hyrja e sakta?

- **Në ushtrimin 2** janë dhënë rrokje, të cilat nxënësi ua ndryshon vendet dhe krijon rrokje të reja.
  OR --- RO
- **Në ushtrimin 3** nxënësi lidh me shigjetë rrokjet për të formuar fjalë dhe më pas i shkruan ato. Nxënësit që mbarojnë më shpejt u sugjerohet që të ndërtojnë edhe fjali të thjeshta me ato fjalë.
  Ora, Rinori, mori
- **Në ushtrimin 4** mësuesja udhëzon nxënësit që të lexojnë etiketat e dhëna dhe me to të krijojnë fjali duke i renditur saktë.
  Rinori e mori orën.
  - Sa fjalë ka fjalia?
  - Cila është fjala më e gjatë, po më e shkurtër?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të krijojnë me goje fjali të thjeshta me fjalët e dhëna në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar mund të shkruajnë fjali të thjeshtë në fletoren e tyre.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **O, o** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Krijimin e rrokjeve të cilat kanë në përbërje shkronjën **O.**
- ✓ Lidhjen e rrokjeve për të krijuar fjalë.
- ✓ Krijimin e fjalisë me anë të bashkimit të etiketave.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani nga një rresht me rrokjet e formuara me shkronjën **O, o**.
2. Analizoni fjalët: *ora, Rinori, mori*
3. Ndërtoni fjali me një prej tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.		

<table>
<tr><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 46</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës O, o.
▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën O, o, rrokje e fjalë me shkrim dore.
▪ Kthen fjalinë nga shkrim shtypi në shkrim dore.
▪ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore.
▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Imagjinatë e drejtuar
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Demostrim
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, grafiku i shkronjës O, o dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën O, o etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë A4, ngjyra.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja nxjerr para klasës disa foto objektesh që kanë në trup O (ORË, LIMONI, PIANO, ROBOT, KAMION, ...)
Mësuesja i nxjerr me radhë dhe nxënësit mundohen që ti shkruajnë ato brenda një kohë të caktuar. Në fund mësuesja i shkruan ato në tabelë dhe nxënësit vetëkorigjojnë.
- Sa fjalë të sakta ka shkruar secili?
Përgëzohen nxënësit për punën e tyre.
- Me çfarë shkrimi i shkruajtëm fjalët?
- Sot do të ndalemi tek shkronjat e dorës dhe në fund të orës disa prej këtyre fjalëve do ti shkruajmë me shkrim dore.

Veprimet në situata</td></tr>
</table>

Hapi 1. Imagjinatë e drejtuar

Mësuesja paraqet me etiketa shkronjën **O** dhe **o** të shtypit dhe i emërtojnë së bashku.

O-e madhe e shtypit, o–e vogël e shtypit.

- Tani le të mbyllim sytë

"Ngrini lart dorën me të cilën shkruani duke bërë një rrethore të bukur në ajër.Kujdes! Le të mundohemi të mos i bashkojmë fillimin me mbarimin, por ti kalojmë mbi njëra – tjetrën. Ja tek u formua shkronja O e madhe e dorës."

Kështu veprojmë edhe me shkronjën o në mënyrë që nxënësi të mësojnë në fillim formën e shkronjës në ajër.

Nëse ka mundësi mësuesi pasqyron në vidioprojektor grafikun e shkronjës O, o.

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra

Zhvillohet përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Bëhet leximi i tyre në kor.

Hapi 3. Demostrim

Paraqitet modeli i shkronjës së dorës O, o në tabelë duke përshkruar elementët e hapat përkatës të saj. Bëhet dallimi mes shkronjave **O, o** të shtypit nga të dorës. Ngre nxënës në tabelë të shkruajnë shkronjën O,o . Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fletë A4 me anë të ngjyrave, për të mësuar dorën.

Demostrohet gjithashtu lidhje e shkronjës **o** me shkronja të tjera për të krijuar rrokje e fjalë.

Hapi 4. Punë e pavarur

Më pas nxënësi punon në fletoren e punës sipas modelit.

Fillimisht nxënësi ushtrohen në grafikun e shkronjës o të vogël të dorës e rrokjeve të krijuara me të.

Më pas ato paraqesin grafikun e shkronjës O të madhe të dorës dhe shkruajnë fjalinë:

- Ori e mori orarin.

Në vazhdim, nxënësi pasi lexon fjalitë e dhëna me shkrim shtypi, i shkruan ato duke i kthyer në shkrim dore.

Kontrollohet puna e nxënësve duke dhënë sugjerimet e vlerësimet përkatëse.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara me të e me shkronja të mësuara, fjalë e grupe fjalësh. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

O, o. N, n, A, i, M, u, Ë, ë, mo, no, ro, or, om, on, orar, orë, mora, Ori e Oni, Enea dhe Ola **Vlerësohen nxënësit për:** ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës O,o. ✓ Shkrimin në formë të diktuar shkronjën O, o, rrokjeve e fjalëve me shkrim dore. ✓ Kthimin e fjalive nga shkrim shtypi në shkrim dore. ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore. ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruani nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës O, o. 2. Shkruani 10 fjalë me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën **o**. Shoqëroni disa prej tyre edhe me foto ose vizatime. 3. Korrigjoni diktimin e bërë në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjalë duke parë figura.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.		
Njësia mësimore: Shkronja L, fq. 38		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Dallon shkronjën **L, l** të shtypit. ▪ Shqipton tingullin **L** duke e lidhur me shkronjën **L**.		**Fjalë kyçe:** shkronja **L, l**, loja me litar, luani, delfini, lepuri,limoni; tingull, rrokje, fjalë , fjali		

▪ Përshkruan figurën qendrore ne lidhje me lojen. ▪ Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **L** (në pozicione të ndryshme). ▪ Lexon fjalë që kanë shkronjën **L** në trup të tyre. ▪ Shkruan shkronjë **L, l** të shtypit si edhe rrokje e fjalë te krijuara me to.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Bashkëbisedim ❖ Vëzhgim – përshkrim ❖ Demostrim ❖ Punë individuale ❖ Interpretim i rezultateve
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **L** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **L**, foto ilustruese lojëra të ndryshme, litar, tabela plastike, figura, fletë A4.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Edukim fizik, sporte dhe shendet **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja nxjerr përpara klasës foto të cilat tregojnë lojëra të ndryshme dhe u kërkon nxënësve që t'i emërtojnë ato. Në mes ajo ka shkruar fjalën LOJËRA dhe anash ngjit fotot me rradhë.



Le të zhvillojmë së bashku lojën "Tërheqja e litarit". Mirë është që loja të zhvillohet në mjedis të hapur, por në pamundësi mund të zhvillohet ne klasë nga dy grupe nxënësish.

Mësuesja u tregon nxënësve mënyrën e organizimit dhe rregullat e lojës.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bashkëbisedim

Pas organizimit të lojës, mësuesja zhvillon një bashkëbisedim:

- A ju pëlqejnë lojërat?
- Cila është loja juaj e preferuar?
- A i zbatoni rregullat e lojës?
- Si do të ishte një lojë pa rregulla?

- Pse lojërat dhe aktivitetet sportive bëjnë mirë për trupin tonë?

Mësuesja prezanton para nxënësve se do të punojnë më shkronjën **L**, ashtu si LOJËRAT dhe kërkon nga ato të thonë sa më shumë fjalë. Mësuesja i shkruan ato në pemën e mendjes.



Analizohet fjalën *LOJA* për të nxjerrë në pah shkronjën **l**, por edhe fjalë të tjera.

LO + JA, LI + TAR

Veçohet shkronja **L** dhe shqiptohet tingulli i saj. Nxirren etiketat e shkronjës **L, l** dhe emërtohen ato.

L – e madhe e shtypit, **l** - e vogël e shtypit

Mësuesja bën kujdes që tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë nga ana e nxënësve.

Hapi 2. Vëzhgim - përshkrim

Hapet teksti i Abetares në faqen 38 dhe përqëndrohen tek përshkrimi i figurës qëndrore. Mësuesja me anë të disa pyetjeve krijon një bashkëbisedim me nxënësit. Paraqitet loja me litar që nxënësit e kryen në fillim të orës së mësimit.

- Çfarë paraqitet në figurë?
- Çfarë loje po luajnë fëmijët?
- Cilët janë anëtarët e secilës skuadër?
- Ushtroj nxënësit të lexojmë emrat.
- Cilat ishin rregullat e lojës me litar?

Lojërat janë shumë argëtuese, kur luhen me pasion dhe zbatohen rregullat përkatëse.

Hapi 3. Demostrim

Pasi lexohet tingulli i shkronjes, mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **L, l** të shtypit, fillimisht në ajër duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë formati, me bojra uji për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me makarona, plasteline, fije etj

Klasifikohet shkronja **L, l** në grupin e bashkëtingëlloreve.

Përsëritje në kor e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë me to.

Hapi 4. Punë individuale

- **Ushtrimi i parë:** Duke u bazuar tek simbolet mësuesja shpjegon se pas dëgjimit me kujdes të fjalëve të pasqyruara në foto,nxënësi ngjyros rrethin përkatës. Psh:

-Tek fjala *luani*, ku e dëgjojmë shkronjën **L**? (në fillim)

Atëherë ngjyroset rrethi i parë. Nxënësit punojnë të pavarur rastet e tjera, pas dëgjimit përkatës.

- **Ushtrimi i dytë:** Me atë të përplasjes ne shuplakave të duarve dhe ritmit përkatës, nxënësi bashkon pikat dhe krijon rrokjet. LA LA LI LE LU 1 - 1 1 – 2 – 3.
- **Ushtrimi i tretë:** Nxënësi plotëson fjalët me rrokjet *li, lu, lo* dhe më pas i lexon të plota ato.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ndahet klasa në 3 grupe dhe secili prej tyre bën analizën e dy fjalëve të ushtrimin 3, përkatësisht:

- *Grupi 1 – limoni, loja Grupi 2 – lulja, luga Grupi 3 – mali, lumi*

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjën **L, l** të shtypit.
- ✓ Shqiptimin e tingullit **L, l** duke e lidhur me shkronjën **L, l**.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.
- ✓ Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **L**.
- ✓ Leximin e fjalëve që kanë shkronjën **L** në trup të tyre.
- ✓ Shkrimin e shkronjës **L, l** të shtypit si edhe rrokje e fjalë te krijuara me to.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani 2 rreshta me shkronjën **L, l.**
2. Shkruani 6-8 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën **L, l**.
3. Ndërtoni fjali me dy prej tyre.
4. Lexoni faqen e librit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore:	**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri	-Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5.
Njësia mësimore: Fletore pune, fq.47	**Kriteret e suksesit:**

	Përcaktohen me nxënësit në klasë.
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjës **L, l** të shtypit sipas modelit. ▪ Ndan fjalët në rrokje. ▪ Dallon shkronjën **L, l**, duke e ngjyrosur atë. ▪ Lexon rrokjet dhe dallon figurën përkatëse që lidhet me to. ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Shkronja **L, l** e madhe dhe e vogël e shtypit, dallo, ngjyros **Teknika dhe strategji:** ❖ Gjëegjëza ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **L, l**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **L**, tabela plastike, figura, CD, magnetofon.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën **L**, ose e vendos atë në CD.

-Me kë ngjan shkronja **L**?

L... si lumi që rrjedh ditë e natë,

L... si lejleku me qafën e gjatë,

L... si lopa që qumësht dhuron,

L... si luleshtrydhet plot ëmbëlsi

.....

Paraqiten etiketat e shkronjave **L, l** dhe emërtohen. Pasqyrohen edhe modelet e krijuara një orë më parë me plastelinë, fije apo tela.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Gjëegjëza, Analizë – sintezë

Mësuesja u lexon nxënësve një gjëegjëzë:

- *Majën nën thikë, fillon të hollohet, shënon vizë – pikë, por ngadalë shkurtohet.*
- *Kush është? (lapsi)*

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *lapsi* dhe kryen analizë –sintezë të saj, në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **l**.



Veçohet shkronja **L, l** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurse janë edhe në fletoren e punës.

- **L** e madhe e shtypit. **L** e madhe e dorës
- **l** e vogël shtypit **l** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se sot do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 2. Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **L, l**. Fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4 me anë të ngjyrave, për shkrimin e shkronjave **L, l**. Shkronja **L** e madhe e shtypit shkruhet me anë të dy lëvizjeve, kurse shkronja **l** e vogël e shtypit vetëm me një lëvizje.

Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.





Hapi 3. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 47.

Lexojnë fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **L** dhe më pas fjalën LAPSI, të cilën e analizuam në fillim. Nxënësi ngjyros figurën përkatëse.

Nxënësit do të ushtrohen të pavarur në ushtrimet e dhëna.

- **Në ushtrimin 1** sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës **L** të madhe të shtypit dhe **l** të vogël të shtypit.
- **Në ushtrimin 2** nxënësi dallon shkronjën **L, l** ndër të tjera dhe ngjyros atë.
- **Në ushtrimin 3** janë dhënë rrokje të formuara me shkronjën **L**. Lexon: *LA, LI, LE, LU, LO*. Nxënësi dallon figurën që fillon me rrokjen e dhënë duke e ngjyrosur atë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **L, l** dhe në varësi të kohës të shkruajnë fjalët që ngjyrosen në ushtrimin 3.

Ushtrohen nxënësit të krijojnë me gojë fjali me to. **Vlerësohen nxënësit për:** ✓ Shkrimin e shkronjës **L, l** të shtypit sipas modelit. ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje. ✓ Dallimin e shkronjës **L, l**, duke e ngjyrosur atë. ✓ Leximin e rrokjeve duke dalluar figurën përkatëse që lidhet me to. ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët kyçe. ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruani 2 rreshta me grafikun e shkronjes **L** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **l**. 2. Shkruani 6 fjalë që përmbajnë shkronjën **L, l** në pozicione të ndryshme (2 për secilin). Mund t'i shoqëroni me foto ose vizatime. 3. Ndërtoni 1-2 fjali me fjalë nga faqja e mësimit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: **-**Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.		
Njësia mësimore: Shkronja L, fq. 39		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton saktë tingullin e shkronjës **L.** ▪ Përshkruan me fjalor të thjeshtë lojen me litar.		**Fjalë kyçe:** Shkronja **L, l,** loja me litar, rregulla, fitues, emrat e njërëzve, emrat e kafshëve, shkronjë e madhe		

▪ Lexon fjalë e fjali.. ▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit. ▪ Shkruan me shkronjë të madhe emrat e njerëzve dhe kafshëve. ▪ Kryen analizë të fjalive. ▪ Organizon fjalët për të krjuar fjali. ▪ Shfaq besim e vullnet për të punuar.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive paraprake ❖ Lexim i drejtuar, lexim zinxhir ❖ Punë në dyshe ❖ Lojë ❖ Interpretim i rezultateve
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **L**, tabela plastike, figura që tregojnë lojëra të ndryshme, fletë A4, flipçart, maket me fjalëkryq	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja ka përgatitur një maket me fjalëkryq. Ky fjalëkryq përmban fjalë të cilat lidhjen me lojëra. Nxënësit ngjyrosin sipas dëshirës, pasi zbulojnë fjalën. Fjalët mund të jenë vertikalisht, horizontalisht ose diagonal. Maketi eshtë shoqëruar edhe me foto te lojërave të ndryshme.





L	M	F	I	T	O	R	E
A	I	L	L	E	T	R	A
L	E	T	R	L	O	J	Ë
U	T	Ë	A	O	G	O	L
A	O	I	N	R	M	I	E
J	P	F	U	T	B	O	LL





Veprime në situatë

Hapi 1. Rikujtim i njohurive paraprake, Lexim i drejtuar

Mësuesja u sygjeron nxënësve që të rikujtojnë figuren e faqes paraprake e cila lidhet edhe me figurën e mësimit të sotëm.

- Çfarë loje po luajnë fëmijët?
- Cilët janë anëtarët e skuadrës së parë?
- Po anëtarët e skuadrës së dytë?
- Veç fëmijëve cilët po marrin pjesë në lojë?

Ushtroj nxënësit të lexojnë emrat.

Mësuesja paraqet ne flipçart tekstin “LOJA ME LITAR” bashkë me ilustrimet përkatëse dhe e lexon atë hap pas hapi. Gjatë leximt bëhen edhe pyetje për të kuptuar më mirë përmbajtjen.

- Jona mori litarin. Kush e mori litarin? Jona
- -----

Mësuesja udhëzon nxënësit që të shohin se si janë shkruar emrat e njerëzve dhe të kafshëve. Ashtu siç edhe është përmendur në mësimet më parë, mësuesja thekson përsëri se emrat e njerëzve dhe të kafshëve shkruhen me shkronjë të madhe.

Hapi 2. Lexim zinxhir

Mësuesja udhëzon nxënësit të hapin tekstin e Abetares në faqen 39 dhe bëhet fillimisht leximi i etiketave të shkronjës **L** në të katër format e saj.

Ushtrohen nxënësit me radhë (zinxhir) në leximin e fjalive.

Mësuesja në tekstin e përgatitur dhe nxënësit në libër analizojnë fjalitë e tekstit duke i ndarë në etiketa.

Jona	luan	me	Ilirin	Anën	e	Milin.
1	2	3	4	5	6	7

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit me gjetjen e alternativave së sakta.

Ushtrohen nxënësit në tabelë që të shkruajnë një emër njëriu ose kafshe sipas dëshirës.

Hapi 3. Punë në dyshe

Mësuesja ka përgatitur etiketa me fjalë dhe ua shpërndan nxënësve në dyshe. Ato rendisin saktë etiketat për të formuar fjalinë. Më pas shkruajnë fjalinë e saktë në tekst. *Era luan me Drinin.*

Hapi 4. Lojë

Mësuesja argëton nxënësit duke zhvilluar lojën *“Gjej fjalën e saktë”*. Loja organizohet nga tri grupe. Fillimisht lojën e nis mësuesja. Ajo i thotë nxënësit të parë të secilit grup në vesh një fjalë, që ka në përbërje shkronjën **L**. Nxënësi ia thotë shokut e kështu me rradhe. Nxënësi i fundit thotë fjalën me zë të lartë.

- Cila nga grupet e tha të saktë fjalën?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit të shkruajnë në fletoret e tyre sa më shumë emra njerëzish, konkretisht të shokëve të klasës ose familjarëve për rreth 5 minuta.

Mësuesja kontrollon dhe bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e saktë të tingullit të shkronjës.
- ✓ Përshkrimin me fjalor të thjeshtë te figurave.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive.
- ✓ Përgjigjet e pyetjeve rreth tekstit.
- ✓ Shkrimin saktë të emrave të njerëzve e kafshëve.
- ✓ Organizimin e fjalëve për të krjuar fjali.
- ✓ Analizën e fjalive.
- ✓ Besimin dhe vullnetin për të punuar.

Detyrë shtëpie:

1. Lexoni disa herë faqen e librit.
2. Shkruani emrat e pjesëtarëve të familjes.
3. Ndërtoni fjali me fjalët: *lojë, litar, limoni, lepur.*
4. Qarkoni në një artikull reviste shkronjat **L.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore:	**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri	-Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 48	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi:	**Fjalë kyçe:**

<table>
<tr><td>

- Shkruan shkronjës **L, l** të shtypit sipas modelit.
- Krijon rrokje të cilat kanë në përbërje shkronjën **L.**
- Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje.
- Krijon fjali me anë të bashkimit të etiketave.
- Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.

</td><td>Shkronja L, l e madhe dhe e vogël e shtypit, rrokje, fjalë, fjali

Teknika dhe strategji:
❖ Punë në dyshe
❖ Bashkëbisedim
❖ Punë e pavarur
❖ Interpretimi i njohurive</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës L, l, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën L, tabela plastike, figura kafshësh.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte.</td></tr>
<tr><td colspan="2">

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja ndan klasën në 4 – 5 grupe dhe le si dëtyre, të gjejnë dhe të shkruajnë sa më shumë emra kafshësh që kanë në trup shkronjën **L, l**. Një anëtar i grupit i shkruan ato në një fletë formati.

- *luani, lepuri, lopa, dele, pula, delfin, kali, leopardi ....*

Në fund një përfaqsues nga secili grup pasqyron fletën para klasës. Numërohen fjalët e sakta dhe nxirret grupi fitues, të cilit i jepet një flamuri fitues.

Veprimet në situatë

Hapi 1 Punë në dyshe

Mësuesja organizon punën në dyshe. Në tavolinë vendosen etiketat me shkronja të mësuara. Një nxënës mban në dorë etiktën me shkronjën **L, l** dhe nxënësi tjetër i drejton një nga etiketat e tjera me zanoret e mësuara. Nxënësi i parë lexon etiketën e krijuar, p.sh.

L + A = LA

Veprimtaria përsëritet me nxënësin tjetër.

e + l = el

Hapi 2. Punë e pavarur

</td></tr>
</table>

Mësuesja pas veprimtarive të mësipërme udhëzon nxënësit të hapin fletoren e punës në faqen 48 për të punuar të pavarur ushtrimet e dhëna.

- **Në ushtrimin 1** nxënësi krijon rrokje me shkronjën **L, l** dhe i shkruan ato: *LA, LI, LE, LU, LO,..... AL, IL, EL, UL, OL*
- **Në ushtrimin 2** nxënësi përshkruan kafshët e dhëna dhe plotësojnë tabelën me numrin e tyre.

- Sa luanë janë? 4. Atëherë nxënësi ngjyros 4 rrethorë.

- **Në ushtrimin 3** nxënësi zbulon fjalën e re duke marrë shkronjën e parë të secilës fjalë të dhënë. Lexohen fjalët e dhëna dhe më pas fjala e re.

  miu, ariu, lule, iriqi --- mali

- **Në ushtrimin 4** mësuesja udhëzon nxënësin të lexojnë etiketat e dhëna dhe me to të krijojnë fjali duke i renditur saktë ato.

  Laura luan me lule mali.

  - Sa fjalë ka fjalia?
  - Cila është fjala më e gjatë, po më e shkurtër?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të krijojnë me goje fjali të thjeshta me fjalët e dhëna në fletoren e punës. Nxënësit më të përparuar shkruajnë ndonjë fjali të thjeshtë në fletoren e tyre.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **L, l** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Krijimin e rrokjeve të cilat kanë në përbërje shkronjën **L**.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë e shprehje.
- ✓ Krijimin e fjalive me anë të bashkimit të etiketave.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani nga një rresht me rrokjet e formuara me shkronjën **L, l.**
2. Ndërtoni fjali me fjalët që tregojnë kafshë në ushtrimin 2.
3. Në një revistë qarkoni shkronjën **L, l**.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
-Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 49</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
✓ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës L, l.
✓ Shkruan fjalë duke i kthyer nga shkrim shtypi në shkrim dore.
✓ Shkruan në formë të diktuar shkronjën L, l, rrokje e fjalë me shkrim dore.
✓ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore.
✓ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Imagjinatë e drejtuar
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Demostrim
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, grafiku i shkronjës L, l dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën L, l etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë A4, ngjyra.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake. Kënga e shkronjës L
Mësuesja vë në sfond këngën e shkronjës L dhe udhëzon nxënësit që të jenë të vëmendshëm dhe të mbajnë mend sa më shumë fjalë që kanë në përbërje shkronjën L nga teksti i këngës.
Në fund të këngës nxënësit plotësojnë thesin e fjalëve.

Veprimet në situata
Hapi 1. Imagjinatë e drejtuar</td></tr>
</table>

Mësuesja paraqet me etiketa shkronjën **L** dhe **l** të shtypit dhe i emërtojnë së bashku.

L-e madhe e shtypit, **l**–e vogël e shtypit.

- Tani le të mbyllim sytë

"Ngrini lart dorën me të cilën shkruani dhe bëni një hark të bukur si valë deti e kthyer. Pasi bëjmë kthimin ulemi poshtë dhe pa shkuar ende në fund bëjmë një tjetër rrotullim poshtë nga e majta dhe lëvizim sërish si një valë deti". Ja tek u formua shkronja L e madhe e dorës.

Kështu veprojmë edhe me shkronjën l në mënyrë që nxënësit të mësojnë në fillim formën e shkronjës në ajër.

Nëse ka mundësi mësuesi pasqyron në videoprojektor grafikun e shkronjës L,l

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra

Zhvillohet përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Bëhet leximi i tyre në kor, si edhe e rrokjeve e fjalëve të krijuara me to.

Hapi 3. Demostrim

Paraqitet modeli i shkronjës së dorës L, l në tabelë duke përshkruar elementët e hapat përkatës të saj. Bëhet dallimi mes shkronjave **L, l** të shtypit nga të dorës. Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën L,l . Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fletë A4 me anë të ngjyrave për të mësuar dorën. Demostrohet gjithashtu lidhje e shkronjës **l** me shkronja të tjera për të krijuar rrokje e fjalë.

Hapi 4. Punë e pavarur

Nxënësi punon fletoren e punës sipas modelit.

Fillimisht nxënësi ushtrohen në grafikun e shkronjës l të vogël të dorës e rrokjeve të krijuara me të. Ata gjithashtu shkruajnë grupin e fjalëve lule me erë.

Më pas nxënësi plotëson grafikun e shkronjës L të madhe të dorës dhe shkruan fjalinë:

- Laura luan me Ilirin.

Nxënësit lexojnë shkronjat, rrokjet, fjalët e fjalitë me shkrim dore.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara me to, fjalë e grupe fjalësh. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

- L, l, la, le, lo, li, lë, al, el, ël, ol, ul, lule, Lori, Laura, Lela luan me Elën. ....

Vlerësohen nxënësit për: ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës L,l. ✓ Shkrimin e fjalëve duke i kthyer nga shkrim shtypi në shkrim dore. ✓ Shkrimin në formë të diktuar të shkronjës L, l, rrokjeve e fjalëve me shkrim dore. ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore. ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruani nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës L, l. 2. Shkruani 10 fjalë me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën l. Shoqëro disa prej tyre edhe me foto ose vizatime. 3. Korrigjoni diktimin e bërë në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjalë duke parë figura.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.		
Njësia mësimore: Shkronja K, fq. 40		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton tingullin **K** duke e lidhur me shkronjën **K**. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë që fillojnë me **K** ose që përmbajnë shkronjën **k** në trup të tyre. ▪ Përshkruan figurën qendrore. ▪ Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **K** (në pozicione të ndryshme). ▪ Plotëson sipas figurës fjalët me rrokje mungesore.		**Fjalë kyçe:** Shkronja **K, k**, kinema, kali, kala, ketri, këmishë, koka, keku, kurora; tingull, rrokje, fjalë , fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Bashkëbisedim ❖ Analizë -sintezë ❖ Vëzhgim – përshkrim ❖ Demostrim		

▪ Lexon fjalët e fjalorit të librit .	❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **K** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **K**, foto ilustruese, tabela plastike, fletë A4,videoprojektor, kompjuter.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja mundohet ta shndërrojë klasën në një sallë kinemaje, ku me anë të një videoprojektori paraqet një përrallë të shkurtër ose dokumentar për kafshët. Një variant tjetër është që nxënësit mund ta shohin atë në sallën e kompjuterave.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bashkëbisedim

Pas filmit, mësuesja zhvillon një bashkëbisedim:

- Me kë ju ngjau klasa në këtë fillim mësimi?
- A ju pëlqeu filmi?
- Ju a keni qenë ndonjëherë në kinema?
- Çfarë rregullash duhet të zbatojmë në kinema?

Mësuesja prezanton para nxënësve se do të punojnë më shkronjën **K**, ashtu si fjala KINEMA dhe kërkon nga ato të thonë sa më shumë fjalë. Mësuesja i shkruan ato në pemën e mendjes.



Analizojmë fjalën KINEMA për të nxjerrë në pah shkronjën **K**, por edhe fjalë të tjera.

KINEMA = KI + NE + MA **K** + I, KALI = KA + LI **K** + A

Veçohet shkronja **K** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxjerrim etiketat përkatëse të shkronjës **K, k** dhe emërtohen ato.

K – e madhe e shtypit, **k -** e vogël e shtypit

- Shkronja **K** është zanore apo bashkëtingëllore? Klasifikohet shkronja **K** te grupi i bashkëtingëlloreve.

Mësuesja bën kujdes që tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë nga ana e nxënësve.

Hapi 2. Vëzhgim - përshkrim

Hapet teksti i Abetares në faqen 40 dhe përqëndrohen tek përshkrimi i figurës qëndrore. Mësuesja me anë të disa pyetjeve krijon një bashkëbisedim me nxënësit.

- Çfarë paraqitet në figurë?
- A ngjan kjo me atmosferën në klasën tonë?
- Këtu jemi në kinema. Çfarë vëzhgoni tek filmi që ata po shohin?
  (kalin, ketrin, kërmillin, kërpudha)

Mësuesja ushtron nxënësit që të krijojnë fjali bazuar tek figura.

Hapi 3. Demostrim

Pasi lexohet tingulli i shkronjes, mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **K, k** të shtypit, fillimisht në ajër duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë A4 me anë të ngjyrave, për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plastelinë, fije etj

Përsëritje në kor e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara, si dhe rrokje e fjalë me to.

Hapi 4. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Duke u bazuar tek simbolet mësuesja shpjegon se pas dëgjimit me kujdes të fjalës në foto nxënësi ngjyros rrethin përkatës, nëse shkronja **K** është ne fillim, në mes apo në fund të fjalës.Psh:

- Tek fjala *kala*, ku e dëgjojmë shkronjën **k**? (në fillim)

Atëherë nxënësi ngjyros rrethin e parë. Nxënësit punojnë të pavarur rastet e tjera.

Ushtrimi i dytë: Me atë të përplasjes ne shuplakave të duarve dhe ritmit përkatës, nxënësi lexon rrokjet e krijuara dhe bashkon pikat përkatëse. KO KA KI KE KI 1 - 2 1 – 2 – 3

Ushtrimi i tretë: Nxënësi plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë; *ka, ko, ke ku kë* dhe i lexon ato.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ndahet klasa në 3 grupe dhe secili prej tyre bën analizën e dy fjalëve të ushtrimin 3.

- *Grupi 1 – kali, këmisha Grupi 2 – keku, kurora Grupi 3 – koka, ketri*

Me goje nxënësit krijojnë fjali me këto fjalë.

Ushtrohen nxënësit në leximin e faqes së tekstit.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e tingullit **K** duke e lidhur me shkronjën **K**.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që kanë në trup shkronjën **K**.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.
- ✓ Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **K** (në pozicione të ndryshme).
- ✓ Plotësimin sipas figurës të fjalëve me rrokje mungesore.
- ✓ Leximin e fjalëve të fjalorit të librit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 2 rreshta me shkronjën **K, k.**
2. Shkruaj 6-8 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën **K, k** dhe kryej analizë të tyre. Mund t'i shoqërosh edhe me vizatime.
3. Ndërto fjali me dy prej tyre.
4. Lexo faqen e librit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjalë duke parë figura.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.		
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 50		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjën **K, k** të shtypit sipas modelit.		**Fjalë kyçe:** shkronja **K, k** e madhe dhe e vogël e shtypit.		

▪ Ndan fjalët në rrokje. ▪ Dallon shkronjën **K, k**, duke e ngjyrosur atë. ▪ Lidh figurat dhe fjalët për të krijuar të plotën. ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Gjëegjëza ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake. ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **K, k**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **K**, tabela plastike, figura, CD, magnetofon.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte,

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën **K**, ose e vendos atë në CD.

K... si krokodili që në lumë noton,

K... si kanarina që cicëron,

K... si kalendari që ditët numëron,

K... si kali që kalëron,

*Shkronja **K** në fillim i qëndron.*

Paraqiten etiketat e shkronjave **K, k** dhe emërtohen. Pasqyrohen edhe modelet e krijuara një orë më parë me plastelinë, fije apo tela.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Gjëegjëza, Analizë – sintezë

Mësuesja u lexon nxënësve një gjëegjëzë:

- *"Është tendë me një këmbë dhe pyllin ka shtëpi, gjallërohet e shumohet,veç kur bie shi."*
- *Kush është? (kërpudha)*

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *kërpudha* dhe kryen analizë –sintezë të saj, në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **k**.



Veçohet shkronja **K, k** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurse janë edhe në fletoren e punës.

- **K** e madhe e shtypit. **K** e madhe e dorës
- **k** e vogël shtypit **k** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se sot do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 2. Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **K, k**, fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4 me bojra uji për shkrimin e shkronjës **K, k**.

Ashtu si shkronja **K** e madhe e shtypit, edhe shkronja **k** e vogël e shtypit shkruhet me anë të tri lëvizjeve. **K** si kanguri



Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

Hapi 3. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 50.

Lexojnë fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **K** dhe më pas fjalën KALI, të cilën e analizojnë.

Nxënësit do të ushtrohen të pavarur në ushtrimet e dhëna.

- **Në ushtrimin 1** sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës **K** të madhe të shtypit dhe **k** të vogël të shtypit.
- **Në ushtrimin 2** nxënësi përshkruan figurën dhe lidh pjesët e saj me njëra tjetrën. Më lidhjen e pjesëve lidhen edhe rrokjet. Fjalët e formuara nxënësit i shkruajnë në etiketat përkatëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **K, k** dhe tri fjalë që kanë në përbërje shkronjën **K** (në fillim, në mes dhe në fund).

Ushtrohen nxënësit të krijojnë me gojë fjali me to.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **K, k** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- ✓ Dallimin e shkronjës **K, k**, duke e ngjyrosur atë.
- ✓ Lidhjen e figurave dhe fjalët për të krijuat të plotën.

- ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët kyce.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani 2 rreshta me grafikun e shkronjes **K** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **k**.
2. Shkruani 6 fjalë që përmbajnë shkronjën **K, k** në pozicione të ndryshme (2 për secilin). Mund t'i shoqëroni me foto ose vizatime.
3. Ndërtoni 1-2 fjali me fjalë nga faqja e mësimit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore:	**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri	-Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.
Njësia mësimore: Shkronja K, fq. 41	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton saktë tingullin e shkronjës **K.** ▪ Përshkruan me fjalor të thjeshtë. ▪ Lexon fjalë e fjali. ▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit. ▪ Kryen analizë të fjalive. ▪ Organizon fjalët për të krjuar fjali. ▪ Shfaq besim e vullnet për të punuar	**Fjalë kyçe:** Shkronja **K, k, K, k**, kinema, rregulla, kam, ke, ka, kemi, keni, kanë. **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive paraprake ❖ Lexim i drejtuar, lexim zinxhir ❖ Analizë ❖ Praktikë e udhëhequr, Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte

përmbajnë shkronjën **K**, tabela plastike, figura, fletë formati, flipçart, skeda.	

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja e nis orën e mësimit me një punë me grupe. Ajo ka përgatitur disa skeda, të cilat ua shpërndan secilit grup. Brenda një afati të caktuar nxënësit shkruajnë fjalë të ndryshme, ku shkronja **K** ndodhet në fillim, në mes ose në fund të fjalës.

K në fillim të fjalës	**K** në mes të fjalës	**K** në fund të fjalës
kali	ma**k**ina	bis**k**
...	...	...

Një përfaqësues i grupit del para klasës dhe lexon punën e grupit.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Rikujtim i njohurive paraprake, Lexim i drejtuar

Mësuesja u sugjeron nxënësve që të rikujtojnë figurën e faqes paraprake, e cila lidhet me tekstin që do të marrim në mësimin e sotëm.

- Ku kanë shkuar fëmijët?
- Çfarë po shohin ato?
- Çfarë është shfaqur tek ekrani i madh?
- Cilat rregulla duhet të zbatojmë në kinema?

Mësuesja paraqet në flipchart tekstin "NË KINEMA" bashkë me ilustrimet përkatëse dhe e lexon atë hap pas hapi. Gjatë leximit bëhen edhe pyetje.

- Drini me Jonën dhe Ilirin ikën në kinema. Ku shkuan fëmijët? Në kinema
- -----

Rikujtojmë se emrat e njerësve shkruhen me shkronjë të madhe.

Hapi 2. Lexim zinxhir, analizë

Mësuesja udhëzon nxënësit të hapin tekstin e Abetares në faqen 41 dhe bëhet fillimisht leximi i etiketave të shkronjës **K** në të katërta format e saj.

Ushtrohen nxënësit me radhë (zinxhir) në leximin e fjalive.

Mësuesja në tekstin e përgatitur dhe nxënësit në libër analizojnë fjalitë e tekstit.

Drini	me	Jonën	dhe	Ilirin	ikën	në	kinema.

1 2 3 4 5 6 7 8

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala me e gjatë? Po më e shkurtër?

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit me gjetjen e alternativave së sakta.

Mësuesja ndalet për të sqaruar fjalët pyetëse:

- *Ku? ---- Tregon vend , Kur? --- tregon kohë , Me kë? – tregon dikë që e shoqëron*

Ushtrohen nxënësi që të ndërtojnëfjali te shkurtra me to me ndihmën e mësueses.

Hapi 3. Praktikë e udhëhequr, Punë e pavarur

Mësuesja ndalet në ushtrimet në vazhdimësi. Fillimish ajo udhëzon nxënësin të lexojnë fjalët:

- *kam, ke, ka, kemi, keni, kanë* dhe më pas ti shkruajnë ato.

Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë dhe fjalitë lexohen zinxhir nga ata:

Unë kam kalë. *Unë nuk kam kamera.*

Ai ka kek. *Ai nuk ka kek.*

Ne kemi kamera. *Ne nuk kemi kamera.*

Në ushtrimin e radhës mësuesja udhëzon nxënësit që të lidhin fjalët për të krijuar fjali sipas modelit të dhënë. Fjalitë e krijuara janë:

- *Drini iku në kala*.
- *Klea kalëron me kalë*.
- *Kali e ka emrin Kuk*.

Anash ushtrimit jepet shkronja **K** e paplotësuar.

- Çfarë elementi i mungon? Cili nga variantet është i sakti?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja ushtron nxënësit të shkruajnë fjalitë e mësipërme dhe të bëjnë analizë të tyre. Për efekt kohe mësuesja ndan klasen në tri grupe dhe secili punon nje fjali, nëse përfundon punon edhe të tjerat. Mësuesja kontrollon dhe bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e saktë të tingullit të shkronjës.
- ✓ Përshkrimin me fjalor të thjeshtë te figurave.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive.
- ✓ Përgjigjet e pyetjeve rreth tekstit.

- ✓ Organizimin e fjalëve për të krijuar fjali.
- ✓ Analizën e fjalive.
- ✓ Besimin dhe vullnetin për të punuar.

Detyrë shtëpie:

1. Lexoni disa herë faqen.
2. Shkruani tekstin "NË KINEMA".
3. Formoni fjali me fjalët pyetëse: *Ku?, Kur? Me kë?*
4. Qarkoni në një artikull reviste shkronjat **K.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore:	**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri	-Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.
Njësia mësimore: Fletore pune, fq.51	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Krijon rrokje të cilat kanë në përbërje shkronjën **K.** ▪ Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje. ▪ Shkruan fjalitë pasi i ka lexuar. ▪ Kryen analizë të fjalëve e fjalive të dhëna. ▪ Krijon fjali me fjalët e dhëna. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Shkronja **K, k** e madhe dhe e vogël e shtypit, rrokje, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Shkrim fjalësh ❖ Punë në dyshe ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur ❖ Interpretimi i njohurive
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **K, k**,	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte.

foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **K**, tabela plastike.	

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

1. Mësuesja nxjerr para klasës disa foto të garave me kuaj dhe nxënësit shkruajnë 2-3 fjalë në fletore ose fletë, në formën e vetëdiktimit ose përgatit etiketa të gatshme për secilin nxënës. Lexojnë fjalët që kanë shkruar me shkrim shtypi.(kalë, makinë, kali im i ri, kamera, kinema...)
2. Një veprimtari tjetër që mund të kryejë mësuesja është të ndajë klasën në 4 – 5 grupe. Paraqet foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjën **K**. Nxënësi i sheh dhe i shkruan ato në formë diktimi në një fletë formati.

Në fund një anëtar nga secili grup del dhe i pasqyron para klasës duke i lexuar ato.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Shpallet grupi fitues.

Veprimet në situatë

Hapi 1 Punë në dyshe

Mësuesja organizon punën në dyshe. Në tavolinë vendosen etiketat me shkronja të mësuara. Një nxënës mban në dorë etiketën me shkronjën **K, k** dhe nxënësi tjetër i drejton një nga etiketat e tjera me zanoret e mësuara. Nxënësi i parë lexon etiketën e krijuar, p.sh.
Veprimtaria përsëritet me nxënësin tjetër.







Hapi 2. Punë e pavarur

Mësuesja pas veprimtarive të mësipërme udhëzon nxënësin të hapë fletoren e punës në faqen 51 për të punuar të pavarur ushtrimet e dhëna, pas shpjegimeve përkatëse.

- **Në ushtrimin 1** nxënësi krijon rrokje me shkronjën **K, k** dhe i shkruan ato:
- *KA, KI, KE, KU, KO,..... AK, IK, EK, UK, OK*
- **Në ushtrimin 2** nxënësi përshkruan figurat e dhëna. Ai ndjek rrugën e secilës dhe kur arrin shkruan fjalën përkatëse: *makina, kurora, kamera, kala.*
- **Në ushtrimin 3** janë dhënë dy fjali. Nxënësi i lexon ato dhe më pas i rishkruan. Nxënësi ndan në etiketa fjalitë dhe bën analizë të tyre.
  Krenari e Rina kaluan mirë në kinema.

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala më e gjatë, po më e shkurtër?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të krijojnë me gojë fjali të thjeshta me fjalët e dhëna në fletoren e punës.

makina, kurora, kamera kala

Nxënësit më të përparuar mund të shkruajnë ndonjë fjali të thjeshtë në fletoren e tyre.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Krijimin e rrokjeve të cilat kanë në përbërje shkronjën **K.**
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë e shprehje.
- ✓ Shkrimin e fjalive pasi i ka lexuar ato.
- ✓ Analizën e fjalëve e fjalive të dhëna.
- ✓ Krijimin e fjalive me fjalët e dhëna.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani nga një rresht me rrokjet e formuara me shkronjën ***K, k***
2. Ndërtoni fjali me fjalët: *kalë, kangur, ketër, kërmill.*
3. Në një revistë qarkoni shkronjën **K, k**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.		

<table>
<tr><td>Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 52</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës K, k.
▪ Shkruan fjalë e fjali me shkrim dore sipas modelit
▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën K, k, rrokje e fjalë me shkrim dore.
▪ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore.
▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit</td><td>Fjalë kyçe:
shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Demostrim
❖ Punë e pavarur</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, grafiku i shkronjës K, k dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën K, k etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë A4, ngjyra.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Arte</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja vë në sfond këngën e shkronjës K dhe udhëzon nxënësit që të jenë të vëmendshëm dhe të mbajnë mend sa më shumë fjalë që kanë në përbërje shkronjën K nga teksti i këngës.
Në fund të këngës nxënësit plotësojnë thesin e fjalëve.


Veprimet në situatë
Hapi 1. Rikujtim i njohurive të marra.
Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në kor. Përsëriten shkronjat K, k të shtypit dhe grafiku i tyre. Nxiten nxënësit të thonë fjalë ose emra që fillojnë me K, shkruaj disa prej tyre. Klea, Klarisa.</td></tr>
</table>

Hapi 2. Demostrim

Shpjegohet grafiku i shkronjës K, k të dorës duke e shoqëruar me lëvizjen në ajër. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës me anë të një videoje ilustruese. Bëhet dallimi me shkronjën **K, k** të shtypit. Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fletë A4 me anë të ngjyrave për të mësuar dorën.

Ngre nxënës në tabelë që shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë.

- ke, ika, kam...

Hapi 3. Punë e pavarur

Më pas nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit. Vështirësi paraqet pjesa e djathtë e shkronjës **k**, vëzhgohet ky element dhe përforcohet deri në përvetësimin e tij. Kujdes edhe me shkronjën e madhe të dorës. Nxënësit tregojnë ngjashmërinë me I.

Fillimisht nxënësit ushtrohen në grafikun e shkronjës k të vogël të dorës e fjalëve kala, koka.

Shkruajnë gjithashtu foljet: kam, ke, ka, kemi, keni, kanë

Më pas nxënësit plotëson grafikun e shkronjës K të madhe të dorës dhe shkruan fjalinë:

- Krenari kalëron me kalë.

Nxënësit lexojnë fjalët e fjalitë e shkruara me shkrim dore.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara me to, fjalë e grupe fjalësh. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

- ka, ke, kë, ki, kinema, kala, koka, Koli, Klea, Klarisa dhe Krenari kalëruan me kalë.

Kontrollohen e vlerësohen nxënësit.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës K, k.
- ✓ Shkrimin e fjalëve e fjalive sipas modelit.
- ✓ Shkrimin në formë të diktuar të shkronjës K, k, rrokje e fjalë me shkrim dore.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës K, k.

2. Shkruani të 10 fjalëve me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën k. Shoqërimi i disa prej tyre edhe me foto ose vizatime. 3. Korrigjoni diktimin e bërë në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.		
Njësia mësimore: Shkronja J, fq. 42		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton tingullin **J** duke e lidhur me shkronjën **J**. ▪ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me **J** ose që përmbajnë shkronjën **j** në trup të tyre. ▪ Përshkruan figurën qendrore me temë PIKA E UJIT ▪ Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **j** (në pozicione të ndryshme). ▪ Shkruan fjalë duke i kthyer nga shkronja të mëdha shtypi në shkronja të vogla. ▪ Plotëson sipas kuptimit fjalitë me fjalë mungesore. ▪ Lexon fjalët e fjalorit të librit		**Fjalë kyçe:** Shkronja **J, j**, pika e ujit, udhëtim tingull, rrokje, fjalë , fjali. **Teknika dhe strategji:** ❖ Bashkëbisedim ❖ Analizë -sintezë ❖ Vëzhgim – përshkrim ❖ Demostrim ❖ Punë individuale ❖ Interpretim i rezultateve		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **J** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **J**, foto ilustruese të udhëtimit të pikës së ujit, tabela plastike, fletë A4,videoprojektor, kompjuter.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja fillon mësimin me një udhëtim imagjinar:

“ Sot të dashur fëmijë, do të bëjmë një udhëtim imagjinar, do të ndjekim një pikë uje në udhëtimin e saj. Për ta ndjekur do të mbyllni sytë dhe do të dëgjoni zërin tim. Nëse më dëgjoni me kujdes atëherë në mendjen tuaj do të përfytyroni pikën e ujit brenda një gote, e cila pas pak nuk gjendet me. Ku shkoi ajo? Pika u ujit u ngjit .....”



Mësuesja brenda mundësive mund ta paraqesi udhetimin e pikës së ujit në vidioprojektor me anë të një filmi vizatimor ose shoqëron bisedën me një foto ilustruese a maket, i cili demostron udhëtimin e pikës së ujit.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bashkëbisedim, Analizë

Pas udhëtimit, mësuesja zhvillon një bashkëbisedim:

- A ju pëlqeu udhëtimi?
- Ku shkoi pika e ujit?
- Si u shndërrua ajo?

Mësuesja prezanton para nxënësve se do të punojnë më shkronjën **J**, ashtu si UJI dhe kërkon nga ato të thonë sa më shumë fjalë. Mësuesja i shkruan ato në pemën e mendjes.



Analizojmë fjalën UJI për të nxjerrë në pah shkronjën **J**, por edhe fjalë të tjera.

UJI = U + JI J + I, JELEKU = JE + LE + KU J + E

Veçohet shkronja **J** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxjerrim etiketat përkatëse të shkronjës **J, j** dhe emërtohen ato.

- **J** – e madhe e shtypit, **j** - e vogël e shtypit

Mësuesja bën kujdes që tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë nga ana e nxënësve.

- Shkronja **J** është zanore apo bashkëtingëllore? Klasifikohet tek grupi i bashkëtingëlloreve.

Hapi 2 Vëzhgim - përshkrim

Hapet teksti i Abetares në faqen 42 dhe përqëndrohen tek përshkrimi i figurës qëndrore. Mësuesja me anë të disa pyetjeve krijon një bashkëbisedim me nxënësit.

- Çfarë paraqitet në figurë?
- Çfarë po bën pika e uji?
- Pse trëndafili ndihet aq i kënaqur?

- Ç'mund të themi për fëmijët?

Mësuesja ushtron nxënësit që të krijojnë fjali bazuar tek figura.

Hapi 3. Demostrim

Pasi lexohet tingulli i shkronjes, mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **J, j** të shtypit, fillimisht në ajër, duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë A4, me anë të ngjyrave për të mësuar grafikun e saj. Modelimi bëhet edhe me mjete si: makarona, plastelinë, fije etj.

Përsëritje në kor e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara dhe rrokje e fjalë që krijohen me to.

Hapi 4. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Duke u bazuar tek simbolet mësuesja shpjegon se pas dëgjimit me kujdes të fjalës së pasqyruar në foto, do ngjyroset rrethi përkatës, nëse shkronja **J** është në fillim, në mes apo në fund, psh.

-Tek fjala *jelek*, ku e dëgjojmë shkronjën **j**? (në fillim)

Atëherë do të ngjyrosim rrethin e parë. Nxënësit punojnë të pavarur rastet e tjera, pas dëgjimit.

Ushtrimi i dytë: Janë dhënë disa fjalë me shkronja të mëdha shtypi. Nxënësi i lidh me figutën përkatëse dhe më pas i shkruan ato me shkronja të vogla shtypi.

Ushtrimi i tretë: Nxënësi plotëson fjalitë e dhëna me fjalët që mungojë. Fjalët i marrin nga etiketa e dhënë. Pas plotësimit lexohen fjalitë e plota.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ndahet klasa në 3 grupe dhe secili prej tyre bën analizën e dy fjalëve të ushtrimin 2, duke treguar vendndodhjen e shkronjës **j**.

- *Grupi 1 – lojë, jelek Grupi 2 – ujk, lejlek Grupi 3 – anije, majmun*

Me goje nxënësit krijojnë fjali me këto fjalë. Ushtrohen nxënësit në leximin e faqes së tekstit.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e tingullit **J** duke e lidhur me shkronjën **J**.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që kanë në trup shkronjën **J.**
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore me temë PIKA E UJIT.
- ✓ Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **j**.

<table>
<tr><td colspan="5">✓ Plotësimin sipas kuptimit të fjalive me fjalë që mungojnë.
✓ Leximin e fjalëve të fjalorit të librit.</td></tr>
<tr><td colspan="5">Detyrë shtëpie:
1. Shkruaj 2 rreshta me shkronjën J, j
2. Shkruaj 6-8 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën J, j dhe kryej analizë të tyre.
3. Ndërto fjali me dy prej tyre.
4. Leximi i faqes.</td></tr>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:
-Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan fjalë duke parë figura.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 53</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Shkruan shkronjës J, j të shtypit sipas modelit.
▪ Ndan fjalët në rrokje.
▪ Shkruan fjalët nga shkronja të mëdha shtypi, në shkronja të vogla shtypi
▪ Krijon rrokje me shkronjën J
▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe.
▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Shkronja J, j e madhe dhe e vogël e shtypit, shkruaj, analizo, jaka, ujku, jeleku, lejleku</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Gjëegjëza
❖ Analizë - sintezë
❖ Diskutim i njohurive paraprake,
❖ Veprimtari e udhëhequr
❖ Bashkëbisedim
❖ Punë e pavarur</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës J, j, foto</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte,</td></tr>
</table>

me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **J**, tabela plastike, figura, CD, magnetofon.	

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën **J**, ose e vendos atë në CD.

J.. si java që ka shtatë ditë,

J... si janari që fillon çdo vit,

J ... si jehona që malet buxhet,

J... si jeta jonë e shtrenjtë,

.....

Paraqiten etiketat e shkronjave **J, j** dhe emërtohen. Pasqyrohen edhe modelet e krijuara një orë më parë me plastelinë, fije apo tela.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Gjëegjëza, Analizë – sintezë

Mësuesja u lexon nxënësve një gjëegjëzë:

- *"Në krevat gjithë kohën rri, i vetmuar pa shoqëri, veç natën më shoqëroni dhe gjatë ditës kur pushoni. Kush mbi mua kokën vë, gjumi shpejt do ta zë."*
- *Cili është? (jastëku)*

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *jastëku* dhe kryen analizë –sintezë të saj, në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **j**.



Veçohet shkronja **J, j** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurëse janë edhe në fletoren e punës.

- **J** e madhe e shtypit. **J** e madhe e dorës
- **j** e vogël shtypit **j** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se sot do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 2. Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **J, j**, fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4 me bojra uji për shkrimin e shkronjave **J, j**.

Ashtu si shkronja **J** e madhe e shtypit, ashtu edhe shkronja **j** e vogël e shtypit shkruhet vetëm me anë të një lëvizjeje. Në shkronjën e vogël nuk do harrojmë të vendosim pikën.

Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.



Hapi 3. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 53.

Lexojnë fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **J** dhe më pas fjalën JASTËKU, të cilën e analizuam. Ngjyrosin figurën e dhënë.

Nxënësit do të ushtrohen të pavarur në ushtrimet e dhëna, pas shpjegimeve përkatëse.

- **Në ushtrimin e parë** sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës **J** të madhe të shtypit dhe **j** të vogël të shtypit.
- **Në ushtrimin e dytë** nxënësi përshkruan figurën, plotëson shkronjën e re **J** tek fjala përkatëse. Më pas nxënësi e shkruan fjalën duke e kthyer nga shkrimi me shkronja të mëdha shtypi në shkronja të vogla shtypi.
- **Në ushtrimin e tretë** nxënësi shkruan rrokjet e dhëna që krijohen. *JA – AJ JE – EJ ....*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **J, j** dhe tri fjalë që kanë në përbërje shkronjën **J** (në fillim , në mes dhe në fund).

Ushtrohen nxënësit të krijojnë me gojë fjali me to.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **J, j** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- ✓ Shkrimin e fjalëve nga shkronja të mëdha shtypi, në shkronja të vogla shtypi
- ✓ Krijimin e rrokjeve e fjalive të thjeshta me fjalët kyçe.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani 2 rreshta me grafikun e shkronjes **J** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **j**.
2. Ndërto fjali me fjalët e ushtrimit 2.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia, përrallëza, përralla, tregimi. Gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Përflet ngjarjen kryesore në tekst.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Shkronja J, fq. 43</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore
Nxënësi:
▪ Shqipton saktë tingullin e shkronjës J.
▪ Përshkruan me fjalor të thjeshtë udhëtimin e pikës së ujit.
▪ Lexon fjalë e fjali.
▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit.
▪ Kryen analizë të fjalive.
▪ Pasqyron me vizatim dhe ngjyrosje pikën e ujit në vende të ndryshme.
▪ Shfaq besim e vullnet për të punuar.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Shkronja J, j, J, j, pika e ujit, pa ngjyrë, pa erë, re borë;
jam, je jemi, jeni , janë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Rikujtim i njohurive paraprake
❖ Lexim i drejtuar, lexim zinxhir
❖ Analizë
❖ Praktikë e udhëhequr, Punë e pavarur</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën J, tabela plastike, figura, fletë A4, flipçart, skeda, modelim i lëvizjes së ujit në natyrë.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natytës, Arte</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake</td></tr>
</table>

Mësuesja e nis orën e mësimit me një punë me grupe. Ajo ka përgatitur disa skeda, të cilat ua shpërndan secilit grup. Brenda një afati të caktuar nxënësit shkruajnë fjalë të ndryshme ku shkronja **J** ndodhet në fillim , në mes ose në fund të fjalës.

J në fillim të fjalës	**J** në mes të fjalës	**J** në fund të fjalës
Jeta ..	U**j**ëvarë ...	Puno**j** ...

Një përfaqësues i grupit del para klasës dhe lexon punën e grupit.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Veprime në situata

Hapi 1. Rikujtim i njohurive paraprake, Lexim i drejtuar

Mësuesja u sugjeron nxënësve që të rikujtojnë figurën e faqes paraprake bashkë me udhëtimin imagjinar që bëmë në lidhje me pikën e ujit.

- Çfarë mund të themi për pikën e ujit?
- Sa i rëndësishëm është ai për jetën tonë?
- Çfarë mund të themi për rëndësinë e tij në planetin tokë?

Mësuesja paraqet në flipçart tekstin "UNË JAM UJI" bashkë me ilustrimet përkatëse dhe e lexon atë hap pas hapi. Gjatë leximit bëhen edhe pyetje, që të kuptohet më mirë përmbajtja.

- Çfarë ngjyre ka uji?
- Ku gjendet ai?
- Cilat janë format që ai shfaq? *uji, avull, akull*

Hapi 2. Lexim zinxhir, analizë

Mësuesja udhëzon nxënësit të hapin tekstin e Abetares në faqen 43 dhe bëhet fillimisht leximi i etiketave të shkronjës **J** në të katërta format e saj.

Ushtrohen nxënësit me rradhë (zinxhir) në leximin e fjalive.

Mësuesja në tekstin e përgatitur dhe nxënësit në libër ndajnë fjalitë në fjalë duke bërë një analizë të tyre.



Unë jam me ju.

1 2 3 4

- Sa fjalë ka fjalia?

- Cila është fjala me e gjatë? Po më e shkurtër?

Nxënësit qarkojnë të gjitha shkronjat **j** që ndodhen tek teksti.

- Sa shkronja **j** kemi gjithsej?

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit me përgjigjet Po ose Jo.

Hapi 3. Praktikë e udhëhequr, Punë e pavarur

Mësuesja ndalet në ushtrimet në vazhdimësi. Fillimish ajo udhëzon nxënësit të lexojnë fjalët: *jam , je, jemi, jeni, janë* dhe më pas ti shkruajnë ato.

Ushtrohen nxënësin me gojë të ndërtojnë fjali me to.

Në ushtrimin e radhes mësuesja udhëzon nxënësit që të lidhin fjalitë me figurat e dhëna.

- Më poshte na jepet e ilustruar pika e ujit në udhëtimin e saj. Ushtrohen nxënësit të ngjyrosin ilustrimet e dhëna.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja ushtron nxënësit të shkruajnë fjalitë e ushtrimit të dytë dhe të bëjnë analizë të plotë të tyre.

- *Ata lajnë perime. Ata luajnë me ujë.*

Mësuesja kontrollon dhe bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e saktë të tingullit të shkronjës.
- ✓ Përshkrimin me fjalor të thjeshtë të figurave.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive.
- ✓ Përgjigjet e pyetjeve rreth tekstit.
- ✓ Organizimin e fjalëve për të krjuar fjali.
- ✓ Analizën e fjalive.
- ✓ Besimin dhe vullnetin për të punuar.

Detyrë shtëpie:

1. Lexoni disa herë faqen e librit.
2. Shkruani tekstin “UNË JAM UJI”.
3. Pasqyroni me vizatim udhetimin e pikës së ujit.
4. Qarkoni në një artikull reviste shkronjat **J.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan fjalë duke parë figura.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njjësia mësimore: Fletote pune, fq. 54</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Dallon fjalët të cilat kanë në përbërje shkronjën J.
▪ Bashkon rroket për të formuar fjalë.
▪ Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje.
▪ Shkruan fjalë e fjali pasi i ka lexuar.
▪ Kryen analizë të fjalëve e fjalive të dhëna.
▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Shkronja J, j e madhe dhe e vogël e shtypit, rrokje, fjalë, fjali</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Punë në dyshe
❖ Bashkëbisedim
❖ Punë e pavarur
❖ Interpretimi i njohurive</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës J, j, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën J, tabela plastike.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Edukim fizik, sporte e shëndet, Arte</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja ndan klasën në 4 – 5 grupe. Ajo paraqet foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjën J. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato në formë diktimi në një fletë formati.
Në fund një anëtar nga secili grup del dhe i pasqyron para klasës duke i lexuar ato.
- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta? Shpallet grupi fitues.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1. Punë në dyshe

Mësuesja organizon punën në dyshe. Në tavolinë vendosen etiketat me rrokje të ndryshme, ku njëra prej tyre nuk mund të përdoret. Nxënësit bashkojë rrokje e krijojnë fjalën e saktë dhe e lexon atë.



Hapi 2. Punë e pavarur

Mësuesja pas veprimtarive të mësipërme udhëzon nxënësit të hapin fletoren e punës në faqen 54 për të punuar të pavarur ushtrimet e dhëna.

- **Në ushtrimin e parë** nxënësi ndjek labirintin duke kaluar nëpër fjalët që përmbajnë shkronjën **j** në mënyrë që Jona të shkojë tek Jetmiri. Në fund nxënësi i shkruan fjalët e gjetura.
- **Në ushtrimin e dytë** janë dhënë rrokje të ndryshme. Nxënësi i bashkon ato që të krijojë fjalë me kuptim dhe më pas i shkruan në figurat përkatëse.
- **Në ushtrimin e tretë** nxënësi lexon dhe kopjon fjalinë e dhënë

Nxënësit ndajnë në etiketa fjalinë dhe bëjnë një analizë të saj.

Jena dhe Joni luajnë me kuaj.

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala më e gjatë, po më e shkurtër?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Secili nxënës analizon me gojë një nga fjalët e ushtrimit 2 dhe krijon fjali me të:

- *janari, mjeku, majmuni, jaka, anija, fëmijët.*

Nxënësit më të përparuar mund të shkruajnë ndonjë fjali të thjeshtë në fletoren e tyre.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Krijimin e rrokjeve të cilat kanë në përbërje shkronjën **J.**
- ✓ Krijimin e fjalëve duke bashkuar rrokjet.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë e shprehje.
- ✓ Shkrimin e fjalëve e fjalive pasi i ka lexuar ato.
- ✓ Analizën e fjalëve e fjalive të dhëna.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani nga një rresht me rrokjet e formuara me shkronjën ***J, j***
2. Ndërtoni fjali me fjalët: *mësoj, luaj, këndoj, laj*
3. Në një tekst të një revistë apo gazete qarkoni shkronjën **J, j.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.		
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 55		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës J, j. ▪ Shkruan fjalë e fjali me shkrim dore sipas modelit ▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën J, j, rrokje e fjalë me shkrim dore. ▪ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore. ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit		**Fjalë kyçe:** shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive të paraprake ❖ Demostrim ❖ Punë e pavarur		
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, grafiku i shkronjës **J, j** dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **J**, j etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë A4, ngjyra.		**Lidhja me fushat e tjera:** Arte		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Dëgjohet kënga e shkronjës **J.**				

Mësuesja vë në sfond këngën e shkronjës **J** dhe udhëzon nxënësit që të jenë të vëmendshëm dhe të mbajnë mend sa më shumë fjalë që kanë në përbërje shkronjën **J** nga teksti i këngës.
Në fund të këngës nxënësit plotësojnë thesin e fjalëve.



Veprimet në situatë

Hapi 1. Rikujtim i njohurive të paraprake.

Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në kor. Përsëritet shkronja **J, j** e shtypit dhe grafiku përkatës. Nxiten nxënësit të thonë fjalë ose emra që fillojnë me **J**, shkruaj disa prej tyre. *Jeta, jeta, Joni, jelek, Jona....*

Hapi 2. Demostrim

Shpjegohet grafiku i shkronjës J, j të dorës dhe e shoqëruar me lëvizjen në ajër. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës me anë të një videoje ilustruese.
Bëhet dallimi me shkronjën **J, j** të shtypit, gjithashtu edhe dallimi i saj me shkronjën **I**. Fillimisht nxënësit ushtrohen edhe në fletë A4 me anë të ngjyrave, për të mësuar dorën.
Ngre nxënës në tabelë të shkruajnë shkronjën. Mësuesja shpjegon hap pas hapi edhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera të mësuara : ja, jam, jemi, Jona

Hapi 3. Punë e pavarur

Nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit.
Fillimisht nxënësit ushtrohen në grafikun e shkronjës j të vogël të dorës dhe fjalëve jam, je, jemi, jeni, janë.
Më pas nxënësit plotësojnë grafikun e shkronjës J të madhe të dorës dhe shkruajnë fjalinë:

- Jona e Joni luajne me uji.

Nxënësit lexojnë fjalët e fjalitë e shkruara me shkrim dore.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara me to, fjalë, grupe fjalësh e fjali. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

- ja, je, ji, jo, ju, janari, luaj, luajnë, jelek, lejlek, Jetmiri, Jeta, Jetoni e Joni luajnë me ujë.

Kontrollohen e vlerësohen nxënësit. **Vlerësohen nxënësit për:** ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës J, j. ✓ Shkrimin e fjalëve e fjalive sipas modelit. ✓ Shkrimin në formë të diktuar shkronjën J, j, rrokjeve e fjalëve me shkrim dore. ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore. ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruani nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës J, j. 2. Shkruani 10 fjalë me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën j. Shoqëroni disa prej tyre edhe me foto ose vizatim. 3. Korrigjoni diktimin e bërë në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.		
Njësia mësimore: Përsëritje 2, fq. 44		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Dallon shkronjat e grupit të dytë N, Ë, O, L, K, J në të katër format e tyre ▪ Shqipton tingujt e shkronjave N, Ë, O, L, K, J. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë që fillojnë me N, Ë, O, L, K, J, ose i kanë në trup ato. ▪ Krijon rrokje me shkronjat e mësuara.		**Fjalë kyçe:** Shkronjat N, Ë, O, L, K, J, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla. **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive të paraprake ❖ Punë në grupe		

▪ Analizon fjalët duke i ndarë në rrokje e shkronja. ▪ Qarkon sipas udhëzimeve të dhëna. ▪ Formon fjali me fjalët e dhëna	❖ Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjave N, Ë, O, L, K, J, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjët N, Ë, O, L, K, J , tabela plastike, figura, fletë A4..	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake



Mësuesja paraqet para nxënësve pemën e alfabetit të përgatitur më parë me maket ose të vizatuar, me të gjithë shkronjat e alfabetit dhe diskutojmë rreth saj.

- Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe?
- Sa prej tyre janë zanore e sa bashkëtingëllore?
- Le të rikujtojmë shkronjat e mësuara duke i marrë ato nga pema. (Shkëputen shkronjat dhe vendosen para tabelës)

  Grupi i parë: A, I, M, R, E, U.

  Grupi i dytë: N, Ë, O, L, K, J
- Cilat nga shkronjat e mësuara janë zanore e cilat bashkëtingëllore?

Nxënësit shqiptojë saktë dhe bukur tingujt përkatës të secilës shkronjë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Rikujtimi i njohurive paraprake

Mësuesja paraqet para nxënësve etiketat me të 4 modelet e secilës shkronjë të mësuar dhe nxënësi i emërton ato. Rikujtojmë shkronjat e të dy grupeve të mësuara.

***N** e madhe e shtypit, **o** e vogël e shtypit, K e madhe e dorës, l e vogël e dorës...*

- Nga ndryshojnë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës?
- Sa nxënës kemi në klasë qu u fillon emri me shkronjat N, Ë, O, L, K, J?
- Rikujtojmë si shkruhen emrat e njerëzve.

Ushtrohen nxënësit të shkruajnë disa nga këto emra në tabelë.

Hapi 2. Punë në grupe

Mësuesja ndan klasën në 6 grupe dhe secilit prej tyre i shpërndan etiketën e një shkronje të mësuar.

- *G1 – n, G2 – ë, G3 – o, G4 – l, G5 – k, G6 – j*
- Gjeni sa me shumë fjalë që kanë në trup shkronjën tuaj brenda nja kohe të caktuar.

Një nxënës i shkruan ato në fletë formati dhe një përfaqësues nga grupi i prezanton ato para klasës.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë rrokje e fjalë të sakta?

Hapi 3. Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur

Hapet libri në faqen 44 te Abetares dhe udhëzohen nxënësit në plotësimin e tyre,pas shpjegimit.

- **Në ushtrimin e parë** janë dhënë shkronjat e mësuara në të katër format e tyre, shtypi, dore, të mëdha e të vogla. Nxënësi bashkon vizat e dhënë për t'i pasqyruar të plota dhe më pas i emërton ato.
- **Në ushtrimin e dytë** ushtrohen nxënësit zinxhir në leximin e etiketave të 12 shkronjave të mësuara deri më tani. Rikujtojmë që kemi mësuar 6 zanore dhe e shtata është **Y**-ja
- **Në ushtrimin e tretë** janë dhënë dy tabela ku në njërin krahë janë zanoret dhe në tjetrin bashkëtingëlloret. Nxënësit i kombinojnë ato për të krijuar rrokje.

	a	**i**	**...**
M	ma	mi	...
R	ra	ri	...
...	...	...	...

	n	**l**	**...**
E	en	el	...
Ë	ën	ël	...
...	...	...	...

- **Në ushtrimin e katërt** për secilën shkronjë janë dhënë fjalë përkatëse. Nxënësi pasi lexon fjalët qarkon shkronjën e dhënë tek secila.

Shkëputen fjalë nga fjalët e dhëna të këtij ushtrimi dhe ushtrohen nxënësit në analizë të tyre. P.sh

Lejleku						
Lej			le		ku	
l	e	j	l	e	k	u

Ushtrohen nxënësit me gojë që të ndërtojnë fjali me këto fjalë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja u shpërndan nxënësve disa pjesëza nga revista ose gazeta dhe nxënësit qarkojnë shkronjat e mësuara.

Më pas ata i këmbejnë me shokun e bankës dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjave të grupit të dytë N, Ë, O, L, K, J.
- ✓ Shqiptimin e saktë të tingujve N, Ë, O, L, K, J.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që fillojnë me N, Ë, O, L, K, J, ose i kanë në trup ato.
- ✓ Leximin e rrokjeve dhe fjalëve të dhëna.
- ✓ Analizën e fjalëve duke i ndarë në rrokje e shkronja.
- ✓ Qarkimin sipas udhëzimeve të dhëna.
- ✓ Formimin e fjalive të thjeshta me fjalët e faqes.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani shkronjat e grupit të dytë nga një rresht secila në të 4 format e saj
2. Shkruani nga dy fjalë për secilën shkronjë N, Ë, O, L, K, J.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore:	**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri.	**-**Shkruan fjalë duke parë figura.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.
Njësia mësimore: Përsëritje 2 (fletore pune, fq. 56)	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjat e mësuara të grupit të parë A, I, M, R, E, U dhe grupit të dytë N, Ë, O, L, K, J në katër format e tyre. ▪ Krijon rrokje të ndryshme me shkronjat e marra. ▪ Krijon fjalë me shkronja e rrokje të dhëna. ▪ Plotëson fjalë me shkronja mungesore. ▪ Kthen fjalët nga shkrim shtypi në shkrim dore.	**Fjalë kyçe:** Shkronjat A, I, M, R, E, U, dhe N, Ë, O, L, K, J shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla. **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur

▪ Shfaq dëshirë e vullnet për të punuar.	❖ Punë në grupe
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjave A, I, M, R, E, U, N, Ë, O, L, K, J; foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjët N, Ë, O, L, K, J , tabela plastike, figura, fletë A4.	**Lidhja me fushat e tjera:** Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Zhvillohet me nxënësit lojën e fjalëve. Klasa ndahet në grupe dhe brenda grupit krijohen çifte. Mësuesja ka përgatitur një kapele më karton te cilën ia vë në kokë një nxënësi. Ndryshe nga hera e parë që u bë kjo lojë me foto, këtë herë mësuesja vë në kapele një fjalë të shkruar. Nxënësi që ndodhet përballë, pasi e lexon pa zë ia shpjegon nxënësit që e mban dhe mundohet që ai ta gjejë nga shpjegimi i tij. Nëse nxënësi e gjen fiton pikë grupi i tij. Më pas ndërrohen vendet.

Fjalët do të lidhen me fjalorin e marrë me shkronjat që kemi mësuar deri tani. P.sh.

KALI LUMI KAPELE NUMRA

Veprimet në situatë

Hapi 1. Rikujtimi i njohurive të marra

Rikujtohen shkronjat e mësuara me anë të etiketave dhe krijohen rrokje me to. Organizohet në formë loje ku mësuesja shpërndan etiketa të ndryshme të secilës shkronjë të mësuar në grupin e dytë dhe nxënësit krijohen katërshe - katërshe dhe më pas prezantohen. P.sh.

- *Unë jam O e madhe e shtypit.*
- *Unë jam o e vogël e shtypit.*
- *Unë jam O e madhe e dores.*
- *Unë jam o e vogël e dorës.*

Të gjithë bashkë: *Shkronja O është një zanore.*

Kështu veprohet edhe me rastet e tjera.

Klasifikohen kështu zanoret dhe bashkëtingëlloret e mësuara deri tani.

U paraqes nxënësve etiketa me rrokje e shkronja dhe ato pasi i lexojnë i shkruajnë në fletore me shkronja dore.

- ma –ma Eri – Eri, mami - mami

Hapi 2. Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur

Hapet fletorja e punës në faqen 56 dhe udhëzohen nxënësit në plotësimin e saj.

Fillimisht nxënësi lexon etiketat e shkronjave N, Ë, O, L, K, J dhe më poshtë plotëson ato me të katër format e mësuara duke bashkuar vijat dhe duke plotësuar vendet bosh.

- **Në ushtrimin e parë** nxënësi lexon rrokjet e dhëna. Mësuesja udhëzon nxënësin që të krijojë me to edhe fjalë, psh. *ka + li = kali ja + ka = jaka ...*
- **Në ushtrimin e dytë** nxënësi përshkruan figurën e dhënë dhe më pas gjen dhe shkruan rrokjen që i mungon asaj, duke u mbështetr tek rrokjet e dhëna.
- **Në ushtrimin e tretë** nxënësi përshkruan figurën me shkronjat e dhëna, krijon dhe shkruan fjalën e saktë që i përkon figurës.

Ushtrohen nxënësit me gojë në analizë dhe krijim fjalish me to.

Hapi 3. Punë në grupe.

U paraqiten nxënësve fjalë të ngatërruara dhe udhëzohen të formojnë fjali të saktë që ka kuptim.

Organizohen gjithsej 5 – 6 grupe. P.sh. *ka, Era, të , orë , re --- Era ka orë të re.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruaj në tabelë dy fjali me shkronja të mëdha shtypi dhe udhëzohen nxënësit që në fletoret e tyre të shkruajnë fjalën siç është dhe më pas ta rishkruajnë me shkronja shtypi të vogla dhe me shkronja dore. P.sh.

- *UNË MORA LULE ME ERË TË MIRË.*
- *Unë mora lule me erë të mirë.*
- *Unë mora lule me erë të mirë.*

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjave e mësuara të grupit të parë A, I, M, R, E, U dhe grupit të dytë N, Ë, O, L, K, J në katër format e tyre.
- ✓ Krijimin e rrokjeve të ndryshme me shkronjat e marra.
- ✓ Krijimin e fjalëve me shkronja e rrokje të dhëna.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronja mungesore.
- ✓ Kthimin e fjalëve e fjalive nga shkrim shtypi në shkrim dore.

✓ Shfaqjen e dëshirës e vullnetit për të punuar.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruani shkronjat e mësuara të grupit të dytë në 4 format e tyre, nga një rresht secila. 2. Shkruani fjalët e ushtrimit 2 dhe 3 me shkronja shtypi dhe shkronja dore. 3. Qarkoni shkronjat e mësuara tek një fletë reviste ose gazete.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.		
Njësia mësimore: Përsëritje 2 (Abetare fq. 45)		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Dallon shkronjat e mësuara tek grupi i parë A, I, M, R, E, U dhe grupi i dytë N, Ë, O, L, K, J ▪ Lexon rrokje, fjalë e fjali. ▪ Krijon fjalë më shkronja të dhëna. ▪ Analizon fjalët duke i ndarë në rrokje e shkronja. ▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore. ▪ Plotëson fjalitë me fjalë mungesore. ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Shkronjat A, I, M, R, E, U dhe N, Ë, O, L, K, J shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla. **Teknika dhe strategji:** ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Punë në grupe ❖ Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjave A, I, M, R, E, U, dhe N, Ë, O, L, K, J, figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjët N, Ë, O, L, K, J; tabela plastike, figura, fletë A4.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit				

Veprimtari paraprake

Mësuesja u paraqet nxënësve skeda në formë fjalëkryqi me shkronja të ndryshme dhe udhëzon nxënësit të ngjyrosin shkronjat e mësuara.

Q	y	p	s	d	f	h	v	C
B	g	a	i	n	o	L	ll	x
D	h	Ë	u	J	u	K	q	B
C	v	r	M	ë	M	N	sh	ll
Ç	dh	E	j	U	k	R	D	F
Ll	q	m	I	i	u	r	z	p
Rr	v	A	ë	a	O	L	x	B
Z	zh	D	Q	t	dh	ll	H	v

- A ju ngjan me një forme matematikore pjesa e ngjyrosur? (katror)

Veprimet në situatë

Hapi 1. Rikujtimi i njohurive të marra

Mësuesja paraqet para nxënësve etiketa të ndryshme me shkronjat e mësuara dhe nxënësit i emërtojnë ato. Përsriten shkronjat e të dy grupeve.

N e madhe e shtypit, **l** e vogël e shtypit, K e madhe e dorës, j e vogël e dorës

Më pas mësuesja paraqet etiketa me rrokje dhe ushtron nxënësit ti lexojnë ato dhe te krijojnë fjalë psh

ma = li mali = ka pe le kapele

Hapi 2. Praktikë e udhëhequr, praktikë e pavarur

Hapet libri në faqen 45 te Abetares dhe udhëzohen nxënësit në plotësimin e tyre.

- **Në ushtrimin e parë** nxënësi lexon fjalën e dhënë dhe kryen analizë të saj duke e ndarë në rrokje e shkronja.

Majmuni						
Maj			Mu		ni	
m	A	j	m	U	n	i

- **Në ushtrimin e dytë** nxënësi gjen sa shkronja ka fjalë në fotot e dhëna dhe i shkruan ato në etiketat përkatëse duke bërë edhe lidhjen me shigjetë të figurës me fjalën.
- **Në ushtrimin e tretë** nxënësi lidh fjalët për të krijuar fjali dhe më pas e shkruan atë të plotë me shkronja dore.
- **Në ushtrimin e katërt** nxënësi plotëson fjalitë me fjalët në etiketa dhe më pas i lexon ato.

Ushtroj nxënësin që të kryejë analizë të këtyre fjalive p.sh.

Mua	më	jep	Jona	makarona.

- *Sa fjalë ka fjalia?*
- *Cila është fjala më e gjatë? Po më e shkurtër?*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Punë individuale

Në alfabetin e dhënë në fund të faqes 44 – 45 nxënësi ngjyros shkronjat e mësuara dhe i lexon ato.

Mësuesja ka përgatitur një fletë pune për nxënësit me 2 -3 ushtrime të thjeshta; shkrimin e shkronjave, krijimin e disa rrokjeve, shkrim fjale sipas figurës.

Nxënësit punojnë të pavarur dhe mësuesja kontrollon vazhdimisht punën e tyre duke dhënë sugjerimet përkatëse dhe në fund bën kontrollin e jep vlerësimet e saj

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjave e mësuara të të dy grupimeve.
- ✓ Leximin e rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- ✓ Krijimin e fjalëve më shkronja të dhëna.
- ✓ Analizën e fjalëve duke i ndarë në rrokje e shkronja.
- ✓ Kalimin e fjalive nga shkrim shtypi në shkrim dore
- ✓ Plotësimin e fjalive me fjalë mungesore.
- ✓ Shfaqjen e besimit e vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj një fjalë për secilën shkronjë në tre forma, me shkronja të mëdha shtypi, shkronja të vogla shtypi dhe shkronja dore.
2. (Për nxënësit më të përparuar) Përshkruaj me 2 – 3 fjali të thjeshta një kafshe. (Si modeli i ushtrimit të fundit.)

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Shkronja P, fq. 46</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Shqipton tingullin P duke e lidhur me shkronjën P.
▪ Pasuron fjalorin me fjalë që fillojnë me P ose që përmbajnë shkronjën p në trup të tyre.
▪ Përshkruan figurën qendrore.
▪ Dallon rrokje të krijuara me shkronjën P.
▪ Plotëson sipas kuptimit fjalitë me fjalë mungesore.
▪ Analizon fjalë e fjali .
▪ Lexon fjalët e fjalitë në tekst.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
shkronja P, p, pule me perime, piramida ushqimore, patate</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Improvizim
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Bashkëbisedim-Analizë -sintezë
❖ Vëzhgim – përshkrim
❖ Demostrim
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës P dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën P, foto ilustruese të piramidës ushqimore, tabela plastike, fletë formati.,videoprojektor, kompjuter, mjete kuzhine plastike e cope.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit</td></tr>
</table>

Veprimtari paraprake



Mësuesja tregon para klasës piramidën ushqimore dhe foto të ushqimeve të ndryshme. Kujtohet se çfarë dimë për ushqimet e shëndetshme dhe ushqime jo të shëndetshme. Përmenden disa prej tyre duke u mbështetur edhe tek piramida. Shpjegohet kuptimi i piramidës. Mund të prezantohet edhe me vidioprojektor.
Shkruhen disa emra ushqimesh që fillojnë me **P** ose e kanë në trup shkronjën **P**: *perime, pulë, patate, panxhar, patëllxhanë.*
Nxënësit diskutojnë për ushqimin e tyre të preferuar.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Improvizim

Mësuesja ka improvizuar në një kënd të klasës një tryezë të shtruar me mbulesë, peceta, gota, thikë, lugë, pirunj, pjata ... (mjete prej materiali kallcuk).
Në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për veprimtaritë ditore në lidhje me ushqimin dhe mënyrat e konsumimit.(përdorimi dhe vendosja e lugës, pirunit, thikës.)
Improvizohet një situatë të ngrëni, ku nxënësit demonstrojnë përdorimin e pirunit dhe thikës në tryezë.

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra

Përsëritje në kor e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë të krijuara me to.

Hapi 3. Bashkebisedim, prezantim, analizë

- Çfarë konsumoni ju gjatë ditës sipas vakteve?
- Çfarë ushqimesh ju pëlqejnë më shumë (fruta ose perime)?
- A e dini se çfarë ju ka gatuar mami sot për drekë?

Mësuesja u lexon nxënësve një dietë ditore të shëndëtshme dhe nga aty shkëput fjalën PERIME duke prezantuar se sot do të punojnë më shkronjën **P, p** ashtu si PERIMET, PIRAMIDA, PATATJA etj dhe kërkon nga nxënësit të thonë sa më shumë fjalë. Mësuesja i shkruan ato në pemën e mendjes.
Analizojmë fjalën PERIME për të nxjerrë në pah shkronjën **P**, por edhe fjalë të tjera.
PERIME = PE + RI + ME PE = P + E
Veçohet shkronja P dhe shqiptohet tingulli i saj.
Nxjerrim etiketat përkatëse të shkronjës **P, p** dhe emërtohen ato.

- **P** – e madhe e shtypit, **p** - e vogël e shtypit

Mësuesja bën kujdes që tingulli i saj të shqiptohet sa më saktë nga ana e nxënësve.

Hapi 4. Demostrim

Pasi lexohet tingulli i shkronjes, mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **P, p** të shtypit, fillimisht në ajër, duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë formati, me bojra uji për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plasteline, fije etj. Shtohet shkronjën **P** tek grupi i bashkëtingëlloreve. Krjohen rrokje me të

Hapi 5. Vëzhgim - përshkrim

Hapet teksti i Abetares në faqen 46 dhe përqëndrohemi tek përshkrimi i figurës qëndrore. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër.

- Çfarë paraqitet në figurë? 1 2 3 4

Mësuesja ushtron nxënësit që të krijojnë fjali bazuar tek figura.

Analizojmë fjalinë kryesore:

Kemi	pulë	me	perime.

pu – lë pe – ri - me

Hapi 6. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësi qarkon në fjalët e dhëna rrokjet, *pa, pe, pi, pu, pë.* Lexohet fjala e plotë.

Ushtrimi i dytë: Nxënësi lexon rrokjet e dhëna, i ndërron vendet shkronjave dhe krijojnë rrokje të reja. Lexohen rrokjet e krijuara.

Ushtrimi i tretë: Nxënësi plotëson fjalinë e dhënë me fjalët që mungojnë dhe e lexon atë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja shkruan në tabelë fjalinë: *Pjata ka pule e perime*. Ndahet në etiketa dhe fjalët në rrokje. Individualisht nxënësit plotësojnë ndarjen e fjalëve në rrokjeve.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e tingullit **P** duke e lidhur me shkronjën **P**.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që fillojnë me **P** ose që përmbajnë shkronjën **p** në trup të tyre.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.
- ✓ Plotësimin sipas kuptimit të fjalive me fjalë mungesore.
- ✓ Analizën e fjalëve e fjalive.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive në tekst.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani 1 rresht me shkronjën **P, p** dhe rrokjet që krijohen me të.
2. Shkruani 8-10 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën **P, p**. Mund t'i shoqëroni edhe me vizatime.
3. Ndërtoni fjali me tri prej tyre.
4. Lexoni faqen e librit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri	**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 58	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjës **P, p** të shtypit sipas modelit. ▪ Analizon fjalë e fjali. ▪ Plotëson fjalën me shkronjën që mungon. ▪ Krijon rrokje me shkronjën **P.** ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** shkronja P,p e madhe dhe e vogël e shtypit, shkruaj, analizo, patate, speca, pjeshka, pilaf, piper, peceta. **Teknika dhe strategji:** ❖ Gjëegjëza ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake, ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **P, p**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **p**, tabela plastike, figura, CD, magnetofon.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte,
Organizimi i orës së mësimit	

Veprimtari paraprake

Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën **P,** ose e vendos atë në CD.

P ... si pranvera që me lule lulezon,

P ... si peshku që në det noton,

P... si piktori që e pikturon,

P ... si paqja që po kërkojmë,

Që në planetin tonë të mbizotërojë.

Paraqiten etiketat e shkronjave **P, p** dhe emërtohen. Pasqyrohen edhe modelet e krijuara një orë më parë me plastelinë, fije apo tela.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Gjëegjëza, Analizë – sintezë

Mësuesja u lexon nxënësve një gjëegjëzë:

- *"Plot me ngjyra është ai, e në një kafaz të gjerë rri plot hijeshi, kujdes se porsi njerëzit flet me zë, e çfarë themi persërit."*
- *Cili është? (papagalli)*

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *papagalli* dhe kryen analizë –sintezë të saj, në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **P**.



Veçohet shkronja **P, p** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurëse janë edhe në fletoren e punës.

- **P** e madhe e shtypit. **P** e madhe e dorës
- **p** e vogël shtypit **p** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 2. Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **P, p**. Fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4 me ngjyra uji për shkrimin e shkronjave **P, p**.

Ashtu si shkronja **P** e madhe e shtypit, edhe shkronja **p** e vogël e shtypit shkruhen me anë të dy lëvizjeve. Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.



Hapi 3. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 58.

Lexohen fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **P** dhe më pas fjalën PAPAGALLI, e cila u analizua me lart. Nxënësit e ngjyrosin atë.

Nxënësit ushtrohen të pavarur në ushtrimet e dhëna.

- **Në ushtrimin e parë** sipas udhëzimeve të marra nxënësit do të punojnë grafikun e shkronjës **P** të madhe të shtypit.
- **Në ushtrimin e dytë** nxënësi përshkruan figurat dhe plotëson shkronjën e re **P** tek fjala përkatëse. Mësuesja ushtron nxënësit që të ndërtojë fjali me to.
- **Në ushtrimin e tretë** nxënësi shkruan grafikun e shkronjës **p** të vogël të shtypit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **P, p** dhe tri fjalë që kanë në përbërje shkronjën **P** (në fillim , në mes dhe në fund). Analizojnë njërën prej tyre.

Ushtrohen nxënësit të krijojnë me gojë fjali me to.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **P, p** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjën që mungon.
- ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët kyçe.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani 2 rreshta me grafikun e shkronjes **P** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **p**.
2. Analizo fjalët në ushtrimin 2.
3. Ndërto fjali me to.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan fjalë duke parë figura.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Shkronja P, fq. 47</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Lexon me role pjesën.
▪ Dallon shkronjës P ne tekst.
▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit
▪ Dallon shenjat e pikësimit (. , ? !)
▪ Kryen analizë të fjalive.
▪ Plotëson fjalët e fjalitë me rrokje e fjalë që mungojnë.
▪ Shfaq besim e vullnet për të punuar</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
shkronja P, p, P, p, pulë me perime, shenjat e pikësimit, pikë, presje, pikëpyetje, pikëçuditje.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Improvizim
❖ Lexim i drejtuar, shpjegim
❖ Lexim me role, Analizë
❖ Punë e pavarur
❖ Interpretim i rezultateve</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën P, tabela plastike, figura, fletë A4, flipçart, skeda, piramida ushqimore, etiketa me shenjat e pikësimit.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja e nis orën e mësimit me një punë me grupe. Ajo ka përgatitur disa skeda, të cilat ua shpërndan secilit grup. Brenda një afati të caktuar nxënësit do të shkruajnë fjalë të ndryshme ku shkronja P ndodhet në fillim , në mes ose në fund të fjalës.
<table>
<tr><td>P në fillim të fjalës</td><td>P në mes të fjalës</td><td>P në fund të fjalës</td></tr>
<tr><td>perime
..</td><td>Sapuni
...</td><td>Turp
...</td></tr>
</table></td></tr>
</table>

Një përfaqësues i grupit del para klasës dhe lexon punën e grupit.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Improvizim

Mësuesja improvizon një histori.

Nëna pasi shtroi tryezën i tha fëmijëve:

"*Urdhëroni, do hamë pulë me perime, është plot me vitamina".*

Fëmijët kërkuan për vitamina në pjatë por s'gjetën.

- Çfarë mendoni për fëmijët?
- A mund ti shihnin ato vitaminat?
- Ku janë vitaminat? Tek perimet.

Hapi 2 . Lexim i drejtuar. Shpjegim

Mësuesja paraqet ne flipçart tekstin "PULË ME PERIME" bashkë me ilustrimet përkatëse. Ndryshe nga tekstet e tjera, sot kemi të bëjmë me një dialog ndërmjet pjesëtarëve të familjes.

Fillimisht mësuesja prezanton personazhet dhe më pas lexon tekstin. Shpjegon gjithashtu çfarë është një dialog.

Nxënësit ndjekin paralelisht në librin e Abetares në faqen 47.

- Çfarë ka gatuar mami për drekë?
- Cila ka uri?
- Çfarë vuri mami në pjatë?

Mësuesja ndalet dhe shpjegon shenjat e pikësimit të përdorura.

- Kur ne tregojmë në fund të fjalisë vendosim pikë (.). *Kemi pulë me perime.*
- Kur habitemi përdorim pikëçuditëse. (!). *Ua, pulë!*
- Kur pysim në fund të fjalisë vendisom pikëpyetje. (?) *Pak perime?*
- Kur në mes të fjalisë bëjmë një pushim të shkurtër vendosim presje. (,) *Mami, unë kam uri.*

Hapi 3. Lexim me role, analizë

Mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë fillimisht etiketat e shkronjës **P** në të katërta format e saj.

Ushtrohen nxënësit të lexojnë me role, duke i ndarë secilit prej tyre nga një rol.

Mësuesja në tekstin e përgatitur dhe nxënësit në libër ndajnë fjalitë e tekstit në fjalë duke bërë një analizë të tyre.

Pak	pulë	e	pak	perime

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala me e gjatë? Po më e shkurtër?

Nxënësi qarkon të gjitha shkronjat **P** që ndodhen tek teksti.

- Sa shkronja **P** kemi gjithsej?

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit duke vendosur X në alternativën e saktë.

Hapi 4. Punë e pavarur

Mësuesja do të ndalet në ushtrimet në vazhdimësi.

- *Në ushtrimin 1* nxënësi plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë: *pa, pe, pi, pu.*
- *Në ushtrimin 2* nxënësi lidh pjesët e fjalisë me njëra tjetrën dhe plotëson me fjalën që mungon.
- *Në ushtrimin 3* nxënësi përshkruan figurën dhe lidh fjalët për të krijuar fjali të plota.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit të shkruajnë fjalitë e ushtrimit të fundit në fletoret e klasës.

Mësuesja kontrollon dhe bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Leximin e pjesës në role.
- ✓ Dallimin e shkronjës **P** në tekst.
- ✓ Përgjigjet me fjali të thjeshta të pyetjeve rreth tekstit.
- ✓ Dallimin e shenjave të pikësimit (. , ? !)
- ✓ Kryerjen e analizës së fjalive.
- ✓ Plotësimin e fjalëve e fjalive me rrokje e fjalë që mungojnë.
- ✓ Shfaqjen e besimit e vullnetit për të punuar.

Detyrë shtëpie:

1. Lexoni disa herë faqen.
2. Mësoni pjesën për dramatizim.
3. Shkruani tekstin “PULË ME PERIME”.
4. Formoni fjali duke u bazuar tek shenjat e pikësimit (. ? !)

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore:				

<table>
<tr><td>Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri</td><td>Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan fjalë duke parë figura.</td></tr>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 59</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Dallon fjalët të cilat kanë në përbërje shkronjën P.
▪ Bashkon rroket për të formuar fjalë.
▪ Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje.
▪ Krijon fjali me fjalët e formuara.
▪ Kryen analizë të fjalëve e fjalive të dhëna.
▪ Shkruan në formë të diktuar fjalë e fjali.
▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
shkronja P, p e madhe dhe e vogël e shtypit, rrokje, fjalë, fjali</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Punë në dyshe
❖ Bashkëbisedim
❖ Punë e pavarur
❖ Interpretimi i njohurive</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës P, p, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën P, tabela plastike, etiketa me rrokje.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja ndan klasën në 4 – 5 grupe. Ajo paraqet foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjën P. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato në formë vetëdiktimi në një fletë formati.
Në fund një anëtar nga secili grup del dhe i pasqyron para klasës duke i lexuar ato.
- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?
Shpallet grupi fitues.</td></tr>
</table>

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Punë në dyshe

Mësuesja organizon punën në dyshe. Në tavolinë vendosen etiketat me rrokje të ndryshme, ku njëra prej tyre nuk mund të përdoret. Nxënësi bashkon rrokje, krijon fjalën e saktë dhe e lexon atë. Gjithashtu tregon për etiketën që nuk përdoret.



Hapi 2. Punë e pavarur

Mësuesja pas veprimtarive të mësipërme do të udhëzojë nxënësit të hapin fletoren e punës në faqen 59. *Shënim: Pjesa e dytë e faqes 59 do të punohen bashkangjitur me faqen 60, pasi lidhet me shkronjat e dorës.*

- Në ushtrimin e dhënë pasqyrohen etiketa me rrokje të ndryshme. Nxënësit do ti bashkojnë ato për të krijuar fjalë. Më pas fjalët e krijuara i shkruajnë përbri figurave të dhëna.

Mësuesja ndan klasën në grupe dhe secili punon në fletoren e tyre të klasës, analizë dhe krijim fjalish me dy prej fjaleve të mësipërme, konkretisht:

- *Grupi 1* pulë, pjepër; *Grupi 2* kapak, pemë; *Grupi 3* pure, pupël

p.sh pula = pu + la . Mua me pëlqen pula me pilaf.

1 2 3 4 5 6

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mësuesja realizon një diktim me shkronja shtypi me rrokje, fjalë e fjali që kanë në përbërje shkronjën **P,** psh.

pi, pla, pu, plo, pena, Pina, perime, piper, përpara. Eni ka para Penin. Unë ha pule me perime.

Mësuesja kontrollon punën e nxënësve dhe bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Krijimin e rrokjeve të cilat kanë në përbërje shkronjën **P.**
- ✓ Krijimin e fjalëve duke bashkuar rrokjet
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë e shprehje.
- ✓ Krijimin e fjalive me fjalët kyçe.
- ✓ Analizën e fjalëve e fjalive të dhëna.

✓ Shkrimin në formë të diktuar të fjalëve e fjalive. ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruani 5 fjalë nga fjalori në fletoren e punës. 2. Krijoni 4 fjali me fjalë që tregojnë ushqime dhe që përmbajnë shkronjën **P** në trup të tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** -Luan role sipas modeleve.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.		
Njësia mësimore: Shkronja P, fq. 46-47		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë.**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Dallon shkronjen **P, p** duke shqiptuar saktë tingullin e saj. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **P, p.** ▪ Përshkruan figurën në tekst. ▪ Lexon rrokje, fjalë, fjali që kanë në përbërje shkronjën **P**. ▪ Luan ne role pjesën e leximit. ▪ Kryen analizë e sintezë të fjalëve e fjalive. ▪ Krijon fjali duke përdorin shenjat e pikësimit.		**Fjalë kyçe:** shkronja P, p, pulë me perime, ushqime të shëndetshme, analizë **Teknika dhe strategji:** ❖ Pema e mendjes ❖ Analizë ❖ Bashkëbisedim – përshkrim ❖ Lexim me role ❖ Loje me role (dramatizim) ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në grupe		
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **P** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **P**, tabela plastike, figura, etiketa me rrokje e fjalë, fletë A4, makete, skeda.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake***				

Mësuesja ka përgatitur skeda për seciln nxënës. Në skedë ka pasqyruar nje tabele me shkronja të ndryshme ku ia shpërndan nxënësve dhe udhëzon ato të ngjyrosin shkronjën **P, p**.

- Çfarë u formua pas ngjyrosjes? Shkronja **P**.

Mësuesja pasqyron etiketat dhe rikujtojmë **P** – e madhe e shtypit, **p** – e vogël e shtypit.

A	A	I	L	K
A	P	P	P	A
N	P	U	P	E
M	P	P	P	E
U	P	I	J	M
E	P	M	N	I
E	P	L	J	I
U	A	K	U	A

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Pema e mendjes

Mësuesja ka përgatitur një maket ne formë peme dhe u shpërndan nxënësve fleta me ngjyra. Nxënësit shkruajnë një fjalë me shkronjën **P** dhe e ngjisin atë tek pema.

Lexohen fjalët me rradhe nga secili nxënës, i cili me gojë bën edhe analizë të saj. ***patate = pa + ta + te*** .



Hapi 2. Bashkëbisedim, përshkrim

Hapet libri i Abetares në faqen 46 – 47. Lexohen etiketat e shkronjave dhe ushtrohen nxënësit për të rikujtuar përshkrimin e figurës.

- Le të rikujtojmë çfarë ka gatuar mami në mësimin tonë?
- A janë të shëndetshme perimet?
- Cili është ushqimi juaj i preferuar?

Ndalemi tek shtrimi i tryezës, pajisjet e nevojshme dhe higjiena para dhe pas ushqimit.

Ushtrohen nxënësit në leximin e fjalisë kryesore dhe fjalëve të fjalorit, duke qarkuar shkronjën **P, p**.

Hapi 3. Lexim me role

Mësuesja ndalet tek tekst “PULA ME PERIME”.

- Cilët janë personazhet?

Atëherë mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë sipas personazheve të ndara, pjesën në role.

Rikujtohen shenjat e pikësimit (. , ? !) të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në lexim e interpretim.

Hapi 4. Loja me role (Dramatizim)

Nxënësve i është ndarë detyra që një orë më parë që të luajnë pjesën në role. Për këtë në këndin e klasës është përgatitur një tavolinë e improvizuar dhe nxënësit në grupe luajnë pjesën.

Vlerësohen nxënësit për interpretimin e tyre.

Hapi 5. Punë e pavarur, Analizë

Mësuesja ushtron nxënësit për të rikujtuar ushtrimet e realizuara një orë më parë duke i lexuar ato.

Ushtrimet lidhen me plotësimin e fjalëve me rrokje dhe fjalive me fjalë që mungojnë.

Nxënësit në grupe analizojnë:

- *Grupi 1.* Ina punon me penel. *Grupi 2.* Uji pikon pikë – pikë. *Grupi 3.* Drini mori kupën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në grupe mësuesja ushtron nxënësit që të ndërtojnë nga një fjali sipas shenjave të ndryshme të pikësimit

- *Grupi 1.* Fjali ku të përdoret pika (.)
- *Grupi 2.* Fjali ku të përdoret pikëpyetja (?)
- *Grupi 3.* Fjali ku të përdoret pikëçuditja. (!)

Mësuesja vlerëson punën e nxënësve

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjën **P, p** duke shqiptuar saktë tingullin e saj.
- ✓ Pasurimin e fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **P, p.**
- ✓ Përshkrimin e figurës në tekst.
- ✓ Leximin e rrokjeve, fjalëve, fjalive që kanë në përbërje shkronjën **P**.
- ✓ Dramatizimin në role të pjesës.
- ✓ Kryerjen e analizës e sintezës të fjalëve e fjalive.
- ✓ Krijimin e fjalive duke përdorin shenjat të ndryshme pikësimi.

Detyrë shtëpie:

1. Krijoni nga dy fjali për secilin rast. (. ? !)
2. Përshkruani me 2 – 3 fjali të thjeshta një nga perimet që preferoni më shumë.
3. Lexoni disa herë tekstin e dhënë.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
-Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit. Intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam; Emri, mbiemri, përemri</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
-Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 4; III. 1, 2, 3; V. 5; VI. 6.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 4; 2. 1, 2; 3. 5, 7.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 60</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës P, p.
▪ Shkruan rrokje, fjalë e fjali me shkrim dore sipas modelit
▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën P, p, rrokje e fjalë me shkrim dore.
▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore.
▪ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore.
▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Demostrim
❖ Punë e pavarur
❖ Shkrim i lirë (Diktim)</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, grafiku i shkronjës P, p dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën P, p; etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë A4, ngjyra.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Arte</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Mësuesja vë në sfond këngën e shkronjës P dhe udhëzon nxënësit që të jenë të vëmendshëm dhe të mbajnë mend sa më shumë fjalë që kanë në përbërje shkronjën P nga teksti i këngës.
Në fund të këngës nxënësit plotësojnë thesin e fjalëve.</td></tr>
</table>

polici piano

princesha

Veprimet në situatë

Hapi 1 Lojë

Mësuesja u shpërndan nxënësve fletë të bardha me katër modelet e shkronjës **P** dhe duke lëvizuar nëpër klasë të krijojnë 4 modelet e shkronjës **P** të shtypit dhe të dorës.

- Kur unë të them fjalën *TANI* ju lëvizni nëpër klasë dhe gjeni shokët tuaj për të formuar katër modelet e shkronjave së bashku. Nxënësit prezantohen.
- *Unë jam **P** e madhe e shtypit. Unë jam **p** e vogël e shtypit.*
- *Unë jam P e madhe e dorës. Unë jam p e vogël e dorës.*

Së bashku*: Shkronja P është bashkëtingëllore.*

Mësuesja u prezanton nxënësve se do punojnë sot me dy modelet e shkronjës se dorës.

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra.

Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në kor. Rikujtohen edhe rrokje e fjalë të krijuara me to me shkrim dore.

Hapi 3. Demostrim

Shpjegohet grafiku i shkronjës P, p të dorës duke e shoqëruar me lëvizje në ajër. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës me anë të një vidioje ilustruese. Bëhet dallimi me shkronjën **P, p** të shtypit me ato të dorës. Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fletë A4 me anë të ngjyrave, për të mësuar dorën me grafikun e shkronjës së dorës P, p. Mësuesja shpjegon gjithashtu lidhjen e shkronjës P,p me shkronja të tjera për të krijuar rrokje e fjalë.

Ngre nxënës në tabelë të shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë:

- po, por, pe, ple, pu, pula...

Hapi 4. Punë e pavarur

Nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit.

Fillimisht nxënësi punon ne faqen 59 me grafikun e shkronjës p të vogël të dorës, rrokjeve të krijuara me të. *pa, pi, pe, pu, pë, po* dhe *pla, ple, pli, pre, pru, prë* si edhe fjalëve *pjepër pupla.*

Më pas nxënësi punon në faqen 60 me grafikun e shkronjës P të madhe të dorës dhe fjalëve: *Puka, Petriti*

Në ushtrimin pasardhës mësuesja u kërkon nxënësve që të lexojnë fjalitë e dhëna me shkrim shtypi dhe më pas ti kthejnë ato në shkrim dore.

- Petriti piu pak uji. *Petriti piu pak uji.*

Nxënësit lexojnë fjalët e fjalitë e shkruara me shkrim dore.

Demonstrim i rezultateve të arritura

Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara, fjalë e grupe fjalësh. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

Pa, po, pi, ple, plo, pula, perime, Petriti, pulë me perime. Polina ka para Petritin ....

Kontrollohen e vlerësohen nxënësit.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës P,p.
- ✓ Shkrimin e fjalëve e fjalive sipas modelit.
- ✓ Shkrimin në formë të diktuar shkronjën P, p, rrokje e fjalë me shkrim dore.
- ✓ Kthimin e shkrimit të shtypit në shkrim dore.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit

Detyrë shtëpie:

1. Shkruani nga 3-5 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës P, p.
2. Shkruani 10 fjalë me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën p. Shoqëro disa prej tyre edhe me foto ose vizatime.
3. Korrigjoni diktimin e bërë në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Vlerësim përmbledhës 1		**Situata e të nxënit:** Përsëritje e shkronjave		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi: • Lexon kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme. • Shkruan rrokjet që mungojnë. • Shkruan fjalën poshtë figurës.		**Fjalë kyçe:** anija, kinema, kurora, Ani, Ana, Era, Iliri **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim rreth njohurive paraprake		

• Ndanë fjalët në rrokje e shkronja.	❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: njohuritë paraprake të nxënësve, fletë testimesh të përgatitura, shkronjat kolektive.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Hapi 1. Diskutim rreth njohurive paraprake

Njihen nxënësit me temën dhe u shpjegohet se çfarë është Testi, cili është qëllimi dhe rëndësia e tij.

U shpjegohen rregullat e sjelljes gjatë detyrës me shkrim dhe punës individuale.

Bëhet përsëritje e shkronjave të mësuara të grupit të parë dhe të dytë.

Veprimet në situatë

Hapi 2 . Vëzhgo-Analizo

Nxënësit ndahen në dy grupe, grupi **A** dhe grupi **B**.

U shpërndahen fletët e ushtrimeve të fotokopjuara më parë.

U sqarohen hapat e punës për çdo ushtrim.

Nxiten nxënësit të lexojnë vetë kërkesat.

Këshillohen ngadalë dhe saktë në çdo etapë të ushtrimeve duke u ofruar udhëzimet e nevojshme.

Hapi 3. Punë individuale

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur detyrat e paraqitura.

Gjatë gjithë kohës vëzhgohen dhe u ofrohet ndihma e nevojshme sidomos atyre që shfaqin vështirësi.

Lexojnë kërkesat e ushtrimeve dhe udhëzohen të plotësojnë ato ushtrime që i dinë kurse ato që nuk i kuptojnë u kthehen prapë pasi t'i përfundojnë ato që iu duken më të lehta.

Nxënësit shkruajnë me shkronjat e shtypit apo të dorës, sipas dëshirës me përjashtim të ushtrimit 4, i cili duhet të plotësohet me shkrim dore.

Megjithatë është mirë që nxënësit të ushtrohen më shumë në punën me shkrim dore.

Ushtrimi i parë: Ndajnë fjalët në rrokje e shkronja.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit duhet të plotësojnë shkronjat që mungojnë:

Grupi A **Grupi B**

anija, limoni, piano pema, lulja, kupa

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë fjalën poshtë figurës:

Grupi A: ora, luani, mali **Grupi B**: ujku, muri, jeleku

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me shkronja dore fjalinë e dhënë.

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë fjalët në vendin e duhur për të krijuar fjali kuptimplota.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë shkronja, rrokje, fjalë e fjali.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e kërkesave të ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme.
- Shkrimin e rrokjeve që mungojnë.
- Shkrimin e fjalëve poshtë figurës.
- Shkrimin e fjalive me shkronja të dorës.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje e shkronja.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga një rresht me shkronjat e mësuara.

	Vlerësim i njohurive 1 **Lënda: Gjuhë shqipe** **EMRI:** _____ **KLASA:** _____	**Grupi: A**
1.	Ndaj fjalën në rrokje e shkronja.  	6 pikë
2.	Në fjalët e mëposhtme shkruaj rrokjen që mungon.    a_ _ja _ _ moni pia_ _	9 pikë
3.	Shkruaj fjalën poshtë figurës.    _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _	12 pikë
4.	Shkruaj me shkronja dore fjalitë. Ani e Era me mamin. _____ Kali iku në mal. _____	9 pikë
5.	Shkruaj fjalët në vendin e duhur. luan me Ana Ilirin _____	9 pikë

Shkallët e vlerësimit	**Arritje e pakënaqshme**	**Arritje minimale**	**Arritje mesatare**	**Arritje e kënaqshme**	**Arritje e plotë**
Vlerësimi sipas pikëve	O-11	12-22	23-33	34-39	40-45
Mësusesi/ja i/ e klasës:					

	Vlerësim i njohurive 1 **Lënda: Gjuhë shqipe** **EMRI: _____ KLASA: _____**	**Grupi: B**
1.	Ndaj fjalën në rrokje e shkronja:  	6 pikë
2.	Në fjalët e mëposhtme shkruaj rrokjen që mungon.    pe_ _ _ _ lja ku_ _	9 pikë
3.	Shkruaj fjalën poshtë figurës.    _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _	12 pikë
4.	Shkruaj me shkronja dore fjalinë: Ani e Iliri në rërë. _____ Keli ka kalë. _____	9 pikë
5.	Shkruaj fjalët në vendin e duhur: luan me Era Drinin _____	9 pikë

Nënshkrimi i prindit:	

Shkallët e vlerësimit	**Arritje e pakënaqshme**	**Arritje minimale**	**Arritje mesatare**	**Arritje e kënaqshme**	**Arritje e plotë**
Vlerësimi sipas pikëve	O-11	12-22	23-33	34-39	40-45
Mësusesi/ja i/ e klasës:					
Nënshkrimi i prindit:					

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1, 3, 4; II.7; III.3; IV.5; V.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 5.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja B (faqja 48 e Abetares)</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Shqipton tingullin B duke e lidhur me shkronjën B.
▪ Gjen dhe thotë fjalë që fillojnë me B ose që përmbajnë shkronjën b në trup të tyre.
▪ Përshkruan figurën qendrore.
▪ Dallon rrokje të krijuara me shkronjën B.
▪ Plotëson sipas kuptimit fjalitë me fjalë mungesore.
▪ Analizon fjalë e fjali.
▪ Lexon fjalët e fjalitë në tekst.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
shkronja B, b, borë, babane, bebe, buka; rrokje, fjalë, fjali</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Pema e mendjes
❖ Përshkrim imagjinar
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Vëzhgim – përshkrim
❖ Analizë -sintezë
❖ Demostrim
❖ Punë individuale
❖ Interpretim i rezultateve</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës B dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën B, foto ilustruese të stinës së dimrit, tabela plastike, fletë formati.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake Shëtitje në natyrë, Pema e mendjes
Mësuesja e fillon mësimin me një shëtitje në mjediset përreth shkollës. Nxënësit kështillohen të vërejnë natyrën, gjethet që kanë rënë, pemët, qiellin, temperaturën dhe motin (i cili mund të jetë i vranët, me shi ose borë, duke qenë se jemi në stinën e dimrit)
Me kthimin në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për sa panë dhe përshkruajnë stinën e dimrit që sapo ka hyrë. Fjalët kyçe mësuesja i shkruan tek pema e mendjes.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Përshkrim imagjinar
Mësuesja u kërkon nxënësve që të imagjinojnë një ditë me borë, ashtu si në fotot e paraqitura.
- Si ndiheni?

</td></tr>
</table>

- Si jeni veshur?
- Çfarë po bëni?
- Çfarë mjetesh ju nevojiten për të bërë plakun prej bore?
- Çfarë lojrash preferoni të luani?

Mësuesja u prezanton nxënësve se pikërisht sot do të ndalen në mësimin dhe përvetësimin e shkronjës **B**,**b** ashtu si BORA, BUKURIA, BALONA etj.
Nxënësit plotësojnë pemën e mendjen me fjalë me shkronjën **B**, të cilat gjenden në fillimn, në mes apo në fund të fjalës.
Prezantohet shkronja **B, b** me anë të etiketave dhe bëhet kujdes që tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë nga ana e nxënësve. **B –** e madhe e shtypit, **b –** e vogël e shtypit
Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra
Përsëritje në kor e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë me to.
Hapi 3 Vëzhgim - përshkrim
Hapet teksti i Abetares në faqen 48 dhe përqëndrohemi tek përshkrimi i figurës qëndrore. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër.

- Në cilën stinë jemi?
- Si është moti?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Çfarë kanë veshur ato? 1 2 3
- Çfarë mendoni për harabelin e vogël?

Analizojmë fjalia kryesore:

Po	bie	bore.

bo – rë b - o

Hapi 4. Demostrim
Pasi lexohet tingulli i shkronjes, mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **B, b** të shtypit, fillimisht në ajër, duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë formati, me bojra uji për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plasteline, fije etj. Shtohet shkronjën **B** tek grupi i bashkëtingëlloreve. Krjohen rrokje me të.
Hapi 5. Punë individuale
Ushtrimi i parë: Nxënësi qarkon në fjalët e dhëna rrokjet, ba, be, bo, bu. Lexohet fjala e plotë.
Ushtrimi i dytë: Nxënësi plotëson fjalët me shkronjat që mungojnë. Lexohen fjalët e formuara.
Ushtrimi i tretë: Nxënësi plotëson fjalinë e dhënë me fjalët që mungojnë dhe e lexojnë atë.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura
Ushtrohen nxënësit në tabelë dhe në fletoret e tyre të bëjnë analizë të fjalëve në ushtrimet e dhëna.

- *banane, bebe, bore, bukë, harabeli, balena, biberoni.*

Ushtrohen nxënësit me gojë që të ndërtojnë edhe fjali me to.
Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e tingullit **B** duke e lidhur me shkronjën **B**.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që fillojnë me **B** ose që përmbajnë shkronjën **b** në trup të tyre.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.
- ✓ Dallimin e rrokjeve të krijuara me shkronjën **B.**
- ✓ Plotësimin sipas kuptimit të fjalive me fjalë mungesore.
- ✓ Analizën e fjalëve e fjalive.
- ✓ Leximin e fjalët e fjalive në tekst.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 1 rresht me shkronjën **B,b** dhe rrokjet që krijohen me të.
2. Shkruaj 8-10 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën **B,b** dhe kryej analizë të disa prej tyre.

3. Ndërto fjali me tri prej tyre
4. Leximi i faqes

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5;	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 61- 62	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjës **B, b** të shtypit sipas modelit. ▪ Analizon fjalë e fjali. ▪ Plotëson fjalën me shkronjën që mungon. ▪ Krijon rrokje me shkronjën **B** e me rrokjet fjalë. ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Shkronja **B, b** e madhe dhe e vogël e shtypit, shkruaj, analizo, bredhi, bora, burim, bjeshkë, babagjysh. **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjim i vëmendshëm ❖ Gjëegjëza ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake, ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **B, b**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **B**, tabela plastike, figura, CD, magnetofon.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte, **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën **B**, ose e vendos atë në CD.

Bora bie përmbi tokë,
rrugë e pemë ka mbuluar.
Ne sot jemi katër shokë,
që lodrojmë të gëzuar.
B ... si bora që qilimin e bardhë shtron,
B ... si balona që në qiell flutiron,
B... si balena që në det noton... si piktori që e pikturon,
B ... si bleta që mjaltin na dhuron,
Me shkronjën B fillon.

Paraqiten etiketat e shkronjave **B, b** dhe emërtohen. Pasqyrohen edhe modelet e krijuara një orë më parë me plastelinë, fije apo tela. Rikujtohen shkronjat e mësuara më parë me anë të etiketave.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Gjëegjëza, Analizë – sintezë

Mësuesja u lexon nxënësve një gjëegjëzë:

- *"Vete nga vete, merr shtëpinë me vete, jeton çdo mjedis, kërmillin ka për fis."*
- *Cila është? (breshka)*



Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *breshka* dhe kryen analizë – sintezë të saj, në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **B.**
Veçohet shkronja **B, b** dhe shqiptohet tingulli i saj.
Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurse janë edhe në fletoren e punës.

- **B** e madhe e shtypit. **B** e madhe e dorës
- **b** e vogël shtypit **b** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se sot do ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.
Hapi 2 Veprimtari e udhëhequr
Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **B, b**. Fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4, me bojëra uji për shkrimin e shkronjave **B, b**.
Shkronja **B** e madhe e shtypit ka tri hapa, ndërsa shkronja **b** e vogël e shtypit dy hapa.
Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.



Hapi 3. Punë e pavarur.
Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 61 e më pas 62.
Lexohen fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **B** dhe më pas fjalën BRESHKA, të cilën e analizuam më lart. Nxënësit e ngjyrosin atë.
Nxënësit do të ushtrohen të pavarur në ushtrimet e dhëna, pas shpjegimeve përkatëse.

- *Në ushtrimin 1* sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës **B** të madhe të shtypit.
- *Në ushtrimin 2* Nxënësi përshkruan figurat, plotëson shkronjën e re **B** tek fjala përkatëse. Mësuesja ushtron nxënësit që të ndërtojë fjali me to.
- *Në ushtrimin 3* nxënësi shkruan grafikun e shkronjës **p** të vogël të shtypit.
- *Në ushtrimin e faqës 62* nxënësi lidh rrokjet për të krijuar fjalë e më pas fjalët e dhëna i shkruan tek figurat përkatëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura
Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **B, b**. Më pas shkruajnë në fletore fjalët e ushtrimit 2 dhe i analizojnë ato: *bredh, borë, burim,bjeshke, babagjysh*
Me njërën prej tyre ata ndërtojnë një fjali të thjeshtë.
Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **B, b** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjën që mungon.
- ✓ Bashkimin e rrokjeve për të krijuar fjalë.
- ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët kyçe.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 2 rreshta me grafikun e shkronjes **B** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **b**.
2. Analizo fjalët në ushtrimin 1 faqe 62.
3. Ndërto fjali me tri prej tyre.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:

Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5;</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja B (faqja 49 e Abetares)</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Lexon fjalë e fjali që kanë në përbërje shkronjën B.
▪ Dallon shkronjën B në tekstin e dhënë.
▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit.
▪ Plotëson fjalorin me fjalë e shprehje.
▪ Kryen analizë të fjalive.
▪ Plotëson fjalët e fjalitë me rrokje e fjalë që mungojnë.
▪ Shfaq besim e vullnet për të punuar.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
shkronja B, b, B, b, bora e parë, fjali, fjalë, rrokje, shkronjë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Punë në grupe
❖ Dëgjimi i vëmendshëm
❖ Lexim i drejtuar, shpjegim
❖ Lexim zinxhir, Analizë
❖ Punë e pavarur
❖ Punë në grupe
❖ Interpretim i rezultateve</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën B, tabela plastike, figura, fletë formati, flipchart, skeda; karton me ngjyrë të zezë dhe të bardhë, letër portokalli, ngjitës, furce, bojë, shkopinj druri, kopsa.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natytës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake Punë në grupe
Mësuesja e nis orën e mësimit me një punë me grupe. Ajo ka përgatitur disa skeda, të cilat ua shpërndan secilit grup. Brenda një afati të caktuar nxënësit shkruajnë fjalë të ndryshme ku shkronja B ndodhet në fillim , në mes ose në fund të fjalës.
<table><tr><td>B në fillim të fjalës</td><td>B në mes të fjalës</td><td>B në fund të fjalës</td></tr><tr><td>balona
..</td><td>libri
...</td><td>humb
...</td></tr></table>
Një përfaqësues i grupit del para klasës dhe lexon punën e grupit.
- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Veprime në situata</td></tr>
</table>

Hapi 1. Dëgjimi i vëmendshëm



Mësuesja vendos në sfond për të dëgjuar këngën për fëmijë *"Bie bora e parë"*.
Nxënësit improvizojnë me levizje e shprehi këngën dhe në fund të saj plotësojnë skedën me sa më shumë fjalë që përmbajnë shkronjën **b.**

Hapi 2 . Lexim i drejtuar / Shpjegim

Mësuesja paraqet ne flipchart tekstin "BORA E PARË" bashkë me ilustrimet përkatëse. Përshkruhen figurat e dhëna, prezantohen personazhet; *Bora, Albani, babi* dhe më pas mësuesja u lexon nxënësve pjesën.

Nxënësit ndjekin paralelisht në librin e Abetares në faqen 49. Gjatë leximit bëhen pyetje rreth tekstit në mënyrë që të kuptohet më mirë përmbajtja. Udhëzohen nxënësit të përgjigjen me fjali të plotë.

- Në cilën stinë jemi?
- Çfarë e ka mbuluar qytetin?
- Me çfarë po luajnë fëmijët?
- Çfarë bënë ata me borë?

Hapi 3. Lexim zinxhir.Analizë

Mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë fillimisht etiketat e shkronjës **B** në të katërta format e saj.
Ushtrohen nxënësit të lexojnë zinxhir nga një fjali.
Mësuesja në tekstin e përgatitur dhe nxënësit në libër ndajnë fjalitë e tekstit në etiketa duke bërë një analizë të tyre, psh.

Bora	po	mbulon	qytetin.

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala me e gjatë? Po më e shkurtër?

Nxënësit qarkojnë të gjitha shkronjat **B** që ndodhen tek teksti.

- Sa shkronja **B** kemi gjithsej?

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit duke vendosur X në alternativën e saktë.

Hapi 4. Punë e pavarur

Mësuesja udhëzon nxënësit për të punuar ushtrimet në vazhdimësi.

- Në ushtrimin 1 nxënësi plotëson fjalët e fjalive me shkronjat që mungojnë.
- *Në ushtrimin 2* nxënësi plotësojnë me fjalët ndihmëse duke krijuar grupe fjalësh: *mbin bari, bleu bukën, mban librin, bëri bukën*.

Hapi 5. Punë në grupe

Nxënësit janë përgatitur me disa mjete për të krijuar plakun prej bore. Për këtë secili grup ka këto mjete: karton me ngjyrë të zezë dhe të bardhë, letër portokalli, ngjitës, furçë, bojë, shkopinj druri, kopsa.

Duke u ndalur edhe tek hapat në tekst mësuesja demostron punën para klasës dhe më pas nxënësit punojnë në grupe. Mësuesja vëzhgon punën e tyre duke dhënë sugjerimet dhe ndihmën e saj.
Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën para klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit të shkruajnë fjali të plota më grupet e fjalëve: *mbin bari, bleu bukën, mban librin, bëri bukën*

Mësuesja kontrollon dhe bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Leximin e pjesës.
- ✓ Dallimin e shkronjës **B** në tekst.
- ✓ Përgjigjet me fjali të thjeshta të pyetjeve rreth tekstit.
- ✓ Analizën e fjalive.
- ✓ Plotësimin e fjalëve e grupeve të fjalëve me shkronja e fjalë që mungojnë.

✓ Shfaqjen e besimit e vullnetit për të punuar.
Detyrë shtëpie: 1. Lexo disa herë faqen. 2. Shkruaj tekstin "BORA E PARË" dhe ilustroje me vizatim. 3. Analizo një nga fjalitë e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5;		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 62 – 63		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës B, b. ▪ Shkruan rrokje, fjalë e fjali me shkrim dore sipas modelit ▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën B, b, rrokje e fjalë me shkrim dore. ▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore. ▪ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore. ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit		**Fjalë kyçe:** shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjimi i vëmendshëm ❖ Lojë ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Demostrim ❖ Punë e pavarur ❖ Shkrim i lirë (Diktim)		
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, grafiku i shkronjës **B, b** dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **B**, b etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë formati, bojra uji.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake. Kënga e shkronjës **B**

Mësuesja vë në sfond këngën e shkronjës **B** dhe udhëzon nxënësit që të jenë të vëmendshëm dhe të mbajnë mend sa më shumë fjalë që kanë në përbërje shkronjën **B** nga teksti i këngës.

Në fund të këngës nxënësit plotësojnë thesin e fjalëve.

balona bleta

babi biçikleta

bufi

Veprimet në situatë

Hapi 1 Lojë

Mësuesja ndan klasën në 4 – 5 grupe. Ajo paraqet foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjën **B**. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato në formë vetëdiktimi në një fletë formati.
Në fund një anëtar nga secili grup del dhe i pasqyron para klasës duke i lexuar ato.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Shpallet grupi fitues.
Mësuesja u prezanton nxënësve që sot do punojnë me shkronjën **B,b** të dorës dhe fjalët e mësipërme do t'i shkruajnë në fund të orës me shkronja dore.
Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra.
Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Leximi i tyre në kor. Rikujtohen gjithashtu rrokje e fjalë të krijuara me to, ta paraqitura me shkrim dore. Ushtrohen nxënësit zinxhir në leximin e tyre.

Hapi 3. Demostrim
Shpjegohet grafiku i shkronjës B, b të dorës duke e shoqëruar me lëvizjen në ajër. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës me anë të një videoje ilustruese. Bëhet dallimi me shkronjën **B, b** të shtypit me ato të dorës. Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fleta formati me bojra uji për të mësuar dorën me grafikun e shkronjës së dorës B, b. Mësuesja shpjegon gjithashtu lidhjen e shkronjës B, b me shkronja të tjera për të krijuar rrokje e fjalë.
Ngrihen nxënës në tabelë të shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë: ba, bi, bu, bla, ble, bro, bora, Beni, ...
Hapi 4. Punë e pavarur
Nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit.
Fillimisht nxënësi punon ne faqen 62 me grafikun e shkronjës b të vogël të dorës, rrokjeve të krijuara me të: *ba, bi, be, bu, bë, bo* dhe *bre, bru, bro, bla, bli, ble* si edhe fjalëve *bora, krimbi.*
Më pas nxënësi punon në faqen 63 me grafikun e shkronjës B të madhe të dorës dhe fjalëve: *Buna, Beni, Brikena.* (Rikujtojmë se emrat e njerësve shkruhen me shkronje të madhe.)
Në ushtrimin pasardhës mësuesja i kërkon nxënësit që të lexojnë fjalitë e dhëna me shkrim shtypi dhe më pas ti kthejnë ato në shkrim dore.

- Blerona dhe Beni luajnë me balona. Blerona dhe Beni luajnë me balona.

Nxënësit lexojnë fjalët e fjalitë e shkruara me shkrim dore.
Hapi 5. Punë në grupe
Nxënësit shkruajnë në grupe fjalët që punuam në pjesën e parë të mësimit me shkronja dore.

- Cili nga grupet i ka shkruar më saktë e më bukur?

Demonstrim i rezultateve të arritura Shkrimi lirë
Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara, fjalë, grupe fjalësh e fjali. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

- bi, bu, ba, bla. Bli, blo, balona, banane, burim, Bora mbuloi tokën. ...

Kontrollohen e vlerësohen nxënësit.
Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës B,b.
- ✓ Shkrimin e fjalëve e fjalive sipas modelit.
- ✓ Shkrimin në formë të diktuar shkronjën B, b, rrokje e fjalë me shkrim dore.
- ✓ Kthimin e shkrimit të shtypit në shkrim dore.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkrim nga 2 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës B, b.

2. Shkrim të 10 fjalëve me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën b. Shoqërimi i disa prej tyre edhe me foto ose vizatime.
3. Krijimi i 2- 3 fjalive me to.
4. Korigjimi i diktimit të bërë në klasë.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:

Poezia, përrallëza, përralla, tregime, gjëegjëzë, fjalë të urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:

Përflet ngjarjen kryesore në tekst;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja B (faqja 48 - 49 e Abetares)</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Dallon shkronjen B,b duke shqiptuar saktë tingullin e saj.
▪ Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën B,b.
▪ Përshkruan figurën duke krijuar një tekst të shkurtër.
▪ Lexon tekstin e dhënë dhe diskuton rreth tij.
▪ Kryen analizë e sintezë të fjalëve e fjalive.
▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Shkronja B, b, bora e parë, lexim, analizë shkrim</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Dëgjim i vëmendshëm
❖ Pema e mendjes
❖ Analizë
❖ Bashkebisedim – përshkrim
❖ Lexim zinxhir
❖ Punë e pavarur, Punë në grupe
❖ Prezantim
❖ Interpretimi i rezultateve</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës B dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën B, tabela plastike, figura, etiketa me rrokje e fjalë, fletë formati, makete, skeda, vidioprojektor.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake Përralla “ Floku i borës”
Mësuesja vendos nëpërmjet një videoprojektori, ose magnetofoni përrallën “Floku i Borës”.
Në pamundësi mësuesja ua tregon nxënësve në klasë përrallën.
Në përfundim mësuesja drejton një bashkëbisedim me pyetje, përgjigje rreth saj.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Bashkëbisedim – përshkrim, Pema e mendjes
Mësuesja udhëzon nxënësit rreth një bashkëbisedimi me temë “Bora ime e parë”.</td></tr>
</table>

- A e keni parë të gjithë ju borën?
- Cila ka qenë ndjesie kur e keni parë për herë të parë?
- A ju sjell të njejtën ndjesi kur e shihni përsëri?
- Çfarë bëni ju në një ditë me borë?



Nxënësit në etiketa të shpërndarë nga mësuesja shkruajnë një fjalë që lidhet me temën dhe që në trup përmban shkronjën **b**. Në përfundim i vendosin ato një në plak bore që mësuesja ka përgatitur në formë maketi.
Lexohen fjalët me rradhe nga secili nxënës, i cili me gojë bën edhe analizë të saj. ***harabeli = ha + ra + be + li***
Rikujtojmë nëpërmjet etiketave shkronjën e re me të gjitha format e saj si edhe rikujtojmë shkronjat e mësuara. Krijijmë me to rrokje e me rrokjet fjalë.
Hapi 2. Punë me tekstin. Leximi zinxhir
Hapet libri i Abetares në faqen 48 – 49. Lexohen etiketat e shkronjave dhe ushtrohen nxënësit për të rikujtuar përshkrimin e figurës. Ata krijijnë një histori me fjalët e tyre për të.
Ushtrohen nxënësit në leximin e fjalisë kryesore dhe fjalëve të fjalorit. Aktivizoj nxënësit në analizë të tyre.
Mësuesja ndalet tek tekst "BORA E PARË".

- Cilët janë personazhet?
- Me çfarë po luajnë fëmijët?
- Në cilën stinë ndodhemi?

Atëherë mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë zinxhir pjesën.
Hapi 3. Punë e pavarur, Analizë
Mësuesja ushtron nxënësit për të rikujtuar ushtrimet e realizuara një orë më parë duke i lexuar ato.
Ushtrimet lidhen me plotësimin e fjalëve me shkronja dhe fjalive me fjalë që mungojnë.
Nxënësit në grupe analizojnë:
Grupi 1. Bora mbuloi malin. *Grupi 2.* Babi mbuloi bebin.
Grupi 3. Blerina bleu banane. *Grupi 4.* Mami bleu brokol.
Hapi 4. Prezantim
Nxënësit një orë më parë punuan njëriun prej bore me materiale të ndryshme. Ushtrohen nxënësit sipas përfaqësuesve të grupeve që të tregojnë mënyrën e realizimit dhe nxënësit vlerësojnë njëri tjterin duke dhënë votën e tyre.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura
Në fletoren e klasës, nxënësi shkruajnë me shkrim dore fjalitë që mësuesja ka shkruar në tabelë me shkronja shtypi.

- Babi me Albanin e Benin bënë burrë bore.
- Bubi Ban luan me balonën.
- Mami bleu bukë të mirë.

Lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.
Nxënësi që mbaron veprimtarinë e parë, mësuesja i shpërndan një tekst gazete ose reviste dhe e udhëzon të qarkon shkronjën **B,b**.
Mësuesja vlerëson punën e nxënësve.
Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjën **B,b** duke shqiptuar saktë tingullin e saj.
- ✓ Pasurimin e fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **B,b.**
- ✓ Përshkrimin e figurës duke krijuar një tekst të shkurtër.
- ✓ Leximin e tekstit të dhënë dhe marrjen pjesë në diskutim.

✓ Analizën e sintezën e fjalëve e fjalive. ✓ Kthimin e fjalive nga shkrim shtypi në shkrim dore.
Detyrë shtëpie: 1. Lexo disa herë tekstin e dhënë. 2. Formo fjali me fjalët: *balena, biberoni, banane, balona* 3. Shkruaj tekstin "Bora e parë" me shkrim dore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: **S**hkronja **T** (faqja 50 e Abetares)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton tingullin **T,t** duke e lidhur me shkronjën **T,t**. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë që fillojnë me **T** ose që përmbajnë shkronjën **t** në trup të tyre. ▪ Përshkruan figurën qendrore. ▪ Dallon rrokje të krijuara me shkronjën **T.** ▪ Lidh fjalë për të krijuar fjali. ▪ Analizon fjalë e fjali. ▪ Lexon fjalët e fjalitë në tekst.		**Fjalë kyçe:** shkronja **T, t**, tablet, laptop, kompjutër, tabelë, termometër, timon,tokë. rrokje, fjalë, fjali. **Teknika dhe strategji:** ❖ Pema e mendjes ❖ Bashkëbisedim - shpjegim ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Vëzhgim – përshkrim ❖ Analizë -sintezë ❖ Demostrim ❖ Punë individuale ❖ Interpretim i rezultateve		
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **T** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **T**, foto ilustruese, tabela plastike, fletë formati, tablet, laptop, tastierë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		

Organizimi i orës së mësimit



Veprimtari paraprake . Vizitë në sallën e TIK-ut, Pema e mendjes
Mësuesja e fillon mësimin me vizitë në sallën e TIK-ut. Nxënësit këshillohen të vërejnë pajisjet, dhe ti përshkruajnë ato, pjesët kryesore të tyre, ambjentin, etj. Në pamundësi mësuesja siguron disa pajisje kompjuterike në klasë si: tablet, laptop, tastierë, videoprojektor ....
Me kthimin në klasë nxënësit nxiten të diskutojnë për sa panë dhe fjalët kyçe mësuesja i shkruan tek pema e mendjes.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bashkëbisedim / Shpjegim
Duke mbajtur një tablet në dorë mësuesja pyet:

- A përdorni shpesh ju mjete teknologjike si telefoni, tableti, kompjuteri?
- Për çfarë e përdorni zakonisht?

Mësuesja u prezanton nxënësve se cilat janë anët pozitive dhe negative të përdorimit të mjeteve teknologjike dhe koha me të cilën nuk duhet të abuzojmë me përdorimin e tyre.
Mësuesja u prezanton nxënësve se pikërisht sot do të ndalen në mësimin dhe përvetësimin e shkronjës **T**,**t** ashtu si TABLETI, TELEFONI, TASTET etj. Nxënësit plotësojnë pemën e mendjen me fjalë me shkronjën **T**, të cilat gjenden në fillim, në mes apo në fund të fjalës.
Prezantohet shkronja **T ,t** me anë të etiketave dhe bëhet kujdes se tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë nga ana e nxënësve. **T –** e madhe e shtypit, **t –** e vogël e shtypit

- Shkronja **T** është zanore apo bashkëtingëllore?

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra
Përsëritje në korr e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë me to.

Hapi 3 Vëzhgim - përshkrim
Hapet teksti i Abetares në faqen 50 dhe përqëndrohemi tek përshkrimi i figurës qëndrore. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër.

- Çfarë shohim ne foto?
- Cilët janë personazhet?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Çfarë po shohin ato në tablet?

Tashmë të gjithë ju mund të gjeni librin e Abetares edhe në platformën digitale.
Analizojmë fjalia kryesore: 1 2 3 4 5

Miri	e	Era	kanë	tablet.

ta – blet t - a

Hapi 4. Demostrim
Pasi lexohet tingulli i shkronjes, mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **T,t** të shtypit, fillimisht në ajër, duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësi ushtrohet në fletë formati, me bojra uji për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plasteline, fije etj. Shtohet shkronjën **T** tek grupi i bashkëtingëlloreve. Krijohen rrokje me të

Hapi 5. Punë individuale
Ushtrimi i parë: Nxënësi qarkon në fjalët e dhëna rrokjet, *ta, te, tu, të, to,* ndërsa në u*shtrimin e dytë* qarkon rrokjet *tra, tre, tri,tru, tro*. Lexohen fjalët e plota tek të dy ushtrimet.
Ushtrimi i tretë: Nxënësi plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë dhe e lexon atë.
Ushtrimi i katërt: Nxënësi plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë dhe lidh ato për të krijuar fjali kuptimplota.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit në tabelë dhe në fletoret e tyre të bëjnë analizë të fjalëve nga ushtrimet e dhëna.

- *tabelë, termometër, timon, letra, trotuar ...*

Ushtrohen nxënësit me gojë që të ndërtojnë edhe fjali me to.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e tingullit **T** duke e lidhur me shkronjën **T**.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që fillojnë me **T** ose që përmbajnë shkronjën **t** në trup të tyre.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.
- ✓ Dallimin e rrokjeve të krijuara me shkronjën **T.**
- ✓ Plotësimin sipas kuptimit të fjalive me fjalë mungesore.
- ✓ Analizën e fjalëve e fjalive.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive në tekst.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 1 rresht me shkronjën **T,t** dhe rrokjet që krijohen me të.
2. Shkruaj 8-10 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën **T,t** dhe kryej analizë të disa prej tyre. Mund ti shoqërosh edhe me vizatime.
3. Ndërto fjali me tri prej tyre.
4. Leximi i faqes

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 64- 65	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjës **T, t** të shtypit sipas modelit. ▪ Analizon fjalë e fjali. ▪ Plotëson fjalën me shkronjën që mungon. ▪ Krijon rrokje me shkronjën **T** e me rrokjet krijon fjalë ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** shkronja **T,t** e madhe dhe e vogël e shtypit, shkruaj, analizo, fotografi, kompjuteri, bateri, astiere, matematikë **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjim i vëmendshëm ❖ Gjëegjëza , Lojë ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake, ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **B, b**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **B**, tabela plastike, figura, CD, manjetofon.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Organizimi i orës së mësimit	

Veprimtari paraprake

Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën **T**, ose e vendos atë në CD.

Telefoni jep sinjal,
pi – pi – pi po më thërret,
telefoni zhurmën ndal,
mua babi kur më flet.
T ...si telefoni që më informon,
T ... si trëndafili plot aromë,
T ... si traktori që tokën punon,
T ... si treni që mbi shika vrapon,
Shkronjën T kanë si timon.

Paraqiten etiketat e shkronjave **T, t** dhe emërtohen. Pasqyrohen edhe modelet e krijuara një orë më parë me plastelinë, fije apo tela. Rikujtohen shkronjat e mësuara më parë me anë të etiketave.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Gjëegjëza, Lojë, Analizë – sintezë

Mësuesja u lexon nxënësve një gjëegjëzë:

- *"Rrumbullak strumbullak, unë e hedh dhe ti e kap, me dorë, këmbë e kokë, të gjithë luajmë tok"*
- *Cili është? (topi)*

Mësuesja ka marrë një top në klasë dhe zhvillon një lojë. Nxënësit kalojnë topin dorë më dorë dhe ata që kapin topin duhet të thonë një fjalë që përmban shkronjën **T**. Disa nga fjalët shkruhen në tabelë.

Hapi 2. Analizë – sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *topi* dhe kryen analizë –sintezë të saj, në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **T.**

TOPI			
TO		PI	
T	O	P	I

Veçohet shkronja **T, t** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurse janë edhe në fletoren e punës.

- **T** e madhe e shtypit. **T** e madhe e dorës
- **t** e vogël shtypit **t** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 3 Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **T, t**, fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4, me bojra uji për shkrimin e shkronjave **T, t**.

Shkronja **T** e madhe e shtypit ka dy hapa, ashtu sikurse shkronja **t** e vogël e shtypit.

Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.



Hapi 4. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 64 e më pas 65.

Lexohen fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **T** dhe më pas fjalën TOPI, të cilën e analizuam më lart. Nxënësit e ngjyrosin atë.

Nxënësi ushtrohet i pavarur në ushtrimet e dhëna.

- *Në ushtrimin 1* sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës **T** të madhe të shtypit.
- *Në ushtrimin 2* nxënësi përshkruan figurat, plotëson shkronjën e re **T** tek fjala përkatëse. Mësuesja ushtron nxënësin që të ndërtojë fjali me to.
- *Në ushtrimin 3* nxënësi shkruan grafikun e shkronjës **t** të vogël të shtypit.
- *Në ushtrimin e faqës 65* nxënësi lidh rrokjet për të krijuar fjalë e më pas fjalët e dhëna i shkruan tek figurat përkatëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **T, t**. Më pas ushtroj nxënësit që të shkruajnë në fletore fjalët e ushtrimit 2 dhe ti analizojnë ato:

- *fotografi, bateri, kompjuter, tastierë, matematikë.*

Me njërën prej tyre ata ndërtojnë një fjali të thjeshtë.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **T, t** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjën që mungon.
- ✓ Bashkimin e rrokjeve për të krijuar fjalë.
- ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët kyçe.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 2 rreshta me grafikun e shkronjes **T** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **t**.
2. Analizo fjalët në ushtrimin 1 faqe 65.
3. Ndërto fjali me tri prej tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tinguj, shkronja, zanore dhe bashkëtingëllore, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: **S**hkronja **T** (faqja 51 e Abetares)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Lexon fjalë e fjali që kanë në përbërje shkronjën **T**. ▪ Dallon shkronjën **T** në tekstin e dhënë. ▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit. ▪ Plotëson fjalorin me fjalë e shprehje. ▪ Kryen analizë të fjalive. ▪ Plotëson fjalët e fjalitë me rrokje e fjalë që mungojnë. ▪ Shfaq besim e vullnet për të punuar.	**Fjalë kyçe:** shkronja T, t, T, t, tabletë, abetare, Fjali, fjalë, rrokje, shkronjë **Teknika dhe strategji:** ❖ Punë në grupe ❖ Dëgjimi i vëmendshëm ❖ Lexim i drejtuar, shpjegim ❖ Lexim zinxhir, Analizë ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në grupe ❖ Interpretim i rezultateve
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **T**, tabela plastike, figura , fletë formati, flipcart, skedakompjuter, tabletë	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Punë në grupe	

Mësuesja e nis orën e mësimit me një punë me grupe. Ajo ka përgatitur disa skeda, të cilat ua shpërndan secilit grup. Brenda një afati të caktuar nxënësit shkruajnë fjalë të ndryshme ku shkronja **T** ndodhet në fillim , në mes ose në fund të fjalës.

T në fillim të fjalës	**T** në mes të fjalës	**T** në fund të fjalës
tabletë ..	Abetare ...	trokit ...

Një përfaqësues i grupit del para klasës dhe lexon punën e grupit.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Veprime në situata

Hapi 1. Dëgjimi i vëmendshëm



Mësuesja vendos në sfond për të dëgjuar këngën për fëmijë *"Tren o tren"*.
Nxënësit improvizojnë me levizje e shprehi këngën dhe në fund të saj plotësojnë skedën me sa më shumë fjalë që përmbajnë shkronjën **T.**

Hapi 2 . Lexim i drejtuar. Shpjegim

Mësuesja paraqet ne flipchart tekstin "TABLETI I RI" bashkë me ilustrimet përkatëse. Përshkruhet figurat e dhëna, prezantohen personazhet; Era e Miri dhe më pas mësuesja u lexon nxënësve pjesën.

Nxënësit ndjekin paralelisht në librin e Abetares në faqen 51. Gjatë leximit pyesim rreth tekstit në mënyrë që të kuptohet më mirë përmbajtja dhe nxënësit të përgjigjen me fjali të plotë.

- Çfarë kanë fëmijët?
- Çfarë kërkon Miri në tablet?
- Po Era çfarë po bën?

Hapi 3. Lexim zinxhir.Analizë

Mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë fillimisht etiketat e shkronjës **T** në të katërta format e saj.
Ushtrohen nxënësit të lexojnë zinxhir nga një fjali.
Mësuesja në tekstin e përgatitur dhe nxënësit në libër ndajnë fjalitë e tekstit në etiketa duke bërë një analizë të tyre.

Ai	kërkon	Abetaren	në	tablet.

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala me e gjatë? Po më e shkurtër?

Nxënësit qarkojnë të gjitha shkronjat **T** që ndodhen tek teksti.

- Sa shkronja **T** kemi gjithsej?

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit duke vendosur X në alternativën e saktë.

Hapi 4. Punë e pavarur

Mësuesja udhëzon nxënësit për të punuar ushtrimet në vazhdimësi.

- *Në ushtrimin 1* nxënësi lexon fjalën e dhënë dhe më pas nga shkrim të madh shtypi e shkruan me shkrim të vogël shtypi. Në orën e ardhshme do ta plotësojë dhe me shkronja dore.(pasi të mësohet grafikun i shkronjës)
- *Në ushtrimin 2* nxënësi bashkon etiketat për të formuar fjalinë e saktë. Ato e shkruajnë dhe me gojë e analizojnë atë.

Më pas nxënësi, tek modeli i shkronjës **T** gjejnë pjesën që mungon.

- Cila është alternativa e saktë?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit të analizojnë fjalët: *tulipani* dhe *kompjuteri* dhe të ndërtojnë fjali me fjalët: *tavolina* dhe *tastiera*, fjalë këto të shkëputura nga ushtrimi në tekst.

Mësuesja kontrollon dhe bën vlerësimet përkatëse. **Vlerësohen nxënësit për:** ✓ Leximin e pjesës. ✓ Dallimin e shkronjës **T** në tekst. ✓ Përgjigjet me fjali të thjeshta të pyetjeve rreth tekstit. ✓ Analizën e fjalive. ✓ Plotësimin e fjalëve e grupeve të fjalëve me shkronja e fjalë që mungojnë. ✓ Shfaqjen e besimit e vullnetit për të punuar
Detyrë shtëpie: 1. Lexo disa herë faqen. 2. Shkruaj tekstin "TABLETI I RI" dhe ilustroje me vizatim. 3. Analizo një nga fjalitë e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 65 – 66		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës T, t. ▪ Shkruan rrokje, fjalë e fjali me shkrim dore sipas modelit. ▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën T, t, rrokje e fjalë me shkrim dore. ▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore. ▪ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore. ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjimi i vëmendshëm ❖ Lojë ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Demostrim ❖ Punë e pavarur ❖ Shkrim i lirë (Diktim)		
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, grafiku i shkronjës **T, t** dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **T**, t etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë formati, bojra uji.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi, Arte. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake.*** Kënga (ose përralla) e shkronjës **T**				

Mësuesja vë në sfond këngën (ose përrallën) e shkronjës **T** dhe udhëzon nxënësit që të jenë të vëmendshëm dhe të mbajnë mend sa më shumë fjalë që kanë në përbërje shkronjën **T**.
Në fund të këngës nxënësit plotësojnë thesin e fjalëve.

Toni topi
drejt priti lart



Veprimet në situatë
Hapi 1 Lojë

Mësuesja ndan klasën në 4 – 5 grupe. Ajo paraqet foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjën **T**. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato në formë vetëdiktimi në një fletë formati.
Në fund një anëtar nga secili grup del dhe i pasqyron para klasës duke i lexuar ato.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Shpallet grupi fitues.
Mësuesja u prezanton nxënësve se sot do të punojnë me shkronjën T, t te dorës dhe fjalët e mësipërme do t'i shkruajnë në fund të orës me shkronja dore.
Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra.
Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në kor dhe rrokjeve e fjalëve të krijuara me to me shkrim dore.
Hapi 3. Demostrim
Shpjegohet grafiku i shkronjës T, t të dorës duke e shoqëruar me lëvizjen në ajër. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës me anë të një vidioje ilustruese. Bëhet dallimi me shkronjën **T, t** të shtypit me ato të dorës. Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fleta formati me bojra uji për të mësuar dorën me grafikun e shkronjës së dorës T, t. Mësuesja shpjegon gjithashtu lidhjen e shkronjës T, t me shkronja të tjera për të krijuar rrokje e fjalë.
Ngre nxënës në tabelë të shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë:

- ta, ti, tu, tra, tre, tro, topi,tableti Toni, ...

Hapi 4. Punë e pavarur
Nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit.
Fillimisht nxënësi punon ne faqen 65 me grafikun e shkronjës t të vogël të dorës, rrokjeve të krijuara me të. *ta, ti, te, tu, të, to* dhe *tre, tri, tre, tru, tro* si edhe fjalëve *tetor, petale. plot.*
Më pas nxënësi punon në faqen 66 me grafikun e shkronjës T të madhe të dorës dhe fjalëve: *Tirana, Tropoja, Teuta, Taulanti.* (Rikujtojmë se emrat e njerëzve dhe vendeve shkruhen me shkronje të madhe.)
Në ushtrimin pasardhës mësuesja i kërkon nxënësit që të lexoë fjalitë e dhëna me shkrim shtypi dhe më pas ti kthejë ato në shkrim dore.

- Tina luan me litar. Tina luan me litar.

Nxënësi lexon fjalët e fjalitë e shkruara me shkrim dore.
Hapi 5. Punë në grupe
Nxënësit do të shkruajnë në grupe fjalët që punuam në pjesën e parë të mësimit me shkronja dore.

- Cili nga grupet i ka shkruar më saktë e më bukur?

Demonstrim i rezultateve të arritura Shkrimi lirë
Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara, fjalë, grupe fjalësh e fjali. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

- ti, tu, ta, tra, tri, tro, tableti, torta, litar, Toni iku në Tropojë, Teuta bleu tortë. ...

Kontrollohen e vlerësohen nxënësit.
Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës T,t.
- ✓ Shkrimin e fjalëve e fjalive sipas modelit.

✓ Shkrimin në formë të diktuar të shkronjës T, t, rrokjeve e fjalëve me shkrim dore. ✓ Kthimin e shkrimit të shtypit në shkrim dore. ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore. ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: 1. Shkrim nga 2 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës T, t. 2. Shkrim të 10 fjalëve me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën t. Shoqërimi i disa prej tyre edhe me foto ose vizatime. 3. Krijimi i 2- 3 fjalive me to. 4. Korigjimi i diktimit të bërë në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa:** 1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Identifikon mjetet audio-vizuale dhe ato të teknologjisë informative dhe i përdorë ato për të dëgjuar, për të komunikuar dhe për të bërë regjistrime;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Shkronja **T** (faqja 50 - 51 e Abetares)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Dallon shkronjen **T,t** duke shqiptuar saktë tingullin e saj. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **T,t.** ▪ Mëson rregulla për përdorimin e mjeteve teknologjike**.** ▪ Përshkruan figurën duke krijuar një tekst të shkurtër. ▪ Lexon tekstin e dhënë dhe diskuton rreth tij. ▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore.	**Fjalë kyçe:** Shkronja T, t, tableti i ri, tavolinë, Abetare, tapet, kompjuter, tastierë, tulipan; lexim, analizë, shkrim **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjim i drejtuar ❖ Bashkëbisedim, ❖ Rrjeti i diskutimit ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Pema e mendjes ❖ Lexim zinxhir ❖ Punë e pavarur ❖ Interpretimi i rezultateve
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **T** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **T**, tabela plastike, figura, etiketa me rrokje e fjalë, fletë formati, makete, skeda, tablet, kompjuter, ose vidioprojektor.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Edukimi për media
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Dëgjim i drejtuar	

Mësuesja brenda mundësive merr në klasë një tablet, kompjuter ose vidioprojektor dhe u prezanton nxënësve videon e mësimit të Abetares nëpërmjet platformës digjitale. Këtë orë mësimi mësuesja mund ta realizojë edhe në sallën e TIK-ut.

- Librin e Abetares ne e kemi secili në duart tona, por atë mund ta gjejmë edhe në platformën digitale duke përdorur një nga mjetet teknologjike.

Hapet teksti i Abetares në mësimet që kemi kaluar dhe dëgjojmë pjesëza nga ajo.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bashkëbisedim / Rrjeti i diskutimit

Mësuesja udhëzon nxënësit rreth një bashkëbisedimi me temë "Tableti im".

- A keni ju në shtëpi kompjuter, tablet apo telefon?
- A e përdorni shpesh atë?
- Për çfarë e përdorni zakonisht?

PO — Të kalosh kohë pranë mjeteve teknologjike është mirë apo keq? Pse? — JO

Diskutohen mendimet e nxënësve duke arsyetuar përgjigjet.

Me anë të një flipcharti mësuesja pasqyron një stendë ku ka pasqyruar rregullat e përdorimit të mjeteve teknologjike dhe udhëzon nxënësit për anët pozitive e negative të përdorimit të tyre.

Rregulla

1. Orar i reduktuar.
2. Trupi dhe qafa drejt.
3. Mos e mbajmë afër syve.
4. Mos flasim me të panjohur.
5. Mos futemi në faqe jo të përshtatshme.

Mësuesja ua lexon nxënësve ose ja pasqyron me figura ilustruese.

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra / Pema e mendjes

Mësuesja u paraqet nxënësve etiketa me shkronjat e mësuara dhe nxënësit i përsërisin ato. Krijojnë rrokje e fjalë. Rikujtojmë shkronjën e re **T, t**, T, t. Secili nxënës shkruan një fjalë që fillon ose e ka në trup shkronën **t** dhe e ngjit në stendën që mësuesja ka përgatitur. Nxënësit mund të shkruajnë me shkrim dore ose shtypi.

Hapi 3. Punë me tekstin / Leximi zinxhir **T, t**

Hapet libri i Abetares në faqen 50 – 51. Lexohen etiketat e shkronjave dhe ushtrohen nxënësit për të rikujtuar përshkrimin e figurës. Ata krijojnë një histori me fjalët e tyre për të.

Ushtrohen nxënësit në leximin e fjalisë kryesore dhe fjalëve të fjalorit. Aktivizohen nxënësit në analizë.

Mësuesja ndalet tek tekst "TABLETI I RI".

- Ku ulet Miri? Çfarë sheh ai në tablet?
- Ku është ulur Era? Çfarë po bën ajo në tablet?

Atëherë mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë zinxhir pjesën.

Hapi 4. Punë e pavarur

Rikujtojmë ushtrimin e punuar një orë më parë ku nxënësit fjalët e dhëna me shkronja shtypi të mëdha i kanë shkruan me shkronja të vogla shtypi. Tashmë që ato kanë përvetësuar edhe shkronjat e dorës do ti shkruajnë ato edhe me shkronja dore: tulipani, kompjuteri, tavolina, tastiera.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në fletoren e klasës, nxënësi shkruan me shkrim dore fjalitë që mësuesja ka shkruar në tabelë me shkronja shtypi.

- *Unë punoj në tabelë.*
- *Me termometër mat temperaturën.*

- *Toni luan me top.*

Lexohen fjalitë me shkrim dore.
Nxënësi që mbaron veprimtarinë e parë mësuesja i shpërndan një tekst gazete ose reviste dhe udhëzon të qarkojnë shkronjën **T, t**. Mësuesja vlerëson punën e nxënësve.
Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjën **T,t** duke shqiptuar saktë tingullin e saj.
- ✓ Pasurimin e fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **T,t.**
- ✓ Përvetësimin e rregullave për përdorimin e mjeteve teknologjike.
- ✓ Përshkrimin e 268ere268es duke krijuar një tekst të shkurtër.
- ✓ Leximin e tekstit të dhënë dhe marrjen pjesë në diskutim.
- ✓ Kthimin e fjalive nga shkrim shtypi në shkrim dore.

Detyrë shtëpie:

1. Lexo disa 268ere tekstin e dhënë.
2. Shkruaj tekstin "Tableti I ri" me shkrim dore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tinguj, shkronja, zanore dhe bashkëtingëllore, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: **S**hkronja **D** (faqja 52 e Abetares)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton tingullin **D,d** duke e lidhur me shkronjën **D,d**. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë që fillojnë me **D** ose që përmbajnë shkronjën **d** në trup të tyre. ▪ Përshkruan figurën qendrore. ▪ Lidh rrokjet për të krijuar fjalë. ▪ Analizon fjalë e fjali. ▪ Lexon fjalët e fjalitë në tekst.	**Fjalë kyçe:** Shkronja **D, d**, det, delfin, ditar rrokje, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Pema e mendjes ❖ Bashkëbisedim - shpjegim ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Vëzhgim – përshkrim ❖ Analizë -sintezë ❖ Demostrim ❖ Punë individuale ❖ Interpretim i rezultateve
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **D** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **D**, foto ilustruese, tabela plastike, fletë formati.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake Imagjinatë e drejtuar

Mësuesja paraqet para klasës, foto ose makete që tregojnë pamje nga bota ujore e nënujore. Pasi mësuesja i prezanton ato, ushtron nxënësin të përshkruajë dhe drejton rreth një udhëtimi imagjinar.



- *Mbylli sytë dhe imagjinoni sikur po bëni një udhëtim në botën ujore. Jeni bërë gati, keni marrë pajistet e zhytjes, pompën e frymëmarrjet, pendet e notimit dhe nisu .....*
- Ku ndodheni?
- Çfarë po shihni?

Nga përshkrimi i nxënësve shkëpus dhe shkruaj fjalë që kanë në trup shkronjën **D**.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Analizë - sintezë

Shkëpusni një nga fjalët për të analizuar, psh fjalën DELFINI

DELFINI						
DEL			FI		NI	
D	E	L	F	I	N	I

Mësuesja u prezanton nxënësve se do të ndalen në mësimin dhe përvetësimin e shkronjës **D**,**d** ashtu si DELFINI, DETI, DALLGËT etj. Nxënësit plotësojnë pemën e mendjen me fjalë me shkronjën **D**, të cilat gjenden në fillimn, në mes apo në fund të fjalës nga tematika e fusha të ndryshme. Prezantohet shkronja **D, d** me anë të etiketave dhe bëhet kujdes se tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë nga ana e nxënësve. **D –** e madhe e shtypit, **d –** e vogël e shtypit

- **D**-ja është zanore apo bashkëtingëllore?

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra

Përsëritje në kor e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë me to.

Hapi 3 Vëzhgim - përshkrim

Hapet teksti i Abetares në faqen 52 dhe përqëndrohemi tek përshkrimi i figurës qëndrore. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër.

- Çfarë shohim ne foto?
- Ku gjendemi?
- Çfarë ka në det?
- Çfarë shkëlqen mbi qiell?

Analizojmë fjalia kryesore: 1 2 3 4

Në	det	ka	delfinë.

del - fi - në

d-e-l

Me anë të etiketave shkruhen rrokjet që krijohen me shkronjën d; *di, du,da .....dal, del, dil...*

Hapi 4. Demostrim

Pasi lexohet tingulli i shkronjes, mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **D,d** të shtypit, fillimisht në ajër, duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë formati, me bojra uji për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plasteline, fije etj. Shtohet shkronjën **D** tek grupi i bashkëtingëlloreve. Krjohen rrokje me të.

Hapi 5. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësi qarkon në fjalët e dhëna rrokjet, *di, de, do, du,* ndërsa në u*shtrimin e dytë* plotëson fjalët me rrokjet *dra, dre, dri, dru*. Lexohen fjalët e plota tek të dy ushtrimet.

Ushtrimi i tretë: Nxënësi formon dhe shkruan fjalë të përbëra p.sh. *ditë + lindje = ditëlindje*

Ushtrimi i katërt: Nxënësi lexon fjalët e dhëna dhe qarkon shkronjat *nd*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit në tabelë dhe në fletoret e tyre të bëjnë analizë të fjalëve nga ushtrimet e dhëna.

- *dera, ditari, dushi, druri, paraditë*

Ushtrohen nxënësit me gojë që të ndërtojnë edhe fjali me to.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e tingullit **D** duke e lidhur me shkronjën **D**.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që fillojnë me **D** ose që përmbajnë shkronjën **d** në trup të tyre.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.
- ✓ Dallimin e rrokjeve të krijuara me shkronjën **D.**
- ✓ Analizën e fjalëve e fjalive.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive në tekst.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 1 rresht me shkronjën **D, d** dhe rrokjet që krijohen me të.
2. Shkruaj 8-10 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën **D,d** dhe kryej analizë të disa prej tyre. Shoqëro me foto ose vizatime.
3. Ndërto fjali me tri prej tyre.
4. Leximi i faqes.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 67- 68		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjës **D, d** të shtypit sipas modelit. ▪ Analizon fjalë e fjali. ▪ Plotëson fjalën me shkronjën që mungon. ▪ Krijon rrokje me shkronjën **D** e me rrokjet fjalë. ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Shkronja **D, d** e madhe dhe e vogël e shtypit, shkruaj, analizo, oktapodi, dielli, dallgët, çadra, lodra, kandili. **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjim i vëmendshëm ❖ Gjëegjëza, Lojë ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake, ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur		
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **D, d**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **D**, tabela plastike, figura, CD, manjetofon.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit				

Veprimtari paraprake Dëgjim i vëmendshëm

Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën **D**, ose e vendos atë në CD.

Dimri vjen me shumë zhurmë.,
me të ftohtë e me acar.
Deti tërë valë e shkumë,
qetësohet në behar.
D ...si deti me dallgë plot,
D ... si delfini që bukur noton,
D... si dallëndyshja që në qiell lodron,
D ... si dielli në rrezaton
Shkronja D i drejton.

Paraqiten etiketat e shkronjave **D, d** dhe emërtohen. Pasqyrohen edhe modelet e krijuara një orë më parë me plastelinë, fije apo tela. Rikujtohen shkronjat e mësuara më parë me anë të etiketave.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Gjëegjëza, Lojë Analizë – sintezë

Mësuesja u lexon nxënësve një gjëegjëzë:

- *"I rrumbullakët, shumë i nxehtë, pa të bota, nuk ka jetë."*
- Cili është*? (dielli)*
- Cilat janë disa nga mirësitë që këmi nga dielli?

Hapi 2. Analizë – sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *dielli* dhe kryen analizë –sintezë të saj, në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **D.**

DIELLI				
DI		E	LLI	
D	I	E	LL	I

Veçohet shkronja **D, d** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurse janë edhe në fletoren e punës.

- **D** e madhe e shtypit. **D** e madhe e dorës
- **d** e vogël shtypit **d** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 3 Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **D, d**. Fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4, me bojra uji për shkrimin e shkronjave **D, d**.

Shkronja **D** e madhe e shtypit ka dy hapa, ashtu sikurse shkronja **d** e vogël e shtypit.



Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

Hapi 4. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 67 e më pas 68.

Lexohen fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **D** dhe më pas fjalën DIELLI, të cilën e analizuan me lart. Nxënësit e ngjyrosin atë.

Nxënësi ushtrohen i pavarur në ushtrimet e dhëna, pas shpjegimeve përkatëse.

- *Në ushtrimin 1* sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës **D** të madhe të shtypit.
- *Në ushtrimin 2* nxënësi përshkruan figurat e plotëson shkronjën e re **D** tek fjala përkatëse. Mësuesja ushtron nxënësin të ndërtojë fjali me to.
- *Në ushtrimin 3* nxënësi shkruan grafikun e shkronjës **d** të vogël të shtypit.
- *Në ushtrimin e faqes 68* nxënësi lidh rrokjet për të krijuar fjalë e më pas fjalët e dhëna i shkruan tek figurat përkatëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **D, d**. Më pas ushtrohet nxënësi që të shkruajnë në fletore fjalët e ushtrimit 2 dhe t'i analizojë ato: *oktapodi, dallgët, çadra, kandili, lodrat*
Me njërën prej tyre ndërton një fjali të thjeshtë.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **D, d** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjën që mungon.
- ✓ Bashkimin e rrokjeve për të krijuar fjalë.
- ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët kyçe.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 2 rreshta me grafikun e shkronjes **D** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **d**.
2. Analizo fjalët në ushtrimin 1 faqe 68.
3. Ndërto fjali me tri prej tyre.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Shkronja **D** (faqja 53 e Abetares)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Lexon fjalë e fjali që kanë në përbërje shkronjën **D**. ▪ Dallon shkronjën **D** në tekstin e dhënë. ▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit. ▪ Plotëson fjalorin me fjalë e shprehje. ▪ Kryen analizë të fjalive. ▪ Krijon fjali me fjalë të dhëna. ▪ Shfaq besim e vullnet për të punuar.	**Fjalë kyçe:** shkronja D, d, D, d, ditari, deti Adriatik, delfin, fjali, fjalë, rrokje, shkronjë **Teknika dhe strategji:** ❖ Punë në grupe ❖ Dëgjimi i vëmendshëm ❖ Lexim i drejtuar, shpjegim ❖ Lexim zinxhir, Analizë ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në grupe ❖ Interpretim i rezultateve
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **D**, tabela plastike, figura , fletë formati, flipchart, skeda.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Punë në grupe	

Mësuesja e nis orën e mësimit me një punë me grupe. Ajo ka përgatitur disa skeda, të cilat ua shpërndan secilit grup. Brenda një afati të caktuar nxënësit do të shkruajnë fjalë të ndryshme ku shkronja **D** ndodhet në fillim, në mes ose në fund të fjalës.

D në fillim të fjalës	**D** në mes të fjalës	**D** në fund të fjalës
delfini	lo**d**ra	Kën**d**
..	...	**...**

Një përfaqësues i grupit del para klasës dhe lexon punën e grupit.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Veprime në situata

Hapi 1. Dëgjimi i vëmendshëm

Mësuesja vendos në sfond për të dëgjuar këngën për fëmijë *"Ditari i bizeles"*.

Nxënësit improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën dhe në fund të saj diskutojnë së bashku:

- A e dini ju se çfarë është një ditar?
- Çfarë mund të shkruhet në një ditar?



Mësuesja u demostron nxënësve disa blloqe në formë ditari dhe u tregon nxënësve përdorimin dhe funksionimin e tij.

Ditari fillon me shkronjën **D**. Le të pasurojmë fjalorin me sa më shumë fjalë që kanë në trup shkronjën **D**.

Hapi 2 . Lexim i drejtuar. Shpjegim

Mësuesja paraqet ne flipchart tekstin "DITARI I DEAS" bashkë me ilustrimet përkatëse, të cilat përshkruhen nga nxënësit.

- Vajzat tek kënga që dëgjuam kishin mbajtur një ditar për rritjen e bizeles, Dea personazhi ynë ka mbajtur një ditar gjatë një shëtitje me anije në detin Adriatik. Le ta ndjekim.

Mësuesja lexon pjesën dhe nxënësit ndjekin paralelisht në librin e Abetares në faqen 53. Gjatë leximit pyesim rreth tekstit në mënyrë që të kuptohet më mirë përmbajtja dhe nxënësit të përgjigjen me fjali të plotë.

- Si është moti?
- Ku ndodhet Dea?
- Çfarë sheh ajo në detin e kaltër?
- Si ngjajnë delfinët?

Mësuesja tregon se në fillim të ditarit është shkruar data, e cila është mjaft e rëndësishme në shkrimin e një flete ditari. Mësuesja prezanton disa nga hapat e shkrimit të një ditari.

Hapi 3. Lexim zinxhir - Analizë

Mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë fillimisht etiketat e shkronjës **D** në të katër format e saj.

Ushtrohen nxënësit të lexojnë zinxhir nga një fjali.

Mësuesja në tekstin e përgatitur dhe nxënësi në libër ndan fjalinë e tekstit në etiketa duke bërë një analizë të tyre.

Sa	bukur	duken	delfinët.

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala me e gjatë? Po më e shkurtër?

Nxënësit qarkojnë të gjitha shkronjat **D** që ndodhen tek teksti.

- Sa shkronja **D** kemi gjithsej?

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit duke vendosur X në alternativën e saktë.

Hapi 4. Punë e pavarur

Mësuesja udhëzon nxënësin për të punuar ushtrimet në vazhdimësi.

- *Në ushtrimin 1* nxënësi bën dallimin e shkronjës ***d*** me shkronjën ***b*** duke plotësuar fjalët e dhëna.
- *Në ushtrimin 2* nxënësi plotëson fjalitë me fjalët në etiketë dhe më pas lexojnë fjalinë e plotë.

- *Në ushtrimin 3* nxënësi bashkon etiketat për të formuar fjalitë e sakta. Më pas e shkruan dhe me gojë e analizon atë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura
Ushtrohen nxënësit të analizojnë dhe të ndërtojnë fjali me fjalët: *ditari* dhe *delfini.*
Mësuesja kontrollon dhe bën vlerësimet përkatëse.
Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Leximin e pjesës.
- ✓ Dallimin e shkronjës **D** në tekst.
- ✓ Përgjigjet me fjali të thjeshta të pyetjeve rreth tekstit.
- ✓ Analizën e fjalive.
- ✓ Plotësimin e fjalëve e fjalive me shkronja e fjalë që mungojnë.
- ✓ Shfaqjen e besimit e vullnetit për të punuar

Detyrë shtëpie:

1. Lexo disa herë faqen.
2. Shkruaj tekstin "DITARI I DEAS" dhe ilustroje me vizatim.
3. Analizo një nga fjalitë e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 68 – 69	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës D, d. ▪ Shkruan rrokje, fjalë e fjali me shkrim dore sipas modelit. ▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën D, d, rrokje e fjalë me shkrim dore. ▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore. ▪ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore. ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali. **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjimi i vëmendshëm ❖ Lojë ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Demostrim ❖ Punë e pavarur ❖ Shkrim i lirë (Diktim)
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, grafiku i shkronjës **D, d** dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **D**, d; etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë formati, bojra uji.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Organizimi i orës së mësimit	

Veprimtari paraprake. Kënga(ose përralla) e shkronjës **D**

Mësuesja vë në sfond këngën (ose përrallën) e shkronjës **D** dhe udhëzon nxënësit që të jenë të vëmendshëm dhe të mbajnë mend sa më shumë fjalë që kanë në përbërje shkronjën **D**.

Në fund të këngës nxënësit plotësojnë thesin e fjalëve.



delfin dallgë

oktapod diell

Veprimet në situatë dëshirë det

Hapi 1 Lojë

Mësuesja ndan klasën në 4 – 5 grupe. Ajo paraqet foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjën **D**. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato në formë vetëdiktimi në një fletë formati.

Në fund një anëtar nga secili grup del dhe i pasqyron para klasës, duke i lexuar ato.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Shpallet grupi fitues.

Mësuesja u prezanton nxënësve se do punojnë me shkronjën D,d te dorës dhe fjalët e mësipërme do t'i shkruajnë në fund të orës me shkronja dore.

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra.

Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në kor dhe rrokjeve e fjalëve me shkrim dore, të krijuara me to.

Hapi 3. Demonstrim

Shpjegohet grafiku i shkronjës D, d të dorës duke e shoqëruar me lëvizjen në ajër. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës me anë të një vidioje ilustruese. Bëhet dallimi me shkronjën **D, d** të shtypit me ato të dorës. Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fleta formati me bojra uji për të mësuar dorën me grafikun e shkronjës së dorës D, d. Mësuesja shpjegon gjithashtu lidhjen e shkronjës D, d me shkronja të tjera për të krijuar rrokje e fjalë.

Ngre nxënës në tabelë të shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë:

- da, di, du, dra, dre, dro, deti, delfini, Dea, Daniel ...

Hapi 4. Punë e pavarur

Nxënësit punojnë në fletoren e punës sipas modelit.

Fillimisht nxënësi punon ne faqen 68 me grafikun e shkronjës d të vogël të dorës, rrokjeve të krijuara me të. *da, di, de, du, dë, do* dhe *dra, dri, dre, dru, dro* si edhe fjalëve *dikur, disa.*

Më pas nxënësi punon në faqen 69 me grafikun e shkronjës D të madhe të dorës dhe fjalëve: *Dibër, Dardani, Drilona..* (Rikujtojmë se emrat e njerësve dhe vendeve shkruhen me shkronjë të madhe.)

Në ushtrimin pasardhës mësuesja kërkon që nxënësi të lexojë fjalitë e dhëna me shkrim shtypi dhe më pas ti kthejë ato në shkrim dore.

- Drilona këndoi në ditëlindjen e Dardanit. *Drilona këndoi në ditëlindjen e Dardanit.*

Nxënësi lexon fjalët e fjalitë e shkruara me shkrim dore.

Hapi 5. Punë në grupe

Nxënësit do të shkruajnë në grupe fjalët që punuam në pjesën e parë të mësimit me shkronja dore.

- Cili nga grupet i ka shkruar më saktë e më bukur?

Demonstrim i rezultateve të arritura Shkrimi lirë

Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara, fjalë, grupe fjalësh e fjali. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

- di, du, da, dra, dri, dro, domate, dele, Dori, Dibër. Në det ka dilfinë. ...

Kontrollohen e vlerësohen nxënësit.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës D,d.
- ✓ Shkrimin e fjalëve e fjalive sipas modelit.
- ✓ Shkrimin në formë të diktuar të shkronjës D, d, rrokjeve e fjalëve me shkrim dore.

✓ Kthimin e shkrimit të shtypit në shkrim dore. ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore. ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
Detyrë shtëpie: 1. Shkrim nga 2 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës D, d. 2. Shkrim të 10 fjalëve me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën d. Shoqërimi i disa prej tyre edhe me foto ose vizatime. 3. Krijimi i 2- 3 fjalive me to. 4. Korigjimi i diktimit të bërë në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: **S**hkronja **D** (faqja 52 - 53 e Abetares)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Dallon shkronjen **D, d** duke shqiptuar saktë tingullin e saj. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **D,d.** ▪ Përshkruan figurën duke krijuar një tekst të shkurtër. ▪ Lexon tekstin e dhënë dhe diskuton rreth tij. ▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore.		**Fjalë kyçe:** shkronja **D, d**, det. Delfin, ditar. lexim, analizë, shkrim **Teknika dhe strategji:** ❖ Punë në grupe ❖ Punë në çifte ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Pema e mendjes ❖ Lexim zinxhir ❖ Punë e pavarur ❖ Interpretimi i rezultateve		
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **D** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **D**, tabela plastike, figura, etiketa me rrokje e fjalë, fletë formati, makete, skeda.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Mësuesja ndan klasën në grupe dhe paraqet një foto për secilin grup duke udhëzuar ata që të ndërtojnë fjali ose një histori të shkurtër. Konkretisht:  				





G1. Në fund të detit *G.2 Ditëlindja ime* *G.3 Ditari im* *G.4 Bota e dinozaurve*

Veprimet në situatë

Hapi 1. Punë në çifte

Mësuesja organizon punën në çife. Në tavolinë vendosen etiketat me rrokje të ndryshme, ku njëra prej tyre nuk mund të përdoret. Nxënësit bashkojnë rrokjet e krijojnë fjalën e saktë dhe e lexojn atë. Gjithashtu tregon për etiketën që nuk përdoren.

di ok ~~do~~ ta po oktapod

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra. Pema e mendjes

Mësuesja u paraqet nxënësve etiketa me shkronjat e mësuara dhe nxënësit i përsërisin ato. Krijojnë rrokje e fjalë. Rikujtojmë shkronjën e re **D, d**, D, d. Secili nxënës shkruan një fjalë që fillon ose e ka në trup shkronën **D** dhe e ngjit në stendën që mësuesja ka përgatitur. Nxënësi mund të shkruajë me shkrim dore ose shtypi

D,d,*D,d*

Hapi 3. Punë me tekstin. Leximi zinxhir

Hapet libri i Abetares në faqen 52 – 53. Lexohen etiketat e shkronjave dhe ushtrohen nxënësit për të rikujtuar përshkrimin e figurës.

Ushtrohen nxënësit në leximin e fjalisë kryesore dhe fjalëve të fjalorit. Aktivizohen nxënësit në analizë të tyre.

Mësuesja ndalet tek teksti “DITARI I DEAS”.

- Ku ndodhet Dea?
- Ku po i shkruan ajo kujtimet?
- Çfarë po sheh në udhëtimin me anije?

Atëherë mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë zinxhir pjesën.

Për herë të parë nxënësi lexon tekstin me shkronja të vogla shtypi.

Rikujtojmë ushtrimin e punuar një orë më parë ku nxënësi fjalët e dhëna me shkronja shtypi të mëdha i ka shkruar me shkronja të vogla shtypi.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalitë që mësuesja ka shkruar në tabelë me shkronja shtypi.

- *Unë kam ditar.*
- *Dea luan me delfinë.*
- *Danieli bleu tortë për ditëlindje.*

Lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.

Nxënësi që mbaron veprimtarinë e parë mësuesja i shpërndan një tekst gazete ose reviste dhe udhëzon të qarkojë shkronjën **D,d**.

Mësuesja vlerëson punën e nxënësve.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjën **D,d** duke shqiptuar saktë tingullin e saj.
- ✓ Pasurimin e fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **D,d.**

✓ Përshkrimin e figurës duke krijuar një tekst të shkurtër. ✓ Leximin e tekstit të dhënë dhe marrjen pjesë në diskutim. ✓ Kthimin e fjalive nga shkrim shtypi në shkrim dore.
Detyrë shtëpie: 1. Lexo disa herë tekstin e dhënë. 2. Shkruaj me 3 - 4 fjali një fletë nga ditari yt. (kujtimet e tua)

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: **S**hkronja **S** (faqja 54 e Abetares)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton tingullin **S, s** duke e lidhur me shkronjën **S, s**. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë që fillojnë me **S** ose që përmbajnë shkronjën **s** në trup të tyre. ▪ Përshkruan figurën qendrore. ▪ Lidh rrokjet për të krijuar fjalë. ▪ Analizon fjalë e fjali. ▪ Lexon fjalët e fjalitë në tekst.		**Fjalë kyçe:** Shkronja **S, s**, rregulla të qarkullimit rrugor, semafori; **Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgim në natyrë ❖ Përshkrim. Analizë -sintezë ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Vëzhgim – përshkrim - analizë ❖ Demostrim ❖ Punë individuale ❖ Interpretim i rezultateve		
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **D** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **D**, foto ilustruese, tabela plastike, fletë formati, makete me shenja të qarkullimit rrugor, semafori.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake .*** Vëzhgim në natyrë Si veprimtari paraprakte mësuesja mund të përdori një nga veprimtaritë e mëposhtme: - Shëtitje e shkurtër në rrugën pranë shkollës nëse jeni në një zonë urbane. Vëzhgohen shenjat e qarkullimit rrugor dhe diskutohet rreth tyre. - Përgatitja e një maketi ku tregohet nje zonë urbane, me shenja të qarkullimit rrugor. Këshillohen nxënësit për zbatimin e tyre. - Ftesë e një polici në klasë i cili mund ti flasë nxënësve për shenjat e qarkullimit rrugor dhe kujdesin që duhet të tregojnë në rrugë. Tek secila situatë që zgjidhet një nga shenjat e qarkullimit rrugor shumë të rëndësishme për t'u zbaruar si nga makinat, ashtu edhe nga këmbësorët është *semafori.*				

Veprimet në situatë

Hapi 1. Përshkrim.Analizë - sintezë

Mësuesja paraqet një semafor në klasë të improvizuar dhe diskutojnë rreth tij. Semafori ka tri sy.

- Çfarë na sinjalizon secili prej tyre?
- Cila nga ngjyrat na jep neve të drejtën për të ecur?

SEMAFORI							
SE		MA		FO		RI	
S	E	M	A	F	O	R	I

Pas bisedës, mësuesja shkruan fjalën SEMAFORI e cila analizohet. Mësuesja u prezanton nxënësve se pikërisht sot do të ndalen në mësimin dhe përvetësimin e shkronjës **S**,**s** ashtu si SEMAFORI, SIGURIA, SIRENA etj. Nxënësit plotësojnë pemën e mendjen me fjalë me shkronjën **S**, të cilat gjenden në fillimn, në mes apo në fund të fjalës nga tematika e fusha të ndryshme.

Prezantohet shkronja **S, s** me anë të etiketave dhe bëhet kujdes që tingulli i saj të shqiptohet sa më i saktë nga ana e nxënësve. **S –** e madhe e shtypit, **s –** e vogël e shtypit



- S-ja është zanore apo bashkëtingëllore?

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra

Përsëritje në kor e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë me to.

Hapi 3 Vëzhgim – përshkrim - analizë

Hapet teksti i Abetares në faqen 54 dhe përqëndrohen tek përshkrimi i figurës qëndrore. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër.

- Çfarë shohim ne foto?
- Çfarë po bëjnë fëmijët?
- Si po e ndërtojnë ato?
- Përshkruajmë ngjyrat e përdorura.

Analizojmë fjalia kryesore: 1 2 3 4

Ne	po	ndërtojmë	semaforin.

se - ma – fo - rin

s-e

Me anë të etiketave shkruhen rrokjet që krijohen me shkronjën ***s***; *si, su,sa .....sal, sel, sil...*

Hapi 4. Demostrim

Pasi lexohet tingulli i shkronjes, mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **S,s** të shtypit, fillimisht në ajër, duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë formati, me bojra uji për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plasteline, fije etj. Shtohet shkronjën **S** tek grupi i bashkëtingëlloreve. Krjohen rrokje me të.

Hapi 5. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësi qarkon në fjalët e dhëna rrokjet, *sa, si, se, su, so* dhe lexojnë fjalët e dhëna.

Ushtrimi i dytë: Nxënësi bashkon rrokjet dhe krijon fjalë. Më pas e shkruan fjalën e dhënë.

Ushtrimi i tretë Nxënësi plotëson fjalinë e dhënë me fjalët që mungojnë, duke iu referuar edhe figurës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit në tabelë dhe në fletoret e tyre të bëjnë analizë të fjalëve nga ushtrimet e dhëna.

- *Sapuni, sita, sirena, sandale*

Ushtrohen nxënësit me gojë që të ndërtojnë edhe fjali me to.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e tingullit **S** duke e lidhur me shkronjën **S**.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që fillojnë me **S** ose që përmbajnë shkronjën **s** në trup të tyre.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.
- ✓ Dallimin e rrokjeve të krijuara me shkronjën **S.**
- ✓ Analizën e fjalëve e fjalive.

<table>
<tr><td colspan="5">✓ Leximin e fjalëve e fjalive në tekst.</td></tr>
<tr><td colspan="5">Detyrë shtëpie:
1. Shkruaj 1 rresht me shkronjën S, s dhe rrokjet që krijohen me të.
2. Shkruaj 8-10 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën S,s dhe kryej analizë të disa prej tyre.
3. Ndërto fjali me tri prej tyre.
4. Leximi i faqes.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1 Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqja 70- 71</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Shkruan shkronjës S, s të shtypit sipas modelit.
▪ Analizon fjalë e fjali.
▪ Plotëson fjalën me shkronjën që mungon.
▪ Krijon rrokje me shkronjën S e me rrokjet fjalë.
▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe.
▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Shkronja S,s e madhe dhe e vogël e shtypit, shkruaj, analizo; sandale, sirena, kthesa, spitali, autobusi, semafori, stadiumi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
❖ Dëgjim i vëmendshëm
❖ Gjëegjëza, Lojë
❖ Analizë - sintezë
❖ Diskutim i njohurive paraprake
❖ Veprimtari e udhëhequr
❖ Bashkëbisedim
❖ Punë e pavarur</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës S, s, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën S, tabela plastike, figura, CD, magnetofon.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shoqëria dhe mjedisi, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake Dëgjim i vëmendshëm
Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën S, ose e vendos atë në CD.

S ...si semafori që në rrugë na drejton,
S ... si sirena që na njofron,
S... si sorkadhja që bukur vrapon,
S ... si skifteri që larg fluturon
S ... si stinët që vejnë e vijnë
e njëra tjetrën se arrijnë.</td></tr>
</table>

Paraqiten etiketat e shkronjave **S, s** dhe emërtohen. Pasqyrohen edhe modelet e krijuara një orë më parë me plastelinë, fije apo tela. Rikujtohen shkronjat e mësuara më parë me anë të etiketave.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Gjëegjëza, Lojë Analizë – sintezë

Mësuesja u lexon nxënësve një gjëegjëzë:

- *"Nuk ka bark, e nuk ka gojë, kur ka rast, ha sa të dojë. Me të hyrë ajo në pyll, zverdhen pemët, bëhen dyll."*
- Cila është*? (sëpata)*
- Cilat janë disa nga mirësitë që kemi nga dielli?



Hapi 2. Analizë – sintezë

Mësuesja shkruan në tabelë fjalën *sëpata* dhe kryen analizë –sintezë të saj, në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **S.**

Veçohet shkronja **S, s** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurse janë edhe në fletoren e punës.

- **S** e madhe e shtypit. **S** e madhe e dorës
- **s** e vogël shtypit **s** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se sot do të ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 3 Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **S, s**. Fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4, me bojra uji për shkrimin e shkronjave **S, s**.



Shkronja **S** e madhe e shtypit ka vetëm një hapa, ashtu sikurse edhe shkronja **s** e vogël e shtypit.

Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

Hapi 4. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 70 e më pas 71.

Lexohen fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **S** dhe më pas fjalën SANDALE, të cilën nxënësit e analizojnë dhe e ngjyrosin.

Nxënësi shtrohet i pavarur në ushtrimet e dhëna, pas shpjegimeve përkatëse.

- *Në ushtrimin 1* sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës **S** të madhe të shtypit.
- *Në ushtrimin 2* nxënësi përshkruan figurat dhe plotëson shkronjën e re **S** tek fjala përkatëse. Mësuesja ushtron nxënësin që të ndërtojë fjali me to.
- *Në ushtrimin 3* nxënësi shkruan grafikun e shkronjës **s** të vogël të shtypit.
- *Në ushtrimin e faqës 71* nxënësi lidh rrokjet për të krijuar fjalë e më pas fjalët e dhëna i shkruan tek figurat përkatëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **S, s**.Më pas shkruajnë në fletore fjalët e ushtrimit 2 dhe i analizojnë ato: *sirena, kthesa,spitali, autobuzi, semafori, stadiumi.*

Me njërën prej tyre ata ndërtojnë një fjali të thjeshtë.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **S, s** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjën që mungon.
- ✓ Bashkimin e rrokjeve për të krijuar fjalë.
- ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët kyçe.

✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: 1. Shkruaj 2 rreshta me grafikun e shkronjes **S** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **s**. 2. Analizo fjalët në ushtrimin 1 faqe 71. 3. Ndërto fjali me tri prej tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: **S**hkronja **S** (faqja 55 e Abetares)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Lexon fjalë e fjali që kanë në përbërje shkronjën **S**. ▪ Dallon shkronjën **S** ne tekstin e dhënë. ▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit. ▪ Plotëson fjalorin me fjalë e shprehje. ▪ Kryen analizë të fjalive. ▪ Krijon fjali me fjalë të dhëna. ▪ Shfaq besim e vullnet për të punuar.	**Fjalë kyçe:** shkronja **S, s**, S, s, konkursi, semafori, pikturojmë, ndërtojmë; fjali, fjalë, rrokje, shkronjë. **Teknika dhe strategji:** ❖ Improvizim situate ❖ Pema e mendjes ❖ Lexim i drejtuar, shpjegim ❖ Lexim zinxhir, Analizë ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në grupe ❖ Interpretim i rezultateve
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **S**, tabela plastike, figura, fletë formati, flipchart, skeda, kartona,letra me ngjura, ngjitëse, gërshërë.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake Improvizim situate

Improvizohet një situatë, ku nxënësit luajnë me role kalimin e rrugës sipas sinjaleve të semaforit. Krijohet hapësira e kryqëzimit dhe nëpërmjet abazhurit dhe letrave me ngjyra që i vendosin, improvizohet semafori me tre ngjyrat e tij.

Nxënësit përsëritin rregullat e kalimit të rrugës kur ka semafor. Mësuesja shkruan në tabelë me ngjyra të dukshme tre rregullat kryesore të përdorimit të semaforit.

- ***Mos kalo!***

- *Prit pak!*
- *Nisu tani!*



Veprime në situata

Hapi 1. Pema e mendjes

Semafori fillon me shkronjën **S**. Le të pasurojmë fjalorin me sa më shumë fjalë që kanë në trup shkronjën **S**, në fillim në mes dhe në fund duke krijuar një pemë të mendjes. Analizojmë disa prej tyre

Hapi 2 . Lexim i drejtuar. Shpjegim

Mësuesja paraqet ne flipchart tekstin "KONKURSI" bashkë me ilustrimet përkatëse të cilat përshkruhen nga nxënësit.

Mësuesja lexon pjesën dhe nxënësit ndjekin paralelisht në librin e Abetares në faqen 55.

Gjatë leximit bëhen pyetje rreth tekstit në mënyrë që të kuptohet më mirë përmbajtja.

Nxënësit përgjigjen me fjali të plotë.

- Çfarë ndërtuan fëmijët me karton një ditë më parë?
- Po sot çfarë po bëjnë?
- Pse pjesa titullohet "Konkursi"?
- Çfarë mjetesh na nevojiten për ndërtimin e një semafori?
- Ju jeni pajisur me këto mjete ndaj prezantojini ato.

Nxënësit të përgatitur një orë më parë prezantojnë mjetet që kanë sjellë në klasë.

Hapi 3 Lexim zinxhir.Analizë

Mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë fillimisht etiketat e shkronjës **S** në të katërta format e saj.

Ushtrohen nxënësit të lexojnë zinxhir nga një fjali.

Mësuesja në tekstin e përgatitur dhe nxënësit në libër ndajnë fjalitë e tekstit në etiketa duke bërë një analizë të tyre.

Dje	ndërtuam	me	karton	semaforin.

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala me e gjatë? Po më e shkurtër?

Nxënësit qarkojnë të gjitha shkronjat **S** që ndodhen tek teksti.

- Sa shkronja **S** kemi gjithsej?

Pas leximit nxënësi plotëson ushtrimin rreth tekstit duke vendosur X në alternativën e saktë dhe duke iu përgjigjur pyetjeve me fjali të plotë.

Njihen nxënësit me fjalët pyetëse: *Si?, Pse?, Sa?, Përse?,* dhe kuptimin e tyre.

Hapi 4 Punë e pavarur

Në tekst është dhëna fjala e urtë *"Punën e sotme, mos e lër për nesër".*

- A e dini ju se çfarë janë fjalët e urta?
- Si e kuptojmë fjalën e urtë të dhënë në tekst? (çdo punë ka kohën e vet për të kryer)

Mësuesja udhëzon nxënësit për të punuar ushtrimin në vazhdimësi.

- Në ushtrimin më poshtë nxënësi plotëson fjalitë me fjalët ndihmëse në etiketë. Lexohen ato.

Hapi 5.Punë në grupe.

Me mjetet që nxënësit kanë marrë, siç jepet edhe në tekst, nxënësit punojnë në grupe për ndërtimin e semaforit. Klasa ndahet në tri grupe: *grupi i kuq, grupi portokalli, grupi i gjelbër.*

Puna nis gjatë kësaj ore dhe vazhdojn në orën e ardhshme, ku bëhet edhe konkursi përkatës.

Mësuesja udhëzon nxënësit dhe ndihmon ato hap pas hapi.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit të ndërtojnë fjali me fjalët pyetëse: *Si?, Pse?, Sa?*

Mësuesja kontrollon dhe bën vlerësimet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Leximin e pjesës
- ✓ Dallimin e shkronjës **S** në tekst.
- ✓ Përgjigjet me fjali të thjeshta të pyetjeve rreth tekstit.
- ✓ Analizën e fjalive.
- ✓ Plotësimin e fjalëve e fjalive me shkronja e fjalë që mungojnë
- ✓ Shfaqjen e besimit e vullnetit për të punuar

Detyrë shtëpie:
1. Lexo disa herë faqen.
2. Shkruaj tekstin "KONKURSI" dhe ilustroje me vizatim.
3. Analizo një nga fjalitë e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 71 – 72	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës S, s. ▪ Shkruan rrokje, fjalë e fjali me shkrim dore sipas modelit ▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën S, s, rrokje e fjalë me shkrim dore. ▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore. ▪ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore. ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit	**Fjalë kyçe:** Shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali. **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjimi i vëmendshëm ❖ Lojë ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Demostrim ❖ Punë e pavarur ❖ Shkrim i lirë (Diktim)
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, grafiku i shkronjës **S, s** dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **S**, s etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë formati, bojra uji.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukata fizike, sportet dhe shëndeti, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake. Lojë
Mësuesja organizon lojën për t'u zhvilluar në oborr. Ajo ka realizuar grafikun e shkronjës **S** në oborr me shkumës dhe nxënësit vihen në rresht për një dhe bëjnë vrap të lehtë nën udhëheqjen e mësuesit sipas formës së shkronjës **S, s**. Përsëritet 2-3 herë veprimtaria.
Më pas vrapi i lehtë bëhet tek grafiku i shkronjave të dorës.
Veprimet në situatë
Hapi 1 Punë në grupe

Mësuesja ndan klasën në 4 – 5 grupe. Ajo paraqet foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjën **S**. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato në formë vetëdiktimi në një fletë formati.
Në fund një anëtar nga secili grup del dhe i pasqyron para klasës duke i lexuar ato.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Shpallet grupi fitues.
Mësuesja u prezanton nxënësve që sot do punojnë me shkronjën S, s te dorës dhe fjalët e mësipërme do t'i shkruajnë në fund të orës me shkronja dore.
Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra.
Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në kor dhe rrokjeve e fjalëve me shkrim dore,të krijuara me to.
Hapi 3. Demostrim
Shpjegohet grafiku i shkronjës S, s të dorës duke e shoqëruar me lëvizjen në ajër. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës me anë të një vidioje ilustruese. Bëhet dallimi me shkronjën **S, s** të shtypit me ato të dorës. Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fleta formati me bojra uji për të mësuar dorën me grafikun e shkronjës së dorës S, s. Mësuesja shpjegon gjithashtu lidhjen e shkronjës S, s me shkronja të tjera për të krijuar rrokje e fjalë.
Ngre nxënës në tabelë të shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në fjalë:

- si, sa, su se,....sal, sol, sil.... susta, sirena, Sonila, Semi....

Hapi 4. Punë e pavarur
Nxënësi punon në fletoren e punës sipas modelit.
Fillimisht nxënësi punon ne faqen 71 me grafikun e shkronjës s të vogël të dorës, rrokjeve të krijuara me të. *sa, si,* lidhëzave *as, ose, mos* si edhe fjalëve *sardele, biskota,pastron.*
Më pas nxënësi punon në faqen 72 me grafikun e shkronjës S të madhe të dorës dhe fjalëve: *saranda.Skënderaj, Samina* (Rikujtojmë se emrat e njerësve dhe vendeve shkruhen me shkronje të madhe.)
Në ushtrimin pasardhës mësuesja u kërkon nxënësve që të lexojnë fjalitë e dhëna me shkrim shtypi dhe më pas ti kthejnë ato në shkrim dore.

- Spartaku mëson me Saminën. *Spartaku mëson me Saminën.*

Nxënësit lexojnë fjalët e fjalitë e shkruara me shkrim dore.
Hapi 5. Punë në grupe
Nxënësit do të shkruajnë në grupe fjalët që punuam në pjesën e parë të mësimit me shkronja dore.

- Cili nga grupet i ka shkruar më saktë e më bukur?

Demonstrim i rezultateve të arritura Shkrimi lirë
Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara, fjalë, grupe fjalësh e fjali. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

- so, si, sel, sul, ose, mos, sandale, supa, rosa, Saranda e bukur ka det të kaltër.

Kontrollohen e vlerësohen nxënësit.
Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës S,s.
- ✓ Shkrimin e fjalëve e fjalive sipas modelit.
- ✓ Shkrimin në formë të diktuar të shkronjës S, s, rrokjeve e fjalëve me shkrim dore.
- ✓ Kthimin e shkrimit të shtypit në shkrim dore.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkrim nga 2 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës S, s.

2. Shkrim të 10 fjalëve me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën s. Shoqërimi i disa prej tyre edhe me foto ose vizatime.
3. Krijimi i 2- 3 fjalive me to.
4. Korigjimi i diktimit të bërë në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Përflet ngjarjen kryesore në tekst;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: **S**hkronja **S** (faqja 54 - 55 e Abetares)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Dallon shkronjen **S,s** duke shqiptuar saktë tingullin e saj. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **S, s.** ▪ Përshkruan figurën duke krijuar një tekst të shkurtër. ▪ Lexon tekstin e dhënë dhe diskuton rreth tij. ▪ Bashkëpunon në punën në grup. ▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore		**Fjalë kyçe:** shkronja **S, s**, semafor, konkurs, lexim, analizë, shkrim **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjim i vëmendshëm ❖ Punë individuale ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Pema e mendjes ❖ Lexim zinxhir ❖ Punë e pavarur ❖ Punë në grupe ❖ Interpretimi i rezultateve		
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **S** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **s**, tabela plastike, figura me shenja të qarkullimit, etiketa me rrokje e fjalë, fletë formati, makete, skeda, CD, manjetofon.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** **Dëgjimi i vëmendshëm** Mësuesja vë në sfond këngën *"Semafori"* (ose u reciton atyre vjershën "Semafori flet me sy" të Ymer Elshanit). Nxënësit improvizojnë lëvizje e shprehi gjatë interpretimit të këngës. Diskutojmë rreth tekstit: - Çfarë na tregon kënga?				

- Çfarë mesazhi nxjerrim?

Veprimet në situatë

Hapi 1. Punë individuale

Mësuesja iu shpërndan atyre fleta të përgatitura ku nxënësi ngjyros tri ditat e semaforit dhe ngjit anash fjalët përkatëse që simbolizojnë ngjyrat. Mësuesja udhëzon nxënësin që të shkruajnë fjalën semafori më shkronja shtypi dhe dore.



Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra - Pema e mendjes

Mësuesja u paraqet nxënësve etiketa me shkronjat e mësuara dhe nxënësit i përsërisin ato. Krijojnë rrokje e fjalë. Rikujtojmë shkronjën e re **S, s,** S, s. Secili nxënës shkruan një fjalë që fillon ose e ka në trup shkronën **S** dhe e ngjit në stendën që mësuesja ka përgatitur. Nxënësi mund të shkruajë me shkrim dore ose shtypi

Hapi 3. Punë me tekstin - Leximi zinxhir

Hapet libri i Abetares në faqen 54 – 55. Lexohen etiketat e shkronjave dhe ushtrohen nxënësit për të rikujtuar përshkrimin e figurës.

Ushtrohen nxënësit në leximin e fjalisë kryesore dhe fjalëve të fjalorit. Aktivizohen nxënësit në analizë të tyre.

Mësuesja ndalet tek teksti "KONKURSI".

- Çfarë kishin ndërtuar fëmijët?
- Çfarë i kishte mbetur pa bërë?
- Kur e kanë konkursin?
- Çfarë duan ata?

Atëherë mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë zinxhir pjesën.

Hapi 4. Punë e pavarur

Rikujtojmë ushtrimin e punuar një orë më parë ku nxënësit fjalët e dhëna me shkronja shtypi të mëdha i kanë shkruan me shkronja të vogla shtypi. Tek **S**-ja e krijuar me pazëlla nxënësi gjen pjesën e saktë që mungon dhe e qarkon atë.

Hapi 5. Punë në grupe

Një orë më parë nxënësit kanë nisur të krijojnë një semafor me mjetet e tyre, të ndarë në grupe.

- Ashtu sikurse nxënësit tek pjesa jonë, edhe ne kemi një konkurs. Fillimisht le të përfundojmë punën me ngjyrosjet apo ngjitjet përkatëse.

Pasi nxënësit përfundojnë, një përfaqësues për secilin grup, prezanton punën para klasës. Për të votuar mësuesja zgjedh përfaqësues nga jashtë.

- Cili e fitoi konkursin, grupi i kuq, portokalli apo i gjejbër?

Grupi fitues përcjell një mesazh për përdorimin e semaforit.

Të tria punimet vlerësohen nga mësuesja dhe vendosen në këndin e klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në fletoren e klasës, nxënësi shkruan me shkrim dore fjalitë e ushtrimit në tekst:

- *Dje ndërtuam semaforin.*
- *Sot pikturuam semaforin.*
- *Nesër do të jemi në konkurs.*

Lexohen fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.

Mësuesja vlerëson punën e nxënësve.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjën **S,s** duke shqiptuar saktë tingullin e saj.
- ✓ Pasurimin e fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **S,s.**

✓ Përshkrimin e figurës duke krijuar një tekst të shkurtër. ✓ Leximin e tekstit të dhënë dhe marrjen pjesë në diskutim. ✓ Bashkëpunimin e punës në grup ✓ Kthimin e fjalive nga shkrim shtypi në shkrim dore.
Detyrë shtëpie: 1. Lexo disa herë tekstin e dhënë. 2. Ndërto fjali me fjalët pyetëse: Si?, Sa?, Pse? 3. Përshkruaj semaforin me 3- 4 fjali.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja **H** (faqja 56 e Abetares)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shqipton tingullin **H,h** duke e lidhur me shkronjën **H,h**. ▪ Pasuron fjalorin me fjalë që fillojnë me **H** ose që përmbajnë shkronjën **h** në trup të tyre. ▪ Përshkruan figurën qendrore. ▪ Lidh rrokjet për të krijuar fjalë. ▪ Analizon fjalë e fjali. ▪ Lexon fjalët e fjalitë në tekst.		**Fjalë kyçe:** shkronja **H, h**, hëna, teleskopi, nata,harabeli.lahuta; fjali, fjalë, rokje, shkronja **Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgim në natyrë ❖ Përshkrim. Analizë -sintezë ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Vëzhgim – përshkrim - analizë ❖ Demostrim ❖ Punë individuale ❖ Interpretim i rezultateve		
Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **H** dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **H**, foto ilustruese dhe vizatime të qiellit në mbrëmje, tabela plastike, fletë formati.		**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake .*** Gjëegjëzë Mësimi nis si veprimtari paraprake me një gjëegjëzë: *"Herë e plotë, herë e re, por gjithnjë me dritë je"* ose *" Herë si drapër,herë si bukë, nuk nxen fare, terrin zhduk"* - Cila mendoni se është? (*hëna*) - Nga e kuptuat? ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 1.*** Përshkrim				

Mësuesja ka porositur nxënësit që të sjellin vizatime me temë *"Natë me hënë"*. Nxënësit i paraqesin ato në një stendë të krijuar nga mësuesja dhe i përshkruajnë.

- Si është qielli natën?
- Çfarë shohim me sy të liri?
- Çfarë mjeti mund të na ndihmojë që të shohim më qartë dhe më nga afër?

Hapi 2. Analizë - sintezë

Pas përshkrimit,mësuesja shkruan fjalën HËNA dhe e analizojnë atë.

HËNA			
HË		NA	
H	Ë	N	A

Mësuesja u prezanton nxënësve se do ndalen në mësimin dhe përvetësimin e shkronjës **H**,**h** ashtu si HËNA, HARABELI, HEKURI etj. Nxënësit plotësojnë pemën e mendjen me fjalë që e kanë në përbërje shkronjën **H**, nga tematika e fusha të ndryshme.

Prezantohet shkronja **H, h** me anë të etiketave dhe bëhet kujdes që tingulli i saj të shqiptohet saktë nga ana e nxënësve. **H** – e madhe e shtypit, **h** – e vogël e shtypit



- **H** -ja është zanore apo bashkëtingëllore?

Hapi 3. Rikujtim i njohurive të marra

Përsëritje në kor e shkronjave të mësuara. Dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Nxënësit shkruajnë në A4 disa nga shkronjat e mësuara madje edhe rrokje e fjalë me to.

Hapi 4. Vëzhgim – përshkrim - analizë

Hapet teksti i Abetares në faqen 56 dhe përqëndrohemi tek përshkrimi i figurës qëndrore. Nxiten nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të formojnë fjali ose një tekst të shkurtër.

- Çfarë shohim ne foto?
- Si është qielli?
- Si duhet hëna?
- Çfarë po bën personazhi ynë i veçantë, Ufi?
- A e dini ju si quhet mjeti me të cilin ai po vëzhgon hënën dhe yjet?

Analizojmë fjalia kryesore: 1 2 3 4

Hëna	duket	bukur.

hë- na h-ë

Me anë të etiketave shkruhen rrokjet që krijohen me shkronjën **h**; *he, hë, hu, ha..... hal, hel, ...*

Hapi 5. Demostrim

Pasi lexohet tingulli i shkronjes, mësuesja paraqet para nxënësve modelimin e shkronjës **H,h** të shtypit, fillimisht në ajër, duke përshkruar hapat dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen në fletë formati, me bojra uji për të mësuar grafikun e saj. Modelimi mund të bëhet edhe me mjete te ndryshme si makarona, plasteline, fije etj. Shtohet shkronjën **H** tek grupi i bashkëtingëlloreve. Krjohen rrokje me të.

Hapi 6. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësi qarkon në fjalët e dhëna rrokjet, *ha,he, hu, ho, hë* dhe lexon fjalët e dhëna.

Ushtrimi i dytë: Nxënësi kryen analizë të fjalëve të dhëna duke i ndarë ato në rrokje e shkronja.

harabeli							
ha		ra		be		li	
H	a	r	a	b	e	l	i

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit në fletoret e tyre të ndërtojnë nga një fjali të thjeshtë me emrat që analizuan.

- *harabeli, lahuta.*

Mësuesja bën vlerësimet e nxënësve.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shqiptimin e tingullit **H** duke e lidhur me shkronjën **h**.
- ✓ Pasurimin e fjalorit me fjalë që fillojnë me **H** ose që përmbajnë shkronjën **h** në trup të tyre.
- ✓ Përshkrimin e figurës qendrore.

- ✓ Dallimin e rrokjeve të krijuara me shkronjën **H.**
- ✓ Analizën e fjalëve e fjalive.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive në tekst.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 1 rresht me shkronjën **H, h** dhe rrokjet që krijohen me të.
2. Shkruaj 6-8 fjalë që e kanë në përbërje shkronjën **H,h** dhe kryej analizë të disa prej tyre. Mund ti shoqërosh edhe me vizatime.
3. Ndërto fjali me tri prej tyre.
4. Leximi i faqes.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 73- 74	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Shkruan shkronjës **H, h** të shtypit sipas modelit. ▪ Analizon fjalë e fjali. ▪ Plotëson fjalën me shkronjën që mungon. ▪ Krijon rrokje me shkronjën **H** e me rrokjet fjalë. ▪ Krijon fjali të thjeshta me fjalët kyçe. ▪ Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** shkronja **H,h** e madhe dhe e vogël e shtypit, shkruaj, analizo, sandale, hëlika, harku i hënës, helikopter, hija. **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjim i vëmendshëm ❖ Gjëegjëza , Lojë ❖ Analizë - sintezë ❖ Diskutim i njohurive paraprake, ❖ Veprimtari e udhëhequr ❖ Bashkëbisedim ❖ Punë e pavarur
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, shkronja ilustruese, etiketa me grafikun e shkronjës **H, h**, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **H**, tabela plastike, figura, CD, magnetofon.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja interpreton një vjershë për shkronjën **H**, ose e vendos atë në CD.

H ...si hëna që natën ndriçon,
H ... si helikopteri që lart fluturon,
H... si harta që shumë vende na mëson,
H ... si hekurudha që krahët e saj
I zgjat nëpër fusha.

Paraqiten etiketat e shkronjave **H, h** dhe emërtohen. Pasqyrohen edhe modelet e krijuara një orë më parë me plastelinë, fije apo tela. Rikujtohen shkronjat e mësuara më parë me anë të etiketave.

Veprimtari në situatë

Hapi 1. Analizë – sintezë

helikopteri										
he		li		kop			te		ri	
h	e	l	i	k	o	p	t	e	r	i

Mësuesja shkëput nga vjersha fjalën *helikopteri* dhe kryen analizë –sintezë të saj, në mënyrë që të nxjerrë në pah shkronjën **h.**

Veçohet shkronja **H, h** dhe shqiptohet tingulli i saj.

Nxirren 4 etiketat përkatëse të kësaj shkronje, sikurse janë edhe në fletoren e punës.

- **H** e madhe e shtypit. **H** e madhe e dorës
- **h** e vogël shtypit **h** e vogël e dorës

Mësuesja u prezanton nxënësve se do ndalen në grafikun dhe shkrimin e dy shkronjave të shtypit.

Hapi 2 Veprimtari e udhëhequr

Mësuesja paraqet grafikun e shkronjës **H, h**. Fillimisht në ajër me anë të një përshkrimi dhe më pas në tabelë. Nxënësit ushtrohen fillimisht në fletë A4, me bojra uji për shkrimin e shkronjave **H, h.**



Shkronja **H** e madhe e shtypit bëhet me tri hapa, kurse shkronja **h** e vogël e shtypit me dy hapa.

Ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

Hapi 3. Punë e pavarur.

Nxënësit hapin fletoren e punës në faqen 73 e më pas 74.

Lexohen fillimisht etiketat me katër modelet e shkronjës **H** dhe më pas fjalën HËNA, të cilën nxënësit e kanë analizuar më parë dhe e ngjyrosin.

Nxënësi ushtrohet i pavarur në ushtrimet e dhëna,pas shpjegimeve përkatëse.

- *Në ushtrimin 1* sipas udhëzimeve të marra nxënësi punon grafikun e shkronjës **H** të madhe të shtypit.
- *Në ushtrimin 2* nxënësi përshkruan figurat, plotëson shkronjën e re **H** tek fjala përkatëse. Mësuesja ushtron nxënësin të ndërtojë fjali me to.
- *Në ushtrimin 3* nxënësi shkruan grafikun e shkronjës **h** të vogël të shtypit.
- *Në ushtrimin e faqës 74* nxënësi lidh rrokjet për të krijuar fjalë e më pas fjalët e dhëna i shkruan tek figurat përkatëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrohen nxënësit që të shkruajnë nga një rresht me shkronjën **H, h**. Më pas shkruajnë në fletore fjalët e ushtrimit 2 dhe i analizojnë ato: *helika, hipëm, helikopter, harku, hija.*

Me njërën prej tyre ata ndërtojnë një fjali të thjeshtë.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Shkrimin e shkronjës **H, h** të shtypit sipas modelit.
- ✓ Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- ✓ Plotësimin e fjalëve me shkronjën që mungon.
- ✓ Bashkimin e rrokjeve për të krijuar fjalë.
- ✓ Krijimin e fjalive të thjeshta me fjalët kyçe.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

1. Shkruaj 2 rreshta me grafikun e shkronjes **H** dhe 2 rreshta me grafikun e shkronjës **h**.
2. Analizo fjalët në ushtrimin 1 faqe 74.
3. Ndërto fjali me tri prej tyre.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhë dhe komunikim</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tinguj, shkronja, zanore dhe bashkëtingëllore, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja H (faqja 57 e Abetares)</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Lexon fjalë e fjali që kanë në përbërje shkronjën H.
▪ Dallon shkronjën H ne tekstin e dhënë.
▪ I përgjigjet me fjali të thjeshta pyetjeve rreth tekstit.
▪ Plotëson fjalorin me fjalë e shprehje.
▪ Kryen analizë të fjalive.
▪ Rendit saktë fjalët për të krijuar fjali.
▪ Krijon fjali me fjalët e reja.
▪ Shfaq besim e vullnet për të punuar.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
shkronja H, h, H, h, hëna, natën, dritë, teleskop, astronaut;
fjali, fjalë, rrokje, shkronjë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Dëgjim i vëmendshëm
❖ Përshkrim
❖ Pema e mendjes
❖ Lexim i drejtuar, shpjegim
❖ Lexim zinxhir, Analizë
❖ Punë e pavarur
❖ Interpretim i rezultateve</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën H, tabela plastike, figura, fletë formati, flipchart, skeda, vidioprojektor.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Shoqëria dhe mjedisi, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake Dëgjim i vëmendshëm
Mësuesja pasqyron nëpërmjet një videoprojektori përrallën “Pse hëna nuk ka fustan”. Në pamundësi ajo ia lexon nxënësve përrallën. Diskutojnë rreth saj.
- Çfarë kërkonte hëna të bënte?
- Pse sa herë shkonte për provë tek rrobaqepësi asaj nuk i bënte fustani?
- Në të vërtetë pse hëna nuk ka fustan?
Dëgjohen mendimet e nxënësve dhe diskutojmë së bashku.
Veprime në situata
Hapi 1 Përshkrim
Mësuesja, për ta lidhur edhe me përrallën e hyrjes së mësimit, paraqet para klasës një foto që tregon fazat e hënës dhe diskutojnë së bashku.
- Nëpërmjet kësaj foto shpjegohet më së miri se përse hëna nuk ka fustan dhe përse ajo shfaq githmonë forma të ndryshme.
Mësuesja shpjegon nëpërmjet një fjalori të thjeshtë, të kuptueshëm për nxënësit fazat e hënës.
Hapi 2. Pema e mendjes
</td></tr>
</table>

- Hëna fillon me shkronjën **H**. Le të pasurojmë fjalorin me sa më shumë fjalë që kanë në trup shkronjën **H**, duke krijuar një pemë të mendjes. Analizojmë disa prej tyre

Hapi 3 . Lexim i drejtuar. Shpjegim
Mësuesja paraqet ne flipchart tekstin "HËNA" bashkë me ilustrimet përkatëse të cilat përshkruhen.
Mësuesja lexon pjesën dhe nxënësit ndjekin paralelisht në librin e Abetares në faqen 57.
Gjatë leximit bëhen pyetje rreth tekstit në mënyrë që të kuptohet më mirë përmbajtja.
Mësohen nxënësit të përgjigjen me fjali të plotë.

H, h

- Kur duket hëna më mirë?
- A ka hëna dritë?
- Cili ia jep asaj dritën?
- Me çfarë duket hëna bukur?
- Si quhen njerëzit që kanë mbërritur në hënë dhe e kanë eksploruar atë?

Mësuesja ilustron me foto *teleskopin* dhe *astronautët* si fjalë të reja dhe mbase të panjohura për nxënësit dhe i përshkruan ato duke dhënë edhe shpjegimin përkatës.
Hapi 4 Lexim zinxhir.Analizë
Mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë fillimisht etiketat e shkronjës **H** në të katërta format e saj.
Ushtrohen nxënësit të lexojnë zinxhir nga një fjali.
Mësuesja në tekstin e përgatitur dhe nxënësit në libër analizojnë fjalitë e tekstit.

Hëna	duket	më	mirë	natën.

- Sa fjalë ka fjalia?
- Cila është fjala me e gjatë? Po më e shkurtër?

Nxënësit qarkojnë të gjitha shkronjat **H** që ndodhen tek teksti.

- Sa shkronja **H** kemi gjithsej?

Pas leximit nxënësit plotësojnë ushtrimin rreth tekstit duke vendosur X në alternativën e saktë dhe duke iu përgjigjur pyetjeve me fjali të plotë. Ushtrohen nxënësit në leximin e fjalorit tek *"Shtëpia e fjalëve"*.
Hapi 5 Punë e pavarur
Mësuesja udhëzon nxënësin për të punuar ushtrimet në vazhdimësi, pas shpjegimeve përkatëse.

- *Ushtrimi 1*. Nxënësi shton rrokjen *hem*, në fund të fjalëve të dhëna dhe i lexon ato.
- *Ushtrimi 2*. Janë dhënë etiketa me fjalë të ngatërruara. Nxënësi i rendit për të krijuar fjali të plotë.
- *Ushtrimi 3*. Nxënësi bashkon rrokjet për të krijuar fjalë.

Më pas nxënësi njihet me disa pasthirrma, që ne shpesh përdorim dhe kanë në trup shkronjën *h*.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura
Ushtrohen nxënësit të krijojnë fjali me fjalët që tregojnë pasthirrma. P.sh

- *Ah, harrova kuletën!*
- *Eh, u kujtova për librrin!*
- *Oh, sa kohë e bukur!*

Mësuesja u mëson nxënësve se në fund të këtyre fjalive vendoset pikëçuditëse.(!)
Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Leximin e pjesës.
- ✓ Dallimin e shkronjës **H** në tekst.
- ✓ Përgjigjet me fjali të thjeshta të pyetjeve rreth tekstit.
- ✓ Analizën e fjalive.
- ✓ Renditjen e saktë të fjalëve për të krijuar fjali.
- ✓ Krijimin e fjalive me fjalët e reja.

✓ Shfaqjen e besimit e vullnetit për të punuar
Detyrë shtëpie: 1. Lexo disa herë faqen. 2. Shkruaj tekstin "HËNA" dhe ilustroje me vizatim. 3. Analizo një nga fjalitë e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 74 – 75		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: ▪ Modelon grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës H, h. ▪ Shkruan rrokje, fjalë e fjali me shkrim dore sipas modelit. ▪ Shkruan në formë të diktuar shkronjën H, h, rrokje e fjalë me shkrim dore. ▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore. ▪ Lexon fjalë e fjali me shkrim dore. ▪ Shfaq besim e vullnet gjatë procesit të të shkruarit		**Fjalë kyçe:** shkronjat e dorës, rrokje, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjimi i vëmendshëm ❖ Lojë ❖ Rikujtim i njohurive të marra ❖ Demostrim ❖ Punë e pavarur ❖ Shkrim i lirë (Diktim)		
Burimet e informacionit dhe mjete: fletorja e punës, grafiku i shkronjës **H, h** dhe shkronjave të mësuara të dorës, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **H**, h etiketa me rrokje e fjalë me shkrim dore, tabela plastike, fletë formati, bojra uji.		**Lidhja me fushat e tjera:** Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake.*** Dëgjim i vëmendshëm. (ose loje "Hapa - hollapa) Si veprimtari paraprake mësuesja mund të përdorë një nga veprimtaritë e mëposhtme: 1. Dëgjimi i këngës *"Hëna dhe dielli"*. Nxënësit argëtohen, shoqërojnë atë me lëvizje e shprehi dhe në fund shkruajnë tri fjalë që i ka mbetur në mendje nga kënga. 2. Dalin në oborrin e shkollës dhe të organizohet për 10 minuta me nxënësit loja "Hapa –dollapa". Në fund përsëri ato shkruajnë tri fjalë që i ka mbetur në mendje nga loja. ***Veprimet në situatë*** ***Hapi 1*** Punë në grupe Mësuesja ndan klasën në 4 – 5 grupe. Ajo paraqet foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjën **H**. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato në formë vetëdiktimi në një fletë formati.				

Në fund një anëtar nga secili grup del dhe i pasqyron para klasës duke i lexuar ato.

- Cili nga grupet ka shkruar më shumë fjalë të sakta?

Shpallet grupi fitues.

Mësuesja u prezanton nxënësve se do punojnë me shkronjën H, h të dorës dhe fjalët e mësipërme do t'i shkruajnë në fund të orës me shkronja dore.

Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra.

Përsëritje e shkronjave të dorës të mësuara deri më tani. Lexim i tyre në kor. Leximi edhe i rrokjeve e fjalëve që krijohen me to, me shkrim dore.

Hapi 3. Demostrim

Shpjegohet grafiku i shkronjës H, h të dorës duke e shoqëruar me lëvizjen në ajër. Shpjegohen elementet përbërës të saj. Nëse ka mundësi mund të ndiqet një grafik i shkronjës me anë të një vidioje ilustruese. Bëhet dallimi me shkronjën **H, h** të shtypit me ato të dorës. Gjithashtu nxënësit ushtrohen edhe në fleta formati me bojra uji për të mësuar dorën me grafikun e shkronjës së dorës H, h. Mësuesja shpjegon gjithashtu lidhjen e shkronjës H, h me shkronja të tjera për të krijuar rrokje e fjalë.

Ngre nxënës në tabelë të shkruajnë shkronjën dhe lidhjen e saj me shkronjat e tjera në rrokje e fjalë:

- ha, hi, hu, hum, ham, hem, her, har, harku, hëna, helika, Hana ...

Hapi 4. Punë e pavarur

Nxënësi punon në fletoren e punës sipas modelit.

Fillimisht nxënësi punon ne faqen 74 me grafikun e shkronjës h të vogël të dorës, rrokjeve të krijuara me të. *ha, hi, he, hë, ho* , si edhe fjalëve *leh, kreh, nuhat, lehtë, lahuta, hatabeli, hunda.*

Më pas nxënësi punon në faqen 75 me grafikun e shkronjës H të madhe të dorës dhe fjalëve: *Himara, Hana* (Rikujtojmë se emrat e njerësve dhe vendeve shkruhen me shkronje të madhe.)

Në ushtrimin pasardhës mësuesja u kërkon nxënësve që të lexojnë fjalitë e dhëna me shkrim shtypi dhe më pas ti kthejnë ato në shkrim dore.

- Henri hipi në helikopter. *Hënri hipi në helikopter.*

Nxënësit lexojnë fjalët e fjalitë e shkruara me shkrim dore.

Hapi 5. Punë në grupe

Nxënësit do të shkruajnë në grupe fjalët që punuam në pjesën e parë të mësimit me shkronja dore.

- Cili nga grupet i ka shkruar më saktë e më bukur?

Demonstrim i rezultateve të arritura Shkrimi lirë

Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, shkronja të tjera të mësuara, rrokje të krijuara, fjalë, grupe fjalësh e fjali. Kjo varion nga niveli i nxënësve.

- ha, he, hi, hu, krah, krëhër, hekuros, Hektori kapi harkun. Hera pa hënën. ...

Kontrollohen e vlerësohen nxënësit.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Modelimin e grafikut të shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës H,h.
- ✓ Shkrimin e fjalëve e fjalive sipas modelit.
- ✓ Shkrimin në formë të diktuar shkronjën H, h, rrokje e fjalë me shkrim dore.
- ✓ Kthimin e shkrimit të shtypit në shkrim dore.
- ✓ Leximin e fjalëve e fjalive me shkrim shtypi e dore.
- ✓ Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit

Detyrë shtëpie:

1. Shkrim nga 2 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës H, h.
2. Shkrim të 10 fjalëve me shkronja dore, të cilat kanë në përbërje shkronjën h. Shoqërimi i disa prej tyre edhe me foto ose vizatime.
3. Krijimi i 2- 3 fjalive me to.
4. Korigjimi i diktimit të bërë në klasë.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja H (faqe 56 - 57 e Abetares)</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
▪ Dallon shkronjen H, h duke shqiptuar saktë tingullin e saj.
▪ Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën H, h.
▪ Krijon me imagjinatë.
▪ Përshkruan figurën duke krijuar një tekst të shkurtër.
▪ Përvetëson leximin e tekstit.
▪ Kthen fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
shkronja H, h, hëna, astronaut, teleskop, lexim, analizë, shkrim</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Dëgjim i vëmendshëm
❖ Punë individuale
❖ Rikujtim i njohurive të marra
❖ Pema e mendjes
❖ Lexim zinxhir
❖ Punë e pavarur
❖ Punë në grupe
❖ Interpretimi i rezultateve</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës H dhe shkronjave të mësuara të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën h, tabela plastike, figura me pamje të hapësirës, etiketa me rrokje e fjalë, fletë formati, makete, skeda.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake Imagjinatë e drejtuar
Mësuesja pasqyron para klasës figura e foto që tregojnë hapësirë, hënën, yjet, qiellin, planetet dhe udhëzon nxënësit të imagjinojnë një udhëtim në hënë.
- Pasi jeni njohur me mësimin dhe këto pamje, mbyllni sytë dhe imagjinoni sikur keni veshur rrobet e një astronauti. Tashmë jeni gati. Nisuni.....
- Ashtu me sy mbyllur kush më thotë se ku ndodhet dhe çfarë po sheh?
- A ka mbërritur ndonjëri në hënë apo jeni në hapësirë?
Nxënësi shpreh atë që ndjen dhe imagjinon.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Punë individuale
Mësuesja iu shpërndan nxënësve skeda të përgatitura me foto nga hapësira. Nxënësit ngjyrosin dhe shkruajnë fjalë që lidhen me to, psh. hapësira, hëna, planetet, astronauti.
Hapi 2. Rikujtim i njohurive të marra. Pema e mendjes
Mësuesja u paraqet nxënësve etiketa me shkronjat e mësuara dhe nxënësit i përsërisin ato. Krijojnë rrokje e fjalë. Rikujtojmë shkronjën e re H, h, H, h. Secili nxënës shkruan një fjalë që fillon ose e ka në</td></tr>
</table>

trup shkronën **H** dhe e ngjit në stendën që mësuesja ka përgatitur. Nxënësit mund të shkruajnë me shkrim dore ose shtypi

Hapi 3. Punë me tekstin. Leximi zinxhir

Hapet libri i Abetares në faqen 56 – 57. Lexohen etiketat e shkronjave dhe ushtrohen nxënësit për të rikujtuar përshkrimin e figurës.

Ushtrohen nxënësit në leximin e fjalisë kryesore dhe fjalëve të fjalorit. Rikujtojmë analizën e fjalëve.

Mësuesja ndalet tek teksti "HËNA".

- Kur duket hëna më mirë?
- Cili ia jep asaj dritën?
- Si quhet ai që udhëton në hapësirë?

Atëherë mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë zinxhir pjesën dhe ta ritregojnë atë më fjalët e tyre.

Hapi 4. Punë e pavarur

Më fjalët që nxënësit krijuan një orë më parë mësuesja ia ndan grupeve që ti analizojnë dhe të ndërtojnë fjali me gojë.

- *G1. lahem, kujtohem G2. krihem, drejtohem, G3. pastrohem, mësohem*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në fletoren e klasës, nxënësit shkruajnë me shkrim dore fjalitë e ushtrimit në tekst:

- *Drini pa hënën në teleskop.*
- *Hëna mëson me Erën.*
- *Ah, sa det të bukur ka Himara.*

Lexojnë fjalitë me shkrim dore nga fletorja e tyre.

Mësuesja vlerëson punën e nxënësve.

Vlerësohen nxënësit për:

- ✓ Dallimin e shkronjën **H,h** duke shqiptuar saktë tingullin e saj
- ✓ Pasurimin e fjalorin me fjalë e shprehje që kanë në trup shkronjën **H,h.**
- ✓ Krijimin me imagjinatë.
- ✓ Përshkrimin e figurës duke krijuar një tekst shkurtër
- ✓ Leximin e tekstit të dhënë dhe marrjen pjesë në diskutim.
- ✓ Kthimin e fjalive nga shkrim shtypi në shkrim dore

Detyrë shtëpie:

1. Lexo disa herë tekstin e dhënë.
2. Ndërto fjali me fjalët që tregojnë pasthirrma: *Ah.., Oh.., Eh...*
3. Përshkruaj me 3- 4 fjali vizitën në hënë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		

<table>
<tr><td>Njësia mësimore:
Përsëritje 3, faqe 58 në Abetare</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingujt: P, B, T, D, S, H.
• Identifikon shkronjat e mësuara në fjalë të ndryshme (në pozicione të ndryshme).
• Gjen fjalë që në trup të tyre kanë shkronjat P, B, T, D, S, H, në pozicione të ndryshme.
• Ndan fjalët në rrokje dhe shkronja.
• Bashkimin e shkronjave për të formuar rrokje.</td><td>Fjalë kyçe:
Pula, balena, topi, deti, supa, hoteli</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Vëzhgim- analizë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, etiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake

Nxënësit ndahen në dy grupe.
Njërit grup i shpërndahen etiketat me shkronjat e shtypit; P, p, B, b, T, t, D, d, S, s, H, h, kurse grupit tjetër shkronjat e dorës: P, p, B, b, T, t, D, d , S, s, H, h.
Lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave të shtypit dhe të dorës.
Përsëritet loja për të aktivizuar sa më shumë nxënës të klasës.

Veprimet në situatë
Hapi 1.Diskutim për njohuritë paraprake
-Nxënësit nxiten të gjejnë fjalë me shkronjat e mësuara.
Shembull: P- Pinoku.
U drejtohen pyetjet:
- Me cilën shkronjë fillon kjo fjalë ?
- Sa rrokje ka fjala Pinoku?
- Sa shkronja ka kjo fjalë ?
Vazhdohet edhe me fjalë tjera të cilat i gjejnë nxënës të ndryshëm.

Hapi 2.Vëzhgim - Analizë
Hapet libri në faqen 58 të Abetares dhe nxënësit nxiten të shqiptojnë tingujt e shkronjave të mësuara që ndodhen në krye të faqes. Dallojnë tingujt bashkëtingëllorë: P, B, T, D, S, H.
Ushtrimi i parë: Udhëzohen të bashkojnë shkronjat nga kolona dhe rreshti për të formuar rrokje.

Ushtrimi i dytë: Udhëzohen që në fjalët e secilit rresht të tabelës të qarkojnë shkronjën përkatëse.</td></tr>
</table>

Hapi 3.Punë individuale

Ushtrimi i tretë: Janë dhënë disa fjalë të shkruara në etiketa. Bashkohet rrokja e fundit e fjalës paraardhëse me rrokjen e parë të fjalës pasardhëse dhe formohet një fjalë e re e cila shkruhet në etiketën përkatëse.

Ushtrimi i katërt:
Nxënësit udhëzohen që të ngjyrosin të gjitha shkronjat që kanë mësuar deri tani.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:
Nxiten të gjejnë fjalë me shkronjat e mësuara dhe t'i shkruajnë saktë ato në fletore.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingujve: **P, B, T, D, S, H.**
- Identifikimin e shkronjave të mësuara në fjalë të ndryshme (në pozicione të ndryshme).
- Gjetjen e fjalëve që në trup të tyre kanë shkronjat **P, B, T, D, S, H** në pozicione të ndryshme.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje dhe shkronja.
- Bashkimin e shkronjave për të formuar rrokje.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani në fletore emra njerëzish, kafshësh e sendesh që fillojnë me shkronjat. Shembull :

	Njerëz	Kafshë	Sende
P			
B			
T			
D			
S			
H			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		

<table>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore:
Përsëritje 3, faqe 76 e Fletore punës</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingujt P, B, T, D, S, H.
• Gjen fjalë me shkronjat P, B, T, D, S, H.
• Shenjëzon rrokjet e tepërta në fjalët përkatëse.
• Plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë.
• Shkruan me shkronja të dorës fjalët e gjetura.</td><td>Fjalë kyçe:
Patate, balena, traktori, dentisti, sapuni, hekuri.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Copëza të përziera
❖ Vëzhgo-analizo
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, etiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara, etiketa me fjalë.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake
Lojë - Ecim me rrokje
Nxënësit ndahen në gjashtë grupe (sipas shkronjave të mësuara). Çdo grupi u shpërndahen fletët e bardha ku shkruajnë nga dy fjalë me shkronjën përkatëse.
Ja disa shembuj:
Grupi 1: Shkronja P - patate, pula;
Grupi 2: Shkronja B- balona, balerina;
Grupi 3: Shkronja T- topi, timoni;
Grupi 4: Shkronja D- dera, drita;
Grupi 5: Shkronja S- semafori, sapuni;
Grupi 6: Shkronja H- hëna, hoteli.
Më pas, nga çdo grup dalin nga dy nxënës, paraqesin fjalët e gjetura dhe i ndajnë në rrokje, ku për çdo rrokje e bëjnë nga një hap duke ecur. Për çdo fjalë tregojnë numrin e rrokjeve të gjetura.
Përsëritet veprimtaria duke përfshirë sa më shumë nxënës.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Copëza të përziera
Nxënësve në dyshe u shpërndahen etiketa me fjalë të ngatërruara. Udhëzohen t’i renditin ato për të formuar fjali me kuptim. Lexojnë fjalitë e formuara.</td></tr>
</table>

Hapi 2. Vëzhgo-Analizo

Hapet Fletore pune në faqen 76 dhe nxënësit nxiten të shqiptojnë tingujt e shkronjave të mësuara që ndodhen në krye të faqes. Rikujtojnë se të gjithë tingujt janë bashkëtingëllorë.

Ushtrimi i parë:

Janë dhënë katër figura dhe poshtë janë shkruar emrat e tyre me nga një rrokje që mungon. Nxënësit plotësojnë fjalët duke u ndihmuar nga disa rrokje qe ndodhen anash. Lexojnë fjalët e plotësuara.

Ushtrimi i dytë: Janë dhënë grupe me nga katër rrokje për të formuar fjalë. Por në secilin grup rrokjesh, një rrokje është tepër. Nxënësit duhet të gjejnë rrokjen e tepërt, ta shënojnë me ***x*** dhe të shkruajnë fjalën e duhur në vendin përkatës. Lexojnë fjalët e formuara.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i tretë:

Nxënësit udhëzohen të gjejnë rrugën e figuave të paraqitura deri te emrat e tyre. Shkruajnë emrat në vendet përkatëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë në fletore nga një fjali me secilin emër nga ushtrimi i tretë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingujve **P, B, T, D, S, H.**
- Gjetjen e fjalëve me shkronjat **P, B, T, D, S, H.**
- Gjetjen e rrokjeve të tepërta në fjalët përkatëse.
- Plotësimin e fjalëve me rrokjet që mungojnë.
- Shkrimin me shkronja dore të fjalëve të gjetura.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Fjalitë e shkruara në klasë i shkruajnë me shkronja dore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;		

<table>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore:
Përsëritje 3, faqe 59 në Abetare</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton saktë tingujt bashkëtingëllorë.
• Shkruan emrat përkatës afër secilës.
• Gjen fjalitë që iu përshtaten figurave dhe në katrorin para tyre shkruan numrin.
• Lexon me zë njërën nga fjalitë</td><td>Fjalë kyçe:
Pata, banka, dora, torta, supa, harta</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Stuhi mendimesh
❖ Vëzhgo -emërto-shkruaj
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, tiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë,Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake
Nxënësit ndahen në dy grupe të barabarta dhe qëndrojnë të ulur në karrige të renditur njëri pas tjetrit. Mësuesi-ja qëndron para tyre dhe i thërret dy të fundit të vijnë tek ai-ajo. Që të dyve u tregon në vesh një shkronjë të ndryshme dhe ata duhet të shënojnë me gisht shkronjën në shpinën e shokut /shoqes. Kështu vazhdohet deri sa shkronja të arrijë deri te personi i parë i cili duhet ta shënojë në letër, ndërsa mësuesi/ja kontrollon se a është shkronja e cila është treguar në fillim. Nëse po atëherë loja vazhdon me shkronja të tjera derisa të kryhen gjashtë shkronjat që po përsëriten.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Stuhi mendimesh
Ngriten nxënës të ndryshëm në tabelë për të shkruar të gjitha shkronjat e mësuara der tani. Shkruajnë shkronjat e shtypit dhe të dorës, të mëdha e të vogla.
Formohen rrokje dhe më pas fjalë të ndryshme, që kanë shkronjat në trup të tyre, në fillim, në mes dhe në fund.
.

Hapi 2. Vëzhgo-emërto-shkruaj
Hapet libri në faqen59 të Abetares. Përsëritet edhe njëherë shqiptimi i tingujve bashkëtingëllor që ndodhen në krye të faqes
Ushtrimi i katërt: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurat e paraqitura. Emërtojnë ato dhe shkruajnë emrat e tyre në vendet përkatëse.

Hapi 3. Punë individuale</td></tr>
</table>

Ushtrimi i pestë: Janë dhënë gjashtë figura që paraqesin një ngjarje në vazhdimësi. Secila figurë ka numrin përkatës. Nxënësit individualisht gjejnë fjalitë që iu përshtaten figurave dhe në katrorin para tyre vendosin numrat përkatës të figurave. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Nxënësit ndahen 1- 6 dhe secili lexon nga një fjali nga ushtrimi i pestë. Vazhdojnë grupet derisa të lexojnë të gjithë. **Vlerësohen nxënësit për:** • Shqiptimin e saktë të tingujve bashkëtingëllorë. • Shkrimin e emrave përkatës të figurave të paraqitura. • Gjetjen e fjalive që iu përshtaten figurave. • Leximin e saktë të njërës nga fjalitë.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani në fletore me shkronja dore fjalitë e ushtrimit të pestë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja Sh, fq. 60		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **Sh.** • Identifikon shkronjën **Sh**. • Gjen fjalë që e përmbajnë tingullin **Sh** në pozicione të ndryshme. • Përshkruan figurën qendrore. • Qarkon rrokjet e caktuara në fjalët e dhëna. • Plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë.		**Fjalë kyçe:** shqiponja, shtëpia, shkronjat **Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale		

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Sh** të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **Sh**.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për qytetari demokratike

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Përsëriten shkronjat e mësuara. Nxënësit i shkruajnë në tabelë duke i ndarë në zanore dhe bashkëtingëllore.

Veprimet në situatë

Hapi 1 .Vëzhgo-Analizo

Paraqitetnjë foto e shqiponjës dhe nxiten nxënësit të komentojnë rreth saj:

-Çfarë shikoni?

-Çfarë dini për shqiponjën?

-Me se ushqehet ajo?

-Ta shqiptojmë së bashku fjalën.

Shkruhet fjala SHQIPONJA në tabelë dhe nxiten ta lexojnë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **Sh**.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: SHQI-PO-NJA.

-Pra, fjala SHQIPONJA ka tri rrokje. Ku ndodhet shkronja Sh? (në fillim)

Përsëritet veprimtaria edhe për fjalën SHTËPIA.

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 60 të Abetares dhe nxiten nxënësit të shqiptojnë tingullin e shkronjës **Sh** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë?

-Cilat shkronja po i shihni?

-A janë zanore apo bashkëtingëllore?

Lexohen ankesat e shkronjave.

-Çfarë mendoni, a kanë të drejtë shkronjat që ankohen? A bëni edhe ju gabime kur i shkruani?

-Lexohet vjersha e dhënë. U drejtohen pyetjet:

-Cilat fjalë e kanë në fillim shkronjën Sh? (Shkruhen fjalët në tabelë).

-Cilat fjalë e kanë në fund shkronjën Sh? (Shkruhen fjalët në tabelë).

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të qarkojnë shkronjën Sh në vjershë.

Ushtrimi i dytë: Qarkojnë rrokjet sha, she, shi, shu, sho në fjalët e dhëna.

Ushtrimi i tretë: Plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën Sh në fillim, në mes apo në fund.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Sh.**
- Identifikimin e shkronjës **Sh.**
- Gjetjen e fjalëve të tjera që përmbajnë tingullin **Sh** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Qarkimin e rrokjeve të caktuara në fjalë.
- Plotësimin e fjalëve me rrokjet që mungojnë.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin **Sh**.

Shkruani emrat e tyre poshtë figurave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5;	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Fletore pune faqe 79-80	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **Sh, sh** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **Sh, sh** në fjalët e dhëna. • Lidh figurat me fjalët përkatëse. • Bashkon rrokjet për të formuar fjalë. • Lexon fjalët e formuara.	**Fjalë kyçe:** Shporta, shqiponja, peshorja **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale

• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i shkronjës **Sh, sh**.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit ndahen në grupe. Kërkohet të gjejnë sa më shumë fjalë që kanë tingullin Sh në fillim, në mes apo në fund. Grupi që gjen më shumë fjalë shpallet fitues.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet fjala **SHPORTA** në tabelë dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

-Për çfarë shërben shporta?

-Me cilën shkronjë fillon kjo fjalë?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **Sh, sh** e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Sh**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e formimit të saj nga dy shkronjat S dhe h. Pra, S + h = Sh.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **sh** të vogël.

Ngriten disa nxënës dhe e shkruajnë në tabelë shkronjën e madhe dhe të vogël **Sh, sh.**

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 78. Nxënësit vëzhgojnë për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin shqiponjën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Nxënësit në mënyrë të pavarur nxënësit do të shkruajnë shkronjën Sh. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit lexojnë fjalët dhe i lidhin me figurat përkatëse.

Ushtrimi i tretë: Lidhin rrokjet dhe shkruajnë fjalën e formuar.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë shkronjë sh sipas modelit të dhënë.

Ushtrimi i pestë: Bashkojnë rrokjet dhe lexojnë fjalët e formuara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë nga dy rreshta me shkronjën **Sh, sh.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Sh, sh** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Sh, sh** në fjalët e dhëna.
- Lidhjen e figurave me fjalët përkatëse.
- Bashkimin e rrokjeve për të formuar fjalë.
- Leximin e fjalëve të formuara.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën **Sh, sh**.

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën **Sh, sh.**

Shkruani dy fjali me fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën **Sh, sh.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5;		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja Sh, fq. 61		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurën që ilustron tekstin. • Parashikon ngjarjen në bazë të termave të dhënë. • Lexon tekstin qartë dhe saktë. • Shenjëzon përgjigjet e sakta • Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.	**Fjalë kyçe** Cicërimat, trumcaku, ngrica, grimca **Teknika dhe strategji:** ❖ Parashikimi me anë të titullit ❖ Lexim me ndalesa ❖ Lexim në role ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Sh** të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, magnetofon, Cd.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Dëgjohet kënga e shkronjës Sh.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Parashikim me anë të titullit

Paraqitet titulli i tekstit në tabelë. Nxënësve u drejtohet pyetja;

-Çfarë mendoni, përse bëhet fjalë në këtë tekst?

Hapi 2. Lexim me ndalesa

Teksti u lexohet në dy ndalesa. Kështillohen nxënësit të dëgjojnë me vëmendje sepse do të përgjigjen në pyetjet e bëra.

Ndalesa e parë: Shkronjat....vijat e mia.

U drejtohen pyetjet:

-Çfarë po bëjnë shkronjat?

-Çfarë kërkonte shkronja A?

-Përse ankohet shkronja O?

-Po shkronja E, çfarë ankese kishte?

Ndalesa e dytë: Mua më.... ashtu si duhet.

U drejtohen pyetjet:

-Pse u ankua shkronja Ë?

-Po shkronja I, çfarë tha?

-Çfarë dëshire kishin shkronja U dhe Y?

-Çfarë mësuat nga ankesat e shkronjave?

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit lexojnë fjalët dhe i lidhin ato për të formuar fjali. Lexojnë fjalitë e formuara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Formojnë fjali me fjalët: *shkronjë, shtëpi, peshk.*

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e fjalëve në bazë të titullit.
- Saktësinë e përgjigjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- Leximin e bukur dhe pa gabime.
- Lidhjen e fjalëve për të formuar fjali.
- Nxjerrjen e mesazhit të tekstit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:
Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.
Mësoni përmbajtjen e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5;		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqja 79 - 80		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi:		**Fjalë kyçe:**		

• Shkruan shkronjën ***Sh, sh*** të dorës sipas modelit. • Shkruan rrokje e fjalë me shkrim dore. • Shkruan me të diktuar **Sh, sh, *Sh, sh,*** rrokje, fjalë e fjali. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit. .	Shkronja ***Sh, sh*** e madhe dhe e vogël e dorës **Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë me fjalë ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Sh, sh, *Sh, sh*** të shtypit dhe të dorës.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit udhëzohen të gjejnë fjalë me shkronjën Sh në trup të tyre. Njëri nxënës thotë fjalën, kurse tjetri e ndan atë në rrokje. Shembuj fjalësh: shtëpia, peshku, shporta, shota, shkrimtari, Shpresa.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Analizë dhe sintezë

Përsëritet shkronja Sh, sh e shtypit.

Prezantohet grafiku i shkronjës ***Sh*** të madhe të dorës.

Analizohen elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës, duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria me shkronjën ***sh*** të vogël të dorës.

Hapi 2 .Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 79 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën ***sh***, rrokjet dhe fjalët mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i dytë: Në faqen 80, shkruajnë shkronjën ***Sh*** të madhe dhe fjalinë e dhënë. U rikujtohet se emrat e njerëzve dhe qyteteve shkruhen me shkronjë të madhe.

fjali. Lexojnë fjalitë e krijuara dhe i shkruajnë ato me shkronja dore. Bazohen te figurat e paraqitura.

Ushtrimi i tretë: Nxënësit lexojnë fjalitë dhe i shkruajnë ato me shkronja të dorës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: **Ushtrimi i katërt:** Shkruajnë me të diktuar shkronjat Sh, sh, ***Sh, sh***, rrokje, fjalë e fjali. .**Vlerësohen nxënësit për:** • Shkrimin e shkronjës ***Sh, sh*** të dorës sipas modelit. • Shkrimin e rrokjeve e fjalëve me shkrim dore. • Shkrimin me të diktuar të shkronjave Sh, sh, ***Sh, sh***, rrokjeve fjalëve e fjalive. • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga dy rreshta me shkronjën ***Sh, sh*** të dorës. Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën ***Sh, sh.*** Shkruani dy fjali me fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën ***Sh, sh.***

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia, përrallëza, përralla, tregime, gjëegjëzë, fjalë të urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Përflet ngjarjen kryesore në tekst;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja Sh, faqe 60-61		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon fjalët dhe fjalitë e dhëna. • Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë. • Lidh përmbajtjen e tekstit me përvoja personale. .		**Fjalë kyçe:** Shkronjat **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti, etiketa me fjalë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Paraqiten në tabelë etiketa me fjalë ku shkronjat janë ngatërruar ose nuk janë shkruar si duhet. Nxiten nxënësit t'i lexojnë dhe të vërejnë gabimet. Më pas ngriten nxënës dhe i shkruajnë ato si duhet në tabelë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Diskutohet me nxënësit rreth ankesave të shkronjave. Nxiten të tregojnë edhe për gabime të tjera që mund të bëjnë nxënësit gjatë shkrimit. Së bashku me mësuesen formulohen dhe shkruhen në tabelë edhe ankesa të tjera të shkronjave.

Hapi 2. Lexim zinxhir

Hapen librat e Abetares dhe secili nxënës lexon nga dy fjali të tekstit.

Nxiten të lexojnë pa gabime dhe duke respektuar shenjat e pikësimit.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit lexojnë fjalët dhe i lidhin ato për të formuar fjali.

Lexohen emrat e qyteteve dhe vihet theksi te shkrimi i tyre me shkronjë të madhe.

Ushtrimi i dytë: Lexojnë fjalitë dhe duke vëzhguar figurat, plotësojnë fjalën që mungon

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Tregojnë përmbajtjen e tekstit me disa fjali duke u ndihmuar me pyetje.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e saktë të fjalëve e fjalive.
- Plotësimin e fjalive me fjalët që mungojnë.
- Lidhjen e përmbajtjes me përvoja personale.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Kopjoni bukur katër fjali të tekstit.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tinguj, shkronja, zanore dhe bashkëtingëllore, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja F, faqe 62</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin F.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që përmbajnë tingullin F në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Bashkon rrokjet për të formuar fjalë.
• Lidh pjesët e fjalisë sipas modelit për të krijuar fjali me kuptim.
• Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
Flamuri, fëmijët, ferma.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgim/Analizë dhe sintezë
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës F të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën F.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake
Paraqiten para nxënësve figura të ndryshme, emri i të cilave fillon me shkronjën F.
Shembull: flamuri, flaka, fiku, festa, fëmijët. Udhëzohen nxënësit në grupe të formojnë nga një fjali për to.

Veprimet në situatë
Hapi 1 .Vëzhgim /Analizë dhe sintezë</td></tr>
</table>

Paraqitet një foto e fëmijëve që mbajnë në duar flamurin e Shqipërisë dhe atë të Kosovës. Nxiten nxënësit të komentojnë rreth saj.

- Kë po shihni?
- Çfarë kanë në duar fëmijët?
- Si ndihen ata?

U shpjegohet se çfarë simbolizojnë flamujt e dy shteteve tona.

Shkruhet në tabelë fjala FLAMURI dhe lexohet nga nxënësit.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës F.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? FLA-MU-RI
- Pra, fjala FLAMURI ka tri rrokje. Ku ndodhet shkronja F?

Hapi 2.Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri i Abetares në faqen 62 dhe nxiten nxënësittë shqiptojnë tingullin e shkronjës F që ndodhet në krye të faqes.Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten nxënësit të përshkruajnë figurën qendrore me detaje. Ndihmohen me pyetjet:

- Çfarë shihni në figurë?
- Ku kanë shkuar fëmijët?
- Çfarë po bëjnë ata?

U shpjegohet kuptimi i fjalës *fermë.*

Shkruhet në tabelë fjalia "Fëmijët shkuan në fermë" dhe lexohet nga nxënësit.

Bëhet analiza fjali-fjalë-rrokje-tingull. U drejtohen pyetjet:

- Sa fjalë ka kjo fjali? –Cila është fjala e parë? –Po e dyta? Vazhdohet kështu me radhë.
- Fjala ***Fëmijët*** sa rrokje ka? Pra, fjala ***Fë-mi-jët*** ka tri rrokje. Ku gjendet shkronja **F**? (në fillim)

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të bashkojnë rrokjet për të formuar fjalë. Lexojnë me radhë fjalët e formuara.

Ushtrimi i dytë: Lidhin rrokjet dhe shkruajnë fjalët sipas modelit të dhënë.

Ushtrimi i tretë: Lexojnë fjalët e dhëna dhe i lidhin ato për të formuar fjali. Orientohen duke u bazuar në shembullin e dhënë.

Ushtrimi i katërt: Fillimisht u shpjegohet nxënësve kuptimi i fjalëve *prashit, krasit, vjel.* Më pas nxënësit duke përdorur fjalët ndihmëse plotësojnë fjalitë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Lexojnë fjalitë e formuara në ushtrimin e katërt. Tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën F në fillim, në mes apo në fund.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **F.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **F** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Bashkimine rrokjeve për të formuar fjalë.
- Lidhjen e fjalëve për të formuar fjali me kuptim.
- Plotësimin e fjalive me fjalët që mungojnë.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin F.

Shkruani emrat e tyre poshtë figurave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 81-82	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **F, f** të shtypit sipas modelit. • Lidh fjalët me figurat përkatëse. • Bashkon rrokjet për të formuar fjalë. • Lexon fjalët e formuara. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Flutura, fëmijët, foleja, trëndafili **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë dhe sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **F, f** të shtypit, etiketa me shkronja, rrokje	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës

e fjalë që përmbajnë shkronjën **F, f** në pozicione të ndryshme, magnetofon, Cd.	**Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë këngën për shkronjën F nga you tube.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet fjala FLUTURA në tabelë dhe nxiten nxënësit të t'u përgjigjen pyetjeve:

- Cila fjalë është shkruar në tabelë?
- Çfarë dini për fluturën?
- A ju pëlqejnë fluturat? Pse?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **F, f** e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **F**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Krahasohet me shkronjat tjera, duke vënë në pah ngjashmërinë dhe dallimet me shkronjën E.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **f** të vogël të shtypit.

Hapi 3. Punë individuale

Pasi ngjyrosin fluturën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Shkruajnë shkronjën ***F*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i dytë: Udhëzohen nxënësit të lexojnë fjalët dhe të lidhin ato me figurat përkatëse.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë shkronjën ***f*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Duke u bazuar në shembullin e dhënë, lidhin rrokjet me shigjetë dhe shkruajnë fjalët.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i pestë: Duke vëzhguar figurat, bashkojnë rrokjet dhe krijojnë fjalë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **F, f** të shtypit sipas modelit.

• Lidhjen e fjalëve me figurat përkatëse. • Bashkimin e rrokjeve për të formuar fjalë. • Leximin e saktë të fjalëve të formuara. • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga dy rreshta me shkronjën **F, f.** Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **F, f**. Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **F, f.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja F, faqe 63		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurën që ilustron tekstin. • Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit. • Shenjëzon përgjigjet e sakta duke u bazuar te përmbajtja e tekstit.		**Fjalë kyçe** Ferma, fëmijët, kafshët **Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimesh ❖ Lexim me ndalesa ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës F të shtypit, të madhe e të vogël, etiketa.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake***				

Nxiten nxënësit që kanë shkronjën F në emrin e tyre të shkruajnë emrin në etiketat e vendosura në tabelë. Më pas qarkojnë shkronjën F dhe tregojnë nëse ajo ndodhet në fillim, në mes apo në fund.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Stuhi mendimesh

Hapet libri i Abetares në faqen 63 dhe nxiten nxënësit të përshkruajnë figurën qendrore me detaje. Emërtojnë secilën kafshë, pemën, traktorin, natyrën.

Hapi 2. Lexim me ndalesa

Teksti ndahet në dy pjesë të cilat lexohen me ndalesa. U drejtohen pyetje për të analizuar dhe parashikuar ngjarjen.

Pjesa e parë: *Ditën e hënë.....panë.*

- Ku shkuan Drini, Ufi e Jona?
- Kë takuan atje?
- Për çfarë u foli fermeri?
- Çfarë mendoni se u pëlqeu fëmijëve më shumë në fermë? Pse?

Pjesa e dytë: nga *Sa bukur.....në fermë..*

- Çfarë po thonin fëmijët?
- Si po ndiheshin ata? Pse?
- A do të donit edhe ju të vizitonit një fermë?

Kërkohet nga nxënësit të imitojnë zërat e kafshëve.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shenjëzojnë përgjigjet e sakta duke u bazuar te përmbajtja e tekstit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë tri fjali nga teksti me të cilat përpiqen të përmbledhin ngjarjen. Ndihmohen nga mësuesi/ja.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Përgjigjet e sakta në pyetjet lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Shenjëzimin e përgjigjeve të sakta.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime. Mësoni përmbajtjen e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 82-83	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën F, f të dorës sipas modelit. • Shkruan mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore. • Shkruan fjalitë e dhëna me shkronja dore. • Shkruan me të diktuar **F, f,** F, f, rrokje, fjalë e fjali. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Fieri, Flutura, Fatjoni, Flora **Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë fjalësh ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale
• **Burimet e informacionit dhe mjete:** Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **F, f , F, f**, të shtypit dhe të dorës.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësve u thuhen fjalë që kanë në trup të tyre shkronjën F ose jo. Sa herë përmendet një fjalë që përmban shkronjën F, nxënësit ngriten në këmbë, kurse ulen kur fjala e thënë nga mësuesi/ja nuk përmban shkronjën F.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Analizë dhe sintezë

Përsëritet shkronja **F, f** e shtypit.

Prezantohet grafiku i shkronjës F.

Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Krahasohet me shkronjë **F** të shtypit.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën f.

Hapi 2. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 82 dhe udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë shkronjën f, duke shkruar mbi vija të ndërprera. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë mbi vija shkronjën F duke parë modelin e dhënë. U rikujtohet se emrat e njerëzve dhe të qyteteve fillojnë me shkronjë të madhe.

Ushtrimi i tretë: Nxënësit lexojnë fjalitë dhe i shkruajnë ato me shkronja dore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar **F, f** , F, f, rrokje, fjalë e fjali .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës F, f të dorës sipas modelit.
- Shkrimin mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.
- Shkrimin e fjalive të dhëna me shkronja dore.
- Shkrimin me të diktuar të F, f rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Shkruani nga dy rreshta me shkronjën F, f.
Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën F, f.
Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën F, f.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja F, fq.62-63</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin saktë dhe bukur.
• Tregon përmbajtjen e tekstit.
• Gjen fjalë që kanë shkronjën F në trupin e tyre dhe klasifikon ato.
• Punon albumin me figura të kafshëve.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Fermë, fëmijët, kafshët</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Mendo-thuaj-shkruaj
❖ Lexim zinxhir
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti,etiketa me fjali, fletë A4 me ushtrimin e përgatitur.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Në tabelë krijohen tri kolona në të cilat do të vendosen veç e veç etiketa ku do të shkruhen emra njerëzish, kafshësh e sendesh. Në etiketa është caktuar vendndodhja e shkronjës F dhe numri i shkronjave të fjalës. Nxënësit gjejnë fjalët që kërkohen. Ai që e gjen del dhe e shkruan.
<table><tr><td>Njerëz</td><td>Kafshë</td><td>Sende</td></tr><tr><td>F_ _ _ _</td><td>_ _f_ _</td><td>_ _ _ _f_ _</td></tr></table>
Shembull: Fjona, kafshë, telefon

Veprimet në situatë
Hapi 1. Lexim zinxhir</td></tr>
</table>

Hapen librat e Abetares në fq.63 dhe u tregohet nxënësve se do të lexojnë secili nga dy fjali të tekstit. Nxiten të lexojnë saktë dhe bukur, duke respektuar shenjat e pikësimit. Pasi të lexojnë të gjithë, 2-3 nxënës do të thonë përmbajtjen.

Hapi 2. Punë individuale

Punohet ushtrimi i fundit fq. 63. Nxënësit janë udhëzuar orën e kaluar të sjellin figura të kafshëve të ndryshme. Në grupe do t'i ngjesin ato duke formuar albumin me figura të kafshëve.

Punimet vendosen në këndin e klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Formojnë fjali me fjalët *floku, fruta.* Lexojnë fjalitë e shkruara.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e tekstit saktë dhe bukur.
- Tregimin e përmbajtjes së tekstit.
- Gjetjen e emrave që në trupin e tyre kanë shkronjën F.
- Punimin e albumit me figura të kafshëve.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruaj me shkrim dore tekstin " Në fermë".

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Vlerësim përmbledhës 2		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit orës mësimore: Nxënësi:		**Fjalë kyçe:** bleta, dhelpra, çelës, dhëmbi, Ylli, Yllka		

• Lexon kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme. • Lidh rrokjet për të formuar fjalë. • Shkruan fjalën poshtë figurës. • Ndanë fjalët në rrokje. • Qarkon fjalët e shkruara saktë. • Përgjigjet pyetjeve me fjali të plota.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim rreth njohurive paraprake ❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: njohuritë paraprake të nxënësve, fletë testimesh të përgatitura, shkronjat kolektive.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Hapi 1. Njihen nxënësit me temën dhe u rikujtohet se çfarë është Testi, cili është qëllimi dhe rëndësia e tij.
U shpjegohen rregullat e sjelljes gjatë detyrës me shkrim dhe punës individuale.
Bëhet përsëritje e shkronjave të mësuara.

Veprimet në situatë

Hapi 2 . Vëzhgo-Analizo
Ndahet klasa në dy grupe, grupi A dhe grupi B.
U shpërndahen fletët e ushtrimeve të fotokopjuara më parë.
U ipen sqarime të qarta për çdo ushtrim.
Nxënësit nxiten të lexojnë kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të pavarur.
Kështillohen ngadalë dhe saktë çdo etapë të ushtrimit duke i udhëzuar nxënësit.

Hapi 3. Punë individuale

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur detyrat e paraqitura.
Gjatë gjithë kohës vëzhgohen dhe u ofrohet ndihma e nevojshme sidomos atyre që shfaqin vështirësi.
Lexojnë kërkesat e ushtrimeve dhe udhëzohen të plotësojnë ato ushtrime që i dinë kurse ato që nuk i kuptojnë u kthehen prapë pasi t'i përfundojnë ato që iu duken më të lehta.
Nxënësit duhet të shkruajnë me shkronjat e shtypit ose të dorës, sipas dëshirës me përjashtim të ushtrimit 2, i cili duhet të plotësohet me shkrim dore.

Megjithatë është mirë që nxënësit të ushtrohen më shumë në punën me shkrim dore.

Ushtrimi i parë: Lidhin rrokjet dhe shkruajnë fjalët.

Grupi A **Grupi B**

bleta, flamuri, sheshi bora, festa, shtëpia

Ushtrimi i dytë: Ndajnë fjalët në rrokje.

Grupi A **Grupi B**

çe-lës, shko-lla, ha-ra-be-li qe-ni, she-shi, qu-ka-pi-ku

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë fjalët me shkronja dore.

Grupi A: dhelpra, rrushi, çanta **Grupi B:** kapuçi, ylberi, gjirafa

Ushtrimi i katërt: Qarkojnë fjalën e shkruar saktë.

Ushtrimi i pestë: Ndajnë fjalët me hapësirën e duhur dhe shkruajnë fjalinë saktë.

Grupi A **Grupi B**

Dhëmbët duhet pastruar. Pastroni dhëmbët rregullisht.

Ushtrimi i gjashtë: Shkruajnë numrin e fjalëve në fjali**.**

Ushtrimi i shtatë: Plotësojnë fjalitë me fjalët e duhura.

Grupi A **Grupi B**

Java ka shtatë ditë. Viti ka 12 muaj.

Vera vjen pas pranverës. Pranvera vjen pas dimrit.

Ushtrimi i tetë: Renditin fjalët dhe formojnë fjalinë.

Grupi A **Grupi B**

Fermeri korr grurin. Bujku lëvron arën.

Ushtrimi i nëntë: Qarkojnë rrokjet **va, ve** në fjalët e dhëna.

Ushtrimi i dhjetë: Përgjigjen pyetjeve me fjali të plota.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mblidhen fletët, nxiten nxënësit të diskutojnë për vështirësitë dhe problemet që kanë pasur. Mbahen shënime që të përmirësohen më tej.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e kërkesave të ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme.
- Lidhjen e rrokjeve për të formuar fjalë.

- Shkrimin e saktë të fjalës poshtë figurës.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- Qarkimin e fjalëve të shkruara saktë.
- Përgjigjet e pyetjeve me fjali të plota.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Shkruani nga një rresht me shkronjat e mësuara.

	Vlerësim i njohurive 2 **Lënda: Gjuhë shqipe** **EMRI:** _____ **KLASA:**_____	**Grupi: A**
1.	Lidh rrokjet për të formuar fjalë. ble shi fla ta she muri	3 pikë
2.	Ndaj fjalën në rrokje. çelës shkolla harabeli	4 pikë
3.	Shkruaj fjalët me shkronja dore.    _____ _____ _____	6 pikë
4.	Qarko fjalën e shkruar saktë: çilimi ruga dhëmbi qilimi rruga llëmbi	6 pikë
5.	Ndaj fjalët dhe shkruaj fjalinë saktë: Dhëmbëtduhetpastruar. _____	6 pikë

6.	Shkruaj me numër sa fjalë kanë fjalitë. Yllka përgatit kek. ____ Prishtina është qytet i bukur. ____	5 pikë
7.	Plotëso fjalitë me fjalët e duhura. Java ka _____ (shtatë ditë, pesë ditë) Vera vjen pas_____ (dimrit, pranverës)	5 pikë
8.	Rendit fjalët për të formuar fjali. grurin korr Fermeri _____	3 pikë
9.	Qarko rrokjen **va** në fjalët e mëposhtme: varësja vera varka	2 pikë
10.	Përgjigju pyetjeve me fjali të plota: Si quhet mësuesja jote? _____ Ku jeton? _____	5 pikë

Shkallët e vlerësimit	**Arritje e pakënaqshme**	**Arritje minimale**	**Arritje mesatare**	**Arritje e kënaqshme**	**Arritje e plotë**
Vlerësimi sipas pikëve	O-11	12-22	23-33	34-39	40-45
Mësusesi/ja i/ e klasës:					
Nënshkrimi i prindit:					

	Vlerësim i njohurive 2 **Lënda: Gjuhë shqipe** **EMRI:** _____ **KLASA:**_____	**Grupi: B**
1.	Lidh rrokjet për të formuar fjalë. bo ta fes ra shtë pia	3 pikë
2.	Ndaj fjalët në rrokje. 	4 pikë
3.	Shkruaj fjalët me shkronja dore.    _____ _____ _____	6 pikë
4.	Qarko fjalën e shkruar saktë: çershia llamba dhoma qershia llampa lloma	6 pikë
5.	Ndaj fjalët dhe shkruaj fjalinë saktë: Pastronidhëmbëtrregullisht. _____	6 pikë
6.	Shkruaj me numër sa fjalë kanë fjalitë: Ylli përgatit biskota. ____ Tirana është qytet i bukur. ___	5 pikë

7.	Plotëso fjalitë me fjalët e duhura. Viti ka_____ (12 muaj, 8 muaj) Pranvera vjen pas_____ (dimrit, verës)	5 pikë
8.	Rendit fjalët për të formuar fjali: arën lëvron Bujku _____	3 pikë
9.	Qarko rrokjen **ve** në fjalët e mëposhtme: veza varka vendi	2 pikë
10.	Përgjigju pyetjeve me fjali të plota: Si quhet mësuesja jote? _____ Ku jeton? _____	5 pikë

Shkallët e vlerësimit	**Arritje e pakënaqshme**	**Arritje minimale**	**Arritje mesatare**	**Arritje e kënaqshme**	**Arritje e plotë**
Vlerësimi sipas pikëve	O-11	12-22	23-33	34-39	40-45
Mësusesi/ja i/ e klasës:					
Nënshkrimi i prindit:					

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja V, faqe 64</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin V.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin V në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Qarkon rrokjet e përcaktuara në fjalët e dhëna.
• Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Violina, viti, pranvera, vera, vjeshta, dimri, muajt e vitit</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-analizo
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës V të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën V, magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit dëgjojnë këngën për shkronjën V nga you tube.

Veprimet në situatë
Hapi 1 . Vëzhgo-analizo
Para nxënësve paraqitet një foto e violinës. Nxiten nxënësit të komentojnë rreth saj.
- Çfarë po shihni?
- Për çfarë shërben violina?
- A ju pëlqejnë tingujt e violinës?</td></tr>
</table>

- Ta shqiptojmë së bashku fjalën.

Shkruhet fjala VIOLINA në tabelë dhe lexohet nga nxënësit.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës V.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? VI-O-LI-NA

Pra fjala VIOLINA ka katër rrokje. – Ku ndodhet shkronja V? (në fillim)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje -përgjigje

Hapet libri i Abetares në faqen 64 dhe nxiten nxënësit të shqiptojnë tingullin **V** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje. Ndihmohen me pyetjet:

- Çfarë shikoni në figurë?
- Cilat janë stinët e vitit?
- Si dallohen stinët nga njëra-tjetra?
- Në cilën stinë jemi tani?
- Sa muaj ka viti?

Lexohen muajt e vitit dhe duke u ndihmuar nga figura tregojnë se cilët muaj i takojnë secilës stinë.

Shkruhet në tabelë fjalia " Sot po mësojmë për vitin" dhe lexohet nga nxënësit.

Bëhet analiza fjali-fjalë-rrokje-tingull.

-Sa fjalë ka fjalia? -Cila është fjala e parë? –Po e dyta?...e kështu me radhë.

-Fjala ***viti*** sa rrokje ka? – Pra, ***vi-ti*** ka dy rrokje. -Ku ndodhet shkronja **v**? (në fillim)

Udhëzohen nxënësit të shkruajnë numrat sipas radhës së muajve të vitit.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të qarkojnë rrokjet: *va, ve, vi, vu* te fjalët e dhëna. Lexojnë me radhë fjalët. Sqarohet kuptimi i tyre nëse ka nevojë.

Ushtrimi i dytë: Lexojnë fjalitë dhe i plotësojnë me fjalët që mungojnë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i tretë: Plotësojnë fjalët në fjali duke u bazuar në fjalinë e shkruar më lart.

Tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën **V** në fillim, në mes apo në fund.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **V.**

• Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që përmbajnë tingullin **V** në pozicione të ndryshme. • Përshkrimin e figurës qendrore. • Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Qarkimin e rrokjeve të përcaktuara në fjalët e dhëna. • Plotësimin e fjalive me fjalët që mungojnë.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin **V**. Shkruani emrat e tyre poshtë figurave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 84, 85	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **V, v** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **V, v** në fjalët e dhëna.. • Lidh fjalët me figurat përkatëse. • Bashkon rrokjet për të formuar fjalë me kuptim. • Lexon rrjedhshëm fjalët e formuara. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Veza, vija, vendi **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë dhe sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **V, v** plastelinë, etiketa me shkronja, rrokje e fjalë që përmbajnë shkronjën **V, v** në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Organizimi i orës së mësimit	

Veprimtari paraprake

Mësuesi-ja ka përgatitur disa etiketa që përmbajnë fjalë të cilat në trupin e tyre kanë shkronjën V. Një nxënës lexon çfarë ka në etiketën e parë dhe mundohet që përmes gjesteve t'iu tregojë të tjerëve se për çfarë bëhet fjalë. Loja vazhdon me nxënës të tjerë derisa të zbulohen të gjitha fjalët.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet në tabelë fjala VEZA dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve :

- Cila fjalë është shkruar në tabelë?
- Si duket veza?
- A ju pëlqejnë vezët?
- Me cilën shkronjë fillon kjo fjalë?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **V, v** e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **V**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **v** të vogël të shtypit.

Hapi 3. Punë individuale

Pasi ngjyrosin vezën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Shkruajnë shkronjën ***V*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i dytë: Lexojnë fjalët dhe i lidhin ato me figurat përkatëse.

Ushtrimi i tretë: Lidhin rrokjet në tabelën e dhënë dhe shkruajnë fjalët e formuara.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë shkronjën ***v*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i pestë: Bashkojnë rrokjet dhe krijojnë fjalë duke u ndihmuar nga figurat e dhëna. Lexojnë fjalët e formuara.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **V, v** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **V, v** në fjalët e dhëna.

• Lidhjen e fjalëve me figurat përkatëse. • Bashkimin e rrokjeve për të formuar fjalë me kuptim. • Leximin e rrjedhshëm të fjalëve. • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani dy rreshta me shkronjën **V, v.** Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **V, v**. Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **V, v**.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja V, faqe 65		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurën që ilustron tekstin. • Përgjigjet në pyetjet e parashtruara. • Lexon tekstin saktë dhe bukur. • Formon fjalë me shkronjat e para të figurave të dhëna.		**Fjalë kyçe:** Kalendar, stinë, muaj, javë, ditë. **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhënie pyetje-përgjigje ❖ Lexim i drejtuar ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës V të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, kalendari i vitit.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake***				

Nxiten nxënësit të mendojnë një fjalë që në trup përmban shkronjën V. Një nxënës e përshkruan atë pa e treguar emrin, të tjerët duhet të gjejnë fjalën. Çdo fjalë shkruhet në tabelë dhe lexohet nga nxënësit. Tregohet se në çfarë pozicioni gjendet shkronja V.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Paraqitet para nxënësve një kalendar i vitit dhe nxiten nxënësit të komentojnë rreth tij.

U drejtohen pyetjet:

- Çfarë po shihni?
- Për çfarë përdoret kalendari?
- Sa muaj ka viti? Cilët janë ata?
- Sa ditë ka java? Cilat janë?
- Çfarë dite është sot?

Hapi 2. Lexim i drejtuar

Teksti lexohet me intonacion nga mësuesi/ja. Më pas nxënësit lexojnë në heshtje duke nënvizuar fjalët që nuk i kuptojnë. Më pas, bëhet sqarimi i tyre dhe disa nxënës lexojnë tekstin me intonacion.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i dytë: Nxënësit formojnë fjalë me shkronjat e para të secilës figurë të dhënë, duke shkruar emrat e katër stinëve të vitit.

Ushtrimi i tretë: Udhëzohen të lidhin fjalët sipas modelit të dhënë. Sipas nevojës ndihmohen nga mësuesi/ja.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë fjali me fjalët: *pranvera, vera, vjeshta, dimri.*

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Përgjigjet e sakta në pyetjet e parashtruara.
- Leximin e saktë dhe të bukur.
- Formimin e fjalëve me shkronjat e para të figurave të dhëna.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:
Mëso përmendësh ditët e javës, muajt dhe stinët e vitit.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 85, 86</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën V, v të dorës sipas modelit.
• Shkruan mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore
• Shkruan me të diktuar V, v, V, v rrokje e fjalë.
• Shkruan fjali me shkronja dore.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Viti, pranvera, vera, vjeshta, dimri, shkronja V, v e madhe dhe e vogël e dorës.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Mendo-vizato-shkruaj
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">• Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës V, v, V, v të shtypit dhe të dorës, fletë të përgatitura për stinët e vitit.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësve u shpërndahen fletë të përgatitura, të cilat ata duhet t’i plotësojnë duke vizatuar stinët e vitit apo duke shkruar muajt e vitit sipas stinëve. Punimet ekspozohen në këndin e klasës.
<table><tr><td>Pranvera</td><td>Vera</td></tr><tr><td>Vjeshta</td><td>Dimri</td></tr></table></td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1. Analizë dhe sintezë

Përsëritet shkronja **V, v** e shtypit.

Prezantohet grafiku i shkronjës V.

Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Krahasohet me shkronjën V të shtypit.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën v.

Hapi 2. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 85 dhe udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë shkronjë v duke shkruar mbi vija të ndërprera. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë mbi vija shkronjën V dhe emrat sipas modelit të dhënë. U rikujtohet se emrat e njerëzve fillojnë me shkronjë të madhe.

Ushtrimi i tretë: Në ushtrimin e tretë nxënësit shkruajnë me shkronja dore fjalitë e dhëna. Lexojnë fjalitë e formuara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë me të diktuar **V, v**, V, v, rrokje, fjalë e fjali .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës V, v të dorës sipas modelit.
- Shkrimin mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.
- Shkrimin me të diktuar të **V, v,** V, v, rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- Shkrimin e fjalive me shkronja dore.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Shkruani nga dy rreshta me shkronjën V, v.
Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën V, v.
Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën V, v.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Përflet ngjarjen kryesore në tekst;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja V, fq. 64-65</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin saktë dhe bukur.
• Formon rrokje, fjalë e fjali që përmbajnë shkronjën V.
• Rendit ditët e javës, muajt dhe stinët e vitit sipas radhës.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe
Viti, pranvera, vera, vjeshta, dimri, ditët e javës, muajt e vitit.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Lexim zinxhir
❖ Punë individuale
❖ Lojë me fjalë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti, etiketa me ditët e javës, stinët dhe muajt e vitit.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit ndahen në treshe. Njëri thotë një rrokje që përmban shkronjën V, tjetri gjen dhe thotë një fjalë që e përmban atë rrokje ndërsa i treti krijon një fjali me atë fjalë. Përsëritet veprimtaria me sa më shumë nxënës.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Lexim zinxhir
Hapen librat e Abetares në fq.65 dhe u tregohet nxënësve se do të lexojnë secili nga dy fjali prej tekstit. Nxiten të lexojnë saktë dhe bukur, duke respektuar shenjat e pikësimit.
Pasi të lexojnë të gjithë, disa nxënës do të thonë përmendësh ditët e javës, muajt dhe stinët e vitit.</td></tr>
</table>

Hapi 2. Punë individuale

Punohet ushtrimi i parë në faqen 65. U shpërndahen nxënësve në grupe etiketa me emra të ditëve të javës, muajve dhe stinëve të vitit. Udhëzohen t'i renditin ato sipas radhës, e më pas i prezantojnë para klasës.

Hapi 3. Lojë me fjalë

Nxënësit me etiketat e muajve në duar duhet të renditen sipas radhës. Pas renditjes së drejtë, lexojnë e zë të lartë etiketat që kanë në duar. Përsëritet veprimtaria edhe me stinët e vitit dhe ditët e javës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë në fletore emrat e ditëve të javës, muajve dhe stinëve të vitit.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e tekstit saktë dhe bukur.
- Formimin e rrokjeve, fjalëve e fjalive që përmbajnë shkronjën V.
- Renditjen e saktë të ditëve të javës, muajve e stinëve të vitit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani me shkrim dore tekstin "Kalendari i vitit".

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tinguj, shkronja, zanore dhe bashkëtingëllore, rrokje, fjalë e fjali të ndryshme;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Shkronja Dh, fq. 66	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **Dh.** • Identifikon shkronjën **Dh**. • Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **Dh** në pozicione të ndryshme. • Përshkruan figurën qendrore.	**Fjalë kyçe:** dhëmbët, dhurata, dhelpra, dhjeta **Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale

• Ndan fjalët e dhëna në rrokje. • Lidh fjalët për të formuar fjali me kuptim.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Dh** të shtypit, foto me figura, fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **Dh**.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Paraqitet para nxënësve një gjëegjëzë që si përgjigje ka fjalën dhëmbët.

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo

Paraqitet një foto e dhëmbëve dhe nxiten nxënësit të bëjnë komente rreth tyre:

- Çfarë shikoni?
- Çfarë dini për dhëmbët? Ku janë të vendosur ata?
- Si duken dhëmbët?

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 66 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës Dh që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar objektin që shohin- pastën e dhëmbëve. Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë?

-Për çfarë përdoret?

Shkruhet në tabelë fjalia "Ne kujdesemi për dhëmbët" dhe lexohet nga nxënësit. Bëhet analiza fjali-fjalë-rrokje-tingull, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Dh. U drejtohen pyetjet:

-Sa fjalë ka kjo fjali? -Cila është fjala e parë? –Po e dyta? Vazhdohet kështu e radhë.

-Fjala ***dhëmbët*** sa rrokje ka? – Pra, fjala ***dhëm-bët*** ka dy rrokje Ku gjendet shkronja ***dh*****?** (në fillim)

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Pasi të shikojnë figurat e secilit shembull dhe shkronjat e shpërndara**,** nxënësit plotësojnë katrorët e zbrazët duke formuar fjalët përkatëse.

Ushtrimi i dytë: Fjalët e paraqitura me figurë dhe me shkronja nxënësit i ndajnë në rrokje. Rrokjet i shkruajnë poshtë fjalëve në katrorët e zbrazët.

Ushtrimi i tretë: Nxiten nxënësit të lexojnë fjalët e para në të tri kolonat.

- Nëse lidhen këto tri fjalë a ka ndonjë kuptim?

Nxiten të lexojnë në heshtje fjalët e kolonave dhe të lidhin ato sipas modelit. Tre nxënës lexojnë para klasës fjalitë e krijuara.

Ushtrimi i katërt:

- Cili veprim kryhet kur përdoret shenja + ?
- Si quhen numrat që mblidhen?

Me përgjigjen e dhënë plotësojnë fjalën e nisur.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën Dh.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Dh.**
- Identifikimin e shkronjës **Dh.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **Dh** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Ndarjen e fjalëve të dhëna në rrokje.
- Lidhjen e fjalëve për të formuar fjali me kuptim.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u jepet detyra e fundit.
Pasi të plotësojnë fjalinë në libër, e shkruajnë atë tri herë në fletore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Fletore pune faqe 87-88		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **Dh ,dh** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **Dh, dh** në fjalët e dhëna. • Plotëson rrokjet me shkronjën **Dh, dh.** • Lidh rrokjet e dhëna dhe shkruan fjalën e formuar.	**Fjalë kyçe:** Dhëmbi, dhurata, dhjeta, dhia **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **Dh, dh**, magnetofon, Cd, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **Dh, dh** në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Dëgjohet kënga e shkronjës Dh.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet fjala DHËMBI në tabelë dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

-Si duket një dhëmb i shëndoshë?

-Si prishen dhëmbët?

-Cilat ushqime dëmtojnë dhëmbët tanë?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja Dh e shtypit, e madhe dhe e vogël .

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Dh**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Nxënësit e kanë më të lehtë pasi Dh përbëhet nga dy shkronja të mësuara më parë. Pra **D + h = Dh.**

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **dh** të vogël.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 87 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pastaj udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Sqarohet kuptimi i simbolit të detyrës së parë dhe në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë shkronjat **Dh, dh**. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit ndjekin figurat emri i të cilave fillon me **Dh.**

Ushtrimi i tretë: Plotësojnë rrokjet duke shkruar shkronjë **Dh** apo zanoren që mungon.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë shkronjën **dh** në katrorët e zbrazët sipas modelit.

Ushtrimi i pestë: Lidhin me shigjetë rrokjet nga tri kolonat e dhëna për të formuar fjalë me kuptim, të cilën e shkruajnë në kolonën e fundit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë nga një rresht me shronjën Dh,dh.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Dh, dh** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Dh, dh** në fjalët e dhëna.
- Plotësimin e rrokjeve me shkronjën **Dh, dh.**
- Lidhjen e rrokjeve të dhëna për formimin e fjalëve.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën **Dh, dh** të shtypit.

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën **Dh, dh**.

Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën **Dh, dh.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja Dh, fq. 67		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
Dallon titullin në pjesën e dhënë.
Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
Lexon tekstin saktë dhe bukur.
Përgjigjet në pyetjet që lidhen me përmbajtjen e tekstit. .
Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar..
Përgjigjet në pyetjet nga përvoja personale.
Shënon porositë që ndjek me </td><td>Fjalë kyçe:
Dhëmbi i parë, dhembja, kujdesi, pasta

Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-Analizo
❖ Lexim në dyshe
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Dh të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, etiketa me emrat e nxënësve, mjete shkrimi, ngjyra.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Shëndeti</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxiten nxënësit që e kanë shkronjën Dh në emrin e tyre të shkruajnë emrin në etiketat e vendosura në tabelë. Më pas qarkojnë shkronjën Dh dhe tregojnë nëse ndodhet në fillim, në mes apo në fund.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje- përgjigje
Hapet libri në faqen 67 të Abetares dhe nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje. Ndihmohen me pyetjet:
-Çfarë po shihni në figurë?
- Për çfarë përdoret pasta e dhëmbëve?
- Ku duhet të vendoset ajo?
-Çfarë shije ka pasta e dhëmbëve?
- Çfarë ngjyre ka pasta e dhëmbëve në këtë figurë?

Hapi 2. Lexim në dyshe</td></tr>
</table>

Së pari diskutohet rreth titullit të tekstit. Pastaj iu tregohet nxënësve se ky tekst është një bisedë në mes të dy personave: babait dhe djalit. Nxënësit ndahen në dyshe, ku njëri do të lexojë fjalët e babait e tjetri të djalit. Dyshet e nxënësve lexojnë me radhë.

Pas leximit duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara tregojnë përvojat e tyre personale për daljen e dhëmbit të parë, dhembjet e dhëmbit dhe veprimeve që bëjnë në ato raste.

Hapi 3. Punë individuale

Individualisht lexojnë në heshtje porositë që janë dhënë dhe shënojnë me ✓ ato porosi që ata ndjekin në përditshmëri.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion të duhur. Nxjerrin mesazhin nga teksti i lexuar.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Dallimin e titullit në pjesën e dhënë.
- Leximin e tekstit saktë dhe bukur.
- Përgjigjet në pyetjet që lidhen me përmbajtjen e tekstit. .
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti i mësuar..
- Përgjigjet në pyetjet nga përvoja personale.
- Shënimin me ✓ të porosive që ndjek .

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:
Mësoni përmendësh fjalët e personazheve përkatës për të dramatizuar tekstin.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore:		**Kriteret e suksesit:**		

<table>
<tr><td>Fletore pune, fq. 88-89</td><td>Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
Shkruan shkronjën  të dorës sipas modelit.
Shkruan rrokje dhe fjalë me shkronjën  të dorës në pozicione të ndryshme.
Shkruan me të diktuar shkronjën Dh,dh,  ,rrokje , fjalë e fjali që përmbajnë këtë shkronjë
Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
Dhelpra, dhia, kërpudha, Dhurata</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Dh,dh,  , etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Dh,dh,  në pozicione të ndryshme.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Artet, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësve u shpërndahen fletët dhe udhëzohen të vizatojnë nga një kërpudhë. Më pas, në pjesën e sipërme të saj vizatojnë nga dhjetë rrathë brenda të cilëve shkruajnë shkronjën Dh, dh. Punimet e tyre i vendosin në këndin e klasës.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Copëzat e përziera
Shkruhen në tabelë fjalët: Dhurata, dhuratë, të bukur, bleu.
Nxënësit nxiten të renditin fjalët dhe të formojnë fjalinë: Dhurata bleu dhuratë të bukur.
Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe te emrat e njerëzve.
Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Analizë & sintezë</td></tr>
</table>

Prezantohet grafiku i shkronjës . Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Krahasohet me shkronjë Dh, dh të shtypit. Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 88 dhe 89 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë shkronjën sipas modelit. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Vazhdojnë me rrokjet dhe fjalët përkatëse.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit punojnë sikurse te ushtrimi i parë.

Ushtrimi i tretë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit lidhin fjalët e tri kolonave për të krijuar fjali me kuptim. Fjalitë e krijuara i shkruajnë me shkronja dore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

- **Ushtrimi i katërt:** Shkruajnë me të diktuar nga një rresht me **Dh,dh,**  ,rrokje , fjalë e fjali që përmbajnë këtë shkronjë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkriin e shkronjës  të dorës sipas modelit.
- Shkrimin e rrokjeve dhe fjalëve me shkronjën  të dorës në pozicione të ndryshme**.**
- Shkriin me të diktuar shkronjën **Dh,dh,** , rrokje, fjalë e fjali që përmbajnë këtë shkronjë.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me 

Shkruani nga tri fjalë që përmbajnë .

Shkruani nga një fjali me ndonjërën nga fjalët e shkruara.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Luan role sipas modeleve;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Dh, fq 66, 67</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon fjalitë saktë dhe qartë dhe tregon kuptimin e tyre.
• Analizon dhe sintetizon rrokje, fjalë e fjali.
• Shkruan me shkronja dore fjalitë e dhëna.
• Dramatizon tekstin "Pasta e dhëmbëve".</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Babai, djali, porosia</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale
❖ Dramatizim</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti, etiketa me fjalë e fjali,</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit ndahen ne dyshe. Udhëzohen që njëri të thotë një rrokje që përmban tingullin Dh e tjetri të gjejë një fjalë që e përmban atë rrokje. Pas tre shembujve të tillë ndërrojnë rolet.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Analizë e sintezë
Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup iu jepen nga dy zarfa. Në njërin janë të vendosura etiketa me fjalë për të krijuar dy fjali ndërsa në tjetrin dy shirita me fjali të cilat do t'i ndajnë në pjesë përbërëse. Udhëheqësit e grupeve prezentojnë punën e bërë.

Hapi 2. Punë individuale</td></tr>
</table>

Kthehemi te detyra 3 e faqes 66 ku nxënësit një ditë më parë kanë krijuar fjali duke lidhur me shigjetë fjalë nga tri kolonat. Fjalitë e krijuara i shkruajnë në fletoret e tyre me shkronja dore. Poashtu shkruajnë edhe porosinë që ata e ndjekin më së shumti në përditshmërinë e tyre.(fq.67) ***Hapi 3.*** Dramatizim Një ditë më parë nxënësit janë udhëzuar që të mësojnë përmendësh fjalët e babait dhe djalit nga teksti "Pasta e dhëmbëve". Ashtu në dyshe dalin para klasës dhe dramatizojnë tekstin. Zgjidhet dyshja më e suksesshme. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura** Krijojnë fjali dhe ndajnë fjalitë në pjesë përbërëse. **Vlerësohen nxënësit për:** • Leximin e fjalive saktë dhe bukur. • Analizën dhe sintetizën e rrokjeve, fjalëve e fjalive. • Shkrimin me shkronja dore të fjalive të dhëna. • Dramatizimin e tekstit "Pasta e dhëmbëve".
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Mësoni përmbajtjen e tekstit "Pasta e dhëmbëve"dhe nxjerrni porosinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja Rr, fq. 68		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **Rr.**		**Fjalë kyçe:** Rrokja, rrushi, rrota, rrufeja		

• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **Rr** në pozicione të ndryshme. • Përshkruan figurën qendrore. • Qarkon rrokjet në vendin fjalët e dhëna. • Lidh rrokjet për të formuar fjalët.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Rr** të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **Rr,** magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhjame temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Paraqiten para nxënësve foto të frutave si: rrushi, arra, manaferra. Nxiten nxënësit të emërtojnë figurat dhe të tregojnë se cili u pëlqen më shumë dhe pse. Mësuesi/ja shkruan emrat e tyre poshtë figurave, të cilët lexohen globalisht nga nxënësit.

Veprimet në situatë

Hapi 1 .Vëzhgo-Analizo

Paraqitet një foto me një makinë që ecën në rrugë dhe nxiten nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër rreth saj:

-Çfarë shikoni?

-Ku po ecën makina?

-Cilat pjesë të makinës prekin rrugën?

- Sa rrota ka makina?

-T'i shqiptojmë së bashku fjalët.

Shkruhen fjalët RRUGA dhe RROTA në tabelë dhe nxiten t'i lexojnë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **Rr.**

-Sa rrokje kanë këjo fjalë? Provojmë t'i ndajmë: RRU-GA, RRO-TA.

-Pra, fjalët kanë nga dy rrokje. Ku ndodhet shkronja Rr? (në fillim)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 68 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës **Rr** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin. Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë?

-Çfarë po bëjnë fëmijët? Ku janë ulur dy nga ata? Çfarë ka mbi tavolinë? Cilat fjalë mund të formohen me rrokjet që ndodhen aty?

-Lexohet fjalia: *Ne luajmë me rrokje e fjalë.* **-**Sa fjalë ka kjo fjali? -Fjala ***rrokje*** sa rrokje ka? Gjejnë rrokjet me përplasje duarsh.(dy rrokje).- Ku gjendet shkronja **Rr**?

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të qarkojnë rrokjet : *rra, rrë, rre, rri, rru, rro* te fjalët e dhëna.

Ushtrimi i dytë: Bashkojnë rrokjet e paraqitura me ngjyrë të njëjtë peë të formuar fjalë me kuptim. Fjalët e formuara i shkruajnë në drejtkëndëshat e zbrazët.

-Nga sa rrokje ka secila fjalë e formuar? Ku ndodhet shkronja **Rr** te këto fjalë?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën Rr.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Rr.**
- Identifikimin e tingullit **Rr** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Qarkimin e rrokjeve në fjalët e dhëna.
- Lidhjen e rrokjeve për të formuar fjalë.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin Rr.

Shkruani emrat e tyre poshtë figurave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore:		**Kriteret e suksesit:**		

<table>
<tr><td>Fletore pune faqe 90, 91</td><td>Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Rr, rr të shtypit sipas modelit.
• Identifikon shkronjën Rr, rr në fjalët e dhëna.
• Ngjyros fjalët që lidhen me figurat.
• Plotëson rrokjet me shkronjën rr apo ndonjë zanore
• Bashkon rrokjet me formë të njëjtë.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
Rrota, rrethi, rrushi, rrobat</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i Rr, rr, plastelinë, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Rr, rr në pozicione të ndryshme.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit udhëzohen që të formojnë me plastelinë nga një rrotë. Punimet i vendosin në këndin e ekspozitës.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
Shkruhet fjala RROTA në tabelë dhe nxiten nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve:
-Cila fjalë është shkruar në tabelë?
-Çfarë është Rrota? (pjesë e mjeteve të transportit)
-Me cilën shkronjë fillon fjala Rrota?
Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja Rr, rr e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë
Prezantohet grafiku i shkronjës Rr. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Shpjegohet mënyra e formimit të saj nga dy shkronja.
Pra, R + r = Rr
Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.
Përsëritet veprimtaria për shkronjën rr të vogël të shtypit.</td></tr>
</table>

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 90 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin rrotën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Sqarohet kuptimi i simbolit të detyrës së parë dhe në mënyrë të pavarur, nxënësit gjejnë fjalët e fshehura në fjalëkryq që tregojnë emrat e figurave. I ngjyrosin ato me të njëjtën ngjyrë apo me ngjyra të ndryshme.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit plotësojnë rrokjet me shkronat që mungojnë: RRA, RRI, RRU, RRË, RRO, RRE, ARR, ERR, URR, ËRR, ORR, IRR dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë shkronjën duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Bashkojnë rrokjet e formave të njëjta dhe formojnë fjalët: rrotullim, kokrra, oborri, rrufe, të cilat i lexojnë .

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Rr, rr.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Rr, rr** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Rr, rr** në fjalët e dhëna.
- Gjetjen dhe ngjyrosjen e fjalëve të fshehura në fjalëkryq.
- Plotësimin e rrokjeve e shkronjën **rr** apo ndonjë zanore.
- Formimin e fjalëve nga rrokjet në figura të njëjta.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani dy rreshta me shkronjën **Rr, rr.**

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Rr, rr.**

Shkruani dy fjali, me fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Rr, rr.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

<table>
<tr><td>Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td>Rezultatet e të nxënit të temës:
Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;</td></tr>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore:
Shkronja Rr, fq. 69</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
• Qarkon fjalët e shkruara saktë.
• Lidh fjalinë e duhur me figurën.</td><td>Fjalë kyçe:
Fëmijët, loja, rrokjet, fjalët, fjalitë</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Rr të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, mjete shkrimi, fletë, ngjyra.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit ndahen në dy grupe. Njëri grup mban në dorë figura disa prej të cilave kanë shkronjën Rr në trupin e tyre e disa jo, ndërsa grupi tjetër mban etiketa me shkronjën Rr.
Në momentin kur u thuhet FILLO, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet figurë- shkronjë e të tjerët mbesin tek.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim me ndalesa
-Hapet libri faqe 69 në Abetare dhe paraqitet titulli në tabelë.
Nxënësit nxiten të mendojnë për 2-3 minuta rreth titullit dhe të tregojnë se çfarë janë rrokjet dhe fjalët
Dëgjohen mendimet e disa nxënësve.
Ndahet teksti në tri pjesë dhe lexohet me ndalesa.</td></tr>
</table>

Ndalesa e parë: që *nga fillimi deri te* "*…me rrokje e fjalë.*''

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë loje mund të luhet me rrokje e fjalë?

-A luani ju ndonjëherë në klasë këtë lojë?

Vazhdojmë me leximin e pjesës së dytë.

-Ndalesa e dytë:'' *Duke bashkuar . ... fjalën RRUSHI".*

Ndihmohen me pyetjet:

-A është kjo loja që ju e menduat?

-Cilat fjalë formuan fëmijët?

-Provoni të krijoni fjali me këto fjalë.

Lexohet pjesa e fundit.

Ndihmohen me pyetjet:

-Cila fjali u formua?

-A mund të formohet ndonjë fjali tjetër me këto fjalë?

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit .

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shenjëzojnë përgjigjet e sakta.

Ushtrimi i dytë: Qarkojnë fjalët e shkruara saktë.

Ushtrimi i tretë: Lidhin fjalinë e duhur me figurën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Parashikimin e ngjarjes në bazë të titullit dhe figurës.
- Leximin e tekstit saktë dhe me intonacion.
- Përgjigjet në pyetjet që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
- Qarkimin e fjalëve të shkruara saktë.
- Lidhjen e fjalive të duhura me figurat përkatëse.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:
Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.

Ktheni dy fjalitë e para të tekstit në fjali me kuptim të kundërt dhe shkruani në fletore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 91-92	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **Rr, rr** të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me shkronjën **Rr, rr** në pozicione të ndryshme**.** • Lidh fjalë në fjali dhe shkruan ato. • Shkruan me të diktuar **Rr, rr, Rr, rr,** rrokje, fjalë e fjali. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Oborri, korriku, kokrra, Rrësheni **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese Rr, rr, grafiku i shkronjës të shtypit dhe të dorës, Rr, rr, Rr, rr, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Rr, rr, Rr, rr, në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Paraqitet një fotografi e një shtëpie me oborr. Nxënësit përshkruajnë oborrin e paraqitur, e krahasojnë atë me oborrin e shtëpisë së tyre dhe vlerësojnë rëndësinë e tij për banorët e shtëpisë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Paraqiten para nxënësve shiriti me fjalinë: **Në oborr luajnë Rroni e Rrita.**

Aktivizohen nxënësit të identifikojnë shkronjën **Rr, rr** dhe ta qarkojnë.

Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe te emrat e njerëzve.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës Rr. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Krahasohet e shkronjën Rr të shtypit.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën rr.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 91 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën rr. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën Rr duke parë modelin e dhënë (fq.92) dhe fjalën e dhënë.

Ushtrimi i tretë: Në ushtrimin e tretë nxënësit lidhin fjalët me shigjeta për të krijuar fjali. Lexojnë fjalitë dhe i shkruajnë ato. Sqarohet emri i vendit *Rrëshen.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar nga dy rreshta me Rr, rr, Rr, rr, rrokje, fjalë e fjali.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës Rr, rr të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën Rr, rr në pozicione të ndryshme**.**
- Lidhjen e fjalëve në fjali dhe shkrimin e tyre.
- Shkrimin me të diktuar të Rr, rr Rr, rr, rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Shkruani nga dy rreshta me shkronjën Rr, rr.
Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë Rr, rr.
Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë Rr, rr.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore:		**Rezultatet e të nxënit të temës:**		

<table>
<tr><td>Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td>Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;</td></tr>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore:
Shkronja Rr, fq 68, 69</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Formon fjali me fjalët e dhëna.
• Shkruan me shkronja dore fjalitë e dhëna.
• Ndan në rrokje dhe shkronja fjalët e dhëna.
• Formon fjalë me rrokjet e dhëna.
• Krijon fjali bazuar në figura.</td><td>Fjalë kyçe:
Fëmijët, loja, rrokjet, fjalët ,fjalitë</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale
❖ Shkrim i lirë</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti, etiketa me fjalë e fjali, fletë A4</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit ndahen ne dyshe. Udhëzohen që njëri të thotë një rrokje që përmban tingullin Rr e tjetri të gjejë një fjalë që e përmban atë rrokje. Pas tre shembujve të tillë ndërrojnë rolet.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Analizë dhe sintezë
Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup iu jepen etiketa me fjalë (rrugë, korrik, oborr). Në grup përpiqen të krijojnë fjali me këto fjalë. Udhëheqësit e grupeve tregojnë fjalitë e formuara. Prej secilit grup përzgjidhet nga një fjali nga nxënësit dhe shkruhet në tabelë me shkronja të shtypit.
Hapi 2. Punë individuale
Nxënësve iu shpërndahen fletë A4 me ushtrime rreth shkronjës Rr.
1. Shkruajnë me shkronja dore fjalitë nga tabela.
2. Ndajnë në rrokje dhe shkronja fjalët e dhëna.(Përzgjidhen nga mësuesi/ja)
3. Formojnë fjalë me rrokjet e përcaktuara. (Përzgjidhen nga mësuesi/ja)</td></tr>
</table>

Hapi 3. Shkrim i lirë

Te ushtrimi i dytë në faqen 69 janë paraqitur dy figura. Nxënësit udhëzohen që për secilën figurë të shkruajnë nga një fjali, ndryshe nga ato që janë dhënë në libër.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Krijojnë fjali dhe lexojnë ato para klasës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Formon fjali me fjalët e dhëna.
- Shkruan me shkronja dore fjalitë e dhëna.
- Ndan në rrokje dhe shkronja fjalët e dhëna.
- Formon fjalë me rrokjet e dhëna.
- Krijimin e fjalive bazuar në figura.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Mësoni përmbajtjen e tekstit "Rrokje e f'jalë."

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja Q, faqe 70		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **Q.** • Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **Q** në pozicione të ndryshme. • Përshkruan figurën qendrore. • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Qarkon rrokjet e përcaktuara në fjalët e dhëna		**Fjalë kyçe:** Qershia, qeni, qukapiku, qepa **Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale		

• Formon fjalë bazuar në figura dhe shkronjat pranë tyre. • Lidh pjesët e fjalisë sipas modelit për të krijuar fjali me kuptim • Plotëson fjalinë me fjalët që mungojnë.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Q** të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **Q,** magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë këngën: "Qershia" nga you tube. Këngën mund ta gjeni në këtë vegëz: https://youtu.be/sCGXArvNg88.

Në orën e Edukatës figurative mund të përgatiten më parë qershi prej letre apo plasteline dhe të ngjiten me spango në mënyrë që nxënësit të mund t'i vendosin në vesh.

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo

Mësuesja mban në dorë qershitë e punuara dhe nxënësit nxiten të bëjnë komente të rreth tyre:

- Ju pëlqejnë qershitë?

- Çfarë ngjyre kanë?

- Çfarë forme kanë?

- Si është shija e tyre?

- Kur piqen qershitë?

-Ta shqiptojmë së bashku fjalën **QERSHITË.**

Shkruhet fjala **QERSHITË** në tabelë dhe nxiten ta lexojnë atë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Q.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: QER-SHI-TË.

-Pra, fjala QER-SHI-TË ka tri rrokje. Ku ndodhet shkronja Q? (Në fillim)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 70 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës **Q** që ndodhet në krye të faqes.Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë? Si duket djali? Pse?

U lexohet vjersha . Disa nxënës e lexojnë atë.

U drejtohen pyetjet:

- Po ju, keni vjelur ndonjëherë qershi? Si jeni ndier ?

Udhëzohen të qarkojnë shkronjën Q në fjalët e vjershës.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të qarkojnë rrokjet: *qa, qe, qi, qo, qu, që* te fjalët e dhëna. Lexojnë me radhë fjalët. Sqarohet kuptimi i tyre nëse ka nevojë.

Ushtrimi i dytë: Vëzhgojnë figurat dhe renditin shkronjat përreth tyre për të formuar emrat që u përkasin atyre figurave. Lexojnë emrat.

Ushtrimi i tretë: Lexojnë grupet e fjalëve në të dy anë në mënyrë që të formojnë fjali me kuptim. I lidhin me shigjetë pjesët përkatëse.

Ushtrimi i katërt: Nga nxënësit kërkohet të thonë së bashku emrat e muajve të vitit.U tregohet atyre që shumë prej muajve të vitit janë emërtuar në bazë të aktiviteteve që ndodhin në atë kohë**.** P.sh qershi-qershor, korrje-korrik etj.

Lexojnë fjalinë *Qershitë piqen në qershor* dhe bëhet analiza e saj. E shkruajnë atë përsëri në vendin përkatës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën Q në fillim, në mes apo në fund..

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Q.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **Q** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Qarkimin e rrokjeve të përcaktuara në fjalët e dhëna.
- Formimin e fjalëve bazuar në figura dhe shkronjat pranë tyre.
- Lidhjen e pjesëve të fjalisë sipas modelit për të krijuar fjali me kuptim.
- Plotësimin e fjalive me fjalët që mungojnë.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Lexoni vjershën për qershitë.
Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin Q.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 93,94</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Q, q të shtypit sipas modelit.
• Identifikon shkronjën Q, q në fjalët e dhëna..
• Ndan fjalët në rrokje sipas modelit të dhënë.
• Lidh rrokjet për të formuar fjalë.
• Shkruan fjalët e formuara në vendin përkatës.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Qeni, qepa, qukapiku</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i Q, q, plastelinë, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Q, q në pozicione të ndryshme.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhjame temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake

Para nxënësve paraqes simbolin e fytyrës së qeshur  . Tregojnë se çfarë paraqet ky simbol dhe japin mendimet e tyre se kur njeriu qesh më shumë. Më pas kërkohet nga nxënësit t'i bëjnë të tjerët të qeshin.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
Hapet Fletorja e punës në faqen 93 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.
- Si quhet kjo kafshë?</td></tr>
</table>

- Çfarë raporti keni ju me qenin?
- Ju pëlqen të mbani qen në shtëpi?
- Si bën qeni?

E shkruaj fjalën QENI në tabelë dhe kërkoj nga nxënësit të tregojnë se çfarë kam shkruar. Qarkohet shkronja Q.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **Q,q** e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Q**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Krahasohet me shkronjën O, duke vërejtur ngjashmërinë dhe dallimin mes tyre.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **q** të vogël të shtypit..

Hapi 3.Punë individuale

Pasi ngjyrosin qenin, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Shkruajnë shkronjën ***Q*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera

Ushtrimi i dytë: Ndjek me laps figurat që u fillon emri me Q për të ndihmuar qenin të shkojë te ushqimi i tij i preferuar.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë shkronjën ***q*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Ndan në rrokje fjalët: qukapik, qerpik, spinaq dhe qeleshe.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i pestë: Lidh rrokjet e tri kolonave me shigjetë dhe formon fjalë të cilat i shkruan në kolonën e fundit.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Q, q** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Q, q** në fjalët e dhëna.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje sipas modelit të dhënë.
- Lidhjen e rrokjeve për të formuar fjalë.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga dy rreshta me shkronjën **Q, q.** Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Q, q.** Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **Q, q.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Shkronja Q, faqe 71	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurën që ilustron tekstin. • Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës. • Lexon tekstin qartë dhe saktë. • Përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit. • Diskuton dhe argumenton rreth pergjigjeve që jep • Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.	**Fjalë kyçe** Fëmijët, frutat, qershitë, bërthamat, **Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë - gjëegjëza ❖ Lexim zingjir- diskutim ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Q të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, mjete shkrimi, fletë, ngjyra.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Para nxënësve paraqiten dy gjëegjëza për qershitë:

Rruqe-rruqe paparruqe
brenda dru e jashtë e kuqe.

E ëma shami jeshile
E bija shami kuqe.

Pastaj mund t'iu lexojmë disa të dhëna për qershitë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim me ndalesa

-Hapet librifaqe 71 në Abetare dhe u paraqitet titulli në tabelë.

-Nxënësit nxiten të mendojnë për 2-3 minuta, të tregojnë se për çfarë do të mësojnë, bazuar në titull dhe figurë.

Teksti lexohet së pari nga mësuesi/ja e pastaj zinxhir nga nxënësit. Për 2-3 minuta e lexojnë edhe në heshtje dhe hapet diskutimi me pyetjet: A të pëlqejnë qershitë? PO JO- PSE?

A bëri mirë Iliri që i hëngri me bërthamë? PO JO - PSE?

Nxënësit përgjigjen dhe mundohen të argumentojnë përgjigjet e tyre.

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të vendosin në vendin e shkronjës së parë që mungon, shkronjat *q* dhe *p* , për të fituar fjalë të sakta.

Ushtrimi i dytë: Udhëzohen të plotësojnë skedën duke përdorur fjalën *quhet* në secilën fjali.

Ushtrimi i tretë: Shenjëzojnë në njërin nga katrorët e zbrazët për të treguar cila pjesë duhet t'i shtohet shkronjës Q që të jetë e plotë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxjerrin mesazhin nga teksti i lexuar.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Parashikimin e ngjarjes në bazë të titullit dhe figurës.
- Saktësinë e leximit të tekstit.
- Përgjigjet në pyetjet lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:
Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.
Mësoni përmbajtjen e tekstit.
Prezentoni(shkruani) ne fletore si quhen anëtarët e familjes tënde.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shkruan fjalë duke parë figura;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 94, 95</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Q, q të dorës sipas modelit.
• Plotëson fjalët me shkronjën Q, q në pozicione të ndryshme.
• Shkruan mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore
• Shkruan me të diktuar Q, q , Q, q.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Shkronja Q, q e madhe dhe e vogël e dorës.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë me etiketa
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">• Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese , grafiku i shkronjës Q ,q , Q , q, të shtypit dhe të dorës etiketa te zbrazëta me ngjyrë kuqe, pemë të vizatuara në fletë A3</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet nga një fletë A3 ku është vizatuar nga një pemë e madhe dhe etiketa të kuqe në formë qershie ku do të shkruajnë fjalë që në trupin e tyre kanë Q. Etiketat e plotësuara ngjiten në pemë dhe secili grup lexon fjalët e shkruara. Punimet vendosen në mur.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Analizë dhe sintezë
Përsëritet shkronja Q, q e shtypit.
Prezantohet grafiku i shkronjës Q.
Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.</td></tr>
</table>

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë. Krahasohet me shkronjën Q të shtypit.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **q**.

Hapi 2 .Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 94 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën **Q**, **q**, duke shkruar mbi vija të ndërprera. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë rrokjet e fjalët duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i tretë: Në ushtrimin e tretë nxënësit lidhin me shigjetë fjalët e tri kolonave për të krijuar fjali. Lexojnë fjalitë e krijuara dhe i shkruajnë ato me shkronja dore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar **Q, q** , **Q , q**, rrokje, fjalë e fjali .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës Q, **q** të dorës sipas modelit.
- Shkrimin mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.
- Shkrimin me të diktuar të Q, **q,** rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Shkruani nga dy rreshta me shkronjën Q, **q**.
Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Q, **q.**
Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën Q, **q.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Përflet ngjarjen kryesore në tekst;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja Q, fq 70,71		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit orës mësimore:
Nxënësi:
Lexon tekstin saktë dhe me intonacion.
Tregon përmbajtjen e tekstit.
Nxjerr mesazhin e tregimit
Shkruan me shkronja dore fjalitë e dhëna</td><td>Fjalë kyçe:
Qershitë, qumështi, qepa pëlqen
Teknika dhe strategji:
❖ Zgjedh -argumento
❖ Copëzat e përziera
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti, etiketa me fjali, fletë A4 me figura të ushqimeve</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit udhëzohen që të lexojnë skedat me emrat e anëtarëve të familjes të punuara një ditë më parë në shtëpi. Kontrollohet saktësia në të shkruarit e emrave të njerëzve.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Zgjedh-argumento
Në tabelë vendosen tri foto të tri ushqimeve: qumështit, qershive dhe qepës. Kërkohet nga nxënësit të grupohen në tri grupe, varësisht se cili prej ushqimeve u pëlqen më shumë. Grupi që janë mbledhur afër qumështit diskutojnë dhe argumentojnë pse iu pëlqen ai ushqim. Njëjtë veprojnë edhe grupet e tjera.

Hapi 2. Copëza të përziera
Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup iu jepen etiketa me fjali nga teksti pa ndonjë renditje. Nxënësit duhet t'i renditin fjalitë sipas radhës së veprimeve pa i parë në libër. Fitues zgjidhet grupi që ka kryer punën më shpejt dhe ka renditur saktë fjalitë.

Hapi 3. Punë individuale
Fjalitë e renditura shkruhen në tabelë nga mësuesi/ja. Kërkohet nga nxënësit që në fletoret e tyre të shkruajnë ato fjali me shkronja dore dhe në fund të secilës fjali të shkruajnë numrin e fjalëve që ato përmbajnë.</td></tr>
</table>

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tregojnë mesazhin e tregimit. **Vlerësohen nxënësit për:** • Leximin e tekstit saktë dhe me intonacion. • Tregimin e përmbajtjes së tekstit. • Nxjerr mesazhin e tregimit. • Shkrimin me shkronja dore të fjalive të dhëna.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Mësoni përmbajtjen e tekstit" Qershitë."

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Përsëritje 4, faqe 72 në Abetare		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingujt **Sh, F, V, Dh, Rr, Q.** • Identifikon shkronjat e mësuara në fjalë të ndryshme (në pozicione të ndryshme). • Gjen fjalë që në trup të tyre kanë shkronjat **Sh, F, V, Dh, Rr, Q** në pozicione të ndryshme. • Formon rrokje me shkronjat e dhëna. • Shkruan emrat e figurave të paraqitura. • Formon fjali me fjalët e dhëna.		**Fjalë kyçe:** Shishja, qeni, fiku, dhelpra, varka, rrushi **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizo-plotëso ❖ Shkrim i lirë		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, etiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara, fletë A4.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Zhvillohet një lojë. Mësuesi/ja paraqet para nxënësve fletën me shkronjën **Sh,** dhe të gjithë nxënësit që kanë në emrin apo mbiemrin e tyre këtë shkronjë, ngriten në këmbë. Vazhdon veprimtaria edhe me shkronjat **F, V, Dh, Rr, Q.**

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit ndahen në gjashtë grupe.

Çdo grupi i jepet nga një fletë A4 në mes të së cilës është shkruar njëra nga shkronjat **Sh, F, V, Dh, Rr, Q**. Udhëzohen nxënësit të shkruajnë fjalë që përmbajnë në trupin e tyre atë shkronjë.

Hapi 2. Analizo-plotëso

Ushtrimi i parë: Hapet libri në faqen 72 në Abetare dhe nxiten nxënësit të shqiptojnë tingujt e shkronjave të mësuara **Sh, F, V, Dh, Rr, Q.** Theksohet se të gjithë janë tinguj bashkëtingëllorë.

Më pas i shkruajnë shkronjat duke kaluar me laps mbi vija të ndërprera.

Ushtrimi i dytë: Udhëzohen të bashkojnë shkronjat nga kolona dhe rreshti për të formuar rrokje. Më pas lexojnë rrokjet e formuara.

Ushtrimi i tretë: Nxënësit lexojnë me zë fjalët e dhëna në tabelë. Më pas, udhëzohen që në fjalët e secilit rresht të tabelës të qarkojnë shkronjën përkatëse.

Ushtrimi i pestë: Udhëzohen të ngjyrosin shkronjat e mësuara.

Hapi 3. Shkrim i lirë

Udhëzohen të shkruajnë fjali me një nga fjalët e dhëna në tabelë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Nxënësit shkruajnë emrat e figurave të paraqitura.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingujve **Sh, F, V, Dh, Rr, Q.**
- Identifikimin e shkronjave të mësuara në fjalë të ndryshme (në pozicione të ndryshme).
- Gjetjen e fjalëve që në trup të tyre kanë shkronjat **Sh, F, V, Dh, Rr, Q** në pozicione të ndryshme.

- Formimin e rrokjeve me shkronjat e dhëna.
- Shkrimin e emrave të figurave.
- Formimin e fjalive me fjalët e dhëna.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani në fletore emra njerëzish, kafshësh e sendesh që fillojnë me shkronjat. Shembull:

	Njerëz	Kafshë	Sende
Sh			
F			
V			
Dh			
Rr			
Q			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Përsëritje 4, faqe 96, në Fletore pune		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi:		**Fjalë kyçe:** Dhelpra, violina, qukapiku, rrota, shishe, qafa		

• Shkruan shkronjat e shtypit dhe të dorës **Sh, F, V, Dh, Rr, Q.** • Formon rrokje me shkronjat e dhëna. • Bashkon rrokjet për të formuar fjalë. • Shkruan emrat e figurave të paraqitura. • Formon fjali me fjalët e dhëna.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Copëza të përziera ❖ Analizo-plotëso ❖ Shkrim i lirë
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, gjëegjëza, etiketa me fjalë.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesi/ja u lexon nxënësve disa gjëegjëza, përgjigjet e të cilave janë fjalë me shkronjat e mësuara. Nxënësit përpiqen të gjejnë përgjigjet dhe shkruajnë fjalët në tabelë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Copëza të përziera

Nxënësve në dyshe u shpërndahen etiketa me fjalë të ngatërruara. Udhëzohen t'i renditin ato për të formuar fjali me kuptim. Lexojnë fjalitë e formuara.

Hapi 2. Analizo-plotëso

Hapet Fletore pune në faqen 96 dhe udhëzohen nxënësit hap pas hapi për kryerjen e detyrave.

Nxënësit shkruajnë shkronjat **Sh, F, V, Dh, Rr, Q** të shtypit dhe të dorës duke kaluar me laps mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të formojnë rrokje me shkronjat e dhëna dhe t'i shkruajnë ato me shkronja të dorës. Lexojnë rrokjet e formuara.

Ushtrimi i dytë:

Bashkojnë rrokjet e formave të njëjta dhe shkruajnë fjalët. Lexojnë me zë fjalët e formuara.

Hapi 3. Shkrim i lirë

Shkruajnë në fletore nga një fjali me secilin emër nga ushtrimi i tretë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: **Ushtrimi i tretë:** Shkruajnë emrat e figurave të paraqitura dhe i lexojnë ato. **Vlerësohen nxënësit për:** • Shkrimin e shkronjave të shtypit dhe të dorës **Sh, F, V, Dh, Rr, Q.** • Formimin e rrokjeve me shkronjat e dhëna. • Bashkimin e rrokjeve për të formuar fjalë. • Shkrimin e emrave të figurave të paraqitura. • Formimin e fjalive me fjalët e dhëna.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Fjalët e formuara të ushtrimit 2 i shkruajnë në fletore me shkronja dore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Përsëritje 4, faqe 73 në Abetare		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton saktë tingujt bashkëtingëllorë. • Shkruan shkronjat e mësuara, të shtypit dhe të dorës. • Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë. • Lexon me intonacion tekstin. • Tregon përmbajtjen e tekstit me disa fjali.		**Fjalë kyçe:** Miushët, shtëpia prej bore, zogjtë **Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimesh ❖ Vëzhgo -lexo-shkruaj ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, tiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake***				

Nxënësit ndahen në dy grupe të barabarta dhe qëndrojnë të ulur në karrige të renditur njëri pas tjetrit. Mësuesi-ja qëndron para tyre dhe i thërret dy të fundit të vijnë afër. Që të dyve u tregon në vesh një shkronjë të ndryshme dhe ata duhet të shënojnë me gisht shkronjën në shpinën e shokut/shoqes. Kështu vazhdohet deri sa shkronja të arrijë deri te personi i parë i cili duhet ta shënojë në letër, ndërsa mësuesi kontrollon se a është shkronja e cila është treguar në fillim. Nëse po atëherë loja vazhdon me shkronja të tjera derisa të kryhen gjashtë shkronjat që po përsëriten.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Stuhi mendimesh

Ngriten nxënës të ndryshëm në tabelë për të shkruar të gjitha shkronjat e mësuara der tani. Shkruajnë shkronjat e shtypit dhe të dorës, të mëdha e të vogla.

Formohen rrokje dhe më pas fjalë të ndryshme, që kanë shkronjat në trup të tyre, në fillim, në mes dhe në fund.

Hapi 2. Vëzhgo-lexo-shkruaj

Hapet libri në faqen 73 të Abetares. Përsëritet edhe njëherë shqiptimi i tingujve bashkëtingëllorë që ndodhen në krye të faqes.

Ushtrimi i gjashtë: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurat e paraqitura. Përshkruajnë se çfarë shohin, duke emërtuar figurat dhe parashikuar ngjarjen.

Paraqitet titulli “Shtëpia prej bore” në tabelë dhe lexohet nga nxënësit.

U shpjegohet se për të ndërtuar ngjarjen e plotë, duhet të lexojnë fjalitë dhe të plotësojnë ato me fjalët që mungojnë, duke u bazuar edhe te figurat.

Sipas nevojës ndihmohen nga mësuesi/ja.

Pas përfundimit, nxënës të ndryshëm lexojnë tekstin.

Hapi 3. Punë individuale

Nxënësit lexojnë fjalitë dhe shenjëzojnë përgjigjet e sakta, të cilat lidhen me përmbajtjen e tekstit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxënësit tregojnë përmbajtjen tekstit me disa fjali.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e saktë të tingujve bashkëtingëllorë.
- Shkrimin e shkronjave të mësuara, të shtypit dhe të dorës.
- Plotësimin e fjalive me fjalët që mungojnë.
- Leximin me intonacion të tekstit.
- Tregimin e përmbajtjes së tekstit me disa fjali.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani në fletore me shkronja dore tekstin “Shtëpia prej bore”.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja G, faqe 74</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin G.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin G në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Qarkon rrokjet e përcaktuara në fjalët e dhëna
• Lidh pjesët e fjalisë sipas modelit për të krijuar fjali me kuptim
• Plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë.
• Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Globi, gomari, gota, guri</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-Analizo
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës G të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën G magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake
Paraqiten para nxënësve disa figura si: gomari, goma, gota.
Nxiten nxënësit të komentojnë rreth tyre

Veprimet në situatë
Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo
Mësuesja mban në dorë një glob dhe nxënësit nxiten të bëjnë komente rreth tij:</td></tr>
</table>

- Çfarë kam në dorë?
- Çfarë forme ka?
- Cilat ngjyra dominojnë?
- Me çfarë përngjan globi?

Nëse nuk ka përgjigje të sakta u jepen të dhëna për globin

-Ta shqiptojmë së bashku fjalën **GLOBI.**

Shkruhet fjala GLOBI në tabelë dhe nxiten ta lexojnë atë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës G.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: GLO-BI.

-Pra, fjala GLO-BI ka dy rrokje. Ku ndodhet shkronja G? (Në fillim)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 74 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës G që ndodhet në krye të faqes.Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë?

- Çfarë po bëjnë fëmijët?

- Kush ndodhet pas globit? Çfarë po bën ai?

Lexohet titullin "Ufi tregon globin". Bëhet analiza fjali-fjalë-rrokje-tingull.

Udhëzohen të qarkojnë shkronjën G në fjalët e titullit.

Ftohen nxënësit të prekin globin dhe ta rrotullojnë atë. U tregohet se edhe vendi ynë paraqitet aty.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shohin figurat dhe poshtë tyre të plotësojnë emrat me rrokjet *ga, go, gu* të cilat mungojnë.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit udhëzohen të qarkojnë rrokjet: *gra, gre, gri, gro, gru,* te fjalët e dhëna. Lexojnë me radhë fjalët. Sqarohet kuptimi i tyre nëse ka nevojë .

Ushtrimi i tretë: Janë dhënë tri fjali të cilave u mungon nga një fjalë. Fjalët që mungojnë janë shkruar në një tabelë ndihmëse me ngjyrat e fjalëve të fjalive përkatëse. Fillimisht nxënësit bazohen te ngjyra e pastaj edhe te kuptimi. Shkruajnë fjalët në vendet e tyre. Sqarohet kuptimi i fjalive nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Lexojnë fjalitë e formuara në ushtrimin e tretë dhe qarkojnë shkronjën G.Tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën G në fillim, në mes apo në fund.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **G.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **G** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Qarkimin e rrokjeve të përcaktuara në fjalët e dhëna
- Plotësimin e fjalive ne fjalët që mungojnë.
- Plotësimin e fjalëve me rrokjet që mungojnë.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin **G.**

Shkruani emrat e tyre poshtë figurave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 98, 99	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **G, g** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **G, g** në fjalët e dhëna. • Ngjyros fjalët që lidhen me figurat. • Plotëson rrokjet me shkronjën **G, g** apo ndonjë zanore.	**Fjalë kyçe:** Globi, goma, gomari, guri **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë dhe sintezë ❖ Punë individuale

• Bashkon rrokjet me formë të njëjtë. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **G, g,** plastelinë, etiketa me shkronja, rrokje e fjalë që përmbajnë shkronjën **G, g** në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Secilit nxënës i jepet në dorë nga një etiketë e zbrazët. Disa prej tyre kanë ngjyrë të kuqe e aty shkruajnë fjalë që kanë shkronjën G në fillim, disa kanë ngjyrë te kaltër dhe përdoren për fjalët që kanë shkronjën g ne mes, si dhe etiketat me ngjyrë të gjelbër për fjalët që kanë shkronjën g në fund. Lexojnë fjalët që kanë shkruar.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet Fletorja e punës në faqen 98 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje. Pyeten :

- Si quhet ky objekt?
- Modelin e cilit planet e tregon?
- Çfarë tregon ngjyra e kaltër? Po e gjelbra me te kaftën?

Shkruhet fjala GLOBI në tabelë dhe kërkohet nga nxënësit të tregojnë se çfarë po shkruan. Qarkohet shkronja **G.**

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **G, g** e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **G.** Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Krahasohet me shkronjat e tjera.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **g** të vogël të shtypit..

Hapi 3. Punë individuale

Pasi ngjyrosin globin, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës. Krijojnë vija të drejta e rrethore.

Ushtrimi i parë: Shkruajnë shkronjën ***G*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera

Ushtrimi i dytë: Gjejnë fjalë që emërtojnë figurat dhe i ngjyrosin ato me ngjyrat që u pëlqejnë..

Ushtrimi i tretë: Plotësojnë rrokjet me shkronjën **g** apo ndonjë zanore.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë shkronjën ***g*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i pestë: Bashkon rrokjet në figura të njëjta dhe krijon fjalë. Ato i shkruan në vendet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **G, g,** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **G, g,** në fjalët e dhëna.
- Plotësimin e rrokjeve me shkronjën **G, g** apo ndonjë zanore.
- Bashkimin e rrokjeve me formë të njëjtë.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani dy rreshta me shkronjën **G, g.**

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **G, g.**

Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **G, g.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7
Njësia mësimore: Shkronja G, faqe 75	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurën që ilustron tekstin. • Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës. • Lexon tekstin saktë dhe me intonacion. • Shenjëzon përgjigjet e sakta. • Shpjegon kuptimin e fjalëve të reja. • Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.	**Fjalë kyçe** Fëmijët, Ufi, globi, fushat, malet.detet, oqeanet, kontinenetet **Teknika dhe strategji:** ❖ Lexim i drejtuar ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale

Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës G të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, etiketa, globi	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Secilit nxënës i jepet në dorë nga një etiketë, disa prej të cilave kanë shkronja, disa rrokje e disa fjalë. Etiketat janë me ngjyra të ndryshme. Bëhen bashkë nxënësit që kanë në dorë etiketat me ngjyrë të njëjtë. I renditin si duhet shkronjat, rrokjet e fjalët. Të renditura si duhet ngjiten në tabelë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim i drejtuar

-Hapet libri faqe 71 në Abetare dhe paraqitet titulli në tabelë.

Nxënësit nxiten të mendojnë për 2-3 minuta, të tregojnë se për çfarë do të mësojnë, bazuar në titull dhe figurë.

Teksti lexohet së pari nga mësuesi-ja . Pastaj kërkohet nga nxënësit të lexojnë në heshtje dhe të qarkojnë në tekst fjalët e panjohura të cilat do të sqarohen më vonë.

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pasi të kenë lexuar tekstin, u drejtohen pyetjet:

- A ekziston Ufi në të vërtetë? Nëse po, çfarë është ai?
- Çfarë mësuan fëmijët nga Ufi?
- A do të doje të udhëtoje rreth Tokës për ta parë se si duket në të vërtetë?
- Si quhen njerëzit që udhëtojnë në gjithësi?

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shenjëzojnë përgjigjen e saktë, duke u bazuar te përmbajtja e tekstit.

Ushtrimi i dytë: Udhëzohen të plotësojnë fjalët duke lexuar edhe një herë pjesë nga teksti. Numërojnë me kujdes se nga sa shkronja mungojnë për të qenë më të saktë.

Ushtrimi i tretë: Shikojnë figurën e globit dhe lexojnë emërtimet. Mundohen të shpjegojnë me fjalë ato.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

I bëjnë pyetje njëri - tjetrit për globin dhe mundohen të japin shpjegime. Përcillet biseda mes tyre. Në fund jepen shpjegime nga mësuesi/ja me anë të fotove apo nga videoprojektori.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Parashikimin e ngjarjes në bazë të titullit dhe figurës.
- Saktësinë e leximit të tekstit.
- Përgjigjeve të pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Pyetjet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:
Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.
Mësoni përmbajtjen e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 99,100	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën G, g të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me shkronjën G, g në pozicione të ndryshme**.** • Shkruan mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore • Shkruan me të diktuar G, g, G, g. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Gota, guri, gruri, globi **Teknika dhe strategji:** ❖ Lojë me etiketa ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale

• **Burimet e informacionit dhe mjete:** Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës G, g , G, g,të shtypit dhe të dorës .	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Në tabelë apo videoprojektor paraqiten foto të disa sendeve: gota, guri, gruri, gishti, globi. Nga nxënësit kërkohet të tregojnë se çfarë kanë të përbashkët këto figura. Pasi të gjejnë këtë, tregojnë emrat e tyre e mësuesja i shkruan poshtë figurave. Lihet vend për të shkruar ato fjalë me shkronja dore.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Analizë dhe sintezë

Përsëritet shkronja **G, g** e shtypit.

Prezantohet grafiku i shkronjës **G.**

Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë. Krahasohet me shkronjën **G** të shtypit.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **g**.

Hapi 2. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 99 dhe udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë shkronjën g, duke shkruar mbi vija të ndërprera.Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë mbi vija shkronjën G duke parë modelin e dhënë. U rikujtohet se emrat e njerëzve fillojnë me shkronjë të madhe

Ushtrimi i tretë: Në ushtrimin e tretë nxënësit lidhin me shigjetë fjalët e tri kolonave për të krijuar fjali. Lexojnë fjalitë e krijuara dhe i shkruajnë ato me shkronja dore. Bazohen te figurat e paraqitura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar G,g , G, g, rrokje, fjalë e fjali .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës G, g të dorës sipas modelit.
- Shkrimin mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.

• Shkrimin me të diktuar të G, g, rrokjeve, fjalëve e fjalive. • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga dy rreshta me shkronjën G, g. Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën G, g. Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën. G, g.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Përflet ngjarjen kryesore në tekst;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Shkronja G, faqe 74,75		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon tekstin saktë dhe e intonacion. • Tregon përmbajtjen e tekstit. • Rendit saktë fjalët në fjali. • Shkruan me shkronja dore fjalitë e dhëna		**Fjalë kyçe:** Globi, malet, fushat, liqenet, oqeanet, lumenjtë, kontinentet **Teknika dhe strategji:** ❖ Mendo-thuaj-shkruaj ❖ Lexim zinxhir ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti,etiketa me fjali, fletë A4 ushtrimin e përgatitur,		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Nxënësit udhëzohen që të thonë emra të njerëzve, të kafshëve dhe sendeve që kanë në trupin e tyre shkronjën G. Shkruhen nga nxënësit në tabelë në tri kolona të veçanta.				

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim zinxhir

Hapen librat e Abetares në fq.75 dhe u tregohet nxënësve se do të lexojnë secili nga dy fjali prej tekstit. Pasi të lexojnë të gjithë, 2-3 nxënës do të thonë përmbajtjen. Sigurohemi që edhe të tjerët ta kenë mësuar.

Hapi 2. Punë individuale

Punohet ushtrimi i fundit fq.75. Fjalët e shkruara në figura me formë dhe ngjyrë të ndryshme i renditin saktë për të formuar fjali.

Vazhdohet me ngjyrosjen e figurës ku duhet t'i kushtohet kujdes dallimit në mes të kontinenteve dhe oqeaneve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

U shpërndahen fletë A4 ku në njërën anë shkruhen emrat (figurat): mal, fushë, det, lum, det, oqean, kontinent, ndërsa në anën tjetër shpjegimet se çfarë janë ato. Nxënësit i lexojnë me vëmendje dhe i lidhin pjesët përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e tekstit saktë dhe me intonacion.
- Tregimin e përmbajtjes së tekstit.
- Renditjen e saktë të fjalëve në fjali.
- Shkrimin me shkronja dore të fjalive të dhëna.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani me shkrim dore tekstin "Loja me glob".

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1		
Njësia mësimore: Shkronja C, faqe 76		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **C.** • Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që përmbajnë tingullin **C** në pozicione të ndryshme. • Përshkruan figurën qendrore. • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Qarkon rrokjet e përcaktuara në fjalët e dhëna • Lidh pjesët e fjalisë sipas modelit për të krijuar fjali me kuptim • Plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë. • Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë.	**Fjalë kyçe:** Cicërima, cepi, copa **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë&sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **C** të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **C,** magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësve u lëshohet në magnetofon të dëgjojnë cicërima zogjsh për disa çaste.

- Çfarë po dëgjoni? Kur dhe ku dëgjohen më shumë cicërimat e zogjve? Cili nga ju di të imitojë cicërimat? Nxënësit dalin para klasës dhe imitojnë këta zëra.

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri i Abetares në fq.76. Nxënësit vëzhgojnë figurën dhe nxiten të bëjnë komente rreth saj:

- Çfarë po shihni në figurë?
- Ku ndodhet zogu?
- Çfarë po bën djali?
- Si e ndau djali ushqimin për zogun?

- Keni vepruar ju ndonjëherë kështu me ndonjë zog?

Lexohet vjersha nga mësuesi-ja.

- A mund të flasë zogu?
- A mund të shoqërohesh me një zog?

Nxënësit tregojnë nëse kanë ndonjë zog në shtëpi.

Hapi 2. Analizë& sintezë

Nxiten nxënësit të shqiptojnë tingullin e shkronjës C që ndodhet në krye të faqes.Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Shkruhet fjala CICËRIMA në tabelë dhe nxiten ta lexojnë atë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës C.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë. : CI-CË-RI-MA

-Pra, fjala CI-CË-RI-MA ka katër rrokje. Ku ndodhet shkronja C? (Në dy rrokjet e para)

Udhëzohen të qarkojnë shkronjën C në fjalët e vjershës.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të qarkojnë rrokjet: *ca, ce, ci, co, cu, cë* te fjalët e dhëna.

Lexojnë me radhë fjalët. Sqarohet kuptimi i tyre nëse ka nevojë .

Ushtrimi i dytë: Nxënësit plotësojnë katrorët e zbrazët me emrat e figurave përkatëse. Në dispozicion kanë edhe shkronjat e fjalës të shpërndara rreth figurave.

Ushtrimi i tretë: Lidhin me shigjetë emrat e figurave me fjalët që tregojnë veprimet që ata kryejnë :

Tullumbacja- pëlcet Zogu - cicëron Macja - mjaullin Balerina - kërcen

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Lexojnë fjalitë e formuara në ushtrimin e tretë dhe qarkojnë shkronjën C. Tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën C në fillim, në mes apo në fund.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **C.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që përmbajnë tingullin **C** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Qarkimin e rrokjeve të përcaktuara në fjalët e dhëna.
- Formimin e e fjalëve nga shkronjat e dhëna.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin C.

Shkruani emrat e tyre poshtë figurave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore:		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;		

<table>
<tr><td>Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td></td></tr>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 101, 102</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën C, c të shtypit sipas modelit.
• Identifikon shkronjën C, c në fjalët e dhëna..
• Ngjyros fjalët që lidhen me figurat.
• Plotëson rrokjet me shkronjën C, c apo ndonjë zanore.
• Bashkon rrokjet nga figurat me formë të njëjtë.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
Celulari, speci, kastraveci</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete:Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i C, c, plastelinë, etiketa me shkronja, rrokje e fjalë që përmbajnë shkronjën C, c në pozicione të ndryshme.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit dëgjojnë këngën për shkronjën C nga you tube. Këngën mund ta gjeni në këtë vegëz:
https://youtu.be/jImmud_S63g.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
Hapet Fletorja e punës në faqen 98 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje. Pyeten :
- Si quhet ky objekt?
- Çfarë forme, ngjyre e madhësie ka?
- Me çka ngjan, nga çka dallon?
- Për çfarë përdoret?
- Cilat janë të mirat dhe të këqijat që kemi nga celulari?</td></tr>
</table>

E shkruaj fjalën Celulari në tabelë dhe kërkoj nga nxënësit të tregojnë se çfarë kam shkruar. Qarkohet shkronja C.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja C, c e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës C. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën c të vogël të shtypit.

Hapi 3. Punë individuale

Pasi ngjyrosin celularin, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës. Krijojnë vija rrethore.

Ushtrimi i parë: Shkruajnë shkronjën ***C*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera

Ushtrimi i dytë: Në disa kavanozë janë futur disa letra me forma dhe ngjyra të ndryshme . Secila copë e letrës përmban nga një shkronjë. Duke renditur ato shkronja formojnë fjalinë *Speca në furrë*.

Ushtrimi i tretë: Plotësojnë rrokjet me shkronjën c apo ndonjë zanore.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë shkronjën ***c*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i pestë: Bashkon rrokjet në figura të njëjta dhe krijon fjalë. Ato i shkruan në vendet përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **C, c** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **C, c** në fjalët e dhëna.
- Plotësimin e rrokjeve me shkronjën **C, c** apo ndonjë zanore.
- Bashkimin e rrokjeve nga figurat me formë të njëjtë.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani dy rreshta me shkronjën **C, c.**

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **C, c.**

Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **C, c.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja C, faqe 77</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• Parashikon ngjarjen në bazë të termave të dhënë.
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• Shenjëzon përgjigjet e sakta
• Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe
Cicërimat, trumcaku, ngrica, grimca</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Parashikim me terma paraprakë
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës C të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, etiketa, globi</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nga nxënësit kërkohet të mendojnë për pak çaste emrat e zogjve që ata dinë. Më pas tregojnë emrat dhe i shkruajmë në tabelë. Nëse kanë përmendur emrin trumcaku, mësuesja qarkon atë emër.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Parashikim me terma paraprakë
Në tabelë shkruhen fjalët: trumcaku, uria, dimri, ndihma, falënderimi. Udhëzohen nxënësit që të mendojnë për 2-3 minuta dhe të krijojnë një tregim që përmban ato figura. Disa nxënës thonë tregimet që krijojnë.

Hapi 2. Lexim me ndalesa</td></tr>
</table>

Teksti ndahet në tri pjesë të cilat lexohen me ndalesa. Bëhen pyetje për të analizuar dhe parashikuar.

Pjesa e parë : nga *Ciu-ciu.....të lënduar.*

- Cili është personazhi i këtij tregimi?
- Në çfarë gjendje ishte ai?
- Cila stinë ishte? Si e kuptuat?
- A do ta ndihmojë ndokush trumcakun?

Pjesa e dytë: nga *Miri.....grimca buke.*

- Si veproi Miri me trumcakun?
- A do të bëje njëjtë edhe ti?
- A do të përmirësohet trumcaku?

Pjesa e tretë: nga *Trumcaku.....cicërimën e tij.*

- A ndodhi ashtu si menduat?
- Çfarë mësuat nga ky tregim?

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shenjëzojnë përgjigjet e sakta, duke u bazuar te përmbajtja e tekstit.

Ushtrimi i dytë: Renditin si duhet fjalët e dhëna për të krijuar fjali me kuptim. Fjalitë e krijuara i shkruajnë dhe i lexojnë.

Ushtrimi i tretë: Shikojnë figurën e picës dhe lexojnë shkronjat në pjesët e saj. Mundohen të renditin ato shkronja dhe zbulojnë fjalën që është fshehur aty-*trumcaku.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë tri fjali nga teksti me të cilat përpiqen të përmbledhin ngjarjen. Ndihmohen nga mësuesi/ja.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Parashikimin e ngjarjes në bazë të termave të dhënë.
- Saktësinë e leximit të tekstit.
- Përgjigjet në pyetjet lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.
- Plotësimin e ushtrimeve.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:
Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.
Mësoni përmbajtjen e tekstit.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shkruan fjalë duke parë figura;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 102,103</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën C, c të dorës sipas modelit.
• Plotëson fjalët me shkronjën C, c në pozicione të ndryshme.
• Shkruan mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.
• Shkruan me të diktuar C, c, C, c.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Gota, guri, gruri, globi</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Dëgjim i këngës
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">• Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës C, c , C, c, të shtypit dhe të dorës, magnetofon.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhjame temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Në magnetofon apo videoprojektor lëshohet kënga "Ciu-ciu o zog i vogël" dhe dëgjohet vetëm strofa e parë.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Analizë dhe sintezë
Përsëritet shkronja C, c e shtypit.
Prezantohet grafiku i shkronjës C.
Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.
Krahasohet e shkronjën C të shtypit.</td></tr>
</table>

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën c.

Hapi 2. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 102 dhe udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë shkronjën c, duke shkruar mbi vija të ndërprera. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë mbi vija shkronjën C duke parë modelin e dhënë. U rikujtohet se emrat e qyteteve fillojnë me shkronjë të madhe

Ushtrimi i tretë: Në ushtrimin e tretë nxënësit lidhin me shigjetë fjalët e tri kolonave për të krijuar fjali. Lexojnë fjalitë e krijuara dhe i shkruajnë ato me shkronja dore. Bazohen te figurat e paraqitura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar C, c , C, c rrokje, fjalë e fjali .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës C, c të dorës sipas modelit.
- Shkrimin mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.
- Shkrimin me të diktuar të C, c rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- Krijimin e fjalive nga fjalët e kolonave.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:

Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën C, c.

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën C, c.

Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën C, c.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

<table>
<tr><td>Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td>Rezultatet e të nxënit të temës:
Shkruan fjalë duke parë figura;</td></tr>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore:
Shkronja C ,fq. 76,77</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
Lexon tekstin saktë dhe bukur.
Tregon përmbajtjen e tekstit.
Gjen fjalë që kanë C në trupin e tyre.
Klasifikon fjalët sipas pozicionit të shkronjës C në trupin e tyre.
Punon figurën e trumcakut sipas modelit të dhënë.</td><td>Fjalë kyçe:
Trumcaku, dimri, djali, ndihma</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Mendo-thuaj-shkruaj
❖ Lexim zinxhir
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete:
Libri i nxënësit, tabelë alfabeti,etiketa me fjali, fletë A4 ushtrimin e përgatitur.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Në tabelë krijohen tri kolona në të cilat do të vendosen veç e veç etiketa ku do të shkruhen emra njerëzish, kafshësh e sendesh. Në etiketa është caktuar vendndodhja e shkronjës C dhe numri i shkronjave të fjalës. Nxënësit gjejnë fjalët që kërkohen. Ai që e gjen del dhe e shkruan.

<table><tr><td>Njerëz</td><td>Kafshë</td><td>Sende</td></tr><tr><td>C _ _ _</td><td>_ _ c _ _</td><td>_ _ _ _ c _</td></tr></table>
Ndihmë - Coli,macja, karroca
Veprimet në situatë
Hapi 1. Lexim zinxhir</td></tr>
</table>

Hapen librat e Abetares në fq.77 dhe u tregohet nxënësve se do të lexojnë zingjir nga dy fjali prej tekstit. Pasi të lexojnë të gjithë, 2-3 nxënës do të thonë përmbajtjen. Sigurohemi që edhe të tjerët ta kenë mësuar. ***Hapi 2.*** Punë individuale Punohet ushtrimi i fundit fq.77. Udhëzohen të prejnë me gërshërë pjesët me të cilat do të krijojnë figurën e trumcakut. Pjesët e prera i ngjesin me ngjitës mbi një letër me ngjyrë, duke u bazuar te modeli i dhënë. Punimet vendosen në këndin e klasës. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:** Nxënësit formojnë fjali me fjalë që përmbajnë shkronjë C në trup të tyre. **Vlerësohen nxënësit për:** • Leximin e tekstit saktë dhe bukur. • Tregimin e përmbajtjes së tekstit. • Gjetjen e fjalëve që kanë C në trupin e tyre. • Klasifikiin e fjalëve sipas pozicionit të shkronjës C në trupin e tyre. • Punimin e trumcakut prej letre.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani me shkrim dore tekstin "Cicërimat e trumcakut".

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara.		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Shkronja Ç, faqe 78		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **Ç.**		**Fjalë kyçe:** Çanta, çorapet, kapuçi, çizmet		

• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **Ç** në pozicione të ndryshme. • Përshkruan figurën qendrore. • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Qarkon rrokjet e përcaktuara në fjalët e dhëna. • Lidh pjesët e fjalisë sipas modelit për të krijuar fjali me kuptim. • Plotëson fjalët me rrokjet që mungojnë. • Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë&sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Ç** të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **Ç,** videoprojektori (nëse ka).	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit në grupe mendojnë dhe tregojnë për veshjet që përdorim në vjeshtë dhe në dimër.
Fjalët shkruhen në tabelë nga mësuesi/ja.

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Para nxënësve paraqiten katër figura: çizmet, kapuçi, çorapet dhe çadra. Së pari emërtojnë ato e pastaj diskutohet rreth tyre.

- Çfarë kanë të përbashkët këto figura?

- Kur përdoren më shumë?

- A i mbani në çantën e shkollës gjatë stinës së dimrit?

- Kush kujdeset për çantën tënde, ti apo prindërit?

Nxënësit tregojnë përvojat e tyre.

Hapi 2. Analizë& sintezë

Hapet libri i Abetares në faqen 78. Shohin figurën dhe përshkruajnë Anën.

-Pse Ana është kaq e lodhur?

Shkruhet titulli "Çanta e Anës është plot me sende" në tabelë dhe lexohet nga nxënësit.

Bëhet analiza fjali-fjalë-rrokje-tingull, për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Ç. U drejtohen pyetjet:

- Sa fjalë ka kjo fjali? - Cila është fjala e parë?- Po e dyta? Vazhdohet kështu me radhë.

-Fjala ÇANTA sa rrokje ka? Ndahet në rrokje: ÇAN -TA. –Pra, kjo fjalë ka dy rrokje.

-Ku ndodhet shkronja Ç? (në fillim)

Nxiten nxënësit të shqiptojnë tingullin e shkronjës Ç që ndodhet edhe në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Udhëzohen të qarkojnë shkronjën Ç në fjalët e vjershës.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të bashkojnë rrokjet për të formuar fjalë. Fjalët e formuara i shkruajnë dhe i lexojnë.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit udhëzohen të qarkojnë rrokjet: *ça, çe, çi,ço, çu, çë* te fjalët e dhëna. Lexojnë me radhë fjalët. Sqarohet kuptimi i tyre nëse ka nevojë.

Ushtrimi i tretë: Lidhin me shigjetë pyetjet me përgjigjet, të cilat janë dhënë me fjalë dhe me figura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë të plota fjalitë e formuara në ushtrimin e tretë dhe qarkojnë shkronjën Ç. Tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën Ç në fillim, në mes apo në fund.

Ndihmë : *Në pranverë çel manushaqja. Ana çoi librin në bibliotekë. Qukapiku çukit pemën*.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Ç.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **Ç** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Qarkimin e rrokjeve të përcaktuara në fjalët e dhëna.
- Formimin e e fjalëve nga shkronjat e dhëna.

Detyrë shtëpie:

Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin Ç.

Shkruani emrat e tyre poshtë figurave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 104, 105		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **Ç, ç** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **Ç, ç** në fjalët e dhëna.. • Ngjyros fjalët që lidhen me figurat. • Plotëson rrokjet me shkronjën **Ç, ç** apo ndonjë zanore • Bashkon rrokjet me formë të njëjtë. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** çadra, çelësi, çorapet **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i shkronjës **Ç, ç,** plastelinë, etiketa me shkronja, rrokje e fjalë që përmbajnë shkronjën **Ç, ç** në pozicione të ndryshme.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesi/ja ka përgatitur disa etiketa që përmbajnë fjalë të cilat në trupin e tyre kanë shkronjën ç. Një nxënës lexon çfarë ka në etiketën e parë dhe mundohet që përmes gjesteve t'iu tregojë të tjerëve se për çfarë bëhet fjalë. Loja vazhdon me nxënës tjerë derisa të zbulohen të gjitha fjalët.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet Fletorja e punës në faqen 104 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje. Pyeten :

- Si quhet ky objekt?
- Çfarë forme ka?
- Për çfarë përdoret?

- A keni ju një të tillë?

Shkruhet fjala Çadra në tabelë dhe kërkoj nga nxënësit të tregojnë se çfarë kam shkruar. Qarkohet shkronja Ç.

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **Ç, ç** e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Ç**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Krahasohet me shkronjën C, duke vërejtur ngjashmërinë dhe dallimin mes tyre.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **ç** të vogël të shtypit.

Hapi 3. Punë individuale

Pasi ngjyrosin çadrën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Shkruajnë shkronjën ***Ç*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera

Ushtrimi i dytë: Udhëzohen të ndjekin figurat që u fillon emri me Ç për të dalë më lehtë nga labirinti.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë shkronjën ***ç*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Ndajnë në rrokje fjalët të cilat janë paraqitur edhe me figura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i pestë: Bashkojnë rrokjet dhe gjysmat e figurave dhe krijojnë fjalë dhe figura të plota. Ato fjalë i shkruajnë në fletore.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Ç, ç** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Ç, ç** në fjalët e dhëna.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje .
- Bashkimin e rrokjeve për të formuar fjalë.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani dy rreshta me shkronjën **Ç, ç.**

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Ç, ç**.

Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **Ç, ç**.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të temës:
Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Ç, faqe 79</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• Parashikon ngjarjen në bazë të termave të dhënë.
• Shenjëzon përgjigjet e sakta.
• Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe
Çanta, çalë-çalë, çelës, çokollatë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Parashikim me anë të titullit dhe ilustrimit
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Ç të shtypit, të madhe e të vogël, etiketa, foto e çantës, etiketa me fjalë.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Para nxënësve paraqitet fotoja e një çanteje të shkollës. Pasi të tregojnë se çfarë po shohin, fotoja ngjitet në tabelë ndërsa në një kënd të tabelës vendosen disa etiketa në të cilat ka emra të sendeve që vendosen apo nuk vendosen në çantën e shkollës. Nëse etiketa mban emrin e sendit që i përket çantës, ajo etiketë vendoset afër çantës. Të tjerat mbesin anash.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Parashikim me anë të titullit dhe ilustrimit
Hapet libri i Abetares në faqen 79. Udhëzohen të lexojnë titullin dhe të shohin figurën për të parashikuar ngjarjen.</td></tr>
</table>

-Çfarë nuk shkon me çantën e Anës?

Hapi 2. Lexim me ndalesa

Teksti ndahet në dy pjesë të cilat lexohen me ndalesa. Bëhen pyetje për të analizuar dhe parashikuar ngjarjen.

Pjesa e parë : nga *Ana.....në çantë?*

- Cilat janë personazhët e këtij tregimi?
- Pse ishte e lodhur Ana?

Sqarohet fjala çalë-çalë.

- Si ishte bërë çanta e saj?
- Kush e vuri re këtë?
- Çfarë do të ndodhë më tej?

Pjesa e dytë: nga *Ana.....me vete.*

- Cilat gjëra kishte Ana në çantë?
- A të ka ndodhur ty ndonjëherë kështu?
- Çfarë e porositi babai?

-Çfarë mësuat nga ky tregim?

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shenjëzojnë përgjigjet e sakta, duke u bazuar te përmbajtja e tekstit.

Ushtrimi i dytë: Qarkojnë fjalët e shkruara saktë, nga dy fjalë të dhëna për secilën figurë. Fjalët e shkruara saktë i lexojnë para të tjerëve.

Ushtrimi i tretë: Shikojnë figurën e dhënë dhe lexojnë dy fjalitë. Fjalinë e cila përputhet me figurën e shënojnë me ✓.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë tri fjali nga teksti me të cilat mundohen të përmbledhin ngjarjen. Ndihmohen nga mësuesi/ja.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Parashikimin e ngjarjes në bazë të titullit dhe figurës.
- Përgjigjet në pyetjet lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.

• Shenjëzimin e përgjigjeve të sakta.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime. Mësoni përmbajtjen e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 105,106		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Ç, ç të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me shkronjën Ç, ç në pozicione të ndryshme**.** • Shkruan mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore. • Shkruan me të diktuar **Ç,ç**, Ç, Ç, rrokje, fjalë e fjali. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Çokollata, çamçakëzi **Teknika dhe strategji:** ❖ Dëgjim i këngës ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		
• **Burimet e informacionit dhe mjete:** Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese , grafiku i shkronjës **Ç, ç**, Ç, Ç të shtypit dhe të dorës, magnetofon apo videoprojektor.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake*** Në magnetofon apo videoprojektor lëshohet kënga " Çokolata yummy-yummy" dhe dëgjohet nga nxënësit. Mund ta gjeni në këtë vegëz: https://www.youtube.com/ëatch?v=1lXKr_R9Zkc ***Veprimet në situatë***				

Hapi 1. Analizë dhe sintezë

Përsëritet shkronja Ç,ç e shtypit.

Prezantohet grafiku i shkronjës Ç,

Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Krahasohet e shkronjën C të shtypit. Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën Ç.

Hapi 2 .Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 105 dhe udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë shkronjën Ç duke shkruar mbi vija të ndërprera.Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë mbi vija shkronjën Ç duke parë modelin e dhënë. U rikujtohet se emrat e njerëzve fillojnë me shkronjë të madhe.

Ushtrimi i tretë: Në ushtrimin e tretë nxënësit shkruajnë me shkronja dore fjalitë e dhëna. Figurat që janë prezente në ato fjali i kthejnë në fjalë. Lexojnë fjalitë e formuara.

Ushtrimi i katërt: I përgjigjen pyetjes së dhënë duke u bazuar te figura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë me të diktuar **Ç,ç**, Ç, Ç rrokje, fjalë e fjali .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës Ç, Ç të dorës sipas modelit.
- Shkrimin mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.
- Shkrimin me të diktuar të shkronjës Ç, Ç, rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- Krijimin e fjalive nga fjalët dhe figurat.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën Ç, Ç.

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Ç, Ç.

Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën Ç, Ç.

	Lënda: Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi				
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Shkronja Ç ,fq.78, 79		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon tekstin saktë dhe me intonacion. • Tregon përmbajtjen e tekstit. • Formon rrokje, fjalë e fjali që përmbajnë shkronjën Ç. • Rendit fjalët për të formuar fjali. • Krijon fjali bazuar në figurë.		**Fjalë kyçe** Ana, çanta, biçikleta **Teknika dhe strategji:** ❖ Copëza të përziera ❖ Lexim zinxhir ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti, etiketa me fjali, fletë A4 ushtrimin e përgatitur		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit ndahen në treshe. Njëri thotë një rrokje që përmban shkronjën Ç, tjetri gjen dhe thotë një fjalë që e përmban atë rrokje, ndërsa i treti krijon një fjali me atë fjalë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Copëza të përziera

Nxënësve në dyshe u shpërndahen etiketa me fjalë të ngatërruara. Udhëzohen t'i renditin ato për të formuar fjali me kuptim.

Hapi 2. Lexim zinxhir

Hapen librat e Abetares në fq.79 dhe u tregohet nxënësve se do të lexojnë secili nga dy fjali prej tekstit. Pasi të lexojnë të gjithë, nga 2-3 nxënës do të thonë përmbajtjen, hyrjen i pari, pjesën e dytë i dyti ndërsa përfundimin i treti. Sigurohemi që të gjithë ta kenë mësuar dhe të tregojnë porosinë e tregimit..

Hapi 3. Punë individuale

Punohet ushtrimi i fundit fq.79. Udhëzohen të shikojnë figurën dhe të krijojnë sa më shumë fjali për të përshkruar atë dhe sa më shumë herë të përdorin shkronjën Ç.

Ndihmë : *Ana ka një biçikletë. Biçikleta ka rrota. Ana pastron biçikletën me furçë. Ana nuk i ka flokët kaçurrela....*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Lexojnë fjalitë e krijuara. Zgjidhet shkrimi më i mirë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e tekstit saktë dhe me intonacion.
- Tregimin e përmbajtjes së tekstit.
- Formon rrokje, fjalë e fjali që përmbajnë shkronjën Ç.
- Renditjen e fjalëve për të formuar fjali.
- Krijimin e fjalive bazuar në figurë.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani me shkrim dore tekstin "Çanta e Anës".

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Shkronja Gj, faqe 80		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **Gj.**		**Fjalë kyçe:** Gjirafa, gjuha shqipe		

• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **Gj** në pozicione të ndryshme. • Përshkruan figurën qendrore. • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Ngjyros shkronjat e mësuara. • Gjen fjalë që përmbajnë tingullin **Gj** në pozicione të ndryshme.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Gj** të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **Gj**, gjëegjëza.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësve u tregohet një gjëegjëzë për gjirafën.

Jam e bukur e qafëgjatë
Shumë kafshë më kanë lakmi
Se qëndroj mbi të gjitha
Dhe ec plot krenari.

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo

Paraqitet para nxënësve një foto e gjirafës dhe nxiten nxënësit të komentojnë rreth saj.

- Çfarë po shihni?

- Çfarë dini për gjirafën?

- Ku jeton ajo?

- Me se ushqehet?

Shkruhet fjala GJIRAFA në tabelë dhe lexohet nga nxënësit.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Gj.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: GJI-RA-FA.

-Pra, fjala GJIRAFA ka tri rrokje. Ku ndodhet shkronja Gj? (Në fillim)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 80 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës Gj që ndodhet në krye të faqes.Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin.

Ndihmohen me pyetjet:

- Çfarë shikoni në figurë?
- Çfarë po bën vogëlushi me prindërit e tij?
- Si ndihet ai në këtë shëtitje?
- Çfarë mendoni, në cilën gjuhë po flasin ata?

Shkruhet në tabelë fjalia "Gjuha shqipe është e bukur" dhe lexohet nga nxënësit.

Bëhet analiza fjali-fjalë-rrokje-tingull.

-Sa fjalë ka fjalia? -Cila është fjala e parë? –Po e dyta?...e kështu me radhë.

-Fjala **Gjuha** sa rrokje ka? –Pra, **Gju-ha** ka dy rrokje. -Ku ndodhet shkronja Gj? (në fillim)

Lexohen nga mësuesi/ja vargjet e vjershës së Gjergj Fishtës.

U shpjegohen fjalët më të vështira për t'u kuptuar nga nxënësit, meqenëse është shkruar në dialektin gegë. Pyeten:

- Me çfarë e krahason poeti Gjergj Fishta gjuhën shqipe?

Mësuesi/ja lexon vargjet e Naim Frashërit. Pyeten:

- Po Naim Frashëri çfarë thotë për gjuhën shqipe?
- A mendoni edhe ju se gjuha jonë është e bukur?

Bisedohet me nxënësit se sado që flasim gjuhë të huaja, prapëseprapë gjuha jonë është më e bukura. Ne duhet të jemi krenar për gjuhën tonë, dhe duhet të mësojmë ta flasim dhe ta shkruajmë atë sa më bukur.

Lexohen vjershat nga nxënës të ndryshëm.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit ngjyrosin shkronjat e mësuara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën **Gj** në fillim, në mes apo në fund.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Gj.**

• Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **Gj** në pozicione të ndryshme. • Përshkrimin e figurës qendrore. • Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Ngjyrosjen e shkronjave të mësuara.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Lexoni vargjet e vjershave për Gjuhën shqipe. Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin **Gj.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 107-108		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **Gj, gj** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **Gj, gj** në fjalët e dhëna.. • Ngjyros fjalët që lidhen me figurat. • Shkruan emrat e figurave të dhëna. • Plotëson rrokjet me shkronjën **Gj, gj** apo ndonjë zanore. • Ndan në rrokje fjalët. • Lidh fjalitë me figurat përkatëse. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Gjyshërit, shkronja Gj, gj e madhe dhe vogël e shtypit **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **Gj, gj,** plastelinë, etiketa me shkronja,		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:**		

rrokje e fjalë që përmbajnë shkronjën **Gj, gj** në pozicione të ndryshme.	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë këngën e shkronjës Gj.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet fjala GJYSHËRIT në tabelë dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

-A i doni ju shumë gjyshërit?

-Si e kaloni kohën me ta?

-A i dëgjoni këshillat e tyre?

-Me cilën shkronjë fillon kjo fjalë?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **Gj, gj** e madhe dhe e vogël e shtypit.

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Gj**. Analizohet në elementet përbërëse dhe mënyra e formimit të saj nga dy shkronja, G dhe j. Pra **G + j = Gj.** Shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **gj** të vogël të shtypit.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 107.

Pasi ngjyrosin gjirafën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës. Krijojnë vija të drejta e rrethore.

Ushtrimi i parë: Shkruajnë shkronjën ***Gj, gj*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit vërejnë figurat dhe shkruajnë fjalët me shkronjat e dhëna.

Ushtrimi i tretë: Plotësojnë rrokjet me shkronjën **gj** apo ndonjë zanore.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë emrat e figurave të dhëna.

Ushtrimi i pestë: Udhëzohen të ndajnë në rrokje fjalët e dhëna në tabela.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i gjashtë: Lexojnë fjalitë dhe i lidhin ato me figurat përkatëse.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Gj, gj,** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Gj, gj,** në fjalët e dhëna.
- Plotësimin e rrokjeve me shkronjën **Gj, gj** apo ndonjë zanore.
- Shkrimin e saktë të emrave të figurave të dhëna.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- Lidhjen e fjalive me figurat përkatëse.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën **Gj, gj.**

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Gj, gj.**

Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **Gj, gj.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7
Njësia mësimore: Shkronja Gj, faqe 81	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurën që ilustron tekstin. • Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës. • Shenjëzon përgjigjet e sakta duke u bazuar në përmbajtjen e tekstit. • Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.	**Fjalë kyçe** Lura, gjuha shqipe, gjyshërit. **Teknika dhe strategji:** ❖ Lexim i drejtuar ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Gj të shtypit, të madhe e të vogël, etiketa me shkronja, rrokje e fjalë.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:**

	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Secilit nxënës i jepet në dorë nga një etiketë, disa prej të cilave kanë shkronja, disa rrokje e disa fjalë. Etiketat janë me ngjyra të ndryshme. Bëhen bashkë nxënësit që kanë në dorë etiketat me ngjyrë të njëjtë. I renditin si duhet shkronjat, rrokjet e fjalët. Të renditura si duhet, ngjiten në tabelë dhe lexohen nga nxënësit.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim i drejtuar

-Hapet libri faqe 81 në Abetare dhe u paraqitet titulli në tabelë.

-Nxënësit nxiten të mendojnë për 2-3 minuta, të tregojnë se për çfarë do të mësojnë, bazuar në titull dhe figurë.

Teksti lexohet së pari nga mësuesi-ja. Pastaj kërkohet nga nxënësi të lexojnë në heshtje dhe të qarkojnë në tekst fjalët e panjohura të cilat do të sqarohen më pas.

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pasi të kenë lexuar tekstin, u drejtohen pyetjet:

- Sa vjeç është Lura?
- Ku ka lindur ajo?
- Po tani, ku ndodhet?
- Për çfarë e ndihmojnë gjyshërit Lurën?
- Si ndihet ajo?
- Po ta takonit Lurën, çfarë do t'i thonit?

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shenjëzojnë përgjigjen e saktë, duke u bazuar te përmbajtja e tekstit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxjerrin mesazhin nga teksti i mësuar.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Parashikimin e ngjarjes në bazë të titullit dhe figurës.

• Përgjigjet e sakta në pyetjet lidhur me përmbajtjen e tekstit. • Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme: Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime. Mësoni përmbajtjen e tekstit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 108-109		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Gj, gj të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me shkronjën Gj, gj në pozicione të ndryshme**.** • Shkruan mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore. • Shkruan me të diktuar **Gj, gj,** Gj, gj, rrokje, fjalë e fjali. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Gjeli, gjilpëra, gjashta, gjarpri **Teknika dhe strategji:** ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale ❖ Lojë fjalësh		
• **Burimet e informacionit dhe mjete:** Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Gj, gj,** Gj, gj, të shtypit dhe të dorës, videoprojektori ose foto të figurave që përmbajnë shkronjën **Gj.**		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Në tabelë apo videoprojektor paraqiten foto të disa sendeve: *gjeli, gjilpëra, gjashta, gjarpri*. Nga nxënësit kërkohet të tregojnë se çfarë kanë të përbashkët këto figura. Pasi të gjejnë këtë, tregojnë emrat e tyre, të cilët mësuesja i shkruan poshtë figurave. Lihet vend për të shkruar ato fjalë me shkronja dore.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Analizë dhe sintezë

Përsëritet shkronja Gj, gj e shtypit.

Prezantohet grafiku i shkronjës Gj.

Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Krahasohet e shkronjën Gj të shtypit. Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **gj**.

Hapi 2. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 108 dhe udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë shkronjën gj, duke shkruar mbi vija të ndërprera. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë mbi vija shkronjën Gj duke parë modelin e dhënë. U rikujtohet se emrat e qyteteve fillojnë me shkronjë të madhe.

Ushtrimi i tretë: Nxënësit lexojnë fjalitë e dhëna dhe i shkruajnë ato me shkronja dore.

Hapi 3. Lojë fjalësh

Mësuesja thotë fjalë që kanë në trup të tyre tingullin Gj ose jo. Sa herë dëgjojnë fjalë që përmbajnë Gj, nxënësit ngriten në këmbë, në të kundërtën ata ulen.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar **Gj,gj** , Gj, gj, rrokje, fjalë e fjali .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës Gj, gj të dorës sipas modelit.
- Shkrimin mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.

• Shkrimin me të diktuar të Gj, gj**,** rrokjeve, fjalëve e fjalive. • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga dy rreshta me shkronjën Gj, gj. Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Gj, gj. Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën Gj, gj.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Shkronja Gj, fq. 80-81		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit orës mësimore: Nxënësi: • Lexon tekstin saktë dhe me intonacionin e duhur. • Ritregon përmbajtjen e tekstit. • Lidh fjalët për të formuar fjali. • Formulon fjali me fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Gj.		**Fjalë kyçe:** Gjuha shqipe, Lura, gjyshërit **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Lexim zinxhir ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti, grafiku i shkronjës **Gj, gj**, Gj, gj të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		
Organizimi i orës së mësimit				

Veprimtari paraprake

Nxënësit udhëzohen që të thonë emra të njerëzve, të kafshëve dhe sendeve që kanë në trupin e tyre shkronjën Gj. Shkruhen nga nxënësit në tabelë në tri kolona të veçanta.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Duke u bazuar në vargjet e mësuara dhe diskutimet e mëparshme, nxiten nxënësit të shprehin mendimet tyre për gjuhën shqipe, të cilat paraqiten në tabelë.



Hapi 1. Lexim zinxhir

Hapen librat e Abetares në fq.81 dhe u tregohet nxënësve se do të lexojnë secili nga dy fjali prej tekstit. Pasi të lexojnë të gjithë, 2-3 nxënës do të thonë përmbajtjen. Sigurohemi që edhe të tjerët ta kenë mësuar.

Hapi 2. Punë individuale

Punohet ushtrimi i fundit fq.81. Lidhin fjalët e dhëna për të formuar fjali. Lexojnë me zë fjalitë e formuara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësve u shpërndahen etiketa me fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Gj. Secili mendon dhe shkruan me shkronja dore një fjali me atë fjalë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e tekstit saktë dhe me intonacionin e duhur.
- Ritregimin e përmbajtjes së tekstit.
- Lidhjen e fjalëve për të formuar fjali.
- Formulimin e fjalive me fjalë që përmbajnë shkronjën Gj në trup të tyre.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani me shkrim dore gjashtë fjali të tekstit "Lura flet gjuhën shqipe".

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Ll, faqe 82</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin Ll.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin Ll në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Formon fjalë bazuar në figura dhe shkronjat pranë tyre.
• Lidh pjesët e fjalisë sipas modelit për të krijuar fjali me kuptim.
• Shkruan fjalë që mbarojnë me të njëjtën rrokje.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Papagalli, kërmilli, flutura</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-Analizo
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Ll të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën Ll, videoprojektori (nëse ka).</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake
Paraqiten para nxënësve foto të shpendëve si: pëllumbi, papagalli, dallëndyshja.
Nxënësit vëzhgojnë fotot dhe identifikojnë ato. Shkruhen nga mësuesi/ja emrat e tyre poshtë figurave.

Veprimet në situatë
Hapi 1 .Vëzhgo-Analizo
Orientohet vëmendja e nxënësve te papagalli duke i nxitur të komentojnë rreth tij.
U drejtohen pyetjet:
-Çfarë dini për papagallin?</td></tr>
</table>

-Si duket? Përshkruani.

-Çfarë e dallon atë nga shpendët e tjerë?

-Ta shqiptojmë së bashku fjalën PAPAGALLI**.**

Shkruhet fjala PAPAGALLI në tabelë dhe lexohet nga nxënësit..

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Ll.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: PA-PA-GA-LLI.

-Pra, fjala PA-PA-GA-LLI ka katër rrokje. Ku ndodhet shkronja Ll? (Në mes)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 82 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës Ll që ndodhet në krye të faqes.Theksohet se është tingull bashkëtingëllor.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë?

-Si është moti?

-Kë takoi kërmilli?

-Si mendoni, për çfarë po bisedojnë ata?

Shkruhet në tabelë fjalia "Një ditë kërmilli takoi fluturën" dhe lexohet nga nxënësit.

Bëhet analiza fjali-fjalë-rrokje-tingull.

-Sa fjalë ka fjalia? -Cila është fjala e parë? –Po e dyta?...e kështu me radhë.

-Fjala **kërmilli** sa rrokje ka? Pra, **kër-mi-lli** ka tri rrokje. -Ku ndodhet shkronja **ll**? (në mes)

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Vëzhgojnë figurat dhe renditin shkronjat përreth tyre për të formuar emrat që u përkasin atyre figurave. Lexojnë emrat.

Ushtrimi i dytë: Lexojnë fjalët në balona dhe lidhin ato duke formuar fjali. Shkruajnë fjalitë dhe i lexojnë ato me zë para klasës.

Ushtrimi i tretë: Lidhin fjalët që mbarojnë me të njëjtën rrokje dhe i shkruajnë ato.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën **Ll** në fillim, në mes apo në fund.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Ll.**

• Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **Ll** në pozicione të ndryshme. • Përshkrimin e figurës qendrore. • Formimin e fjalëve bazuar në figura dhe shkronjat pranë tyre. • Lidhjen e pjesëve të fjalisë sipas modelit për të krijuar fjali me kuptim. • Shkrimin e fjalëve që mbarojnë me të njëjtën rrokje. .
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin **Ll.** Shkruani emrat e tyre poshtë figurave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 110-111		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **Ll, ll** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **Ll, ll** në fjalët e dhëna.. • Ndan fjalët në rrokje sipas modelit të dhënë. • Lexon fjalët duke ngjitur shkallët me rrokje. • Shkruan emrat e figurave të paraqitura. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Llamba, shkronja Ll, ll e madhe dhe e vogël e shtypit **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **Ll, ll,** plastelinë, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **Ll, ll** në pozicione të ndryshme.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:**		

	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë këngën për shkronjën **Ll.**

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet në tabelë fjala LLAMBA dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve::

- Cila fjalë është shkruar në tabelë?
- Për çfarë na shërben llamba?
- Me cilën shkronjë fillon kjo fjalë?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **Ll, ll** e madhe dhe e vogël e shtypit.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Ll.** Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e formimit të saj nga dy shkronja L dhe l. Pra: **L + l = Ll**. Shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **ll** të vogël të shtypit.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 110 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin llambën, nxënësit udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Shkruajnë shkronjën ***Ll*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i dytë: Udhëzohen nxënësit të ngjitin shkallët duke lexuar fjalët që formohen nga rrokjet.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë shkronjën ***ll*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë emrat e figurave të dhëna.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i pestë: Ndajnë në rrokje fjalët e dhëna në tabela.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Ll. ll** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Ll, ll** në fjalët e dhëna.

• Ndarjen e fjalëve në rrokje sipas modelit të dhënë. • Leximin e fjalëve duke ngjitur shkallët me rrokje. • Shkrimin e emrave të figurave të dhëna. • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga dy rreshta me shkronjën **Ll, ll.** Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Ll, ll**. Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën **Ll, ll.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Ll, faqe 83</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• Lexon tekstin saktë dhe me intonacion.
• Përgjigjet në pyetjet që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
• Diskuton dhe argumenton rreth përgjigjeve që jep.
• Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe
Kërmilli, flutura</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë -gjëegjëza
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Ll, e madhe dhe e vogël e shtypit, gjëegjëza për kërmillin dhe fluturën.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake</td></tr>
</table>

Nxënësit në dyshe udhëzohen të gjejnë fjalë me shkronjën Ll në trup të tyre, në pozicione të ndryshme. Njëri nxënës tregon fjalën, kurse tjetri e ndan atë në rrokje. Aktivizohen sa më shumë nxënës.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lojë-gjëegjëza

Para nxënësve paraqiten dy gjëegjëza: për kërmillin dhe fluturën.

Kudo që shkon
kudo që vete,
shtëpinë përherë
e ka e vete.
(Kërmilli)

Është e bukur, krahëlehtë,
qëndron mbi lule,
por nuk është bletë.
(Flutura)

Hapi 2. Lexim me ndalesa

Hapet libri faqe 82 në Abetare dhe paraqitet titulli në tabelë.

Teksti lexohet nga mësuesi/ja me ndalesa. Pas çdo ndalese nxënësve u drejtohen pyetje për të analizuar dhe parashikuar ngjarjen.

Ndalesa e parë: *Na ishte.....krahë të hollë.*

- Për kë po flitet në tekst?
- Pse ndihej i lodhur kërmilli?
- Me kë u takua kërmilli?
- Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa e dytë: *Ajo fluturonte.....pranë.*

- Çfarë bënte flutura?
- Çfarë i tha ajo kërmillit?
- Si mendoni, për çfarë e donte flutura shtëpinë me vete?

Ndalesa e tretë: *Pas pak.....shtëpisë së vet.*

- Si veproi kërmilli kur filloi të binte shi?
- Çfarë ndodhi me fluturën?
- Si përfundon ngjarja?

Lexohet teksti me intonacion nga disa nxënës.

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shenjëzojnë përgjigjet e sakta duke u bazuar te përmbajtja e tekstit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë tri fjali nga teksti me të cilat përpiqen të përmbledhin ngjarjen. Ndihmohen nga mësuesi/ja.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Saktësinë e leximit të tekstit.
- Përgjigjet në pyetjet lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Pyetjet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.
Mësoni përmbajtjen e tekstit " Kërmilli dhe flutura".

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 111-112		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Ll, ll të dorës sipas modelit. • Shkruan mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore. • Shkruan me të diktuar **Ll, ll, Ll, ll,** rrokje, fjalë e fjali. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Shkronja e madhe dhe e vogël e dorës Ll, ll. **Teknika dhe strategji:** ❖ Copëza të përziera ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		

• **Burimet e informacionit dhe mjete:** Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Ll, ll**, **Ll, ll** të shtypit dhe të dorës, etiketa e fjalë që përmbajnë shkronjën **Ll,** kub prej kartoni me rrokje në faqet e tij.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Zhvillohet një lojë me nxënësit. Mësuesi/ja ka përgatitur një kub prej kartoni, në faqet e të cilit janë shkruar rrokje që përmbajnë shkronjën Ll. Nxënësit hedhin kubin dhe lexojnë rrokjen që u bie. Më pas do të gjejnë fjalë që përmbajnë atë rrokje.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Copëza të përziera

Nxënësve në dyshe u shpërndahen etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Ll, të cilat duhet t'i renditin për të formuar fjali me kuptim. Lexojnë fjalitë e formuara para klasës.

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Përsëritet shkronja Ll, ll e shtypit.

Prezantohet grafiku i shkronjës Ll.

Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Krahasohet me shkronjën Ll të shtypit. Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën ll.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 111 dhe udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën ll, duke shkruar mbi vija të ndërprera. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën Ll duke ndjekur modelin e dhënë. Shkruajnë fjalinë dhe e lexojnë atë.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë me shkronja dore fjalitë dhe zëvendësojnë figurat me fjalë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar **Ll, ll**, **Ll, ll,** rrokje, fjalë e fjali .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës Ll, ll të dorës sipas modelit.
- Shkrimin mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.
- Shkrimin me të diktuar të Ll, ll**,** rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie:
Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën Ll, ll.

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Ll, ll**.**

Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën Ll, ll**.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Poezia, përrallëza, përralla, tregimi, gjëegjëza, fjalët e urta, mesazhe urimi, letra të thjeshta, porosi, shënime personale.	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Përflet ngjarjen kryesore në tekst;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7
Njësia mësimore: Shkronja Ll, fq 82-83	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon tekstin saktë dhe me intonacion.. • Tregon përmbajtjen e tekstit. • Përgjigjet duke argumentuar mendimet e tij/saj. • Nxjerr mesazhin e tregimit.	**Fjalë kyçe:** Kërmilli, flutura **Teknika dhe strategji:** ❖ Lexim zinxhir ❖ Punë individuale ❖ Rrjeti i diskutimit
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, tabelë alfabeti, shkronja **Ll, ll,** Ll, ll, etiketa me fjali.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës

	Lidhja me temat ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesi-ja ka përgatitur disa etiketa që përmbajnë fjalë të cilat në trupin e tyre kanë shkronjën Ll. Një nxënës lexon çfarë ka në etiketën e parë dhe mundohet që përmes gjesteve t'iu tregojë të tjerëve se për çfarë bëhet fjalë. Loja vazhdon me nxënës të tjerë derisa të zbulohen të gjitha fjalët.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim zinxhir

Hapen librat e Abetares në fq.83 dhe u tregohet nxënësve se do të lexojnë secili nga dy fjali të tekstit. Nxiten të lexojnë saktë dhe bukur, duke respektuar shenjat e pikësimit. Pasi të lexojnë të gjithë, 2-3 nxënës do të thonë përmbajtjen.

Hapi 2. Punë individuale

Punohet ushtrimi i fundit në fq. 83. Nxënësit lexojnë përshkrimet për kërmillin dhe fluturën, dhe shenjëzojnë ato që janë sakta.

Hapi 3. Rrjeti i diskutimit

Nxënësve u drejtohet pyetja e cila shkruhet në tabelë:

A kishte të drejtë kërmilli që ankohej? Po/ Jo Pse?

Nxënësit ndahen në dy grupe sipas përgjigjes që japin dhe argumentojnë mendimin e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Tregojnë mesazhin e tregimit.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e tekstit saktë dhe me intonacion.
- Tregimin e përmbajtjes e tekstit.
- Përgjigjet duke argumentuar mendimet e tij/saj.
- Nxjerrjen e mesazhit të tregimit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani me shkronja dore pesë fjali nga teksti “Kërmilli dhe flutura”.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.</td><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të temës:
Zhvillon dëshirën për të lexuar tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Y, fq. 84</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin Y.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin Y në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Ndan fjalët në rrokje.
• Lidh fjalët me figurat përkatëse.
• Formon fjalë të reja sipas modelit të dhënë.
• Plotëson fjalitë me fjalët që mungojnë.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Iliri, hëna, yjet</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-Analizo
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë dhe sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Y të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën Y, magnetofon, CD.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit dëgjojnë këngën “Ylli i vogël lart në qiell” nga you tube. Këngën mund ta gjeni në këtë vegëz: https://youtu.be/sCGXArvNg88

Veprimet në situatë
Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo
Paraqiten para nxënësve foto të diellit, hënës dhe yjeve. U drejtohen pyetjet:
- Çfarë shikoni?
- Kur e shohim diellin?
- Po hënën dhe yjet?</td></tr>
</table>

- Si duken ato?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre duke vëzhguar figurat.

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 84 të Abetares. Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje. Ndihmohen me pyetjet:

- Çfarë shikoni në figurë?
- Është ditë apo natë?
- Nga e kuptoni që është natë?
- Çfarë po bën vogëlushi?

Hapi 3. Analizë dhe sintezë

Shkruhet në tabelë fjalia "Iliri ngjyrosi hënën edhe yjet" dhe lexohet nga nxënësit.

Bëhet analiza fjali-fjalë-rrokje-tingull.

-Sa fjalë ka fjalia? -Cila është fjala e parë? – Po e dyta?...e kështu me radhë.

-Fjala ***yjet*** sa rrokje ka?

Pra, fjala ***y-jet*** ka dy rrokje.

- Ku ndodhet shkronja **Y**? (në fillim)

Theksohet se është tingull zanor. Përsëriten të gjitha zanoret e mësuara.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit lexojnë dhe shkruajnë zanoret.

Ushtrimi i dytë: Udhëzohen të ndajnë fjalët në rrokje. Më pas, tregojnë para klasës ndarjen që kanë bërë.

Ushtrimi i tretë: Lexojnë fjalët dhe i lidhin me figurat përkatëse.

Ushtrimi i katërt: Lexojnë gjëegjëzën dhe duke u bazuar te figura gjejnë zgjidhjen.

Ushtrimi i pestë: Formojnë dhe shkruajnë fjalët sipas modelit. Lexojnë fjalët e reja të krijuara.

Ushtrimi i gjashtë: Plotësojnë fjalinë me fjalët që mungojnë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën Y në pozicione të ndryshme.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Y.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **Y** në pozicione të ndryshme.

• Përshkrimin e figurës qendrore. • Ndarjen e fjalëve në rrokje. • Lidhjen e fjalëve me figurat përkatëse. • Formimin e fjalëve të reja sipas modelit të dhënë. • Plotësimin e fjalive me fjalët që mungojnë.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin Y. Shkruani poshtë figurave emrat e tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7
Njësia mësimore: Fletore pune faqe 113-114	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **Y, y** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **Y, y** në fjalët e dhëna. • Ndan fjalët në rrokje sipas modelit të dhënë. • Shkruan emrat e figurave të paraqitura. • Formon fjalë bazuar në figura dhe shkronjat pranë tyre. • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** Ylberi, shkronja Y, y e madhe dhe e vogël e shtypit **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete:	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës

Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **Y, y** magnetofon, Cd, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **Y, y** në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Paraqiten para nxënësve figura të ndryshme, emrat e të cilave përmbajnë shkronjën Y në trup të tyre. Shembull: qytet, sy, yll, fytyrë, detyrë. Udhëzohen nxënësit në grupe të formojnë nga një fjali për to.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet fjala **YLBERI** në tabelë dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

- Kur del ylberi?

- Si duket ai?

- Sa ngjyra ka ylberi?

-Cila ju pëlqen më shumë?

-Me cilën shkronjë fillon kjo fjalë?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **Y** e shtypit, e madhe dhe e vogël .

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Y**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën **y** të vogël.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 113.

Pasi ngjyrosin ylberin, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën Y. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Ngjyrosin zanoret dhe i tregojnë me zë.

Ushtrimi i tretë: Vëzhgojnë figurat dhe renditin shkronjat përreth tyre për të formuar emrat që u përkasin atyre figurave. Lexojnë emrat e shkruar.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë shkronjat me të cilat fillojnë emrat e figurave të dhëna. Më pas lexojnë emrat e formuar nga këto shkronja.

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë shkronjën **y** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i gjashtë: Shkruajnë emrat e figurave të paraqitura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i shtatë: Fjalët e paraqitura në tabela i ndajnë në rrokje. Më pas, tregojnë ndarjen që kanë bërë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Y, y** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Y, y** në fjalët e dhëna.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje sipas modelit të dhënë.
- Shkrimin e emrave të figurave të paraqitura.
- Formimin e fjalëve bazuar në figura dhe shkronjat pranë tyre.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën **Y, y**.

Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Y, y**.

Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën **Y, y.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë duke parë figura;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Shkronja Y, fq. 85		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
Lexon tekstin qartë dhe saktë.
Përgjigjet në pyetjet që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
Tregon përmbajtjen e tekstit me dy-tri fjali.
Shkruan ngjyrat e ylberit.</td><td>Fjalë kyçe:
Iliri, vizatimi, ngjyrat, nëna

Teknika dhe strategji:
❖ Pyetja sjell pyetjen
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës A të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, etiketa me emrat e nxënësve, mjete shkrimi, ngjyra.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit dëgjojnë këngën e shkronjës Y.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Pyetja sjell pyetjen
Nxënësve u drejtohen pyetjet:
- Ju pëlqen juve të vizatoni?
- Çfarë keni dëshirë të vizatoni më tepër? Pse?
- Cilat ngjyra i përdorni më shumë?

Hapi 2. Lexim me ndalesa
Hapet libri faqe 85 në Abetare dhe paraqitet titulli në tabelë.
Teksti lexohet nga mësuesi/ja me ndalesa. Pas çdo ndalese nxënësve u drejtohen pyetje për të analizuar dhe parashikuar ngjarjen.
Ndalesa e parë: Iliri.....të verdhë.
- Çfarë pikturoi Iliri?
- Me cilat ngjyra i ngjyrosi qiellin, hënën dhe yjet?
- A mendoni se do të jetë i kënaqur e vizatimin e tij?
Ndalesa e dytë: Pasi e mbaroi.....hëna ime.
- Si ndihej Iliri pasi mbaroi pikturën?</td></tr>
</table>

- Çfarë i tha ai nënës? Më pas lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali. ***Hapi 3.*** Punë individuale **Ushtrimi i parë:** Nxënësit lexojnë vargjet e paraqitura për ylberin. Më pas plotësojnë duke shkruar ngjyrat e ylberit. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura** Lexojnë tekstin me intonacionin e duhur. **Vlerësohen nxënësit për:** • Leximin e tekstit saktë dhe bukur. • Përgjigjet në pyetjet që lidhen me përmbajtjen e tekstit. • Tregimin e përmbajtjes së tekstit me dy-tri fjali. • Shkrimin e ngjyrave të ylberit
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Mësoni përmbajtjen e tekstit " Lapsat me ngjyra".

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt, shkronjat, rrokjet, fjala, fjalia, shenjat e pikësimit, intonacioni, foljet ndihmëse kam dhe jam, emri, mbiemri, përemri.		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore: Fletore pune, fq. 114-115		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Y, y të dorës sipas modelit. • Shkruan mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore. • Shkruan me të diktuar **Y, y, Y, y,** rrokje, fjalë e fjali. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Shkronja Y, y e madhe dhe e vogël e dorës. **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë		

	❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Y, y, Y, y** të shtypit dhe të dorës,	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësve u thuhen fjalë që kanë në trup të tyre shkronjën Y ose jo. Sa herë përmendet një fjalë që përmban shkronjën Y, nxënësit ngriten në këmbë, kurse ulen kur fjala e thënë nga mësuesi/ja nuk përmban shkronjën Y.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë në tabelë të gjitha zanoret dhe bashkëtingëlloret e mësuara



Hapi 2. Analizë & sintezë

Përsëritet shkronja Y, y e shtypit.

Prezantohet grafiku i shkronjës Y.

Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Krahasohet me shkronjën Y të shtypit. Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën y.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 114 dhe udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën y. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit do të shkruajnë shkronjën Y duke ndjekur modelin e dhënë. Shkruajnë fjalët dhe i lexojnë ato. U rikujtohet se emrat e njerëzve shkruhen e shkronjë të madhe.

Ushtrimi i tretë: Udhëzohen të shkruajnë me shkronja dore fjalitë duke zëvendësuar figurat e paraqitura me fjalë. Lexojnë me zë fjalitë e shkruara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar **Y, y**, Y, y, rrokje, fjalë e fjali .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës Y, y të dorës sipas modelit.
- Shkrimin mbi vija të ndërprera për të formuar rrokje e fjalë me shkrim dore.
- Shkrimin me të diktuar të shkronjave **Y, y, Y, y,** rrokjeve, fjalëve e fjalive.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën Y, y.
Shkruani pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Y, y**.**
Shkruani dy fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën Y, y**.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**	**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7
Njësia mësimore: Përsëritje 5, (faqe 86 e Abetares)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingujt: **G, C, Ç, Gj, Ll, Y.** • Identifikon shkronjat e mësuara në fjalë të ndryshme (në pozicione të ndryshme). • Gjen fjalë që në trup të tyre kanë shkronjat **G, C, Ç, Gj, Ll, Y** në pozicione të ndryshme. • Ndan fjalët dhe shkruan saktë ato.	**Fjalë kyçe:** gota, cjapi, çadra, gjirafa, dielli, ylberi. **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Vëzhgim- analizë

• Formulon përgjigjet në pyetjet e dhëna.	❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, etiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit ndahen në dy grupe.
Njërit grup i shpërndahen etiketat me shkronjat e shtypit: **G, g, C, c, Ç, ç, GJ, gj, Ll, ll, Y, y** kurse grupit tjetër etiketat me shkronja të dorës: **G, g, C, c, Ç, ç, GJ, gj, Ll, ll, Y, y.**
Lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave të shtypit dhe të dorës.
Përsëritet loja për të aktivizuar sa më shumë nxënës të klasës.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake
Nxënësit nxiten të gjejnë fjalë me shkronjat e mësuara.
Ja një shembull: G- gomari.
U drejtohen pyetjet:
-Me cilën shkronjë fillon kjo fjalë ?
-Sa rrokje ka fjala gomari?
-Po shkronja?
Vazhdohet edhe me fjalë tjera të cilat i gjejnë nxënës të ndryshëm.

Hapi 2. Vëzhgim-Analizë
Hapet libri në faqen 86 të Abetares dhe nxënësit nxiten të shqiptojnë tingujt e shkronjave të mësuara që ndodhen në krye të faqes. Dallojnë tingujt bashkëtinglllorë: **G, C, Ç, Gj, Ll** dhe tingullin zanor: **Y**.
Ushtrimi i parë: Udhëzohen të bashkojnë vizat për të formuar shkronjat e mësuara.

Ushtrimi i dytë: Analizojnë figurat e dhëna dhe shkruajnë fjalët poshtë tyre.
Shkruajnë fjalët: *gota, cjapi, çadra, gjirafa, dielli, ylberi*. Identifikojnë shkronjat e mësuara në fjalët e shkruara si: gota- shkronja g gjendet në fillim. Vazhdohet edhe me shembujt tjerë.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i tretë: Ndajnë fjalët dhe shkruajnë në kutitë e duhura.

Ja një shembull:

ç	o	r	a	p	e

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: ço-ra-pe. Pra, fjala çorape ka tri rrokje.

-Ku ndodhet shkronja **ç**? (Shkronja **ç** ndodhet në fillim të fjalës.)

Shkruajnë fjalët: *gjerdan, këpucë, gjethe, gjumë, llambë, ylber.*

Përsëritet veprimtaria edhe për fjalët tjera.

Ushtrimi i katërt:
Nxënësit udhëzohen që duke u bazuar në figurën e dhënë në Abetare, të shkruajnë përgjigjet e pyetjeve:
-Çfarë po bën Genti? (Genti po shkruan detyrat në lap-top.)
-Çfarë po bën Yllka? (Yllka shëtit qenin.)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxiten të gjejnë fjalë me shkronjat e mësuara dhe t'i shkruajnë saktë ato.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingujve: **G, C, Ç, Gj, Ll, Y.**
- Identifikimin e shkronjave të mësuara në fjalë të ndryshme (në pozicione të ndryshme).
- Gjetjen e fjalëve që në trup të tyre kanë shkronjat **G, C, Ç, Gj, Ll, Y** në pozicione të ndryshme.
- Ndarjen e fjalëve dhe shkrimin e drejtë të tyre.
- Formulimin e përgjigjeve në pyetjet e dhëna.

Detyrë shtëpie:
Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani në fletore nga një rresht me shkronjat: **G, C, Ç, Gj, Ll, Y.** Shkruani fjalë e fjali me to.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7		
Njësia mësimore:		**Kriteret e suksesit:**		

<table>
<tr><td>Përsëritje 5, (faqe 116 e Fletore punës)</td><td>Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingujt: G, C, Ç, Gj, Ll, Y.
• Gjen fjalë me shkronjat G, C, Ç, Gj, Ll, Y.
• Ndanë fjalët e gjetura në rrokje.
• Qarkon saktë fjalët e fshehura.
• Shkruan me shkronja të dorës fjalët e gjetura.</td><td>Fjalë kyçe:
gëzim, cirk, çelës, gjyshe, llogari, yll.</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Vëzhgo-analizo
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, tiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake
Lojë- Ecim me rrokje
Nxënësit ndahen në gjashtë grupe (sipas shkronjave të mësuara). Çdo grupi u shpërndahen fletët e bardha ku shkruajnë nga dy fjalë me shkronjën përkatëse.
Ja disa shembuj:
Grupi 1: Shkronja G - gabim, gështenjë;
Grupi 2: Shkronja C - cirk, cep;
Grupi 3: Shkronja Ç - çelës, çekiç;
Grupi 4: Shkronja Gj - gjellë, gjashtë;
Grupi 5: Shkronja Ll - llasticë, llogari;
Grupi 6: Shkronja Y - yll, ylber.
Më pas, nga çdo grup dalin nga tre nxënës paraqesin fjalët e gjetura dhe i ndajnë në rrokje, ku për çdo rrokje e bëjnë nga një hap duke ecur. Për çdo fjalë tregojnë numrin e rrokjeve të gjetura.
Përsëritet veprimtaria duke përfshirë sa më shumë nxënës.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Vëzhgo-Analizo

Hapet libri në faqen 116 të Fletore punës dhe nxënësit nxiten të shqiptojnë tingujt e shkronjave të mësuara që ndodhen në krye të faqes. Rikujtojnë tingujt bashkëtinglllorë: G, C, Ç, Gj, Ll dhe tingullin zanor: Y.
Ushtrimi i parë: Analizojnë figurat e dhëna dhe gjejnë, qarkojnë dhe shkruajnë me shkronja të dorës fjalët e gjetura.
Ushtrimi i dytë: Nxënësit udhëzohen të ndajnë në rrokje fjalët e dhëna.</td></tr>
</table>

Ja një shembull: akullorja: a-ku-llor-ja.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: a – ku – llo - rja.

- Pra, fjala akullorja ka katër rrokje. Ku ndodhet shkronja a? (Në fillim dhe në fund)

Përsëritet veprimtaria edhe për fjalët tjera.

Hapi 3. Punë individuale

Ushrimi i tretë:
Nxënësit udhëzohen të shkruajnë nga dy fjalë me secilën shkronjë të mësuar.
Shembull:
- **G:** gazetë, gëzim;
- **C:** cjap, copë;
- **Ç:** çift, çifteli;
- **Gj**: gjyshe, gjethe,
- **Ll:** llokum, llamarinë;
- **Y**: yndyrë, Yllkë.

Disa nxënës lexojnë ato para të tjerëve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxiten të gjejnë fjalë me shkronjat e mësuara dhe t'i shkruajnë ato saktë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingujve: **G, C, Ç, Gj, Ll, Y.**
- Gjetjen e fjalëve me shkronjat **G, C, Ç, Gj, Ll, Y.**
- Ndarjen e fjalëve të gjetura në rrokje.
- Qarkimin e saktë të fjalëve të fshehura.
- Shkrimin e fjalëve të gjetura me shkronja të dorës.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Formojnë nga një fjali me fjalët e gjetura për shkronjat: **G, C, Ç, Gj, Ll, Y.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Elemente të përgjithshme kulturore te temat e ndryshme**.**		**Rezultatet e të nxënit të temës:** Shkruan shkronjat e mëdha dhe të vogla, rrokje, fjalë dhe fjali;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:**		

I. 1, 3, 5; II.7; III. 2, 3; IV.5; V.5; VI.6	1.1, 2, 4, 7; 2.1, 2, 3, 4, 8; 3.1, 7
Njësia mësimore: Përsëritje 5, (faqe 87 e Abetares)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Shenjëzon me √ përgjigjen e saktë. • Shkruan fjalët hyrëse dhe përmbyllëse nga letra e Erës. • Plotëson letrën e Anës duke përdorur fjalët ndihmëse.	**Fjalë kyçe:** gota, cjapi, çadra, gjirafa, dielli, ylberi. **Teknika dhe strategji:** ❖ Bisedë ❖ Lexim- analizë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, tiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësve në grupe u shpërndahen zarfet me pesë etiketa të zbrazëta.
Secili anëtar i grupit shkruan nga një fjalë (që në trup të tyre kanë shkronjat e mësuara) në etiketë.
Mbyllin zarfet dhe i shkëmbejnë ato mes vete.
U drejtohen pyetjet:
-Për çfarë shërbejnë zarfet?
-Kujt do të dëshironit t'i dërgoni një letër?
-Ku gjendet ai/ajo që do t'ia dërgonit letrën?

Veprimet në situatë

Hapi 1. Bisedë
Nxënësit nxiten të hapin zarfet dhe lexojnë fjalët në etiketa.
Ja një shembull: G- goma.
U drejtohen pyetjet:
-Me cilën shkronjë fillon fjala goma ?
-Sa rrokje ka? Gjejnë rrokjet me përplasje të shuplakave.
-Po shkronja?
Vazhdohet edhe me fjalë tjera nga zarfi.

Hapi 2. Lexim-Analizë

Hapet libri në faqen 87 të Abetares dhe nxënësit njoftohen me temën.

Ushtrimi i pestë:

Nxënësit nxiten të lexojnë letrën që Era i ka shkruar Anës.
Pas leximit, udhëzohen të shenjëzojnë me √ përgjigjen e saktë në kutizat e dhëna.

Era ka shkruar: ☐ detyrë ☑ letër ☐ kartolinë.

Shkruajnë fjalët me të cilat Era fillon dhe përfundon letrën.

Era e filloi letrën me fjalët: _____.
Era e përfundoi letrën me fjalët:_____.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i gjashtë:

Plotësojnë letrën që Ana i ka shkruar Erës duke përdorur fjalët ndihmëse: *unë, letrën, e lumtur, së shpejti, e ëmbël* dhe lexojnë atë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxiten të shkruajnë një letër shokut/shoqes.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Shenjëzimin me √ në përgjigjen e saktë.
- Shkrimin e fjalëve hyrëse dhe përmbyllëse nga letra e Erës.
- Plotësimin e letrës së Anës duke përdorur fjalët ndihmëse.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani në fletore një letër për shokun ose shoqen.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala</td><td colspan="4">Rezultati i të nxënit të temës:
• Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë;
• Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5;III.2</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.2; 2.1; 2.2; 3.1, 3.6</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Nj faqe 88</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin Nj.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin Nj në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Vendos rrokjet në vendin e duhur.
• Lidh rrokjet për të formuar fjalët.
• Formon fjali me fjalët e dhëna.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
binjaket, Manjola, Njomëza, foshnja, njëshi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-Analizo
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Nj të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën Nj, magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit dëgjojnë këngën për shkronjën Nj nga youTube. Këngën mund ta gjeni në këtë vegëz: https://youtu.be/jImmud_S63g.
Teksti i këngës:
Ejani fëmijë, bashkë ne të këndojmë,
Shkronjën tonë të re, sot ne po mësojmë!
Cila është shkronja e re që sot do mësojmë ne?
Ajo është shkronja Nj!
Nj si njolla, nj-njeriu, nj është shkronja jonë e re!
Nj, nj, nj, nj, kjo është shkronja jonë e re!
Kjo është shkronja Nj!</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo

Paraqitet një foto me binjake dhe nxiten nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër rreth saj:

-Çfarë shikoni?

-Çfarë dini për binjaket?

-Si duken ato?

-A duken njësoj ato gjithmonë?

Ta shqiptojmë së bashku fjalën.

Shkruhet fjala ***BINJAKET*** në tabelë dhe nxiten ta lexojnë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **Nj.**

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **BI-NJA-KET.**

-Pra, fjala ***BINJAKET*** ka tri rrokje. Ku ndodhet shkronja **Nj**? (Shkronja **NJ** gjendet në me të fjalës.)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 88 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës **Nj** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingllorë dhe është tingull i përbërë nga dy shkronja: N dhe j. Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin. Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë?

-Ku ishin binjaket? A ju pëlqejnë veshjet e tyre? Cila stinë është? Nga e kuptoni që është verë? Si mendoni çfarë kanë blerë ato?

Lexojnë fjalinë: *Manjola dhe Njomëza janë binjake*. Sa fjalë ka kjo fjali? Te emri *Manjola* sa rrokje janë? Gjejnë rrokjet me përplasje të shuplakave.(Tri rrokje) Ku gjendet shkronja **Nj?** Përsëritet veprimtaria edhe me emrin *Njomëza.*

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të vendosin rrokjet: *nja, një, njo* në vendin e duhur.

Fosh nja i nja ket, sh nja „ një i, njo

Ushtrimi i dytë: Analizojnë fjalët e paraqitura me figura. Lexojmë fjalën e parë: një ulli, disa ullinj.

-Ku e dëgjoni tingullin Nj te fjala *ullinj*: në fillim, në mes apo në fund? (në fund).

-Po te figura e dytë çfarë shikoni? *Një ftua, disa ftonj*. Dëgjojeni me kujdes fjalën *ftonj*: Ku e dëgjoni tingullin **Nj**?

Vazhdohet veprimtaria edhe me fjalët tjera. U drejtohet pyetja: Fjalët: *ullinj, ftonj, lumenj, kallinj misri* cilën shkronjë e marrin kur janë më shumë se një? Marrin shkronjën nj.

Ushtrimi i tretë: Plotësojnë sipas modelit të dhënë, duke lidhur me shigjetë rrokjen *një* me pjesën tjetër të fjalës. Formojnë fjalët: *njëlloj, njëherë, njëqind, njëngjyrësh.* I lexojnë ato.

Ushtrimi i katërt: Lidhin me shigjetë fjalët dhe formojnë fjali sipas shembullit: *Anjeza njeh shkronjat.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën Nj.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Nj.**
- Identifikimin e tingullit **Nj** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e 442igures qendrore.
- Vendosjen e rrokjeve në vendin e duhur.
- Lidhjen e rrokjeve për të formuar fjalët.
- Formimin e fjalive me fjalët e dhëna.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin **Nj.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt Shkronjat Rrokjet Fjala	**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dallon rrokjen në fjalë; • Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.2; 3.1, 3.6
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 118	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën **Nj, nj** të shtypit sipas modelit. • Identifikon shkronjën **Nj, nj** në fjalët e dhëna. • Gjen fjalët e fshehura me simbole. • Shkruan rrokjet dhe emrat e figurave. • Ndan fjalët në rrokje.	**Fjalë kyçe:** njëshi, misër. njomë **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale

• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i **Nj, nj,** plastelinë, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën **Nj, nj** në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit udhëzohen që të formojnë me plastelinë numrin **1**. Zgjedhim ***njëshin*** më të bukur.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet fjala **NJËSHI** në tabelë dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

-Çfarë është njëshi? (Njëshi është numër)

-Me cilën shkronjë fillon fjala **Njëshi**?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **Nj** e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Nj**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. 

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën nj të vogël të shtypit .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 118 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin njëshin, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Sqarohet kuptimi i simbolit të detyrës së parë dhe në mënyrë të pavarur, nxënësit gjejnë shkronjat e fshehura në simbolet e vendosura në kavanoz. Gjejnë dhe shkruajnë fjalët: *Misra të njomë.*

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit shkronjë **Nj** dhe formojnë rrokjet: **NJA, NJI, NJU, NJË, NJO, NJY, ANJ, ENJ, UNJ, ËNJ, ONJ, INJ** dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë shkronën *nj* duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë emrat e figurave të dhëna: *ullinj, gështenja, ftonj, shkronja* dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i pestë: Ndajnë në rrokje fjalët me përplasje të shuplakave dhe shkruajnë rrokjet sipas modelit:

Shkro-nja, njo-lla, bi-nja-këthough.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Nj, nj.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Nj, nj** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Nj, nj** në fjalët e dhëna.
- Gjetjen e fjalëve të fshehura me simbole.
- Shkrimin e rrokjeve dhe emrave të figurave.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani dy rreshta me shkronjën **Nj,nj.**

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Nj, nj.**

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **Nj, nj.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Flet për ngjarjen kryesore në tekst;
• Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 2.2; 2.3; 3.1, 3.6;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Nj faqe 88</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
binjaket, Manjola, Njomëza, sytë, flokët.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Nj të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, mjete shkrimi, fletë, ngjyra.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit ndahen në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën Nj të madhe të shtypit, ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën nj të vogël të shtypit.
Në momentin kur u thuhet FILLO, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave Nj nj.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Lexim me ndalesa
Hapet libri faqe 89 në Abetare dhe u paraqitet titulli në tabelë.</td></tr>
</table>

Nxënësit nxiten të mendojnë për 2-3 minuta, të tregojnë se për çfarë do të mësojnë, e pastaj të përshkruajnë binjaket Manjolën dhe Njomëzën, të tregojnë se çfarë bëjnë ato duke u bazuar te figura.

Dëgjohen disa nxënës.

U ndahet teksti në pjesë dhe u lexohet me ndalesa.

Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te "…kanë në emër shkronjën nj.''

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë janë Manjola dhe Njomëza?

-Si duken ato?

-Çfarë flokësh kanë?

-Si vishen ato?

-Ku gjendet shkronja ***nj*** në emrat e tyre?

-Përveç shkronjës nj, cilat shkronja tjera i kanë të përbashkëta te emrat e tyre? (m, a, o).

-Çfarë mendoni se do të ndodhë tutje?

Vazhdojmë me leximin e pjesës së dytë.

Ndalesa e dytë:'' Ndonjëherë, shokët dhe shoqet ...deri në fund.

Ndihmohen me pyetjet:

-A ngjajnë ato me njëra-tjetrën?

-Pse i ngatërrojnë binjaket shokët dhe shoqet?

-Si sillen ato kur i ngatërrojnë?

-A ishte ngjarja ashtu si e menduat në fillim?

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shenjëzojnë përgjigjet e sakta.

Ushtrimi i dytë: Shkruajnë me shkronja dore numrat: njëqind, njëmbëdhjetë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion. Përshkruajnë binjaket.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
- Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
- Leximin e tekstin qartë dhe saktë.
- Përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Dallon titullin në pjesën e dhënë.

- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.

Shikoni figurat nga ushtrimi i tretë dhe krijoni nga një përrallë për secilën.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt Shkronjat Rrokjet Fjala	**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dallon rrokjen në fjalë; • Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.2; 3.1, 3.6
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 119	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Nj nj të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me shkronjën Nj nj në pozicione të ndryshme. • Shkruan me të diktuar Nj, nj, Nj , nj . • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.	**Fjalë kyçe:** njohuri, njeri, njëmbëdhjetë. **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustrues Nj , nj e, grafiku i shkronjës të shtypit dhe të dorës Nj, nj, Nj , nj , etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Nj, nj, Nj , nj në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Arte Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Paraqiten në fotografi shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe. Nxënësit udhëzohen të tregojnë vendndodhjen e shkronjës **Nj** në alfabet. Pra, shkronja **Nj** është shkronja e njëzet sipas rendit alfabetik.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Paraqiten para nxënësve etiketa me fjalët: ***njeri, Njomëz, shqiponjë, ullinj, njeri.***

Aktivizohen nxënësit të identifikojnë shkronjën Nj, nj dhe ta qarkojnë atë.

Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe te emrat e njerëzve.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës Nj . Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën nj .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 119 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën nj . Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën Nj duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i tretë: Në ushtrimin e tretë nxënësit plotësojnë fjalitë mbi bazën e figurave. Lexojnë fjalitë dhe gjejnë sa fjalë kanë secila fjali.

Shembull: *Manjola bleu ftonj. Kjo fjali ka tri fjalë.*

Vazhdohet në këtë mënyrë edhe me shembujt tjerë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar nga dy rreshta me Nj, nj**,** Nj , nj .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës Nj , nj të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën Nj , nj në pozicione të ndryshme**.**
- Shkrimin me të diktuar të Nj nj | Nj | nj .
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën Nj , nj .

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Nj nj në pozicione të ndryshme.

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë Nj nj .

Modeloni shkronjën Nj, nj, Nj , nj me materiale të ndryshme që i keni në shtëpi si: penj, rruaza, fasule etj.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt Shkronjat Rrokjet Fjala	**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë; • Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1;2.1; 2.2; 3.1, 3.6
Njësia mësimore: Shkronja Th, faqe 90	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **Th.** • Identifikon shkronjën **Th.** • Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **Th** në pozicione të ndryshme. • Përshkruan figurën qendrore. • Vendos rrokjet në vendin e duhur për të formuar fjali. • Shkruan fjalë dy-tri rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna. • Formon fjali me fjalët: fshat, Thethi, malor.	**Fjalë kyçe:** Thethi, fshat, malor **Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Th** të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **Th**.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake***	

Nxënësve u paraqiten dy shporta me etiketa. Njëra shportë ka zanoret: **A, E, Ë, I, O, U, Y**, kurse tjetra bashkëtinglloret: **Sh, Dh, Rr, Nj, Th.** Dalin çifte nxënësish ku njëri nxënës merr nga shporta një bashkëtinglore, kurse tjetri një zanore. Formojnë rrokje dhe fjalë me to.

Shembull: Rrokja*: Sh+O=ShO*. Fjala: s*hok, shoqe, shoh, shoqëroj, shoshë.*

Vazhdohet në këtë mënyrë edhe me shkronjat tjera.

Përsëritet veprimtaria disa herë duke aktivizuar sa më shumë nxënës.

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo

Paraqitet një foto me pamje të fshatit malor Thethi dhe nxiten nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër rreth saj:

-Çfarë shikoni?

-Çfarë dini për fshatin Theth? Ku gjendet ai?

-Si ju duket natyra e këtij fshati?

-Ta shqiptojmë së bashku fjalën **THETHI.**

Shkruhet fjala THETHI në tabelë dhe nxiten ta lexojnë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **Th.**

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: The-thi.

-Pra, fjala Thethi ka dy rrokje. Ku ndodhet shkronja **TH?** (në fillim dhe në mes).

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 90 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës **Th** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtinglloré dhe është tingull i përbërë nga dy tinguj T+h=Th. Pra është shkronjë e përbërë nga këto dy shkronja. Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë?

-Si duket natyra? Cilat kafshë i shihni? Si duken ata?

-Cilat kafshë tjera jetojnë në fshat?

Lexojnë globalisht fjalinë:

Thethi është fshat malor.

U drejtohen pyetjet:

-Sa fjalë ka kjo fjali? (Kjo fjali ka katër fjalë)

-Cila është fjala e parë që dëgjojmë? (Fjala e parë është fjala Thethi)

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të vendosin në vendin e duhur rrokjet: *the, thi, thë* dhe formojnë fjalët: *dja-thi, thi-ka, the-sari, the-si, thë-rras.*

Lexojnë fjalët e formuara dhe me përplasjen e shuplakave gjejnë numrin e rrokjeve për secilën fjalë.

Ushtrimi i dytë

Udhëzohen nxënësit të bashkojnë rrokjet e duhura për të formuar fjalët:

rre-thi, uth-ull, thu-mbi, the-lloj.

Lexojnë fjalët e formuara.

Ushtrimi i tretë:

Nxënësit udhëzohen të shikojnë fotot e paraqitura dhe me shkronjat e dhëna të formojnë fjalën e duhur. Fjalët e formuara janë: *thana, thembra, thërrime.*

Ushtrimi i katërt:

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë në vendin e duhur fjalët: *fshat, Thethi, malor.*

Formojnë fjalinë: *Thethi është fshat malor*. Lexojnë atë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën **Th.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Th.**
- Identifikimin e shkronjës **Th.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit të fjalëve që e përmbajnë tingullin **Th** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Vendosjen e rrokjeve në vendin e duhur për të formuar fjali.
- Shkrimin e fjalëve dy-tri rrokëshe mbi bazën e rrokjeve të dhëna.
- Formimin e fjalisë me fjalët: fshat, Thethi, malor.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin Th.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

<table>
<tr><td>Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala</td><td>Rezultati i të nxënit të temës:
Dallon rrokjen në fjalë;
Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;</td></tr>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5.</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
2.1; 2.2; 3.1, 3.3; 3.5</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 121, 122</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
Shkruan shkronjën Th, th të shtypit sipas modelit.
Identifikon shkronjën Th, th në fjalët e dhëna.
Qarkon fjalët e duhura në mesin e shkronjave.
Plotëson rrokjet.
Formon fjalë mbi bazën e rrokjeve.
Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td>Fjalë kyçe:
Uthulla, thumbi, themeli, djath, thërras</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i Th, th, magnetofon, Cd, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Th, th në pozicione të ndryshme.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja e me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet kënga e shkronjës Th të cilën mund ta gjeni në you tube në vegëzën e mëposhtme:
https://youtu.be/YëeA759Drdg
Ejani fëmijë, bashkë ne të këndojmë,
Shkronjën tonë të re, sot ne po mësojmë!
Cila është shkronja e re që sot do mësojmë ne?
Ajo është shkronja Th!
Th si thana, th si thesi, th është shkronja jonë e re!
Th, th, th, th, kjo është shkronja jonë e re!
Kjo është shkronja Th!</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Shkruhet fjala THARËSJA në tabelë dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

-Për çfarë përdoret tharësja?

-Si mund të jetë ajo?

-Me cilën shkronjë fillon fjala THARËSJA?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja Th e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Th**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë .

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër një-dy herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën th të vogël .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 121 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin tharësen, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Nxënësit do të shkruajnë shkronjat **Th.** Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Në ushtrimin e dytë nxënësit udhëzohen të gjejnë dhe të qarkojnë fjalët: *uthulla, thumbi, themeli, djath, thërras, kthej.*

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë rrokjet: *tha, the, thu, tho, thi, thë, thy* dhe *ath, eth, uth, oth, ith, ëth, yth.*

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë shkronjat th. Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i pestë: Udhëzohen të bazohen në fotot e dhëna, të bashkojnë rrokjet për të formuar fjalë. Lexojnë fjalët e formuara: *gjeth-ja, rre-thi, dja-thi, tha-nat, the-si, va-thi.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë nga dy rreshta me shkronjën **Th, th.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Th, th** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Th, th** në fjalët e dhëna.
- Qarkimin e fjalëve të duhura në mesin e shkronjave.
- Plotësimin e rrokjeve me shkronjën **th.**
- Formimin e fjalëve mbi bazën e rrokjeve.
- Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën **Th, th.**

Shkruani dhjetë fjalë me shkronjën **Th, th** në pozicione të ndryshme.

Shkruani pesë fjali me fjalët e gjetura.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Flet për ngjarjen kryesore në tekst; • Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.2; 2.3; 3.1, 3.6;		
Njësia mësimore: Shkronja Th, Abetare, faqe 91		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurën që ilustron tekstin. • Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës. • Lexon tekstin qartë dhe saktë. • Përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit. • Dallon titullin në pjesën e dhënë. • Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.		**Fjalë kyçe:** Theth, Ana, Rinori, natyra. **Teknika dhe strategji:** ❖ Marrëdhëniet pyetje- përgjigje ❖ Punë individuale ❖ Lojë		

• Nënvizon në tekst fjalët me th nga teksti. • Krijon fjali duke përdorur fjalët ndihmëse.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **Th** të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, etiketa me emrat e nxënësve**,** mjete shkrimi, ngjyra.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësve u shpërndahen fletët. Udhëzohen të vizatojnë nga një rreth a herë që dëgjojnë tingullin **Th**, në fjalët e dëgjuara. U shqiptohen fjalët:

Shembull: *1.thupër, 2. shkollë, 3. thesar, 4. thërras, 5. thyej, 6. peshk.*

Tregojnë sa rrathë kanë shkruar. (Katër rrathë)

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim me ndalesa

Hapet libri në faqen 91 të Abetares dhe nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin*: rrugën, lajmërimin rrugor, veturën, natyrën, malet, majat e maleve.*

Dëgjohen disa nxënës.

U ndahet teksti në pjesë dhe u lexohet me ndalesa.

Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te...’’janë të thepisura’’

U drejtohen pyetjet:

-Për ku u nisën Ana, Rinori dhe prindërit?

-Çfarë fshati është Thethi?

-Çfarë pamje ka natyra? Pse?

-Si janë majat e maleve?

U sqarohet kuptimi i fjalës: *thepisura-të pjerrëta.*

-Çfarë mendoni se do të ndodhë tutje?

Vazhdojmë me leximin e pjesës së dytë.

Ndalesa e dytë: ’’Njerëzit thithin ajër ..... deri në fund.

-Si është ajri kur ka gjelbërim?

-Çfarë ajri është në këtë fshat malor?

-Prej nga vjen uji?

-Si është uji i burimeve?

-Çfarë pinë gjithë anëtarët e familjes?

-Si kaluan ata në këtë fshat?

-Si mund të vazhdojë ngjarja tutje?

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të nënvizojnë në tekst fjalët me th. I lexojnë ato. Shenjëzojnë me √ përgjigjen e saktë.

Ushtrimi i dytë

Nxënësit udhëzohen të lexojnë fjalitë e dhëna dhe t'i plotësonë ato me fjalët ndihmëse: *u kthye, u tha, thura, tha* dhe krijojnë fjalitë:

Ana *u kthye* nga Thethi. Ajo u tha shoqeve: -Sa i bukur ishte Thethi!

Atje thura kurorë me lule. Jona tha: -Edhe unë dua të shkoj në Theth!

Ushtrimi i tretë

Nxënësit udhëzohen të ndajnë fjalët dhe të shkruajnë fjalitë. Theksohet rëndësia e lënies së hapësirës mes fjalëve.

Hapi 3. Lojë

Me anë lojës nxiten nxënësit të gjejnë fjalë që përmbajnë shkronjën **Th.**

Një nxënës, pasi mendohet për 2-3 minuta, del para klasës dhe numëron pesë fjalë që përmbajnë shkronjën **Th.**

Aktivizohen sa më shumë nxënës në lojë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në libra për fëmijë nxënësit qarkojnë shkronjën **Th, th.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Parashikimet për ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
- Leximin e tekstit qartë dhe saktë.
- Përgjigjet e pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
- Dallimin e titullit në pjesën e dhënë.
- Pyetjet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.

• Nënvizimin e saktë të fjalëve me th nga teksti. • Krijimin e fjalive duke përdorur fjalët ndihmëse.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme: Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime. Shkruaj nga teksti fjalët që në trup të tyre kanë shkronjën th.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt Shkronjat Rrokjet Fjala		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dallon rrokjen në fjalë; • Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5.		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.2; 3.1, 3.3; 3.5		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 122, 123		**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë**		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Th th të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me shkronjën Th th në pozicione të ndryshme. • Shkruan me të diktuar Th, th, Th th. • Përgjigjen pyetjeve mbi bazën e figurave. • Shkruajnë me të diktuar nga një rresht me Th, th, Th th. • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** thumbi, thupra, thaj, Thethi, thana. **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabelë alfabeti, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Th, th, Th th të shtypit dhe të dorës, etiketa me fjalë që		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Arte Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:**		

përmbajnë shkronjën Th, th,  në pozicione të ndryshme.	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit nxiten të gjejnë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën th. Fjalët e gjetura i shkruajnë në tabelë. Një nxënës shkruan fjalën, i dyti qarkon shkronjën th, i treti e ndanë atë në rrokje, i katërti gjen numrin e shkronjave.

Shembull: Nxënësi 1: *thepisur;* nxënësi 2*: thepisur;* nxënësi 3*: the-pi-sur;* nxënësi 4: *th-e-p-i-s-u-r.*

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit në grupe udhëzohen që me fjalët e shkruara në tabelë, të formojnë fjali.

Shembull: *Në Theth majat e maleve janë të thepisura.*

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës . Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 122 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën . Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet dhe fjalët.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën  duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i tretë: Nxënësit udhëzohen të përgjigjen pyetjeve mbi bazën e figurave. Lexojnë përgjigjet e shkruara.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar nga një rresht me Th, th, .

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Shkruajnë fjalë e fjali me shkronjën **Th, th,** .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën në pozicione të ndryshme.
- Shkrimin me të diktuar të Th,th .
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga tri rreshta me .

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën .

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë .

Modeloni shkronjën Th, th,  , me materiale të ndryshme që i keni në shtëpi si: penj, rruaza, fasule etj.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt Shkronjat Rrokjet Fjala	**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dallon rrokjen në fjalë; • Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3;I.4; III.2.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.2; 3.1, 3.3; 3.5
Njësia mësimore: Shkronja X, faqe 92	**Kriteret e suksesit:** **Përcaktohen me nxënësit në klasë**
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingullin **X.** • Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **X** në pozicione të ndryshme. • Përshkruan figurën qendrore. • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Vendos fjalët në vendin e duhur për të formuar fjali.	**Fjalë kyçe:** xixa, xixëllonja, xixëllon, natën, qielli **Teknika dhe strategji:** ❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje ❖ Punë individuale

• Rendit fjalët sipas radhës për të formuar fjali. • Shkruan në vendin e duhur fjalët: lexon, librin.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës **X** të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën **X,** magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë kënga: Ylli i vogël lart në qiell, nga you tube. Këngën mund ta gjeni në këtë vegëz: https://youtu.be/sCGXArvNg88 .

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo

Paraqitet një foto me yje duke xixëlluar dhe nxiten nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër rreth saj:

-Çfarë shikoni?

-Si ju duken yjet?

-Ku qëndrojnë yjet? Kur xixëllojnë ata?

-Ta shqiptojmë së bashku fjalën **XIXA.**

Shkruhet fjala XIXA në tabelë dhe nxiten ta lexojnë atë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës X.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: XI-XA.

-Pra, fjala XIXA ka dy rrokje. Ku ndodhet shkronja X? (Në fillim dhe në mes)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 92 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës **X** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingllorë.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë? Si duket qielli? Kur duken yjet?

U lexohet vjersha strofë-strofë. Disa nxënës e lexojnë atë.

U drejtohen pyetjet:

-Si xixëllojnë yjet? Si ndihen vogëlushët kur vrapojnë pas xixëllonjave? Çfarë bëjnë ata?

Shkruhet në tabelë fjalia**:** *Xixëllonja xixëllon*. Lexojnë atë.

U drejtohen pyetjet:

-Sa fjalë ka kjo fjali?

-Te fjala *Xixëllonja* sa rrokje janë?

Gjejnë rrokjet me përplasje shuplakash.(Janë katër rrokje)

-Ku gjendet shkronja X? Përsëritet veprimtaria edhe me fjalën *xixëllon.*

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të lexojnë fjalët: *nxitoj, nxiton, nxitojmë, nxitoni, nxitojnë* dhe të plotësojnë fjalitë e dhëna. Lexojnë fjalitë e formuara.

Ushtrimi i dytë: Lexojnë fjalët e dhëna dhe renditin ato sipas rradhës për të formuar fjalitë.

Lexojnë fjalitë e formuara: *Xixëllonjat xixëllojnë natën. Qielli nxin nga retë.*

Ushtrimi i tretë: Lexojnë fjalinë: *Nxënësi lexon libra.*

U drejtohen pyetjet: Sa fjalë ka kjo fjali? (Ka tri fjalë)

Fjala e parë *Nxënësi* sa rrokje ka? Gjejnë rrokjet me përplasje të shuplakave: Nxë-në-si (Ka tri rrokje).

-Ku dëgjojmë tingullin **X**? (Në mes).

Fjala e dytë: lexon, sa rrokje ka? (Ka dy rrokje).

-Ku gjendet tingulli **x**? (Në mes). Po te fjala libra a dëgjohet tingulli **x?**

Udhëzohen të shkruajnë në vendin e duhur fjalët: *lexon, nxënësi.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën X.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **X.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **X** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Saktësinë e leximit.
- Vendosjen e fjalëve në vendin e duhur për të formuar fjali.
- Renditjen e fjalëve sipas rradhës për të formuar fjali.
- Shkrimin e saktë të fjalëve: lexon, librin.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Lexoni vjershën: Ylli i vogël lart në qiell.

Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin X.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë;
• Dallon rrokjen në fjalë;
• Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5;III.2</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
2.1; 2.2; 3.1, 3.3; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 124-125</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën X, x të shtypit sipas modelit.
• Identifikon shkronjën X, x në fjalët e dhëna.
• Klasifikon fjalët që fillojnë me shkronjën X dhe ato që përmbajnë shkronjën x në trup të tyre në pozicione të ndryshme.
• Ndan fjalët në rrokje sipas modelit të dhënë.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
xixëllonja, nxeh, nxënësi, lexues</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i X, x, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën X, x në pozicione të ndryshme.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit udhëzohen të gjejnë fjalë me shkronjën x në trup të tyre në pozicione të ndryshme. Njëri nxënës tregon fjalën, kurse tjetri ndanë atë në rrokje.
Shembuj fjalësh: xixë, xixëllim, xixëllon, xixëllim, nxënës, lexim, nxehje.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
Shkruhet fjala XIXËLLONJA në tabelë dhe nxiten nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve:
-Cila fjalë është shkruar në tabelë?</td></tr>
</table>

-Si duket xixëllonja? (Xixëllonja është e bukur.)

-Me cilën shkronjë fillon fjala Xixëllonja?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **X** e shtypit, e madhe dhe e vogël .

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **X**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë. 

Përsëritet veprimtaria për shkronjën nj të vogël të shtypit . .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 124 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin xixëllonjën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të lexojnë fjalët e paraqitura dhe t'i klasifikojnë ato në: fjalë që fillojnë me shkronjën **X** dhe fjalë që përmbajnë shkronjën **x**. Lexojnë ato.

Fjalë që fillojnë me shkronjën X	Fjalë që përmbajnë shkronjën x
XIXA	NXËNËSJA
XIXËLLONJA	NXEH
	NXITOJ
	LEXUESI
	LEXIMI
	BËRXOLLA
	NXIU
	NXORI

Ushtrimi i dytë: Shkruajnë shkronën ***x*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i tretë: Ndajnë në rrokje fjalët me përplasje të shuplakave dhe shkruajnë rrokjet sipas modelit: *xixat: xi-xat; nxitimi: nxi-ti-mi*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën X, x**.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **X, x** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **X, x** në fjalët e dhëna.
- Klasifikimin e fjalëve që fillojnë me shkronjën **X** dhe ato që përmbajnë shkronjën **x** në trup të tyre në pozicione të ndryshme.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje sipas modelit të dhënë.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani dy rreshta me shkronjën **X, x.**

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **X, x.**

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **X, x.**

Modeloni shkronjën X, x me materiale të ndryshme që i keni në shtëpi si: penj, rruaza, fasule etj.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
• Flet për ngjarjen kryesore në tekst;
• Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 2.2; 2.3; 3.1, 3.6</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja X, faqe 93</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• Përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
• Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
nxënësi, leximi, xixëllojnë, bota, librat</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës X të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, mjete shkrimi, fletë, ngjyra.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake

Nxënësve u vendosen në shportë etiketat me fjalët: lexoj, Unë, libra, me, përralla, vjersha, tregime, histori, Ne, lexues, jemi, të mirë.</td></tr>
</table>

Dalin nxënësit dhe tërheqin nga një etiketë dhe formojnë fjalitë:

Unë lexoj libra me përralla, vjersha, tregime, histori.

Ne jemi lexues të mirë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim me ndalesa

Hapet libri faqe 93 në Abetare dhe u paraqitet titulli në tabelë.

Nxënësit nxiten të mendojnë për 2-3 minuta, të tregojnë se për çfarë do të mësojnë, e pastaj të përshkruajnë veprimet e djaloshit duke u bazuar te figura. Dëgjohen disa nxënës.

U ndahet teksti në pjesë dhe lexohet me ndalesa.

Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te "….'takuar nëpër libra'

Ndihmohen me pyetjet:

-Sa lexon nxënësi?

-Çfarë të pëlqen më shumë të lexosh?

-Cilët janë miqtë e tu që ke takuar gjatë leximit?

-Ku gjendet emrat e miqve që ke takuar nëpër libra?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë tutje?

Vazhdojmë me leximin e pjesës së dytë.

Ndalesa e dytë:'' A do të nxitosh të vish me mua? ...deri në fund.

Ndihmohen me pyetjet:

-A je i gatshëm të nxitosh bashkë me nxënësin në fjalë?

-Për ku do të ngjiteni së bashku?

-Si do të ngjiteni atje? Pse dëshironi të shëtisni në botën e përrallave? Kë do ta takonit atje? Çfarë do të gjeni? Ku do të fleni? Cila do të jetë shtëpia juaj? Si mund t'i arrini të gjitha këto?

-A ishte ngjarja ashtu si e menduat në fillim?

-Cili është mesazhi që marrim nga ky tekst?

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të shenjëzojnë përgjigjet e sakta.

Ushtrimi i dytë: Shkruajnë fjalët e duhura për të formuar fjalitë:

Nxënësja lexon përralla. Ndihmohen me pyetjet: Çfarë lexon nxënësja përveç përrallave? (Tregime, vjersha, histori, gjëegjëza).

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion. Nxjerrin mesazhin nga teksti i lexuar.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Parashikimin e ngjarjes në bazë të titullit dhe figurës.
- Saktësinë e leximit të tekstit.
- Përgjigjeve të pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Dallimin e titullit në pjesën e dhënë.
- Pyetjet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën **X, x.**

Shkruaj pesë fjali duke u përgjigjur pyetjeve: pse duhet të lexoni, kur lexoni, çfarë lexoni, me kë lexoni, si lexoni.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Tingujt Shkronjat Rrokjet Fjala	**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë; • Dallon rrokjen në fjalë; • Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5.	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.2; 3.1, 3.3; 3.5
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 125-126	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën X x të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me shkronjën X x në pozicione të ndryshme. • Shkruan me të diktuar X, x, X x .	**Fjalë kyçe:** nxitoj, lexoj, xixëlloj, xixa **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë

• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit	❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese X, x, , grafiku i shkronjës të shtypit dhe të dorës X, x, , etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën X, x,  në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit ndahen në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën **X** të madhe të shtypit, ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën **x** të vogël të shtypit.

Në momentin kur u thuhet **FILLO**, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave **X-x.**

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Shkruhen në tabelë fjalët: **nxënës, lexues, nxit, nxeh, nxitoj, xixa, xixëllonja, Xeni, lexo, xanxar .**

Ndahen nxënësit në dy grupe.

Njëri grup del në tabelë identifikojnë dhe qarkojnë shkronjën **X, x** kurse grupi tjetër ndanë fjalët në rrokje dhe tregon vendndodhjen e shkronjës **X, x.**

Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe te emrat e njerëzve.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës  . Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën  .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 125 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën . Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën  duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i tretë: Në ushtrimin e tretë nxënësit plotësojnë fjalitë mbi bazën e figurave. Lexojnë fjalitë dhe gjejnë sa fjalë kanë secila fjali.

Shembull: N*atën në errësirë xixëllojnë xixëllonjat.*

Vazhdohet në këtë mënyrë edhe me shembujt tjerë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar nga dy rreshta me X, x, .

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës  të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën  në pozicione të ndryshme**.**
- Shkrimin me të diktuar të X, x, .
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën  .

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën .

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën .

Modeloni shkronjën  me materiale të ndryshme që i keni në shtëpi si: penj, rruaza, fasule etj.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
• Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.2; 2.3; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Z, faqe 94</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin Z.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin Z në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Numëron figurat e paraqitura.
• Shkruan fjalët pa gabime.
• Plotësojnë fjalët sipas modelit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
zebër, zogj, zambakë, dinozaurët, Zaku, Ziku</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-Analizo
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Z të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën Z, magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit dëgjojnë këngën për shkronjën Z, të cilën mund ta gjeni në këtë vegëz:
https://youtu.be/Mj5TLcRmrjë .
Teksti i këngës:
Ejani fëmijë, bashkë ne të këndojmë,
Shkronjën tonë të re, sot ne po mësojmë!
Cila është shkronja e re që sot do mësojmë ne?
Ajo është shkronja Z!
Z si zemra, z si zogu, z është shkronja jonë e re!
Z, z, z, z kjo është shkronja jonë e re!</td></tr>
</table>

*Kjo është shkronja **Z**!*

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo

Paraqiten etiketat me shkronjat: **A, E, Ë, I, O, U, Y**.

Për çdo etiketë të ngritur lart nxënësit gjejnë nga pesë fjalë dhe i shkruajnë në tabelë.

Shembull: **A-** *ariu, antenë, akuarium, ar, aeroport* .

Qarkojnë shkronjën dhe tregojnë vendndodhjen e saj në fjalë.

U drejtohet pyetja:

-Si e emërtojmë grupin e këtyre shkronjave?

(ZANORE)

Ta shqiptojmë së bashku fjalën **ZANORE.**

Shkruhet fjala **ZANORE** në tabelë dhe nxiten ta lexojnë atë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Z.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **ZA-NO-RE.**

Pra, fjala **ZANORE** ka tri rrokje. Ku ndodhet shkronja **Z?** (Në fillim)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 94 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës Z që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingllorë.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë? Si duket dinozaurët? A e dini ku kanë jetuar ata? Me çfarë ushqehet dinozauri i paraqitur?

Shkruhet në tabelë fjalia**:** ***Zaku dhe Ziku janë dinozaurë***. Lexojnë atë.

U drejtohen pyetjet:

-Sa fjalë ka kjo fjali?

-Sa rrokje ka fjala Zaku?

Gjejnë rrokjet me përplasje shuplakash.(Fjala Zaku ka dy rrokje.)

Rikujtohet përdorimi i shkronjës së madhe te emrat.

-Ku gjendet shkronja **Z?** (Shkronja Z gjendet në fillim).

Përsëritet veprimtaria edhe me fjalët tjera.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të emërtojnë figurat e paraqitura, numërojnë një nga një dhe të shkruajnë: *një zebër, dhjetë zogj, njëzet zambakë*. Lexojnë fjalët e formuara.

Ushtrimi i dytë: Lexojnë fjalinë dhe plotësojnë fjalët që mungojnë.

Formojnë fjalitë: *Dhjeta shkruhet me numrat një dhe zero.*

Njëzeta shkruhet me numrat dy dhe zero.

Lexojnë fjalitë e formuara.

Ushtrimi i tretë: Nxënësve u sqarohet shembulli i fjalëve me kuptim të kundërt dhe plotësojnë sipas modelit:

ngjitem → zbres, mbuloj zbuloj, → lidh zgjidh →

Formojnë fjali me fjalët e shkruara. I lexojnë ato.

Ushtrimi i katërt: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fjalinë me fjalët që mungojnë.

Zaku dhe Ziku janë dinozaurë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën **Z.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Z.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **Z** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Saktësinë e leximit.
- Numërimin e saktë të figurave të paraqitura.
- Shkrimin e fjalëve drejt dhe pa gabime.
- Plotësimin e fjalëve sipas modelit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin Z.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë;
• Dallon rrokjen në fjalë;
• Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
2.1; 2.2; 3.1, 3.3; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 127-128</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Z, z të shtypit sipas modelit.
• Identifikon shkronjën Z, z në fjalët e dhëna.
• Grupon fjalët që fillojnë apo përmbajnë shkronjën z në trup të tyre dhe fjalët që fillojnë apo përmbajnë shkronjën Z në pozicione të ndryshme.
• Ndan fjalët në rrokje sipas modelit të dhënë.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
zebra, zarfi, zjarri, zyre</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i Z, z, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Z, z në pozicione të ndryshme.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit udhëzohen të gjejnë fjalë me shkronjën z në trup të tyre në pozicione të ndryshme. Çdo nxënës që gjen një fjalë ngjitet në ‘’Trenin e fjalëve’’ dhe lëvizin nëpër klasë.
Shembuj fjalësh: Zana, zakon, zemër, zile, zero, zymbyl, zbritje, zotëri, zbraz, zili.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</td></tr>
</table>

Shkruhet fjala **ZEBRA** në tabelë dhe nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve:

-Cila fjalë është shkruar në tabelë?

-Si duket ajo?

-Me cilën shkronjë fillon fjala Zebra?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja Z e shtypit, e madhe dhe e vogël .

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Z.** Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë Z .

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën nj të vogël të shtypit z.

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 127 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin zebrën, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të lexojnë fjalët e paraqitura dhe t'i grupojnë ato në: fjalë që fillojnë me shkronjën **Z** dhe fjalë që përmbajnë shkronjën **Z**.

Fjalë që fillojnë me shkronjën Z	**Fjalë që përmbajnë shkronjën Z**
NXITOJ	ZARFI
NXJERR	ZJARRI
LEXUESI	ZYRA
NXORRI	VIZATOJ
	VAZOJA
	VIZITOJ

Ushtrimi i dytë: Shkruajnë shkronjën **z** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i tretë: Ndajnë në rrokje fjalët me përplasje të shuplakave dhe shkruajnë rrokjet sipas modelit: *zarfi: zar-fi, zambaku: zam-ba-ku.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Z, z.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Z, z** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Z, z** në fjalët e dhëna.
- Grupimin e fjalëve që fillojnë apo kanë në trup të tyre shkronjën **Z** dhe ato që fillojnë apo përmbajnë shkronjën **Z** në trup të tyre në pozicione të ndryshme.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje sipas modelit të dhënë.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani dy rreshta me shkronjën **Z, z.**

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Z, z.**

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **Z, z.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
• Flet për ngjarjen kryesore në tekst;
• Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.2; 2.3; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Z, faqe 95</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• Përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Dramatizon rolin e caktuar.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Zik, Zak, ushqimet, bimë, mish</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
</table>

• Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar. • Liston ushqimet që i pëlqejnë më shumë. • Arsyeton përgjigjet lidhur me ushqimet e parapëlqyera.	
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës X të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, plastelinë, mjete shkrimi, fletë, ngjyra.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit ndahen në dy grupe. Njëri grup modelon me plastelinë apo materiale tjera shkronjën **Z** të madhe të shtypit, ndërsa grupi tjetër shkronjën **z** të vogël të shtypit.

Në momentin kur u thuhet **FILLO**, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave **Z-z.**

Veprimet në situatë

Hapi 1. Leximi me ndalesa

Hapet libri faqe 94 në Abetare dhe u paraqitet titulli në tabelë.

Nxënësit nxiten të mendojnë për 2-3 minuta, dhe duke u bazuar te titulli tregojnë se për çfarë do të mësojnë. Dëgjohen disa nxënës.

U ndahet teksti në pjesë dhe lexohet me ndalesa.

Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te "….'Mishi të bën të fortë'

Ndihmohen me pyetjet:

-Si quhen dinozaurët e kësaj pjese?

-Kë takoi dinozauri Zak?

-Çfarë bënte dinozauri Zik?

-Me cilat fjalë u përshëndetën ata?

-Po ju si përshëndeteni kur takoni dikë? (Mirëmëngjesi, mirëdita, mirëmbrëma)

-Çfarë i pëlqente të hante Zikut? Pse?

-Po Zakut? Pse?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë tutje?

Vazhdojmë me leximin e pjesës së dytë.

-Ndalesa e dytë:'' Unë ha vetëm bimë ...deri në fund.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë hante dinozauri Zik? (Hante bimë dhe ishte bimëngrënës).

-Po dinozauri Zak? (Hante mish dhe ishte mishngrënës).

-A ishte ngjarja ashtu si e menduat në fillim?

-Cili është mesazhi që marrim nga ky tekst?

Nxënësit ndahen në role dhe lexojnë tekstin sipas rolin që kanë.

Pas leximit, dalin çifte nxënësish dhe dramatizojnë pjesën sipas rolit.

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësve në grupe u shpërndahen fletët dhe udhëzohen të bëjnë një listë me ushqimet që u pëlqejnë më shumë. Secili grup paraqet përgjigjet e tyre duke i arsyetuar ato. Punimet e tyre i vendosin në këndin e klasës.

Ushtrimi i dytë: Diskutohen me nxënës disa nga zakonet e mira. Udhëzohen të shenjëzojnë me √ fjalitë që u përshtaten.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Luan rolin e caktuar.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes në bazë të titullit dhe figurës.
- Saktësinë e leximit të tekstit.
- Përgjigjeve të pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Dallimin e titullit në pjesën e dhënë.
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.
- Dramatizimin e rolit të caktuar.
- Listimin e ushqimeve që i pëlqejnë më shumë.
- Arsyetimin e përgjigjeve lidhur me ushqimet e parapëlqyera.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën **Z, z.**

Shkruaj pjesën e pëlqyer nga teksti: Biseda e dinozaurëve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt Shkronjat Rrokjet Fjala		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë; • Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.5		
Njësia mësimore: Fletore pune, faqe 129 -130		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan shkronjën Z ǁ z të dorës sipas modelit. • Plotëson fjalët me shkronjën Z ǁ z në pozicione të ndryshme. • Shkruan me të diktuar Z, z, Z ǁ z . • Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.		**Fjalë kyçe:** Zana, Zamiri, Prizreni, zogu **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake ❖ Analizë & sintezë ❖ Punë individuale		
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese Z, z, Z ǁ z , grafiku i shkronjës të shtypit dhe të dorës Z, z, Z ǁ z , etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Z, z, Z ǁ z në pozicione të ndryshme.		**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit udhëzohen të gjejnë fjalë me shkronjë Z, z në trup të tyre në pozicione të ndryshme dhe i paraqesin në tabelë. Qarkojnë shkronjë Z, z.



Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësve u shpërndahen etiketa me fjalët: *dinozaurët, ushqimi, biseda.*

Diskutojnë në grup dhe me çdo fjalë formojnë fjali.

Shembull: *Dinozauri Zik ha bimë.*

Dalin dhe i lexojnë para të tjerëve.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës Z . Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën z .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 125 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën z . Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën Z duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i tretë: Në ushtrimin e tretë nxënësit plotësojnë fjalitë mbi bazën e figurave.

Shkruajnë me shkronja dore. Lexojnë fjalitë dhe gjejnë sa fjalë kanë secila fjali.

Shembull: *Pasdite Zamira bleu lule.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar nga dy rreshta me **Z, z.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës Z z të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën Z z në pozicione të ndryshme**.**
- Shkrimin me të diktuar të Z, z, Z z.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën Z z .

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Z z.

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën Z z.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
• Flet për ngjarjen kryesore në tekst;
• Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.2; 2.3; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Xh, faqe 96</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin Xh.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin Xh në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Lidh rrokjet për të formuar fjalë.
• Vendos fjalët ndihmëse në vendin e duhur.
• Shkruan saktë fjalët për të formuar fjalinë.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
xhaketa, xhepi, valixhe, Drini</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-Analizo
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Xh të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën Xh, magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit dëgjojnë këngën e shkronjës Xh, të cilën mund ta gjeni në këtë vegëz:
https://youtu.be/YGBK-jvTUaA.
Teksti i këngës:
Ejani fëmijë, bashkë ne të këndojmë,
Shkronjën tonë të re, sot ne po mësojmë!
Cila është shkronja e re që sot do mësojmë ne?
Ajo është shkronja Xh!</td></tr>
</table>

Xh si xhepi, xh-xhaketa, xh është shkronja jonë e re!
Xh, xh, xh, xh, kjo është shkronja jonë e re!
Kjo është shkronja Xh!
Veprimet në situatë
Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo

Paraqitet një foto në të cilën shihet xhaketa me xhepa dhe nxiten nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër rreth saj:

-Çfarë shikoni?

-Kur e veshim xhaketën?

-Çfarë ka xhaketa?

-Ta shqiptojmë së bashku fjalën **XHAKETA.**

Shkruhet fjala XHAKETA në tabelë dhe nxiten ta lexojnë atë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës XH.

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: XHA-KE-TA.

-Pra, fjala XHA-KE-TA ka tri rrokje. Pra fjala ka aq rrokje sa ka zanore.

-Ku ndodhet shkronja Xh? (Në fillim)

Theksohet të kenë kujdes në të shqiptuar XH dhe GJ.

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 96 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës **Xh** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingllorë dhe është shkronjë e përbërë apo dyshe.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore me detaje duke emërtuar çdo objekt që shohin.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë? Çfarë bën djaloshi me emrin Drini? Pse po përgatit ai valixhen? Si mendoni, për ku është nisur ai? Po ju, përgatitni valixhen kur doni të udhëtoni?

-Shkruhet në tabelë fjalia**: Drini po përgatit valixhen.** Lexojnë atë.

U drejtohen pyetjet:

-Sa fjalë ka kjo fjali?

-Te fjala **valixhen** sa rrokje janë?

Gjejnë rrokjet me përplasje shuplakash.(Janë tri rrokje)

-Ku gjendet shkronja xh? (Gjendet në mes të fjalës).

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të lidhin rrokjet me shigjetë dhe të formojnë fjalë. Fjalët e formuara janë: *filxhan, gonxhe, panxhar, xhezve, xhungël*. I lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Lexojnë fjalitë dhe udhëzohen që përmes pyetjeve kush, ku, kë të vendosin fjalët ndihmëse në vendin e duhur për të plotësuar fjalitë.

Shembull: (Kush?) **X*haxhi*** *ka veshur një xhup të madh.*

(Kush?) ***Xhupi*** *e mban ngrohtë.*

(Ku?) Ai fut duart në ***xhepa****.*

(Kë?) Nga nxitimi prish ***zinxhirin*** *e njërit xhep.*

Lexojnë fjalitë e formuara.

Ushtrimi i tretë: Nxënësit udhëzohen të qarkojnë fjalën e shkruar saktë. Fjalët e qarkuara janë: *gjirafë, oxhak, gjethe.*

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë në vendin e duhur fjalët: *valixhen, po.*

Shembull: *Drini po përgatit valixhen***.**

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën **Xh**.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Xh.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **Xh** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Saktësinë e leximit.
- Lidhjen e rrokjeve për të formuar fjalë.
- Vendosjen e fjalëve ndihmëse në vendin e duhur.
- Shkrimin e saktë të fjalëve: valixhen, po.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin **Xh.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë;
• Dallon rrokjen në fjalë;
• Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5; III.2</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 130 -131</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Xh, xh të shtypit sipas modelit.
• Identifikon shkronjën Xh, xh në fjalët e dhëna.
• Shkruan fjalë mbi bazën e figurave.
• Lidh rrokjet për të formuar fjalë..
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
xixëllonja, nxeh, nxënësi, lexues</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i Xh, xh, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Xh, xh në pozicione të ndryshme.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit udhëzohen të gjejnë fjalë me shkronjën xh në trup të tyre në pozicione të ndryshme. Njëri nxënës tregon fjalën, kurse tjetri ndanë atë në rrokje.
Shembuj fjalësh: xhezve, xhiro, xhuxhmaxhuxh, xhufkë, xhiroj, xhami, xhaxha, xhungël.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
Shkruhet fjala XHUPI në tabelë dhe nxiten nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve:
-Cila fjalë është shkruar në tabelë?
-Si duket xhupi yt?</td></tr>
</table>

-Me cilën shkronjë fillon fjala **XHUPI**?

Njihen nxënësit me temën e mësimit dhe prezantohet shkronja **Xh** e shtypit, e madhe dhe e vogël .

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Xh.** Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë .

Përsëritet veprimtaria për shkronjën nj të vogël të shtypit . .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 130 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin xhupin, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të ndjekin figurat që u fillon emri me **Xh.** Shkruajnë emrat e figurave të gjetura: *xhupi, xhaketa, xhinse, xhepi, xhungla.*

Ushtrimi i dytë: Shkruajnë shkronjën ***xh*** duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera.

Ushtrimi i tretë: Bashkojnë rrokjet e formave të njëjta dhe shkruajnë fjalët: *panxhari, filxhani, zinxhiri, oxhaku.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Xh, xh.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Xh, xh** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Xh, xh** në fjalët e dhëna.
- Shkrimin e saktë të fjalëve mbi bazën e figurave.
- Lidhjen e rrokjeve për të formuar fjalë.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani dy rreshta me shkronjën **Xh, xh.**

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Xh, xh.**

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **Xh, xh.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
• Flet për ngjarjen kryesore në tekst;
• Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.2; 2.3; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Xh, faqe 97</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Përshkruan figurën që ilustron tekstin.
• Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• Përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
• Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
Drini, valixhen, xhirime, sheshi</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Copëzat e përziera
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Xh të shtypit dhe të dorës, të madhe e të vogël, mjete shkrimi, fletë, ngjyra.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësve në grupe u shpërndahen etiketa me grupe fjalësh të ngatërruara.
Renditin fjalët dhe formojnë fjali me kuptim.
Shembull:

Xhimi xhup xhepa me ka
Xhimi ka xhup me xhepa.</td></tr>
</table>

Xhaxhai	xhunglën	foli	më	për

Xhaxhai më foli për xhungël.

xhami	shtëpi	Në	thyer	ishte

Në shtëpi ishte thyer xhami.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexim me ndalesa

Hapet libri faqe 97 në Abetare dhe u paraqitet titulli në tabelë.

Nxënësit nxiten të mendojnë për 2-3 minuta, analizojnë figurën në detaje dhe tregojnë se për çfarë do të mësojnë. Përshkruajnë veprimet e djaloshit duke u bazuar te figura. Dëgjohen disa nxënës.

U ndahet teksti në pjesë dhe lexohet me ndalesa.

Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te "….Nisi të bënte gati valixhen''

Ndihmohen me pyetjet:

-Për ku nisej Drini?

-Çfarë do të bënte ai?

-Si titullohej filmi?

-Si ndihej Drini?

-Si i nisi përgatitjet?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë tutje?

Vazhdojmë me leximin e pjesës së dytë.

-Ndalesa e dytë: ''Të parat mori ...deri në fund.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë mori me vete ai?

-Si mendoni në cilën stinë zhvillohet ngjarja? Pse?

-Përse e mbylli me zor valixhen?

-Kush e shoqëroi atë?

-Deri ku shkoi me xhaxhain?

-A ishte ngjarja ashtu si e menduat në fillim?

Diskutohen fjalët e reja nga *Shtëpia e fjalëve.*

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të shkruajnë shkronjat e secilës fjalë në kutizat e duhura.

Lexojnë fjalët e formuara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxënësit lexojnë tekstin me intonacion të duhur. Nxjerrin mesazhin nga teksti i lexuar.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës që ilustron tekstin.
- Parashikimin e ngjarjes në bazë të titullit dhe figurës.
- Saktësinë e leximit të tekstit.
- Përgjigjeve të pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Dallimin e titullit në pjesën e dhënë.
- Pyetjet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:
Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.
Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën Xh, xh.

Shkruaj pesë fjali të pëlqyera nga teksti.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala

Rezultati i të nxënit të temës:

- Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë;
- Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I.1; I.2; I.3; I.5; III.2

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.5

Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 131 -132

Kriteret e suksesit:

Përcaktohen me nxënësit në klasë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

Nxënësi:

- Shkruan shkronjën  të dorës sipas modelit.
- Plotëson fjalët me shkronjën  në pozicione të ndryshme.
- Shkruan me të diktuar X, x, .
- Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.

Fjalë kyçe:

gonxhe, xhaxha, xhami, xhupi

Teknika dhe strategji:

- ❖ Diskutim për njohuritë paraprake
- ❖ Analizë & sintezë
- ❖ Punë individuale

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese X, x, , grafiku i shkronjës të shtypit dhe të dorës X, x, , etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën X, x,  në pozicione të ndryshme.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë Arte Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësve u shpërndahen fletët dhe udhëzohen të bëjnë pika shiu në atë fletë vizatimi duke filluar me një ritëm të ngadalshëm dhe duke e shpejtuar atë. Pasi kanë mbushur fletën me pika, udhëzohen të bashkojnë pikat dhe të formojnë shkronjën Xh dhe xh. Punimet e tyre i vendosin në këndin e klasës.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Shkruhen në tabelë fjalët: mbret, i xhunglës, Luani, është**.**

Nxënësit nxiten të renditin fjalët dhe të formojnë fjalinë: *Luani është mbreti i xhunglës.*

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Analizë dhe sintezë 

Prezantohet grafiku i shkronjës . Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 125 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën. . Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë.

Ushtrimi i dytë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit do të shkruajnë shkronjën  duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet, fjalët dhe fjalitë. I lexojnë ato.

Ushtrimi i tretë: Udhëzohen të zhvendosin fjalët në fjali sipas modelit të dhënë. I lexojnë ato.

Shembull:

1. Shokët	**2. ma pëlqyen**	**3. shumë**	**4. xhupin e ri**

4.Xhupin e ri	**2.ma pëlqyen**	**3. shumë**	**1. shokët**

1. Shokët	**3. shumë**	**2. ma pëlqyen**	**4.xhupin e ri**

4.Xhupin e ri	**3.shumë**	**2.ma pëlqyen**	**1.shokët**

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar Xh, xh,  , fjalë që në trup të tyre kanë: Xh, xh,  në pozicione të ndryshme.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës  të dorës sipas modelit.
- Plotësimin e fjalëve me shkronjën  në pozicione të ndryshme.
- Shkrimin me të diktuar të X, x, .
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani nga dy rreshta me shkronjën  .

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën .

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën  .

Modeloni shkronjën Xh, xh,  me materiale të ndryshme që i keni në shtëpi si: penj, rruaza, fasule etj.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë;
• Dallon rrokjen në fjalë;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5; III.2</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.6</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Zh, faqe 98</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingullin Zh.
• Identifikon me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin Zh në pozicione të ndryshme.
• Përshkruan figurën qendrore.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Vendos rrokjet në vendin e duhur për të formuar fjalë.
• Krijon fjali me fjalët e formuara.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
zhapiku, plazhi, zhavorri, gumëzhima</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgo-Analizo
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Zh të shtypit, foto me figura fjalët e të cilave përmbajnë shkronjën Zh, magnetofon, Cd, videoprojektori (nëse ka).</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit dëgjojnë këngën për shkronjën Zh nga you tube, të cilën mund ta gjeni në këtë vegëz: https://youtu.be/gpQxëzPBSc4.
Teksti i këngës:
Ejani fëmijë, bashkë ne të këndojmë,
Shkronjën tonë të re, sot ne po mësojmë!
Cila është shkronja e re që sot do mësojmë ne?
Ajo është shkronja Zh!
Zh si zhurma, zh-zhapiku, zh është shkronja jonë e re!
Zh, Zh, Zh, Zh, kjo është shkronja jonë e re!</td></tr>
</table>

Kjo është shkronja Zh!

Veprimet në situatë

Hapi 1 . Vëzhgo-Analizo

Paraqiten etiketat me shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe.

Për çdo etiketë të ngritur lart nxënësit gjejnë fjalë dhe i shkruajnë në tabelë.

Shembull: A- *ariu, B-buka, C-cjapi, Ç-çelësi* e kështu me radhë.

Qarkojnë shkronjën dhe tregojnë vendndodhjen e saj në fjalë.

Nxiten nxënësit të kujtojnë ditën e parë të shkollës, ditën kur kanë marrë për herë të parë Abetaren në dorë, mësimin e shkronjave të para, të shtypit e të dorës, mësimin e rrokjeve, fjalëve e fjalive.

U drejtohen pyetjet:

-Si jeni ndier në ditën e parë të shkollës?

-Si të është dukur Abetarja kur e more në dorë për herë të parë?

-Kush u ndihmoi në mësimin e shkronjave?

-Po ti, ke qenë ndonjëherë i emocionuar para shokëve/shoqeve gjatë leximit të teksteve?

-A dini cila shkronjë është duke pritur ta mësoni?

Paraqitet fotoja e Zhapikut dhe diskutohet rreth saj.

-Çfarë po shihni në foto?

-Çfarë është zhapiku? (Zhapiku është zvarranik i vogël).

-Ku mund ta shohim atë? (Atë mund ta shohim në muret e shtëpisë apo në trungun e ndonjë peme.)

Shkruhet fjala **ZHAPIKU** në tabelë dhe nxiten ta lexojnë atë globalisht.

Kryhet procesi i analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **ZH.**

-Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **ZHA-PI-KU.**

-Pra, fjala **ZHAPIKU** ka tri rrokje.

-Po shkronja? (Fjala **ZHAPIKU** ka gjashtë shkronja **Zh-A-P-I-K-U**)

-Ku ndodhet shkronja **ZH**? (Në fillim)

Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Hapet libri në faqen 98 të Abetares dhe nxiten të shqiptojnë tingullin e shkronjës **Zh** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingull bashkëtingllorë dhe është shkronjë e përbërë.

Nxiten të përshkruajnë figurën qendrore.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë shikoni në figurë? Si duket shkronja **Zh**?

Shkruhet në tabelë titulli: *Zh, moj Zh, a je mërzitur?*

Njihen me temën e re mësimore. U lexohet vjersha 1-2 herë.

U drejtohen pyetjet:

- Si titullohet vjersha?

-Pse mund të ishte mërzitur **Zh**?

-Pse ishte e gëzuar ajo?

-Si e kuptoni shprehjen*: ''Dhe më bëhej zemra mal''*? (Shkronja **Zh** po gëzohej)

-Sa strofa ka kjo vjershë?

-Sa vargje ka secila strofë?

Nxënësit lexojnë radhazi nga dy vargje të vjershës.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të shenjëzojnë me √ kuptimin e saktë të shprehjeve: *më bëhej Zemra mal-gëzohesha; Na priftë e mbara-Të na shkojë puna mirë.*

Ushtrimi i dytë: Shkruajnë rrokjet zha, zhi, zhy në vendin e duhur për të formuar fjalë.

Shembull: *plazhi, zhapiku, zhytësi, gumëzhima, zhavorri.*

Lexojnë fjalët e formuara. Formojnë nga një fjali me secilën prej tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxiten të tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën **Zh.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingullit **Zh.**
- Identifikimin me anë të dëgjimit fjalët që e përmbajnë tingullin **Zh** në pozicione të ndryshme.
- Përshkrimin e figurës qendrore.
- Saktësinë e leximit.
- Vendosjen e rrokjeve drejt për të formuar fjalë.
- Krijimin e fjalive me fjalët e formuara.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Vizatoni dy figura fjalët e të cilave përmbajnë tingullin **Zh.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shkruan drejt fjalët,fjalitë dhe i shqipton me intonacionin e duhur;
• Dallon rrokjen në fjalë;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5; III.2</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 133 -134</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Zh,zh të shtypit sipas modelit.
• Identifikon shkronjën Zh,zh në fjalët e dhëna.
• Shkruan mbi bazën e figurave.
• Ndan fjalët në rrokje shkronja sipas modelit të dhënë.
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
zebra, zarfi, zjarri, zyre</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, shkronja ilustruese, modeli i Zh, zh, etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Zh, zh në pozicione të ndryshme.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit udhëzohen të gjejnë fjalë me shkronjën zh në trup të tyre në pozicione të ndryshme.
Çdo nxënës që gjen një fjalë ngjitet në ‘’Trenin e fjalëve’’ dhe lëvizin nëpër klasë.
Shembuj fjalësh: zhavorr, zhabë, zhurmë, zhduk, zhvendos, zhvesh, zhytës, plazhi, gozhda.
Veprimet në situatë

Hapi 1. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
Shkruhet fjala ZHAVORR në tabelë dhe nxiten nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve:
-Cila fjalë është shkruar në tabelë?</td></tr>
</table>

-Për çfarë përdoret?

-Me cilën shkronjë fillon fjala **ZHAVORR**?

Njihen nxënësit me njësinë e re mësimore dhe prezantohet shkronja Zh e shtypit, e madhe dhe e vogël.

Hapi 2. Analizë & sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës **Zh**. Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë 

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën nj të vogël të shtypit .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 133 dhe lihen të shohin për disa çaste në heshtje.

Pasi ngjyrosin zhytësin, udhëzohen të kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera duke ndjekur drejtimin e shigjetës.

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të shkruajnë mbi bazën e figurave.

Shkruajnë: *llamba, lëvozhga, zhavorri, zhapiku, gozhda, kuzhina.* I lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Udhëzohen të ndajnë në rrokje e shkronja fjalët, sipas modelit të dhënë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Zh, zh.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e shkronjës **Zh, zh** të shtypit sipas modelit.
- Identifikimin e shkronjës **Zh, zh** në fjalët e dhëna.
- Saktësinë e shkrimit mbi bazën e figurave.
- Ndarjen e fjalëve në rrokje sipas modelit të dhënë.
- Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani dy rreshta me shkronjën **Zh, zh.**

Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjë **Zh, zh.**

Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjë **Zh, zh.**

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Flet për ngjarjen kryesore në tekst;
• Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.2; 2.3; 3.1; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Shkronja Zh, faqe 99</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Parashikon ngjarjen në bazë të titullit dhe figurës.
• Lexon tekstin qartë dhe saktë.
• Përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.
• Dallon titullin në pjesën e dhënë.
• Nxjerr mesazhin nga teksti i mësuar.
• Shkruan fjalë me kuptim të kundërt për të formuar fjali.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
plazhi, zhytësi, zhytja, det.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Lexim me ndalesa
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, grafiku i shkronjës Zh të shtypit të madhe e të vogël, mjete shkrimi, fletë, ngjyra.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit ndahen në dy grupe. Njëri grup shkruan shkronjën Zh të madhe të shtypit, ndërsa grupi tjetër shkruan shkronjën zh të vogël të shtypit.
Në momentin kur u thuhet FILLO, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave: Zh-zh.
Veprimet në situatë
Paraqitet fotoja e Zhytësit dhe diskutohet rreth saj.
-Çfarë po shihni në foto?</td></tr>
</table>

-Çfarë bënë zhytësi? (Zhytet në ujë, det, liqe apo lumë)

-A jeni zhytur ju në ujë ndonjëherë?

-Ku jeni zhytur?

Hapi 1. Lexim me ndalesa

Hapet libri faqe 99 në Abetare dhe u paraqitet titulli në tabelë.

Nxënësit nxiten të mendojnë për 2-3 minuta dhe duke u bazuar te titulli dhe fotografia e tekstit tregojnë se për çfarë do të mësojnë. Dëgjohen disa nxënës.

U ndahet teksti në pjesë dhe lexohet me ndalesa.

Ndalesa e parë: që nga fillimi deri te "….Dukeshin sikur na ftonin për të luajtur''

Ndihmohen me pyetjet:

-Si titullohet ky tregim?

-Ku ishte për pushime verën e kaluar personazhi i tekstit?

-Po ju, në cilin vend kaluat pushimet verën e kaluar?

-Çfarë shikonte personazhi i tekstit në plazh?

-Keni vështruar ju dallgët e detit? Si ju dukeshin ato?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë tutje?

Vazhdojmë me leximin e pjesës së dytë.

Ndalesa e dytë: ''Ne i vëzhgonim me kureshtje zhytësit që zhyteshin në det. ... deri në fund.

Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë bënin fëmijët? (Fëmijët vëzhgonin zhytësit).

-Si përshkruhen zhytësit? (Zhytësit përshkruhen të guximshëm dhe të fortë).

-Pse u pëlqenin fëmijëve ata?

-A dëshiron të bëhesh zhytës edhe ti? Pse?

-Cili është mesazhi që marrim nga ky tekst?

Diskutohen fjalët e reja nga teksti: *vëzhgoj-shikoj me vëmendje; kureshtje-dëshirë e madhe që të di më shumë për dikë a diçka.*

Nxënësit radhazi lexojnë nga dy a tri fjali.

Hapi 2. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të shkruajnë fjalët me kuptim të kundërt në fjalitë e dhëna sipas modelit të paraqitur. I lexojnë ato.





Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes në bazë të titullit dhe figurës.
- Saktësinë e leximit të tekstit.
- Përgjigjeve të pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Dallimin e titullit në pjesën e dhënë.
- Nxjerrjen e mesazhit nga teksti.
- Shkrimin e saktë të fjalëve me kuptim të kundërt për të formuar fjali.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

Lexoni tekstin bukur dhe pa gabime.

Shkruaj pjesën e pëlqyer nga teksti: ‘’Zhytje në det’’

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala</td><td colspan="4">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shkruan drejt fjalët,fjalitë dhe i shqipton me intonacionin e duhur;
• Dallon rrokjen në fjalë;
• Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5; III.2</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fletore pune, faqe 137</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan shkronjën Zh zh të dorës sipas modelit.
• Gjen fjalë me shkronjën Zh zh në pozicione të ndryshme.
• Zhvendosin fjalët për të formuar fjali.
• Shkruan me të diktuar Z, z, Zh zh .
• Shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
Zana, Zamiri, Prizreni, zogu
Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim për njohuritë paraprake
❖ Analizë & sintezë
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, tabela alfabeti, shkronja ilustruese Z, z, Zh zh , grafiku i shkronjës të shtypit dhe të dorës Z, z, Zh zh , etiketa me fjalë që përmbajnë shkronjën Z, z, Zh zh në pozicione të ndryshme.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë
Arte
Shkencat e natyrës
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësit udhëzohen të gjejnë fjalë me shkronjë Zh, zh në trup të tyre në pozicione të ndryshme dhe i paraqesin në tabelë. Qarkojnë shkronjë Zh, zh dhe tregojnë vendndodhjen e saj në fjalë.


Veprimet në situatë</td></tr>
</table>

Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësve u shpërndahen eiketa me fjalët: *plazhi, zhytësi, zhytem, deti.*

Diskutojnë në grup dhe me çdo fjalë formojnë fjali.

Shembull: Më pëlqen të vizitojë plazhin e Shëngjinit.

Lexojnë ato para të tjerëve.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Analizë dhe sintezë

Prezantohet grafiku i shkronjës . Analizohet në elementet përbërëse dhe shpjegohet mënyra e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë.

Nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 1-2 herë.

Përsëritet veprimtaria për shkronjën .

Hapi 3. Punë individuale

Hapet Fletorja e punës në faqen 134 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit shkruajnë shkronjën . Orientohen në mbajtjen e drejtimit sipas vijave duke parë modelin e dhënë. Shkruajnë rrokjet e fjalët dhe i lexojnë ato.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit udhëzohen të zhvendosin fjalët në fjali sipas modelit të dhënë.

1.Drini	**2.zhveshi**	**3.kostumin**	**4.e zhytjes.**

3.Kostumin	**4.e zhytjes**	**2. zhveshi**	**1. Drini**

1.Drini	**3.kostumin**	**4.e zhytjes**	**2.zhveshi**

2.Zhveshi	**1.Drini**	**3.kostumin**	**4.e zhytjes.**

Lexojnë fjalitë dhe rikujtojnë përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me të diktuar nga dy rreshta me **Zh, zh,** .

Vlerësohen nxënësit për:

• Shkrimin e shkronjës  të dorës sipas modelit. • Gjetjen e fjalëve me shkronjën  në pozicione të ndryshme. • Zhvendosjen e fjalëve për të formuar fjali. • Shkrimin me të diktuar të **Zh, zh,** . • Shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani nga dy rreshta me shkronjën  . Shkruani dhjetë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën . Shkruani pesë fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjën .

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Tingujt Shkronjat Rrokjet Fjala		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë; • Shkruan drejt fjalët,fjalitë dhe i shqipton me intonacionin e duhur; • Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.5		
Njësia mësimore: Përsëritje 6, (faqe 100 e Abetares)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shqipton tingujt: **Nj, Th, X, Z, Xh, Zh.** • Identifikon shkronjat e mësuara në fjalë të ndryshme (në pozicione të ndryshme). • Gjen fjalë që në trup të tyre kanë shkronjat **Nj, Th, X, Z, Xh, Zh** në pozicione të ndryshme.		**Fjalë kyçe:** binjakët, tharëse, xixëllonja, zemra, xhaketa, zhapiku. **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim për njohuritë paraprake		

• Gjen dhe ngjyros saktë fjalët e dhëna në grupin e shkronjave. • Shkruan alfabetin e gjuhës shqipe me shkronja dore.	❖ Vëzhgim- analizë ❖ Punë individuale
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, etiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara.	**Lidhja me fushat e tjera:** Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit ndahen në dy grupe
Njërit grup i shpërndahen etiketat me shkronjat e shtypit: Nj, nj, Th, th, X, x, Z, z, Xh, xh, kurse grupit tjetër shkronjat e dorës: **Nj,,nj, Th,,th, X, x, Z, z, Xh, xh,, Zh, zh.**
Lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave të shtypit dhe të dorës.
Përsëritet loja për të aktivizuar sa më shumë nxënës të klasës.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim për njohuritë paraprake
Nxënësit nxiten të gjejnë fjalë me shkronjat e mësuara.
Ja një shembull: Nj-Njomëza
U drejtohen pyetjet:
-Me cilën shkronjë fillon kjo fjalë ?
-Sa rrokje ka emri Njomëza? Me çfarë shkronje shkruhen emrat e njerëzve?
-Sa shkronja ka emri Njomëza? Ku gjendet shkronja Nj?
Vazhdohet edhe me fjalë tjera të cilat i gjejnë nxënës të ndryshëm.

Hapi 2. Vëzhgim-Analizë
Hapet libri në faqen 100 të Abetares dhe nxënësit nxiten të shqiptojnë tingujt e shkronjave të mësuara që ndodhen në krye të faqes. Rikujtojnë se janë tinguj bashkëtinglllorë dhe dallojnë shkronjat e përbëra (dyshe): **Nj, Th, Xh, Zh.**

Ushtrimi i parë: Udhëzohen të bashkojnë vizat për të formuar shkronjat e mësuara.

Ushtrimi i dytë: Analizojnë figurat e dhëna dhe shkruajnë fjalët poshtë tyre.

Shkruajnë fjalët: : *binjakët, tharëse, xixëllonja, zemra, xhaketa, zhapiku.* Identifikojnë shkronjat e mësuara në fjalët e shkruara dhe tregojnë venndodhjen e tyre në fjalë si: binjakët- shkronja *nj* gjendet në mes. Vazhdohet edhe me shembujt tjerë.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i tretë: Gjejnë fjalët: **ngrica, bubullima, vullkani, shiu, rrebeshi, tërmeti, ylberi, bora, vetëtima, stuhia, era** dhe ngjyrosin ato sipas ngjyrave përkatëse në grupin e shkronjave në kutitë e paraqitura.

T	T	Ë	R	M	E	T	I	A	A	K	X
B	B	O	R	A	C	RR	E	B	E	SH	I
V	E	T	Ë	T	I	M	A	I	I	XH	K
O	S	T	U	H	I	A	SH	I	U	T	Y
N	G	R	I	C	A	Y	L	B	E	R	I
B	U	B	U	LL	I	M	A	XH	O	TH	M
O	V	U	LL	K	A	N	I	E	R	A	L

Ushtrimi i katërt:
Nxënësit udhëzohen të shkruajnë me shkronja dore alfabetin e gjuhës shqipe.
Ngjyrosin shkronjat e mësuara. Disa nxënës e thonë alfabetin e gjuhës shqipe para të tjerëve.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxiten të gjejnë fjalë me shkronjat e mësuara dhe t'i shkruajnë saktë ato.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingujve: **Nj, Th, X, Z, Xh, Zh.**
- Identifikimin e shkronjave të mësuara në fjalë të ndryshme (në pozicione të ndryshme).
- Gjetjen e fjalëve që në trup të tyre kanë shkronjat **Nj, Th, X, Z, Xh, Zh** në pozicione të ndryshme.
- Gjetjen dhe ngjyrosjen e saktë të fjalët e dhëna në grupin e shkronjave.
- Shkrimin e alfabetit të gjuhës shqipe me shkronja dore.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Shkruani në fletore alfabetin e gjuhës shqipe me shkronja të shtypit.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td colspan="2">Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Tingujt
Shkronjat
Rrokjet
Fjala</td><td colspan="4">Rezultati i të nxënit të temës:
• Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë;
• Shkruan drejt fjalët,fjalitë dhe i shqipton me intonacionin e duhur;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5; III.2</td><td colspan="4">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Përsëritje 6, (faqe 136 e Fletore punës)</td><td colspan="4">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shqipton tingujt: Nj, Th, X, Z, Xh, Zh.
• Gjen fjalë me shkronjat Nj, Th, X, Z, Xh, Zh.
• Formon rrokje me shkronjat e mësuara.
• Bashkon rrokjet për të formuar fjalë.
• Shkruan fjalë mbi bazën e figurave.</td><td colspan="4">Fjalë kyçe:
gëzim, cirk, çelës, gjyshe, llogari, yll.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Teknika dhe strategji:
❖ Lojë
❖ Vëzhgo-analizo
❖ Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, tiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara.</td><td colspan="4">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="7">Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake
Lojë- Ecim me fjali
Nxënësit ndahen në gjashtë grupe (sipas shkronjave të mësuara). Çdo grupi u shpërndahen fletët e bardha ku shkruajnë nga një fjali duke përshkruar vendndodhjen e shkronjës përkatëse në alfabet.
Ja disa shembuj:
Grupi 1: Shkronja Nj-Shkronja Nj është shkronja e njëzet në alfabet.
Grupi 2: Shkronja Th-Shkronja Th është shkronja e njëzet e nëntë në alfabet.
Grupi 3: Shkronja X-Shkronja X është shkronja e tridhjetë e dytë në alfabet.
Grupi 4: Shkronja Z-Shkronja Z është shkronja e tridhjetë e pestë në alfabet.
Grupi 5: Shkronja Xh- Shkronja Xh është shkronja e tridhjetë e tretë në alfabet.
Grupi 6: Shkronja Zh- Shkronja Zh është shkronja e tridhjetë e gjashtë në alfabet.
Më pas, nga çdo grup dalin nxënësit dhe paraqesin fjalitë e gjetura dhe i ndajnë në fjalë, ku për çdo fjalë bëjnë nga një hap duke ecur.</td></tr>
</table>

Përsëritet veprimtaria duke përfshirë sa më shumë nxënës.

Veprimet në situatë
Hapi 1. Vëzhgo-Analizo

Hapet libri në faqen 136 të Fletore punës dhe nxënësit nxiten të shqiptojnë tingujt e shkronjave të mësuara që ndodhen në krye të faqes. Rikujtojnë se janë tinguj bashkëtinglllorë.
Ushtrimi i parë: Nxënësit udhëzohen të formojnë rrokje me shkronjat e mësuara. Rikujtojnë se rrokjet formohen duke lidhur shkronjën e mësuar me një zanore sipas modelit të dhënë.
Ushtrimi i dytë: Nxënësit udhëzohen të bashkojnë rrokjet e formave të dhëna dhe të shkruajnë fjalët: *xixa, xhepi, zogu, thika, plazhi, njëshi.* I lexojnë ato.

Hapi 3. Punë individuale

Ushrimi i tretë:
Nxënësit udhëzohen të shkruajnë fjalët mbi bazën e figurave. Fjalët e formuara janë: gjirafa, oxhaku, gjethja, valixhja.
Disa nxënës lexojnë ato para të tjerëve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:
Nxiten të gjejnë fjalë me shkronjat e mësuara dhe t'i shkruajnë ato saktë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shqiptimin e tingujve: **Nj, Th, X, Z, Xh, Zh.**
- Gjetjen e fjalëve me shkronjat **Nj, Th, X, Z, Xh, Zh.**
- Formon rrokje me shkronjat e mësuara.
- Bashkon rrokjet për të formuar fjalë.
- Shkruan fjalë mbi bazën e figurave.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

- Formoni nga një fjali me fjalë të cilat në trup të tyre kanë shkronjat: **Nj, Th, X, Z, Xh, Zh** në pozicione të ndryshme.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla:1</td><td>Klasa1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
• Flet për ngjarjen kryesore në tekst;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4.</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.2; 2.3; 3.1</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Përsëritje 6, (faqe 101, Abetare)</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shton fjalët mungesore për të formuar fjali kuptimplota.
• Analizon fotot nga teksti.
• Vendos fjalët ndihmëse në vendin e duhur.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Ritregon përmbajtjen e tekstit në mënyrë të përmbledhur.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe:
stuhia, Drini, mësuesja, dielli</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
❖ Diskutim
❖ Lexim/Analizo/Plotëso
❖ Rishikim në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Libri i nxënësit, shkronja ilustruese, tiketa me shkronja, foto me figura të shkronjave të mësuara.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake

Nxënësve në grupe u shpërndahen fishat me fjalë mungesore. Shtojnë fjalë për të formuar fjali me kuptim. Fjalët ndihmëse: binjake, zhytësit, tharjen, zemër, natën, xhaketë.

Njomëza dhe Manjola janë
Zhytësi vesh rrobat e
Tharësja shërben për e flokëve.</td></tr>
</table>

Nënën	**time**	**e**	**dua**	**me**	

Xixëllonja	**xixëllon**		

Zana	**bleu**	**një**	**të kuqe.**

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutim
Nxënësit paraqesin fjalitë e formuara. I lexojnë dhe secili grup paraqet numrin e fjalëve në fjali. Rikujtojnë përdorimin e shkronjës së madhe në fjali.

Hapi 2.Lexo/Analizo/Plotëso

Hapet libri në faqen 101 të Abetares dhe nxënësit njoftohen me temën.
Ushtrimi i parë:

Nxënësit nxiten të analizojnë titullin dhe fotot e paraqitura.

U drejtohen pyetjet:

-Për çfarë do të mësojmë?

-Si është titulli i tregimit?

-A është tregimi i kuptimtë? Pse?

Theksohet se kur mungon ndonjë fjalë në fjali, ajo nuk është kuptimplotë.

Pas analizës së fotove vendosin fjalët në vendin e duhur për të krijuar tregimin me kuptim.

U sqarohet se tregimi përmban: hyrjen, zhvillimin e ngjarjes dhe mbylljen.

Shembull:

Hyrja e tregimit: Bie shi dhe **fryn** erë e fortë. **Jashtë** ka filluar stuhia.

Zhvillimi i ngjarjes: Drini **trembet.** Ai ka frikë nga bubullimat e **vetëtimat.**

Mësuesja i qetëson **fëmijët.**

Ajo u thotë të vizatojnë një **diell.**

Mbyllja e tregimit: Kur e përfundojnë **vizatimin** nxënësit e ngjitin në **tabelë.** Ata **buzëqeshin.**

Lexojnë shkrimet e tyre. Tregojnë përmbajtjen e tregimit në mënyrë të përmbledhur.

Hapi 3. Rishikim në dyshe

Nxënësit shkëmbejnë librat mes vete, korrigjojnë gabimet dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Nxiten të tregojnë përmbajtjen e tregimit.

Vlerësohen nxënësit për: • Shton fjalët mungesore për të formuar fjali kuptimplota. • Analizon fotot nga teksti. • Vendos fjalët ndihmëse në vendin e duhur. • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Ritregon përmbajtjen e tekstit në mënyrë të përmbledhur.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruani në fletore përmbajtjen e tregimit të mësuar.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dallon elemente themelore të poezisë nga proza; • Flet për ngjarjen kryesore në tekst;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.; I.3; I.4; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3;1.4; 2.1;2.2; 2.3	
Njësia mësimore: Ne tani lexojmë vetë			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon vjershën me intonacion. • Tregon që e ka kuptuar përmbatjen e vjershës duke përmendur çështjet kryesore. • Identifikon strofat në vjershë. • Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.			**Fjalë kyçe**: vjershë, strofë, varg, gaz, librari, sodit **Teknika dhe strategji:** • Imagjinatë e drejtuar • Bisedë • Lexim përmbledhje në dyshe • Punë individuale	
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, libra të ndryshëm për fëmijë, mjete shkrimi.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake***				

Dëgjohet kënga “Abetare, Abetare”.

Abetare, Abetare,
sillma diellin në dritare!
Lehtë, lehtë e bukur, bukur,
dora ime sa e lumtur;
Hap një faqe, kthen një
fletë,
nëpër shkronja –Bota vetë.
Rrjedh në fjalë plot kumbim
gjuhë e lasht e vendit tim.
Me ty mendjen lartësoj,
me ty zemrën e gëzoj,
bëhem zog e fluturoj,
Abetare.
Abetare, Abetare,
Ti je dielli në dritare.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Imagjinatë e drejtuar

Nxiten nxënësit të mbyllin sytë dhe të kujtojnë për një çast ditën e parë të shkollës. Më pas hapin sytë dhe i ndajnë kujtimet e tyre me të tjerët. Ndihmohen me pyetjet:

-Çfarë mbani mend nga dita e parë e shkollës? Si u ndjetë kur hytë në klasë?

-Po kur morët librin e Abetares në dorë?

-Çfarë na mësoi Abetarja?

Tregohet kujdes që nxënësit të dëgjojnë më vëmendje njëri-tjetrin.

Hapi 2. Bisedë

Bëhet një prezantim i pjesës së tretë të librit të Abetares (Lexime), përmbajtjes dhe qëllimit që ka kjo pjesë për përforcimin e leximit.

Njihen nxënësit me temën e mësimit. ▼

-Pse vjersha titullohet “Ne tani lexojmë vetë”?

Hapi 3. Lexim përmbledhje në dyshe

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të lexojnë në heshtje.

Vjersha lexohet me strofa duke punuar në dyshe: për strofën e parë një nxënës e lexon kurse tjetri përmbledh përmbajtjen e saj. Pasi e lexojnë në heshtje për disa minuta, dëgjohen disa dyshe.

Për strofat e tjera nxënësit ndërrojnë rolet.

Gjatë leximit nënvizojnë fjalët qe nuk i kuptojnë dhe diskutohet për kuptimin e tyre duke u bazuar edhe te rubrika” Shtëpia e fjalëve”.

Tërhiqet vëmendja e nxënësve te lloji i tekstit: është vjershë, shkruhet në vargje e strofa.

Hapi 4. *Punë individuale*

Udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

-Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” gjejnë alternativën e saktë dhe shënojnë me √.

-Në rubrikën "Shkruaj" nxënësit gjejnë në vjershë fjalët që rimojnë me njëra-tjetrën dhe i shkruajnë sipas modelit: *mirë – dëshirë fletë - vetë librari - të ri plot - sot gjithmonë - jonë*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Lexim zinxhir i vjershës nga nxënësit.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e vjershës me intonacion.
- Identifikimin e strofave në vjershë.
- Përmbledhjen e përmbajtjes duke përmendur çështjet kryesore.
- Ndarjen me të tjerët të përvojave të tyre rreth leximit.

Detyra shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

-Mësoni vjershën përmendësh

-Shkruani strofën që ju pëlqen.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Emri, mbiemri, përemri			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Kupton, dallon dhe përdorë drejtë emrin, mbiemrin dhe përemrin;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.7; 3.2; 3.7	
Njësia mësimore: Fjalë që tregojnë njerëz			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Dallon emrat që tregojnë njerëz. • Gjen emra që tregojnë njerëz. • Përdor drejt shkronjën e madhe për emrat e njerëzve. • Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.			**Fjalë kyçe**: emër, bukëpjekës, sportist, zjarrfikës, postier, kopshtar. **Teknika dhe strategji:** • Shkrim i shpejtë • Vëzhgo –Diskuto • Rishikim në dyshe	

Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, mjete shkrimi.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukim për shoqërinë **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit të dëgjojnë gjëegjëzën për *emrin:*

Çfarë të përket ty,
por njerëzit e tjerë
e përdorin më shumë se ti?

Veprimet në situatë

Hapi 1. Shkrim i shpejtë

Nxiten nxënësit të shkruajnë brenda 5' fjalë që emërtojnë çdo gjë që shohin në klasën e tyre.

Pasi mbaron koha, nxënësit lexojnë fjalët që kanë shkruar.

Njihen me konceptin e emrit si fjalë që emërton njerëz, kafshë, sende, vende.

Më pas u kërkohet që emrat që ata gjetën dhe që emërtojnë njerëz, t'i shkruajnë në tabelë.

Hapi 2. Vëzhgo –Diskuto

Në tabelë shkruhen disa emra, p.sh.: *shtëpi, gjysh, peshk, hallë, lule, Besnik, mik, oborr, shoqe, Ilir, shofer.*

Nxiten nxënësit të identifikojnë emrat që tregojnë njerëz.

Duke diskutuar me gjithë klasën, nënvizohen emrat që do të gjejnë.

- Pse disa emra janë shkruar me shkronjë të madhe në fillim?

Bëhet dallimi midis emrave që tregojnë njerëz dhe emrave të veçantë që u vendosen njerëzve.

Nxiten të tregojnë ëmra të tjerë që tregojnë njerëz.

Hapi 3. Rishikim në dyshe

Hapet Fletorja e punës në faqen 138 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi 1: Lexohen fjalët e dhëna dhe lidhen me figurat përkatëse.

Më pas shkruajnë vetëm fjalët që tregojnë njerëz: vajzë, djalë, mësuese, doctor, police.

Ushtrimi 2: Në mënyrë individuale plotësojnë fjalitë me fjalën e duhur sipas modelit:

Ai që bën bukë, quhet ***bukëpjekës***

Ai që luan sport, quhet ***sportist.***

Ai që fik zjarrin, quhet ***zjarrfikës.***

Ai që shpërndan letrat, quhet ***postier.***

Ai që kujdeset për kopshtin, quhet ***kopshtar.***

Në përfundim të ushtrimeve, nxënësit shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

U lexohet nxënësve një tregim i shkurtër për fëmijë. Gjatë dëgjimit nxënësit do të mbajnë shënim emrat që tregojnë njerëz.

Unë quhem Erblina. Familja ime jeton në një qytet të vogël të gjelbëruar me pemë bliri. Ne periudhën maj - qershor era e blirit mbush qytetin. Duket sikur jeton në një botë përrallash. Unë linda në qershor. Mami im i pëlqente lulet e blirit dhe i kishte kërkuar babit të më quanin Erblina. Unë jam e lumtur me emrin tim. Më duket sikur aroma e blirit më shoqëron ngado.

Në fund lexojnë emrat që gjetën dhe diskutohet me gjithë nxënësit nëse i kanë gjetur saktë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Dallimin e emrave që tregojnë njerëz.
- Gjetjen e emrave që tregojnë njerëz.
- Përdorimin drejt të shkronjës së madhe për emrat e njerëzve.
- Demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.

Detyra shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

-Shkruani 10 emra që tregojnë njerëz.

-Formoni fjali me dy prej tyre.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
• Flet për ngjarjen kryesore në tekst;</td></tr>
<tr><td colspan="4">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4;III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.3;1.4; 2.2; 2.3; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore:
Legjenda e luledielit (ora I)</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="4" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
• Lexon me intonacion.
• Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar.
• Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
luledielli, legjendë, disk</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve
• Veprimtari me dëgjim – mendim të drejtuar (VDMD)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të luledielit dhe luleve të tjera, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet kënga për fëmijë “Sa i dua lulet”.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Stuhi mendimi
Nxiten nxënësit të tregojnë çfarë dinë për lulet.
Shkruhen mendimet e tyre pa i komentuar.
Njihen nxënësit me temën e mësimit.

</td></tr>
</table>

Hapi 2. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të shikojnë figurën.

Lexohet titulli dhe nxiten të tregojnë se çfarë mund t'u ketë ndodhur luleve.

Pasi mendohen për disa caste, dëgjohen disa nxënës.

Hapi 3. *Veprimtari me dëgjim –mendim të drejtuar VDMD*

Kërkohet vëmendja e nxënësve për të kuptuar mënyrën si do veprohet. Lexohet teksti me ndalesa dhe pas çdo pjese drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1: Që nga fillimi deri te … *nuk duket aq e bukur.*

-Ku çeli lulja? Si ishte ajo?

-Çfarë bënë lulet e tjera? Po kafshët?

-Ç'mendim keni për veprimin e tyre?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 2: Që nga *Dielli po e shikonte...* deri te …*Sa u gëzua lulja!*

-Cili po e shikonte nga lart?

-Çfarë vendosi të bënte ai? Pse?

-Si mendoni, pse u gëzua lulja?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 3: Që nga *Lulet e tjera*… deri në fund.

-Çfarë bënë lulet e tjera?

-Pse lulja e diellit kthen kokën nga dielli?

-Ç'mendim keni për këtë?

-Cili nga ju e parashikoi kështu ngjarjen?

Diskutohen fjalë të reja që mund të kenë nxënësit.

Lexim i tekstit në heshtje.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin me intonacion.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.
- Ndarjen me të tjerët të përvojave të tyre rreth leximit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Ritregoni përmbajtjen shkurt.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="4">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
• Flet për ngjarjen kryesore në tekst;</td></tr>
<tr><td colspan="4">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4.III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.3;1.4; 2.2; 2.3; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore:
Legjenda e luledielli (ora II)</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="4" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacion.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
• Zgjeron fjalorin me fjalë të reja.
• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.
• Lidh pjesën me përvoja personale.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: luledielli, legjendë, disk</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Pyetja sjell pyetjen
• Lexim, përmbledhje në dyshe
• Diskutim
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të luledielli dhe luleve të tjera, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Vizatohet një luledielli në tabelë. U shpërndahen nxënësve etiketa me shkronjat që formojnë fjalën luledielli. Nxënësit i ngjitin
</td></tr>
</table>

shkronjat te petalet e lules dhe lexojnë fjalën.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Pyetja sjell pyetjen

Nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve që lidhen me përmbajtjen:

- Si titullohet mësimi? Pse titullohet kështu? Ku çeli lulja? Si ishte ajo? Çfarë bënin lulet e tjera? Po kafshët? Çfarë vendosi të bënte dielli? Pse? Çfarë bënë lulet e tjera? Pse u mërzitën ato?

Hapi 2. Lexim, përmbledhje në dyshe

Njëri nga nxënësit lexon paragrafin e parë dhe tjetri bën përmbledhjen me 1-2 fjali .

Ndërrohen rolet në paragrafin pasardhës.

Hapi 3. Punë individuale

Në rubrikën "**Shkruaj"** nxënësit në dyshe ose individualisht lidhin fjalët:

lule + dielli = luledielli, lule + shtrydhe = luleshtrydhe, lule + bore = lulebore, lule + dele = luledele, lule + shpatë = luleshpatë, lule + lakër = lulelakër, lule+ shqerrë = luleshqerrë, lule + verdhë = luleverdhë.

Ndihmohen që të nënvizojnë në tekst fjalët që tregojnë veprim.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Diskutim**:** Udhëzohen nxënësit hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Në rubrikën "**Lexoj dhe kuptoj"** nxiten të japin mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato:

-Pse u habitën lulet në kopsht?

-Ç'mendim keni për veprimin e tyre?

-A ju ka ndodhur të ndiheni si lulja e diellit nga ndonjë sjellje e shokëve?

-Si keni vepruar?

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin rrjedhshëm dhe me intonacion.
- Përgjigjet e pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Zgjerimin e fjalorit me fjalë të reja.
- Lidhjen e përvojave personale me ngjarjen.

Detyra shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

-Shkruani pjesën që ju pëlqeu më shumë.

-Formoni nga një fjali me fjalët: dielli, luledielli, lulet e tjera.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Emri, mbiemri, përemri</td><td colspan="3">Rezultati i të nxënit të temës:
• Kupton, dallon dhe përdorë drejtë emrin, mbiemrin dhe përemrin.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5; III.5</td><td colspan="3">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 2.1; 2.2; 3.6</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fjalë që tregojnë kafshë</td><td colspan="3">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Dallon emrat që tregojnë kafshë.
• Gjen emra që tregojnë kafshë.
• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe: lopë, lepur, breshkë, luan, kalë</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknika dhe strategji:
• Imagjinatë e drejtuar
• Vëzhgo –Diskuto
• Rishikim në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, libra me përralla për fëmijë, mjete shkrimi.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës
Lidhja e me temat ndërkurrikulare
Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxiten nxënësit të tregojnë për përrallën e tyre të preferuar.
- Cila është përralla juaj e preferuar?
- Pse ju pëlqen?

Veprimet në situatë
Hapi 1. Imagjinatë e drejtuar
Nxiten nxënësit të dëgjojnë një përrallë të shkurtër.
Në një pellg të vogël me ujë jetonte një bretkosë e mirë. Erdhi vera e nxehtë dhe pellgu dita-ditës zvogëlohej. Bretkosa e kuptoi se pas pak kohësh aty s'do të mbetej më asnjë pikë ujë dhe u pikëllua. Si mund të jetonte ajo pa pellgun?
Një ditë, një pëllumb që pinte ngaherë ujë në pellg, shtangu nga trishtimi i bretkosës. Ajo i tregoi për fatin e keq që e priste. Pëllumbi u largua pa thënë asnjë fjalë.</td></tr>
</table>

Pak më vonë ai u kthye bashkë me një mikun e tij të afërt, lejlekun sqepgjatë. Bretkosa e mori me mend se kishin ardhur ta ndihmonin.
Lejleku e mori bretkosën me sqepin e tij dhe bashkë me pëllumbin zemërmirë fluturuan gjatë. Ata qëndruan buzë një pellgu të madh mes pyjesh. Bretkosa ndihej e lumtur.

- Cilat kafshë përmenden në përrallë?

Hapi 2. Vëzhgo –Diskuto

Në tabelë shkruhen disa emra, p.sh.: *mësuese, libër, lepur, laps, mi, deve, kukull*

Nxiten nxënësit të identifikojnë emrat që tregojnë kafshë.

Duke diskutuar me gjithë klasën, nënvizohen emrat që do të gjejnë.

Nxiten të tregojnë ëmra të tjerë që tregojnë kafshë.

Hapi 3. Rishikim në dyshe

Hapet Fletorja e punës në faqen 139 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi 1: Lexohen fjalët e dhëna dhe lidhen me figurat përkatëse.

Më pas shkruajnë vetëm fjalët që tregojnë kafshë: lopë, lepur, breshkë, luan, kalë.

Ushtrimi 2: Në mënyrë individuale plotësojnë fjalitë me fjalën e duhur sipas modelit:

I vogli i qenit quhet këlysh.

I vogli i maces quhet kotele.

I vogli i kalit quhet mëz.

Ushtrimi 3: Në mënyrë intuitive nxënësit do të shkruajnë emrat e dhënë në trajtën e shquar:

qen- qeni peshk-peshku dhelpër -dhelpra dele-delja luan-luani

Në përfundim të ushtrimeve, nxënësit shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shënoni √ pranë emrave që tregojnë kafshë:

dollap zog akullore majmun top gomar mik qen kompjuter lopë

Diskutojnë gjetjet me gjithë klasën.

Vlerësohen nxënësit për:

- Dallimin e emrave që tregojnë kafshë.
- Gjetjen e emrave që tregojnë kafshë.
- Demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.

Detyra shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

-Shkruani 10 emra që tregojnë kafshë.

-Formoni fjali me dy prej tyre.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Dallon formën e përrallëzës, përrallës, tregimit, gjëegjëzës, fjalëve të urta urimeve, shënimeve personale, mesazheve etj.;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Ditëlindja e Blinit</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon tekstin me intonacion.
• U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
• Zgjeron fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja.
• Lidh përvojat personale me ngjarjen.
• Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: ditëlindje, festë e Pavarësisë, dhuratë, emocion</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Harta semantike
• Veprimtari me dëgjim – mendim të drejtuar (VDMD)
• Pyetja sjell pyetjen</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto nga festimet e ditëlindjeve, foto nga festimet e festës së Pavarësisë, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shoqëria dhe mjedisi
Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Edukimi për paqe</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Në tabelë vendosen në mënyrë të ngatërruar etiketa me shkronjat që formojnë fjalën ditëlindje.
Nxiten nxënësit të gjejnë cila fjalë formohet me to.
- Kur e keni ditëlindjen?
- Çfarë ju pëlqen më shumë nga kjo festë?
Njihen nxënësit me temën e mësimit. ▼</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1. *Harta semantike*

Zgjedh fjalën ditëlindje për të punuar me hartën semantike:



Hapi 3. *Veprimtari me dëgjim –mendim të drejtuar (VDMD)*

Kërkohet vëmendja e nxënësve për të kuptuar mënyrën si do veprohet. Lexohet teksti me ndalesa dhe pas çdo pjese drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1: Që nga fillimi deri te … *të festojë bashkë me shokët.*

-Pse Blini ishte i lumtur?

-Çfarë dini për festën e Pavarësisë?

-Pse priste me emocion?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 2: Që nga *Ana, Drini , Jona……* deri te …*urimet e tyre për Blinin.*

-Kush erdhi në ditëlindje?

-Çfarë i sollën shokët?

-Si ndihej Blini?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 3: Që nga *Ana e Drini fillojnë*… deri te …*tortën e ditëlindjes.*

-Çfarë bënë fëmijët në festë?

-Pse u fikën dritat?

- Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 4: Që nga *Fëmijët këndojnë*… deri në fund.

-Çfarë bënë fëmijët kur erdhi torta?

-Si ndihej Drini në atë cast?

-Si mund ta kenë festuar Ditën e Pavarësisë së Kosovës?

Diskutohen fjalë të reja që mund të kenë nxënësit.

Lexim i tekstit në heshtje.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Lezim zinxhir nga secili nxënës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin rrjedhshëm dhe me intonacion.
- Përgjigjet e pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Lidhjen e përvojave personale me ngjarjen.
- Ndarjen me të tjerët të përvojave të tij rreth leximit.

Detyra shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

-Lexoni tregimin rrjedhshëm.

-Shkruani 3 fjali për ditëlindjen tuaj.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dallon formën e përrallëzës, përrallës, tregimit, gjëegjëzës, fjalëve të urta urimeve, shënimeve personale, mesazheve etj.;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2	
Njësia mësimore: Ditëlindja e Blinit			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: **Nxënësi:** • U përgjigjet pyetjeve që lidhen me përmbajtjen. • Lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacion. • Tregon përmbajtjen me fjalë të thjeshta duke përmendur çështjet kryesore. • Përshkruan personazhet duke u mbështetur në përshkrimet, veprimet e tyre dhe marrëdhëniet me personazhet e tjera. • Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.			**Fjalë kyçe**: ditëlindje, festë e Pavarësisë, dhuratë, emocion, kartolinë **Teknika dhe strategji:** • Pyetja sjell pyetjen • Lexim, përbledhje në dyshe • Tabela e personazheve • Harta e ngjarjes	

Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto nga festimet e ditëlindjeve, foto nga festimet e festës së Pavarësisë, grafiku "Harta e ngjarjes", kartolina, mjete shkrimi.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për paqe

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësit tregojnë foto nga festimi i ditëlindjes së tyre dhe lexojnë kartolina që mund të kenë marrë për ditëlindje.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Pyetja sjell pyetjen

-Pse Blini ishte i lumtur? Cilat ishin dy gëzimet e tij? Çfarë i sollën shokët? Çfarë bënë fëmijët në festë? Pse u fikën dritat? Çfarë bënë fëmijët kur erdhi torta? Si ndihej Drini në atë cast? Si mund ta kenë festuar Ditën e Pavarësisë së Kosovës?

Paraqiten foto nga festimet e Ditës së Pavarësisë së Kosovës dhe shoqërohen me një bisedë të shkurtër për këtë ditë.

Hapi 2. Lexim, përmbledhje në dyshe

Njëri nga nxënësit lexon paragrafin dhe tjetri bën përmbledhjen me 1-2 fjali.

Ndërrohen rolet në paragrafin pasardhës.

Lexohen kartolinat që i dërguan shokët Blinit dhe zgjedhin atë që ju pëlqen më shumë duke argumentuar mendimet e tyre për zgjedhjen.

Hapi 3. Tabela e personazheve

Nxënësit punojnë në dyshe për të plotësuar tabelën.

Personazhi	Çfarë priste?	Si ndihej?	Çfarë ka të përbashkët me ty?
Blini			

Lexohet nga disa nxënës dhe diskutohet. Për çdo ide që japin, nxënësit do të gjejnë fjalinë ilustruese në tekst.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në dyshe ose me gjithë klasën punohet grafiku “Harta e ngjarjes” (shiko në faqen më poshtë).

Lexohet nga disa dyshe.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përgjigjet e pyetjeve që lidhen me përmbajtjen.
- Leximin e tekstit rrjedhshëm dhe me intonacion.
- Përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazheve duke u mbështetur në përshkrimet, veprimet e tyre dhe marrëdhëniet me personazhet e tjera.
- Ritregimin e përmbajtjes me fjalë të thjeshta duke përmendur çështjet kryesore.
- Ndarjen me të tjerët të përvojave të tyre rreth leximit.

Detyra shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani një kartolinë për ditëlindjen e shokut ose të shoqes.

Titulli: _____



Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Emri, mbiemri, përemri			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Kupton, dallon dhe përdorë drejtë emrin, mbiemrin dhe përemrin.	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.5			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 2.2; 3.5	
Njësia mësimore: Fjalë që tregojnë sende			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Dallon emrat që tregojnë sende. • Gjen emra që tregojnë sende. • Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore (*në mënyrë intuitive*). • Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.			**Fjalë kyçe**: oxhak, balonë, çadër, xhup, shall, libër **Teknika dhe strategji:** • Veprimtari në dyshe • Vëzhgo –Diskuto- Plotëso • Punë individuale	
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, mjete shkrimi.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës **Lidhja e me temat ndërkurrikulare** Mjedisi	

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit të përshkruajnë klasën e tyre duke emërtuar çdo objekt që shohin.

- Si është klasa juaj?
- Ku i vendosni mjetet e punës?
- Çfarë ka në mure? Po në dritare? Etj.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Veprimtari në dyshe

Në një fletë letre nxënësit do të shkruajnë emrin e një sendi që ndodhet në klasë, p.sh. dollap, tavolinë, laps, libër, etj. Lexohen emrat që kanë shkruar nxënësit dhe theksohet se këta emra tregojnë sende.

Nxiten ta shkruajnë emrin sipas modelit *libër-libri, dritare - dritarja.*

Në një tabelë të përbashkët shkruhen emrat e gjetur nga nxënësit.

i	a
libri	dritarja

Theksohet se emrat e shtyllës së parë janë emra mashkullorë, kurse emrat e shtyllës së dytë janë emra femërorë.

Hapi 2. Vëzhgo –Diskuto-Plotëso

Hapet Fletorja e punës në faqen 140 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi 1: Lexohen fjalët e dhëna dhe lidhen me figurat përkatëse.

Më pas shkruajnë vetëm fjalët që tregojnë sende: oxhak, balonë, çadër, xhup, shall, libër**.**

Ushtrimi 2: Në mënyrë individuale shkruajnë fjalët aty ku duhet duke ndjekur shembullin:

Mbarojnë me a - *dardha, domatja, molla.*

Mbarojnë me i – *speci, limoni, lapsi*

Në përfundim të ushtrimeve, diskutohet puna kolektivisht.

Hapi 3. Punë individuale

Në tregimin "Ditëlindja e Blinit" nënvizojnë emrat që tregojnë sende.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Gruponi emrat në tabelën e mëposhtme: *lugë, lepur, tryezë, kushëri, derë, nxënës, gjarpër, qengj, mami.*

njerëz	kafshë	sende

Vlerësohen nxënësit për:

- Dallimin e emrave që tregojnë sende.
- Gjetjen e emrave që tregojnë sende.
- Dallimin e emrave të gjinisë femërore nga ata mashkullore (*në mënyrë intuitive*).
- Demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.

Detyra shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

-Shkruani 10 emra që tregojnë sende.

-Formoni fjali me dy prej tyre.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
Dallon formën e përrallëzës, përrallës, tregimit, gjëegjëzës, fjalëve të urta urimeve, shënimeve personale, mesazheve etj.;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Vizatuesja e vogël, faqe 106 (ora I)</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
Përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar.
Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: vajza, mami, vizatimi</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
Stuhi mendimi
Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve
Veprimtari me dëgjim – mendim të drejtuar (VDMD)</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të kafshëve, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet kënga për fëmijë “Ciu-ciu zogu i vogël’’, të cilën mund ta gjeni në këtë vegëz nga you tube:
https://youtu.be/YDZRgtDoiDE</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1. Stuhi mendimesh

Nxënësit nxiten të tregojnë çfarë dinë për kafshët. Numërojnë disa kafshë shtëpiake dhe disa kafshë të egra.



Përgjigjet e tyre i shkruajmë në tabelë.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të shikojnë figurën.

Lexohet titulli dhe nxiten të tregojnë se çfarë mund t'u ketë ndodhur vizatueses së vogël.

Pasi mendohen për disa çaste, dëgjohen disa nxënës.

Hapi 3. Veprimtari me dëgjim –mendim të drejtuar VDMD

Kërkohet vëmendja e nxënësve për të kuptuar mënyrën si do veprohet.

Lexohet teksti me ndalesa dhe pas çdo pjese drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1: Që nga fillimi deri te … Vizato macen.

U drejtohen pyetjet*:*

-Çfarë po bisedonte vajza me mamin e saj?

-Po mami, çfarë i propozoi?

-Çfarë vizatoi vajza?

-Ç'mendim keni për vajzën?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 2: Që nga: *Ja e vizatova* ... deri te …*Po mirë po e provoj një herë.*

-Si e vizatoi vajza macen?

-Çfarë vizatoi tutje?

-Si mendoni, përse vajza nuk dëshironte të vizatonte ujkun?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 3: M'i sill pak gërshërët… deri në fund.

-Përse i kërkonte vajza gërshërët?

-Çfarë bëri me to?

-Ç'mendim keni për këtë?

-Përse vajza nuk binte për të fjetur?

-Çfarë mendimi keni për vajzën? Pse?

-A arriti vajza të përfundonte vizatimin? Pse?

-Cili nga ju e parashikoi kështu ngjarjen?

-Ndërmjet kujt po zhvillohet biseda?
Diskutohen fjalë të reja që mund t'i kenë hasur gjatë leximit.
Lexim i tekstit në heshtje.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Përgjigjet e pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.
- Ndarjen me të tjerët të përvojave të tyre rreth leximit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Lexoni tregimin disa herë.

Ritregoni përmbajtjen e tij në fletore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dallon formën e përrallëzës, përrallës, tregimit, gjëegjëzës, fjalëve të urta urimeve, shënimeve personale, mesazheve etj.;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2	
Njësia mësimore: Vizatuesja e vogël, faqe 107 (ora II)			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Tregon kafshën e pëlqyer. • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.			**Fjalë kyçe**: vajza, mami, vizatimi **Teknika dhe strategji:** • Stuhi mendimesh • Lexo/Analizo/Plotëso	

• Plotëson fjalitë e sakta me V dhe ato të gabuara me G. • Përshkruan vizatuesen e vogël duke përdorur fjalët ndihmëse.	• Shkrimi i orientuar
Burimet e informacionit dhe mjete: teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të kafshëve, mjete shkrimi.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësve u shpërndahen fletët dhe udhëzohen të përfundojnë vizatimin e vizatueses së vogël, pasi atë e kishte zënë gjumi.

Punimet e tyre i vendosin në një kënd të klasës.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Stuhi mendimesh

Nxënësit nxiten të përshkruajnë kafshën e tyre të preferuar. Përshkrimet i bëjnë me disa fjali dhe presin nga të tjerët të gjejnë se për cilën kafshë është fjala.

Shembull:

Ka gëzofin me dy ngjyra: të bardhë dhe të hirtë. Ajo ka dhëmbë shumë të mprehtë dhe sy të verdhë. Unë kujdesem për të. Ajo e pastron veten, por edhe unë e mbaj të pastër dhe të rregullt. E ushqej me ushqim të thatë dhe qumësht, por ajo gjithashtu e do peshkun dhe mishin. Ajo është lozonjare. Ndonjëherë më gërvisht me kthetrat e saj. I pëlqen të dalë jashtë në kopshtin tonë, ku nganjëherë ngjitet në pemë. Ndonjëherë ajo kap minj ose zogj. (Macja)

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Lexo/Analizo/Plotëso

Nxënësit hapin librin dhe radhazi lexojnë nga tri fjali.

Ushtrimi 1: Lexojnë fjalitë, analizojnë secilën prej tyre dhe në kutizat e zbrazëta shkruajnë me V, nëse pohimi është i vërtetë dhe me G nëse është i gabuar.

Mami dhe vajza po përgatitin biskota. G

Vajza nuk di se çfarë të vizatojë. V

Vazhdohet edhe me shembujt tjerë.

Ushtrimi i dytë: Ritregojnë përmbajtjen e tregimit.

Ushtrimi i tretë: Diskutojmë së bashku rreth pyetjeve:

-Pse vajza i preu me gërshërë vizatimet që bëri?

-Si mendoni, ujku është i mirë apo i keq? Nëse po, pse, nëse jo pse.

Arsyetojnë mendimet e tyre.

Hapi 3. Shkrim i orientuar

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fjalitë për të përshkruar vajzën në figurë. Emrin e vajzës ia vendosin sipas dëshirës. Fjalitë tjera i plotësojnë duke përdorur fjalët ndihmëse: *këpucë, të vogël, të zinj, çorape, kafe, vizatimi.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Përshkruajnë vizatuesen e vogël dhe emërtojnë atë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.
- Ndarjen me të tjerët të përvojave të tyre rreth leximit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani pjesën e pëlqyer nga teksti.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Dallon formën e përrallëzës, përrallës, tregimit, gjëegjëzës, fjalëve të urta urimeve, shënimeve personale, mesazheve etj.;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Kush e hëngri akulloren, faqe 108</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
• Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar.
• Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: arushi, ëmbëltorja, akullore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimesh
• Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve
• Lexim me ndalesa</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të kafshëve, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Nxënësve në grupe u shpërndahen etiketat me shkronjat: A, LL, O, K, U, J, R, A dhe udhëzohen të formojnë fjalë me ato shkronja. Diskutojnë në grup dhe gjejnë fjalën: AKULLORJA.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Stuhi mendimesh</td></tr>
</table>

Nxënësit nxiten të tregojnë çfarë dinë për akulloren.



Përgjigjet e tyre i shkruajmë në tabelë.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të shikojnë figurën.

Lexohet titulli dhe nxiten të tregojnë se çfarë shohin në foto, çfarë mban arushi në dorë, çfarë mund të ketë ndodhur, çfarë gabimi mund të ketë bërë arushi.

Pasi mendohen për disa çaste, dëgjohen disa nxënës.

Hapi 3. Lexim me ndalesa

Lexohet vjersha me ndalesa në strofa dhe pas çdo strofe, u drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1: Që nga fillimi deri te …gishtat lëpinin.

U drejtohen pyetjet:

-Ku gjendej ëmbëltorja?

-Çfarë kishte aty?

-Si vepronin vizitorët në ëmbëltore? Pse?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 2: Që nga: *Një ditë, kur doli dielli* ... deri te …*e na kërkon dy akullore.*

-Çfarë moti ishte kur shkoi arushi në ëmbëltore?

-Cila stinë është?

-Çfarë bleu ai?

-Si mendoni, për kë e bleu akulloren e dytë?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 3: Akulloren e parë, miku arush… deri në fund.

-Si e hëngri arushi akulloren? Pse?

-Ç'bëri arushi me akulloren e dytë?

-Ç'mendim keni për arushin?

-Cilët janë personazhet e kësaj vjershe?

-Cili nga ju e parashikoi kështu ngjarjen?

-Çfarë ju pëlqeu më shumë nga kjo vjershë?

-Po ju, a keni blerë ndonjëherë vetë akullore? Për kë?

Diskutohen fjalë të reja që mund t'i kenë hasur gjatë leximit.

Lexim i tekstit në heshtje.

Ushtrimi i parë: Shenjëzojnë me √ përgjigjet e sakta.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Përgjigjet e pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.
- Ndarjen me të tjerët përvojat e tyre rreth leximit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani strofën që ju pëlqen më shumë nga kjo vjershë.

Vizatoni një lule dhe një diell. Shkruani brenda tyre fjalë zemre për mamin.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
Dallon formën e përrallëzës, përrallës, tregimit, gjëegjëzës, fjalëve të urta urimeve, shënimeve personale, mesazheve etj.;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Varka-çadër, faqe 109</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit orës mësimore:
Nxënësi:
Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
Përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar.
Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
Diskutim për njohuritë paraprake
Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve
Lexim me ndalesa</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të kafshëve, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet kënga ‘’Shi, shi, largohu ti’’, të cilën mund ta gjeni në you tube në vegëzën e mëposhtme:
https://youtu.be/dmZ2KKs7g7E.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Diskutim i përbashkët
Nxënësit nxiten të tregojnë se çfarë bëjnë në një ditë me shi. Pyetje për diskutim:</td></tr>
</table>

-Si bëhet qielli kur bie shi?

-Si është shiu kur e prek?

-Në cilën stinë bie shi më shpesh?

-Çfarë bëni në një ditë me shi?

-Kur jeni duke luajtur dhe fillon të bjerë shi, si veproni?

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të shikojnë figurën.

Lexohet titulli dhe nxiten të përshkruajnë figurën në detaje.

Pasi mendohen për disa çaste, disa nxënës tregojnë se çfarë bëjnë fëmijët, çfarë mund të ketë ndodhur dhe me çfarë po luanin fëmijët.

Hapi 3. Lexim me ndalesa

Lexohet vjersha me ndalesa në strofa dhe pas çdo strofe, u drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1: Që nga fillimi deri te … e bëri liqen.

U drejtohen pyetjet*:*

-Ku po luanin fëmijët?

-Me çfarë luanin ata?

-Çfarë ndodhi papritur?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 2: Që nga: *Të shpëtojmë lodrat…* deri te *…na erdhi në ndihmë.*

-Çfarë ndodhi me lodrat e fëmijëve?

-Cila stinë ishte?

-Çfarë bënë fëmijët?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë tutje?

Ndalesa 3: E kthyem çadrën… deri në fund.

-Si vepruan fëmijët për të mbrojtur lodrat?

-Si mendoni ju, shpëtuan lodrat nga shiu?

-Si mendoni, ku e morën fëmijët çadrën?

-A ju pëlqen zgjidhja që gjetën fëmijët për të mbrojtur lodrat? Nëse po pse, nëse jo pse?

-Cili nga ju e parashikoi kështu ngjarjen?

-Çfarë ju pëlqeu më shumë nga kjo vjershë?

Nxënësit lexojnë tekstin në heshtje.

Ushtrimi i parë: Shenjëzojnë me √ përgjigjet e sakta.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Përgjigjet e pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.
- Ndarjen e përvojave rreth leximit me të tjerët.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

Shkruani strofën që ju pëlqen më shumë nga kjo vjershë.

Tregoni një histori të ngjashme. Shkruani atë në fletore.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Flet në mënyrë të pavarur për një tekst të shkurtër letrar ose jo letrar;
• Përflet ngjarjen kryesore në tekst;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Dua një qenush, faqe 110 (Ora I)</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
• Arsyeton mendimin lidhur me mbajtjen e qenushit në shtëpi.
• Nënvizon në tekst premtimet e Andit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: Andi, mami, qenush</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve
• Veprimtari me dëgjim – mendim të drejtuar (VDMD)</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të kafshëve, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet kënga për fëmijë “Sa do të doja një qenush’’, të cilën mund ta gjeni në you tube këtë vegëz: https://youtu.be/uj8jYzY1ikQ.
Veprimet në situatë</td></tr>
</table>

Hapi 1. Stuhi mendimesh

Nxënësit nxiten të tregojnë çfarë dinë për qenin.



Përgjigjet e tyre i shkruajmë në tabelë.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të shikojnë figurën.

Lexohet titulli dhe nxiten të tregojnë se çfarë mund t'i ketë thënë djaloshi nënës së tij.

Pasi mendohen për disa çaste, dëgjohen disa nxënës.

Hapi 3. Veprimtari me dëgjim –mendim të drejtuar **(**VDMD)

Lexohet teksti me ndalesa dhe pas çdo ndalese u drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1: Që nga fillimi deri te … unë do të kujdesem vetë për të.

U drejtohen pyetjet*:*

-Cilët janë personazhet e këtij tregimi?

-Ndërmjet kujt po zhvillohet biseda?

-Çfarë i kërkonte ai nënës?

-Po mami, si iu përgjigj?

-Çfarë i thoshte ai mamit?

-Ç'mendim keni për Andin?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 2: Që nga: Qeni do të vrapojë ... deri te …Mirë, do ta mendojmë njëherë.

-Çfarë mendon mami për dëshirën e Andit?

-Cilat ishin veprimet që ia sqaroi mami Andit për kujdesin ndaj qenushit?

-Si mendoni, përse mami i nxjerr pengesa Andit?

-Sa është e vështirë të kujdesesh për një qenush?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 3: Unë mendoj se duhet të marrim një qenush … deri në fund.

-Përse i kërkonte vajza gërshërët?

-Çfarë emrash kishte përzgjedhur Andi?

-Cili emër të pëlqen ty më shumë? Ke ndonjë emër tjetër në mendje?

-A mund t'i mbajë Andi premtimet që i bëri mamit?

-Cili nga ju e parashikoi kështu ngjarjen?

-Si mendoni, është e lehtë apo e vështirë të mbash një qen në shtëpi? Nëse po pse, nëse jo?

-Cili është mesazhi i këtij tregimi?

Nxënësve në dyshe iu ndahen rolet. Lexojnë tekstit sipas rolit përkatës.

Nënvizojnë në tekst premtimet e Andit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur:

Lexon sipas rolit të caktuar dhe shpreh opinionet e tij rreth leximit të shokëve dhe shoqeve të klasës.

Shpreh pëlqim dhe interes ndaj tekstit që dëgjon.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Përgjigjet e pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Arsyetimin e mendimit lidhur me mbajtjen e qenushit në shtëpi.
- Nënvizimin e saktë të premtimeve të Andit nga teksti.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Mësoni rolin e caktuar për dramatizim. Ritregoni përmbajtjen e tekstit në fletore.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Dua një qenush, faqe 110 (Ora II)</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Interpreton rolin e caktuar.
• Përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
• Klasifikon sipas ngjyrave emrat në tekst.
• Përshkruan qenushin duke u përgjigjur pyetjeve.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: Andi, mami, qenush</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Dramatizim
• Pyetje/Përgjigje
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete:
Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të kafshëve, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Këndohet kënga për fëmijë “Sa do të doja një qenush’’, të cilën mund ta gjeni në këtë vegëz: https://youtu.be/51mKtOAREkk.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Dramatizim i tekstit
Njihen nxënësit me temën e mësimit.
Nxënësit në çifte dramatizojnë rolin e caktuar.</td></tr>
</table>

Hapi 2. Pyetje/Përgjigje

Nxënësve u drejtohen pyetje rreth përmbajtjes së tekstit. Ja disa shembuj:

-Si është titulli i këtij tregimi?

-Cilët janë personazhet kryesore?

-A ka personazhe të tjera?

- Kur zhvillohet ngjarja?

- Ku zhvillohet ngjarja?

- Si ka ndodhur?

- Pse ka këtë përfundim?

- Çfarë do të doje ndryshe?

- Gjej një fund tjetër për tekstin.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi i parë: Nxënësve u sqarohet se emrat janë fjalë që tregojnë njerëz, kafshë, shpendë ose sende. Klasifikojnë sipas ngjyrave emrat në tekst**.**

Emra që tregojnë njerëz	**Emra që tregojnë kafshë**	**Emra që tregojnë sende**
Andi	qenush	shtëpi

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur:

Ushtrimi i dytë: Përgjigjen me shkrim pyetjeve për të përshkruar qenushin e paraqitur në foto**.**

Vlerësohen nxënësit për:

- Interpretimin e rolit të caktuar.
- Përgjigjet e pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- Klasifikimin e emrave sipas ngjyrave në tekst.
- Përshkrimin e qenushit duke u përgjigjur pyetjeve.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani një bisedë me mamin sikur ti do të doje një qenush apo ndonjë kafshë tjetër që të pëlqen.

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="4">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;</td></tr>
<tr><td colspan="4">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore:
Biskotat e gjyshes, faqe 112 (Ora I)</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="4" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan fjali për gjyshen.
• Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
• Shenjëzon përgjigjen e saktë.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: gjyshja, Ana, Albani, biskotat, forma</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Shkrim i lirë
• Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve
• Veprimtari me dëgjim – mendim të drejtuar (VDMD)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të kafshëve, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet kënga për fëmijë “Kënga e gjyshes’’, të cilën mund ta gjeni në you tube në këtë vegëz: https://youtu.be/2ekgzzvcGHY.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1. Shkrim i lirë

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Secili grup shkruan në fletë nga një fjali për gjyshen. Fjalinë e fillojnë me shkronjën e parë të kësaj fjale. Shembull:

Grupi 1: **Gj-**Gjyshja ime më tregon përralla.

Grupi 2: **Y-**Ylberi doli me ardhjen e gjyshes.

Grupi 3: **Sh-**Shtëpia e gjyshes është e madhe.

Grupi 4: **J-**Jemi shumë të lumtur pranë gjyshes.

Grupi 5: **A-**Ajo gjithmonë më përgatit ushqime të shijshme.

Përgjigjet e tyre i paraqesin para të tjerëve.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të shikojnë figurën.

Lexohet titulli dhe nxiten të tregojnë se çfarë do të mësojnë, çfarë bëjnë fëmijët, kush është pranë tyre.

Pasi mendohen për disa çaste, dëgjohen disa nxënës.

Hapi 3. Veprimtari me dëgjim –mendim të drejtuar **(**VDMD)

Lexohet teksti me ndalesa në pjesë ku pas çdo pjese drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1: Që nga fillimi deri te … Gjyshja buzëqeshte dhe e lyente me miell te hunda.

U drejtohen pyetjet*:*

-Kur ndodhi ngjarja?

-Ku ndodhen fëmijët?

-Me kë po i përgatiste gjyshja biskotat?

-Çfarë i bëri gjyshja Albanit?

-Ç'mendim keni për Anën e Albanin?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 2: Që nga: Ana flokëverdha... deri te …dhe nisën të bënin biskotat.

-Përse ishte e gëzuar gjyshja?

-Si ndiheshin fëmijët?

-Çfarë përgatitën ata?

-Cilat forma për prerjen e brumit ju pëlqejnë më shumë?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 3: Më pas morën tavën dhe i vendosën biskotat një nga një. … deri në fund.

-Përse i vendosën format në tavë?

-Si mendoni, çfarë biskotash i kishin përgatitur?

-Cili nga ju e parashikoi kështu ngjarjen?

-A ju ka nodhur edhe juve të përgatitni ushqime bashkë me gjyshen?

-Çfarë keni përgatitur?

-Cili është mesazhi i këtij tregimi?

Lexim në heshtje nga nxënësit.

Disa nxënës tregojnë përmbajtjen e tekstit në mënyrë të përmbledhur.

Ushtrimi i parë: Diskutojmë së bashku rreth pyetjes përse familjes i shijuan aq shumë biskotat. Udhëzohen të shenjëzojnë me √ përgjigjen e saktë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur:

Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e fjalive për gjyshen.
- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Përgjigjet e pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- **Shenjëzimin e përgjigjes së saktë.**

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Lexoni tregimin disa herë.

Ritregoni përmbajtjen e tekstit në fletore.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Biskotat e gjyshes, faqe 112 (Ora II)</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan fjali për gjyshen.
• Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
• Përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
• Shenjëzon përgjigjen e saktë.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: gjyshja, Ana, Albani, biskotat, forma</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Shkrim i lirë
• Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve
• Veprimtari me dëgjim – mendim të drejtuar (VDMD)</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të kafshëve, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Arte
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Dëgjohet kënga për fëmijë “Kënga e gjyshes’’, të cilën mund ta gjeni në you tube në këtë vegëz: https://youtu.be/2ekgzzvcGHY.
Veprimet në situatë</td></tr>
</table>

Hapi 1. Shkrim i lirë

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Secili grup shkruan në fletë nga një fjali për gjyshen. Fjalinë e fillojnë me shkronjën e parë të kësaj fjale. Shembull:

Grupi 1: **Gj-**Gjyshja ime më tregon përralla.

Grupi 2: **Y-**Ylberi doli me ardhjen e gjyshes.

Grupi 3: **Sh-**Shtëpia e gjyshes është e madhe.

Grupi 4: **J-**Jemi shumë të lumtur pranë gjyshes.

Grupi 5: **A-**Ajo gjithmonë më përgatit ushqime të shijshme.

Përgjigjet e tyre i paraqesin para të tjerëve.

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Hapi 2. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të shikojnë figurën.

Lexohet titulli dhe nxiten të tregojnë se çfarë do të mësojnë, çfarë bëjnë fëmijët, kush është pranë tyre.

Pasi mendohen për disa çaste, dëgjohen disa nxënës.

Hapi 3. Veprimtari me dëgjim –mendim të drejtuar **(**VDMD)

Lexohet teksti me ndalesa në pjesë ku pas çdo pjese drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1: Që nga fillimi deri te … Gjyshja buzëqeshte dhe e lyente me miell te hunda.

U drejtohen pyetjet*:*

-Kur ndodhi ngjarja?

-Ku ndodhen fëmijët?

-Me kë po i përgatiste gjyshja biskotat?

-Çfarë i bëri gjyshja Albanit?

-Ç'mendim keni për Anën e Albanin?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 2: Që nga: Ana flokëverdha... deri te …dhe nisën të bënin biskotat.

-Përse ishte e gëzuar gjyshja?

-Si ndiheshin fëmijët?

-Çfarë përgatitën ata?

-Cilat forma për prerjen e brumit ju pëlqejnë më shumë?

-Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas?

Ndalesa 3: Më pas morën tavën dhe i vendosën biskotat një nga një. … deri në fund.

-Përse i vendosën format në tavë?

-Si mendoni, çfarë biskotash i kishin përgatitur?

-Cili nga ju e parashikoi kështu ngjarjen?

-A ju ka nodhur edhe juve të përgatitni ushqime bashkë me gjyshen?

-Çfarë keni përgatitur?

-Cili është mesazhi i këtij tregimi?

Lexim në heshtje nga nxënësit.

Disa nxënës tregojnë përmbajtjen e tekstit në mënyrë të përmbledhur.

Ushtrimi i parë: Diskutojmë së bashku rreth pyetjes përse familjes i shijuan aq shumë biskotat. Udhëzohen të shenjëzojnë me √ përgjigjen e saktë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur:

Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e fjalive për gjyshen.
- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur.
- Përgjigjet e pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit.
- **Shenjëzimin e përgjigjes së saktë.**

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Lexoni tregimin disa herë.

Ritregoni përmbajtjen e tekstit në fletore.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Emri, mbiemri, përemri</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Kupton, dallon dhe përdorë drejtë emrin, mbiemrin dhe përemrin.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 2.1; 2.2; 3.6</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Fjalë që tregojnë cilësi</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan fjalë që tregojnë cilësi për personazhet;
• Lidh figurën me fjalën përkatëse;
• Shkruan fjali sipas cilësisë që kanë figurat;
• Përshkruan mjetet sipas cilësive që kanë.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: cilësi, i bukur, e bukur, e madhe, e vogël</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Punë në dyshe
• Punë individuale
• Shkrim i lirë
• Lojë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të të instrumenteve pupullore, veshje, mjete dhe objekte në klasë.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi.
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Veprimtaria zhvillohet në dyshe. Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë cilësitë e gjyshes dhe të biskotave.
• Si është gjyshja?
• Si janë biskotat?
Ja një shembull:
<table>
<tr><td>Gjyshja</td><td>Biskotat</td></tr>
<tr><td>e dashur</td><td>rrethore</td></tr>
</table>
</td></tr>
</table>

punëtore *e buzëqeshur*	*të shijshme* *të buta*

Nxënësit nxiten të shkruajnë fjalë që tregojnë cilësi duke u bazuar edhe në fotografitë nga tregimi i mësuar ‘’*Biskota me gjyshen”*.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Kërkohet nga nxënësit të lidhin figurat me fjalën.

Ja një shembull:

- *Djali i gëzuar.*
- *Lopa laramane.*
- *Ombrella e mbyllur.*
- *Vajza e mërzitur.*
- *Kali i dobishëm.*
- *Flutura laramane.*
- *Breshka e ngadaltë.*

Nxënësit shkruajnë fjalët e lidhura në fletoret e punës.

Lexohen fjalët e lidhura me figurat.

Hapi 2. Nxënësve u kërkohet të lidhin fjalët me figurat e dhëna.

Në tabelën e dhënë në fletore pune, nxënësit shkruajnë si janë veshjet në figurë.

Plotësohet tabela e dhënë.

- *Dorëzat janë të kuqe.*
- *Xhupi është i ngrohtë.*
- *Triko është i leshtë.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 3. Nxënësit përshkruajnë cilësitë të një lodre ose mjeti shkollor të preferuar.

P.sh lapsi- i shkurtër, i ri, i hollë, treni- i gjatë, i vjetër, i bukur.

Ose bëhet përshkrimi gjej objektin.

Vlerësohen nxënësit për:

- Shkrimin e fjalëve që tregojnë cilësi.
- Lidhjen e saktë në mes fjalëve dhe figurave.
- Shkruuan fjali sipas cilësisë që kanë figurat;
- Përshkrimin e saktë të mjeteve dhe objekteve të ndyshme.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Të shkruaj 10 emra të objekteve, lodrave ose mjeteve dhe të tregojë cilësitë e tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 2.3; 2.5; 3.1;3.2		
Njësia mësimore: Porosia e fundit e Skënderbeut		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion tregimin; • Përshkruan figurën e Skënderbeut; • Dallon personazhet dhe idenë e tregimit; • Plotëson fjalitë me fjalët e duhura për personazhet e tregimit		**Fjalë kyçe:** Skënderbeu, Gjini, Gjoni, thuprat, porosia. **Teknika dhe strategji:** ❖ Bisedë ❖ Vëzhgim ❖ Analizë ❖ Punë individuale ❖ Diskutim ❖ Shkruajmë		
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i lëndës, fotografi e Skënderbeut		**Lidhja me fushat e tjera:** Artet, Shoqëria dhe mjedisi **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për paqe		
Organizimi i orës së mësimit ***Hapi 1.*** Bisedë Paraqitet një foto e Skënderbeut, Gjonit dhe thuprat. Nxënësve u kërkohet të flasin për personat në foto. Nxënësit nxiten të bëjnë një koment të shkurtër rreth fotografisë. Parashtrojmë pyetjet: *-A i njihni personat në foto?*				

-Çfarë dini për Skënderbeun?

-Kush është djali i vogël?

-Pse i theu thuprat Gjoni?

Hapi 2. Lexim i drejtuar

Hapet libri në faqen 114 të Abetares dhe lexojmë tekstin me ndalesa. Pas çdo ndalese parashtrojmë pyetjet për pjesën e lexuar.

Ndalesa e parë:

Para se të..... Thyeji!

Parshtrojmë pyetjet:

-Kë thirri Skënderbeu?

-Kujt iu drejtua Skënderbeu?

-Çfarë i tha të merrte?

Çfarë mendoni, i theu Gjini thuprat?

Ndalesa e dytë:

Gjini nuk i ..... një e nga një.

Pas leximit të pjesës së dytë parashtrojmë pyetjet:

- I thyen Gjini dhe të tjerët thuprat?

-Kujt iu drejtua Skënderbeu?

-Çfarë i tha Skënderbeu Gjonit?

-Çfarë bëri Gjoni me thuprat e veçuara?

Ndalesa e tretë:

Gjoni i theu me lehtësi. ..... ‘’ Qëndroni gjithnjë të bashkuar!’’

Parashtrojmë pyetjen:

-Cila ishte porosia e fundit e Skënderbeut?

Shtjellohen fjalët e panjohura dhe bëhet leximi zingjir e tregimit sipas pjesëve logjike.

Hapi 3. Punë individuale

Ushtrimi 1.

Nxënësve u kërkohet të vendosin në katrorët shkronjën V – e vërtetë dhe G – gabim për fjalitë e dhëna.

Ushtrimi 2.

Diskutohet për personazhin e tregimit dhe mendimet e nxënësve për porosinë e fundit të tregimit.

Ushtrimi 3.

Plotësohen fjalitë me fjalët e duhura.

Ja një shembull:

- Skëndërbeu ka qenë *prijës i shqiptarëve.*
- Ai luftonte me *shpatë* dhe mbi *kalë.*
- Në kokë mbante një *përkrenare.*

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e rrjedhsëm dhe pagabime, përshkrimin e figurës së Skënderbeut, Dallimin e personazhit kryesor dhe shkrimin e fjalëve të sakta që lidhen me Skënderbeun.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Shkruaj:

Një fjali për Skënderbeun.

Një fjali për kalin e Skënderbeut.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi	**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2
Njësia mësimore: Parku u Mirushës (Ora I)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion tekstin; • Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit të lexuar; • Vizaton mbi bazën e tekstit të lexuar.	**Fjalë kyçe:** Mirusha. kanion, liqene, lumi, ujëvara, parku. **Teknika dhe strategji:** ❖ Gjetja e titullit ❖ Punë individuale ❖ Veprimtari në dyshe ❖ Vizatim
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i lëndës, fotografi, fletë vizatimi, videoprojektor.	**Lidhja me fushat e tjera:** Artet, shkencat e natyrave **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Globalizimi dhe ndërvarësia

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1.

Për të arritur tek titulli i tekstit që do të mësohet, mësimdhënësi jep disa informacione. Kërkohet nga nxënësit që përmes informatave të dhëna të gjejnë titullin e tekstit të ri.

Ja disa pyetje të munshme:

- *Gjindet në pjesën qëndrore të Kosovës.*
- *Është park.*
- *Kalon lumi Mirusha.*
- *Ka 12 ujëvara dhe 14 liqene.*

Hapi 2.

Mësimdhënësi paraqet titullin e tekstit të ri në tabelë *''Parku i Mirushës''.*

Për t'u njohur më mirë me bukuritë e këtij parku, mësimdhënësi do të paraqet me ndihmen e videoprojektorit një video e cila gjendet në linkun:

https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=ËRnRMmJ862o&ab_channel=FM

Hapi 3.

Lexohet teksti nga mësimdhënësi me zë të lartë. Nxënësit nënvizojnë fjalët e reja që nuk ua dinë kuptimin.

Shpjegohet kuptimi i fjalëve të reja.

Ja një shembull:

kanion – çarje e thellë midis shkëmbinjve

ujëvarë – rrjedhë uji që bie me rrëmbim nga një lartësi e madhe.

Hapi 4. Punë individuale

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin në heshtje dhe të drejtojnë pyetje në qoftë se kanë.

Pyetjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe më pas u jepet përgjigje.

- *Ku gjendet parku i Mirushës?*
- *Cili lum rrjedh në këtë park?*
- *Si njihen ndryshe ujvarat?*

Hapi 4.

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit nga 2-3 fjali.. **Hapi 5.** Nxënësve u shpërndahen fletët për vizatim. Kërkohet nga ta të vizatojnë dhe ngjyrosin pamjen e parkut të Mirushës ose të një parku që ata kanë vizituar. Me ndihmën e videoprojektorit shfaqim një fotografi të parkut dhe ujvarës e cila gjendet në linkun: https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Liqenet_e_Mirush%C3%ABs#/media/Skeda:Mirusha_ëaterfall_-.jpg Më pas ftohen nxënësit të përshkruajnë vizatimet. **Vlerësohen nxënësit për:** • Leximin e rrjedhsëm dhe pagabime, • parashtrimin e pyetje rreth tekstit, • vizatimin e parkut dhe • përshkrimin e vizatimeve.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Të shkruaj disa fjali për vizatimin e filluar në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan rrezikun nga katastrofat natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.5		
Njësia mësimore: Parku u Mirushës (Ora II)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shkruan fjalë që tregojnë cilësi; • Ndan fjalët në rrokje; • Gjen në tekst fjalët që tregojnë cilësi; • Shkruan tri fjali për lojërat në park duke përdorur fjalë që tregojnë cilësi; • Tregon për lojërat dhe rregullat në park.		**Fjalë kyçe:** park, ujëvarë, cilësi, i bukur, i gjatë...		
		Teknika dhe strategji: ❖ Fuqia e lules ❖ Punë individuale ❖ Veprimtari në dyshe ❖ Punë në grupe		

Burimet e informacionit dhe mjete:	**Lidhja me fushat e tjera:**
Libri i lëndës, fotografi, fletë vizatimi.	Artet, shkencat e natyrave **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Globalizimi dhe ndërvarësia

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. Nxënësve u shpërndahen fletët e vizatimit dhe u kërkohet që të vizatojnë lulen me pesë petale. Në mesin e lules shkruajnë fjalën Parku u Mirushës, ndërsa në petalet e tyre do shkruajnë pesë fjalë që tregojnë cilësi.



Ja një shembull:

Lexohen punimet e nxënës

Hapi 2. Punë individuale

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit ta lexojnë tekstin në heshtje. Pas leximit të tekstit, nxënësve u kërkohet të vendosin në katrorët e zbrazët shenjën X për përgjigjet e sakta.

Ja një shembull:

Parku i Mirushës shtrihet:

X në pjesën qëndrore të Kosovës.

në pjesën qëndrore të Shqipërisë.

Hapi 3. Diskutim

Diskutohet me nxënës teksti i lexuar. Nga nxënësit marrim mendimet e tyre rreth parkut.

- *Çfarë ju ka pëlqyer më shumë?*
- *A do dëshironit të shkonit ta vizitoni?*

Hapi 4. Punë në dyshe

Nxënësve u kërkohet që fjalët me ngjyrë të gjelbër t'i ndajnë në rrokje.

Ja një shembull:

liqene = li – qe – ne.

shpella = shpe – lla etj.

Pas përfundimit të kohës së paraparë për këtë veprimtari, fjalët shkruhen edhe në tabelë për mënyrën e saktë të ndarjes së fjalëve.

Hapi 5.

Nxënësve u kërkohet të nënvizojnë në tekst 5 fjalë që tregojnë cilësi. Fjalët e gjetura shkruhen nga mësimdhënësi edhe në tabelën e klasës.

Hapi 6.

Nxënësve u kërkohet të shkruajnë tri fjali për lojërat që zhvillojnë në park. Nxënësit mund të përdorin edhe disa nga fjalët që ata kanë nënvizuar në ushtrimin paraprak.

Lexohen fjalitë nga nxënësit.

Hapi 7. Punë grupe

Nxënësit ndahen në dy grupe.

Grupi i parë tregon se cilat lojëra mund të luhen në park.

Grupi i dytë tregon rregullat e sjelljes në park.

Vlerësohen nxënësit për:

- Gjetjen e fjalëve që tregojnë cilësi,
- ndarjen e fjalëve në rrokje,
- nënvizimin e fjalëve që tregojnë cilësi,
- shkrimin e tri fjalive duke përdorur fjalë që tregojnë cilësi dhe
- diskutimi për lojërat dhe rregullat e sjelljes në park.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Të shkruajnë tri fjali për një park që ka vizituar dhe të përdor fjalët që tregojnë cilësi të cilat i ka nënvizuar në tekst.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Foljet ndihmëse kam dhe jam			• Kupton dhe dallon foljet ndihmëse kam dhe jam në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.5			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.6	

<table>
<tr><td>Njësia mësimore:
Fjalët që tregojnë veprime</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Imagjinon një tregim me fjalët e dhëna,
• Plotëson fjalitë sipas modelit dhe kuptimit.
• Gjen fjalët që tregojnë veprime.
• Shkruan dy fjali me veprimet e personazheve në foto.</td><td>Fjalë kyçe: veprime, nget, luan, shkon</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Imagjinatë e drejtuar
• Punë në grupe
• Punë individuale
• Shkrim i lirë
• Puna në dyshe.</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto, mjete dhe objekte në klasë.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi.
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Mësimdhënësi iu paraqet nxënësve etiketat me fjalët/ose shkruhen në dërrasë: Melisa, luan, Troi, shkruan, Ajana, noton dhe kërkon që nxënësit të imagjinojnë një situatë për 5 minuta.
Nxënësit tregojnë 3-4 situata dhe përzgjedhin krijimin më tërheqës. Argumentojnë mendimin për vlerësimin e bërë.
Veprimet në situatë
Hapi 2. Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë me vëmendje kërkesat e ushtrimeve. Jepen udhëzime për punimin e ushtrimeve.
Ushtrimi 1. Nxënësit shohin figurat dhe tregojnë veprimet që kryejnë fëmijët.
• Jona luan tenis.
• Iliri shkon në shkollë.
• Manjola nget biçikletën.
Hapi 3. Kërkohet nga nxënësit të nënvizojnë fjalët që tregojnë veprime.</td></tr>
</table>

- *Babi pastron oborrin.*
- *Drini rregullon dhomën.*
- *Gjyshja lexon librin.*
- *Dallëndyshja fluturon në qiell.*
- *Anija lundron në det.*

Me ndihmën e pyetjeve të dhëna, plotësohet tabela e paraqitur në fletore pune.

Kush?/Cila?	***Çfarë bën?***
Babi	pastron
Drini	rregullon
Gjyshja	lexon
Dallëndyshja	fluturon
Anija	lundron

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 4. Nxënësit shkruajnë dy fjali për figurën e dhënë në ushtrimin e fundit.

- *Fëmijët bisedojnë me gjyshin.*
- *Gjyshi tregon përralla fëmijëve.*

Vlerësohen nxënësit për:

- Imagjinatën e treguar me fjalët e dhëna.
- Plotësimin e fjalëve sipas modelit dhe kuptimit.
- Gjetjen e fjalëve që tregojnë veprime.
- Shkrimin e dy fjalive me veprimet e personazheve në foto.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruan 10 fjali dhe nënvizon fjalët që tregojnë veprime.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.5		

<table>
<tr><td>Njësia mësimore:
Shoqja e Abës, Bora (Ora I)</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Tregon mënyra të ndryshme të komunikimit;
• Ritregon përmmbajtjen e pjesës së lexuar;
• Diskuton për njerëzit që kanë nevojë
• Krijon një pesëvargësh me fjalën shoqe;</td><td>Fjalë kyçe:
Shoqe, gishtash, shenja, miqësia,</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Punë në grupe
❖ Lexim i drejtuar
❖ Diskutim
❖ Pesëvargëshi</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete:
-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;
-teksti mësimor;
-informacione nga interneti;
-video projektor.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Artet, shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Edukimi për qytetari demokratike</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Punë në grup
Nxënësit ndahen në grupe. Sicili antarë i grupit do të imitoj me gjeste apo veprime të ndryshme. Grupet e tjera do të mundohen të gjejnë se ç’farë do të thotë anëtari i grupit me gjestet e tij. Kështu do të vazhdohet edhe me grupet e tjera.

Hapi 2. Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë dhe bën prezantimin e tregimit.
Lexohet pjesa me ndalesa. Pas çdo leximi nxënësit pyeten për pjesën e lexuar dhe u kërkohet mendimi i tyre.
Ndalesa e parë: Arba...së bashku.
• Cilët janë personazhet e këtij tregimi?
• Si quhet shoqja e Arbës?
• Çfarë bëjnë ato së bashku?
Ndalesa e dytë: Arbës ... librat e Arbës.
• Çfarë i pëlqen të dëgjojë Arbës?
• Çfarë bënë Arba kur Bora fillon të lexojë?
• Si janë librat e Borës?
Ndalesa e tretë: Bora ... quhet Brajl.</td></tr>
</table>

- *Pse Bora lexon në një mënyrë tjetër?*
- *Si lexon Bora?*
- *Si janë shkronjat e librit të saj?*
- *Si quhet alfabeti i Borës?*
- *Po ju, keni dëgjuar ndonjëherë për alfabetin e Brajlit?*

Shpjegojmë fjalët e panjohura.

Mësimdhënësi angazhon nxënësit në leximin zingjir të tregimit sipas pjesëve logjike të tij.

Hapi 3. Mësimdhënësi lexon pjesën ‘’Mëso më shumë’’ rreth alfabetit të Brajlit. Diskutojmë me nxënës rreth alfabetit të Brajlit dhe mundohemi të mësojmë disa nga shkronjat.

Hapi 4. Për të shprehur dashurinë e nxënësve që kanë për shoqet dhe shokët e tyre, krijojmë një pesëvargësh me fjalën shoqe.

Ja një shembull:

Kush? Shoqja

Si është shoqja e juaj? e mirë e dashur

Ç’bën shoqja juaj? *shikon* *lexon* *ndëgjon*

Kush është shoqja juaj më e mirë? *Arba është shoqja më e mirë e Borës.*

Sinonim

Gjithashtu, nxënësit mund të paraqesin edhe ndonjë vizatim për shoqen e tyre.

Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e rrjedhsëm dhe pagabime,
- plotësimin e ‘’Dora e pyetjeve’’ dhe
- shkrimin e fjalive me fjalët që tregojnë veprim.

Detyrë shtëpie:
Të mësojnë disa nga shenjat e gishtave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Flet në mënyrë të pavarur për një tekst të shkurtër letrar ose jo letrar; • Përflet ngjarjen kryesore në tekst;		

<table>
<tr><td>Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td>Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.5</td></tr>
<tr><td>Njësia mësimore:
Shoqja e Abës, Bora (Ora II)</td><td>Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Diskuton për njerëzit që kanë nevojë;
• Plotëson ‘’Dorën e pyetjeve’’rreth përmbajtjes së tregimit;
• Shkruan fjali me fjalët që tregojnë veprim;
• Plotëson tabelën me fjalët që tregojnë veprim.</td><td>Fjalë kyçe:
Shoqe, gishtash, shenja, miqësia,</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
❖ Vëzhgim
❖ Dora e pyetjeve
❖ Diskutim
❖ Shkrimi i lirë
❖ Lexo - plotëso</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete:
-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;
-teksti mësimor;
-informacione nga interneti;
-videoprojektor.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Artet, shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Edukimi për qytetari demokratike</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Me ndihmën e videoprojektorit, paraqesim para nxënësve një video të shkurtë rreth shenjave të gishtave. Videon e gjejmë në vegëzën: https://ëëë.gjshsh.al/fjalori/

Hapi 2. Lexohet tregimi me pjesë nga disa nxënës. Ritregohet pjesa duke plotësuar ‘’Dorën e pyetjeve’’
Pas çdo leximi, bëjmë pyetjet rreth pjesës së lexuar dhe plotësojmë.
Ja një shembull:
• Kush janë personazhet e këtij tregimi?
• Si quhet shoqja e Arbës?
• Çfarë ka dëshirë të bëj Bora kur Arba lexon?
• Si lexon Bora?
• Si formohen shkronjat e Borës?
• Si quhet alfabeti i Borës?

Pas leximit të tregimit, mësimdhënësi pyet për fjalët e shënuara me ngjyrë të kaltër dhe bën pyetjen:</td></tr>
</table>

- *Çfarë tregojnë fjalët me ngjyrë të kaltër?*

Fjalët me ngjyrë të kaltër tregojnë veprime.

Hapi 3. Diskutojmë me nxënës rreth kujdesit që kanë për shokët dhe shoqet e tyre që kanë vështirësi në shikim. Mësojmë disa nga shenjat e gishtave.

Hapi 4. Nxënësve u kërkohet të shkruajnë tri fjali me fjalët që tregojnë veprime.

Ja një shembull:

- *Troi lexon librin me përralla.*
- *Lio ulet gjithmonë në bankën e parë.*
- *Ajana shikon në dritare.*

Hapi 5. Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë tabelën e paraqitur në tekstin e tyre sipas shembullit të dhënë.

	Bora	Arba
lexon	√	
ulet		√
shikon	√	

Diskutohet për veprimet dhe saktësinë e vendosjes së shenjave.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e rrjedhsëm dhe pagabime,
- plotësimin e ‘’Dora e pyetjeve’’,
- shkrimin e fjalive me fjalët që tregojnë veprim dhe
- plotësimin e saktë me veprimet e personazheve.

Detyrë shtëpie:
Formo fjalë me shenjat e alfabetit të Brajtit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Emri, mbiemri, përemri			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Kupton, dallon dhe përdorë drejtë emrin, mbiemrin dhe përemrin.	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.5			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.6	
Njësia mësimore:			**Kriteret e suksesit:**	

<table>
<tr><td>Unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato</td><td>Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• dallon fjalët në fjali që tregojnë përemrat vetorë;
• lidh përemrat vetorë me grupet e fjalëve dhe krijon fjali;
• qarkon përemrat vetorë në fjali të ndryshme.</td><td>Fjalë kyçe:
Unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato</td></tr>
<tr><td>Teknika dhe strategji:
• Vëzhgim, demonstrim
• Punë individuale
• Shkrim i lirë
• Punë në dyshe</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi (ilustrime), fisha me përemra vetorë etj.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi.
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Nxënësit hapin librat dhe komentojnë figurat e paraqitura në libër
• Unë luaj tenis. (gishtin trgues e drejtojmë te vetja.)
Si mendoni fjala unë tregon një person apo shumë persona?
(Tregon një person pra është në numrin njejës).
• Ti lexon (kujt i drejtohet gishti tregues shokut apo shoqes që kemi pranë).
• Ai lexon (gishti tregues i drejtohet një shoku jo shumë pranë nesh).
Kështu vazhdon veprimtaria, për të sqaruar në mënyrë intuitive dhe konkrete fjalët që tregojnë përemrat.
Veprimet në situatë
Hapi 2. Nxënësit lidhin përemrat vetorë me grupet e fjalëve në tekst.
Ja një shembull:
Unë luaj.
Ti lexon.
Ai gatuan.
Ne këndojmë.</td></tr>
</table>

Ju shikoni.

Ata hanë.

Hapi 3. Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë tabelën e dhënë në librin e tyre me përemrat dhe veprimet e tyre.

Me ndihmën e pyetjeve të dhëna, plotësohet tabela e paraqitur në fletore pune.

Unë lexoj	Ne
Ti	Ju
Ai	Ata lexojnë
Ajo	Ato

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 4. Udhëzohen nënësit të rishkruajnë fjalitë duke vendosur në vend të emrit me të kuqe njërin nga përemrat vetorë që gjenden në kllapa.

- Arbri është nxënës i klasës së dytë. (ai/ajo)
- Ai është nxënës i klasës së dytë.
- Edona shkoi në festivalin e fëmijëve. (ai/ajo)
- Ajo shkoi në festivalin e fëmijëve.

Përemrat, pra zëvendësojnë emrat.

Vlerësohen nxënësit për:

- Dallimin e fjalëve në fjali që tregojnë përemrat vetorë.
- Lidhjen e përemrave me grupet e fjalëve dhe krijimin e fjalive.
- Qarkimin e saktë të përemrave dhe ndërrimin e saktë të tyre.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani 3 fjali me përemra vetorë

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Përflet ngjarjen kryesore në tekst;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.2;3.5		
Njësia mësimore: Si ruhet atdheu?		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.		

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Shkruan fjali me shkronjat e dhëna;
• Lexon me intonacion poezinë;
• Diskuton përmbajtjen e poezisë;
• Shkruan një pesëvargësh për atdheun.</td><td>Fjalë kyçe:
Atdhe, lum, burim

Teknika dhe strategji:
❖ Shkrim i lirë
❖ Lexim i drejtuar
❖ Diskutim
❖ Pesëvargëshi</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete:
-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit
-teksti mësimor
-informacione nga interneti, foto</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Artet, shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Edukimi për paqe</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Në tabelë vendoset në formë horizontale shkronjat e fjalës ATDHEU.
Kërkohet nga nxënësit të gjejnë fjalë që fillojnë me shkronjën e dhënë.
Atdheu,
Tirana,
Dhurata,
Era,
Ura.
Hapi 2. Nxënësve u kërkohet të shkruajnë nga një fjali me fjalën e dhënë. Punohet në grupe.
Ja një përgjigje e mundshme:
• Atheu im është Kosova.
• Tirana është kryeqyteti i Shqipërisë.
Kështu vazhdohet edhe me fjalët e tjera.

Hapi 2. Lexim i drejtuar
Lexohet vjersha në vargje. Pas çdo leximi, nxënësve u drejtohen pyetje në lidhje me pjesën e lexuar:
Për çdo pyetje zhvillohet një diskutim me nxënësit për mendimet e tyre, e kështu me radhë deri tek vargjet e fundit.

Hapi 3. Punë individuale
Ushtrimi 1. Vendosin shenjën X për përgjegjen e saktë për pyetjet e dhëna.</td></tr>
</table>

Ushtrimi 2. Diskutohet për vargjet dhe vendosim shenjën e dhënë në përggjigjet e sakta.

Hapi 4. Nxënësve u shpërndahen fletët ku është dhënë pesëvargëshi. Ata krijojnë një pesëvargësh duke u përgjigjur pyetjeve të parashtruara.

Ja një shembull:

Emri: Atdheu

Si duket? i bukur, i shtrenjtë

Çfarë bën? *mbron*, punon , mëson

Shkruaj një fjali për atdheun. _____,

Sinonimi _____

Në fund të orës lexohen punimet e nxënësve.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e rrjedhsëm dhe pagabime i vjershës,
- shkrimin e fjalive dhe
- plotësimin e pesëvargëshit.

Detyrë shtëpie:

Të mësojnë vjershën përmendësh.

Gjej në vjershë fjalët që rimojnë me njëra-tjetrën.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Përflet ngjarjen kryesore në tekst;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 2.3; 2.5; 3.1;3.2		
Njësia mësimore: Shoku i ri i klasës (Ora I)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi:		**Fjalë kyçe:** *shok - shoqe, gjuhë, kujdes, sjellje e mirë*		

• Prezentohet para klasës duke treguar për vetveten; • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacin tekstin; • Diskuton për veprimet ndaj shokëve të rinj.	**Teknika dhe strategji:** ❖ Prezantimi në rreth ❖ Dëgjim i drejtuar ❖ Diskutim
Burimet e informacionit dhe mjete: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit -teksti mësimor -informacione nga interneti, foto	**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Edukimi për paqe, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1. Nxënësve u kërkohet të marrin lapsat dhe ngjyrat nga çanta dhe të ulen në rreth. Lapsat dhe ngjyrat mbahen në prehër. Në dorë marrin nga një laps dhe tregojnë për vete.

Troi merr një ngjyrë dhe thotë:

Unë jam Troi.

Merr lapsin tjetër.

Unë i kam 7 vjet.

Vazhdon të tregojë për vete duke mbajtur nga një laps në dorë. Loja përfundon kur të gjithë nxënësit kanë folur për vetveten.

Hapi 2. Njoftojmë nxënësit për tregimin e ri që do të mësojmë dhe titullin e shënojmë në tabelë.

Lexohet teksti me ndalesa. Pas çdo ndalese, parashtrojmë pyetjet për të komentuar pjesën e lexuar.

- *Në cilën orë të mësimit ishin nxënësit?*
- *Kush erdhi në klasë?*
- *Kë mbante për dore drejtoresha?*
- *Si quhej djali i ri?*
- *Kush e përshëndeti Omanin?*

Lexohet ndalesa e dytë.

- *Nga vinte Omani?*
- *A dinte të fliste shqip ai?*
- *Çfarë kërkoi drejtoresga nga nxënësit?*
- *Si dukej Omani?*

Para leximit të pjeës së fundit, mësimdhënësi parshtron pyetje shtesë:

- Çfarë do të ndodhë në vazhdim?
- A do ti ndihmojnë shokët dhe shoqet Omanit?

Lexohet pjesa e fundit.

Bëjmë pyetjet:

- *A ndodhi si mendut ju?*
- *Kush e ngriti dorën për të marrë Omanin në bankë?*

Hapi 3. Lexohet teksti i ndarë në disa pjesë logjike nga të gjithë nxënësit dhe shtjellojmë fjalët e reja dhe të panjohura për nxënësit.

Ja një shembull:

me vëmendje – me kujdes

i ndrojtur – që ka turp

Hapi 4. Diskutojmë me nxënësit për tekstin e lexuar. Përgjigjemi pyetjeve të dhëna për diskutim.

1. Përse e ngriti dorën Dea?

2. Si do të vepronit po të ishit në vendin e Deas? Pse?

3. Po në klasën tuaj, a ka ardhur ndonjë shok ose shoqe e re? Si jeni sjellë me të?

Vlerësohen nxënësit për:

Prezantimin e vetvetës duke treguar sa më shumë , leximin e rrjedhsëm dhe me intonacion dhe pjesmarrjen në diskutim.

Detyrë shtëpie:

Përshkruaje një nga shokët – shoqet e klasës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.2		
Njësia mësimore: Shoku i ri i klasës (Ora II)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.		

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
përshkruan një të afërm ose shok - shoqe, duke e shoqëruar me vizatim;
përshkruan veprimet e personazheve të tregimit;
përgjigjet në pyetjet e kubit rreth tregimit të mësuar.</td><td>Fjalë kyçe:
shok - shoqe, gjuhë, kujdes, sjellje e mirë
Teknika dhe strategji:
❖ Imagjinatë e drejtuar
❖ Harta e personazheve
❖ Kubimi</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete:
-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit
-teksti mësimor
-informacione nga interneti, foto</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Hapi 1. Vendoset muzikë në sfond dhe nxënësit mbyllin sytë. Orientohen nxënësit të sjellin në mendje një person të veçantë, mund të jetë i afërm, shok - shoqe.
Mësimdhënësi gjatë kësaj kohe bën pyetje për të ndihmuar nxënësit.
Ja një shembull:
• Cili është ky person?
• Ç’pamje ka?
• Çfarë i pëlqen të bëjë?
• Si sillet me ty dhe më të tjerët?
Nxënësit hapin sytë dhe bëjnë përshkrimin e personit që kanë imagjinuar. E shoqërojnë përshkrimin e tyre me vizatim.

Hapi 2. Nxënësit në grupe shkruajnë për veprimet e personazheve të tregimit.
Ja një shembull:
Drejtoresha na përshëndeti kur hyri në klasë.
Mësuesja i dëshiroi mirëseardhje shokut të ri të klasës.
Omani i ndrojtur dhe shikonte dyshemenë.
Dea ngriti e para dorën për ta marrë në bankë.
Klasa jonë do ta ndihmojë Omanin të mësojë gjuhën shqipe.
Hapi 3. Paraqitet kubi dhe zbulojmë katër faqet e tij. Në secilën nga 4 faqet e kubit shkruhet nga një pyetje. Pastaj hudhet kubi dhe cila faqe të bije, trajtohet ajo pjesë apo ai problem.</td></tr>
</table>

PËRSHKRUAJE – Si dukej Omani ? KRAHASOJE - Çka dallon Omani nga nxënësit e klasës? ZBATOJE – Çfarë kërkoi drejtoresha nga nxënësit? ARSYETOJE – Pse Omani u ulë në bankë me Dean? Do ta ndihmonte Omanin ? **Vlerësohen nxënësit për:** • Përshkrimin e një shoku/shoqe, • Përshkrimin e veprimeve të personazheve të tregimit dhe • Përgjigjet saktë në pyetjet e dhëna në kub.
Detyrë shtëpie: Shkruaj emrat e shokëve dhe shoqeve të klasës duke i renditur sipas alfabetit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Foljet ndihmëse kam dhe jam			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Kupton dhe dallon foljet ndihmëse kam dhe jam në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.6	
Njësia mësimore: Kam, ke, ka, kanë			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përgjigjet në pyetjet duke përdorur foljen kam, ke, ka, kanë. • Plotëson si duhet foljet në fjalitë e dhëna . • Shkruan foljen kam sipas vetave.			**Fjalë kyçe**: Kam, ke, ka, kanë **Teknika dhe strategji:** • Mardhënia pyetje - përgjigje • Punë në grupe • Tryeza e rrumbullakët	
Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi (ilustrime), fisha me përemra vetorë etj.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi.	

	Lidhja me temat ndërkurrikulare Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake:

Mësimdhënësi ka përgatitur etiketa apo fletë me pyetjet:

- *Çfarë ke ti?*
- *Çfarë kam unë?*
- *Çfarë ka ai/ajo?*
- *Çfarë keni ju?*
- *Çfarë kemi ne?*
- *Çfarë kanë ata/ato?*

Nxënësit punojnë në grupe për t'i kthyer përgjigje pyetjeve . Në përfundim të punës dalin në përfundimin se folja kam është vendosur në forma të ndryshme të kohës së tashme.

Veprimet në situatë

Hapi 2. Lexohet kërkesa për ushtrimin e pare.

Nxënësit punojnë individualisht për shkrimin e foljes kam në fjalitë e dhëna.

Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.

Unë *kam* atlete të kuqe.

Unë *kam* një fustan me pika.

Kështu vazhdohet edhe me foljet e tjera.

Hapi 3. Diskutohet me nxënës rreth figures.

Çfarë ka Jona?

Plotësohet folja *ka* në vendet e zbrazëta. Lexohen fjalitë.

Në të njejtën mënyrë plotësohen fjalitë edhe me foljen kanë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 4. Nxënësit të vendosur në formë rrethore plotësojnë në fletën në formë fizarmonike zgjedhimin e foljes kam të përgatitur nga mësimdhënësi.

Unë _____ Ne _____

Ti _____ Ju _____

Ai _____ Ata _____

Ajo _____ Ato _____ Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën . Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme. **Vlerësohen nxënësit për:** • Përgjigjet me saktësi në pyetjet në etiketa. • Plotëson me saktësi foljen kam sipas shembullit të dhënë. • Shkruan me saktësi foljet në detyrën e dhënë. • Bashkëpunon me të tjerët në grup.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruaj 4 fjali me foljen kam në kohën e tashme.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.5		
Njësia mësimore: Tri pyetje (ora I)		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.		
Rezultatet e të nxënit orës mësimore: Nxënësi: • Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante. • Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin. • Parashikon përmbajtjen e tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit; • Përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.		**Fjalë kyçe:** *Tërmet, pandemi, stuhi* **Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimesh ❖ Gjetja e titullit ❖ Lexim i drejtuar ❖ Diskutim		
Burimet e informacionit dhe mjete: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit		**Lidhja me fushat e tjera:**		

-teksti mësimor -informacione nga interneti, foto.	Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Hapi 1.

Në tabelë do të shkruajmë tri fjalë:

- *Tërmet*
- *Pandemi*
- *Stuhi*

Pranë secilës fjalë, mësimdhënsi ka vendosur edhe një foto për të ilustruar më mirë fjalët.

Kërkojmë nga nxënësit të japin mendimet e tyre se çfarë njohurish kanë ata për këto fjalë.

Mësimdhënësi shkruan në tabelë të gjitha mendimet e nxënësve.

Hapi 2. Mësimdhënësi fton nxënësit të parashikojnë përmbajtjen e tekstit, duke u mbështetur në fjalët dhe ilustimet e dhëna në tabelë.

Hapi 3. Mësimdhënësi paraqet titullin e tekstit të ri në tabelë.

Lexohet teksi nga mësimdhënësi. Pas çdo pjese të lexuar parashtrojmë pyetje:

- *Çfarë kishte shkruar mësuesi në tabelë?*
- *Çfarë bënë fëmijët? Po mësuesi?*
- *A ishte i kënaqur mësuesi me njohuritë e nxënësve?*
- *Ku e drejtuan nxënësit shikimin?*
- *Çka u dha mësuesi në fund nxënësve?*

Gjatë leximit të tekstit, kërkohet nga nxënësit të nënvizojnë fjalët e panjohura e të cilat do të shtjellojmë pas mbarimit të leximit.

Ja një shembull:

stuhi – erë e fortë me shi ose me borë

pandemi – sëmundje ngjitëse që përhapet shpejt në gjithë botën

tërmet – lëkundje e fuqishme e Tokës

Hapi 4. Pas mbarimit të leximit të tekstit, me ndihmën e videoprojektorit, mësimdhënësi paraqet disa video që lidhen me tri pyetjet e dhëna në tekst. Videot mund të gjenden në vegëzat:

https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=9sË6sXOliOs&ab_channel=ABCNeësAlbania

https://ëëë.facebook.com/unicefalbania/videos/474984830291094/

Hapi 5. Duke u bazuar në videot e ndjekura, nxënësit shkruajnë disa nga rregullat që i kanë mbajtur në mend.

Lexohen disa nga rregullat e shënuara nga nxënësit dhe lexohen rregullat e dhëna edhe në libër.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e rrjedhsëm i tekstit;
- Parashikemet përmes ilustrimeve dhe fjalëve kyçe,;
- Shkrimin e saktë të këshillave.

Detyrë shtëpie:
Të lexojnë rreth këshillave për tërmetet, pandemitë dhe stuhitë

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi	**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 2.3; 2.5; 3.1;3.4
Njësia mësimore: Tri pyetje (ora II)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Përgjigjet në pyetjen e parashtruara rreth tekstit të mësuar; • Plotëson ditarin dypjesësh rreth fjalëve: tërmet, pandemi, stuhi; • Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. • Punon një maskë me materiale të ndryshme.	**Fjalë kyçe:** *Tërmet, pandemi, stuhi* **Teknika dhe strategji:** ❖ Pyetje - përgjigje ❖ Ditari dypjesësh ❖ Diskutim ❖ Punë në grupe
Burimet e informacionit dhe mjete: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit -teksti mësimor -informacione nga interneti, foto.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Organizimi i orës së mësimit	

Hapi 1. Parashtrojmë pyetjet për nxënësit rreth shkrimit të mësuesit në tabelë.

- *Çfarë kishte shkruar mësuesi në tabelë?*
- *Ku i panë nxënësit vedeot për tërmetin, pandeminë dhe stuhinë?*
- *Cilat ishin disa nga këshillat që mësuam?*

E gjithë veprimtari do të zhvillohet në pyetje – përgjigje. Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.

Hapi 2. Nxënësve u kërkohet të lexojnë në heshtje tekstin dhe këshillat e dhëna në librin e tyre.

Hapi 3. Veprimtaria e radhës do të organizohet në dyshe. Nxënësit do të plotësojnë një ditar dypjesësh.

Në njërën anë të fletës të ndarë në dy pjesë do të shkruajnë fjalët:

Tërmeti	
Pandemia	
Stuhia	

Në pjesën tjetër, nxënësit shkruajnë disa informacione që kanë mësuar për fjalët e dhëna apo ndonjë këshillë.

Lexohen punimet e nxënësve.

Hapi 4. Diskutohet me nxënës rreth përvojave të tyre jetësore qoftë për tërmetin, pandeminë apo stuhinë.

Mësimdhënëi shkruan në tabelë mendimet e tyre dhe komentohen me këshillat e dhëna në libër.

Hapi 5. Veprimtaria e radhës zhvillohet në grupe, ku secili grup do të punojnë maska të ndryshme duke i zbukuruar dhe me ngjyra dhe materiale të ndryshme.

Secili grup prezanton punimet e tyre dhe vendosin në këndin e artit.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përgjigjet e sakta në pyetjet e parashtruara;
- Plotësimin e saktë në kërkesat e Ditarit dypjesësh
- Diskutimet për përvojat nga pandemia;
- Punimet e maskave.

Detyrë shtëpie:

Të shkruaj tri fjali që lidhen me këshillat për pandeminë.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi
Është, ishte, do të jetë</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Foljet ndihmëse kam dhe jam</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Kupton dhe dallon foljet ndihmëse kam dhe jam në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.5; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.6</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Kam, ke, ka, kanë</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• vendos foljet në kohën e kërkuar;
• ndërton fjali me foljen në kohën e kërkuar sipas konceptit kohë: është – ishte – do të jetë;
• vlerëson punët e të tjerëve;
• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
Është, ishte, do të jetë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Vëzhgim, demonstrim
• Punë individuale
• Shkrim i lirë
• Punë në dyshe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi (ilustrime), fisha me përemra vetorë etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi.
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Së bashku me nxënësit plotësojmë organizuesin grafik.


Veprimet mund të kryhen në kohë të ndryshme:</td></tr>
</table>

- *e shkuar – ishte*
- *e tashme – është*
- *e ardhme – do të jetë*

Veprimet në situatë

Hapi 2. Nxënësit ndahen në grupe. Mësimdhënësi orienton nxënësit sipas grupeve të shkruajnë secili në një etiketë një folje që ka përgatitur. Vendosen këto folje në tabelë sipas kohës.

Është	Ishte	Do të jetë
E hënë	E diel	E martë
Klasa e parë.	Kopshti	Klasa e dytë

Prezantohen punimet e nxënësve.

Hapi 3. Hapen librat tek mësimi i ri. Diskutohet rreth figurave dhe ndryshimeve që pësojnë veprimet në kohë.

foshnjë – fëmijë – i rritur

fare – bimë – pemë

vezë – zog - pulë

Marrim edhe shembuj tjerë të ngjajshëm duke u nisur nga e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 4. Plotësohen fjalitë me *është, ishte* dhe *do të jetë.*

Veprimtari zhvillohet në dyshe. Pas mbarimit të detyrave, nxënësit bëjnë kontrollimin me dyshen tjetër.

Ja një shembull:

Dje ***ishte*** e diel.

Fëmijët shëtitën dhe luajtën me top.

Sot ***është*** e hënë.

Ata janë në shkollë.

Koha **është** me diell.

Edhe nesër ***do të jetë*** kohë e mirë.

Vlerësohen nxënësit për:

- Vendosjen e foljeve në kohën e kërkuar.
- Ndërtimin e fjalive me foljen në kohën e kërkuar sipas konceptit kohë: është – ishte – do të jetë.
- Vlerësimin e punës së tij dhe të tjerëve.
- Bashkëpunimit në dyshe dhe grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruaj nga 2 folje për secilën kohë dhe ndërto fjali me to.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**

Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi	**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 2.3; 2.5; 3.1;3.5
Njësia mësimore: Nënë Tereza	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.
aRezultatet e të nxënit të orës mësimore Nxënësi: • Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve. • Lexon me intonacion. • Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar. • Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit. • Plotëson pesëvargëshin me emrat, mbiemrat, veprimet dhe fjalinë.	**Fjalë kyçe:** *Nënë Tereza, varfërit, Kalkuta* **Teknika dhe strategji:** ❖ Stuhi mendimi ❖ Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve ❖ Veprimtari me dëgjim – mendim të drejtuar ❖ Pesëvargëshi
Burimet e informacionit dhe mjete: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit -teksti mësimor -informacione nga interneti, foto.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shoqëria dhe mjedisi. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Me ndihmën e videoprojektorit paraqesim një video për Nënë Terezën. Videon mund ta gjejmë në vegëzën: https://www.youtube.com/ëatch?v=0fët4gO4edY

Hapi 1.

Nxiten nxënësit të tregojnë çfarë dinë për Nënë Terezen.

Shkruhen mendimet e tyre pa i komentuar.



Hapi 2. Teksti lexohet me ndalesa.

Ndalesa e parë: Nënë Tereza.... njerëz të varfër.

- *Kush ishte nënë Tereza?*
- *Si e kishte zemrën ajo?*
- *Kujt ua kushtoi jetën Nënë Tereza?*
- *Keni ndihmuar ndonjëherë dikë?*

Ndalesa e dytë: Ajo ndihmonte ... të ëmbël!

- *Kë ndimonte ajo?*
- *Si u shërbente njerëzve në nevojë?*
- *Si i ka shëruar njerëzit në nevojë?*
- *Pse u ndihmonte Nënë Tereza njerëzve të varfër?*

Ndalesa e tretë: Nënë Tereza … lënë një porosi:

- *Pse Nënë Tereza na bën krenar gjithë shqipëtarëve?*
- *Çfarë porosie na ka lënë ajo?*

Diskutohen fjalë të reja që mund të kenë nxënësit.

Kërkohet nga nxënësit që tekstin ta lexojnë në heshtje.

Hapi 3. Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Hapi 4. Nxënësit punojnë në dyshe pesëvargëshin për Nënë Terezën.

Emri: *Nënë Tereza*

Dy mbiemra: *e dashur, e lumtur*

Tri folje: *ndihmon, punon, buzëqesh*

Një fjali: *Nënë Tereza u ndihmoi të varfërve në Indi.*

Sinonimi: *Anjezë Gonxhe Bojaxhiu*

Lexohen punimet e nxënësve.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin me intonacion.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.
- Ndarjen me të tjerët të përvojave të tyre rreth leximit.
- Shkrimin e pesëvargëshit

Detyrë shtëpie:
Të plotësojnë ushtrimin 1 dhe 2 në libër.

<table>
<tr><td>Fusha:Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1; I.2; I.3; I.4; III.2</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.6; 2.3; 2.5; 3.1;3.4</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Çfarë është paqja</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
Lexon me intonacion.
Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar.
Punon një pëllumb nga letra.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: paqja, gjyshi, nipi</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
Parashikimi i temës përmes videos - fotos
Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve
Lexim i drejtuar
diskutim
Punë në grupe</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto, letër, gërshërë.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkathtësi për jetë, Artet, Shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Edukimi për paqe</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Paraqesim fotografi të pëllumbit të bardhë përmes videoprojektorit ose foto.
Kërkohet nga nxënësit të japin mendimet e tyre rreth simbolikës së pëllumbit të bardhë.</td></tr>
</table>

Veprimet në situatë

Hapi 1. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të shikojnë figurën.

Lexohet titulli dhe nxiten të tregojnë se kush janë njerëzit në foto dhe për çfarë janë duke diskutuar.

- *Kush janë personanat në foto?*
- *Çfarë janë duke biseduar?*
- *Çfarë mund ta ketë pyetur nipi gjyshin?*
- *Çfarë mendoni se gjyshi po i tregon nipit?*

Pasi mendohen për disa çaste, dëgjohen disa nxënës.

Hapi 2. *Lexim i drejtuar*

Kërkohet vëmendja e nxënësve për të kuptuar mënyrën si do veprohet. Lexohet teksti me ndalesa dhe pas çdo pjese drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1: Një ditë… i thash.

- *Kush e pyeti gjyshin ?*
- *Çfarë e pyeti nipi gjyshin?*
- *Cila ishte përgjigja e gjyshit për paqen?*

Ndalesa 2: Po si… nga vetja!.

- *Si duhet të sillemi me prindër? Po me shokët dhe shoqet e klasës?*
- *Kë duhet të ndihmojmë?*
- *Nga kush duhet filluar ndryshimi?*

Ndalesa 3: të mendojmë… ata me ne.

- *Cila ishte rregulla e artë?*
- *Si e kuptoni ju këtë rregull?*

Diskutohen fjalë të reja që mund të kenë nxënësit.

Lexim i tekstit në heshtje.

Plotësohen duke vendosur shenjat rreth rregullave në ushtrimin e dhënë në libër.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 3. Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Hapi 4. Diskutohet me nxënës teksti i lexuar dhe kërkohet të japin mendimet e tyre rreth shpjegimeve që jep gjyshi.

"Të sillemi me të tjerët siç do të donim të silleshin ata me ne".

Hapi 5. Punë grupe

Me ndihmën e mësimdhënësit, nxënësit modelojnë pëllumbin nga materiali prej letre.

Vlerësohen nxënësit për: • Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve. • Leximin me intonacion. • Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar. • Modelimi i pëllumbit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Lexim i pjesës dhe të mësojnë përmbajtjen.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Foljet ndihmëse kam dhe jam			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Kupton dhe dallon foljet ndihmëse kam dhe jam në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.6	
Njësia mësimore: Dje, sot, nesër			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Dallon kohën e kryerjes së një veprimi. • Vendos fjalët dje, sot, nesër sipas kohës së veprimeve në fjali. • Zgjeron fjalitë e dhëna me fjalë të tij.			**Fjalë kyçe**: Dje, sot, nesër **Teknika dhe strategji:** • Diskutim • Punë në grupe • Punë në dyshe • Shkrim i lirë	
Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi (ilustrime), videoprojektor etj.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi. **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për paqe	

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake:

Hapi 1. Dikutohet me nxënës për veprimet e tyre që kanë bërë një ditë më herët, sot dhe çfarë do të bëjnë një ditë më vonë.

(zgjohem, mësoj, do të shkoj, pastroj, dola, vishem, do të hamë, do të dalshkruaj,vizatoj, do të luaj, luaj, ndihmoj, trokas etj.)

Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se kur kryhen këto veprime.

Mendimet e nxënësve mësimdhënësi i shkruan në tabelë dhe i ndanë sipas kohës që kryhen.

Veprimet në situatë

Hapi 2. Kërkohet nga nxënësit të hapin librat dhe të plotësojnë tabelën.

Veprimtaria do të zhvillohet në grupe.

Pas mbarimit të kohës së paraparë, njëri nga nxënësit ose varësisht se si ndahen punët në grup, prezantohen punimet e grupeve.

Me ndihmën e video projektorit, mësimdhënësi paraqet tabelën me foljet e sakta që duhet të shkruhen në tabelë.

Hapi 3. Punë në grupe

Secili grup merr përsipër të plotësoj fjalitë e filluara në fletore pune.

Pas përfundimit të kohës së paraparë për këtë veprimtari, secili grup paraqet mendimet e tyre.

Fjalitë e plotësuara nga nxënësit shkruhen në tabelë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 4. Punë individuale

Mësimdhënësi ka përgatitur një tabelë të formatit A^4, ku janë dhënë përemrat dhe disa folje. Kërkohet nga secili nxënës të plotësojë sipas kërkesës së dhënë.

Unë	këndova	këndoj	do të këndoj
Ti			
Ai			
Ajo			
Ne			
Ju	këndуat	këndoni	
Ata			do të këndojnë
Ato			

Vlerësohen nxënësit për: • Dallimin me saktësi të kohës së kryerjes së një veprimi. • Vendosjen me saktësi të fjalëve dje, sot, nesër sipas kohës së veprimeve në fjali. • Përshtajen dhe zgjerimit të fjalive sipas kohës së kryerjes së veprimit.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Të shkruhen me shkronja të dorës fjalitë e shkruara në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.; 2.3; 2.5; 3.1;3.2	
Njësia mësimore: Tre miqtë e Dimalit (ora I)			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Tregon për lojërat, ushqimet dhe pushimet që i pëlqejnë; • Lexon me intonacion; • Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar; • Diskuton në grup për përdorimin e teknologjisë.			**Fjalë kyçe**: telefoni, mami, miqtë **Teknika dhe strategji:** • Stuhi mendimi • Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve • Veprimtari me lexim – mendim të drejtuar (VLMD) • Rrethi i diskutimit	
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të telefonit apo mjeteve të tjera, fletë A4.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi **Lidhja me temat ndërkurrikulare**	

	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Në tabelë shkruhen tri fjalë:

Nxënësve u kërkohet të tregojnë për lojërat, ushqimet dhe pushimet që ata pëlqejnë.

Lojërat	Ushqimi	Pushimi
Futbolli, basketbolli Lojëra nga telefoni	Peshku, vezët, pizza Ushqime të shpejta	Pas çdo loje, pasi të mbaroj detyrat, Kur mbaron bateria e telefonit

Veprimet në situatë

Hapi 1. Njihen nxënësit me temën e mësimit. ▼

Hapi 2. Parashikim mbi bazën e titullit

Shkruajmë në tabelë titullin e tregimit që do të mësojmë.

Lexohet titulli dhe nxiten të tregojnë se cilët janë tre miqtë e Dimalit.

Pasi mendohen për disa çaste, dëgjohen disa nxënës.

Hapi 3. *Veprimtari me lexim –mendim të drejtuar VLMD*

Lexohet teksti me ndalesa. Pas çdo pjese drejtohen pyetje rreth përmbajtjes dhe parashikimit të ngjarjes në vijim.

Ndalesa 1. Pas leximit bëjmë pyetjet rreth pjesës së lexuar.

- *Me kë bisedonin gjyshërit në telefon?*
- *Çfarë i blenë gjyshërit për ditëlindje?*
- *Çfarë do të ndodhë në vazhdim? Po me telefonin?*

Vazhdohet me leximin e pjesës tjetër nga një nxënës tjetër.

Bëjmë pyetjet:

- *A ndodhi ashtu si menduat?*
- *Vazhdoi të fliste Dimali me gjyshërit?*
- *Çfarë i thanë prindërit dhe mësuesja?*
- *Po me mësime, si ishte Dimali?*

Ndalesa 3:

- *Çfarë veproi prej asaj dite Dimali?*

- *Cilët ishin tre miqtë e mire të tij?*
- *Çfarë porosie do t'i jap mami Dimalit?*

Ndalesa 4:

Lexohet pjesa e fundit e tregimit.

- *A ndodhi ashtu si menduat*
- *Çfarë porosie tjetër i dha mami Dimalit?*

Diskutohen fjalë të reja që mund të kenë nxënësit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Hapi 4. Në tabelë shkruhet pyetja me mundësi të përgjigjjes: PO ose JO.

A duhet të përdorim telefonin shumë?

PO JO

Sipas përgjigjeve që japin nxënësit ndahen në grupe dhe ndërmjet tyre zhvillohet një diskutim. Në këtë diskutim mund të angazhohet edhe grupi i pavendosur, nëse ka.

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit.
- Leximin me intonacion.
- Shfaqjen e interesit dhe dëshirës për të lexuar.
- Diskutimit rreth përdorimit të teknologjisë.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Të shkruajnë tri fjali për lojën, ushqimet dhe pushimin.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 2.3; 2.5; 3.1	
Njësia mësimore: Tre miqtë e Dimalit (ora II)			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Plotëson diagramin sipas kërkesave të dhëna;
• Lexon me intonacion;
• Tregon përmbajtjen duke u bazuar në pyetjet e parashtruara;
• Shkruan fjali sipas kërkesave të dhëna.</td><td>Fjalë kyçe: telefoni, mami, miqtë
Teknika dhe strategji:
• Diagrami i Venit
• Ruaje fjalën e fundit për mua
• Pyetje - përgjigje
• Shkrim i lirë</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të telefonit apo mjeteve të tjera, fletë A4.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Hapi 1. Vizatohen në drrasë të zezë dy rrathë të mëdhenjë të ngjitur në mes veti. Nxënësit udhëzohen që në rrethin e majtë do të shkruajnë për temën 1 (lojërat në park), ndërsa në rrethin në të djathtë për temen 2 (telefoni). Ndërsa, në lidhjen në mes dy rrathëve shkruhen të përbashkëtat e dy temave.
Hapi 2. Lihen nxënësit të lexojnë në heshtje për disa minuta tregimin. Në varësi të numrit të nxënësve në klasë mësuesja bën leximin e tregimit në zinxhir.
Hapi 3. Nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit të përcaktohen për një apo më shumë pjesë që për ata janë më interesante.
Pjesët e zgjedhura shkruhen në një fletë, ndërsa, në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për citatin (pse e ka zgjedh atë pjesë, cili është mesazhi, rendësia etj.).
Njëri nga nxënësit e tregon faqen ku e ka zgjedhë pjesën, e lexon atë, ndërsa tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit.
Pas leximit, nxënësit e tjerë diskutojnë rreth pjesës së zgjedhur.
Në fund të diskutimit nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentin për atë citat.
E njëjta ecuri e leximit të pjesëve praktikohet edhe tek nxënës të tjerë.</td></tr>
</table>

- ***Demonstrim i rezultateve të arritura***

Hapi 4: Diskutim rreth përmbajtjes.

- *Kush ia bleu telefonin Dimalit?*
- *Si e përdori Dimali telefonin?*
- *Për cilët miq i foli Vesa?*
- *Çfarë bëri Dimali prej asaj dite?*
- *Cila ishte porosia që i dha nëna atij?*

Hapi 5. Nxënësit në mënyrë individuale vazhdojnë shkruajnë fjalitë e filluara.

Aktivitet Fiziku_____

Ushqim Miri_____

Gjumë Pushimi_____

Vlerësohen nxënësit për:

- Plotësimin e diagramit me kërkesat e dhëna.
- Leximin me intonacion.
- Komentimin e pjesës së përzgjedhur;
- Shkrimin e fjalive sipas kërkesave të dhëna.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruaj tri fjalitë që të pëlqyen më shumë në këtë pjesë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Sinonimet Antonimet Hiperbola Krahasimi Personifikimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon kuptimin elementar të sinonimeve dhe antonimeve; Identifikon pjesët (shprehjet) tepër të zmadhuara të qenieve, sendeve a tipareve të tyre;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.7; 3; 8	
Njësia mësimore: Fjalë me kuptime të ndryshme			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Lidh me shigjetë fjalët që kanë kuptim të përafërt dhe të kundërt.
• Formon fjali me fjalët me kuptim të kundërt dhe të përafërt.
• Shkruan fjali me fjalët me kuptim të kundërt dhe të përafërt.</td><td>Fjalë kyçe:
vajzë, çupë, cucë, natë – ditë.
Teknika dhe strategji:
• lojë
• Punë në grupe
• Punë në dyshe</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi (ilustrime), fisha me fjalë etj.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi.
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake:
Hapi 1. Mësimi fillon me një lojë ku nxënësit luajnë në dyshe.
Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që të luajnë me fjalë. Njëri nxënës do të thotë një fjalë kurse tjetri do të mundohet të gjejë fjalën e përafërt me të.
Ja një shembull:
vajzë – cucë
djalë - çun
kalamaj – fëmijë
Mësimdhënësi shkruan në tabelë fjalët që kanë përdorur nxënësit.
Hapi 2. Vazhdohet me lojën e fjalëve. Njëri nxënës do të thotë një fjalë kurse tjetri do të thotë të kundërtën e asaj fjale ose veprimi.
lexoj – shkruaj
ditë – natë
dal – hyj
Mësuesja i shkruan foljet në dërrasë të ndara në dy shtylla.
Veprimet në situatë
Hapi 3. Hapen fletoret e punes së abetares. Kërkohet nga nxënësit të lidhin fjalët sipas kërkesës së dhënë.
Hapi 4. Nxënësve u kërkohet të formojnë e më pas të shkruajnë dy fjali me kuptim të përafërt.
Ja një shembullë:</td></tr>
</table>

- *Lorita hapi derën e makinës.*
- *Arbeni çeli derën e makinës.*

Lexohen disa nga fjalitë e shkruara.

Hapi 5. Lexohet kërkesa për detyrën e radhës dhe duke u bazuar edhe në ushtrimin në fillim të orës, nxënësit do të lidhin me shigjetë fjalët me kuptim të kundërt.

Hapi 6. Lexohet kërkesa për detyrën e radhës. Formohen dhe më pas shkruhen dy fjali me kuptim të kundërt. Ja një shembull:

- Djali mbylli derën.
- Vajza hapi derën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 6. Nxënësit punojnë në dyshe. Mësimdhënësi shpërndan fletët e përgatitura me detyra rreth fjalëve me kuptim të njejtë dhe të kundërt.

Nxënësit gjejnë fjalët me kuptim të kundërt dhe të njejtë.

Mbush gotën. **-** Zbraz gotën

Fik makinën. **–** ndez makinën.

Vlerësohen nxënësit për:

- Lidhjen e saktë me fjalët antonime dhe sinonime.
- Formimin e fjalive me fjalët e dhëna.
- Shkrimin e saktë dhe sipas rregullave drejtshkrimore të fjalive.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruaj 5 fjalë antonime dhe 5 fjalë sinonime.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.2; 2.3; 2.5; 3.1	
Njësia mësimore: Edhe unë di të bëj gol (ora I)			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante. • Përgjigjet në pyetjet rreth përmbajtjes së tekstit. • Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon. • Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet	**Fjalë kyçe**: futbolli, stërvitje, loja, goli, babi, fotografia **Teknika dhe strategji:** • Stuhi mendimi • Lexim i drejtuar • Pyetje – përgjigje • Ditari dypjesësh
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto ose ulustrime të lojës së futbollit.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukata fizike, sportet dhe shëndeti **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Globalizimi dhe ndërvarësia

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësuesja fton nxënësit të mendojnë për lojën e futbollit. Bëjnë stuhi mendimesh për këtë lojë.

Hapi I. Me ndihmën e videoprojektorit paraqesim disa foto që lidhen me këtë sport. Përshkruajmë dhe komentojmë figurat.

Veprimet në situatë

Hapi 2. Mësuesja fton nxënësit të lexojnë pjesën sipas paragrafëve. Për secilin paragraf nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe fjalë e fjali që u pëlqejnë. Mësuesja drejton pyetje për secilin paragraf.

Ja një shembull:

- *Sa muaj u stërviti?*
- *Sa orë në ditë ushtronte?*
- *Sa pale atlete kishte grisur? Po bluza?*

Bëjmë parashikime për përmbajtjen e paragrafit pasues.

- *Kush mendoni se po ushtronte?*

Hapi 3. Lexim zinxhir i tekstit nga secili nxënës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 4. Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”në të cilën nxënësit zgjedhin përgjigjen e saktë tek alternativat për brendinë e pjesës.

Ky tregim bën fjalë për: ***një vajzë.*** *një djalë.*

Vajza: ***shënoi gol.*** *nuk shënoi gol.*

Hapi 5. Diskutim

- *Si e kuptoi vajza që babai e kishte parë ndeshjen?*

Hapi 6. Nxënësit kopjojnë në njërën anë të fletës pjesën e cila u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje, nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e saktë të tekstit.
- Përgjigjet e dhëna për pjesën e lexuar.
- Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon.
- Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Të shkruajnë disa fjali për rregullat e futbollit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.2; 2.3; 2.5; 3.1	
Njësia mësimore: Edhe unë di të bëj gol (ora II)			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Shpreh mendimin e tij për lojën e futbollit; • Shkruan fjalë dhe fjali që tregojnë veprim. • Përgjigjet për brendinë e tekstit sipas pyetjeve të dhëna. • Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar			**Fjalë kyçe**: futbolli, stërvitje, loja, goli, babi, fotografia **Teknika dhe strategji:** • Lexo, përmblidh në dyshe, • Punë individuale, • Punë në çift, • Punë në grup, • Punë me gjithë klasën	

Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto ose ulustrime të lojës së futbollit.	**Lidhja me fushat e tjera:** Edukata fizike, sportet dhe shëndeti **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Globalizimi dhe ndërvarësia

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Mësimi fillon me bisedën rreth dëshirave të nxënësve për ta luajtur ose jo lojën e futbollit.

- *Pse ju pëlqen apo nuk ju pëlqen loja e futbollit?*

Veprimet në situatë

Hapi I. Kërkohet nga nxënësit të punohet në dyshe. Njëri nxënës lexon një paragraf dhe tjetri e përmbledh me 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për paragrafin në vazhdim.

Hapi 2. Paraqitet kubi dhe zbulojmë katër faqet e tij. Në secilën nga 4 faqet e kubit shkruhet nga një pyetje. Pastaj hudhet kubi dhe cila faqe të bije, trajtohet ajo pjesë apo ai problem.

PËRSHKRUAJE – Çfarë bëri vajza para ndeshjes?
KRAHASOJE - Krahasoje një lojë tjetër me lojën e futbollit?
ZBATOJE – Si luhet loja futbollit?
ARSYETOJE – Pse vajza nuk kishte dëshirë të vinte babi në ndeshje ?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 3. Punohet rubrika ‘’ Shkruaj’’.

Nxënësve u kërkohet të nënvizojnë dhjetë fjalë që tregojnë veprim dhe më pas të shkruajnë tri fjali me fjalët e nënvizuara.

Hapi 4. Nxënësve u kërkohet të gjejnë në tekst dhe shkruajnë fjalinë që tregon se babi e kishte parë ndeshjen.

Hapi 5. Nxënësit do të ndahen në tri grupe.

- *Grupi i pare do të shkruaj për futbollin.*
- *Grupi i dytë do të shkruaj për basketbollin.*
- *Grupi i tretë do të shkruaj për volejbollin.*

Bëjmë prezantimin e punës në grupe.

Vlerësohen nxënësit për:

• Shprehjen e mendimeve për lojën e futbollit. • Nënvizimin dhe shkrimin e fjalive që tregojnë veprim. • Përgjigjet për pyetjen e dhëna • Punën në grup.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruaj disa fjali për një sport që të pëlqen.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Shenjat e pikësimit,			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Përdorë drejt shenjat e pikësimi: pikën, presjen, pikëpyetjen, pikëçuditjen etj.;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.4; 2.3; 2.5; 3.7;3.8	
Njësia mësimore: Pika dhe pikëpyetja			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Vendos shenjat e pikësimit sipas llojit të fjalisë. • Shkruan fjali dëftore dhe pyetëse. • Diskuton rreth shenjave të pikësimit që ka vendosur.			**Fjalë kyçe**: (.) pika, (?) pikëpyetja **Teknika dhe strategji:** • Diskutim • Punë e pavarur • Punë në grupe • Punë në dyshe	
Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi (ilustrime), fisha me fjalë etj.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës**,** Artet, shoqëria dhe mjedisi. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:**	

	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake:

Hapi 1. Mësimi fillon duke shkruar në tabelë dy fjali nga mësimdhënësi.

- *Në cilën klase je ti*
- *Unë jam në klasën e parë*

Kërkohet nga nxënësit të japin mendimet e tyre se cilat shenja të pikësimit duhet vendosur në fund të fjalisë dhe çfarë fjali janë.

Në cilën klase je ti? (pikëpyetje – fjali pyetëse)

Jam në klasën e pare. (pikë – fjali dëftore)

Veprimet në situatë

Hapi 2. Vendos pikën aty ku duhet.

Hapen librat e nxënësve dhe lexohet kërkesa e dhënë në ushtrimin e pare.

Nxnënësit lexojnë fjalitë dhe në katrorët e zbrazët vendosin shenjën e pikësimit që lidhet me atë fjali.

- *Mësuesja shkruan në tabelë.*
- *Nxënësit e ndjekin me vëmendje.*
- *Të gjithë kanë dëshirë për të mësuar.*
- *Ora e mësimit kalon pa u ndier.*

Diskutohet me nxënës rreth shenjave që ata kanë vendosur.

Fjalitë me të cilat tregojmë, mbarojnë me pikë.

Hapi 4. Vendos pikën dhe pikëpyetjen aty ku duhen.

Nxënësit lihen të lexojnë fjalitë. Kërkohet të vendosin shenjat e pikësimit në katrorët e zbrazët.

Diskutohet rreth shenjave që ata kanë vendosur dhe lexojmë rregullën për fjalitë pyetëse:

- *Fjalitë me të cilat pyesim, mbarojnë me pikëpyetje.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 6. Shkruaj dy fjali që pyesin dhe dy fjali që tregojnë për figurën.

Nxënësit shkruajnë dy fjali që tregojnë dhe dy fjali pyetëse duke u bazuar në foton e dhënë në libër.

Ja një shembull:

Matini i bie gitares. *Çfarë po bën Olsa?* **Vlerësohen nxënësit për:** • Diskutimeve rreth shenjave të pikësimit. • Vendosjen e saktë të shenjave të pikësimit sipas llojit të fjalisë. • Shkrimin e saktë të fjalive treguese dhe pyetëse. • Bashkëpunimit në dyshe dhe në grup.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruaj me shkronja të dorës fjalitë që tregojnë dhe fjalitë pyetëse që ke shkruar në libër.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1	
Njësia mësimore: Akuariumi (ora I)			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Parashikon përmes fotove titullin e tekstit të ri. • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion. • Dallon emrat e përgjithshëm në tekst • Përgjigjet në pyetjet rreth përmajtjes së tekstit.			**Fjalë kyçe**: akuarium, peshq, lum, det, oqean. **Teknika dhe strategji:** • Stuhi mendimi • Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve • Lexim i drejtuar • Diskutim rreth përmbajtjes	
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të ndryshme të kafshëve.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi.	

	Lidhja me temat ndërkurrikulare Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Shfaqim para nxënësve foto të disa kafshëve përmes videoprojektorit. Kërkojmë nga nxënësit të tregojnë për vendbanimet e tyre.

Ja një shembull:

- *Ku jeton pula?*
- *Si quhet shtëpia e qenit?*
- *Ku jeton peshku?*

Diskutohet për mundësitë e tjera të këtyre vendbanimeve siç janë kopshtet zoologjike, parqet natyrore etj.

Parashtrojmë pyetjen për peshqit.

- *Po peshqit ku mund t'i mbajmë?*

Veprimet në situatë

Hapi 1. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve

Nxënësit hapin librin dhe lihen për një çast të shikojnë figurat.

Lexohet titulli dhe nxiten të tregojnë se çfarë dine për akuariumet.

Mendimet e nxënësve mësimdhënësi i shkruan në tabelë.

Hapi 3. Nxënësve u kërkohet të lexojnë pjesën dhe të nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë.

Pas leximit të tekstit i shpjegojmë ato.

Pjesa e parë:

- *Si filloi teksti?*
- *Cila gjë ju bëri përshtypje më shumë nga pjesa e lexuar?*
- *Përshkruajeni akuariumin me një fjali?*
- *Si janë akuariumet?*
- *A keni pare ndonjëherë akuarium?*

Vazhdohet edhe me pjesët e tjera.

Në fund diskutohet pyetja:

- *Çfarë janë fjalët me ngjyrë të gjelbërt?*

Shkruajmë edhe disa lloje të peshqëve në tabelë.

Lexim zinxhir nga secili nxënës

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Hapi 3. Diskutim rreth përmmbajtjes së tekstit. Kërkohet nga nxënësit të lexohet në heshtje teksti dhe të përgjigjen në pyetjet tek rubrika ‘’Lexoj dhe kuptoj’’.

- *Çfarë është akuariumi?*
- *Si janë peshqit që jetojnë në akuariume të mëdha?*
- *Ku mbahen akuariumet e vogla?*
- *A duhet të tregohet kujdes për to?*

Vlerësohen nxënësit për:

- Parashikimin e ngjarjes mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve.
- Leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion.
- Gjetjen e emrave të përgjithshëm në tekst.
- Përgjigjet e sakta rreth përmbajtjes së tekstit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Së bashku me prindërit shikoni në internet video të akuariumeve të ndryshme në botë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.4; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 2.5; 3.1;3.4	
Njësia mësimore: Akuariumi (ora II)			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit orës mësimore: Nxënësi: • Tregon rreth gjetjeve që ka bërë për akuariumet. • Ndan fjalët në rrokje. • Shkruan fjali me emrat e peshqëve. • Vizaton lloje të ndryshme të peshqëve.			**Fjalë kyçe**: akuarium, peshq, lum, det, oqean. **Teknika dhe strategji:** • Stuhi mendimi • Diskutim • Punë dyshe • Punë e pavarur	

	• Vizatim
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të ndryshme të kafshëve.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi. **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Diskutojmë rreth detyrës së shtëpisë dhe gjetjeve që kanë bërë nxënësit për akuariumet.

Shënojmë mendimet e nxënësve në tabelë.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Diskutojmë rreth pyetjeve në rubrikën ‘’ Diskutojmë’’.

Nxënësit japin mendimete e tyre për pyetjet:

- *A keni dëshirë të mësoni më shumë për akuariumet? Çfarë?*
- *A ju pëlqen të keni një akuarium në shtëpi? Si do të kujdeseshit për të?*

Hapi 2. Nxënësve u kërkohet të nënvizojnë fjalët me ngjyrë të gjelbërt në tekst. Fjalët e nënvizuara ndahen në rrokje sipas shembullit të dhënë tekst.

Pas leximit të rrokjeve për secilën fjali të ndarë, nxënësve u kërkohet të vizatojnë peshqit sipas fotografive të dhëna në tekst.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura.

Hapi 3. Nxënësve u kërkohet të plotësojnë emrat e peshqëve në tekstin e tyre dhe më pas edhe të shkruajnë nga një fjali me secilin emër të peshqëve.

Ja një shembull:

Trofta është peshk i ujërave të ëmbla.

Vlerësohen nxënësit për:

- Ndarjen e fjalëve me saktësi në rrokje.
- Shkrimin e fjalive për peshqit.
- Vizatimin e peshqëve.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Të shkruhet një tekst i shkurtë rreth peshqëve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Fjala, fjalia...			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3;III.2; III.4			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.2;3.5; 3.7;3.8	
Njësia mësimore: Zhvendosim fjalë në fjali			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Rendit sipas rendit logjik fjalët për të krijuar fjali. • Ndryshon vendin e fjalëve në fjali • Lexon me intonacion fjalitë. • Shkruan fjali nga fjalët e dhëna.			**Fjalë kyçe**: etiketa, fjalë, fjali **Teknika dhe strategji:** • Copëzat e përziera • Punë e pavarur • Punë në grupe	
Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi (ilustrime), fisha me fjalë etj.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi. **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
Organizimi i orës së mësimit ***Veprimtari paraprake:*** ***Hapi 1.*** Mësimdhënësi shkruan në tabelë fjalinë e cila nuk është e renditur si duhet. Kërkohet nga nxënësit të formojnë fjali me fjalët e dhëna. *ngjyrosën fëmijët në orën flamurin e vizatimit.* Fëmijët ngjyrosën në orën e vizatimit flamurin.				

Në orën e vizatimit fëmijët ngjyrosën flamurin. ***Veprimet në situatë*** **Hapi 2**. Mësimdhënësi ka përgatitur etiketa me fjalë. Secilit grup i shpërndahen etiketat të cilat nxënësit duhet ti rendisin për të fituar fjalinë. Pas përfundimit të kohës së paraparë për këtë veprimtari, secili grup prezanton detyrën e tyre dhe tregon renditjet e mundshme që ata kanë gjetur për etiketat e dhëna. Lexohen fjalitë e krijuara. Pjesët e fjalisë mund të ndërrojmë vendin pa e prishur kuptimin. **Hapi 4.** Hapen librat dhe plotësohen fjalët që mungujnë në fjalitë e dhëna në tekst. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura** **Hapi 6.** Punë në grupe Nxënësit ndahen në grupe me nga 4 mxënës. Secili grup krijon nga dy fjali me fjalët e dhëna. Lexohen fjalitë e secilit grup dhe diskutohet për fjalitë dhe renditjen e tyre. **Vlerësohen nxënësit për:** • Renditjen e etiketave dhe krijimin e fjalive. • Leximin e saktë dhe me intonacion të fjalive. • Ndryshimin e vendit të fjalëve në fjali. • Shkrimin e fjalive sipas etiketave të fjalive.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Shkruaj 3 fjali dhe ndrysho vendin e fjalëve në fjali.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Gjëegjëza Fjalët e urta			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Dallon formën e përrallëzës, përrallës, tregimit, gjëegjëzës, fjalëve të urta urimeve, shënimeve personale, mesazheve etj.;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2; III.4			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.1; 2.2; 3.3; 3.5	
Njësia mësimore: Fjalë të urta dhe gjëegjëza			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon me intonacion fjalët e urta dhe gjëegjëzat.
• Tregon kuptimin e fjalëve të urta.
• Gjen zgjidhjen e gjëegjëzave të treguara nga të tjerët.</td><td>Fjalë kyçe: fjalë të urta, gjëegjëza
Teknika dhe strategji:
• Stuhi mendimi
• Lexim i drejtuar
• Punë në grupe</td></tr>
<tr><td>Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, videoprojektor.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Shkruajmë në tabelë një fjalë të urtë.
Ku ka bletë, ka edhe mjaltë.
Kërkojmë nga nxënësit të japin mendimet se si e kuptojnë fjalinë.
Veprimet në situatë
Hapi 1. Njihen nxënësit me temën e re.
Lexohen fjalët e urta në tekst dhe diskutohet me gjithë nxënësit.
Nxjerrim përfundimin se fjalët e urta na japin këshilla.
Hapi 2. Lexohen dy ushtrimet e dhëna në tekst. Kërkohet nga nxënësit që të tregojnë se si e kuptojnë rastin e pare dhe cila nga fjalët e urta i përshtatet më shumë tekstit të dhënë.
Me ndihmën e videoprojektorit shfaqim edhe disa fjalë të urta e të cilat gjenden në vegëzën:
https://shqip.info/120-fjale-te-urta-shqipe/
Hapi 3. Lexojmë gjëegjëzat e dhëna në tekst. Kërkohet nga nxënësit të gjejnë përgjigjet se çfarë fshihet pas fjalëve.
Gjëegjëzat fshehin përmes fjalëve diçka që duhet ta gjejmë.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 4. Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup do të tregojë një gjëegjëzë, kurse grupi tjetër do të mundohet të gjejë se çfarë fshihet pas fjalëve të dhëna.</td></tr>
</table>

Nëse nxënësit nuk arrijnë të formojnë gjëegjëza, mësimdhënësi ndihmon duke u prezantuar ato me videoprojektor (ose në letër). Gjëegjëzat mund të gjinden në vegëzën: https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=rDrfsKËbOzg&ab_channel=PerrallaShqip **Vlerësohen nxënësit për:** • Leximin me saktësi dhe intonacion të fjalëve të urta dhe gjëegjëzave. • Kuptimin e fjalëve të urta. • Tregimin dhe gjetjen e gjëegjëzave në grup.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Të shkruajnë tri fjalë të urta dhe tri gjëegjëza.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data:**
Tema mësimore: Fjalia Shenjat e pikësimit Intonacioni			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdorë drejt shkronjat;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.3; I.5; III.2			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 2.2; 3.6; 3.7	
Njësia mësimore: Shtojmë dhe heqim fjalë në fjali			**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Dollon fjalinë më të vogël; • Formon fjali me fjalët e dhëna; • Shkruan fjali duke hequr fjalë.			**Fjalë kyçe**: Fjali, zgjerim, shkurtim **Teknika dhe strategji:** • Loja me fjalë • Punë e drejtuar • Shkrim i drejtuar.	
Burimet e informacionit dhe mjete: fletore pune e abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotografi (ilustrime), fisha me fjalë etj.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi.	

	Lidhja me temat ndërkurrikulare Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake:

Hapi 1. Mësimdhënësi ka përgatitur etiketa me fjalë. Nxirren nxënësit duke marrë dy etiketa për të formuar fjali.

Fjalitë paraqiten para klasës.

Mira shkruan.

Nili lexon.

Roi punon.

Mondi luan.

Kërkohet nga nxënësit që fjalitë më të vogla të zgjerojnë edhe me fjalë të tjera.

Roi punon në kompjuterin e babit.

Mondi luan me shokët në oborrin e shkollës.

Veprimet në situatë

Hapi 2. Shkruajmë në qendër të tabelës fjalën Jani. Kërkojmë nga nxënësit të formojnë fjali të vogla.

Fjalia duhet të ketë kuptimin e plotë.



Hapi 3. Hapet teksti. Lexohen fjalitë dhe dallojmë ndryshimin.

Fjalia e pare është e vogël, kurse fjalitë tjera janë më të gjata dhe i kemi zgjeruar me fjalë të tjera.

Hapi 4. Në ushtrimin e radhës, nxënësit zgjerojnë fjalinë e vogël përmes pyetjeve.

Ja një shembull:

Emi ha (Çfarë?) *mëngjesin* (Kur?) *në ora 8.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 5. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë dhe të shkruajnë fjalitë duke hequr fjalët me ngjyrë të kuqe.

Ne vizitojmë gjyshen çdo të diel. Ne vizitojmë gjyshen.

Ne vizitojmë gjyshen. Ne vizitojmë gjyshen.

Bruna luan me Besën çdo ditë. Bruna luan me Besën.

Bruna luan me Besën. Bruna luan.

Vlerësohen nxënësit për:

- Dallimin e fjalive më të vogla.
- Zgjerimin e fjalive të vogla.
- Shkrimin e fjalive duke hequr fjalët me ngjyra.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruani 5 fjali të vogla dhe zgjeroni ato.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**

Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi	**Rezultati i të nxënit të temës:** • Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij; • Përshkruan rrezikun nga dukuritë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu;
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1;I.2; I.3;1.6; III.2; III.3	**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 3.5;3.6
Njësia mësimore: Në park (ora I)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.
Rezultatet e të nxënit orës mësimore: Nxënësi: • Përshkruan figurat nga teksti. • Gjen përgjigjen e saktë nga zarfi. • Shkruan fjali sipas termave të dhëna.	**Fjalë kyçe**: lule, lulishtare, lodra, kujdes. **Teknika dhe strategji:** • Lojë • Punë dyshe • Stuhi mendimi • Imagjinatë e drejtuar • Një rri / Tre ikin

Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotë të luleve. foto të parqeve, etiketa.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës**,** Arte, shoqëria dhe mjedisi. **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për paqe

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxënësve u shpërndahet një zarf ku janë të vendosura shkronjat e fjalës PARKU.

Nxënësve u kërkohet të formojnë fjalën me shkronjat të cilat gjenden në zarf.

Lexohet fjala e formuar nga disa dyshe të nxënësve.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Kërkohet nga nxënësit të vërejnë figurën në librat e tyre.

- *Çfarë shihni?*

Mësimdhënësi kërkon që njerëzve që janë në figurë mund t'u vënë emra.

Ja një shembull:

- *Troi vozit biçikletën.*
- *Mia dhe Lio këpusin lulet.*
- *Melisa vrapon në park.*
- *Ajana shikon shokët e saj duke luajtur.*

Hapi 2. Imagjinatë e drejtuar

Mësimdhënësi parashtron pyetjet:

- *Keni qenë në park?*
- *A dëshironi të shkojmë bashkë?*

Nxënësve u kërkohet të mbyllin sytë duke vendosur kokën mbi duart e tyre.

Mësimdhënësi fillon leximin e tregimit.

Tregimi do të lexohet ngadalë dhe me intonacionin e një përralle.

Gjatë leximit do të tregoj edhe për fjalët e panjohura.

Nxënësit hapin sytë dhe diskutohet për përshtypjet e tyre rreth pjesës së lexuar.

Hapi 3. Një rri ? Tri ikin

Nxënësit ndahen në grupe me katër nxënës. Secili grup do të marr 4 zarfe me nga një pyetje dhe katër përgjigje, ku njëra nga to është e saktë.

Ja një shembull:

Ku shkuan Olti, Shendi dhe Jona?

Përgjigjet:

- *Olta, Shendi dhe Jona shkuan në parkun e shkollës.*
- *Në parkun e qytetit.*
- *Në parkun e lagjes.*
- *Në parkun nacional të Mirushës.*

Kështu vazhdohet edhe me tri pyetjet dhe përgjigjet e tjera.

Hapi 4. Diskutohet në grup për përgjigjet e sakta të pyetjeve të dhëna në zarf.
Zgjedhin pyetjet e sakta dhe etiketat futen në zarf.

Tre nxënës nga grupi largohen në grupet e tjera (njëshi tek dyshi, dyshi tek treshi, treshi tek katërshi).

Nxënësit e mbetur në grup u shpjegon nxënësve të ardhur në grup për përgjigjet e që ata kanë dhënë.

Nxënësit kthehen në grupet e tyre dhe diskutojnë edhe një herë përgjigjet e tyre dhe plotësojnë nëse ka nevojë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Shënohen në tabelë fjalët: park, lule, kujdes, lulishtarja. Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë katër fjali me fjalët e dhëna.

Vlerësohen nxënësit për:

- Përshkrimin e figurës dhe përdorimit të emrave të përveçëm.
- Përgjigjjeve të sakta nga pyetjet nga zarfi.
- Shkrimin e fjalive sipas termave të dhëna.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Shkruaj një tekst të shkurtë rreth kujdesit në park.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Poezia Përrallëza Përralla Tregimi			**Rezultati i të nxënit të temës:** • Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtra për jetën dhe dëshirat e tij; • Përshkruan rrezikun nga dukuritë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu;	
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1;I.2; I.3;1.6; III.2; III.3			**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.3; 3.4; 3.5	

Njësia mësimore: Në park (ora II)	**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi: • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion tregimin. • Diskuton rreth kujdesit të natyrës • Zbaton rregullat për kujdesin ndaj natyrës. • Vizaton një park.	**Fjalë kyçe**: lule, lulishtare, lodra, kujdes. **Teknika dhe strategji:** • Harta e koncepteve • diskutim • MarrëdhënjaË pyetje - përgjigje • Shkrim i lirë
Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, fotë të luleve. foto të parqeve, etiketa, fletë A4.	**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës**,** Arte, shoqëria dhe mjedisi. **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për paqe

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Vendoset fjala Parku në mes të tabelës dhe plotësojmë me fjalë dhe fjali nga teksti i lexuar.

Plotësohet harta e koncepteve me gjithë klasën.



Veprimet në situatë

Hapi 1. Lexohet teksti zingjir nga gjithë nxënësit.

Diskutohet rreth pyetjeve në rubrikën'' Lexoj dhe kuptoj''.

Hapi 2. Diskutim

Diskutohet me nxënës për pyetjet e parashtruara në rubrikën ''Diskutojmë''.

Hapi 3. Plotësohet rubrika '' Shkruajmë''.

Nxënësve u kërkohet të nënvozojnë fjalët që u tha lulishtarja.

Shkruajnë fjali të cilat do të duhej të zbatojnë fëmijët rreth kujdesit në park.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 4. Nxënsve u shpërndahen fletë t bardha të vizatimit ku do të vizatojnë një park sipas rregullave të caktuara tek posteri ‘’Miq të natyrës’’. **Vlerësohen nxënësit për:** • Leximin e saktë dhe me intonacion. • Diskutimeve rreth përmbajtjes së tekstit. • Zbatimit të rregullave për natyrën. • Vizatimin e parkut sipas rregullave të shkruara në poster.
Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme: Të shkruaj rregulla të tjera rreth zbatimit të rregullave për mbrojtjen e natyrës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla**:1	**Klasa**1	**Data:**
Tema mësimore: Fjala Fjalia Shenjat e pikësimit Intonacioni Foljet ndihmëse kam dhe jam Emri, mbiemri përemri		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Lexon tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse. • Kupton, dallon dhe përdorë drejtë emrin, mbiemrin dhe përemrin; • Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit;		
Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; III.2. III.4; III.5; III.6		**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.3; 3.5;3.6;3.7		
Njësia mësimore: Vlerësim përmbledhës 3		**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.		
Rezultatet e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: • Lexon kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme. • Rendit fjalët për të formuar fjali. • Shkruan me shkronja dore alfabetin e gjuhës shqipe. • Përgjigjet pyetjeve me fjali të plota. • Shkruan emra njerëzish, kafshësh e sendesh. • Përshkruan cilësitë e mamit.		**Fjalë kyçe:** mami, Jona, Drini, fëmijët, park **Teknika dhe strategji:** ❖ Diskutim rreth njohurive paraprake ❖ Vëzhgo-Analizo ❖ Punë individuale		

Burimet e informacionit dhe mjete:	**Lidhja me fushat e tjera:**
njohuritë paraprake të nxënësve, fletë testimesh të përgatitura, shkronjat kolektive.	Matematikë, Arte, Shkencat e natyrës **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Hapi 1. Njihen nxënësit me temën dhe u rikujtohet se çfarë është Testi, cili është qëllimi dhe rëndësia e tij.

U shpjegohen rregullat e sjelljes gjatë detyrës me shkrim dhe punës individuale.

Bëhet përsëritje e shkronjave të mësuara.

Veprimet në situatë

Hapi 2 . Vëzhgo-Analizo

U shpërndahen fletët e ushtrimeve të fotokopjuara më parë.

U ipen këshilla të qarta për çdo ushtrim.

Nxiten nxënësit të lexojnë vetë kërkesat.

Këshillohen ngadalë dhe saktë çdo etapë të ushtrimit duke i udhëzuar nxënësit.

Hapi 3. Punë individuale

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur detyrat e paraqitura.

Gjatë gjithë kohës vëzhgohen dhe u ofrohet ndihma e nevojshme sidomos atyre që shfaqin vështirësi.

Lexojnë kërkesat e ushtrimeve dhe udhëzohen të plotësojnë ato ushtrime që i dinë kurse ato që nuk i kuptojnë u kthehen prapë pasi t'i përfundojnë ato që iu duken më të lehta.

Nxënësit duhet të shkruajnë me shkronjat e shtypit ose të dorës, sipas dëshirës me përjashtim të ushtrimit 3, i cili duhet të plotësohet me shkrim dore.

Megjithatë është mirë që nxënësit të ushtrohen më shumë në punën me shkrim dore.

Ushtrimi i parë: Nxënësit plotësojnë: emrin, vendin ku jetojnë dhe emrin e nënës.

Ushtrimi i dytë: Renditin fjalët dhe formojnë fjalinë: *Nëna përqafoi Jonën.*

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë me shkronja dore alfabetin e gjuhës shqipe.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë përgjigjet e pyetjeve duke u bazuar në fotot e paraqitura. Udhëzohen të përgjigjen me fjali të plota.

Ushtrimi i pestë: Lexojnë tekstin e dhënë dhe më pas qarkojnë përgjigjen e saktë.

Ushtrimi i gjashtë: Shkruajnë nga dy emra njerëzish, kafshësh dhe sendesh.

Ushtrimi i shtatë: Shkruajnë nga katër fjalë të cilat tregojnë cilësi të mamit, pra tregojnë si është mami.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Mblidhen fletët, nxiten nxënësit të diskutojnë për vështirësitë dhe problemet që kanë pasur.

Mbahen shënime që të përmirësohen më tej.

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin e kërkesave të ushtrimeve në mënyrë të vetëdijshme.
- Renditjen e fjalëve për të formuar fjali.
- Shkrimin e alfabetit të gjuhës shqipe me shkronja dore.
- Përgjigjet e pyetjeve me fjali të plota.
- Shkrimin e emrave të njerëzve, kafshëve e sendeve.
- Përshkrimin e cilësive të mamit.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:
Shkruani alfabetin e gjuhës shqipe. Ngjyros me të kuqe zanoret.

Vlerësim i njohurive 3

Lënda: Gjuhë shqipe

KLASA: _____

1. Plotëso: — 5 pikë

Unë jam_____

Jetoj në _____

Mami im quhet_____

2. Rendit fjalët për të formuar fjali. — 4 pikë

Jonën | Nëna | përqafoi

_____

3. Shkruaj me shkronja dore alfabetin e gjuhës shqipe.Ngjyros me të kuqe zanoret. — 6 pikë

A			**Ç**		
		F			
	J				**M**
		O			

4. Shkruaj përgjigjet e pyetjeve: — 6 pikë

Çfarë po bën Drini?



_____

_____

Kush zhytet në det?



_____

_____

<table>
<tr><td>5.</td><td>Lexo tekstin e mëposhtëm.

Nxënësit e klasave të para u nisën në shëtitje në parkun e qytetit.
Ata ishin shumë të gëzuar. Rrugës deri në park ata këndonin këngën e Alfabetit.
Oh, sa ditë e bukur ishte!

Qarko përgjigjen e saktë:

1.Nxënësit shkuan në: a) në parkun e qytetit, b) në teatër; c) në fshat

2.Fëmijët ishin: a) të frikësuar; b) të gëzuar; c) të hutuar

3.Ata këndonin: a) këngën e Nënës; b) këngën e Shkollës; c) këngën e Alfabetit</td><td>6 pikë</td></tr>
<tr><td>6.</td><td>Shkruaj në tabelë:

<table><tr><td>Emra njerëzish</td><td>Emra kafshësh</td><td>Emra sendesh</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table></td><td>5 pikë</td></tr>
<tr><td>7.</td><td>Shkruaj katër fjalë që tregojnë cilësitë e mamit.

</td><td>5 pikë</td></tr>
</table>

Shkallët e vlerësimit	**Arritje e pakënaqshme**	**Arritje minimale**	**Arritje mesatare**	**Arritje e kënaqshme**	**Arritje e plotë**
Vlerësimi sipas pikëve	O-11	12-22	23-33	34-39	40-45
Mësusesi/ja i/ e klasës:					
Nënshkrimi i prindit:					

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1;I.2; I.3;1.6; III.2; III.3</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 3.4; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Takim i paharruar (ora I)</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• Lexon rrjedhshëm tekstin;
• Shkruan fjali për termat e dhënë;
• Rendit tekstin sipas rendit logjik;
• Ritregon pjesën e lexuar të tekstit;
• Këndon këngën në kor.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: Vlora, takim, valle, kostume, këngë, qytete,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Diskutim paraprak
• Stuhi mendimesh
• Dora e fshehtë
• Punë në grupe
• Marrëdhënie pyetje – përgjigje</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të të instrumenteve pupullore, veshje popullore.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Artet, shoqëria dhe mjedisi.
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Edukimi për paq</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake
Veprimtaria zhvillohet në dyshe. Paraqiten para nxënësve katër fjalë: Vlora, takuan, kostume, kënduan. Fjalët mund të shoqërohen edhe me foto ose vizatime. Nxënësve u kërkohet që në dyshe të shkruajnë katër fjali me fjalët e dhëna.
Ja një shembull:</td></tr>
</table>

- *Në Vlorë u ngrit flamuri.*
- *Erjoni dhe Shendi takuan shokët e tyre.*
- *Valbona kishte veshur një kostum pupullor.*
- *Lorita dhe Edona këndunan shumë këngë të bukura.*

Lexohen fjalitë e nxënësve.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Mësimdhënësi ka përgatitur për secilin grup zarfe me tregimin e ndarë në pjesë. Pjesët e tregimit nuk janë të renditura si duhet. Kërkohet nga nxënësit që të bashkojnë fletët dhe të formojnë tregimin.

Hapi 2. Nxënësit renditin tregimin sipas radhës. Më pas hapin librin dhe i vendosin numra paragrafëve. Secili grup nxjerr një përfaqësues që lexon tregimin e plotë ose mund të lexohet me radhë nga një paragraf sipas radhës, nga të gjithë pjesëtarët e grupit.

Shpjegohen fjalët dhe shprehjet e reja.

Hapi 3. Diskutohet rreth përmbajtjes së tregimit dhe përgjigjemi pyetjeve në rubrikën ‘’Lexo dhe diskuto’’.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Lexim zinxhir nga secili nxënës.

Hapi 4. Në fund do të këndojnë këngën ‘’ Xhamadani vija-vija ’’e cila gjendet në vegëzën:

https://www.youtube.com/ëatch?v=KAi6f7m5994&ab_channel=mariohysa

Vlerësohen nxënësit për:

- Leximin me intonacion dhe të bukur.
- Shkrimin e fjalive me termat e dhënë;
- Renditjen e tekstit sipa radhës së veprimeve,
- Dikutimin rreth përmbajtjes së tekstit;
- Këndimin e këngës.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Të shkruajnë disa emra të qyteteve dhe instrumenteve popullore.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla 1</td><td>Klasa 1</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="3">Tema mësimore:
Poezia Përrallëza Përralla Tregimi</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
• Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara;</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:
I.1;I.2; I.3;1.6; III.2; III.3</td><td colspan="2">Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
1.1; 1.4; 2.3; 3.4; 3.5</td></tr>
<tr><td colspan="3">Njësia mësimore:
Takim i paharruar (ora II)</td><td colspan="2">Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="3" rowspan="2">Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
Nxënësi:
• zbulon zgjidhjen e asocacionit;
• dikuton për qytetet, veshjet dhe instrumentet popullore;
• përshtat fjalët me tekstin e dhënë;
• ngjyros instrumentet dhe veshjet popullore.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: çifteli, tupan – daulle, fyell, veshje,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Teknika dhe strategji:
• Asociacioni
• Diskutim
• Gushkuqi rrethor
• Punë individuale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet e informacionit dhe mjete: Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të instrumenteve pupullore.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
Shkencat e natyrës, Artet, Shoqëria dhe mjedisi.
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Edukimi për paqe</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit
Veprimtari paraprake. Punë në grupe.
Me ndihmën e videoprojektorit, para nxënësve paraqesim asociacionin dhe kërkojmë zgjedhjen e tij. Së pari bëjmë hapjen e kolonave e në fund zbulojmë zgjedhjen përfundimtare. Fitues do të jetë grupi i cili zgjidh më shumë kolona dhe gjithashtu gjen përgjigjjen përfundimtare. Asociacioni ka të përfshirë brenda vetes instrumente popullore.
Ja një shembull:</td></tr>
</table>



Veprimet në situatë

Hapi 1.Kërkohet nga nxënësit të lexohet teksti i tregimit në heshtje.

Nxënësve u kërkohet të nënvizojnë qytetet e përmendura në tekst dhe të tregojnë nëse kanë ndonjë informacion.

Dikutohet për veshjet e paraqitura në foton e librit dhe cilat nga veshjet do të dëshironin të vishnin.

Hapi 2. ***Gushkuqi rrethor***

Me ndihmën e videoprojektorit, nxenesit i dëgjojnë me vëmendje dhe bëjne dallimin e instrumentit, duke e përcaktuar saktësisht ritmin e tupanit, fyellit, lahutës dhe çiftelisë. Gjithashtu, mësimdhënsi paraqet edhe disa veshje popullore.

-Kërkoj nga nxënësit të flasin rreth instrumenteve të mësipërme.

- *Shpjegon me fjalë të thjeshta se si janë ndërtuar instrumente dhe veshjet popullore.*
- *A ka nxënësi ne shtepi instrumente apo veshje popullore.*
- *Sa janë të përdorshme këto instrumente dhe veshje popullore nëpër dasmat shqiptare.*
- *Përshkruan njërin nga instrumentet apo veshjet popullore që i pëlqen.*

Te gjitha keto tema nxenesit bashke me mesuesen i diskutojne ne forme rrethore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Hapi 3. Plotësohet rubrika ‘’Shkruaj dhe ngjyros’’. Pas të kenë vendosur fjalët e duhura në vend të vizave, ngjyrosen instrumentet dhe veshjet popullore.

Vlerësohen nxënësit për:

- Gjetjen e zgjidhjeve për kolonat dhe përgjigjen përfundimtare.
- Diskutimeve në rreth reth pyetjeve të dhëna; ,
- Shkrimin e fjalëve për të plotësuar tekstin;
- Ngjyrosjen e vizatimeve.

Detyrë shtëpie: Nxënësve u sugjerohet detyra e mëposhtme:

Të punojnë një album me veshje dhe instrumente popullore.



Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Fjalë që tregojnë sende			**Situata e të nxënit:** Klasa ime	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi: • Dallon emrat që tregojnë sende. • Gjen emra që tregojnë sende. • Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore (*në mënyrë intuitive*). • Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.			**Fjalë kyçe**: oxhak, balonë, çadër, xhup, shall, libër **Teknika dhe strategji:** • Veprimtari në dyshe • Vëzhgo –Diskuto- Plotëso • Punë individuale	
Burimet e informacionit dhe mjete: Fletore pune, njohuritë paraprake të nxënësve, mjete shkrimi.			**Lidhja me fushat e tjera:** Shkencat e natyrës **Lidhja e me temat ndërkurrikulare**	

	Mjedisi

Organizimi i orës së mësimit

Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit të përshkruajnë klasën e tyre duke emërtuar çdo objekt që shohin.

- Si është klasa juaj?
- Ku i vendosni mjetet e punës?
- Çfarë ka në mure? Po në dritare? Etj.

Veprimet në situatë

Hapi 1. Veprimtari në dyshe

Në një fletë letre nxënësit do të shkruajnë emrin e një sendi që ndodhet në klasë, p.sh. dollap, tavolinë, laps, libër, etj. Lexohen emrat që kanë shkruar nxënësit dhe theksohet se këta emra tregojnë sende.

Nxiten ta shkruajnë emrin sipas modelit *libër-libri, dritare - dritarja.*

Në një tabelë të përbashkët shkruhen emrat e gjetur nga nxënësit.

i	**a**
libri	dritarja

Theksohet se emrat e shtyllës së parë janë emra mashkullorë, kurse emrat e shtyllës së dytë janë emra femërorë.

Hapi 2. Vëzhgo –Diskuto-Plotëso

Hapet Fletorja e punës në faqen 140 dhe udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e ushtrimeve.

Ushtrimi 1: Lexohen fjalët e dhëna dhe lidhen me figurat përkatëse.

Më pas shkruajnë vetëm fjalët që tregojnë sende: oxhak, balonë, çadër, xhup, shall, libër**.**

Ushtrimi 2: Në mënyrë individuale shkruajnë fjalët aty ku duhet duke ndjekur shembullin:

Mbarojnë me a - *dardha, domatja, molla.*

Mbarojnë me i – *speci, limoni, lapsi*

Në përfundim të ushtrimeve, diskutohet puna kolektivisht.

Hapi 3. Punë individuale

Në tregimin “Ditëlindja e Blinit” nënvizojnë emrat që tregojnë sende.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Gruponi emrat në tabelën e mëposhtme: *lugë, lepur, tryezë, kushëri, derë, nxënës, gjarpër, qengj, mami.*

njerëz	kafshë	sende

Vlerësohen nxënësit për:

- Dallimin e emrave që tregojnë sende.
- Gjetjen e emrave që tregojnë sende.
- Dallimin e emrave të gjinisë femërore nga ata mashkullore (*në mënyrë intuitive*).
- Demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.

Detyra shtëpie: Nxënësve u sugjerohen detyrat e mëposhtme:

-Shkruani 10 emra që tregojnë sende.

-Formoni fjali me dy prej tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla** 1	**Klasa** 1	**Data**
Tema mësimore: Vizatuesja e vogël, faqe 106 (ora I)			**Situata e të nxënit:** Kafshët	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi: • Parashikon se çfarë do të ndodhë mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve. • Lexon rrjedhshëm dhe me intonacion të duhur. • Përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e tekstit. • Shfaq interes dhe dëshirë për të lexuar. • Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.			**Fjalë kyçe**: vajza, mami, vizatimi **Teknika dhe strategji:** • Stuhi mendimi • Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve • Veprimtari me dëgjim – mendim të drejtuar (VDMD)	
Burimet e informacionit dhe mjete:			**Lidhja me fushat e tjera:**	

Teksti i Abetares, njohuritë paraprake të nxënësve, foto të kafshëve, mjete shkrimi.	Shkencat e natyrës, Arte **Lidhja e me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm